



Libra të tjerë nga Petro Zheji

Shqipja dhe Sanskritishtja (Pjesa I), 1996

Shqipja dhe Sanskritishtja (Pjesa II), 1996

***Albanian and Sanskrit* (Part I), 2011**

Libri i Aforizmave, 2012



Titulli i librit: **Roli Mesianik i Shqipes (shembja e Kullës së Babelit)**

Autori: **Petro ZHEJI**

Redaktor/Kurator: **Albjon BOGDANI**

46 / SCRIPTA MANENT

© 2015 Autori dhe UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr.9380, dt.28.04.2005 i Shtetit Shqiptar "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

uetpress@uet.du.al

www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press çertifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-24-6

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



Shtëpia Botuese Universitare
"UETPress" është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës

ROLI MESIANIK I SHQIPES

shembja e kullës së babelit

PETRO ZHEJI

ROLI MESIANIK I SHQIPËS

shembja e kullës së tabatit

PETRO ZHILLI

Dy fjalë

Falenderoj në mënyrë të veçantë Albjon Bogdanin që mori përsipër, me përkushtim, punën e kujdesshme dhe të lodhshme të përgatitjes së librit për shtyp.

Po ashtu falenderoj djalin tim Artur Zheji për kurajon që më ka dhënë dhe gjithë përpjekjet për botimin e këtij libri.

Janë të falenderuar gjithashtu të gjitha ata që sponsoruan dhe inkurajuan daljen e tij jo vetëm materialisht, por edhe shpirtërisht.

Me dashuri e mirënjohje,

Autori

By Date

The following table shows the dates of the various
the following table shows the dates of the various
the following table shows the dates of the various

The following table shows the dates of the various
the following table shows the dates of the various

The following table shows the dates of the various
the following table shows the dates of the various

The following table shows the dates of the various

The following table shows the dates of the various

ROLI MESIANIK I SHQIPES

Petro Zheji

Shqipëri – Albania
2015

ROLI MESIANIK I SHQIPES

Qëllimi i këtij studimi është:

§ Të tregojë (provojë, demostrojë) praninë e rrënjëve të stërlashta ("operatorë të lirë") të Shqipes në tërë Gjuhët e Botës pa përjashtim. Kjo do të përbënte gjer diku dhe, në një farë mënyre, atë që Autori emërton si "Universaliteti" i Gjuhës Shqipe, që lidhet në një mënyrë krejt të natyrshme e llogjike me arkaitetin e saj, me të qenurit e saj, si na mëson De Rada, "*una Lingua Primeva*".

§ Të vëre në pah gjer në shkallën më bindëse që të jetë e mundur, fuqinë e jashtëzakonshme *motivuese* të Shqipes, aftësinë e saj, e thënë ndryshe, që të tregojë lidhjen e ngushtë të Fjalës me kuptimin e saj, korispondencën e ngushtë, të mbrendshme, të thellë të fjalës si morfemë me fjalën si sememë. Duke bërë këtë (në mënyrën më universale si asnjë gjuhë tjetër), Shqipja superon vijën e ndarjes mes "*le Signifiant*" (emërtimit, emërtuesit, emërdhënësit) dhe "*le signifié*" (të emërtuarit, objektit të emërtimit) që tregohet (nga Lacan e të tjerë) me shenjën "S / s". Kështu, falë Shqipes,

* Shpërndarja e operatorëve të saj të lirë në të gjitha gjuhët e botës...

Shqipja është në gjendje të motivojë, ku më pak a ku më shumë, ku plotësisht e ku pjesërisht, të gjithë gllorarin e gjuhëve të botës, sikundër këtu në këtë libër do të shihet krejt qartë.

fjalët pajisen me një kuptim të vetin, kuptim që buron nga vetë forma e tyre, ato pajisen shkurt, e thënë metaforikisht, me një pasaportë, me një "kartë identiteti" që u lejon të "qarkullojnë" lirisht, pa pengesa e keqkuptime... Shembujt e shumtë që do të pasojnë do të tregojnë më qartë e fare qartë përse është konkretisht fjala.

§ Të vërtetojë se të gjitha gjuhët (duke e zgjeruar këtu gjer në maksimum termin "Gjuhë" sa të përfshijë çdo veprimtari mendore, çdo Shkencë e degë të Dijes) i "binden" Algoritmit Simbolik, si një artikullim llogjik i Vizionit të lashtë e të stërlashtë* të Realitetit, i asaj që njihet nga Dija e Kohës sonë si "*Philosophia Perennis*".** Mund të themi se Algoritmi

* Por siç do të shikojmë, edhe më i ri...

Shih lidhur Algoritmin Simbolik si artikullim llogjik i Mendimit Mithik e Mistik paraqitjen e shkurtër në fund të tekstit. Algoritmi Simbolik përfshin dy llogjika, llogjikën formale (a ndryshe llogjika aristoteliane, konceptuale, a llogjika e *Tertium Non Datur* : $(x = x)$, "kodi *F*") dhe llogjikën esenciale (a ndryshe llogjika simbolike e *Tertium Datur* : $(x = -x)$, "kodi *E*").

Algoritmi Simbolik operon përmes ekuacioneve simbolike, të cilat janë ekuivalenca simbolesh me prejardhje shumë të stërlashtë, e thënë ndryshe, simbolesh *arkeotipale* (sikundër: \oplus , \bullet , \otimes , \circ , ...) që shërbejnë si elementë kognositivë për shtjellimin e Theorisë sonë.

** Sipas Leibniz-it, e sipas Aldous Huxley edhe shumë e shumë studjuesve të tjerë të së Kaluarës dhe të së Tashmes, duhet të ketë ekzistuar një Fillosofi e të Gjitha Fillosofirave ("*La philosophie des philosophies*"), nga e cila kanë rrjedhur ose të cilës, qoftë edhe në një mënyrë disi opake dhe implicite, i referohen të gjitha fillosofitë... e rrjedhimisht edhe të gjitha gjuhërat, me qenë se siç ka dalë haptas sot në Shkencë, edhe vetë Gjuhësia vështrohet dhe ajo tashmë si një Fillosofi, e për më tepër si një Fillosofi e Fillosofive (Heidegger: "*Die Sprache ist das Haus des Seins...*").

Simbolik, me grupin, gjithmonë të njëjtë, të ekuacioneve të tij simbolike, përbën *Invariantin e çdo transformimi ndërgjuhësor*. Kjo do të thotë, me fjalë më të thjeshta, se kur kalohet nga një sistem gjuhësor në një tjetër, shumë e shumë gjëra ndryshojnë (fjalë, shprehje etj. etj.), por prap diç mbetet domosdoshmërisht pa ndryshuar, dhe ky është pikërisht Algoritmi Simbolik, që mund të nxirret, në një mënyrë a në një tjetër, nga çdo gjuhë, si një "ndëngjuhë e fshehtë dhe e shifruar" dhe së cilës çdo gjuhë i përmbahet. Por do të kemi rast të flasim e të diskutojmë për të gjitha këto me një mënyrë.

Nga "*Libri i Aforizmave*" citojmë këtu këtë pasazh mbi "*Perennial Philosophy*":

"...Këtë shprehje e gjejmë të përdorur për herë të parë nga Leibniz, ndonëse ai vetë nuk pretendonte se ajo ishte një shpikje e tij. Ai thoshte se e kishte gjetur atë në shkrimet e theollogut të shekullit XVI Augustine Steuch, i cili që sipas tij një nga shkrimtarët më të mirë të krishterë të kohës. Steuch e cilësonte "*Filosofinë e Përrjetshme*" si të Vërtetën zanafillore absolute që i pat qenë zbuluar njeriut para Rënies, por krejtësisht e harruar pas asaj e më tej, dhe që mundi të recuperohet në historinë e mendimit njerëzor vetëm gradualisht dhe në trajtë fragmentare.

Shumë më vonë, në kohën tonë (1945) Aldous Huxley hartoi një antologji të traditave fetare dhe mistike ku viheshin rreth shumë e shumë gjëra të përbashkëta me "*Filosofinë e Fillosofive*". Në parathënien e librit të tij ai e përcaktonte "*Philosophia Perennis*" si: '*...një metafizikë që pranon ekzistencën e një Realiteti Hyjnor në botën e sendeve materiale, të qenieve të gjalla dhe të mendjes njerëzore... një psikologji që zbulon në shpirtin e njeriut diçka të ngjashme dhe madje identike me Realitetin Hyjnor... një etikë sipas të cilës qëllimi i mbramë i njeriut duhet të jetë njohja e themeleve himanente dhe trashëndente të të gjitha qenieve, diçka e stërklashtë dhe e harruar, por në të njëjtën kohë universale.'*

Mund të gjenden rudimente (mbeturina) të Fillosofisë të Përrjetshme në Dijen tradicionale të popujve primitivë në çdo vend të Botës. Në një trajtë plotësisht të zhvilluar, ajo është e pranishme në çdo fëmijë të një niveli të lartë..."

Një tezë themelore e Shkencës së Re të Etimologjisë që ne këtu, si edhe gjetkë, kemi nisur të inaugurojmë, është se:

***"Fjalët referojnë, tek e mbramja, jo tek një koncept,
por tek një simbol."***

Ky Studim është mbushur me shembullat të *motivimit* të gllosave të huaja me Gjuhën Shqipe,* e cila funksionon si një *gjuhë e ndërmjetme* duke i pajisur të gjitha fjalët e të gjitha gjuhërave të botës me kuptimin që ato vetë nuk janë në gjendje ta zbulojnë. Kështu të gjitha gjuhët e botës, pa Shqipen, "nuk do të kishin kuptim", siç kanë pretenduar se ato vërtetë "s'kanë asnjë kuptim" shkencëtarë, gjuhëtarë të rangut botëror, si Saussure-i, Lacan-i etj.**

Me fjalë të tjera, Studimi tregon bollshëm e qartazi se:

**Shqipja i motivon fjalët e gjuhëve të huaja duke i "shpënë"
tek simboli që ato, "pa e ditur" përshkruajnë
a te një simbol i njëvlefshëm me të.**

* Merret fjala për t'u etimologjizuar, ndahet në pjesët e saj të thjeshta përbërëse, transkribohet në gjuhën simbolike dhe me ndërmjetësinë e Shqipes (dhe Algoritmit Simbolik) "përcillet" tek simboli i saj motivues.

** Ata arritën në këtë përfundim fatal për dy arsye: (1) nuk njihej në thellësi, në tërë pasurinë e operatorëve të saj të lirë, Gjuha Shqipe, e pra mungonte një gjuhë *ndërmjetësuese* ("Roli Mesianik" i Shqipes); (2) mendohej gabimisht se fjalët referoheshin përfundimisht tek një *koncept* e jo tek një *simbol* dhe mungonte një artikullim llogjik i mendimit njerëzor të stërlashtë, të lashtë dhe aktual, sikundër që është *Algoritmi Simbolik*. Kjo mosnjohje, duke e bërë të pamundur motivimin, shpinte në përfundimin e pashmangshëm sipas të cilit fjalët në vetvete nuk kishin asnjë kuptim... e pra nuk duheshin parë ndryshe veçse si disa etiketa që u ngjiteshin një herë e mirë (nëpërmjet një konvencioni) sendeve për t'i dalluar mes tyre.

Këtu shprehja "pa e ditur" do të thotë se vetë gjuhët e huaja, me mjetet e tyre leksikore nuk janë në gjendje t'i reduktojnë, t'i shpien fjalët e tyre tek simbolet përkatëse që ato përshkruajnë, duke mos u bërë dot koshjente kështu për lidhjen që këto fjalë mbajnë me simbolet arkeotipale të cilave u referohen dhe të cilët, nga ana e tyre, përbëjnë motivimin e thellë, të fundëm të tyre.*

Duke patur parasysh distancën e madhe, si në hapësirë ashtu edhe në kohë, të gjuhërave të marra në shqyrtim këtu (ndër të tjera Sanskritishtja, Asirishtja, Hebraishtja, Greqishtja, Latinishtja, Gjermanishtja, Kinezçja, Persishtja, Hititishtja, etj. etj.), prania e operatorëve Shqiptarë mund të shpjegohet vetëm duke supozuar se *gjuha Shqipe përbën zanafillën e përbashkët të të gjitha këtyre gjuhërave*, pamvarësisht familjes gjuhësore të cilës ato i përkasin. Edhe në këtë rast dhe në këtë mënyrë, Shqipja *heq kufijtë* dhe dëshmon për faktin, disi të çuditshëm dhe të papritur nga gjuhëtarë profesionistë, se *ndarja* rigjide e gjuhërave në familje të caktuara gjuhësore, nuk është krejt e saktë.

E thënë më thjeshtë, gjuha Shqipe ka shumë mundësi të cilësoh "Gjuha Nënë" (gjerm. *Muttersprache*) e të gjitha gjuhërave, gjë që dëgjohet një herë e mirë enigmën ende të padeshifruar të Monogjenezë.

Heqja hipotetike e kufijve mes gjuhërave, gjë që realizohet me ndërhyrjen m e s i a n i k e të Shqipes, duhet shpjeguar edhe me faktin themelor se Shkenca e Ré e Etimologjisë që ne po inaugurojmë, e referon fjalën, si tek prejardhja e saj, jo më tek *koncepti* – por tek *simboli*, tek një paradigëm primare, e lashtë, e thellë, superlative.

* Një nga përfundimet më të rëndësishme të këtij Studimi është dhe fakti, i pa vënë re gjeri më tani, se çdo ekuacion simbolik lidhet me një mith kozmogonik dhe rrjedh, në një mënyrë a një tjetër, nga një "çift ekuivokal" (homonimi a thujasë-homonimi).

Një tezë themelore e Shkencës së Re të Etimologjisë që ne këtu, si edhe gjetkë, kemi nisur të inaugurojmë, është se:

***"Fjalët referojnë, tek e mbramja, jo tek një koncept,
por tek një simbol."***

Ky Studim është mbushur me shembullat të *motivimit* të gllosave të huaja me Gjuhën Shqipe,* e cila funksionon si një *gjuhë e ndërmjetme* duke i pajisur të gjitha fjalët e të gjitha gjuhërave të botës me kuptimin që ato vetë nuk janë në gjendje ta zbulojnë. Kështu të gjitha gjuhët e botës, pa Shqipen, "nuk do të kishin kuptim", siç kanë pretenduar se ato vërtetë "s'kanë asnjë kuptim" shkencëtarë, gjuhëtarë të rangut botëror, si Saussure-i, Lacan-i etj.**

Me fjalë të tjera, Studimi tregon bollshëm e qartazi se:

**Shqipja i motivon fjalët e gjuhëve të huaja duke i "shpënë"
tek simboli që ato, "pa e ditur" përshkruajnë
a te një simbol i njëvlefshëm me të.**

* Merret fjala për t'u etimologjizuar, ndahet në pjesët e saj të thjeshta përbërëse, transkriptohet në gjuhën simbolike dhe me ndërmjetësinë e Shqipes (dhe Algoritmit Simbolik) "përcillet" tek simboli i saj motivues.

** Ata arritën në këtë përfundim fatal për dy arsye: (1) nuk njihej në thellësi, në tërë pasurinë e operatorëve të saj të lirë, Gjuha Shqipe, e pra mungonte një gjuhë *ndërmjetësuese* ("Roli Mesianik" i Shqipes); (2) mendohej gabimisht se fjalët referoheshin përfundimisht tek një *koncept* e jo tek një *simbol* dhe mungonte një artikullim llogjik i mendimit njerëzor të stërlashtë, të lashtë dhe aktual, sikundër që është *Algoritmi Simbolik*. Kjo mosnjohje, duke e bërë të pamundur motivimin, shpinte në përfundimin e pashmangshëm sipas të cilit fjalët në vetvete nuk kishin asnjë kuptim... e pra nuk duheshin parë ndryshe veçse si disa etiketa që u ngjiteshin një herë e mirë (nëpërmjet një konvencioni) sendeve për t'i dalluar mes tyre.

Këtu shprehja "pa e ditur" do të thotë se vetë gjuhët e huaja, me mjetet e tyre leksikore nuk janë në gjendje t'i reduktojnë, t'i shpien fjalët e tyre tek simbolet përkatëse që ato përshkruajnë, duke mos u bërë dot koshjente kështu për lidhjen që këto fjalë mbajnë me simbolet arkeotipale të cilave u referohen dhe të cilët, nga ana e tyre, përbëjnë motivimin e thellë, të fundëm të tyre.*

Duke patur parasysh distancën e madhe, si në hapësirë ashtu edhe në kohë, të gjuhërave të marra në shqyrtim këtu (ndër të tjera Sanskritishtja, Asirishtja, Hebraishtja, Greqishtja, Latinishtja, Gjermanishtja, Kinezçja, Persishtja, Hititishtja, etj. etj.), prania e operatorëve Shqiptarë mund të shpjegohet vetëm duke supozuar se *gjuha Shqipe përbën zanafillën e përbashkët të të gjitha këtyre gjuhërave*, pamvarësisht familjes gjuhësore të cilës ato i përkasin. Edhe në këtë rast dhe në këtë mënyrë, Shqipja *heq kufijtë* dhe dëshmon për faktin, disi të çuditshëm dhe të papritur nga *gjuhëtarë* profesionistë, se *ndarja* rigjide e gjuhërave në familje të caktuara gjuhësore, nuk është krejt e saktë.

E thënë më thjeshtë, gjuha Shqipe ka shumë mundësi të cilësohet si "Gjuha Nënë" (gjerm. *Muttersprache*) e të gjitha gjuhërave, gjë që do të zgjidhte një herë e mirë enigmën ende të padeshifruar të Monogjenezës.

Heqja hipotetike e kufijve mes gjuhërave, gjë që realizohet me ndërhyrjen m e s i a n i k e të Shqipes, duhet shpjeguar edhe me faktin themelor se Shkenca e Ré e Etimologjisë që ne po inaugurojmë, e referon fjalën, si tek prejardhja e saj, jo më tek *koncepti* – por tek *simboli*, tek një paradigëm primare, e lashtë, e thellë, superlative.

* Një nga përfundimet më të rëndësishme të këtij Studimi është dhe fakti, i pa vënë re gjeri më tani, se çdo ekuacion simbolik lidhet me një mith kozmogonik dhe rrjedh, në një mënyrë a një tjetër, nga një "çift ekuivokal" (homonimi a thujse-homonimi).

Dhe dimë që:

*"Qui decouvre une relation entre deux symboles,
ce trouve au centre de l'univers."**

(Kush gjen një marrëdhënie mes dy simboleve,
e gjen veten në Qendrën e Universit.)

Gjë që të tregon se pikëpamja nga e cila Etimologjia e Ré e sheh Gjuhën, është ajo e *Qëndrës*, e Parimit Suprem të Universit, e pra më e sakta, më e vërteta, më e *qëndrueshmja* që mund të jetë.

Dimë gjithashtu që:

"Le symbol abat les murs."

(Simboli shemb muret.)

Pra mund të shkruajmë:

S i m b o l i = - ⊕ = E = (x = -x)
= *Coincidentia oppositorum*, "Philosophia Perennis"

...çka shpjegon ndër të tjera dhe rënien e mureve që ndajnë familjet e ndryshme gjuhësore.

Përse vallë përçimi tek simboli duhet ta përfundojë "Odisenë" e etimologjizimit të një fjale?

Pasi mbrrin Qendrën, fjala nuk ka ku shkon më tej për efekte etimologjizimi. Ajo ndesh atje në një *"nec plus ultra"*. Kështu që një etimologjizim i tillë është përfundimtar dhe absolut. Gjë që do të thotë edhe se këto etimologjira janë krejt të sigurta dhe të pakundërshtueshme, sikundër e tillë është vetë Qendra Spirituale, tek e cila ato referojnë.

Për të gjitha këto arsye ne mund të themi se Gjuha Shqipe është ndër të tjera një gjuhë para-Babeliane *par excellence*.

* Shih J. Chevalier, *"Dictionnaire des Symboles"*.

Që këndeje del ndër të tjera edhe se:

"Një gjuhë para-Babeliane është patjetër një gjuhë simbolike."

Mos harrojmë ato sa na thotë Jean Chevalier në "Hyrjen" e fjalorit të tij të simboleve: "*La logique du symbol c'est la logique du Tiers Inclus*"... E pra, një Gjuhë Simbolike do të jetë patjetër një gjuhë që lidhet drejtpërsëdrejti me Qëndrën Mistike, e pra ajo duhet vështruar atëhere padyshim si Gjuha e Parë, si Gjuha e Perëndisë, e Frymës së Shenjtë, nëpërmjet së cilës edhe vetë Bota u krijua, siç na tregojnë Shkrimet e Shenjta...

Duke vënë gishtin mbi Shqipen si "Gjuhë Mëmë" zgjidhet, një me të, edhe problemi i M o n o g j e n e z ë s.

Jemi në gjendje, nga ana tjetër, të zbulojmë edhe kuptimin e thellë të mitit të Kullës së Babelit.

Dhe ja se si:

Gjuhët diferencohen nga njëra-tjetra vetëm në nivelin e përciptë *konceptual*, kurse e kundërta ndodh me to në nivelin e thellë *simbolik* në të cilin që të gjitha janë *strukturalisht* (simbolikisht) e njejta Gjuhë,^{*} sikundër janë *një* në këtë nivel edhe të gjitha fillosofitë e të gjitha fetë. Kjo ndodh për arsye se në këtë nivel "funksionon" lirshëm dhe pa pengesa vizioni arkeotipal mbi Botën i "*Philosophia Perennis*", që është vështruar në fillim të kohërave si një *revelatë hyjnore*, si një "*Philosophy of Philosophies*", si një Super-Fillosofi.^{**}

* Mund të flitet pra për një Invariant Ndërgjuhësor, të përjetshëm dhe omniprezent, të përbërë nga një grup transformacionesh (ekuivalencash) simbolike, që është po ay për të gjitha gjuhët.

** "*Libri i Aforizmave*": Që nxirret më lehtë e më pastër, se nga çdo gjuhë tjetër, nga Shqipja...

Studimi jep shembulla të bollshëm se të gjitha gjuhët, sado të ndryshme në dukje, ngrihen mbi një "Metagjuhë", që do të thotë mbi një Gjuhë të "padukshme" për një sy të zakonshëm, mbi një Gjuhë të "nëndheshme" e cila është e njejta për të gjitha. Në këtë tekst jepen jo pak shembuj që rikonfermojnë këtë tipar themelor të çdo gjuhe.

E thënë ndryshe:

"Të gjitha gjuhët janë, në nivelin simbolik (Algoritmi Simbolik), e njejta Gjuhë."

Dhe me qenë se me fjalën "Gjuhë" është nënkuptuar çdo "sistem kognositiv", e pra çdo Shkencë, ndër të tjera, informacioni që ne mund të nxjerrim nga Gjuha vlen në shumë raste edhe si një "zbulim" në vetën trupin e Diturisë, qoftë kjo Fizikë, a Psikologji, a Mjekësi, etj. etj.*

Dhe do kemi raste plot në këtë Studim të shohim se si: ***Gjuhësia, ashtu sikundër ne e konceptojmë atë, si asnjëherë të shkëputur nga Mendimi e pra nga Fillosofia, dhe është fjala këtu për "Philosophia Perennis", mund të shërbejë si një Euristikë e tepërfuqishme.***

Simbolet, këtu, sikundër gjatë, janë të pluriinterpretueshëm. Dhe kjo sepse korrespondenca midis *simbolit* dhe *konceptit* nuk është univoqe, por plurivoqe. Që do të thotë, të njejtit simbol i përgjigjen shumë koncepte, që formojnë atë që quajmë "spektri semantik" i simbolit.

Nga këto pluriinterpretime ne mund të nxjerrim informacione shumë të thella dhe të rëndësishme edhe për fusha të tjera të Dijës. Vihemi pra, pak

* Kështu, në vargun e shkencave që po ngrihen (thellohen) në nivelin e "*Sciences des profondeurs*" (Fizika Kuantike, Psikologjia e Inkoshientit, Mjekësia e Staminalitetit dhe NDE, etj. etj.), shtohet në këtë studim edhe Shkenca jonë e Etimologjisë që referon tek Qendra e pra tek llogjika e kodit E (kodi i thellësisë), dhe që për këtë arsye mund ta quajmë "*Etimologie du profondevur*"...

a shumë, e thënë figurativisht, në pozitën për t'u katapultuar, sikur nga një trampolinë, në dimensione të ndryshme të Realitetit dhe në fusha të ndryshme të Njohjes.

*"Zbërthimi" i Gjuhës në atë mënyrë sui generis siç e realizojmë ne, na lejon të gjejmë pa stërmundim të gjitha të vërtetat themelore të Shkencës, që nga dhe del se të Parët tanë i kanë ditur (në mënyrën e tyre) ato më së miri, pa çka se ne nuk u kemi besuar, pa çka se ne nuk kemi dashur a s'kemi mundur ta hapim atë thesar të pashtershëm Diturie Universale e të pavdekshëm, që ata na përçuan e na lanë trashëgim nëpërmjet Gjuhës.**

Dëshmitë nga burime të ndryshme rikonferojmë faktin themelor se Gjuha (të gjitha gjuhët pa përjashtim) ngrihen mbi një vizion mitik të Universit, se thesari që fshihet në gjirin e Gjuhës, pasi hapet me çelësin magjik të Algoritmit Simbolik, jep një informacion tërësor e tërëpërshkues dhe po aq aktual sot sa ka qenë edhe shekuj më parë. Dhe puqen kështu Gjuhësia, Fillosofia, Mithologjia, Theollogjia, Fizika, Psikollogjia, Genetika, Mjekësia, e kështu me radhë shkencat dhe fushat e ndryshme të njohjes.

Studimi sjell shembuj nga më të shumtët që tregojnë në të njejtën kohë si arkaicitetin e informacionit të mbartur nga Gjuha, ashtu edhe aktualitetin e tij.

Dhe pajtimi mes mendimit modern dhe atij të stërlashtë:

Arkaicitet = Aktualitet

mund të interpretohet ndër të tjera edhe si emergjencë e kodit E, m.q.s.:

$$E = (x = -x) = \bigcirc = (\alpha = \omega) = e \text{ Tëra} = \text{Holizmi}$$

a thënë ndryshe si një "mbyllje e ciklit", e pra si afrim i Fundit të Botës.

* Kështu Algoritmi Simbolik shërben jo vetëm si një Euristikë, por edhe si një Kriter vërtetësie.

Sot, po kalohet në një llogjikë tjetër, nga llogjika e *Tertium Non Datur* (kodi F) në atë të *Tertium Datur* (kodi E), pra një llogjikë anti-aristoteliane e cila vetëm ajo është në gjendje të zgjidhë paradokset në të cilat ndesh sot Shkenca e Kohës. Emergjencia sot, kudo në Dijen njerëzore, e kodit E, flet qartë për një Përmbysje epokale, për dy kolapse (që janë në thelb i njëjti), për Kolapsin e Arsyes e pra të Mendimit Njerëzor, dhe për atë të Materies e të Botës materiale.* Kjo është emergjenca e llogjikës së "*Deus Datur*" (Zoti si "i Treti i Përfshirë"), e pra e Logosit Hyjnor në nivelin më të thellë të çdo fushe të Shkencës dhe dimensionit të Realitetit.

Shqipja pohon pa ekuivoqe se:

"E mbara mbrihet në mbarim."

Pra, gjersa është arritur e *mbara*, kjo do të thotë se jemi në *mbarim* (ose mjaft afër tij) të Historisë njerëzore. Dhe ky është një profetizim që bëhet duke u mbështetur në Urtinë, marramendthore në thellësinë e saj, të Gjuhës...

Do duheshin parathënë e thënë edhe shumë gjëra të tjera që kanë të bëjnë me një sërë problemesh që lidhen më intimisht dhe në hollësi me metodollogjinë tonë krejt të veçantë të asaj që mund ta quajmë *Shkenca e Rë e Etimollogjisë*, por mendojmë, për arsye didaktike, ta fillojmë gjithshka *in media res...*, që do të thotë praktikisht se: a) Do të hidhemi drejt për së drejti, pa shumë e shumë parasqarime, në analizën etimollogjike, llogjike, fillosofike (sipas rastit) të gllorave të huaja dhe në procedurën e motivimit të tyre nëpërmjet Shqipes; b) Do të japim shpjegime e justifikime në "rrugë e sipër" për shumë e shumë gjëra, për të gjitha ato njohuri, para-prakisht të injoruara, që do ta vënë në gjendje lexuesin të kuptojë arsyet, e cekta dhe të thella, të këtij apo atij pohimi, i dukur në krye aprioristik dhe arbitrar; c) Do të riprodhohen pjesërisht, aty e atje sipas rastit dhe nevojës, fragmente të Teorisë që e bëjnë tekstin të kuptueshëm dhe të justifikueshëm llogjikisht në deduktimet e përgjithësimet e tij.

* Në gjuhën e simboleve: $E = -F = -(x = x) = - \bullet \dots$

Pra, siç shikohet, preferohet një metodë *induktive*, ndaj asaj *deduktive*, që nuk se mungon, por që vjen pas kur është fjala për ti pajisur rezultatet edhe me një mbështetje teorike, duke treguar, si në një alternativë, se si ato mund të bëhen të rrjedhin vetëm e krejt llogjikisht nga presupozimet e një Teorie të Përgjithshme siç është ajo e Algoritmit Simbolik, si artikullim llogjik i Mendimit Mistik, i "*Philosophia Perennis*". Shkurt e me një fjalë, në krye shembulli konkret (fjala për t'u etimologjizuar) dhe më pas teorizimet e zgjerimet eventuale të Bisedës.

Pra atëhere le të fillojmë.

Fillojmë me një fjalë të huaj të zgjedhur *ad libitum*:

- 1) **Sanskr. a - d u ṣ ṭ a (आधर)** = fr. *libre de faute, innocent* (që s'ka gabuar, i pafajshëm)

Motivimi me Shqipen jep:

– **d y s h ë s h t ë**

Theksi semantik këtu bie mbi operatorin e lirë të Shqipes i cili mungon në Sanskritisht: "**d y s h**" = 2 , që është nga të gjitha numurat simbolikë, më i keqi, më ogurzezi.*

* Për simbolizmën e **d y s h i t (2)** lexojmë ndër të tjera tek Cirlot (fq.232):
 "...Two stands for echo, reflection, conflict and counterpoise or contraposition; or the momentary stillness of forces in equilibrium; it also corresponds to the passage of time – the line which goes from behind forward; it is expressed geometrically by two points, two lines or an angle. It is also symbolic of the first nucleus of matter, of nature in opposition of the creator, of the moon as opposed to the sun. In all esoteric thought, two is regarded as ominous: it connotes shadow and the bisexuality of all things, or dualism... Two, then, is the number associated with the Magna Mater."

(...Dyshi simbolizon jehonën, konfliktin, kundërshtimin dhe kundërvënien ose qetësinë e përkohshme të forcave në ekuilibër. Ai është gjithashtu numuri

- 2) **Rus. b e d à (б е д а)** = ingl. *misfortune, need, tribulation* (fatkeqësi, mjerim)

Me Shqipen:

b ë d à

e pra simbolikisht:

$$D à = \textcircled{\ominus} \quad \dots(F)$$

Por, në bazë të Algoritmit Simbolik:*

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

Pra atëherë, duke përmbledhur:

$$b e d à \rightarrow \text{shq. } b \ddot{e} d \grave{a} = \textcircled{\ominus} = F = \bullet = e \text{ zeza, e keqja, } \\ \text{fatkeqësia, mjerimi...}$$

Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm...

Në Rusisht mungon operatori "b ë" në kuptimin e "bërjes", që është bash ay që duhet këtu për të bërë të mundur motivimin. Në Rusisht mungon gjithashtu edhe operatori "d a" në kuptimin e "n d a r j e s". Kështu që Rusishtja është krejt e pa aftë të *motivojë* fjalën e saj "b e d à", të na tregojë, pra, përse kjo fjalë ka në Rusisht atë kuptim që ka. Mund të themi atëhere, qoftë edhe metaforikisht, se kjo fjalë e Rusishtes, si shumë e

simbolik që i korrespondon kalimit të kohës. Shprehet gjeometrikisht me dy pika, dy vija apo një kënd. Simbolizon gjithashtu bërthamën e parë të materies, materien në kundërvënie me Krijuesin, Hënën në kundërvënie me Diellin. Në mendimin ezoterik dyshi vështrohet si një numur ogurzi. Është simbol i Hijes dhe i biseksualitetit të përbotshëm e i dualizmit... Dyshi lidhet gjithashtu si numur me 'Magna Mater'.)

* Shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.785-859.

shumë të tjera (dhe jo vetëm në Rusisht), qarkullon mbrenda sistemit të saj leksikor "pa pasaportë"... *me të cilën ajo mund të pajiset vetëm falë Shqipes*. Po do të kemi rast më vonë të flasim më hollësisht mbi këtë çështje.

Duke zgjeruar Bisedën:

Shikojmë pra se "ndarja" është "e keqe", ndaj edhe në Shqip:

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

ndarja ndyrja

Mirëpo nga ana tjetër, Paracelsus na thotë:

"Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang."

që do të thotë që:

"Gjithshka fillon me një *ndarje*."

e pra dhe vetë Bota materiale krijohet në këtë mënyrë, do me thënë me një *ndarje*.

Pra atëhere, nga sa më sipër del se:

*"Bota dhe krijimi i saj duhen vështruar si diçka e keqe,
si një 'e zezë', si një fatkeqësi."*

Kjo është në përputhje të plotë me Mendimin Mistik (mbi të cilin ngrihet vetë Gjuha) të të gjitha kohërave dhe vendeve.

Nga ana tjetër, Krijimi i Botës, sipas skemës të përgjithshme të mitheve kozmogonike realizohet me kalimin (që është një "rënje") nga kodi E tek kodi F:

$$E \downarrow = F$$

e pra nga Fryma (○), tek Materia (●).*

Shihet pra edhe kështu (si edhe në shumë mënyra të tjera) se:

*"Krijimi i Botës materiale, sipas Botëkuptimit Mistik,
është një e keqe (●), madje nga të gjitha të këqijat, më e keqja."*

Shqipja e jep bukur këtë me aforizmën:

"Krymja, me një krim."

dhe është fjala natyrisht për krijimin e Botës...

3) **Ingl. b a d = i keq (ital. cattivo)**

Me Shqipen:

b â d à = ⊕ = F = ● = e keqja,...

Pra as Inglishtja, për mungesë operatorësh të lirë të përshtatshëm, nuk është në gjendje të motivojë...

4) **Gjerm. s t e r b e n = me vdek (ingl. to die)**

Kjo fjalë Gjermanisht do të thotë "të vdesësh". Vetë Gjermanishtja me materialin e saj leksikor nuk është në gjendje të na thotë p s e për të shprehur kuptimin e "vdekjes" në Gjermanisht është zgjedhur pikërisht k j o fjalë. Shqipja, pó. Dhe ja se si:

Si punë e parë e "zbërthejmë" fjalën "s t e r b e n" në pjesët që e përbëjnë dhe që ne i quajmë "operatorë të lirë".*

* Mythi kozmogonik i rënjes të Frymës në Materje... (shih edhe fq.34-35)

Do të kemi:

ster ben

Në Shqip:

ster(r) = terr, izi,... e pra simb. ●

Pjesa tjetër "-b e n" është një mbaresë foljore dhe lidhet me Shqipen "b ë n".** Motivimi i fjalës "s t e r b e n" nëpërmjet Shqipes do të jetë atëhere:

ster ben → shq. ster bën = "bën ster" = sterr = ●

Shohim se Gjermanishtja "s t e r b e n" e shpreh konceptin e vdekjes me ngjyrën e zezë.***

Kështu pra fjala Gjermanisht "s t e r b e n" përshkruan, "pa e ditur", një simbol, simbolin e të zezës, një nga interpretimet e të cilit është edhe a i vdekjes.

Siç do të shikojmë më tej, kjo është e përgjithshme:

Fjalët kanë përshkruar dikur simbole dhe jo koncepte. Pra mund të themi se Gjuha në gjenezën e saj ka qenë simbolike dhe më pas, me kalimin e kohës, ajo u bë konceptuale, ashtu sikundër edhe tërë Dituria njerëzore që kaloi nga stadi i Simbolizmit në atë të Konceptualizmit.

Vëmë ré këtu se "s t e r" dhe "-b e n", elementët me të cilët mund të "shpjegohet", "motivohet" fjala Gjermanisht "sterben", nuk janë semema në Gjermanisht, nuk janë atje operatorë të lirë a rrënjë të pastërta a, e thënë ndryshe, ato nuk i përkasin fondit leksikor të Gjermanishtes. Kjo fjalë

* Operatori i lirë është, siç dimë, një "njësi semantike minimale".

** Shih edhe fq.313.

*** Shih lidhur me këtë edhe më poshtë fq.17.

është pra një fjalë e ndërtuar, e "gatuar" sipas një "recete" (duke marrë e ngjitur bashkë "s t e r" dhe "b e n") dhe me lëndë të parë thjeshtë Shqiptare, me qenë se vetëm në Shqip "s t e r" dhe "b ë n" kanë një kuptim në vete dhe bash atë që i jep tërë fjalës Gjermanisht kuptimin e "vdekjes" që ajo në fakt ka.

Ky dhe është pikërisht Roli Mesianik, domethënë n d ë r m j e t ë s u e s i Gjuhës Shqipe. Shqipja e "shpie" fjalën e huaj, pasi e zberthen, tek simboli që ajo përshkruan, duke e shpjeguar pra kështu, duke e motivuar pra kështu.

Mund të vëmë ré këtu se në Gjermanisht: "f i n s t e r" = i,e errët..., e pra simb. " ● ". Kjo fjalë mund të ndahet në:

f i n s t e r

ku "f i n" është Shqipja "b ë n" dhe "s t e r" është Shqipja "s t e r (r)" = i,e errët... Ne shohim pra kështu se Gjermanishtja e ka operatorin "s t e r" në kuptimin e errësirës, por jo në gjendje të lirë, por të përngjitur me "f i n-". Sikur ta kishte patur të lirë, ajo do të ishte në gjendje ta motivo-nte, qoftë edhe pjesërisht, fjalën "s t e r b e n" që, duke u lidhur me konceptin e vdekjes, lidhet natyrisht edhe me atë të errësirës.

Le të vëmë ré këtu edhe një gjë tjetër.

Në Shqip kemi:

s t e r (r) = i zi, i errët

dhe gjithashtu:

s h t e r (r) = mbaroj, nuk kam më...

si edhe:

s h t e r p (ingl. s t e r i l e)

dhe:

s t e r é = dhé, tokë

Kjo tregon se operatori "s t e r" është shumë produktif në Shqip.

Lidhja mes kuptimeve të ndryshme (polisemi) të rrënjës "s t e r (r)" në Shqip është m i s t i k e. Lexojmë lidhur me këtë çështje në fjalorin "Dictionnaire des symboles" të Jean Chevalier, ndër të tjera edhe këto:

"Dans le langage du blason la couleur n o i r se nomme 'sable', ce qui exprime ses affinités avec la terre s t e r i l e...

...Il (le noir) est associe aux t e n é b r e s primordiales...

La terre s'oppose symboliquement au ciel comme le principe passif au principe actif; l'aspect féminin à l'aspect masculin de la manifestation; l'obscurité à la lumière; le yin au yang...

...Dans son influence sur le psychisme, le Noir donne une impression d'opacité, d'épaississement, de l o u r d e u r...

*Le Noir est l'image de la m o r t, de la t e r r e, de la sepulture..."**

(Në gjuhën heraldike ngjyra e zezë quhet ,rërë', si për të shprehur afërsinë e saj me një tokë s h t e r p...

...Ngjyra e zezë lidhet me e r r ë s i r ë n primordiale...

Toka i kundërvihet simbolikisht qiellit sikundër parimi pasiv parimit aktiv, sikundër aspekti femëror aspektit mashkullor të manifestimit, sikundër errësira dritës, sikundër Yin-i Yang-ut...

...Nga pikëpamja shpirtërore e Zeza jep përshtypjen e opacitetit, të dendësisë, të r ë n d ë s i s ë...

E Zeza është imazhi i v d e k j e s, i t o k ë s, i varrit...)

Shikojmë këtu, ndër të tjera, lidhjen mistike mes fjalëve Shqip:

s t e r (r) é dhe s t e r (r)

(tokë)


(i zi)

* J. Chevalier, "Dictionnaire des symboles", fq.537 dhe 746.

Kjo na bën të mendojmë se edhe fjala Italishte (Latine) "t e r r a" (tokë) lidhet mistikisht me Shqipen "t e r r" (errësirë), "s t e r r".

Mund të themi se fjalët: "s t e r (r)", "s t e r r é", "s h t e r r", "s h t e r p" etj., janë rreze polisemike të të njëjtit simbol, simbolit të së zezës.

Mund të shkruajmë pra:



E shprehim këtë edhe duke thënë se të gjitha këto fjalë janë e njëjta fjalë-simbol,* ndonëse konceptualisht të ndryshme.

Nga sa pamë del që edhe fjala Latinisht: "s t e r i l i t a s" (shterpësi) motivohet fare mirë dhe më së miri (në të gjitha aspektet) me ndihmën e Shqipes.

Dhe së fundi, duke dalë nga thema e Bisedës sonë:

Vëmë re se sa thuhet në tekstin e cituar se: "...Dans son influence sur le psychisme, le Noir donne une impression de... lourdeur..."** gjen zbatim në Gjermanisht ku: "s c h w a r z" = *i zi*, e pra simb. " ● ", dhe "s c h w e r" = *i rëndë*, e pra simb. " ↓ ".

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.827.


** Gjithashtu nga teksti i cituar del edhe karakteri negativ i të zezës, gjë që simbolikisht do të paraqitej me ekuacionin simbolik: ● = -1 ... (F).

Kështu Gjermanishtja shtron ekuacionin simbolik:^{*}

$$\bullet = \downarrow \quad \dots(F)$$

schwarz schwer

- 5) Sanskr. d o ş a (दोष) = fr. *défaut... vice, faute, erreur, manquement... péché, tort, transgression, crime, outrage, dommage, effets désastreux, conséquence fâcheuse; malignité, méchanceté...* (defekt, e metë, ves, gabim, mungesë...; mbrëmje; errësirë, natë...; mëkat, padrejtësi, transgresion, krim, fyerje... dëm, pasojë katastrofale..., ligësi...)

Pra simb. "  "... Por dimë se Algoritmi Simbolik pozon:

$$2 = \bullet \quad \dots(F)$$

Pra kjo fjalë lidhet me simbolizmin e "dyshit", kështu që si e tillë është e motivueshme me Shqipen :

d y s h (2)

Vetëm në këtë mënyrë (duke e shpënë fjalën "d o ş a" tek Shqipja "d y s h" ose "d a s í"...) mund të shpjegohet (motivohet) tërë larmia e kuptimeve të saj në dukje kaq të ndryshme, por që lidhen me një segment të spektrit semantik të bashkësisë të figurave simbolike në F.

Lexonjësi do të jetë në gjendje, shpresojmë, ta bëjë vetë këtë, duke u mbështetur në të gjitha ato që janë thënë tek *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*. Prandaj dhe nuk po zgjatemi më tej.

Por le të ndalemi pak, sidoqoftë, tek informacioni a mesazhi fillosofik, theollogjik e mitik që fjala Sanskritishte "d o ş a" (दोष) me tërësinë e

* Shih edhe fq.326.

spektrit të saj semantik (që Shqipja na lejon ta çlirojmë e ta justifikojmë) na përçon.

Ne pamë se numuri dy (2) simbolizonte në të njejtën kohë si *materien*, ashtu edhe të *keqen*.

Nga kjo del, sipas Mendimit Mistik, se *Bota materiale është e keqe*, se Bota është një mashtrim (në Fillosofinë e lashtë Indiane: një gënjeshtër, një iluzion i Maya-s*) si edhe, duke u mbështetur në sa më sipër (në kuptimet e ndryshme të fjalës Sanskritisht "d o ş a"), se ajo është *defektoze*, se ajo është e *gabuar*, e *gënjeshtërt*, *mëkatore* (e lindur nga një mëkat, "mëkati origjinal", lat. *peccatum originalis*, sipas theollogjisë së Krishterë), se ajo është e *padrejtë*, se ajo është *kriminale* (e lindur siç është nga një krim), që përputhet me mitin e Sakrificës Kozmogonike,** se ajo është *fyese për Zotin****, se ajo është plot me *ligësira*, me *keqësira* e *vuajtje*, se *dashuria*

* Tek Cirlot (fq.206) lexojmë:

"...The world, not as it is in itself but as we perceive it and react upon it, is the product of our own maya or delusion... The Highest Being is the lord and the master of Maya... All the rest of us... are the victims of our individual Maya...To liberate man from such a spell... is the principal aim of all the great Indian philosophies."

(...Bota, jo ashtu si ajo është të vërtetë, por ashtu sikundër ne e perceptojmë atë dhe reagojmë ndaj saj, është pjellë e Majas dhe iluzionit... Qënja Supreme është zot e padron i Majas, kurse ne të tjerët, jemi të gjithë viktima saj... Çlirimi i njeriut nga një magji e tillë... përbën qëllimin kryesor të fillosofirave të mëdha indiane.)

** Po aty (fq. 64): "The basis of most cosmogonies is the 'cosmic sacrifice'..." (Baza e pjesës më të madhe të kozmogonive është 'sakrifica kozmike'...)

*** Me qenë se:

$$\text{Bota} = \bullet = - \bigcirc = -(x = -x) = -\text{Qendra} = \\ -\text{Coincidentia oppositorum} = -\text{DEUS...}$$

për të është e *dëmshme* për njeriun, se ajo (*bota*) është një pasojë *katastrofale* në theollogjinë Judaike e të Krishterë e mosbindjes së Adamit dhe Evës në kopshtin e Edenit për të mos ngrënë nga pema e ndaluar, e *dallimit* të së mirës nga e keqja...* e kështu me radhë.

Pra duke përmbledhur:

Të gjitha kuptimet e fjalës Sanskritisht "d o ş a" (दोष) lidhen me simbolizmen e numurit "d y s h" (2) tek i cili Shqipja e shpie këtë fjalë duke e motivuar kësisoj.

Mund të vëmë ré këtu edhe disa gjëra të tjera.

Ne shohim se gabimi, mëkati, padrejtësia, mungesa, dëmi, terri..., të gjitha këto koncepte të ndryshme jepen në Sanskritisht nga e njejtja fjalë "d o ş a" që siç pamë lidhej, përmes Shqipës, me simbolizmen e numurit dy (2). Me qenë se ato jepen në Sanskritisht me të njejtën fjalë është e arsyeshme që mes tyre të ekzistojë ndonjë lidhje.

Le ta zbulojmë atë dhe le të shohim me këtë rast edhe një herë rolin e Shqipës.

Kujtojmë në Ungjill, Krishtin: "*Unë e munda Botën!*" [*Ego vici mundum...*] (Gjoni, 16:33), si edhe: "*Dashuria për Botën (●) është armiqësi për Zotin (- ○)...*" (Jakovi , 4:4).

Ndaj pra dhe Krishti predikon në Ungjill mosdashurinë për Botën materiale dhe parathotë fundin e saj... Këto e shumë e shumë pasazhe të kësaj natyre, dëshmojnë se edhe Krishtërizmi i mirëfilltë, zanafillor, rikonfermon negativitetin e Botës ashtu sikundër kjo del edhe nga analizat tona gjuhësore.

- * Zoti i tha Adamit dhe Evës në Parajsë: "*Mund të hani nga çdo pemë, por veç jo nga ajo e Njohjes, e dallimit mes të Mirës dhe të Keqes. Se, menjëherë porsa që të hani prej saj do të vdisni*". (Gjeneza, 2:17)

Mëkati sikundër edhe faji, gabimi, vështrohen si një *mungesë*...

Mungesë do të thotë: *jo plotësi, jo tërësi*. Me qenë se simboli *i plotësisë, i tërësisë* është, siç dimë, \bigcirc , "mungesa e plotësisë", shkurt *mungesa, e mangëta*, do të jetë simbolikisht $-\bigcirc$ e pra edhe \bigoplus .

Duhet të kemi pra simbolikisht, me qenë se *mëkati, faji, krimi, gabimi*... tregohen simbolikisht, arkeotipisht me " \bullet ":*

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \bigoplus & \dots(F) \\ \text{mëkat,} & & \text{mungesë} & \\ \text{gabim, faj} & & & \end{array}$$

Algoritmi Simbolik e rikonfermon plotësisht këtë, me qenë se ne gjejmë duke transkriptuar konceptet e shprehura nga fjala Sanskritisht "*d e ś a*", një ekuacion simbolik në F.

Ky ekuacion rikonfermohet dhe nga Shqipja:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \bigoplus & \dots(F) \\ \text{p i s} & & \text{p j e s ë} & \end{array}$$

Mund të shtojmë se fjala "*d ë m*", "*d ā m*" (në kuptimin e lat. *damnus*, ingl. *damage*), lidhet mbrenda Shqipes me fjalën "*d a m*", "*d a m u n*"... (nga folja *DAJ*). Dhe kjo sepse siç pamë:

$$\begin{array}{ccc} \bigoplus & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{d a m, damun} & & \text{d ë m} & \\ (\text{ingl. } \textit{divided, split}) & & (\text{ingl. } \textit{damage}) & \end{array}$$

* Shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, në fund të tekstit.

- 6) Hebr. **N a t h a n a e l** (נ ת נ א ל) = Emër i përveçëm që do të thotë "I dhënë nga Zoti", "dhuratë e Zotit"...

Do zbërthyer si:

N a t h a n a e l

dhe me Shqipen:

"N a (e ka) d h a n ë* Ylli"

Këtu: shq. **Ylli** = hebr. **El** = **Zoti**. Gjë që rikonfermohet edhe nga sa lexojmë tek Cirlot: "*The 'flaming star' is a symbol of the Mystic Centre...*"**

"N a t h a n" do të thotë në Hebraisht "i dhanë" (ingl. *given*). "na-" shërben në Hebraisht si një prefiks për diatezën e pësorës, e pra rrënja është "t h a n", e pra me Shqipen "d h a n", pjesore e foljes "me *dhanë*".

- 7) Hebr. **E m m a n u e l** (ע מ נ י א ל) = Emri që ju vu Krishtit kur lindi, që do të thotë në Hebraisht: "*Ësht me ne Zoti*" (ital. *Dio e con noi*, ingl. *God is with us*)***

Kjo është një fjalë "teoforike" (që përmban emrin e Zotit) dhe që përbëhet nga dy fjalë Hebraike: ל א = "E l", që do të thotë "Zot", dhe: נ ו מ נ ע = "I m m ā n ū", që do të thotë "me ne".

Vëmë ré se trajta e mirëfilltë është Shqipja: "â m e n e" ("është me ne"), kurse trajta e transkriptuar e Hebraishtes: "I m m ā n ū" flet për një asimilim regresiv të grupit: hebr. *mm* < shq. *mn*.

* Në Shqip: "dhanie" = "dhunti" = "dhuratë"... (ingl. "*gift*")

** Cirlot (fq.310): '*Ylli i përflakur' është një simbol i Qendrës Mistike...*

*** Tesktualisht, tek Ungjilli sipas Matheut (1:23): "*Dhe ja: Virgjëresha do të mbetet me barrë dhe do të lindë një djalë, dhe emëri i tij do të jetë Emanuel, që do të thotë 'Zoti është me ne'.*"

Motivimi pra me anë të Shqipes bëhet si:

â me ne Ylli

("âsht me ne Ylli" = "âsht me ne Zoti")

Do të shohim se *me anë të Shqipes* motivohen shumë e shumë fjalë Hebraike, disa nga të cilat në disa raste të veçanta mund t'ishin edhe të vetmotivueshme pa nevojën, pra, të ndërhyrjes së Shqipes. Por kjo sidoqoftë na lejon prap se prap, të flasim për një sërë *konkordancash* mes këtyre dy gjuhëve (Shqip dhe Hebraisht) madje gjer në atë pikë sa të flitet* si për dy gjuhë motra, gjë që prap sidoqoftë nuk i përgjigjet të vërtetës, me qenë se etimologjizimi i fondit leksikor Hebraik bëhet në një përqindje mjaft të madhe vetëm falë ndihmës së Shqipes.

Nga Rilindësit tanë ai që është marrë më tepër dhe më në thellësi me afërsinë e Hebraishtes me Shqipen, duke vënë në dukje aftësitë më të larta e më të shumta etimologjizuese të kësaj të fundit, ka qenë Bilotta një njohës i madh i Hebraishtes.**

8) **Ingl. b u s y** = ital. *occupato* (i z a n ë)

Motivohet me Shqipen si:

b â z a n

* Siç më rezulton nga një informacion vetjak, por i vërtetë e i sigurt që kam në dispozicion, edhe nga vetë Fan Noli, megjithëse, nga sa jam në dijeni, ai nuk ka botuar apo nuk ka lënë gjë të shkruar për këtë çështje.

** *Bernardo Bilotta* (1843–1918). Kryepriфт arbëresh, njohës i mirë i gjuhës Hebraishte i cili ka zbërthyer një seri fjalësh Hebraisht (përfshirë këtu një numër të madh emrash me përmbajtje theollogjike) duke i reduktuar tek Shqipja.

E tepërt të vëmë në dukje se Inglishtja nuk është në gjendje ta motivojë, "me forcat e veta" këtë fjalë...

- 9) **Rus. zaniatsia (заняться) = ingl. profession (zanat, zeje)**

Është Shqipja:

me zan

Që këndeje edhe Ruishtja: "**zaniatie**" (занятие) = ital. *occupazione*.

Që këndeje edhe Turqishtja: "**zanat**" = ital. *occupazione, professione*.

Në të gjitha këto fjalë operatori motivues është Shqipja:

zâ, zan, zë..., zeje...

Ky operator ka në Shqip, siç do të shohim më vonë, një spektër shumë më të gjerë se ai në Ruisht dhe në çdo gjuhë tjetër, gjë që do të thotë se ai është më autokton tek ne se gjetkë.

- 10) **Gjerm. ander = ingl. other; different; next; opposite (tjetër; i ndryshëm; i mëpasshëm; i kundërt)**

Do zbërthyer si:

a n d e r

dhe me Shqipen:

â n d ā r = ⊕

Shpënia në këtë simbol, nëpërmjet Shqipes, e fjalës gjermanisht "a n d e r", na lejon të nxjerrim (motivojmë) të gjitha kuptimet e saj.

Kemi:

$$\oplus = - \ominus = -1 \quad \dots(F)$$

Dhe del kështu kuptimi i "kundërvënies": kundërvënia Njishit, Zotit, që është kundërvënja *par excellence*, kundërvënia superlative, absolute, paradigmatiche (-1 , $-\bigcirc$), Antiteza në fillosofinë e Hegelit, mohimi i parë dialektik (mohimi i Zotit) që nga dhe Bota materiale (si një TJETËRsim a një Alienacion në fillosofinë e Hegelit^{*}) lindi.

Kuptimi "i mëpasshëm", e pra "i dyti", del duke patur parasysh sa vijon:

$$a \ n \ d \ e \ r \ \rightarrow \ \text{shq. } \hat{a} \ n \ d \ \bar{a} \ r = \bigoplus = F = -1 = 2 = \text{i dyti, }^{**}$$

ai që pason,^{***} i mëpasshmi...

Kujtojmë këtu se nga ekuacioni simbolik ($2 = -1$) të cilin e gjejmë në një mënyrë a në një tjetër në të gjitha gjuhët,^{*} rrjedh (algjebrikisht) ($3 = 0$) që përbën themelin e Matematikës Mistike.

Kuptimi "i ndryshëm", "tjetër"... e pra ($\neq 1$), ($x \neq -x$), del për faktin se tjetri, pasuesi (ingl. *the other, the next...*) duke qenë i kundërt me të parin ka nga ai *ndryshimin* maksimal, superlatif, absolut.

* Shih edhe më poshtë, fq.37.

** Një sqarim: $-\bigcirc = \bigoplus = 1/2 \quad \dots(F)$

dhe: $-\bigcirc = -1$

që nga edhe: $-1 = 1/2$

e pra: $2 = -1$

Po " 2 " është i dyti, ai që pas-on, i më-pas-shmi...

*** Vëmë ré këtu se në Shqip: "p e s" (5) dhe "p a s", "p a s o n" (2), kështu që:

$$2 \text{ (i dyti, pasuesi) } = 5 \text{ (pesa)}$$

* Do të kemi rast ta verifikojmë kronkretisht këtë...

Kështu me ndërmjetësinë e saj, Shqipja na lejoji të nxjerrim të gjitha kuptimet e fjalës Gjermanishte "a n d e r".

Vëmë re se në Shqip fjala "i ndryshëm" lidhet mbrenda Shqipes me fjalën "ndarje", gjë që na jep ekuacionin simbolik:

$$(\neq 1) = (|) \dots(F)$$

i NDRyshëm NDARje

Mistikisht kjo do të thotë që tërë ndryshmëria e Botës materiale, tërë larmia e saj, ka lindur nga n d a r j a e " \bigcirc " (\oplus) e pra, gjithmonë mistikisht (sipas mitheve kozmogonike), nga çgjymtyrimi, shpërbërja (ingl. *dismemberment*) e Hyjnisë (\bigcirc).

Me qenë se: *

$$2 = -1 = \oplus = \bullet = \neq 1 \dots(F)$$

Tjetri mohimi ndarja Bota larmia e
Pasuesi materiale Botës materiale
I dyti

ne shikojmë atëhere se *Bota fillon me të Dytin*, i cili paraqitet kështu si Krijuesi dhe i pari i saj.**

* Shih *Një Parashtrim i Shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.827.

** Sipas Rrymës së fuqishme dhe ndikimplotë në Fenë e Krishterë, si edhe krejt kulturën Europiane në përgjithësi, të njohur me emrin "Gnosticizëm", Bota është krijuar nga Demiurgu, që njihet gabimisht si Zoti i vërtetë, por që në fakt është veçse një "shpërbërës" i Tij, që me këtë krim krijoi Botën, kështu siç e njohim ne, pra një Botë të rreme.... Kujtojmë përveç kësaj se, nëpërmjet aforizmës "*Nga një krim, krymja...*", Shqipja "denoncon" fare qartë krimin e krijimit të Botës.

Po le të zgjerohemi pak mbi këtë tematikë, që të kemi të paktën një idë se "sa larg vret Gjuha"...

$$2 = -1 = \textcircled{1} = \bullet$$

Tjetri mohimi ndarja Bota materiale

Po kush është "i d y t i" (2)? Është "i n-d y t i" (Djalli, ●), na thotë Shipja, "i n-d a t i" (⊕), "i n-d a m u n i" e pra "D e m o n i" (Djalli) i cili u bë kështu "D o m i n u s", i cili u bë kështu Zot i kësaj Botës tonë materiale ku ai është "i Pari" ("pseudo i pari", -1).

Me qenë se:

$$\bigcirc = 1$$

dhe me qenë se:

$$\bigcirc = (x = -x) = \textit{Coincidentia oppositorum} = \textit{DEUS}$$

dhe me qenë se:

$$\text{"i dyti"} = 2 = -1 = \textcircled{1} = \bullet$$

ne shohim se: I dyti (djalli) është krijuar nga i Pari (1, ⓪), nëpërmjet një mohimi (-1) të këtij të fundit, nga një ndarje e Tij (⊕). Mund të themi se: i Pari e l i n d i të Dytin, e bashkë me të e nëpërmjet tij l ë n d ë n (●). Duke qenë kështu: d j a l l i është d j a l l i i Zotit të vërtetë, i Atit.

Bibla e rikonfermon këtë.

Kështu tek libri i Jobit lexojmë: "Dhe ja ndodhi që të bijtë e Zotit erdhën e ju paraqitën Atij dhe qe, mes tyre, edhe *Satana*..."*

* Jobi, 1:6.

Fakti që i pari (pseudoipari) * me të cilin Bota filloi është simbolikisht "**-1**", shpjegon shumë gjëra. Kjo tregon p.sh. përse në Rusisht "**r a z**" (раз) do të thotë "një" (herë) (= ingl. *once*) dhe në të njejtën kohë "pa", "mos", si prefiks privatif, mohues, si për shembull në "**raz-uçitsa**" (разучиваться) = ç-mësohem, "**raz-devats**" (раздевать) = ç-vesh, e kështu me radhë. Po "**r a z**" ka në Rusisht edhe kuptimin e ndarjes, e prerjes, si në "**rez-ats**" (резать) = *pres*, si edhe kuptimin e pluralitetit, të larmisë, të ndryshuermërisë, si në "**raz-nije**" (разный) = *të ndryshëm, të shumtë...* e kështu me radhë.

Kështu Rusishtja nëpërmjet operatorit të saj të lirë "**r a z**" (раз) shtron vargun e ekuivalencave simbolike në F:

$$\begin{array}{ccccccc} -1 & = & \textcircled{1} & = & \neq 1 & & \dots(F) \\ \text{raz} & & \text{rezats} & & \text{raznije} & & \end{array}$$

11) **Rus. o d i n (один)** = ingl. *one* (një)

Kjo fjalë e Rusishtes duhet të tregojë një "ndarje" (me qenë se *me ndarjen filloi gjithshka*)... Pra atëherë është i mundur një zberthim i tillë:

o d i n

dhe me Shqipen:

ô dan ose **â dan**
("âsht da", "damun", "dan")

e pra simbolikisht:

$\textcircled{1}$

dhe për ekuivalencë simbolike:

- 1

* Shih edhe ndër të tjera edhe shënimin mbi Gnosticizmin, fq.62 dhe 131.

Me qenë se fillimi lidhet me një mohim (ndër të tjera, në planin fillosofik: *mohimi i parë dialektik*), ne kuptojmë përse në Shqip "H e k" = një (1), dhe në të njejtën kohë "h e k" = heq, zbres (ingl. *subtract*) e pra " – " a ç'është njëlloj " – 1 ". Në Shqip fjala "heq" që lidhet, siç pamë me *Hekun* (= – 1) ka dhe kuptimin "vuaj", si në shprehjen p.sh. "Hoqi shumë..." (vuajti shumë). Dhe kjo kuptohet, sepse, algoritmikisht: $-1 = \textcircled{1} = \bullet$, një e zezë, një e keqe, vuajtje prà...

- 12) Hebr. r o s h (ש א ר) = ingl. *head; chief, leader; summit, top; the best; beginning, commencement, origin* (koka; kryetari, shefi, udhëheqësi; pikë, majë; më i miri; sasi e madhe; fillimi)

Le të tregojmë në se qëndron kjo lidhje e Rusishtes "r a z" (р а з) me Hebraishten "r o s h" dhe ndërhyrjen e Shqipes si motivuese.

Lidhja mes Rusishtes "r a z" (р а з) = *një*, e pra simbolikisht " – 1 " (edhe gjithashtu për arsye se "r a z-" ka, si prefiks, siç e pamë, edhe një kuptim privatif, negativ) dhe Hebraishtes "r o s h" = *krye, kokë, i pari, fillimi*, del vetvetiu për faktin se këto dy gllosa kanë një formë pothuajse identike dhe, nga ana tjetër, kuptimet e tyre janë krejt të përafërta në mos identike.*

Nga ana tjetër, Rusishtja "r a z e n", "r a z n i j e" (*i ndryshëm, të ndryshëm, të shumtë...*) e cila lidhet brenda Rusishtes me fjalën "r a z" (sepse: $-1 = (\neq 1) = \text{të ndryshëm, jo të njënjëshëm, të shumtë}$), lidhet prap me Hebraishten "r o s h", që do të thotë ndër të tjera edhe shumicë (ingl. *multitude*). Vëmë ré më në fund edhe se në Rusisht "r e z a t s" = *me pré, p-res, ris-koj*, dhe "r a z" = *pjesë, ris-k*.

Kështu, ndër të tjera, Hebraishtja dhe Rusishtja shtrojnë ekuacionin simbolik:

* Shih edhe më poshtë fq.38-39.

$$-1 = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

hebr. rosh rus. raz

Është e qartë pas të gjitha këtyre se Rusishtja "raz" ("raz-en", "rez-ats") dhe Hebraishtja "rosh", "ras", janë etimologjikisht një, lidhen me fjalë të tjera me të njejtën rrënjë.

Të kalojmë tani tek Shqipja.

- a) Në Shqip kemi: "p-r e s" (rus. *rezats*, ingl. *cut*), "r i s-k" (hebr. *ras*, ingl. *slice*, *piece*) kuptime që jepen simbolikisht me " $\textcircled{1}$ ". Këtu, mendoj, duhet përfshirë edhe Shqipja "r e s h-t" = *ndaloj*, *pres*, *ndërpres*, *pushoj*, dhe këtu duhet përfshirë, pa dyshim, edhe fjala "b-r i s k", Inglishtja "r a z-o r", Itat. "r a s-o i o".
- b) Në Shqip: "r a s h" = ingl. *I fell* (folja "to fall") si edhe "r e s h j e" = ingl. *rainfall*, si edhe "r a s t" (ital. *c a s o* < lat. *cado*, *cecidi*, *c a s u m*, *cadere*; gjerm. *die Falle* = rast, që lidhet me foljen *fallen* = me rà...). Të gjitha këto fjalë simbolizohen në mënyrë adeguate me " \downarrow ". Dhe me qenë se fjalët Shqipe në (a) dhe fjalët Shqipe në (b) kanë forma të ngjashme e përshkruajnë simbole ekuivalente, siç është " $\textcircled{1}$ " e " \downarrow ", ne mund të nxjerrim si përfundim se kemi të bëjmë në të dy rastet me fjalë të bashkrrenjësme, a shkurt, me "të njejtën" fjalë.*

Vëmë ré këtu se në Rusisht "rush-itsa" (*рушится*) = *bie*, *rrëzohem*, *shkatërrohem*, dhe kjo fjalë si rrënjë ("rush") lidhet padyshim mbrenda Rusishtes me "raz-", "rez-"..., dhe kjo për arsye se kemi të bëjmë me fjalë me forma të ngjashme e me kuptime që përshkruajnë simbole ekuivalente, siç janë " $\textcircled{1}$ " dhe " \downarrow ".

* Shih lidhur me këtë edhe fq.50, 271 dhe 551.

Kështu mund të themi se Rusishtja shtron këtë varg të gjatë ekui-valencash simbolike:

$$\begin{array}{ccccccc} -1 & = & \textcircled{1} & = & \neq 1 & = & \downarrow & \dots(F) \\ \text{raz} & & \text{rezats} & & \text{razen} & & \text{rushitsa} & \end{array}$$

S'ka dyshim se Rusishtja "*rush-itsa*" dhe Shqipja "*rash*", "*resh-je*"... janë e njehta fjalë sepse kanë formë të përngjashme dhe përshkruajnë të njejtin simbol " \downarrow " .

Mund të shtojmë këtu edhe Shqipen "**p-r i s h**" që lidhet mbrenda Shqipes, ndër të tjera, me "**p-r e s**", si edhe ndër të tjera, me Rusishten "**r u s h - i t s a**" (*рушится*) = *shemben, shkatërrohem*.

- c) Në Shqip: "**r i s i**" = *rini, të qenurit të ri* (ingl. *young, youth*). Me qenë se i riu, siç thamë më lartë, mohon dialektikisht të vjetrën, ne mund të shkruajmë simbolikisht " -1 " ose edhe " $-\textcircled{1}$ " .

Në Shqip gjithashtu: "**r i o s h**" = *iri*, e pra përsëri " -1 " .

Me qenë se: $-1 = \textcircled{1} = \downarrow \dots(F)$, shohim se "**r i s i**" dhe "**r i o s h**" duhen lidhur, mbrenda Shqipes, me "**p-r e s**", "**r i s -k**", "**r e s h t**" ($\textcircled{1}$) si edhe me "**r a s h**", "**r a s t**", "**r e s h t j e**", "**p-r i s h**"... (simb. \downarrow).

- ç) Në Shqip: "**s ë r i s h**" që zërthehet në "**s ë - r i s h**", ku "**s ë**" është një nyje e përngjitur dhe bërthama semantike përbëhet nga "**r i s h**". Kuptimi i kësaj fjale është "**së dyti**", "**një herë tjetër**", dhe dimë që simbolikisht: *tjetri, i dyti* = **2** .

Po tani le të vërejmë se si në Shqip: "**p ë r s ë r i t j e**" (që duhet zërthyer në "**për-së-ri-t-je**" = "**një herë tjetër**", "**së dyti**", e pra simb. **2**), dhe "**p ë r t ë r i t j e**" që duhet zërthyer në "**për-të-ri-t-je**" që do të thotë ri-gjenerim, rinim (ingl. *renewal*), e pra atëhere, me qenë se e reja mohon dialektikisht të vjetrën, simb. " -1 " .

Kështu Shqipja shtron edhe në këtë mënyrë ekuacionin e rëndësishëm:

$$2 = -1 \quad \dots(F)$$

përSËritje përTËritje

Le të vëmë ré këtu diçka me rëndësi që e lidh thujtë–homonimi të Shqipes me një tipar themelor të mendimit dhe të praktikës mitike të studjuar me mjeshtëri dhe hollësi nga Mircea Eliade në librin "*Le mythe de l'éternel retour*". Në kapitullin '*Le mythes et l'histoire*' lexojmë ndër të tjera:

"Un objet ou un acte ne devient réel que dans la mesure ou il imite ou répète un archetyp. Ainsi la réalité s'acquiert exclusivement par répétition ou participation; tout ce qui n'as pas un modèle exemplaire est 'dénué de sens', c'est-à-dire manque de réalité..."

(Një objekt ose një veprim bëhet real vetëm për sa e për aq sa ai imiton apo përsërit një arketip. Kështu pra Realiteti arrihet vetëm nëpërmjet përsëritjes apo pjesëmarrjes; një send (a veprim) që nuk merr për shembull një model, 'nuk ka kuptim', nuk ka realitet...)*

Në kapitullin '*La regeneration du temps*', Autori tregon se si Bota mbahet me një përsëritje të Aktit të Krijimit (nëpërmjet një mite kozmogonik). Një nga këto mite kozmogonike është ndër të tjera edhe ai i *Hieros Gamos*, i "Martesës së Shenjtë" mes Qiellit (parimi mashkullor, **3**) dhe Tokës (parimi femëror, **2**). Përsëritja e këtij akti (rituali i martesës, i dasmës) përtërin Botën e Njeriun.**

Ne shohim pra se *Bota mbahet duke u ribërë* (duke përsëritur bërjen). Shqipja e jep bukur këtë me **ban** (bahet) dhe **ban** (m-bahet), ku në

* Mircea Eliade, "*Le mythe de éternel retour*" (fq.48).

** *Ibid.* (fq.65): "...Martesa e Shenjtë realizon në një mënyrë konkrete 'rilindjen' e botës dhe të njeriut..."

rastin e parë është fjala për *bërjen, krijimin e Botës*, ndërsa në rastin e dytë për *mbajtjen, konservimin e saj*.

- d) Në Shqip: "i r i", "e r è" (ingl. *young, new*) lidhet mbrenda Shqipes "me r à" (unë *rash*, ti *rè*, ai *rà*...) edhe kjo sepse kemi të bëjmë me dy fjalë me forma të përngjashme dhe me kuptime që lidhen me simbole ekuivalente, siç janë "– 1" (*iri*) dhe "↓" (*rè, rà,...*).
- dh) Në Shqip: "r i n i a" (ingl. *youth*), e pra "– 1", dhe "r è n i a" (ingl. *to fall*) e pra simb. "↓". Pra Shqipja shtron edhe në këtë mënyrë ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \downarrow \quad \dots(F) \\ \text{r}i\text{n}i\text{a} & & \text{r}\grave{e}\text{n}i\text{a} \end{array}$$

Mos harrojmë se në Shqip: "d j a l i" dhe "d j a l l i" (= kundërshtari, lat. *Adversarius*, e pra simb. "– 1").

Sejcila nga këto dy figura simbolike ekuivalente shpreh një mit kozmogonik: "– 1" [që mund të shkruhet edhe si "– ○", me qenë se: ○ = (x = –x) = *Coincidentia oppositorum* = *DEUS*] do të thotë *mohimi i Hyjnisë* (– ○), sakrifikimi i një Qenje Hyjnore. Lexojmë me këtë rast tek Cirlot:

"The basis of most cosmogonies is the 'cosmic sacrifice', expressing the idea that the creation of forms and matter can take place only by modifying primordial energy. Such a modification, so far as primitive and protohistoric peoples are concerned, was seen to exist in such painful forms as mutilation, struggle or sacrifice. In Babylonian cosmogony it assumed the form of the killing of the original mother Tiamat (the dragon) whose body was used in the

creation of heaven and earth... According to the Rigveda, the gods would sacrifice a primeval being – the giant Purusha..."^{*}

(Shumica e miteve kozmogonike flasin për një 'sakrificë kozmike', pas të cilës qëndron bindja se krijimi i formave dhe i materies është i mundur vetëm nëpërmjet një modifikimi të Energjisë Primordiale. Një modifikim i tillë, përsa i përket popujve më primitivë dhe parahistorikë, qëndronte në trajta të tilla të dhimbshme, si çgjymtyrimi (ingl. *mutilation*), lufta, sakrifica, therrorizimi... Në kozmogoninë Babilonase ajo mori trajtën e vrasjes së nënës zanafillore Tiamat (Dragoi), trupi i së cilës u përdor në krijimin e Qiellit dhe të Tokës... Sipas traditave indiane, krijimi i botës lidhej me luftën e perëndive me një tribu demonësh me emrin Asura ose me përbindësha të tjerë të ndonjë lloji tjetër. Sipas Rigvedës, Perënditë sakrifikuan një qenie primordiale, gjigandin Purusha...)

Lidhur me figurën e dytë simbolike që është ajo e rënies, ajo flet për një mit tjetër kozmogonik – atë të rënies së engjujve rebelë me në krye Luciferin, tashmë Shejtani, që krijuan, pas *ndarjes* (⊕) dhe *rënies* (↓), një mbretëri të tyre, e pra këtë Botën tonë materiale, mbret i të cilës është pikërisht Luciferi. Është interesant të vihet re këtu se si në Hebraisht: "Malak" (מ ל א כ) = "Engjull" (dhe Djalli ish një krye-engjull); "i Mallkuar" (dhe Djalli u mallkua nga Zoti, pasi ju kundërvu dhe u nda prej Atij^{**}; "mbret" (dhe Djalli, siç thamë, u bë Mbret i Botës, siç e rikonfermon

* Shih Cirlot, "Cosmogonic sacrifice", fq.64.

** Kujtojmë këtu Hebraishten "m a l a k" (מ ל א כ) = ingl. *to break off, to nip off (partly)...* (përçaj, copëtoj).

Kjo do të thotë edhe pra që Djalli është i mangët, nuk është i plotë, është fragmentar:

$$\oplus = - \bigcirc \quad \dots(F)$$

fragmentaritet jo plotësi, jo përsosje

Ungjilli ku ai cilësohet nga Krishti is Urdhëtari i kësaj Bote, me të cilin por Ai Krishti s'ka asnjë lidhje...)*

...Figura e dytë (simboli i rënies) mund të interpretohet gjithashtu si miti kozmogonik i rënies (↓) së Frymës (○) dhe krijimit, për pasojë, të materies dhe tërë Botës materiale:**

$$\text{○} \downarrow = \bullet$$

Rënia e Frymës Krijimi i materies

Le të vëmë re se këtu kemi të bëjmë, prap se prap, me një mit kozmogonik, me qenë se mund të shkruajmë, për ekuivalencë:

$$E(\text{○}) \downarrow = F(\bullet)$$

Kjo është dhe teza e mbrojtur nga Neo-platonizmi.***

Sipas fillosofisë së Hegelit**, Bota krijohet në momentin e dytë (2), në atë të Antitezës, që mund të tregohet fare mirë simbolikisht me " - 1 " ose edhe " - ○ " me qenë se: **1 = ○ = Fryma Absolute.**

* Kujtojmë nga Ungjilli, Krishtin: "Këndej e tutje s'kam për të biseduar më me ju: sepse **princi i kësaj bote** është në të ardhur dhe s'ka asnjë gjë të përbashkët me mua." (Gjoni, 14:30)

** Cirlot, "Labyrinth" (fq.173): "The fall, i.e. the loss of the Spirit in the process of Creation..." (Rënia, d.m.th. humbja e Frymës gjatë procesit të Krijimit...)

*** Ringjallja e Platonizmit po në forma disi të ndryshuara. Neo-platonizmi i jep prioritet Frymës mbi Materien. Është pra një doktrinë thellësisht spiritualiste që, si e tillë, ka ndikuar shumë edhe në theollogjinë e Krishterë, atë Islame, në Gnosticizëm e kështu me radhë. Vepër themelore është "Eneadet", shkrime të fillosofit Plotinus të përpiluara nga nxënësi i tij Prophyry rreth vitit 270 p.K.

** Nga "*Libri i Aforizmave*" kujtojmë lidhur me sistemin fillosofik të Hegelit ndër të tjera edhe këto:

Në krye, para se Bota të krijohej, kemi Frymën Absolute (*Teza, 1*), në gjirin e të cilës të dy frymërat, subjektive dhe objektive, janë në harmoni të plotë mes tyre, bashkekzistojnë në paqe; pra këtu: ($x = \boxed{x}$) ... (E) dhe: $-(\rightarrow \neq \leftarrow) = \text{jo konflikt, jo luftë}$.

Ky është momenti i parë i Triadës. Në momentin e dytë që përbën Antitezën dhe që lidhet, sipas Hegelit, me alienacionin (tjetërsimin a, e thënë më troç, "marrinë" e Frymës Absolute), të dy frymërat, fryma subjektive edhe ajo objektive, gjer atëhere në paq, i kundërvihen njëra tjetrës, e pra në këtë rast do të kemi: ($-x = \boxed{x}$) ... (F) dhe sigurisht: $(\rightarrow \neq \leftarrow)$.

Por kalimi nga E në F përbën një mith kozmogonik. Pra, në momentin e dytë të Triadës hegeliane ne kemi krijimin e Botës Materiale si pjellë e Alienacionit (çmendurisë) të Frymës Absolute.

Momenti i tretë është Sinteza që përpiket ti pajtojë këto dy momente, që realizon por vetëm një pajtim pjesor, e pra një ekuilibër të përkohshëm, e pra një kompromis që ne mund ta tregojmë fare mirë simbolikisht me ∞ ...

Fryma Absolute ($-\infty$) në këtë moment, nuk është më e tillë, ajo relativizohet (∞). Ky proces (*Werden*), rendjeje drejt Absolutit, vazhdon me mohime e integritete të vazhdueshme (ashtu sikundër që Hegeli na i përshkruan hollësisht në librin më të famshëm të tij, me titull: "*Die Phänomenologie des Geistes*" (*Fenomenologjia e Frymës*), deri sa më në fund, Fryma dizalienohet, *kthehet* përsëri në vehte e pasuruar me përvojën e atyre që pa a njohu gjatë përvojës të thellë të udhëtimit të saj të gjatë në procesin e *Werden*-it. Fryma Absolute është prap tani e tillë siç qe para nisjes të Procesit. Pra kemi një lëvizje *rrethore*, fundi që përkon me fillimin, a më saktë, me të Tërën para fillimit.

Mund të shkruajmë atëhere:

Fundi (ω) = Fillimi, e Tëra (\bigcirc)

Pasi arritëm në këtë pikë në kuptojmë se në fjalët: *i ri, rà, rash, risí, rini, riosh, reshje,...* etj. të Shqipës, thelbi i mirëfilltë semantik qëndron tek gërma "R".

Mund të shkruajmë pra "përmbledhtazi":

$$R \{ -i, -e, -a, -isi, -ash, -iosh, -osh, -es, -is, -ini, -az, -ez, -as, \dots \}$$

që do të thotë se, për shembull, simbolikisht:

$$\begin{aligned} "i ri" &= "rà" = "rishtas" = "rini" = "rosh" = "raz" = "ras" \\ &= "riosh" = "res" = \dots = R = 2 \dots \end{aligned}$$

dhe për ekuivalencë simbolike:

$$2 = -1 = \downarrow = (\neq 1) \quad \dots(F)$$

Ne pamë sa i larmishëm në trajta e kuptime është spektri i simbolit (gërmës) "R" në Shqip, më i pasur se në Rusisht dhe në Hebraisht.

Duke qenë kështu, Shqipja motivon më mirë fjalë të trajtës "R {...}" në këto gjuhë.


Ekuacioni i rëndësishëm ($2 = -1$) jepet në gjuhët që lidhen me Latinishten, me biseminë e operatorit "r i-" (*ris-, res-, re-,...*) që nuk është tjetër veçse Shqipja "i r i", dhe kjo sepse i ri-u është *i dyti* (pas të vjetrit, të parit), e pra simbolikisht **2**, dhe në të njejtën kohë ai i *kundërvihet* dialektikisht të vjetrës, e pra të parit, e pra atëhere simb. -1 . Kështu duke marrë prefiksën "ri-", "re-", "ris-"..., në gjuhët e huaja me kuptimin "i riu", "e reja" etj., ne vihemi në gjendje të shpjegojmë mitikisht,

Ekuacion ky që shtrohet, siç pamë nga Inglishtja, me biseminë e "u p" dhe "over" dhe me Shqipen me "mbarë" (○) e "mbarim" (ω).

filosofikisht dhe llogjikisht, përse ky prefiks ka këto dy vlera: "2" dhe "–1". Në asnjë gjuhë tjetër kjo nuk është e mundur.

Mund të themi atëhere se: "r i-", "r e-", "r i s-", "r e s"... në gjuhët e familjes Latine motivohen nëpërmjet Shqipes: "i R i", "e r e", "r i s í", "r e s h t", "r i s h t a z"... etj.

Le të shtojmë se ekuacioni themelor simbolik ($2 = -1$) jepet gjithashtu nga Gjermanishtja, Inglishtja e Shqipja edhe si vijon:



13) Ital. d e r i v a r e = rrjedh (prejardhje), prodhohet nga...

Mund të ndahet në:

d e r i + v a r e

* Shih dhe fq.664.

ku "-v a r e" është një prapashtesë verbalizonjëse që identifikohet me Shqipen "b ë r ë" dhe me Sanskritishten "b h a r a" = *běj...* Theksi semantik bie kështu dek "d e r i-" që s'është tjetër veçse Shqipja "d a r ë" (nga folja DAJ), e pra simb. $\textcircled{1}$.

Pra kemi:

deri vare \rightarrow shq. bërë Darë = $\textcircled{1}$

Ne dimë se gjithshka rodhi (si *prej*-ardhje, si *zanafillë*) nga ndarja e të TËRËS ($\textcircled{0}$) në dysh [$\textcircled{1}$, $1/2$, ()]. Kjo qe rrjedhja, derivimi i parë që përcaktoi rrjedhjen, krijimin e Botës materiale. Dhe në fakt "derivimi" (ital. *derivazione*), "prejardhja" e parë, siç na mëson Mendimi Mitik (me mitet e ndryshme kozmogonike), ka qenë i tillë.*

* Krijimin e Botës me anë të ndarjes, shkëputjes e pra me anë të "d e r i v a z i o n e", e ndeshim edhe në gjithë mendimin mistik të Mesjetës, si për shembull tek Paracelsi, një nga përfaqësuesit më karizmatikë të krejt një epoke, mendje gjeniale, mistik i bindur dhe fillosof i hollë. Rikujtojmë këtu *dictum*-in e tij:

"Die *Separatio* ($\textcircled{1}$) ist aller Geburt (\bullet) Anfang."

[*Ndarja është fillimi i çdo lindjeje...*]

Veç kësaj: Në mitin Bibilik, shkaku i lindjes së Botës materiale, të kësaj Botës sonë fenomenale, të ngjizur me dukurira, gjendet në mosbindjen e Adamit dhe Evës, Zotit, gjë që më pas përbëri edhe dogmën e të ashtuquajturit "mëkat zanafillor" (lat. *peccatum originalis*).

Por siç kemi parë:

mëkat = \bullet = $\textcircled{1}$ (ndarë-ndyrë) = *ndarje nga Zoti...*

Vëmë ré këtu gjithashtu se simboli " \bullet " mund të interpretohet ndër të tjera edhe si *materie*, *Botë materiale*. Në këtë mënyrë pra, dogma judaike e krishterë, ripohon atë që thotë Paracelsi dhe pra *a fortiori* edhe shpjegimin e fjalës Latine "d e r i - v a r e" nëpërmjet Shqipes "b ë r D A R", e pra:

Me qenë se Gjuha, siç dimë tashmë, referon gjithmonë tek Qendra dhe tek ngjarja *par excellence* siç është krijimi i Botës, çdo *rrjedhje*, çdo *origjinim* do të vështrohet atëhere si një *ndarje*,* që nga edhe arsyeja që Italishtja "d e r i v a r e" mund të motivohet me Shqipen "d a r ë".

14) Lat. **terminus** = kufi, cak

Kjo fjalë lidhet si me zanafillën e saj me Greqishten "t e r m a" (τ ε ρ μ α = cak, skaj, fund (ingl. *extremity, end*). Bërthama semantike e kësaj fjale përbëhet nga "t e r" që, me qenë se tërë fjala tregon një "cak", një "kufi", e pra një "ndarje" (simb. ⊕), nuk mund të jetë tjetër veçse Shqipja "d a r" (nga folja DAJ).

Është e qartë pas kësaj se edhe fjalë të tilla si Italishtja "t e r m i n a r e" (*për-fund-øj*) etj. motivohen prap, si më sipër, me Shqipen.

Po ashtu Inglishtja "e n d" = *fund*, motivohet edhe ajo me Shqipen.

Ajo mund të ndahet në:

$$\begin{array}{c} \oplus = F = \bullet = \textit{materia, Bota materiale} \\ \text{(ndarë)} \qquad \qquad \text{(ndyrë)} \end{array}$$

Miti judaik i engjëjve rebelë, me në krye Luciferin, tregon se si atë ngritën krye kundër Zotit, si u *ndanë prej Tij* (⊕), gjë që e bëri Luciferin, veç të tjerash, një *Demon* (shq. *damun* = i ndarë; it. *diviso, separato...*), si dhe një farë DEMI-ur-gu, pra një pseudo-krijues të një Bote më vete dhe të "parin" e saj.

* Rikujtojmë këtu nga Mircea Eliade (shih fq.33): "*Një objekt apo veprim vështrohet si real për aq sa ai imiton a përsërit një arketip. Kështu realiteti përftohet vetëm nëpërmjet përsëritjes a pjesëmarrjes...*"

Dhe ajo që përsëritet, tek e cila "participohet", është kurdoherë Gjesti i Parë i Krijimit të Botës (Ngjarja *par excellence*). Kështu është për çdo veprimtari të njeriut primitive, kështë është edhe për Gjuhën.

e + n d

dhe me Shqipen:

â n d à = simb. ⊙
("âsht ndà")

që ëshë pikërisht kuptimi i kësaj fjale në Inglisht, ai i cakut të fundëm.

Vëmë ré se, sipas të lashtëve, Bota materiale kishte një fund, një cak, një kufi. A e thënë ndryshe, ajo ishte e fundme, gjë që jepet fare mirë nga simboli " ⊙ ". Kishte një Botë të fundme, që ishte Bota jonë materiale, dhe një Botë Qiellore, e Perëndive. Për një kohë të gjatë Shkenca e Perëndimit e hodhi poshtë mendimin se Bota mund të kishte një cak, një fund në Hapësirë, si edhe gjithashtu se ajo kishte edhe një kufi, cak në Kohë, se me fjalë të tjera ajo kishte një fillim (krijim) e pra edhe një fund. Por sot Shkenca detyrohet të vetpërgënjeshtrohet, duke pranuar e provuar se Bota vërtetë ka një kufi në Hapësirë (Teoria e Vrimave të Zeza) dhe një fillim e fund në Kohë (Teoria e *Big Bang*-ut dhe *Big Crunch*-it), duke i dhënë kështu të drejtë, si edhe në shumë gjëra të tjera, të lashtëve.*

- 15) **Lat. d e t e r m i n o** = ingl. *to bound, fix the limits of, to determine*
(për-cak-toj, vu caqe, kufij)

Është e qartë se edhe kjo fjalë mund të motivohet me Shqipen:

d a r

ose edhe:

t h y e r

...që lidhen me Latinishten "t e r" (ku bie theksi semantik i tërë fjalës).

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

Në të dyja rastet fjala përcillet tek simboli " ⊕ ", një nga interpretimet e të cilit është ai i *cakut*, i *ndarjes*, i *kufirit* etj.

- 16) Lat. **deterior** = ingl. *lower, inferior, poorer, worse* (më i ultë, inferior, më i varfër, më i keq)

Edhe kjo fjalë, si fjala e mësipërme, motivohet në të njejtën mënyrë nga Shqipja. Vëmë ré se me këto dy fjalë Latinishtja shtron, me ndihmën e Shqipes, ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{determino} & & \text{deterior} & \end{array}$$

Ky është një ekuacion tepër i përhapur në Gjuhë dhe kjo sepse ka të bëjë me krijimin e Botës, në qoftë se interpretojmë " ⊕ " si *ndarje* dhe " ● " si *materie*, Botë materiale. Rikujtojmë prap e prap të thënën e famshme të Paracelsit: "*Die Separatio (⊕) ist aller Geburt Anfang (●)*"...

Në Shqip ky ekuacion jepet në mënyra të shumta, si: "*n d a m j e*" (⊕) dhe "*n d y m j e*" (●), "*p j e s ë*" (⊕) dhe "*p i s*" (●), etj. etj.

Le të vëmë ré me këtë rast sa vijon:

- a) Me qenë se Shqipja jep:

$$\text{pes (5)} = \text{pjesë (}\oplus\text{)} = \text{pis (}\bullet\text{)} = \text{pse (}\leftrightarrow\text{)}$$

ne mund te themi se:

"**PESA (5)** është **PSE**-ja (↔) e **BOTËS MATERIALE (●)**,
që është kështu e **PIS**-të (●)
dhe vetëm një **PJESË (⊕)** e të **GJITHËS (○)**."

Kjo gjen një rikonfermë të plotë në Mendimin Mitik.

Kështu për shembull tek Cirlot lexojmë:

"Traditionally, the number five symbolizes man after the fall... [The] quinary is symbolic of the whole of the material world..." (Sipas traditës pesa simbolizon njeriun pas rënies... [Pesa] simbolizon tërësinë e botës materiale...) "*

dhe më tutje:

*"...the Hieros Gamos is signified by the number five, since it represents the union of the principle of heaven (three) with that of the 'Magna Mater' (two)." (...Hieros Gamos tregohet me numurin pesë (5), me qenë se paraqet bashkimin e parimit Qiellor (tre) me atë të Magna Mater (dy).)***

Shprehja *"the quinary is symbolic of the material world..."* përkthehet në gjuhën e simboleve: $5 = \bullet \dots(F)$, ekuacion ky që ne nxorrem me "p e s" (5) e "p i s" (●).

Një nga mithet kozmogonike është edhe ai i *Hieros Gamos*, "Martesës së Shenjtë", që simbolizohet me *bashkimin* e treshit (3) me dyshin (2). E pra ky bashkim që krijoi Botën, vlen simbolikisht *pesë* (5). Kështu mund të themi se:

"P e s a e krijoi Botën."

Vëmë ré me këtë rast se gjer dhe vetë fjala "b a s h k i m" në Shqip, duke u zbërthyer në "b a s h - k - i m" na jep si bërthamë semantike "b a s h" që, me qenë se "b" dhe "p" janë të dyja bilabiale (dybuzore) dhe "sh" dhe "s" janë të dyja sibilante, s'ka asnjë dyshim se është prap

* Cirlot, fq.270.

** Po aty, fq.233.

Shqipja "p e s" (5). Fakti që *pesa* është e tëra (tërësia) materiale, vërtetohet linguistikisht me Greqishten "p e n d e" (π έ ν τ ε) (5) = "p a n d a" (π ά ν τ α) (të gjitha), dhe me Greqishten "p a s" (të gjitha) që, siç do të shohim, reduktohet tek Shqipja "p e s".

- b) Fjala Shqip "p a s" (2), siç e kemi parë, lidhet dhe ajo me "p e s ë n" (5). Ne kemi vërtetuar, nëpërmjet Matematikës Mistike,* se me ekuacionin simbolik: "p e s" (5) = "p i s" (●), Shqipja, siç pamë, lidh krijimin e *Botës* dhe, në të njejtën kohë, të së keqes (●), me numurin *pesë*.

Kuptojmë atëhere gjithashtu përse *Bota nuk është e Tëra*** me qenë se Shqipja jep "p e s ë" / "p j e s ë" dhe Matematika Mistike (5 = 1/2).

- 17) *lat. post* = *ingl. afterwards; after; behind* (pas, pastaj, prapa)

Lidhet në instancë të fundit si me motivuesen e saj me Shqipen:

i p e s t ë

që e shpie atë tek simboli që ajo, "pa ditur" përshkruan, do me thënë tek numuri 5 = shq. p e s.

Algoritmi Simbolik na jep, siç dimë, ekuivalencën:

$$\begin{array}{ccc} 2 & = & 5 \quad \dots(F) \\ \text{lat. post} & & \text{shq. i pesti} \end{array}$$

* Le të kujtojmë edhe një herë vërtetimin e kësaj ekuivalence:

$$(2 = 5) \rightarrow (5 - 2 = 0) \rightarrow (3 = 0)$$

...ekuacion themelor i Arithmetikës Mistike.

** Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* fq.837.

- 18) Ital. **poster**i = ingl. *posterity, descendants* (pasardhës; brezat e ardhshëm)

Lidhet me Shqipen:

pastaj

dhe përfundimisht, si me motivuesen e vet, me Shqipen:

i pesti (5)

Kjo fjalë Italisht (lat. "p o s t e r u s" = pasardhës, i ardhshëm) mund të krahasohet edhe me fjalën Shqip "i p o s h t ë r" (i poshtëm) dhe kjo lidhje qëndron për arsye sepse, siç pamë, Shqipja shtron ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} 5 & = & \downarrow \quad \dots(F) \\ \text{i pesti} & & \text{i poshtëri} \end{array}$$

Që është kështu rikonfermohet nga fakti që në Italisht: "d i s c e n d e r e" = *me zbrit*, e pra simb. \downarrow , dhe në të njejtën kohë "i d i s c e n d e n t i" = *pasardhësit*. Pra shohim se edhe Italishtja shtron ekuacion:

$$\begin{array}{ccc} 2 & = & \downarrow \quad \dots(F) \\ \text{discendente} & & \text{scendere} \end{array}$$

Ekziston edhe një rikonfermim tjetër, mitik, të pohimit të mësipërm. Dihet se Bota është krijuar me një n d a r j e (nga Zoti, nga Qendra, e pra me këtë rast : "ndarje" = decentrim), simb. \odot , pas të cilës *pas-oi* (2) një *rënie* (zbritje), simb. \downarrow . Kjo është teza mitike dhe mistike e krijimit të Botës me një rënie (ingl. *fall*). Që Bota filloi me një rënie Shqipja e tregon bukur me:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \downarrow \quad \dots(F) \\ \text{filloj} & & \text{falem} \\ & & (\text{falitem} = \text{bie}) \end{array}$$

Në Shqip kuptimi i foljes "fal" si "rënie" është ruajtur qartë në shprehje të tilla si "u fal dielli" (= dielli rà, zbriti, perëndoi).

Vëmë ré se Italishtja me "s c e n d e r e" = *zbres*, e pra simb. ↓ , dhe "d i s c e n d e r e" = *me prejardh, me rrjedh prej...* dhe "i d i s c e n d e n t i" = *pasardhësit*, rikonfermon prap e prap se pasardhësit janë ata që zbritën, që ranë..., e pra se "i p o s t e r i" janë ata që ranë poshtë, të poshtëmit, "të p o s h t ë r i t".

Italishtja ripohon gjithashtu në këtë mënyrë tezën mitike (ndër të tjera: miti i rënies së engjujve rebelë, miti Biblik i rënies së Adamit dhe Evës...) dhe mistike (mbrojtur, ndër të tjera nga Neo-Platonizmi*) të "fillimit" të Botës me një "falje"** (falitje, rënie = ingl. *fall*).

19) **Ital. i m p o s t o r e** = ingl. *impostor, swindler, liar* (fallsifikues, gënjeshtar, mashtrues)

Këtu prefiksi "im" (nga "in") nuk luan ndonjë rol semantik, kështu kuptimi lidhet krejtësisht me "**p o s t o r**" që është Shqipja "i **p o s h t ë r**" dhe pra "i **p e s t i**" e pra 5 .

Kështu Gjuha (këtu: Italishtja, Latinishtja etj.) na thotë se pasardhësit (pra neve, Njerëzit, tërë Bota jonë materiale...) janë të poshtër, ata janë të rremë, dhe Realiteti i tyre për pasojë është edhe ai i rremë, një fallsifikim, një mashtrim. Kjo është në përputhje të plotë, ndër të tjera, edhe me Fillosofinë e lashtë Indiane, siç lexojmë tek Cirlot:

"...The world, not as it is in itself, but as we perceived it and react upon it, is the product of our own Maya-Shakti and of the motion picture that it incessantly produces... The highest Being is the lord and master

* Shih edhe më poshtë, fq.36 dhe 62.

** Shih Cirlot (fq.173) : "...*humbja e Frymës gjatë procesit të Krijimit...*"

*of Maya. All the rest of us... are the victims of our individual Maya... to liberate man from such a spell... is the principal aim of all great Indian philosophies."**

(...Bota, jo ashtu si ajo është në vetvehte, por ashtu sikundër ne e perceptojmë atë dhe reagojmë ndaj saj, është një pjellë e Maya-s apo iluzionit... kështu ne jemi të gjithë rob të Maya-Shakti-t tonë vetjake dhe i "filmave" që ajo parreshtur prodhon... Qënja Supreme është edhe zot e padron i Maya-s, kurse ne, të gjithë të tjerët, jemi viktima të Maya-s tonë... Çlirimi i njeriut nga një magji e tillë... përbën qëllimin kryesor të fillosofirave të mëdha Indiane.)

Kjo Botë është pra e rreme, "É una i m p o s t u r a !" (është një fallsifikim). Kjo është një Botë fenomenale, dhe "fenomen" në Greqisht do të thotë "dukuri" (ingl. *appearance*), e pra "fasadë", jo realitet i thellë, i vërtetë. Siç dihet në këtë rezultat arrin edhe fillosofia e Kantit, me dallimin që bën mes "fenomenit" dhe "noumenit", ky i fundit thelbi, realiteti i mbramë dhe i vërtetë. Por, sado e çuditshme mund të duket, në këtë rezultat arrin edhe Shkenca bashkohëse e në veçanti, duke e provuar këtë tezë përfundimisht, Fizika Kuantike.

Lexojmë lidhur me këtë çështje p.sh. tek libri i Nick Herbert "*Quantum Reality*":**

"Werner Heisenberg, the Christopher Columbus of quantum theory, first to set foot on the new mathematical world, took an equally tough stand against reality-nostalgic physicist such as Einstein when he wrote: 'The hope that new experiments will lead us back to objective events in time and space is about as well founded as the hope of discovering the end of the world in the unexplored regions of the Antarctic'."

* Po tek Cirlot, (fq.206).

** Nick Herbert "*Quantum Reality: Beyond the New Physics*" (1985).

dhe më tutje: *"The world is created in the act of observation..."*

Siç shohim, të vrojtuarit (observimi), që realizohet me matjen, krijon materjen dhe Botën materiale (realitetin objektiv). Ky pra është rezultati i fundëm dhe i patundur në të cilën arrin Shkenca. Në vende të tjera, në Kozmologji, na thuhet se krijimi i materies dhe i Botës materiale shkaktohet nga thyerja e Simetrisë perfekte, primordiale, Simetri që e thyer jep Botën materiale, objektive, dhe që e fshehur dhe e pathyer përbën Realitetin e mbramë, të thellë, të vërtetë.

Kjo situatë paraqitet simbolikisht kështu:

Simetria e Pathyer [ingl. *unbroken*] primordiale

$$(para krijimit të Botës materiale) = (x = -x) = \bigcirc = E$$

Simetria e Thyer [ingl. *broken*] (që krijoi Botën materiale)

$$= (x \neq -x) = - (x = -x) = -E = F = (x = x)$$

$$= -\bigcirc = \bigoplus = \bullet = \boxed{\bigcirc} \dots$$

Shohimë kështu qartë, falë Algoritmit Simbolik (strukturizim llogjik i Mendimit Mistik dhe i cili mund të nxirret në tërësinë e tij nga një analizë *sui generis* llogjike, fillosofike, etimologjike, e Gjuhës), se si Thyerja e Simetrisë, që mund të tregohet simbolikisht edhe me " \bigoplus ", krijon Botën materiale, simb. " \bullet ".

Kështu ne shohim se ekuacioni simbolik: $\bigoplus = \bullet \dots(F)$, mund të vështrohet si ai i krijimit të Botës (\bullet) me Thyerjen e Simetrisë (\bigoplus), siç na mëson kozmologjia moderne. Por, duke riinterpretuar simbolin " \bigoplus " si "matje", ne mund të themi edhe, sipas përfundimit të fundit në të cilën arrin Fizika Kuantike, siç pamë, se: **"Bota materiale (\bullet) krijohet gjatë procesit të matjes (\bigoplus)."**

Por po e lëmë këtu për ta rimarrë sërish më vonë këtë çështje...

20) Gjerm. **u n t e r** = ndën, poshtë

Dhe me Shipen:

$$u \ n \ t \ e \ r \ \rightarrow \ \text{shq. } \hat{a} \ n \ d \bar{a} \ r = \textcircled{\ominus} = F = \downarrow = \text{poshtë...}$$
21) Inql. **u n d e r** = ndën, poshtë

Dhe me Shqipen:

$$u \ n \ d \ e \ r \ \rightarrow \ \text{shq. } \hat{a} \ n \ d \bar{a} \ r = \textcircled{\ominus} = F = \downarrow$$

Rikujtojmë këtu Rregullën e Përgjithshme: "Në qoftë se dy a më shumë fjalë nga e njëjta gjuhë ose nga gjuhë të ndryshme ngjajnë mes tyre (homonimi ose thujtjese-homonimi) dhe referojnë tek i njëjti simbol a në simbole ekuivalente (qoftë edhe duke patur kuptime të ndryshme) ato mund të jenë të bashkrënjëshme e pra, në instancë të fundit, 'e njëjta' fjalë."

Në rastin tonë mund atëhere të shkruajmë:

2	=	↓	...(F)
gjerm. andere		gjerm. unter	
		(ingl. under)	

22) Rus. **d r u g o i** (д р у г о й) = ital. *altro* (tjetri)

Theksi semantik bie mbi "d r" që është Shqipja "d ā r" = ingl. *divided*, e pra mund të shkruajmë:

$$d \ r \ u \ - \ g \ o \ i \ \rightarrow \ \text{shq. } d \ \bar{a} \ r \dots = \textcircled{\ominus} = F = \mathbf{2} = \text{tjetri...}$$

* Shih ndër të tjera edhe fq.271 dhe 551.

23) Sanskr. **a r t h a** (अर्थ) = fr. *raison; membre viril* (arsye; organ mashkullor)

Në Shqip: i **a r d h s h ë m** = i arsyeshëm, i shtruar në Kuvend...*

Mund të shkruajmë atëhere:

sanskr. "a r t h a" = shq. "a r d h a"

Në Shqip gjithashtu: **h e r d h e** (fr. *membre viril, testicule*). Dhe ky është kuptimi tjetër i fjalës Sanskritishte që po shqyrtojmë. Pra dhe mund të shkruajmë gjithashtu:

sanskr. "a r t h a" = shq. "h e r d h e"

Këtu lind pyetja:

sanskr. *artha* < shq. *ardha*? apo shq. *ardha* < sanskr. *artha*?

Më poshtë, në vijim, do të shohim zgjidhjen e kësaj dileme...

Po le të vëmë re këtu se si në Shqip, ashtu edhe në Sanskritisht, ruhet po ai paralelizëm mes "arsyes" dhe "organit mashkullor". Kjo flet për një afërsi të thellë fillosofike, për një "*Weltanschauung*" të afërt mes dy gjuhërave, e pra dhe mes dy popujve që kanë folur këto gjuhëra.**

* Shih Fjalorin e Gazullit: "*Fjalë të rralla të Malsisë së Madhe*".

** Dhe për Mendimin Mistik m.q.s. *ari* lidhet me diellin (ndërsa *argjendi* me hënën) dhe m.q.s. nga ana tjetër, dielli lidhej tek të lashtët me parimin mashkullor, shkurt me mashkullin, atëherë kuptohet përse në Sanskritisht: "**A r y a**" (अर्य) = fr. *home d'une classe supérieure; maître* (burrë i një shtrese të lartë; mjeshtër); kurse në Shqipen e Arbëreshëve: "**A r-i**" = ital. *fidanzato, sposo; eore, guerriero, uomo forte* (i fejuar, dhëndër; hero, luftëtar, burrë i fortë) dhe në Malësi të Madhe: "**A r u j**" = burrë, mashkull.

Shih edhe shënimin fq.163.

24) Sanskr. **a r d h a** (अर्ध) = fr. *demi* (gjysma), e pra simb. $\textcircled{1}$...

E pra atëhere me Shqipen:

$$\mathbf{a\ r\ d\ h\ a} \rightarrow \text{shq. } \mathbf{A\ r\ d\ à} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = 1/2$$

Ku: "a r-" = shq. "A r" (ingl. *gold*) = $\textcircled{0}$ *, dhe "-d h a" = shq. "me Da" (ingl. *to divide*).

Vëmë ré gjithashtu se, në bazë të Algorimit Simbolik mund të shkruajmë edhe për Sanskritishten "a r t h a":

$$\mathbf{a\ r\ t\ h\ a} \rightarrow \text{shq. } \mathbf{a\ r\ d\ à} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \leftrightarrow \text{ (fr. } \mathbf{raison}$$

Rigjejmë kështu nëpërmjet Sanskritishtes ekuivalencën e rëndësishme simbolike:

$$\textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(\mathbf{F})$$

$$\mathbf{ardha} \text{ (अर्ध) } \quad \mathbf{artha} \text{ (अर्थ) }$$

Nga sa më sipër ne gjejmë se:

$$\text{sansk. "a r t h a" (} \leftrightarrow \text{) } < \text{shq. "a r t h y" (} \textcircled{1} \text{)}$$

Ekuacioni tepër i rëndësishëm simbolik: $\textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(\mathbf{F})$, mund të përftohet, posë nga Shqipja, edhe nga shumë e shumë gjuhë të tjera, siç do të kemi rast të shohim. Kështu p.sh. në Shqip:

* Dihet se në Mendimin Mistik, mbi të cilin, siç është treguar në studimet e tjera të Autorit "*Shqipja dhe Sanskritishtja*" dhe "*Libri i Aforizmave*", është ngritur edhe vetë Gjuha, ekziston relacioni: $\mathbf{A\ r} = \textcircled{0}$.

Le të vëmë ré këtu edhe këtë: "a r" lidhet brenda Sanskritishtes me "a r i n" (अरिन्) = fr. *rou, disque* (rrotë, disk), e pra simb. $\textcircled{0}$.

$$\textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(F)$$

$$\begin{array}{ccc} \mathbf{n d a j} & & \mathbf{n d a j} \\ \text{(copëtoj)} & & \text{(prandaj)} \end{array}$$

Në Italisht: "**i n d i**" ("q u i n d i") = *pas asaj, pastaj*, e pra simb. **2**, dhe gjithashtu *prandaj, për këtë arsye, për këtë shkak...*, simb. $(x = x) = \leftrightarrow$.

Kështu Italishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\mathbf{2} = \leftrightarrow \dots(F)$$

$$\begin{array}{ccc} \mathbf{i n d i} & & \mathbf{i n d i} \\ \text{(quindi)} & & \text{(quindi)} \end{array}$$

Sipas Arithmetikës Mistike (simbolike) mund të shkruajmë:

$$\mathbf{1/2 = 0.5 = 5}$$

Dhe, nga ana tjetër, gjithnjë sipas Arithmetikës Mistike (themeli i saj) kemi:

$$\mathbf{3 = 0}$$

që nga dhe ($\mathbf{2 = -1}$), një ekuacion, siç do shohim, shumë i përhapur në gjuhë.

Duke i shtuar të dy krahëve të ekuacionit ($\mathbf{3 = 0}$) numurin **2**, do të kemi:

$$\mathbf{5 = 2}$$

e pra atëhere edhe:

$$\mathbf{1/2 = 2}$$

Kështu që:

$$(\mathbf{2 = \leftrightarrow}) = (\mathbf{1/2 = \leftrightarrow})$$

ose edhe:

$$\textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(F)$$

ekuacion që shtrohet pra edhe nga Italishtja me "*(qu)indi, (qu)indi*".

Dhe së fundi le të vëmë ré këtu se Italishtja "i n d i" = *pas asaj, pastaj...*, motivohet përmes Shqipes:

$$i \ n \ d \ i \ \rightarrow \ shq. \ \hat{a} \ n \ d \grave{a} = \textcircled{1} = F = \leftrightarrow$$

- 25) Lat. **i n d e** = ingl. *starting point; cause; origin* (pikë nisjeje; shkak; zanafillë)

Ne dimë që gjithshka ka filluar me një *ndarje*. Kujtojmë këtu të thënë e famshme të Paracelsit: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang..." (*Ndarja* është fillimi i gjithshkaje...)

Nga ana tjetër kemi parë ekuacionin:

$$\textcircled{1} = - \bigcirc = -1 = \bullet \quad \dots(F)$$

Pjesa	Mohimi i	Fillimi	...i Botës
n d a r j a	t ë T ë r ë s		m a t e r i a l e

Duke qenë kështu, "i n d e" duhet të tregojë një "n d a r j e", a e thënë ndryshe, duhet të "përshkruajë" *simbolin* e "ndarjes".

Kështu atëherë Latinishtja "i n d e" nuk është tjetër veçse Shqipja:

$$\hat{a} \ n \ d \grave{a}$$

("âsht ndà")

Mund të shkruajmë përmbledhtazi:

$$i \ n \ d \ e \ \rightarrow \ shq. \ \hat{a} \ n \ d \grave{a} = \textcircled{1} = F = \leftrightarrow$$

Nga Latinishtja "i n d e" rrjedh, gjithpò me atë kuptim, edhe Italishtja "o n d e", që motivohet, siç kuptohet lehtë, me anë të Shqipes "â n d à".

Dhe më në fund le të shtojmë këtu se në Shqip thuhet "n d a j", por edhe "a n d a j" në kuptimin gjithmonë të *shkakësisë* (↔).

26) Sanskr. n i d a n a (निदान) = ingl. *origin; cause* (shkak; origjinë)

Me qenë se siç kemi parë:

$$\textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(F)$$

del qartë se kjo fjalë Sanskritishte mund të motivohet me Shqipen:

$$n d a n = \text{simb. } \textcircled{1}$$

nga folja "n d a j" (ingl. *to divide*).

Kështu, ashtu si edhe gjuhët e tjera, Sanskritishtja, që përcjell urtësinë e stërlashtë të Fillosofisë të madhe Indiane, na thotë se shkak i origjinës, i fillimit të Botës ka qenë një Ndarje, sikundër këtë na thotë në një "gjuhë" tjetër edhe Hegeli, që na e shpjegon fillimin e Botës materiale me n d a r j e n e frymave (Subjektive dhe Objektive) në gjirin e Frymës Absolute. Këtë na thotë siç pamë edhe Paracelsi, këtë na thonë edhe të gjitha mitet kozmogonike që mund të përmbliidhen të gjitha në një kalim nga *kodi E* (= ○), në *kodin F* (= ⊕). Pra fjala Sanskrite, duke paraqitur ato kuptime që ka (*zanafillë, shkak*) nuk mund të jetë tjetër veçse Shqipja "n d a n".

27) Gjerm. d a n n = ingl. *then; ital. indi, quindi* (më pas, pastaj)

Me Shqipen:

$$d a n n < \text{shq. } d a m u n = \textcircled{1} = F = 2$$

Vëmë në dukje këtu se kalimi nga Shqipja "d a m u n" tek Gjermanishtja "d a n n" është kryer me një asimilim progresiv: "-m u n" → "-n n".

28) Gjerm. **d e n n** = ingl. *for, because* (sepse, me qenë se, për arsye se...)

Me Shqipen:

$$d e n n < \text{shq. } d a m u n = \textcircled{1} = F = \leftrightarrow$$

Edhe këtu kalimi nga Shqipja "-m u n" tek Gjermanishtja "-n n" është kryer nëpërmjet një asimilimi progresiv. Kështu Gjermanishtja shtron edhe ajo në këtë mënyrë ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} 2 & = & \leftrightarrow & \dots(F) \\ d a n n & & d e n n & \end{array}$$

Me qenë se: $2 = \textcircled{1} = d a m u n$, del qartë se Gjermanishtja "d a n n" dhe "d e n n" s'janë tjetër veçse Shqipja "d a m u n", me asimilim progresiv dhe me "Ablaut" (apofoni = ndrrimzanoreje) në fjalën e dytë për shmangie keqkuptimi.

Për të treguar se ekuacioni ($\textcircled{1} = \leftrightarrow$) është universal, në kuptimin që atë e gjejmë në të gjitha gjuhët, kemi sjellur disa pak shembulla duke realizuar një farë "Consensio linguarum":

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \leftrightarrow & \dots(F) \\ \text{shq. ndaj} & & \text{ndaj} & \\ \text{shq. pjesë} & & \text{pasí} & \\ \text{ital. metà} & & \text{motivo} & \\ \text{gjerm. Halbe} & & \text{deshalb} & \\ \text{sanskr. ardha} & & \text{artha} & \\ \text{ital. quindi}^* & & \text{quindi} & \\ \text{.....} & & \text{.....} & \end{array}$$

* Ital. "q u i n d i" = *pas, pastaj*, e pra simb. 2 . Por Algoritmi Simbolik na jep: $2 = F = \textcircled{1}$. Kjo na jep dhe të drejtën që tek Italishtja "q u i n d i" të shohim dhe një n d a r j e, e pra simb. $\textcircled{1}$.

Një nga rrjedhimet e shumta të këtij "*Consensio linguarum*" është se *shkaku* (i krijimit të Botës) ka qenë një *ndarje*, një *thyerje*, pikërisht ashtu sikundër pohon edhe Paracelsus.

Jashtë theme mund të shtojmë këtu edhe se në Gjermanisht: "Auf-bruch" = *fillim* (fillimi i Botës, krijimi i saj) dhe njëkohësisht: "brech-en" = *thyej, copëtoj*.

Kështu që Gjermanishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{1} = -1 = \bullet \quad \dots(F)$$

brechen Aufbruch

Dimë, nga ana tjetër, se Gjuha emërton sipas një paradigme superlative, *primordiale*, etj. etj. Kjo do të thotë që kur Gjuha "flet" për shkahun, nënkupton shkahun më parësor, më të hershëm dhe superlativ, atë të *krijimit të Botës*.

Duke qenë kështu, të gjitha gjuhët, si një konkretizim të një *Weltanschauung* primordial të përbashkët për të gjithë popujt e lashtë, pohojnë unanimisht, ndonëse sejcila në mënyrën e vet, të vërtetën themelore të *krijimit të Botës me anë të një N d a r j e*, duke rikonfermuar ndër të tjera intuicionin gjenial të Paracelsus, të shprehur në *dictum*-in e tij të famshëm e të stërpërsëritur: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang.*"

Shqipja na jep:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

ndarja ndyrja

si edhe:

$$\sim = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

ndrrim ndarje
ndryshim

Që mund të interpretohet ndër të tjera si:

"Ndarja ka sjellur me vete një ndryshim, një ndrrim, e pra një zëvendësim të të parit (1) me një tjetër, me një të dytë (2)."

Realizohet kështu kalimi:

$$1 \rightarrow 2$$

dhe me qenë se: $1 = E$ dhe $2 = F$, ne mund të shkruajmë:

$$(1 \rightarrow 2) = (E \rightarrow F)$$

Kalimi nga E në F (kalim që siç kemi parë është një *rënje*)* përfaqësohet në skemën e përgjithshme të miteve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

Le ta zgjerojmë edhe më tej tani Bisedën.

Si rikonfermë se kalimi nga "1" në "2" mund të vështrohet si një *mit kozmogonik*, kemi edhe ato sa lexojmë në Ungjillin apokrif të Thomait, në të cilin kur dishepujt e pyesin Krishtin se kur do të vijë Mbretëria e Qiejve, ai u përgjigjet ndër të tjera: *"Kur ta bëni dyshin (2) një (1)"...***

* *"The fall of the Spirit into the matter..."*

** Nga Ungjijtë apokrifë, e pikërisht nga ay i Thomait: *"Dishepujt e pyetën Krishtin se kur do të hynin në Mbretërinë e Qiejve. Dhe atëhere Ai u tha atyre: 'Kur do ta bëni dyshin një, dhe kur do ta bëni të brendshmen si të jashtmen dhe të jashtmen si të brendshmen, dhe atë që është lartë si atë që është poshtë, dhe kur do ta bëni burrin grua dhe gruan burrë që këta të dy të jenë një gjë e vetme... atëhere pó, do të hyni në Mbretërinë e Qiejve!..."*

Komenti ynë:

- 1) Këto të thëna lidhen me ato sa lexojmë në *Tabula Smaragdina*, e pra që lidhen kështu me Hermes Trismegistus, a ndryshe Thotin, i adhuruar si Perëndi në Egjyptin e lashtë.
- 2) Të gjitha këto të thëna përfshihen, nga ana tjetër, në kodin E, sepse kemi për shembull:
 - a) "...kur ta bëni dyshin një..." Mund të shkruajmë atëhere simbolikisht: $(2 \rightarrow 1)$, e pra $[(x = x) \rightarrow (x = -x)]$, e pra atëhere akoma $(F \rightarrow E)$.
 - b) "...kur do ta bëni të brendshmen si të jashtmen dhe të jashtmen si të brendshmen..."

Simbolikisht:

$$(-x = \boxed{x}) \rightarrow (x = \boxed{x})$$

d.m.th.:

$$F \rightarrow E$$

- c) "...kur ta bëni atë që është lartë si atë që është poshtë..."

$$(\uparrow = -\downarrow) \rightarrow (\uparrow = \downarrow)$$

d.m.th.:

$$F \rightarrow E$$

- d) "...dhe kur do ta bëni burrin grua dhe gruan burrë që këta të dy të jenë një gjë e vetme..."

$$(x \neq -x) \rightarrow (x = -x)$$

d.m.th.:

$$F \rightarrow E$$

Pra siç shikojmë *Mbretëria e Qiejve mbërrihet kur kalohet nga kodi F në kodin E*.

Kjo është një ngritje, pra dhe mund të shkruajmë:

$$F \uparrow = E$$

e pra:

$$\bullet \uparrow = \circ$$

ose edhe:

$$\circ = \bullet \uparrow = - \bullet$$

Mbretëria e Qiejve	jo Bota materiale	fundi i Botës materiale
-----------------------	----------------------	----------------------------

Arrijmë në përfundimin se mbrritja në Mbretërinë e Qiejve (\circ) bëhet kur Bota materiale merr fund ($- \bullet$).

Pra, fundi i Botës lidhet me emergjencën e kodit E. Por, siç pamë dhe më sipër:

$$E = \circ = \textit{Whole} = \textit{Holizëm}$$

Kështu:

"Emergjenca e kodit E lidhet me emergjencën e paradigmës holistike."

Po kjo emergjencë e fundit po ndodh sot.

Atëhere, kjo do të thotë se fundi i Botës ($- \bullet = -F = E$) nuk është larg. Kjo përputhje mes dy konkluzioneve (atij që arrihet nëpërmjet Algoritmit Simbolik dhe atij që arrihet nëpërmjet Fizikës Kuantike) që shpie në profetizimin e fundit të Botës, është sa e çuditshme, aq edhe matematikisht e saktë.

Vëmë rë këtu se Algoritmi Simbolik, përveç rolit si *kriter vërtetësie* dhe si *euristikë*, ka edhe atë të *profecisë*. Në rastin që shqyrtuam, për shembull, Algoritmi Simbolik na flet për emergjencën e kodit E, ndërsa Fizika Kuantike na flet për emergjencën e paradigmës holistike. Dhe ne pamë se këto dy emergjenca janë e njejta emergjencë. Dhe më në fund, ne gjetëm edhe se ato që profetizon Krishti në Ungjillin apokrif të Thomait, gjejnë një mbështetje të pakundërshtueshme llogjike në kodin E, gjë që na lejon të përfundojmë (siç bëmë) *me një motiv eskatologjik* a, e thënë ndryshe, *me profetizimin e fundit të Botës*.

Po ardhja e Mbretërisë Qiellore ("...si në qiell, ashtu mbi dhé...") përputhet me fundin e Botës, e pra me:

$$- \bullet = -F = E$$

Kështu që krijimi i Botës si mit kozmogonik do të jetë e kundërta, e pra:

$$E \downarrow = F$$

Nga sa më sipër, me kombinime të tjera, ne mund të shkruajmë:

$$2 = \leftrightarrow = -1 = \bullet \dots(F)$$

Djali është shkaku i krijimit të Botës

Ekvacioni:

$$2 = \text{Djali}$$

është një nga arkeotipet madhore të Inkoshjentit Kolektiv.*

* Ky është një term i përdorur në psikologji, "shpikësi" i famshëm i të cilit është Carl Gustav Jung. Koshienti kolektiv është i njejtë për të gjithë njerëzit, i pandryshueshëm dhe i trashëgueshëm. Ai përbëhet nga ato që Freud i quante "mbeturina arkaike".

Rëndësia e tij është shumë e madhe për arsye se ai përmban strukturat universale të organizimit të informacionit (pak a shumë, po në një tjetër drejtim, si "kallëpet" Kantiane të kategorirave dhe gjykimeve sintetike *a priori* të Arsyes). Këto janë arkeotipet, sipas të cilave Bota mund të organizohet dhe të shpjegohet më thellë dhe ndryshe nga mënyra klasike e një fillosofie konceptuale.

Simbolet e Algoritmit tonë Simbolik mund të vështrohen dhe ato si arkeotipe. Edhe neve në këtë Studim vëmë rë produktivitetin dhe efikasitetin e tyre të jashtëzakonshëm.

Tek Cirlot gjejmë, ndër të tjera, lidhur me simbolizëmën e këtij numuri: ...kundërvënie, anti-Zot, "*first nucleus of matter*", më ogursëzi nga të gjitha numurat...*

S'ka dyshim pra se ai është numuri simbolik i Djallit.

Cirlot na jep, qoftë edhe gjer diku *implicite*, ekuacionin ($2 = -1$) (këtu " -1 " si e kundërta e numurit " 1 " që është ai i Zotit; si negativiteti i djallit, djalli si Fryma e Mohimit ("*Ich bin der Geist der stets verneint...*").

Kështu pra: *Analizat tona gjuhësore, nxjerrin në pah faktin qëllimisht të fshehur nga një pseudo-fé, se krimi i krijimit të Botës është kryer nga Djalli (Demiurgu i keq).***

* Shih fq.11.

** Le të kujtojmë këtu lidhur me Doktrinën e fuqishme të Gnosticizmit ndër të tjera edhe këto nga "*Libri i Aforizmave*":

"Gnosticism (from *gnostikos*, 'learned', from Greek: γνῶσις, *knowledge*) is a scholarly term for a set of religious beliefs and spiritual practices common to early Christianity, Hellenistic Judaism, Greco-Roman mystery religions, Zoroastrianism (especially Zurvanism), and Neoplatonism... A common characteristic of some of these groups was the teaching that the realisation of Gnosis (esoteric or intuitive knowledge), is the way to salvation of the soul from the material world.

They saw *the material world as created through an intermediary being (Demiurge) rather than directly by God*. In most of the systems, this demiurge was seen as imperfect, in others even as evil. Different gnostic schools sometimes identified the demiurge as Ahriman, Saklas, Samael, Satan, Yaldabaoth..."

[...Gnosticizëm nga "g n o s t i k o s", *i mësuar, i ditur, njohës*... nga Greqishtja "g n o s i s" [që është Shqipja "n j o h", *njohje, dije*]) është një term i përdorur nga dijetarët për të treguar një sërë besimesh fetare dhe praktikash spirituale të përbashkëta për Krishtërizmin e hershëm, për Judaizmin Helenik, për

Do të shohim gjatë parashtrimit të mëtejshëm të këtij studimi, të tjera e të tjera vërtetime llogjiko–gjuhësore të këtij pohimi që shumëkujt mund ti tingëllojë si një blasfemi e hapur dhe si një "skandal" i vërtetë.

29) Gjerm. **d a** = për arsye, për shkak se... e pra simb. $(x = x)$, \leftrightarrow .

Është e qartë, pas gjithë atyre që pamë më sipër, se Gjermanishtja "d a" (si p.sh. "Da er nicht in Stande war mit mir zu sprechen..." = *Për arsye se nuk qe në gjendje të bisedonte me mua...*) do identifikuar me Shqipen:

D a

("d a j", "d a m u n" etj.)

misteret fetare Greko–Rromake, për Zoroastrizmin (dhe veçanërisht Zurvanizmin) dhe Neoplatonizmin. Një karakteristikë e përbashkët e disa prej këtyre grupeve ka qenë doktrina se – vënia në praktikë e *Gnosis* (njohja ezoterike ose intuitive) është bash rruga për shpëtimin, shkrimin e shpirtit nga Bota materiale.

Sipas tyre, *Bota është krijuar nga një qenie "ndërmjetësuese" (Demiurgu) dhe jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Zoti.*

Në pjesën më të madhe të këtyre sistemeve, ky demiurg vështrohej si *i papërsosur*. Në disa të tjerë, madje edhe si *i ligë*. Shkollat e ndryshme gnostike e identifikonin, herë–herë, demiurgun me Ahrimanin, Saklasin, Samaelin, Shejtanin, Yaldabaoth...) të gjithë "personazhe", ku më shumë ku më pak, negativë dhe krijues të një Bote negative...)

Le përmendim këtu doktrinën gnostike të Marcione-s (85–160 pas Krishtit) që rikonfermon hipotezën tonë (të pasqyruar në Gjuhë) se Bota është e keqe (simboli ● = *Bota materiale; e keqja, Djalli*) dhe krijim i të Ndytit (**2** = ●). Marcione mendonte, pos kësaj, se tërë materia ishte e keqe. Ndaj dhe ndoqi doktrinën e "Doçetizmit" sipas të cilës trupi i Krishtit ishte krejt jo i lëndshëm, në kundërshtim me Katolikët që besonin në një mishërim të plotë, tërësor të Krishtit.

dhe kjo sepse:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{\ominus} & = & \leftrightarrow \quad \dots(F) \\ \text{shq. da} & & \text{gjerm. da} \\ \text{shq. ndaj} & & \text{shq. ndaj} \end{array}$$

Le të shqyrtojmë tani fjalën Shqipe "d e r i" që tregon një *cak*, një *fund*.

Kjo fjalë lidhet, brenda Shqipes me fjalën "d a r ë" (nga folja "d a j"), pra simb. $\textcircled{\ominus}$, simbol ky që mund të interpretohet, ndër të tjera, në kuptimin e *cakut*, *kufirit*.

Edhe Italishtja, ndër të tjera, përdor konceptin e kufirit për të shprehur këtë gjë, dhe kjo sepse në Italisht thuhet "*fino a...*", po "*fino*" lidhet me Latinishten "*finis*" që do të thotë pikërisht "kufi" (ingl. *boundary*, *limit*, *border*). Mund të shkruajmë simbolikisht:

$$\text{shq. d e r i} \rightarrow \text{shq. d ā r} = \textcircled{\ominus} = (A \cdots B) \quad \dots(F)$$

30) Rus. d o (д о) = deri, gjer...

Është Shqipja:

$$d à = \textcircled{\ominus} = F = (A \cdots B)$$

Le të vëmë ré këtu se në Shqip "p r e j" do të thotë "n d a j" (fr. *couper*, ingl. *cut*), e pra simb. $\textcircled{\ominus}$, dhe në të njejtën kohë "prej-ardhje", *origjinë*, *pikënisje* (ital. *da*, ingl. *from*), e pra simb. - 1 .

31) Ingl. f r o m = p r e j

Edhe kjo fjalë e Inglishtes me duke u zbërthyer në:

f r o m

e pra:

pre m

a më shkoqur:

"pré jam"

jep Shqipen:

"jam pré"

që edhe e motivon atë, që e shpie, me fjalë të tjera, tek simboli i *prerjes*
" ① " që ajo përshkruan.*

32) Lat. *dum* = ital. *fino a...* (deri)

Me Shqipen:

d ā m

(nga folja Shqip "DAj")

simbolikisht:

① → (A.....B)

Gjithashtu siç pamë pak më lartë:

shq. "deri" < shq. "d ā r"

Latinishtja "dum"^{**} në kuptimin *in d e r s a* (ingl. *while, during the time that...*), duke treguar një *in t e r v a l* kohe, gjë që ne mund ta tregojmë simbolikisht me "(A.....B)" e pra, për ekuivalencë simbolike, edhe me

* Shih për këtë edhe etimologjinë e fjalës Latine "d e r i v a r e" (fq.39).

** Le të kujtojmë këtu vargjet e këngës Latine:

"*Gaudeamus igitur, Juvenes dum sumus...*"

(Le të galdojmë pra, *deri* sa jemi të rinj...)

" ⊕ ", del krejt e qartë se nuk mund të motivohet ndryshe veçse me Shqipen "d a m" (folja "DAj").

33) Ingl. **b o u n d** = kufi

Reduktohet tek Shqipja:

b ë n d à = simb. ⊕

34) Ingl. **b o u n d a r y** = kufi, cak

Lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen:

"b ë n d a r ë" ose **"b ë n d a r ë"**

që e përcjell këtë fjalë të Inglishtes tek *simboli* " ⊕ " që ajo *duhet të* përshkruajë.

35) Ingl. **b o r d e r** = kufiri

Shpjegohet me Shqipen:

b ë r d a r ë = ⊕

* Siç del nga analiza e fjalëve në këtë Studim, por edhe gjithashtu nga parimet bazë të Etimologjisë së Ré që ne po inaugurojmë, etimologjizimi i fjalëve duhet të përfundojë (pa "çarë" kokën për zbarrën "*Saussuriane-Lacaniane*", *S/s*) gjithmonë tek një simbol.

Nuk ndodh kështu në shkencën e vjetër, klasike të etimologjisë, që duke e referuar fjalën tek një concept, e lë etimologjizimin e saj detyrimisht të papërfunduar. Gjë që edhe vetë e pohon, duke iu bindur zbarrës (sipas saj) të pakapërcyeshme (*S/s*). Do të flasim edhe më vonë për këtë çështje...

- 36) Jap. **k a b u r u** (かぶる) = ingl. *wear* (ka bar, ka bart...*)

Është Shqipja:

k a b a r

Në Japonisht mungon si operatori "**b a r (t)**" (ingl. "to **b e a r**"), ashtu edhe operatori "**k a**" (ingl. *has*, lat. *habet*). Kështu që pra gjuha Japoneze nuk është në gjendje ta motivojë me mjetet e saja leksikore fjalën e saj "k a b u r u". Duhet për këtë ti kërkojë ndihmë Shqipes. E ky është *rol i motivues a mesianik (ndërmjetësues) i Shqipes* me të cilin ne në këtë Studim dhe do të mirremi kryesisht.

- 37) Japon. **k u d a r u** (下る) = ingl. *to descend* (zbrës)

Me Shqipen:

k a d a r = ⊕ = ↓ ... (F)

- 38) Frengj. **t o m b e r** = ingl. *to fall* (me rà)

Simbolikisht kuptimi i kësaj fjale Frengjisht do të tregohej me simbolin tonë *arkeotipal* " ↓ ". Ky është simboli që ajo duhet të përshkruajë. Po si? Në ç'mënyrë? Frengjishtja nuk është në gjendje të na e thotë këtë.

E zbërthejmë fjalën "t o m b e r":

t o m b e r

Këtu "t o m" është Shqipja "**t h y m**" = i ndarë, i këputur (ingl. *broken*), e pra simb. " ⊕ " (gjithnjë me simbolet tona arkeotipale) dhe "b e r"

* Në të folmen e Veriut... Me këtë rrënjë lidhet edhe fjala "t a b a r e" (në kuptimin e Ital. "*soprabito*" = pallto e lehtë) e përdorur më tepër në Veri (Shkodër etj.).

është një mbaresë foljore dhe është Shqipja "b ë r" (fr. *faire*, ingl. *to do*, sanskr. *bhara*).

Pra e tërë fjala do të thotë:

"t h y m b ë r" e pra "b ë r ⊕"

Por "t o m b e r" do të thotë "me rà" e jo "me ndà", e pra simb. " ↓ " dhe jo " ⊕ ". Po atëhere? Ashtu vërtetë, por simboli " ↓ " i përshkruar nga fjala Frengjisht "t o m b e r" është ekuivalent me simbolin " ⊕ " siç tregohet në "*Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*" në fund të tekstit. Mes këtyre dy simboleve ka një lidhje të thellë mitike që shpreh faktin (ngjarjen) e rëndësishëm të krijimit të Botës materiale nga një përçarje (⊕) e cila u pasua nga një rënie (↓). Rikujtojmë këtu ndër të tjera rënien e engjyjeve rebelë që u ndanë (përçanë) nga Zoti dhe r a n ë e krijuan kështu një Botë të pamvarur, Botën tonë materiale, mbretëri të cilit është pikërisht kryetari i engjyjeve rebelë, d.m.th. Luciferi, tashmë Shejtan.

Lidhur me "rënien" si faktor të krijimit të Botës materiale, tek Cirlot mund të lexojmë ndër të tjera edhe sa vijon:

*"...The fall of man from the paradisiac state and his return to it find varied manners of symbolic expression, the most characteristic being the labyrinth..."***

(...Rënia e njeriut nga gjendja parajsore dhe kthimi i tij tek ajo, është shprehur në mënyra të ndryshme, më karakteristikja e të cilave është ajo e labirinthit...)

* Kujtojmë këtu nga Ungjilli ndër të tjera: "...Djalli i hoqi udhë tek një vend i lartë dhe i tregoi atij, brenda në një çast, të gjitha mbretëritë e botës. Dhe i tha atij: 'Do ta jap ty tërë fuqinë dhe shkëlqimin e tyre, sepse mua më janë dhënë dhe unë mund t'ia jap ato kujtdo që të dua. Ndaj pra edhe në se ti do të më adhurosh, ato do të jenë të gjitha të tuat'..." (Lluka, 4:5-7).

** Cirlot, fq.173.

dhe po aty:

*"...Yet Homer reserves the end of the of the periplus of Odysseus for a triumphant but affectionate 'return' to his wife, his hearth and home. This is a mystic idea analogous to the mystery of the 'fall' of the soul into the material plane of existence (by the process of involution) and to the necessity of its returning to the starting-point (evolution) – a mystery which has been expounded by Platonic idealism and by Plotinus in particular..."**

(...Por prap tek Homeri shikojmë diçka tjetër kur na tregon se peripecirat e Odisesë kurorëzohen nga një 'kthim' triumfues dhe dashuriplotë tek e shoqja, te vatra dhe tek shtëpia e tij. Kjo është një ide mistike analloge me misterin e 'rënies' të shpirtit në planin material të ekzistencës (gjatë procesit të involucionit) dhe nevojës e kthimit tek pika e nisjes (evolucioni) – një mister që është mbrojtur e përhapur si i tillë nga fillosofia idealiste e Platonit dhe nga Plotini në veçanti...)

Duke qenë kështu, përshkrimi i simbolit " ↓ " (efekti: rënia) mund të zëvendësohet me atë të simbolit " ⊕ " (shkaku: çarja, përçarja, ndarja, thymja...).

Atëherë për motivimin e fjalës Frengjisht "t o m b e r" me anë të Shqipes, kemi:

$$t o m b e r \rightarrow \text{shq. thym ber} = \oplus = F = \downarrow$$

39) Ingl. d o w n = poshtë (ital. giù)

Zbërthehet si:

$$d o w n \rightarrow \text{shq. d à b a n} = \oplus = \downarrow \quad \dots(F)$$

* Po aty, fq.294

Këtu:

"-w n" është Shqipja "b ë n"

"d o-" është Shqipja "d a" (folja *daj*) e pra simb. \oplus

Dhe kujtojmë këtu të thënë e famshme të Paracelsit: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang..."*

Duke e treguar simbolikisht *ndarjen* me " \oplus ", *fillimin* me " -1 ",** dhe *bërjen* (si *materializim*) me " \bullet ", përftohet ekuacioni simbolik:

$$\oplus = -1 = \bullet \quad \dots(F)$$

Separatio *Anfang* *Geburt*

Që bërja (materializimi i diçkaje) lidhet gjithnjë me një "**n d a r j e**" kjo gjen rikonfermime të shumta jo vetëm në Gjuhë por edhe në çdo fushë të Dijes dhe në çdo dimension të Realitetit, siç do të kemi rast të shohim e të bindemi.

* *Philippus Aureolus Theophrastus Bombastus von Hohenheim* (1493–1541), lindur në Zvicër, i njohur si *Paracelsus* – alkimist, fizikant, astrolog, mjek, botanist, "okultist"... Një personalitet i madh i Rilindjes Europiane. Vështrohet si themeluesi i mjekësisë moderne. Kudo në shkrimet e tij vihet rë një mendim i fuqishëm, origjinal dhe tepër pjellor. Paracelsus është një personazh historik që do të mbetet përjetësisht në memorien e qytetërimit europian, për meritat e tij sa të jashtëzakonshme aq dhe origjinale në të gjitha fushat me të cilat ai u mor me një gjenialitet të rallë.

Si fillosof Paracelsus lidhet me Mendimin Mistik pra dhe tërë metodologjia e tij mbështetet mbi simbolet dhe lidhjet e tyre. Nuk është e rastit që ai ishte dhe një okultist, d.m.th. një lëvrues i një diturie të fshehtë dhe të mistershme që operonte me teknika dhe rituale simbolike. Ekziston një afinitet midis mendimit tonë në këtë Studim dhe atij të Paracelsus nga i cili neve kemi huazuar frymën dhe ekzoterizmin (llogjik).

** Shiko edhe fq.104,389 dhe 671.

Ekuacioni simbolik: $\textcircled{\ominus} = \downarrow \dots(F)$ realizohet shumë qartë në Italisht me çiftin thujse-homonimik:

"scindere" = ndaj ($\textcircled{\ominus}$) dhe "scendere" = zbres (\downarrow)

Në këto dy fjalë theksi semantik bie mbi "i n d e r e" dhe "e n d e r e", duke qenë "s c-" thjesht prostatike, pa kurrfarë vlere semantike. Pra atëhere këto dy fjalë motivohen në një mënyrë krejt bindëse me Shqipen:

â n d a r ë

(ital. *è diviso, è separato*)

40) Lat. **t e m p l u m** = ingl. *temple*

Lexojmë për këtë tek Cirlot:

*"The word 'temple' derives from the root 'tem' – 'to divide'. Etruscan soothsayers made a division of the heavens by means of to straight lines intersecting at a point directly above the head, the point of intersection being a projection of the notion of the 'Centre', and the lines representing the two directions of the plane..."**

(Fjala "tempull" rrjedh nga rrënja *tem-* "ndaj", "thyej". Mistikët Etruskë kryenin një *ndarje* të qiellit nëpërmjet dy vijave të drejta që priteshin tek një pikë pikërisht mbi kokë. Pika e ndërprerjes vështrohej si një projektim i konceptit të "Qëndrës"...)

Njihen lidhjet e Etruskishtes me Shqipen,** kështu që s'ka dyshim se fjala Etruskisht "**t e m**" s'është tjetër veçse Shqipja "**t h y m**" nga folja "me thy".

* Cirlot, fq.332.

** Shih ndër të tjera "*Les Etrusques commencent a parler*" (1961) nga Z. Mayani.

Tek fjala "t e m p l u m" theksi semantik bie tek "t e m", me atë kuptim në Shqipen, që pamë më sipër.

Atëhere kemi:

$$t e m - p l u m \rightarrow \text{shq. } t h y m \dots = \textcircled{1} = \boxed{\circ}$$

Simboli i fundit, duke interpretuar "[" dhe "]" si mbyllje, dhe " o " si Qendra Mistike, na jep një paraqitje të saktë simbolike të tempullit, si "Shtëpi e Zotit".

Tempulli përfshin edhe një kuptim tjetër të veçantë, veç atij të një strukture arkitektonike. Duke u shprehur më gjerë, mund të themi se ajo që më tepër se çdo gjë tjetër theksohet në të, është kuptimi 'suprem i 'Qendrës'...

"t e m" është Shqipja "d a m" ose Shqipja "t h y m", në të dy rastet pra simboli i ndarjes, $\textcircled{1}$.

Le të shtojmë këtu edhe këtë:

Me qenë se *ndarja* lidhet me *mohimin* ($\textcircled{1} = -1$), dhe me qenë se simboli " $\boxed{\circ}$ " lidhet me *mbrendësimin* (vetia integrative e mohimit dialektik: $(-x = \boxed{x})$),* ne kemi në mënyrë të njëpasnjëshme:

$$x / = -x = \boxed{x} \quad \dots(F)$$

(ndarja) (mohimi) (brendësimi)

Duke qenë kështu, me qenë se " x " mund të jetë çfarëdo, ne e sjellim, në këtë mënyrë, fjalën e mësipërme Asirishte tek simboli \boxed{x} , që është jo vetëm paraqitja e tempullit, si banesë e Zotit, por edhe e çdokujt, pra thjesht "banesë", "ndërtesë".

* Shiko ndër të tjera *Një parashtrimi i Shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

Le të vëmë ré me këtë rast edhe se vetë fjala Shqip "n d ë r-t e s ë" lidhet si me motivuesen e saj me rrënjën ("operatorin e lirë") "n d a r ë" pra simb. ① .

41) Turq. **d u r m a k** = ndërpres

Theksi semantik bie kështu mbi "d u r", që është Shqipja:

d a r (folja DAJ) = simb. ①

Këtu "-mak" është një mbaresë verbalizonjëse në kuptimin e "bërjes".

Edhe tek Shqipja "n d ë r-p r e s" kemi: "n d ë r" = "n d a r".

42) Turq. **k a d e r** = ingl. *destiny, fate, predestination* (fat)

Do zbërthyer në:

k a d e r

dhe me Shqipen:

k a d ā r = simb. ①

Ekziston krejt një "*Consentio linguarum*" që rikonfermon se koncepti i "fatit" është në një sërë gjuhësh, në mos në të gjitha, një rreze e spektrit semantik të simbolit ① . Kështu për shembull në Shqip "f a t i", në kuptimin e mësipërm (ingl. *destiny*), tregohet me fjalën "r i s k" që do të thotë pikërisht "pjesë", "copë", e pra simbolikisht ① . * Ashtu edhe Rusishtja "u d e l" (удел) që do të thotë "fat", "risk" lidhet mbrenda Rusishtes me fjalën "d o l j a" (доля) që do të thotë "fetë", "rrisk". Në Inglisht fjala "l o t" do të thotë në të njejtën kohë edhe "pjesë" edhe "fat". Në Greqisht "m o í r a" (μοίρα) do të thotë në të njejtën kohë edhe "pjesë", "copë",

* Vërejmë më në fund se ky operator gjendet, ndër të tjera, edhe në Shqipen "b - r i s k" (ingl. "r a z - o r").

"risk", si edhe "fat" (ingl. *fate, destiny, lot, fortune*). Në mitologjinë Greke flitet për Moirat që presin e tjerrin fatin e njerëzve në lindje (lat. *Parcae*; ingl. *Fates*). Mund të sillnim shembulla edhe nga të tjera gjuhë, por edhe kaq mendojmë se mjafton.

Vëmë ré se simboli $\textcircled{1}$ i përshkruar nga fjala "f a t" (krahaso me "f e t a" = *copë, risk, pjesë*), është po ai i përshkruar nga "n d a r j e", "t h y m j e", fjalë që lidhen respektivisht me "n d ë r t i m" dhe "t h e m e l i m".

Ekuivalenca simbolike:

$\textcircled{1}$ = ● = *ndërtimi material, Bota materiale, Njeriu mishëror...*

nxjerr në pah faktin se për mentalitetin e popujve të lashtë (mentalitet që është reflektuar në Gjuhë) fati ishte themeli i jetës së Njeriut, nga ai mvarej tërë ndërtimi i jetës së tij që ishte pra kështu e paracaktuar.

Pas të gjitha këtyre s'ka dyshim se fjala Turqisht "k a d e r" nuk mund të ketë motivim tjetër veçse nëpërmjet Shqipes "k a d ā r" sikundër që edhe e pamë.

43) Japon. k a d o (角) = ingl. *corner, angle* (cep, kënd)

Është Shqipja:

k a n d

Tek Cirlot një nga kuptimet (interpretimet) e simbolizmës të numurit d y (2) është edhe ai i k ë n d i t. *

* Tek Cirlot lexojmë ndër të tjera tek "Numbers" (fq.232): "Two... is expressed geometrically by two points, two lines or an angle." (Dyshi... shprehet gjeometrisht me dy pika, dy vija apo një kënd.)

Pra Japonishtja "k a d o" mund të motivohet me Shqipen si:

$$k a d y = "ka 2" = 2$$

Edhe Shqipja: "k a n d" = "k a n d à" = \oplus = $1/2 = 2 \dots(F)$

- 44) Sanskr. a - n i d a n a (अनिदान) = ingl. *without foundation; causeless*
(pa themel; pa shkak)

Mund të motivohet me Shqipen si:

$$- n d a n ("pa-ndarë") = - \oplus$$

Në këtë pikë duhet ta zgjerojmë disi Bisedën.

Algoritmi Simbolik jep:

$$n d a n = \oplus = \bullet = bërja, materializimi$$

E pamë këtë edhe pak më lart kur cituam Paracelsus. Pra: "Pa n d a r j e [a - n i d a n a] nuk ka krijim të materies (- \bullet) dhe as pra të Botës Materiale."

Ekuacioni ($\oplus = \bullet$) për të cilin është fjala këtu, jepet në Shqip në shumë mënyra, si për shembull me çiftin ekuivokal "n d a r ë" (\oplus) = "n d y r ë" (\bullet), ose "p j e s ë" (\oplus) = "p i s" (\bullet)...

Nga ana tjetër, sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$\oplus = - \circ \dots(F)$$

ku simboli i fundit është ndër të tjera ai *mohimit* të së Tërës, ai i *sakrifikimit* (-) të një Qenieje të Përsosur (\circ), e pra ai i Kurbanit. Ky njihet në literaturën simbolike (Mendimi Mistik) si "*Sakrifica Kozmogonike*".

Ne arritëm pra atëhere të motivojmë më së miri, me anë të Shqipës, kup-
timin e thellë të fjalës Sanskritishte "a-n i d a n a" (अनिदान).*

Duke zgjeruar dhe më tej ndoshta pa qenë e nevojshme Bisedën, ne mund
të shtojmë edhe sa vijon:

- a) Sanskritishtja "a-n i d a n a" na thotë se *pa ndarje nuk ka krijim* e pra,
me fjalët e Paracelsus, që "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang"...
- b) "a-n i d a n a" (अनिदान) = $-\textcircled{\ominus}$ = *pa cak* = *papërcaktueshmëri* =
Parimi i papërcaktueshmërisë në Fizikën kuantike = Fizika Kuantike...

Dhe me qenë se sipas Algoritmit Simbolik:

$$\textcircled{\ominus} = \bullet = \text{materie}$$

del se:

$$\text{Fizika Kuantike} = -\bullet$$

e pra që Fizika Kuantike nuk studjon më *materien* dhe as, rrjedhimisht,
Botën materiale, por një *Botë Spirituale*, "imagjinere", që përfaqëson,
në instancë të fundit, *Realitetin e mbarmë, të vërtetë*, jo më fenomenal.
Kjo dhe e bëri Eisteinin, me një përbujzje të padrejtë, ta quajë këtë
Fizikë: "...a spooky physics!..."**

- c) Me qenë se:

$$\text{Fizika Kuantike} = -\textcircled{\ominus} = \text{a-n i d a n a} = \textit{pa themel},$$

$$\textit{pa themelim, pa krijim}...$$

* Shih edhe më lartë, fq.55.

** "Fizikë fantazmash" apo siç e quante edhe ndryshe me ironi Einstein: "*spectral communication at a distance*"... (komunikim *fantazmash* në distancë).

del se:

"Fizika Kuantike studjon një Botë të pa Krijuar, e pra edhe të pavdekshme, të përjetshme..."

ç) Me qenë se:

– $\textcircled{1} = \textcircled{0} = (x = -x) = \text{'Coincidentia oppositorum',}$
the Mystical Centre, the Supreme Principle of the Universe...,
*the Paradise...**

ne mund të themi atëhere edhe se:

*"Fizika Kuantike studjon Botën Tjetër,
 Mbretërinë Qiellore, Parajsën..."*

Ky është një shembull, ndër të panumurtit, **të pranisë të Gjuhës në Shkencë dhe këtu, të një pajtimi epokal** (siç do të shohim edhe më mirë më pas) **mes Shkencës e Fésë (Theollogjisë)** që ishte i menduar, për shekuj e shekuj me radhë, krejt i pamundur.

Mbeten edhe shumë e shumë gjëra të tjera të rëndësishme për të thënë lidhur me këtë çështje, por do të jetë për një rast tjetër... ku do të përpiqemi të jemi edhe më të qartë, më konkretë e më të kuptueshëm për një audiencë të gjerë lexonjësish...

Le të motivojmë tani kuptimin tjetër të Sanskritishtes **"a-n i d a n a"** (अनिदान), atë të "mungesës së shkakut" (ingl. *causelessness*).

Për këtë kemi:

– $\textcircled{1} = E = - \leftrightarrow$
 "without foundation" "causless"

* Shih Cirlot, "Centre" (fq.40).

Me ndihmën e Shqipës dhe të Algoritmit Simbolik u vumë në gjendje të motivojmë edhe këtë kuptim të rëndësishëm të fjalës Sanskritishte që po shqyrtojmë.

M.q.s. nga ana tjetër " – ⊕ " mund të interpretohet si *papërcaktueshmëri* = *Parimi i Papërcaktueshmërisë* = *Fizika Kuantike*, del se:

"Parimi i Shkakësisë nuk është më funksionues në Fizikën Kuantike."

...që është pra si e tillë *sine causa* a, më saktë, bash ashtu si Substanca e Spinozës, *causa sui* ("shkak i vetes së saj").

Rënien e parimit të kauzalitetit në Fizikën Moderne u detyrua ta pranojë edhe vetë Einsteini, armik i betuar i Fizikës Kuantike e sidomos i Frymës së saj. Ja *ad litteram* fjalët e tij:

"Hitherto people have looked upon the Principle of Causality as a proposition which would in the course of years admit of experimental proof with an ever-increasing exactitude.

Now, Heisenberg has discovered a flaw in the proposition. The principle of causality loses its significance as an empirical proposition.

*Causality is thus only conceivable as a Form of the theoretical system."**

[Gjer më sot Parimi i Shkakësisë vështrohej si një propozicion që me kalimin e kohës do të mund të provohej eksperimentalisht me një saktësi gjithnjë e më të madhe.

Por ja Heisenbergu zbuloi në këtë propozicion një të metë... Kështu që parimi i shkakësisë humbet tani kuptimin e tij si një propozicion empirik.

Shkakësia mund të konceptohet këndeje e tutje vetëm si një Formë e Sistemit Teorik...]

* J. L. Christian, *"Philosophy: An Introduction to the Art of Wondering"* (1973).

Vëmë re se Sanskritishtja "n i d a n a" = *themel*, motivohet me Shqipen:

$$n d a n = \textcircled{1} = F = \textcircled{\square} = \bullet = \dots$$

Duke shumëzuar të dy anët e këtij ekuacioni me -1 , do të kemi:

$$\begin{aligned} -\textcircled{1} &= -F = E = -\bullet = \circ \dots = (x = -x) \\ &= -(x = x) = -\infty = \dots \end{aligned}$$

Mund të interpretojmë:

$$\begin{aligned} -\textcircled{1} &= \text{--cak} = \text{papër-cak-tueshmëri} = \text{Parimi i Papërcaktueshmërisë} \\ &= \text{Fizika Kuantike} = -(x = x) = \text{jo Parimi i moskontradiksionit} = \\ &= \text{Llogjika Aristoteliane} = \text{--Arsyeja Njerëzore} = (x = -x) = \\ &= \text{Llogjika e Tertium Datur} = \text{Qendra Mistike} = \text{Parimi Suprem i} \\ &= \text{Universit} = -\infty = \text{jo relativiteti, jo Teoria e Relativitetit} \\ &= \text{Absoluti} = \text{ZOTI} = \dots \end{aligned}$$

Nëpërmjet analizës së Gjuhës ne përftuam një informacion të rëndësishëm e të shumëfishtë. Ndër të tjera se: *...Fusha e studimit të Fizikës moderne (kuantike) është përtej materies e Botës materiale, se është jashtë Kohës e Hapësirës [$-\textcircled{1} = E = (t = 0, s = 0)$]; ...se ajo është Fizika (më saktë tashmë "Metafizika") e Hiçit (e Atij që ne quajmë të tillë);* ...se ajo nuk mund të pajtohet kurrësi me Teorinë e Relativitetit, e kështu me rradhë... Të gjitha përfundime këto, të cilat Fizika e sotme zyrtare i rikonfermon.***

* Parimi i papërcaktueshmërisë i Fizikës Kuantike është simbolikisht: $-\textcircled{1}$. Por Algoritmi Simbolik na jep: $-\textcircled{1} = -\bullet = \circ \dots(E)$, dhe ky simbol i fundit mund të interpretohet, ndër të tjera, edhe si "zero", si "Hiç".

** Kështu për shembull, Fizika "zyrtare" me gjithë përpjekjet durimplote dhe eksperimentet e holla e të stërholla që po kryen, nuk arrin ta pajtojë dot

Shohim edhe në këtë rast se si:

Gjuhësia, ashtu sikundër ne e konceptojmë atë, si asnjëherë të shkëputur nga Mendimi e pra nga Fillosofia, dhe është fjala këtu për "Philosophia Perennis", mund të shërbejë si një Euristikë e tepërfaqishme.

Do të kemi rast të shohim edhe të tjera e të tjera shembulla të këtij roli të Gjuhës.

45) Inql. **d i m** = terr, errësirë

Me Shqipen:

$$d a m = \textcircled{\ominus} = F = \bullet$$

46) Ital. **vetusto** = i vjetër

Nga Shqipja: "**vjet**" = ital. *anno*. Zbërthimi i kësaj fjale do të ishte me Shqipen:

vjet **âsht**

do të thotë: "ka vjet" = "âsht i vjetshëm" = âsht i vjetër...

Italishtja nuk e motivon dot këtë fjalë për arsye se i mungon operatori "v j e t" që është në Italisht, siç pamë, "*anno*".

47) Ital. **veterano** < Shq. i **vjetër** < **vjet**.

kursesi Teorinë e Relativitetit me Fizikën Kuantike. Gjë që tashmë e dimë, pasi:

$$\begin{aligned} \text{Teoria e Relativitetit} &= \text{X} = F = \textcircled{\ominus} = \text{---} \textcircled{\ominus} \\ &= \text{-- Parimi i papërcaktueshmërisë} = \text{-- Fizika Kuantike} \end{aligned}$$

Shih lidhur me këtë çështje edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

48) Turq. **s e n e** = vjet

Lidhet si me prejardhjen e saj nga Shqipja:

s y n i

Dhe kjo sepse siç lexojmë ndër të tjera tek Cirlot: "...*the s u n has been equated mythically with the e y e of Heaven...*"* [...*dielli është njësuar mitikisht me syrin e Qiellit...*]

Por "1 vjet" është një rotullim i plotë i tokës rreth Diellit. Që këndeje edhe lidhja e *vitit* me *diellin*, e pra edhe me *synin*.**

49) Sanskr. **s ū r i a** (सूर्य) = fr. *soleil* (dielli)

Lidhet me Shqipen:

s y r i (ingl. *eye*)

dhe kjo me qenë se "Dielli" vështrohej si "Syri i Qiellit".

Lidhur me këtë lexojmë ndër tek Cirlot: "D i e l l i : ...Në Indi, si *S u r y a*, ay (dielli) është *s y r i* i Varunës; në Persi ai është *s y r i* i Ahura-Mazda; në Greqi, si *Helios*, është *s y r i* i Zeusit (ose i *Uraniusit*); në Egjipt është *s y r i* i *Ra*, dhe në Islam është *s y r i* i *Allahut*."***

Shtojmë këtu gjithashtu edhe Inglishten "**s u n**" (fr. *soleil*), që është sërish Shqipja: "**s y n i**".

* Shih Cirlot, fq.317.

** Shtojmë mbi të gjitha këto se Dielli është vështuar mitikisht edhe si djali i Qiellit. Kështu, në Shqip: "**d i e l l i**, **d j a l i**"; në Inglisht: "**s u n**, **s o n**"; në Gjermanisht: "**S o n n e**, **S o h n**"; në Rusisht: "**s o n t s e**, **s i n**" etj.

*** Shih lidhur me këtë çështje edhe fq.771.

50) Ital. **s e n a t o** = kuvendi i pleqve në Romën e lashtë

Për sa pamë më sipër, nga Shqipja:

s y n i

51) Ingl. **s e n i o r** = i moshuar, plak

Nga Shqipja:

s y n i

52) Lat. **s c i o** = di (që nga dhe "**s c i e n t i a**" = dije, dituri)

Kemi thënë e parë se Gjuha emërton sipas një paradigme **superlative**.^{*} Prandaj edhe këtu, me qenë se shkalla më e lartë e Dijes është **p a m j a**

* Kujtojmë këtu nga Mirce Eliade, tek "*Le mythe de l'éternel retour, Archetypes et répétition*" (fq.48): "Un objet ou un acte ne devient reel que dans la mesure ou il imite ou répète un archetype. Ainsi la réalité s'acquiert exclusivement par répétition ou participation; tout ce qui n'a pas un modèle exemplaire est 'dénue de sens', c'est-a-dire manqué de réalité. Les homes auraient donc tendance a devenir archetypaux et paradigmatiques... L'homme des cultures traditionnelles ne se reconnait comme reel que dans la mesure ou il cesse d'être lui-même (pour un observateur modern) et se contente d'imiter et de repeater les geste d'un autre. En d'autre termes, il ne se reconnait comme reel, c'est-a-dire comme 'véritablement lui-même' que dans la mesure ou il cesse précisément de l'être."

(Një objekt ose një veprim bëhet real vetëm për sa e për aq sa ai imiton apo përsërit një arketip. Kështu pra Realiteti arrihet vetëm nëpërmjet *përsëritjes* apo *pjesëmarrjes*; një send (a veprim) që nuk ka një model shembullor, "nuk ka kuptim", nuk ka realitet... Njerëzit do të prireshin pra të bëheshin arkeotipalë dhe paradigmatikë... Njerëzit e kulturave tradicionale e gjykonin veten si qenie reale vetëm për sa e për aq sa reshtnin së qenuri ata vetë (për

drejtëpërsëdrejti e objektit të Njohjes, Latinishtja "s c i o" nuk mund të jetë tjetër veçse Shqipja:

s h o h

(ingl. *to see*)

një rrënjë kjo që mungon në gjendje të lirë në Latinisht.

53) Greq. *s o f i a* (σ ο φ ί α) = dituria

Vjen nga Shqipja:

s h o f

për të njejrat arsye si edhe për Latinishten "s c i o".

54) Greq. *a l y t h i a* (α λ ή θ ε ι α) = ingl. *the truth* (e vërteta)

Motivimi me Shqipen jep:

a l y t h i a → shq. - **l i t h** = - ⌘ = **zgjdhja, Liria**

Simboli i fundit është ndër të tjera dhe ai i lirisë, i zgjidhjes, i Absolutit.*

një vëzhgues modern) dhe mjaftoheshin së imituarit e së përsëriturit *gjestet* (*bëmat*) e një tjetri. Me fjalë të tjera, njeriu tradicional e quan veten real, d.m.th. "me të vërtetë ai vetë"vetëm për sa e për aq sa rresht së qenuri i tillë.)

E njejta gjë ndodh, siç kemi diskutuar edhe gjetiu, edhe në Gjuhë: çdo fjalë duhet të referojë tek një model, tek një paradigmë, ku koncepti që ajo shpreh realizohet në një dimension madhor, epror dhe arketipal *par excellence*..

* Nga Latinishtja "A b s o l u t u s" < a b s o l v o = *zgjdh, gjej të pafajshëm, liroj...* (e pra simbolikisht - ⌘).

Algoritmi Simbolik jep:

$- \infty = E = (x = -x) = \text{the mystical Centre,}$
the Supreme Principle of the Universe, the Holy Spirit,
the Paradise... = \bigcirc = the All, the Universe, the Infinite... G O D

Le ta zgjerojmë tani Bisedën në disa drejtime:

- 1) Ne shikojmë se koncepti i të "v ë r t e t ë s" ($(x = -x)$, \bigcirc , *a-lythia*) është ekuivalent me atë të "l i r i s ë" ($-\infty$).

Mund të themi pra se **e vërteta është kusht i domosdoshëm i lirisë**, se *pa të vërtetë nuk ka liri...* dhe anasjelltas, **liria është kusht i domosdoshëm për të vërtetën**. Ku s'ka liri, me fjalë të tjera, ka vetëm gënjeshtër...

$(x = -x) = \bigcirc = E = -\infty$
e Vërteta **Liria**

Kështu, siç shihet, *e vërteta* dhe *liria* janë dy koncepte ekuivalente.

- 2) Kuptojmë atëhere këtë të thënë të thellë nga Ungjilli:

*"Ubi autem Spiritus (\bigcirc) Domini, ibi libertas ($-\infty$)."**

Fryma e Zotit (lat. *Spiritus Domini*) është Qendra Mistike, *Coincidentia oppositorum*, e pra ekuacioni $(x = -x)$, e pra edhe e TANA (\bigcirc), Infiniti.**

* Korinthisit (II, 3:17): *"Dominus autem Spiritus est Ubi autem Spiritus Domini ibi libertas."* (Zoti është Frymë dhe atje ku është Fryma e Tij është dhe Liria.)

** Cirlot (fq.123): $\bigcirc = \text{Infinity, the Universe, the All...}$

3) Krishti në Ungjill:

"Do të mësoni të Vërtetën
dhe e Vërteta do ju bëjë juve të lirë."^{*}

Simbolikisht:

$$\bigcirc = -\infty \quad \dots(E)$$

e Vërteta = Liria

Por edhe Greqishtja pozon, bash si Krishti siç kemi parë me ndihmën e Shqipes, po këtë ekuacion:

$$\bigcirc = -\infty$$

greq. a-lythia = shq. -lyth

Dhe kjo mund të vështrohet si një prani e thellë e Ungjillit në Greqisht...

4) Fizika Kuantike = parimi i papërcaktueshmërisë = $-\bigcirc = E$
 = $-\infty$ = zgjidhja, Liria... = $\bigcirc = e$ Vërteta, Alythia...

Me fjalë të tjera:

- Prania e Fizikës Kuantike në Greqisht (me ndihmën e Shqipes).
 - Mosfunksionimi i konceptit të Ligjit ($-\infty$) në Fizikën Kuantike, eksperimentalisht e provuar dhe teorikisht^{**} e pranuar.
- 5) Pra e Vërteta, Liria... janë koncepte që bëjnë pjesë në kodin E, dhe jo në kodin F, e pra jo të arritshme si të tilla nga Arsyeja Njerëzore.

* Ungjilli sipas Gjonit, 8:32.

** Gjer vetë Einsteini, kundërshtar i vendosur i Fizikës Kuantike, detyrohet të pranojë rënien e ligjit të kauzalitetit, gjë që hap mundësinë e krijimit të Fizikës së Rë. (Shih lidhur me këtë dhe fq.420)

Mund të shkruajmë:

$$(x = x) = -(x = -x) = -\bigcirc = -(-\infty) \quad \dots(F)$$

Arsyeja jo Qendra jo e Vërteta jo Liria

6) Nga sa më sipër, mund të shkruajmë edhe:

$$\text{e Vërteta} = \bigcirc = -\bullet = -\text{materialia}, -\text{Bota materiale}$$

që nga edhe:

*"E vërteta i kundërvihet Botës materiale,
e mohon atë, e asgjëson atë..."*

Krishti në Ungjill: "...Kam ardhur të dëshmoj për të Vërtetën."* Dhe gjetskë: "Unë jam e Vërteta..."** Por triumfi i të Vërtetës nëpërmjet Krishtit, do ti jepte fund, nga sa pamë, Botës, gjë që edhe shpjegon Përse-në e thellë të vrasjes së Krishtit... Kështu pra Bota mbahet mbi Gënjeshtren, pra dhe e Vërteta (greq. *Alythia*, ἀλήθεια) asaj nuk i përket, ashtu sikundër nuk i përket as Liria [shq. – *lyth*, – ∞].

55) Kin. k ð u (□) = ingl. *mouth* (gojë)

Është Shqipja:

g o j ë

Këtu lidhen edhe fjalë të Shqipes si "me k u", "m e k o j", "m ë k o j", të gjitha fjalë këto që japin kuptimin e të ushqyerit të një fëmije apo të një të sëmuri.

* Gjoni, 18:37.

** Gjoni, 14:6.

56) Ital. **ca d e r e** = ingl. *to fall* (me rà)

Me Shqipen:

ca d e r e → shq. **ka d ā r** = ⊕ = ↓ ... (F)

Edhe këtu pra "rënia" del si rrjedhim i "ndarjes". Dhe kjo është një taktikë e përdorur gjerësisht në shumë gjuhë.

57) Lat. **ca e d o** = ingl. *to cut, to cut down; to beat; to kill* (me pré; me i rà, me godit; me v r a)

Lidhet me Shqipen:

ka d à

Simbolikisht kuptimi i parë, themelor, do të jepej me " ⊕ ".

58) Lat. **ca d o** = ingl. *to fall, to fall down, drop; to fall, to perish; to be destroyed...* (me rà, bie; me rà, me vdek; shembem)

Motivimi me anë të Shqipes do të na japë:

ca d o → shq. **ka d à** = ⊕ = **F** = ↓

Kështu pra simbolikisht, kuptimi i parë, themelor, do të jepej me " ↓ ".

Këto dy fjalë (*caedo* dhe *cado*) janë e "njejta" fjalë, kuptimet e tyre janë konceptualisht disi të ndryshme, por ato i përkasin të njejtës rrënjë. Kjo shihet edhe nga fakti se kemi:

caedo, caedere, c e c i d i, caesum (shq. me pré, ⊕)

cado, cadere, c e c i d i, casum (shq. me rà, ↓)

me fjalë të tjera, ato zgjedhohen, si folje, të dyja njëloj.

Shihet se këtu taktika e Gjuhës për të shmangur keqkuptimin (sikur këto fjalë të shkruheshin krejt njëloj: homonimi perfekte) është një apofoni a, siç e quajnë linguistët gjermanë, një "Umlaut", do me thënë një ndrrim zanore: "ae" që bëhet "e".

Shohim se si Latinishtja shtron në këtë mënyrë ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\textcircled{1} = \downarrow \dots(F)$$

$$c a e d o \quad c a d o$$

Kjo rivërteton analizën e fjalës Italisht "c a d e r e" që ne kryem më sipër, duke e reduktuar atë, për motivim, tek Shqipja "k a d à".

59) **Ital. a c c a d e r e** = ingl. *to happen* (me ndodh, me ngjã)...

Këtu kemi një kuptim tjetër e rrënjës "c a d o", të cilin nuk e përmendëm më lartë, bashkë me të tjerët, është edhe: "ndodh", "ngjan" (ingl. *happen*), siç del në pah nëpërmjet fjalës tjetër të Italishtes "a c c a d e r e".

Kjo fjalë zbërthehet në:

$$a c + c a d e r e$$

"c" në "ac" vjen nga një "d" (e pra: "ac" < "ad"), duke u shndrruar në "c" si rrjedhojë e një asimilimi progresiv. Këtu "ad" është një parashtesë me kuptimin e lëvizjes, një parashtesë që mund ta quajmë foljore, por që nuk lot ndonjë rol në semantizmin e mirëfilltë të fjalës "a c c a d e r e". Duke qenë kështu, motivimi i fjalës "a c c a d e r e" bëhet njëloj si edhe ai i fjalës "c a d e r e" që pamë më sipër.

E pra simbolikisht:

$$a c c a d e r e \rightarrow c a d e r e = \downarrow = \bullet = \textit{materializim}...$$

Kjo etimologji rikonfermohet edhe nga miti kozmogonik i "Rënies" (ingl. *The Fall*). Siç lexojmë tek Cirlot: "*The Fall signifies the incarnation of the Spirit.*"*

Duke e zgjeruar tani Bisedën, le të kujtojmë këtu Inglishten "u p" që do të thotë në të njejtën kohë edhe *fund*, edhe *lart*, *ngritje lart*, kështu që Inglishtja shtron me këtë bisemi ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \omega & = & \uparrow & \dots(E) \\ \text{u p} & & \text{u p} & \\ \text{(mbarim)} & & \text{(lart)**} & \end{array}$$

Duke shumëzuar të dy krahët e këtij ekuacioni me "- 1", do të kemi:

$$\begin{array}{ccc} \alpha & = & \downarrow & \dots(F) \\ \text{it. accadere} & & \text{cadere} & \\ \text{(fillimi)} & & \text{(rënie, ingl. fall)} & \end{array}$$

* Shih fq.Cirlot, "*the Fall*" (fq.101).

** Ajo që na jep të kuptojmë Inglishtja me këtë ekuacion të rëndësishëm simbolik është se:

*"Fundi (ω) i Botës do të ndodhë me një ngritje lart (↑)
të atyre sa ranë..."*

Kjo do të thotë pra, për ata që dinë të shohin e të kuptojnë, se rrënjët tona janë në qiell, tek i cili ne të gjithë do të kthehemi pasi të vdesim. Inglishtja na e jep simbolikisht këtë të vërtetë edhe me fjalën "o v e r" (gjerm. "ü b e r"), që shtron dhe ajo ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} \omega & = & \uparrow & \dots(E) \\ \text{o v e r} & & \text{o v e r} & \\ \text{(fundi)} & & \text{(ngritja)} & \end{array}$$

Është ndoshta rasti këtu për të vënë në dukje se, siç thotë Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"... që do të thotë se gjithshka fillon me një ndarje sikundër edhe Bota jonë materiale ka filluar.

Algoritmi Simbolik na jep relacionin simbolik: $\textcircled{1} = \bullet \dots(F)$, në të cilin duke interpretuar " $\textcircled{1}$ " si *ndarje* (thyerje, prerje) dhe " \bullet " si *materie*, si *Botë materiale*, ne mund të themi se "*Botë lind me një ndarje*"..., duke rikonfirmuar kështu saktësinë e mendimit të Paracelsit.

Kështu pra që është e natyrshme, do me thënë krejt në frymën e Mendimit Mistit (vizionit primordial, mistik mbi Universin, që po rikthehet kaq i fuqishëm, kaq vërshues dhe tërëpërshkues, përmbysës dhe papërmbytur sot në Mendimin dhe Shkencën e Kohës sonë) të lidhësh konceptin e "ndodhjes" (ingl. *happening*) me atë të një "ndarjeje" (ingl. *separation*).

Le të shtojmë këtu se edhe Shqipja "ndodhje", me thelbin e saj semantik "n d o-" flet për një "n d a r j e". Kështu Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \bullet \dots(F) \\ \text{n d a r j e} & & \text{n d o d h j e} \end{array}$$

6o) Ingl. *h a p p e n* = ital. *accadare, succedere* (me ndodh, me ngjã)

Mund të motivohet fare mirë me Shqipen po të kihet parasysh se " \bigcirc " është simboli i të Tërës, i Frymës, i Qendrës, i Zotit me qenë se:

$$\bigcirc = (x = -x) = \text{Qendra} = \textit{Coincidentia oppositorum} = \text{DEUS}$$

Sipas miteve kozmogonike Bota është krijuar me mohimin (vrasjen) e një Qenje Hyjnore, gjë që mund ta tregojmë simbolikisht me " $-\bigcirc$ " dhe me çgjymtyrimin (ingl. *dismemberment*) e saj e pra simb. " $\textcircled{1}$ ".*

* Shih më poshtë, fq.95-96.

Po kemi sipas Algoritmit Simbolik:

$$\textcircled{1} = () = \text{hapje}$$

Pra Bota ka filluar me një "h a p j e": kalimi nga " $\textcircled{0}$ " në " $\textcircled{1}$ ".

Po duke qenë kështu, edhe fjala Inglistht "h a p p e n" (= ndodh) duke u zbërthyer në:

h a p + p e n

ku "-p e n" është Shqipja "b ë n" (ingl. *to do, to make*), do të thotë:

"b ë n h a p"

e pra simbolikisht ajo flet për një kalim nga " $\textcircled{0}$ " në " $\textcircled{1}$ ", që është një kalim nga kodi E në kodin F, kalim në të cilin mund të reduktohen të gjitha mitet kozmogonike, siç do të kemi rastin të shohim më mirë e hollësishtëm përmes shembujve të ndryshëm që do të jepen gjatë këtij studimi.

Ja pra disa ilustrime të rolit mesianik të Shqipes:

Shqipja i motivon fjalët e gjuhëve të huaja duke i "shpënë" tek simboli që ato, "pa e ditur" përshkruajnë a tek një simbol i njëvlefshëm me të.

Këtu shprehja "pa e ditur" do të thotë se vetë gjuhët e huaja, me mjetet e tyre leksikore nuk janë në gjendje ti reduktojnë, ti shpien fjalët e tyre tek simbolet përkatëse që ato përshkruajnë, duke mos u bërë dot koshjente kështu për lidhjen që këto fjalë mbajnë me simbolet arkeotipale të cilave u referohen dhe të cilët, nga ana e tyre, përbëjnë motivimin e thellë, të fundëm të tyre.

Në qoftë se Gjuha Shqipe, siç po tregojmë, lot një rol kaq të rëndësishëm ndërmjetësues mes fjalës dhe simbolit, si në shembujt e mësipërm

ashtu dhe në ato që do të vijojnë, *i vetmi konkluzion i mundshëm që mund të nxirret që këndej është se ajo duhet të jetë më afër se çdo gjuhë tjetër (a të paktën më afër se shumica e tyre) gjuhës së parë simbolike.*

61) Ital. **s c a r t o** = skarco

Këtu "S" si mohuese rri për "– 1".*

Me Shqipen atëhere:

s c a r t o → shq. – **k r y t** = "e pa kryt" = e pa përkryt...
= jo e kryer plotësisht, jo e përkryer...

e pra:

– ○ = ● = e keqe (e pra "skarco")

62) Ital. **d i s t i n t o** = inglt. *distinct, separate* (i dalluar, i veçuar)...

E pra simb. " ⊕ ", e pra atëhere edhe " – ○ " = *jo me të tanën, jo me të gjithën...*, "i ndarë nga gjithë të tjerët", "i nderuar", "i shquar"...

Motivimi me Shqipen:

d i s t i n t o → shq. **d y s h T a n** = 2 . t a n = – t a n = – ○ = ⊕ **

* Shih edhe fq.111-115.

** Kujtojmë këtu se Arithmetika Mistike jep: (3 = 0), që nga: (2 = – 1 = –).

ital. "distinto" < lat. "d i s t i n c t u s"

ku "-ct" është Shqipja "katis", "gatis"... edhe Sanskritishtja "ghatita" (घटित) po me atë kuptim.

63) Ital. **discreto** = mesatar, jo i plotë, i ndarë...

Me Shqipen:

d y s h k r e j t = 2. \bigcirc = - \bigcirc = \bigoplus = *mesatarí, normalitet, etj.*

Në Fizikë përdoret shprehja "madhësi diskrete" ose "natyrë diskrete" kur është fjala për një manifestim jo me valë, por me grimca.*

64) Rus. **d r o b a** (д р о б а) = thyesë

Me Shqipen:

d r o b a → shq. **d a r b â** = \bigoplus = % = *thyesa..*

Siç shikojmë kjo fjalë e Rusishtes mund të motivohet *vetëm me Shqipen*, sepse *vetëm në Shqip* ekziston operatori "d a r" me kuptimin e *ndarjes* dhe operatori "b a" me kuptimin e *bërjes*. Pra pyetjes: *Si realizohet një thyesë?* do të mund ti përgjigjeshim: Duke *ba* një *darje*.

Shtojmë këtu se dhe fjala "**t h y e s a**" e Shqipës nuk është tjetër veçse një derivat i foljes "m e **t h y**" (ingl. *to break*).

Ky është një nga rastet jo të rralla të inkapsullimit të një operatori të lirë Shqiptar, pa të cilin fjala e shqyrtuar nuk do të mund të motivohej, të etimologjizohej.

* Mund të shkruajmë:

\bigoplus = *F* = \bullet
g r i m c a **m a t e r i a l e**
 (madhësi diskrete)

Shih gjithashtu edhe fq.699.

65) Rus. *podrobnost* (подробность) = hollësi

Motivimi:

p o d r o b e n o s t

dhe me Shqipen:

b â d a r : b a n â s h t = ⊕

(është bërë e darë)

Në Italisht "*d e t t a g l i o*" = *hollësi* (rus. *podrobnost*), ku "*t a g l i o*" nga "*tagliare*" = *me pré* (rus. *drobits*) = ⊕ .

Pra, koncepti i "hollësisë" lidhet edhe në Frengjisht me atë të "ndarjes".

Në Gjermanisht: "*A u s - s c h n i t t*" = *hollësi*... Dhe theksi semantik këtu bie në "*s c h n i t t*" nga folja "*s c h n e i d e n*" = *me pré* (⊕).

66) Ital. *discrepanza* = boshllëk, mangësi, mosnjehjësi...

Me Shqipen:

d y s h k r e - j t b a n = 2 . ○ = - 1 . ○ = - ○ = *jo krejtësi, jo plotësi*

Këtu "b a n" është, siç kuptohet lehtë, folja Shqip "me b a" (ingl. *to do*).

67) Greq. *agripnia* (αγρυπνία) = ingl. *persistent loss of sleep, insomnia* (pagjumësi; syçelur, vigjilent)

Me Shqipen:

â (n) g r é b â n

d.m.th. "që rri ngritur", "që nuk fle"... Përdoret edhe në rastin e lutjeve të besimtarëve gjatë natës.

Rrënja "*n g r e*" lidhet me operatorin e njohur Shqip "*k r y*", "*n g r é*", "*k r e j t*".

Vëmë re me këtë rast se Shqipja shtron ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} 1 & = & \bigcirc \quad \dots(E) \\ \text{kry} & & \text{krejt} \end{array}$$

Me këtë rrënjë lidhet edhe në Greqisht fjala "akro-fobia" (= frikë nga *lartësia*), si edhe në kombinime të tjera.*

68) Ital. *però* = ingl. *but* (por)

Motivimi me Shqipen:

però → shq. *por* → i,e *parë* = $-1 = F = (\rightarrow \nleftrightarrow) = \text{kundërvënie, kundërshtim...}$

Le të vëmë re këtu se:

a) "Njëshi" si fillim arkeotipal i Botës është "negativ", sepse Bota ka filluar me një mohim, ky përbën mitin e "*Cosmogonic Sacrifice*" dhe është kjo "sacrificë", pikërisht *m o h i m i*, ai që ne tregojmë me " -1 ", i një Qenje Hyjnore, "kurbani". Mund të themi pra edhe se:

*"Bota ka filluar me një kurban."***

* Shih ndër të tjera edhe fq.70,389 dhe 671.

** Shqipja e jep bukur këtë me aforizmën:

"Krymja nga një Krim."

Tek Cirlot lexojmë lidhur me këtë, ndër të tjera (*Cosmogony*, fq.62):

"The basis of most cosmogonies is the '*cosmic sacrifice*', expressing the idea that the *creation of forms and matter can take place only by modifying primordial energy*. Such a modification, so far as most primitive and protohistoric peoples are concerned, was seen to exist in such painful forms as mutilation, struggle or *sacrifice*. In Babylonian cosmogony it assumed the form of the *killing* of the *original* mother Tiamat (the dragon),

Mund të shtojmë këtu se prefiksi "p a r a-" me kuptim negativ, në fjalë si *paranormal*, *paradoks*, etj. lidhet me Shqipen "i,e p a r ë" për arsyt që u treguan më sipër. Kjo rrënjë gjendet e pastër ndër të tjera edhe në Sanskritishten "p a r a" (पर) me dy kuptime të kundërta si në Shqip "1" dhe "-1".

Duke zgjeruar edhe më tej Bisedën:

Marrim fjalën "p a r a n o r m a l". Sipas vlerës (negative a pozitive) që i japim prefiksit "p a r a" (1 a -1) kjo fjalë do të thotë:

a) jo normalitet , b) normalitet i parë

whose body was used in the creation of heaven and earth... According to the Rigveda, the gods would sacrifice a primeval being – the giant Purusha... Clearly, then, these cosmogonies have a psychological implication because they express the central idea that **there is no creation without sacrifice, no life without death**... Here we have the origin of all the bloody sacrifices of the world's religions..."

(Shumica e miteve kozmogonike flasin për një 'sakrificë kozmike', pas të cilës qëndron bindja se krijimi i formave dhe i materies është i mundur vetëm nëpërmjet një modifikimi të Energjisë Primordiale. Një modifikim i tillë, përse i përket popujve më primitivë dhe parahistorikë, qëndronte në trajta të tilla të dhimbshme, si çgjymtyrimi [ingl. *mutilation*], lufta, sakrifica, therrorizimi... Në kozmogoninë Babilonase ajo mori trajtën e vrasjes së nënës zanafillore Tiamat (Dragoi), trupi i së cilës u përdor në krijimin e Qiellit dhe të Tokës... Sipas traditave indiane, krijimi i botës lidhej me luftën e perëndive me një tribu demonësh me emrin Asura ose me përbindësha të tjerë të ndonjë lloji tjetër. Sipas Rigvedës, Perënditë sakrifikuan një qenje primordiale, gjigandin Purusha... Kuptohet qartë pas kësaj se të gjitha këto kozmogonira, mbartin me vete një kuptim të thellë psikologjik. Ato sikur duan të na thonë se 'nuk mund të ketë krijim pa sakrificë, dhe as mund të ketë jetë pa vdekje'. Ne zbulojmë këtu zanafillën e therroreve të përgjakshme të ferave kudo në botë...)

Që këndeje përfundimi, disi i guximshëm, por i vërtetë, se ajo që ne quajmë sot "paranormale" në kuptimin jo normale, jo e zakonshme, duhet të ketë qenë dikur normale, krejt e zakonshme. *Paranormaliteti*, me fjalë të tjera, *duhet të ketë qenë një dhuntí e përbashkët për të gjithë Njerëzimin*.

Marrim tani fjalën "**paradoks**" që do të thotë:

Paradoksi – **dhoksia** ($\delta \acute{o} \xi \alpha$) = –*jo lavdi...*, *jo e vërtetë*

Paradoksi është parë, pothuaj gjer sot, si një "jo e vërtetë", si një gënjeshtër, si rrjedhim i një gabimi llogjik.

Po sot kanë ndryshuar punët, paradoksi vështrohet tani, përkundrazi, si *shprehja* e një të vërtete të thellë, absolute. Dhe kjo jo vetëm në *Fillosofi*, por madje edhe, në një mënyrë a në një tjetër (e herë–herë edhe krejt *haptas*) në Fizikë, ku na thuhet (Bohr)* se ekzistojnë dy lloj gjykimesh

* *Niels Henrik David Bohr* (1885–1962). Fizikant i shquar danez. Dha një kontribut vendimtar në njohjen e strukturës të atomit dhe në hedhjen e themeleve të Mekanikës Kuantike. Ai zgjidhi një sërë problemesh të ngatërruara të Fizikës Kuantike, duke u mbështetur në urtësinë e lashtë të Lindjes. E tija është thënia "*Contraria sunt complimenta*" [*Të kundërtat përplotësojnë njëra–tjetrën*].

Sipas tij ekzistojnë dy lloj gjykimesh, a) gjykime të cekta, kur e kundërta e një gjykimi të vërtetë nuk është e vërtetë, b) gjykime të thella kur e kundërta e një gjykimi të vërtetë është dhe ajo e vërtetë.

Në rastin e parë është fjala për propozicionet (ingl. *statements*) e Fizikës Klasike (deterministe) e cila i përmbahet, siç dimë, llogjikës aristoteliane, Arsyes njerëzore, kodit **F** : ($x = x$). Në rastin e dytë është fjala për propozicionet e Fizikës Kuantike, kodi **E** : ($x = -x$).

Kështu Bohri rikonfermon ekzistencën e dy llogjikave, e dy kodeve, e pra atë, qoftë dhe pjesërisht, të Algoritmit tonë Simbolik, si artikullim llogjik i "*Philosophia Perennis*".

(ingl. *statements*): 1) *Të cekta*, kur e kundërta e tyre nuk është e vërtetë;
2) *Të thella*, kur edhe e kundërta e tyre është e vërtetë.

Le të tregojmë me " x " një gjykim. Në rastin e parë (*gjykime të cekta*) do të kemi:

$$(x \neq -x) \text{ e pra } (x = x) \quad \dots(F)$$

Në rastin e dytë (*gjykime të thella*):

$$(x = -x) \quad \dots(E)$$

Pra: Një gjykim është i *cektë* kur i përket kodit F e llogjikës së tij, që është ajo aristoteliane a ndryshe Arsyeya Njerëzore. Këto janë sigurisht *atëhere* edhe gjykimet normale, të arsyeshme, "të pranueshme".

Një gjykim është i *thellë* kur i përket kodit E dhe llogjikës së tij që është ajo anti-aristoteliane, ajo që bie në kundërshtim me Arsyen Njerëzore, që nuk përfshihet dot prej saj, që e superon, e trashendon atë. Këto janë *atëhere* edhe gjykimet paranormale, paradoksale, "të papranueshme", "absurde"...

Kështu pra:

"Paradoksi është shprehja e një të vërtete të thellë."

Duke zgjeruar dhe më tej zgjerimin e Bisedës tonë, shtojmë akoma se:

a) Të vërtetat e cekta, si të përfshira në kodin F, janë *relative* edhe kjo sepse kemi:

$$(x = x) = F = \infty = \text{Relativitet}$$

b) Të vërtetat e thella (paranormale, paradoksale, "absurde") si të përfshira në kodin E janë *absolute*, edhe kjo sepse kemi:

$$(x = -x) = E = -\infty = \text{Absoluti}$$

69) Rus. **v j e t h i j** (**в е т х и й**) = i vjetër, i lashtë, i vjetëruar

Është Shqipja:

i v j e t ë r

nga fjala Shqip "**v j e t**" që mungon në Rusisht, ku: *vjet, vit* = "god".

70) Rus. **n a d o** (**н а д о**) = duhet (mungesë që duhet plotësuar...)

Motivohet me Shqipen :

n a d o → shq. **n d a** (ingl. *divide*) = $\textcircled{1}$ = - $\textcircled{0}$ = *jo krejt, jo e gjitha, jo e plotë, m a n g ë s i...**

Edhe fjala Shqip "**d u h e t**" (ingl. *ought to...*) përshkruan edhe ajo të njejtin simbol, atë të mangësisë:

duhet → shq. **d a h e t** = $\textcircled{1}$ = **F** = - $\textcircled{0}$

71) Ingl. **w a n t** = nevojë, mungesë

Për motivimin e kësaj fjale shkruajmë:**

w a n t

Dhe atëhere me Shqipen do të kemi:

b â â n d à = $\textcircled{1}$ = - $\textcircled{0}$

Mos harrojmë se njeriu **d o** [ingl. *to want*] bash atë që i **m u n g o n** [ingl. *the wanting* = mungesën].

* Simboli " $\textcircled{0}$ " është edhe ai, ndër të tjera, i të Tanës, i të Plotës, i të Përsosurës. Prandaj dhe " $- \textcircled{0}$ " = *jo e plotë, jo e përsosur, e mangut...*

** Ingl. "**w**" = shq. "**b**". (shih ndër të tjera edhe fq.69, 184, 192 dhe 782)

72) Ingl. **to need** = duhet

Me Shqipen:

need → shq. **ndà** = ⊕ = - ⊙73) Lat. **dēbēre** = duhet

Me Shqipen:

da bërë = "bërë dà" = ⊕ ...Po ashtu edhe Italishtja "**d o v e r e**", Frengjishtja "**d e v o i r**", etj.74) Ingl. **wreath** = kurorë

Shkruajmë:

w r e a t h

dhe me Shqipen atëhere:

b ë r e t h

simbolikisht:

⊙ = rrethi, kurora...

75) Jap. **k a i w a** (会話) = ingl. *conversation, talking* (bisedë, kuvendim)

Është Shqipja:

m e **k u v e t** = me bisedue

Për sa i përket etimologjisë të fjalës "**k u v e t**", duhet thënë se ajo lidhet me fjalën "**k a v i**", trajtë e vjetër e Shqipes për "**k a u**". Dhe kjo për arsye se në kohërat tepër të lashta *kau* dhe *lopa* vështroheshin si zotër të Fjalës, si Fjalë e Personifikuar. Tek Cirlot ne gjejmë një shpjegim për këtë: "*Cow... 'Vac', the feminine aspect of Brahma, is known as the 'melodious Cow'... a description stemming from the idea of the world's creation out of*

sound..." [Lopa...'Vac', aspekti femëror i Brahmës, njihet si 'lopa melodioze'... një ide që rrjedh nga ajo e krijimit të Botës nga zëri...]*

76) Sanskr. **g a v i** (गवी) = fr. vache ; parole (lopë ; fjalë)

Është Shqipja:

k a u

dhe në trajtën e saj arkaike:

k a v i**

Lidhjen e thellë mitike të "fjalës" me "kaun" e gjejmë në Shqip në foljen e Veriut "me **k u v e t**" (*me kuvendue, me bisedue*) etj. etj

Këndej rrjedh (nga Shqipja) edhe Ruishtja "g o v o r i t s" (говорить)*** = *me bisedue, me kuvendue*, si edhe Japonishtja "k a i w a" (会話).

77) Sanskr. **g o p a** (गोपा) = ai që sheh qetë, që i ruan ato, bariu i qeve

Këtu:

"p a" = folja Shqip "me **p a**" (fr. *voir*; ingl. *see, take care of...*)

"k a" = Shqipja "k a u", "k a v i" (fr. *boeuf*)

Pra me Shqipen:

p a k a u → "p a-mësi i q e-ve"
(ai që kujdeset për qetë)

* Cirlot, fq.65.

** Në Shqip: "lau" < "lavi" (trajta arkaike), "pau" < "pavi", "thau" < "thavi", etj.

*** Shtojmë këtu se lidhja mes *kaut* dhe *fjalës* ekziston edhe në Ruisht, ku: "govorits" (гов-оритъ) = *me kuvet*, dhe "govjadina" (гов-ядина) = *mish kau*.

Kujtojmë se në Shqip: "me *pa*" = shikoj, *ruaj** (ingl. *guard, to watch over*).

78) Greq. **p i s o** (πίσω) = ingl. *behind, after* (pas, mbrapa)

Kjo fjalë nuk është tjetër veçse Shqipja:

p a s

në kuptimin "mbrapa" (ingl. *behind, after*) dhe simbolikisht pra "2" ose edhe "-1".

Mund të shkruajmë:

greq. "p i s o" < shq. "p a s"

Dhe kjo edhe sepse "p a s" në Shqip nuk është si në Greqisht e "izoluar", por hyn në shumë kontekste, në një sërë ekuacionesh simbolike, si për shembull:

Kështu, në Shqip ndër të tjera:

$$2 = -1 = \leftrightarrow = \bullet = 5 \dots(F)$$

p a s p a s p a s í p i s p e s

Etj. etj.

Një gjë e tillë nuk ndodh, siç dihet, me Greqishten "p i s o" (πίσω).

Ky operator është huar nga Shqipja edhe në disa gjuhë me prej-ardhje nga Latinishtja.

Kështu në Latinisht: "p o s t", "p o s t-quam"... = Shq. "p a s".

Në Frengjisht: "p u i s"... = shq. "p a s".

* Shih edhe fq.258, 729 dhe 777.

Është interesant të vihet ré se edhe Frengjishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccccc}
 2 & = & \leftrightarrow & = & \bullet & \dots(F) \\
 \text{puis} & & & & \text{pis} & \\
 (\text{pas}) & & \text{puis-que} & & (\text{i keq}) & \\
 (\text{pas}) & & (\text{pasí}) & & &
 \end{array}$$

79) Ital. *p o s c i a* = *p a s t a j*

Nga Shqipja:

p a s

Në Italisht "*p o s c i a*" është disi e vjetëruar. E gjejmë ndër të tjera tek Dante Aligheri:

"...*p o s c i a*, *più che 'l dolor, potè 'l digiuno...*"
[Il Conte Ugolino...]*

80) Ital. *d a* = ing. *f r o m* (nga, prej...)

Është Shqipja:

d a (folja DAj) = simb. \textcircled{D}

Edhe kjo sepse "*prej*-ardhja" lidhet gjithmonë, paradigmatisht, me një "*ndarje*".

Duke zgjeruar Bisedën, shtojmë se në Shqip:

"**p r e j**" = 1) *prerje* (\textcircled{D}) dhe njëkohësisht 2) *origjinë, prejardhje* (α)

* Dante Aligheri, "*Inferno*" (Canto XXXIII):

"...*e ma pas, shka dhimbja s'mundi me ba, e bani uria...*"

Kemi:

$$\text{pr e j-ardhje (it. da)} = \textcircled{\ominus} = F = -1$$

Me fjalë të tjera "prejardhja" lidhet gjithmonë me një "negativitet". Kështu të thuash se Bota fillon me një *ndarje* [Paracelsus: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang..."] a të thuash se ajo fillon me një *mohim* (negativitet) është e njejta gjë, edhe sepse kemi:

$$\text{ndarje} = \textcircled{\ominus} = F = -1 = \text{mohim}$$

Prandaj edhe të thënë e Paracelsusit mund ta parafranojmë p.sh. ndër të tjera, kështu:

"Die *Negatio* ist aller Geburt Anfang."

(Mohimi është fillimi i gjithashkaje)

Me qenë se pastaj Algoritmi Simbolik na jep:

$$\begin{aligned} F &= \textcircled{\ominus} (\textit{Separatio}) = -1 (\textit{Negatio}) = (\rightarrow \neq \leftarrow) (\textit{Oppositio}) \\ &= \downarrow (\textit{casus}) = \square (\textit{Implicatio}) = \dots \bullet (\textit{Materialisatio, Geburt...}) \end{aligned}$$

Ne mund ta parafranojmë, duke e përgjithësuar të thënë e Paracelsus edhe kështu:

"Codex *F* (.....) ist aller Geburt Anfang."

Që do të thotë se Bota është krijuar nga kodi *F*, nga një figurë e tij çfarëdo simbolike.

Kemi kështu *mitet e ndryshme kozmogonike skema e përgjithshme e të cilave është:*

$$E \downarrow = F$$

Kështu që të thuash se Bota është krijuar me një ndarje, a me një mohim, a me një rënie, a me një kundërvënie... etj. etj. është e njejta gjë:

"Bota (si edhe çdo send në të) mund të vështrohet si e krijuar nga një figurë (në të gjitha interpretimet e saj) çfarëdo e kodit F."

Le të shtojmë këtu se në Shqip flitet bukur për negativitetin e fillimit, me "n g a" = "prej" dhe "n g ë" = "nuk", në të folmen e Arbëreshëve. Dhe kujtojmë këtu vargjet:

*"Moj e bukura Morë...
Si të lash e më n g ë të pash..."**

Kështu Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \alpha & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{n g a} & & \text{n g ë} \end{array}$$

Le të kujtojmë këtu disi rastësisht këtu edhe Italishten "d e r i v a r e",** që zërthënet me Shqipen si: "b ë r ë d a r ë" → ⊕ = ndarje... Që do të thotë se rrjedhimi i parë, paradigmantik, ka qenë një ndarje. *Një ndarje nga kush? nga se? Një ndarje nga Qendra Mistike, nga Zoti.*

81) Ital. e n t r o = brenda (p.sh.: "entro due giorni" = brenda dy ditësh)

Motivohet me Shqipen si:

$$e n t r \dots \rightarrow \text{shq. â n d a r} = \oplus = F = - \bigcirc = \square$$

Edhe në Sanskritisht: "ā n t a r a" (आन्तर) = ingl. interior, inward, within (i brendshëm, brenda).

* Jeronim de Rada, "Këngët e Milosaos" (1836).

** Shih edhe fq.39.

Motivimi:

a n t a r - a

dhe me Shqipen:

$$\hat{a} n d \bar{a} r = \textcircled{1} = F = \textcircled{\ominus}$$

Kujtojmë këtu edhe fjalën Shqip "a n ë t a r", që do të thotë "pjesëtar", e pra $\textcircled{1}$, por edhe "i mbrendshëm", simb. $\textcircled{\ominus}$.

82) Arab. k a d í (قاضي) = ingl. *judge* (gjykatës)

Me Shqipen:

$$\begin{aligned} k a d i &\rightarrow \text{shq. } k a d \grave{a} = D \grave{a} \text{ (ai që } dan \text{ grindjen, sherrret)} \\ &= -(\rightarrow \neq \leftarrow) \dots e \text{ pra } pajton \text{ } (\rightarrow = \leftarrow) \dots (E) \end{aligned}$$

83) Akad. d a i a n u = ingl. *judge* (gjykatës)

Edhe këtu është Shqipja:

d a n

Shih më sipër (86).

84) Ital. m e n t r e = ndërsa

Me Shqipen:

$$m e n t r e \rightarrow \text{shq. } m e n d a r^* = \textcircled{1} = F = (A \dots B)$$

* Po këtu edhe Asir. "a d a n n u" = interval kohe (ingl. *a period of time of predetermined length*). Motivimi do të bëhej si: "â d a m u n" = simb. $\textcircled{1}$. Shtojmë se tek "nn" të fjalës "a d a n n u" ne duhet të shikojmë një asimilim progresif: $(m \rightarrow n)$.

Vëmë ré këtu se Shqipja "n d ë r s a" motivohet edhe ajo brenda Shqipes si:

$$n d \ddot{e} r - s a \rightarrow \text{shq. } n d \bar{a} r = \textcircled{\oplus} = F = \textcircled{\ominus} = (t \neq 0) \dots$$

pra një "i n t e r v a l" kohe...

85) **Spanj.** c a d a = çdo

Zbërthehet me Shqipen si:

$$k a d \grave{a} = \textcircled{\oplus} = (|| \dots ||)$$

86) **Greq.** k a t h e (κ á θ ε) = ingl. *each one* (sejçili, kushdo, çdo...)

Pra duhet parë në të Shqipja:

$$k a t h y = \textcircled{\oplus} = F = (\neq 1) = \textit{jo vetëm një, por kushdo} \dots$$

87) **Rus.** k a z h d i j (к а ж д ы й) = çdo

Këtu "-zh-" duhet vështruar si një epentezë (ndërkallje asemantike). Pra, tërë fjala reduktohet në "k a d i" që lidhet me Shqipen:

$$k a d \grave{a} = \textcircled{\oplus} = \dots$$

88) **Rus.** m e z h d u (м е ж д у) = n d ë r, ndërmjet

Edhe këtu "-zh-" duhet vështruar si një epentezë, pra:

$$m e (z h) d u < \text{shq. } m e d \grave{a} = \textcircled{\oplus} = (|) \dots (F)$$

89) Rus. **shljuha** (шлюха) = grua e përdalë, prostitutë

Lidhet me foljen Shqipe:

me **shlu**

pra "nji gru e *shlume*...", e pra një prostitutë.

90) Ingl. **slut** = prostitutë

Është Shqipja:

shlūt

(nga folja "shloj")

1) Ital. **mandare** = dër-goj

Me Shqipen:

ma ndare → shq. **me ndarë** = ndarë = \oplus = *F* = \sim

Për t'u bindur gjer në fund për saktësinë e këtij motivimi, le të kemi parasysh këtu, si "*Consentio linguarum*", ekuacionin simbolik të shtruar nga Italishtja:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{metà} & & \text{moto} \\ \text{(gjysëm)} & & \text{(lëvizje)} \end{array} \quad \dots(F)$$

që tregon se si "lëvizja" lidhet me një "ndarje" a, ç'është njëlloj, me një "mungesë", me qenë se:

$$\oplus = - \bigcirc = \text{jo e gjitha, mangësi}$$

Në Shqip gjithashtu:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{ndar-je} & & \text{ndry-shim} \end{array}$$

Në Rusisht:

$$\begin{array}{rcccl} 2 & = & \sim & & \dots(F) \\ \text{dva} & & \text{dvi-gats} & & \\ (\text{dy}) & & (\text{lëviz}) & & \end{array}$$

dhe m.q.s. ($2 = 1/2$)*, që nga edhe: ($2 = -1$),** ne mund të shkruajmë edhe këtu:

$$\textcircled{D} = \sim \dots(F)$$

Dhe së fundi, shtojmë këtu se edhe Shqipja "d ë r g o j" (ital. mandare...), jep edhe ajo gjithpò këtë ekuacion me qenë se:

$$\text{dër} \rightarrow \text{shq. dar} = \textcircled{D} = F = \sim$$

Do të mund të shtojmë këtu edhe Inglishten "t o d r i v e" që tregon dhe ajo lëvizje dhe në të cilën theksi semantik bie mbi "d r", që s'është tjetër veçse Shqipja "d a r ë" (nga folja DAJ).

92) Rus. **ç a s t** (часть) = pjesë

Dhe me Shqipen:

$$\text{ç a â s h t ("âsht ç a")} = \text{ç a} = \textcircled{D}$$

Me Shqipen motivohen kështu edhe fjalë të tilla në Rusisht si: "ç a s t o" (часто) = *shpesh*, "ç a s t o t a" (частота) = *shpeshësi, frekuencë,...* "s ç a s t i j e" (счастье) = *risk, fat...*

* Siç del nga Arithmetika Mistike, me qenë se duke shumëzuar të dy anët me "2", kemi ($4 = 1$), dhe duke hequr nga të dy anët "1" kemi ($3 = 0$), që është bash themeli, siç e kemi parë, i Arithmetikës Mistike.

** Një formulë kjo tepër, po tepër e përhapur në Gjuhë siç do të kemi shumë e shumë raste për ta vënë ré.

Shtojmë këtu se në Rusisht *fatit* i thonë edhe "d o l j a" (доля) = pjesë, risk..., nga folja "d e l i t s" (делить) = ndaj, copëtoj.

- 93) Rus. *ç a s t o* (ч а с т о) = shpesh, e pra simbolikisht: (≠ 1).

Dhe është prap Shqipja:

ç a â s h t = $\textcircled{1}$ = *F* = (≠ 1) = jo një herë, por shpesh, disa herë...

Vëmë ré me këtë rast se në Shqip:

$\textcircled{1}$ = (≠ 1) ... (F)
d a s í d i s a

- 94) Ingl. *a n d* = edhe

Motivimi me Shqipen:

a n d → shq. *â n d à* = $\textcircled{1}$ = ∞ ... (F)

- 95) Gjerm. *u n d* = edhe

Me Shqipen:

u n d → shq. *â n d à* = $\textcircled{1}$ = ∞ ... (F)

- 96) proto-Gjerm. *s k e i d a n* = ingl. *to separate, to sever* (me nda)

Theksi semantik bie mbi "k e i d a" që është Shqipja:

k a d à = $\textcircled{1}$

* Shih lidhur me këtë edhe fq.73.

Duke e zgjeruar gjer diku jashtë themës Bisedën, ne jemi në gjendje të motivojmë me këtë rast edhe Inglishten "t o s e v e r" = n d a j, e pra simbolikisht " ⊕ ". Me Shqipen:


S e v e r → shq. "s" bërë = "bër S" = ⊕

...simbol që tregon ndër të tjera: n d a r j e, p j e s ë t i m, d a l l i m, e që në kuptim është ekuivalent me: ⊕ .

Po kështu edhe për fjalën Latinisht "S e p a r a t i o", me Shqipen:

S e p a r a - t i o → shq. "bërë" [lat. para] "S"

Dhe rigjejmë kështu skemën (simbolin) Yin–Yang kinez ku dy të kundërtat ndahen nga një vijë sinusoidale, nga një "S".



Dy parimet themelore, ay pozitiv (mashkullor, *Yang*) dhe ay negativ (femëror, *Yin*) dhe Trigramat e "I Ching".*

* Në këtë skemë, "—" paraqet *Yang*-un (energji pozitive), ndërsa "– –" paraqet *Yin*-in (energji negative). Këto dy simbole kombinohen në proporcione të ndryshme gjatë vitit, sipas fillosofëve të lashtë Kinezë.

Edhe fjala Hebraisht "s h a b a r" (שָׁבַר) = ingl. *to divide, to separate* (ndaj, pjesëtoj), mund të motivohet fare lehtë me Shqipen si:

b ë r ë S

e pra simbolikisht:



Ja dhe në këtë rast, si në çdo rast tjetër, ne e përcollëm fjalën e huaj, tek e mbramja, tek një simbol.

Rivërtetohet kështu se:

"Fjalët nuk përshkruajnë, tek e mbramja, koncepte, por simbole."

Me qenë se, nga ana tjetër, siç lexojmë tek libri i Jean Chevalier:

"La logique du symbol est la logique du Tiers Inclus."
(Llogjika e simbolit është ajo e të Tretit të Përfshirë.)

$$[(x = -x) = E]$$

si edhe:

"Le symbol abat les murs."
(Simboli shemb muret.)

$$[- \textcircled{1} = E]$$

dhe me qenë se:

$$E = 1$$

duke e referuar fjalën për motivim tek një simbol, si në të gjitha rastet e mësipërme, e kemi referuar në të njejtën kohë edhe tek një paradigmë superlative, primordiale.

Me qenë se Gjuha emërton sipas një paradigme primordiale, superlative, ndarja *par excellence* do të jetë ajo me të cilën Bota dhe u krijua.*

Prandaj dhe simboli i *Yin Yang*-ut mund të vështrohet si ai i krijimit të Botës.

Gërma "S" që realizon ndarjen, mund të vështrohet si simboli i gjarpërit (lat. *S-erpens*), dhe ne dimë se, sipas një miti të besueshëm Biblik: Bota u krijua kur Adami dhe Eva, pas shtytjes së gjarpërit, hëngrën nga pema e ndaluar e *dallimit* të së Mirës nga e Keqja. Bota u krijua pra, e thënë ndryshe, nga një *Separatio*, pikërisht ashtu siç na mëson edhe Paracelsus, e pra nga një *Ndarje-bërës*, nga një *Dallues* e pra nga *Djalli* (ndën trajtën e gjarpërit, lat. *S-erpens*) e pra atëhere shkurt, në dimensionin gjuhësor, nga gërma (simboli) "S".

Po në Inglisht edhe "several" = *disa*, e pra simbolikisht ($\neq 1$).

Ne vihemi kështu në gjendje të motivojmë gjithashtu edhe Inglishten:

several (disa) < sever (dasi) = \oplus = F = ($\neq 1$) = *jo një...*

Po ashtu dhe në Shqip:


dasi = \oplus = F = ($\neq 1$) = *jo një, disa*

Shtojmë edhe se:

S = \oplus = F = \otimes = -1

Kuptimin bashkues (\otimes) e gjejmë në shumë gjuhë, por në një mënyrë të spikatur në Rusisht ku "s" = \otimes , si p.sh. në "s-toboi" (с-тобою) = *me ty* (gjerm. *mit*) ty, "s-direktorom" (с-директором) = *me drejtorin...*

* Që bota është krijuar me një ndarje këtë e gjejmë ndër të tjera tek e thëna e Paracelsit: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*", që në të shkrojtur simbolike jep siç dimë: $\oplus = -1 = \bullet \dots(F)$



Pema e dallimit të së mirës nga e keqja.
Adami, Eva, dhe Gjarpëri që i shtyri në ngasje

Kuptimin mohues e gjejmë mjaft të spikatur në Shqip: "s'punoj" = – punoj,
"s'lexoj" = "nuk lexoj" = – lexoj.

Dhe më në fund, le të vërtetojmë se:

$$S = S$$

Këto dy simbole janë grafikiisht të *ngjashme*. Që këndeje mund të arrijmë në përfundimin, qoftë edhe paraprak dhe hipotetik, se: $S = 5$.

Kjo edhe për arsye se, ndër të tjera:

- a) $5 = \text{X} = \text{miti i "Hieros Gamos",}$ që është bashkimi *par excellence*, mes Qiellit (3) dhe Tokës (2) që solli me vete, në dimensionin mitik, krijimin e Botës.

Por pamë se edhe:

$$S = \text{X}$$

dhe pra atëhere:

$$S = \text{X} = 5$$

Ja pra dhe një arsye tjetër përse: $S = 5$.

- b) Pamë se: $S = -1$ (në Shqip për shembull: "s'punoj" = - punoj). Por edhe: $5 = -1$.^{**} Kështu që, sipas mendimit tonë, nuk ka asnjë dyshim se:

$$S = 5$$

Mos harrojmë së fundmi se:

$$5 = 1/2 = \text{⊙}$$

E pra **p e s a**, si g j y s m a, është n d a r j a (*dallimi*) *par excellence* (ajo e krijimit të Botës), rol të cilin lot, siç dimë, edhe gërma "S".

Duke zgjeruar Bisedën, ne dimë se *pesa* (5) është numuri i *njeriut*.^{***}

* Shih fq.44.

** Dhe kjo sepse: $(5 = -1) = (6 = 0) = (6/2 = 0/2) = (3 = 0) =$ baza e Arithmetikës Mistike.

*** Shiko edhe fq.145, 294, 429 dhe 623.

Që këndej dhe:

$$\text{Njeriu} = 5 = S \quad \dots(F)$$

Mund të duket e çuditshme që *djalli* të jetë bash *njeriu*. Por kjo mund të rikonfermohet në shumë mënyra, si për shembull nga ato sa na thotë Hermes Trismegistus:*

"Man is one unchangeable evil."

Nga ana tjetër, mund të shkruajmë:

$$5 = -1$$

e pra:

$$\text{Njeriu} = -\text{Zoti}$$

Që nga edhe akoma, me ndihmën e Algoritmit Simbolik:

$$\text{Njeriu} = [\text{Zoti}] \quad \dots(F)$$

Ndoshta do rikthehemi përsëri në këtë Bisedë më vonë. Por tani vëmë ré akoma edhe se:

$$1 \downarrow = -1 = 5$$

Që këndej del se:

"Njeriu (5 , - 1) është Perëndi e rënë (1 ↓)."

Detyrë pra e tij është (shih Ungjillin)** të ngjitet përsëri në lartësinë e parë e të ribëhet i perëndishëm. Tërë predikimi i Krishtit synon këtu.

* *"Corpus Hermeticum"*, shih ndër të tjera edhe fq.291, 325 dhe 357.

** Gjoni (10.34): *"Ju gjegj ahere Jisui atyre: A nuk është shkrojtur në ligj tuaj sa u thashë, që ju jeni perëndira..."* (Lat. *"respondit eis lesus nonne scriptum est in lege vestra quia ego dixi dii estis..."*)

Kujtojmë se, në bazë të Biblës, Adami rà dhe bashkë me të, të gjithë ne.

Krishti, i mbiquajtur me të drejtë "Adami i Ri", i vuri vetes për detyrë ta ringrejë Adamin dhe bashkë me të, të gjithë ne.

Të tjerat po dihen...

Mund të shkruajmë atëhere, duke përmbledhur:

	⊕	=	(≠ 1)	...(F)
rus.	çast		çasto	
	(часть)		(частьe)	
shq.	dasí		disà	
ingl.	sever		several	

Ne shikojmë kështu se "pluraliteti" e pra "shumësia" e pra "s a s i a" lidhet, si me origjinën e saj, me një n d a r j e.

97) Ingl. **q u a n t i t y** (*amount, portion*) = s a s í

Edhe Inglishtja "*quantity*" (simb. ≠ 1) nuk është tjetër veçse Shqipja:

$$k a \hat{a} n d à = \oplus = (\neq 1) \quad \dots(F)$$

Rikujtojmë se në Sanskritisht "**k h a n d a**" (खण्ड) do të thotë ndër të tjera "me NDA" (ingl. *divide*), e pra kemi edhe këtu "**k a n d à**" = ⊕ = ...

Rikujtojmë këtu edhe se termi "**k u a n t a**" në Fizikën Kuantike, që flet për një "sasi subatomike" energjie, lidhet dhe ajo, si me prejardhjen e saj, me Shqipen:

$$\text{lat. } q u a n t a \rightarrow \text{shq. } k a \hat{a} n d à = \oplus = F = \bullet = (\varepsilon / c^2)$$

Ku "ε" tregon "energjinë", ndërsa "c" shpejtësinë e dritës.*

Ekuacioni:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

mund të interpretohet edhe si:

"Bota materiale (●) lind (=) nga një ndarje (⊕)." ¹

Dhe rigjejmë kështu, prap e prap, të thënë e famshme të Paracelsus:
"Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang"...**

Edhe Shqipja "S a?" ("s a - s i") duhet motivuar me simbolin e "Sigmës"
(ndarëse dhe bashkuese), do me thënë me:



Kjo është ndarja e parë, tek e cila të gjitha ndarjet e tjera referohen (dhe nga e cila emërohen). Është ndarja mes dy parimeve në mendimin mistik Kinez, mes "Jangut" (*Yang* = parimi mashkullor) dhe "Jingut" (*Yin* = parimi femëror).***


Në Fillosofinë e lashtë Kineze na thuhet se realiteti krijohet nga bashkimi, përzierja e këtyre dy parimeve në proporcione të ndryshueshme.

* Shih edhe sa thuhet në fq.698 lidhur me natyrën e dyfishtë, korpuskulare dhe valore, jo vetëm të fotonit, por edhe të çdo grimce tjetër materiale, siç qe i parë që e zbuloi shkencëtari frëng De Broglie.

** Shih ndër të tjera fq.45, 142, 269, 526, 670 dhe 742.

*** Shih dhe më lartë, figurën fq.111.

Ndaj pra dhe:



Me qenë se kështu, sipas Fillosofisë së lashtë Kineze (dhe jo vetëm, por edhe sipas tërë Mendimit Mistik) krijohet Realiteti material, Bota materiale, ne mund të themi se me dublicitetin e kuptimeve të " S " (ndarje dhe bashkim), Gjuha shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccccccc} \oplus & = & \otimes & = & \bullet & & \dots(F) \\ \text{ndarje} & & \text{bashkim,} & & \text{Bota materiale} & & \\ & & \text{përzierje} & & & & \end{array}$$

Vëmë re se fjala "b a s h – k i m" (⊗) lidhet me Turqishten "b e s h" = 5 dhe përcillet tek rrënja e saj zanafillore (operator i lirë) tek Shqipja "p e s" (5).*

Dihet se p e s a (5) është numuri simbolik i "Martesës së Shenjtë" (Hieros Gamos) (⊗) që përbën një mit kozmogonik dhe që paraqet bashkimin *par excellence*, paradigmantik.

98) Hebr. S h l o m o (ש ל מ o) = emri i Salomonit (turq. S u l e j m a n)

Motivohet me Shqipen:

$$i \text{ S h l u m i} = - \otimes = E$$

* Shih edhe fq.44 dhe 663.

Kemi:

$$- \text{X} = \text{i zgjidhuri, i zgjedhuri}$$

Salomoni vështrohej pra i tillë, gjë që e bënte atë hyjnor.

Algoritmi Simbolik na jep: *

$$- \text{X} = \underline{\mathbf{V}}^{**} \quad \dots(\text{E})$$

i zgjidhuri i zgjedhuri

Dhe kemi, gjithmonë sipas Algoritmit Simbolik:

$$\underline{\mathbf{V}} = \mathbf{E} = \mathbf{1} = \bigcirc = \text{DEUS}^{***}$$

që këndeje del qartë *natyra hyjnore e të zgjedhurit*, e pra e Solomonit sipas Hebrejve.

* Me qenë se *vetëm Zoti është i lirë, jashtë ligjit, mbi ligjin* (- X) atëhere mund të themi se *vetëm Zoti është i zgjidhuri* (- X), e pra *i zgjedhuri* (V), dhe me qenë se simboli i fundit, duke qenë ay i "alternativës absolute", është njëkohësisht edhe ay i vendimmarrjes (frenj. *choix*), del se:

*"Vendimet i përkasin të gjitha,
në instancë të fundit, vetëm (1) Zotit."*

** Është fjala për propozicionin llogjik "*aut... aut...*" (shq. "*ose... ose...*") që quhet edhe ai i *diskonjunksionit të rreptë*, ose ai i "zgjedhjes" (fr. *choix*), ose ai i *alternativës absolute*, dhe që tregohet me simbolin "V".

Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.825.

*** Për "*Consentio linguarum*" kujtojmë këtu se në Italisht kemi:

$$\underline{\mathbf{V}} = - \text{X} \quad \dots(\text{E})$$

scelto sciolto

- 99) Hebr. **s h a l o m** (ש ל ו מ) = një sërë kuptimesh si ai i *shëndetit*, i *paqes*, i *mirësisë*, i *lumturisë*, etj. etj.

Të gjitha kuptime këto që bëjnë pjesë në kodin E, e që mund të bëhen të rrjedhin të gjitha nga Shqipja, siç tregohet më poshtë:

$$- \bullet \text{ (shlymje)} = - \text{X} \text{ (shlūmje, Liri)} = E = \dots$$

$$(\rightarrow = \leftarrow) = (x = -x) = \text{Qendra Mistike: Parajsa, Perëndia, e Vërteta, Dashuria, Paqja, Lumtura, Mirësia...}$$

Le të kujtojmë këtu me këtë rast edhe aforizmën e Shqipes:

"Ma parë shlymja, mandej shlumja."

që sharon ekuacionin simbolik:

$$- \bullet = - \text{X} \quad \dots(E)$$

shlymja shlumja

- 100) Asir. **k u d u r r u** = gjerm. *G r e n z e*; ingl. *boundary* (kufi, shenjë)

Motivimi me Shqipen jep:

$$k u \ d u r \rightarrow \text{shq. } k a \ d \bar{a} r = \textcircled{1}$$

Shtojmë këtu se Asirishtja nuk është në gjendje ta motivojë vetë këtë fjalë (si edhe shumë e shumë të tjera...) për mungesë operatorësh të lirë të përshtatshëm.

Kujtojmë këtu se kufiri është një ndarje. Prandaj për shembull, siç kemi parë, Inglishtja "**b o n d**", "**b o u n d a r y**", "**b o r d e r**"... janë të motivueshme të gjitha me Shqipen: "**b ë n d à**", "**b ë n d a r ë**", "**b ë r d ā r**"

Vërejmë gjithashtu me këtë rast se Gjermanishtja "G r e n z e" lidhet si me prejardhjen e saj me Shqipen "g u r" ("gur i kufirit").*

101) **Asir. g a m â r u** = gjerm. *vollbringen, zu Ende bringen, vollenden*
(me mbarue, me plotësue, me i dhanë fund)

Duhet ndarë në:

g a m â r u

dhe me Shqipen:

k a m a r ù

ku "m a r ù" është folja "m a r o j" ose me epentezë "m-b-a r o j". Në gjuhën Asiriane "m a r u" nuk ekziston si operator i lirë (si rrënjë e pastër, e thjeshtë, me një kuptim më vehte). As "g a" nuk rri atje më vehte dhe as është një mënyrë a kohë e foljes "k a m" (ingl. *have*), si në Shqip. Pra Asirishtja nuk është në gjendje ta motivojë fjalën e saj "g a m â r u" pa ndihmën e Shqipes.

Vëmë ré këtu se "m a r o j" ("m-b-a r o j") lidhet në Shqip me shumë fjalë të tjera të bashkërrënjëshme, si "m r i j" (m-b-rij), "m a r ë" (m-b-arë) etj.

Në Shqip mund të formulohet kështu ky gjykim kuptim-plotë dhe në frymën e "*Philosophia Perennis*":

"Procesi** m-b-aron kur m-b-rihet e m-b-ara."

* Këtu mund të përmendim edhe Rusishten "g r a n" (грань), "g r a n i c a" (граница) = kufi. Lidhur me rëndësinë dhe pjellorinë e operatorit Shqip "g u r", shih nga i njejt i Autor edhe "*Shqipja dhe Sankritishtja*", Pjesa I.

** Dhe është fjala për *Procesin Dialektik* (gjerm. *Werden* = ingl. *becoming*) në terma të fillosofisë së Hegelit.

Shih ndër të tjera edhe shënimet fq.37.

Kjo është në përputhje të plotë, ndër të tjera, me ato sa na mëson Algoritmi Simbolik (strukturizim llogjik i Mendimit Mistik), sipas të cilit kemi simbolikisht:

$$\bigcirc = \omega = -\sim \dots(E)$$

m a r ë **m a r o j** **m r i j**
 (Omega, *fundi*) (jo më lëvizje,
 fund i procesit)

Procesi, zhvillimi (gjerm. *Entwicklung*) ka për qëllim rivendosjen e Tërësisë (ingl. *Whole*) fillestare (Teza hegeliane, Fryma Absolute ende e pa alienuar).

Në Rusisht kjo jepet bukur me:

"**ce**l" (цель) = qëllimi

"**ce**l!" (целы) = e tëra

Edhe gjuhë të tjera na tregojnë qartë se *qëllimi* arrihet tek *fundi* i procesit.

Kështu për shembull në Inglisht: "E n d" = 1) *qëllimi*; 2) *fundi* (pra qëllimi realizohet kur arrihet fundi i Procesit).

Ashtu dhe në Gjermanisht: "E n d e" = 1) *qëllimi*; 2) *fundi*.

Ashtu edhe në Frengjisht kemi: "l e **f i n**" = *qëllimi*, dhe në të njëjtën kohë "l a **f i n**" = *fundi*. E kështu me radhë.

Në Shqip rrënja "m a r o j" ka një spektër të gjerë kuptimor (përfundoj, arrij, tërësi...), pra lidhje mistike të rëndësishme, gjë që nuk mund të thuhet për Asirishten "g a m a r u". Që këndej edhe një arsye më tepër për prioritetin e rrënjës Shqipe "m a r o j" ndaj Asirishtes "g a m a r u".

Shtojmë këtu edhe se në Asirishte gjithashtu "g a m r u" në kuptimin "i plotësuar", "i përfunduar" (gjerm. *vollendet, vollkommen*), simb. \bigcirc .

102) Asir. **g i m r u** = gjerm. *All, Gesamtheit* (e tëra, tërësia)

Kjo fjalë do ndarë në:

g i m r u

dhe me Shqipen:

k a m a r

("ka mbarë")

Ne shohim se sikundër në Shqip "m a r o j" lidhet me "m a r" (= e tëra), ashtu edhe në Asirishte "g a m r u" (maroj, mbaroj, përfundoj) lidhet me "g i m r u" (marë, mbarë, e tëra), kështu që edhe Asirishtja na thotë se " \bigcirc " (e plota, e tëra) është fundi i Procesit, e pra " ω " (*Omega*). Ne mund të themi se edhe Asirishtja shtron kështu, si shumë e shumë gjuhë të tjera, ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \bigcirc & = & \omega \quad \dots(E) \\ \text{asir. } \mathbf{g i m r u} & & \mathbf{g a m r u} \\ \text{shq. } \mathbf{m a r \ddot{e}} & & \mathbf{m a r o j} \end{array}$$

Vëmë ré këtu edhe sa vijon:

Në Japonisht:

"m a r u" (丸) = rreth, unazë (ingl. *circle, ring*), e pra simb. \bigcirc

"m a r u d e" (丸で) = krejt, krejtësisht, përsosmërisht
(ingl. *quite, entirely, perfectly*), e pra përsëri \bigcirc

Kështu Japonishtja na thotë me fjalë të tjera se simboli i të Tërës, i të Përsosurës është " \bigcirc ", gjë që është mistikisht në rregull, me qenë se tek Cirlot ne lexojmë:

$$\bigcirc = \textit{The All, Infinity} \dots$$

Nga ana tjetër është e qartë se këto fjalë japonishte lidhen me Shqipen "m a r o j", "m r i j", "m a r ë"...

Edhe një gjë tjetër: në Shqip "k e r" lidhet me "q a r-k" (e pra ○) dhe në të njejtën kohë, gjithpò në Shqip "k r e-j" (○).

Por mund të vëmë ré edhe një gjë tjetër:

Në Shqip: "k r y" (përfunduar, mbaruar) dhe "k r e-j", me fjalë të tjera Shqipja shtron edhe kështu ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\omega = \bigcirc \quad \dots(E)$$

k r y k r e j t

Në Shqip, lidhur me këtë operator themelor, mund të jipet aforizma:

"E mbara mbrihet në mbarim."

Këtë na thotë në mënyrën e saj edhe gjuha Asiriane. Nga ana tjetër, në qoftë se "b"-në e vështrojmë si një epentezë, aforizmën e mësipërme mund ta shkruajmë edhe si:

"E mara mrihet në marim."*

Në këtë trajtë, përputhja me Asirishten është e plotë.

Në Inglisht "u p" do të thotë në të njejtën kohë "fund", "mbarim", si edhe "krejt". Pra simbolikisht:

$$\omega = \bigcirc \quad \dots(E)$$

u p u p

* Shqipja e shpreh këtë aforizmatikisht ndër të tjera edhe me:

"Te sosja, përsosja."

Por ka dhe më:

Në Inglisht "u p" (ashtu sikundër "o v e r") do të thotë edhe "nalt", e pra simb. \uparrow . Kështu, Inglishtja na jep të kuptojmë se *fundi, mbarimi është edhe një ngritje lart*, pra në Qiell, që nga edhe kemi rënë. Kështu Inglishtja na sugjeron se rrënjët tona janë në qiell.

103) **Asir. m u r a d e** = ingl. *entirely, perfectly* (krejtësisht, përsosmërisht)

Është përsëri Shqipja:

m ā r ë, m b a r ë

Në Shqip: "**m (b) a r ë**" = e gjitha, e tëra. Por në Shqip gjithashtu edhe "**i m b a r ë**" = i mirë, i përsosur, si edhe "**i m b r i m**" = i arritur, i sosur, i përsosur.

Kështu që Shqipja na thotë në mënyrën e saj se: *Vetëm e mbara, e tëra është e mirë dhe e vërtetë.*

Kjo përputhet me Mendimin e Kohës sonë "Vetëm e Tëra është e Vërtetë". Kjo ide shprehet edhe me konceptin modern të Holizmit,* si edhe të Globalizmit, simb. \bigcirc .

Algoritmi Simbolik e rikonfermon, prap e prap, këtë pohim me qenë se jep:

$$\begin{aligned} \bigcirc &= e T ë r a = E = 1 \\ &= (x = -x) = Q ë n d r a M i s t i k e = Z o t i \end{aligned}$$

Kështu që të pohuarit e Holizmit sot ëshë ekuivalent me të pohuarit e të qenurit të Zotit. Me këtë Shkenca e Kohës sonë orientohet, ku në një mënyrë ku në një tjetër, drejt një reference absolute (dhe jo më relative),

* Shih ndër të tjera edhe fq.60, 361 dhe 566.

sikundër është Qendra Mistike, "*the Supreme Principle of the Universe*" që simbolikisht, siç e pamë edhe më sipër, do të jepej me " \bigcirc ", simbol ky që është ndër të tjera edhe ay i "Holizmit".*

104) Jap. **m a r ù** (丸) = ingl. *circle; complete; pure* (rreth; i plotë; i qëruar)... e pra simb. \bigcirc .

Është Shqipja:

m a r ù

e pra atëhere edhe:



Dimë se:

\bigcirc = *the All, the Universe, the Infinite...***

si edhe:

\bigcirc = $(x = -x)$ = *the Mystic Centre, the Supreme Principle of the Universe, the Paradise, G O D*

Ja pra atëhere përse "m a r ù" = \bigcirc (ingl. *completeness*), e pra kuptimin e "plotësisë" (*Pleroma*), e pra kuptimin e Zotit.

Për sa i përket kuptimit "pastërti shpirtërore", "qashtërsi" (ingl. *purity*), vërejmë se Algoritmi Simbolik na jep:

\bigcirc = - \bullet ... (E)
the All purity

* Shih Cirlot, fq.40.

** Ibid., fq.123.

Duke zgjeruar disi Bisedën shtojmë:

Hegeli thotë:

*"E vërteta është e tëra."**

Po ne shohim se edhe Gjuha (këtu Asiriane, Japonishte, Shqipe...) na thotë të njejtën gjë... Ne mund të shkruajmë, me qenë se koncepti i të Vërtetës, i të Tërës dhe ai i Përsosjes përputhen:

$$e \text{ Vërteta} = e \text{ Tëra} = \text{Përsosja} = \bigcirc$$

Ne mund të shkruajmë nga sa më sipër (dhe jo vetëm) se:

$$\begin{aligned} e \text{ Vërteta} &= \text{Përsosja [asir. marù]} = \bigcirc = (x = -x) \\ &= E = -F = -(x = x) \dots \end{aligned}$$

Ndalemi hë për hë këtu... Kjo do të thotë se: *E vërteta nuk është racionale*, ajo nuk i bindet Arsyës e ligjeve të saj. Ja dhe përse Zoti, që është e Vërteta Supreme, nuk mund të "kapet" (kup-tohet) me anë të arsyes etj. etj., edhe shumë e shumë pasoja të rëndësishme të nxjerra nga Gjuha si një hambar informacioni të pashterrshëm, për të cilin do të flasim në situata të tjera kontekstuale të cilat në këtë Studim nuk besoj se do na mungojnë.

* Këtë pohon Hegeli në parathënien e *"Die Phänomenologie des Geistes"* (*Fenomenologjia e Frymës*), nga ku citojmë: "...*E vërteta është e tëra... dhe me këtë duam të themi se Absoluti njihet për atë çka ai është në të vërtetë vetëm në fund të procesit, të zhvillimit*. Vetëm kur ky proces ka përfunduar mund të diktohet plotësisht racionaliteti që është çpalosur tek Ai. Duhet patur gjithmonë parasysh se: e vërteta – dhe realiteti – kanë një ecuri rrethore sepse fillohet nga një subjekt për tu kthyer tek ai pasi që kuptohet që objekti që duket sikur është i kundërt dhe i pavarur prej tij, nuk është tjetër veçse një 'shprehje' e vet subjektit (dhe del në pah pra fare qartë kështu një Fillosofi Idealiste, sepse Objekti bëhet të rrjedhë nga Subjekti dhe Materia nga Fryma)."

105) Kinez. **zhàn** (战) = ingl. *war, battle, fight, combat* (zanje, luftë, betejë, përpjekje)

Është Shqipja:

z a n, z a n j e

nga folja "me u **z a n ë**", e pra simb. ($\rightarrow \neq \leftarrow$).

Rrënja e thjeshtë dhe e pastër (operator i lirë) këtu është "**z â n**" (në të folmen e Veriut), "**z ë n**" (në të folmen e Jugut).

106) Kinez. **zhàn** (占) = ingl. *to occupy, possess, seize* (me zanë, zaptoj, me pushtue)

Është Shqipja:

me **z a n ë**

(në kuptimin e *pushtimit*)

...si edhe akoma "**z a p t o j**" ku theksi semantik bie mbi "**Z a**". *

Simbolikisht:

- ○ = ● ... (F)

Le të vëmë re se të dy këto gjuhëra (Shqipja dhe Kinezçja) shtrojnë *në të njejtën mënyrë* (d.m.th. me të njejtin interpretim të simboleve) ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

($\rightarrow \neq \leftarrow$) = - ○ = ● ... (E)

kin. **zhàn** (战)

shq. **z a n i e**

kin. **zhàn** (占)

shq. **z a n i e**

* Shih edhe fq. 766.

Ndonjë shpjegim dhe zgjerim:

- 1) Simboli " \bigcirc " ka një spektër të pasur interpretimesh si: *"the All, the Universe, the Infinite..."*, përsosja, e bardha, boshi (vakuumi), e lira... Këtu është marrë interpretimi "bosh", "i lirë"...
- 2) Mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} - \bigcirc & = & \bullet \\ \text{z } \hat{\text{a}} & & \text{z } \hat{\text{i}} \end{array} \quad \dots(\text{F})$$

Ne shohim se si Shqipja shtron me "z â" dhe "z i" një ekuacion të rëndësishëm që mund të interpretohet në shumë mënyra, sejcila shumë e rëndësishme në llojin e vet.

Për shembull:

- a) Për " \bigcirc " = *e tana* dhe " \bullet " = *e keqja*, ne mund të japim këtë përcaktim të së Keqes:

"E keqja (\bullet) është vetëm një mangësi ($-\bigcirc$)."

- b) Për " \bigcirc " = *e vërteta*...

"E keqja (\bullet) është vetëm një mungesë Dije, është padije."

Dhe m.q.s. \bullet duke qenë *e keqja*, është njëkohësisht edhe *mëkati*, del atëhere se edhe mëkati është padije (injorancë). Kuptojmë atëhere përse Krishti, në çastin e vdekjes, duke ju drejtuar Zotit i thotë: *"Fali ata, o At, se s'dijnë ç'bëjnë!"**... Vëmë në dukje se në Sanskritisht fjala "a v y d y ā" (अविद्या) do të thotë në të njëjtën kohë edhe mungesë dijeje (injorancë) edhe njëkohësisht, e keqe, mëkat.

* Lluca, 23:24.

Me Shqipen kjo fjalë zërthehet si:

av y d y a → shq. - **b â d i** = "nuk di" = - ○ = ●

- 3) Në Frengjisht "**f a u t e**" do të thotë në të njëjtën kohë *mungesë* (krahaso me Spanjishten "**f a l t a r**" = me mungue, me qenë mangut) simb. " - ○ " dhe *gabim*, simb. " ● ".

Kështu edhe Frengjishtja shtron të njëjtin ekuacion simbolik dhe me të njëjtat interpretime:

- ○	=	●	...(F)
faute		faute	
(mungesë)		(gabim)	

Në këtë "*Consensio linguarum*" që po bëjmë këtu, mund të përfshijmë dhe shumë gjuhë të tjera, si bie fjala:

- ○	=	●	...(F)
ingl. flaw		fail	
(mungesë)		(gabim)	
gjerm. fehlen		Fehler	
(mungesë)		(gabim)	
...		...	

Biseda mund të zgjerohej shumë më tepër se kaq dhe jo pa interes, por për arsye që nënkuptohen lehtë, po e lëmë me kaq, duke menduar ta vazhdojmë më vonë në të tjera kontekste të përshtatshme.*

* Në një përfundim anallog me Gjuhësinë arrin edhe rryma e fuqishme fillosofike e theollogjike e Gnostikëve, sipas të cilëve mëkati nuk është gjë

107) Kin. z ŭ (组) = p ě r b ě j (ingl. *to constitute, to form, to organize*)

Është Shqipja:

z ě

në kuptimin e "bërjes", të *fillimit*, të *konceptimit*, e kështu me radhë...

Kështu në Shqip, p.sh.: "zë të mendohem" = *filloj* të mendohem, ose "me këtë e zuri atë fëmijë" = "me kë e *konceptoi* (ngjizi) atë fëmijë", etj.

Le ta zgjerojmë edhe disi më tepër Bisedën:

Në Shqip operatori "z ě " (zanje) ka dhe shumë kuptime të *tjera*, nga të cilët le të përmendim këtu atë të: 1) *fillimit*, 2) *kapjes*... *Si shpjegohet kjo bisemi?* Ashtu sikur çdo polisemi: *me ndihmën e Algoritmit*.

Dhe ja se si:

$$\begin{array}{rcccl} -1 & = & \boxed{1} & & \dots(\bar{f}) \\ z \ddot{e} & & z \ddot{e} & & \\ \text{(filloj)} & & \text{(kap, zaptoj, burgos)} & & \end{array}$$

tjetër veçse mosnjohje e të vërtetës. Duke qenë kështu, njohja e të vërtetës, dhe vetëm kjo (gjithmonë sipas Gnosticizmit), është kusht i mjaftueshëm (dhe i domosdoshëm) Shpëtimi, në kuptimin të Krishterë të fjalës.

Sa do e çuditshme dhe joorthodoksale që mund të tingëllojë, edhe vetë Krishti, themelonyjësi i Krishtërizmit, thotë këtu e atje në Ungjill pak a shumë të njejtën gjë, si në rastin kur u thotë dishepujve: "*Do njihni të Vërtetën dhe e Vërteta do ju bëjë juve të lire.*" (Gjoni, 8:32).

Ky propozicion mund e duhet të transkriptohet në gjuhën simbolike të Algoritmit si:

$$\begin{array}{rcccl} \bigcirc & = & - \bullet & = & -\infty & \dots(E) \\ \text{e Vërteta} & & & & \text{Liria} & \end{array}$$

Pra, me qenë se " 1 " është numuri simbolik i Zotit, del se *fillimi* i bërjes të diçkaje duhet të kalojë domosdoshmërisht nga një *kapje*, nga një *burgosje* etj. etj. I Kapuri, i Burgosuri ($\boxed{1}$, \square), me këtë rast, është vetë Zoti (1 , \bigcirc , ...).

Po këtë strategji semantike e gjejmë edhe në Gjermanisht, ku:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \boxed{1} \quad \dots(F) \\ \text{A n f a n g} & & \text{G e f a n g e n e} \\ \text{(fillimi)} & & \text{(i Burgosuri)} \end{array}$$

Pra siç shikohet nga shembullat e mësipërme, *fillimi*, *bërja* etj. etj. presupozojnë një *kapje të Hyjnisë*.

Në Latinisht: "c a p e r e", që vjen nga Shqipja "k a p", dhe në të njejtën kohë në Italisht (nga Latin.) "c a p i r e" = "k u p t o j". Pra: *Të kuptuarit* ka si kusht për realizimin e tij, *kapjen*, burgosjen e Zotit, siç thamë.

Algoritmi Simbolik na jep gjithashtu:

$$\begin{array}{ccc} 5 & = & \boxed{1} \quad \dots(F) \\ \text{njeriu} & & \text{Zoti} \end{array}$$

Numuri 5 është, siç lexojmë ndër të tjera në librin e simboleve të Cirlot,^{*} bash numuri i Njeriut.

Kurse numuri Një (1) dihet botërisht se simbolizon Zotin.

Atëhere, ekuacioni i mësipërm mund të interpretohet si:

"Njeriu është gardiani i Zotit."

* Shih lidhur me këtë edhe fq.44, 145, 294, 429 dhe 623.

Një gjë të tillë ka pohuar dhe Heidegger, pa qenë në gjendje që ta vërtetojë. Sipas tij: "*Mann als Hirt des Seins*" (Njeriu është bariu i Qenies...)*

* *Martin Heidegger* (1889–1976), një nga fillosofët më të mëdhenj Gjermanë të shekullit XX. Nga veprat e tij të shumta le të përmendim këtu "*Sein und Zeit*" (Qenja dhe Koha), si kryeveprën e tij, si edhe "*Unterwegs zur Sprache*" (Rruga për tek Gjuha).

Nga "*Libri i Aforizmave*" riprodhojmë ndër të tjera:

"Objekti" i studimit të Heideggerit është *Qenja* (gjerm. *Sein*, ital. *Essere*, ingl. *Being*...). "*Sein*" dallohet antitetikisht nga "*Seiende*" a ndryshe, siç e quan ai, "*Dasein*", që do të thotë një të qënur këtu a atje, një të qënur konkret, po jo veç Qenja në vetvehte, në kuptimin e saj më të pastër dhe trashëndental. Problemi i Qënjes, i kuptuar në këtë mënyrë, do të thonim të "*Papercak* tuar", të pa konkretizuar në këtë apo atë entitet ("*Dasein*", ital. *Esser-ci...*) nuk është shqyrtuar kurrë, nga asnjë fillosof, në mos po, edhe vetëm jo aq sa duhej dhe si duhej, nga fillosofi i madh, parasokratik grek Parmenidi.

Heideggeri dallon dy "realitete", njërin fenomenal, konkret, dhe ky është *Dasein*, dhe një tjetër, të thellë, esencial, të padukshëm, trashëndental, misterioz, të cilën ai e quan thjesht "Qënje" (*Sein*). Kemi pra atëhere këtu një *dikotomi* analloge pak a shumë më atë të: 1) *Noumenit* ("sendit në vetvehte") dhe "fenomenit" në fillosofinë kantiane, 2) Kodit E dhe kodit F, në teorinë e Algoritmit Simbolik, 3) "*Implicate Order*" dhe "*Explicate Order*" në sintetizimin gjer diku llogjik të Bohm-it të Fizikës Kuantike, dhe 4) Mbretërisë Qiellore e Mbretërisë tokësore, në fenë e Krishterë...

Lidhur me këtë pikë të fundit, shtojmë këtu shkarazi se të gjithë studjuesit e fillosofisë të Heideggerit kanë vënë në dukje frymën mistike, që e përshkon atë fund e majë. Dikush, nga fillosofët e Kohës shkon gjer atje sa ta cilësojë fillosofinë e tij si "*A religion èithout shrine*" (Një fë pa altar). Dhe kjo sepse, ai nuk flet kurrë për Zotin në kuptimin e fesë zyrtare. Zoti për të është "*Qënja*". Dhe vetëm kaq. Dhe ai thotë për Njerinë se "*Njeriu është bariu i Qënjes*". Le ta përkthejmë këtë pohim të fundit në Gjuhën tonë Simbolike. Dimë se numuri simbolik i Njeriut është 5. Tek Cirlot (fq.270) lexojmë: "*Pesa është numuri*

simbolik i Njeriut pas rënies". Para rënies numuri i Njeriut duhet të ketë qenë **1**, sa numuri i Zotit, bir i pandarë ende i të Cilit ai ish. Dhe kjo sepse:

$$1 \downarrow = -1 = -\bigcirc = \bigoplus = 1/2 = 0.5 = 5$$

Por, nga sa më sipër kemi ende:

$$5 = -\bigcirc$$

e pra, sipas Algoritmit Simbolik, edhe:

$$5 = \boxed{\bigcirc}$$

Simboli "[]" është ai i mbylljes, i mbrojtjes, i ruajtjes. Pra atëhere vërtetë:

"Njeriu (5) është (=) bariu, ruajtësi ([]), i Qënjes (○)."

Kjo do të thotë atëhere edhe se Njeriu është "gardiani" i Zotit, ai që e *burgos* në thellësinë e vetes së tij Atë, që nuk e lë Atë të dali lirisht, të çfaqet ashtu siç është.

Kjo do të thotë atëhere edhe se Njeriu është "gardiani" i Zotit, ai që e *burgos* në thellësinë e vetes së tij Atë, që nuk e lë Atë të dali lirisht, të çfaqet ashtu siç është.

Në Gjuhë:

- 1	=	$\boxed{\bigcirc}$...(F)
gjerm. Anfang		fangen	
lat. incipere		capere	
shq. zë		zë	

(fillimi, krijimi i Botës) (burgosja e parimit Hyjnor)

Duke vijuar pak a shumë në këtë vijë, Qënja ka vetëm një mundësi shfaqjeje, jo aspak si "*Sein*", por si "*Dasein*". Në gjuhën tonë të Algoritmit Simbolik, ne do të thonim se E (dhe gjithshka lidhet me këtë kod) mund të shfaqet (njihet) vetëm si F (dhe me gjithshka lidhet me këtë kod). Po $F = -E$. Pra atëhere ne mund të themi se *Qënja mund të na shfaqet vetëm sikundër nuk është, me të kundërtën e saj, me mohimin e saj*. Kështu ne mund të dimë për Qënjen vetëm çfarë ajo nuk është. Një situatë të tillë ne kemi edhe në theollogji, a

më sakt, në "Theologjinë Negative", që mund të na zbulojë çfarë Zoti nuk është, por jo se çfarë është.

Duke u kthyer tek Hedeggeri: Duke mos e njohur Qënjen, d.m.th. "Sein", fillosofia është kufizuar në njohjen (qoftë edhe pa qenë krejt e ndërgjegjshme për këtë) e "Dasein" që duke qenë një mohim i "Sein", është edhe një konkretizim i Tij në Kohë edhe në Hapësirë, në forma dhe sende të ndryshme.

Kështu Qënja identifikohet për ne, nga mos njohja, me Hiçin, me "Nicht-Sein", e pra, krejt paradoksalisht e padrejtësisht me Mosqënjen.

Ekuacionin *Sein = Nicht-Sein* e ndeshim edhe në fillosofinë e Hegelit.

Në një vepër tjetër themelore të tij me titull: "Was ist die Metaphysik?" (Ç'është Metafizika?) Heidegger shkruan, ndër të tjera: "Thënia e lashtë *ex nihilo nihil fit* [nga 'hiçi' s'del asgjë] rifiton tani një tjetër kuptim që lidhet me vetë problemin e Qënjes, e ndaj pra mund të zëvendësohet me *ex nihilo omne ens qua ens fit* [nga 'hiçi' dalin (lindin) të gjitha]". Del qartë se për Heideggerin të thuash "Qënje" a "Hiç" është e njejta gjë.

Në një pasazh tjetër ai thotë se tërë Metafizika vërtitet rreth "konceptit" të Hiçit. Por Hiçi nuk mund të vështrohet madje as si një koncept, sepse nuk mund të përCAKtohet (- ⊕), duke mos patur një CAK, një kufi. Kujtojmë këtu ekuacionin e Algoritmit Simbolik:

$$\bigcirc = \infty = \text{infinito} = \text{non finito} = - \oplus = \text{non deFINibile} = \text{i papërcaktueshëm}$$

Mos perceptueshmëria e Hiçit shpjegohet pikërisht me papërcaktueshmërinë e tij, m.q.s. siç dimë: *përcaktim* = ⊕ = *matje* [sansk. *matra*] = ● = *materie* [sansk. *matra*], *send*, *Botë materiale*. Ndërsa Hiçi, nuk është asgjë (jo gjë, ingl. *nothing* = *no thing*) nga të gjitha këto, për vetë faktin se është ASGJË! (As një gjë).

Fizika Kuantike na mëson (Wheeler e të tjerë...) se është matja ajo që krijon sendin: ⊕ = ● . E pra atëhere Hiçi, duke qenë i pamatshëm (në të dy kuptimet, ital. *immensurabile* = i pamatshëm; i pafund) nuk mund të

perceptohet, të njihet, të kapet. Ajo që ne "kapim" nuk është ai ("*Sein*", Zoti, Qënja) po Ekzistenca (në gjuhën e Heideggerit: "*Dasein*").

Dhe më tej, Fizika Kuantike vë në dukje se anallogjia më "flagrante" me Zotin tek ajo, është "fusha e vakuumit", pra, me fjalë të tjera Hiçi. Me fjalët e fizikantit dhe fillosofit të njohur të shkencës, J. Polkinghorne: "*The nearest analogy in the physical world (to God) would be... the Quantum Vacuum.*"

...Bota (ashtu, si në të vërtetë nuk është por veç na duket) sikundër na zbulon tashmë pa pikë dyshimi Shkenca dhe Fillosofia moderne (si edhe ajo e lashtë, si bie fjala Fillosofia Indiane) është një krijim (*ri-krijim*) i yni, ajo është një rikrijim, në dimensionin illogjik, i kodit F, a ç'është njëlloj, i Arsyës njerëzore.

Aforizma e Shqipes "*Shka lind është land*" tregon se Hiçi, duke qenë asgjë, e pra duke mos qenë lëndor, është i palindur, i pa bërë. Një aforizëm tjetër e Shqipes thotë "*Çdo e bërë është e përbërë*", simbolikisht (● = ∞). Pra atëhere Hiçi (Qënja, Zoti) është i thjeshtë, është "sendi" më i thjeshtë që mund të jetë.

Një nga veprat themelore të Heideggerit është edhe "*Unterwegs zur Sprache*". Ai kthehet e rikthehet vazhdimisht në çështjen e Gjuhës në pothuaj të gjitha shkrimet e tij, ndonëse jo nga një vështrim i saj "shkencor", thjesht linguistik, por duke e parë atë me syrin e Fillosofit, duke e konsideruar atë vetë një Fillosofi më vehte, në mos po si nivelin më të thellë të fillosofisë.

Sipas Heideggerit, Gjuha është më afër Qënjes se çdo gjë tjetër, aq sa ai e quan atë "*Haus des Seins*" (*Shtëpia e Qënjes*). Është vetëm duke rikujtuar Dijen e lashtë, "ngulur" thellë në Gjuhë, shkruan ai, që njeriu mund të vihet në gjendje të dëgjojë thirrjen që çprej zanafillës të Kohës Qënja i drejton. Duke medituar thellë mbi këtë Dije të groposur, që çprej një lashtësie të stërlashtë në Gjuhë, ne do të jemi të zot të biem në gjurmët e asaj Gjuhe primordiale në gjirin e të cilës fshihet (e pra rrethohet) Fjala themelvënëse e Qënjes, ai cak pa cak i mbamë (gjerm. *Grund*) e i Përtejme (trashendental) që të gjitha i mban dhe që prap e prap e sidoqoftë na shpëton, i përpirë në vorbullën e Abisit (gjerm. *Ab-grund*) të NIHILIZMIT.

Mund të themi, pa frikë, se Mendimi i Heideggerit përqëndrohet i tëri tek një rishqyrtim, tek një interpretim i ri i Ontologjisë (Dijes mbi Qënjën), duke vënë në pah prap e prap natyrën e saj gjer në fund trashendentale, atë të një koncepti–limit.

Sipas Heideggerit tërë Metafizika tradicionale mund e duhet të kritikohet e të superohet, gjë që bëhet e mundur me zbulimin e Qënjës si një diferencë e pa zhdukshme që fshihet në gjithshka, në çdo objekt e individ të veçantë, ndonëse prap hapet e zbulohet në kohëshmërinë e Historisë.

Duke u ndalur pak në këtë pikë shohim se *është punë e lehtë ta përkthejmë këtë pikëpamje mbi Qënjën të Heideggerit (si edhe parimet themelore të Fillosofisë së tij) në Gjuhën e Algoritmit tonë Simbolik.*

Ka vërtetë një diferencë të pa shlyeshme mes Ekzistencës (Realitetit Objektiv) dhe Qënjës, mes Njeriut edhe Zotit. Dimë se: **Njeriu = 5**, ndërsa **Zoti = 1**. Dhe kemi, siç kemi parë: **5 = -1** (sepse: **6 = 3 + 3 = 0 + 0 = 0**). Gjithashtu: **Botë materiale = ● = -1 = -Qënja = -Zoti**.

Së dyti: **-1 = -○ = □**, që do të thotë: **[Qënja] = Njeriu (5 , -1) = ⊕ = pjesë = ● = materie, Botë materiale**.

Që do të thotë gjithashtu që Qënja fshihet (□) në çdo njeri (5), si edhe në çdo send (●) e pjesë të së Tërës... ⊕.

Dhe tani vazhdojmë...

Heidegger thotë se shkak i Ankthit ekzistencial pothuaj "epidemik" i njeriut të kohës sonë duhet kërkuar tek lidhja e humbur e tij me Qënjën nga *shkak i rëndësisë dhe vëmendjes të paktë që i kushtohet sot Gjuhës*.

Është vetëm duke rrënuar thellë e më thellë në misterin e Gjuhës, duke u marrë si punë e parë e kryepunë me Etimologjinë e gjuhërave të lashta, që ne do të vihemi në gjendje ta dëgjojmë më në fund zërin e Qënjës, zërin e të Vërtetës.

Fjalët, për Heideggerin, nuk janë si ca etiketa ngjitur mbi disa vazo boshe vetëm për ti dalluar ato nga njëra–tjetra (roli, funksioni vetëm e vetëm "dallues" i fjalëve) siç pretendonte dikur një shkencë konvencionaliste

e gjuhësisë (...Saussure, Lacan...). Ato, përkundrazi, janë, në lashtësinë e tyre, si ca rezervuare që përmbajnë e ruajnë gjatë shekujsh e qindra shekuj një Dituri Hyjnore, misterin e Botës, kujtesën e humbur të Njerëzimit, Zërin e qashtër, kumbonjës e tronditës të Oënjes. Me këtë zë dhe u krijua e mbahet Bota, siç e dëshmon ndër të tjera dhe aforizma Shqipe "**Zani zuni**" (zëri krijoi) (shih lidhur me këtë edhe Cirlot: "*Sound*", fq.114), si edhe Gjenezën në Bibël dhe fillimin e Ungjillit të shën Gjjonit). Pra zëri, fjala i bëri të gjitha e pra edhe ajo e vetëm ajo mundet të gjitha ti shpjegojë.

Kështu shpjegohet edhe rëndësia si Gnosis (njohje) por edhe si ontos (qenje), që Heideggeri i jep pa asnjë rezervë Gjuhësisë në përgjithësi e veçan e mbi të gjitha Etimologjisë.

Vazhdojmë...

Misteri i **Botës përbën** një Dituri të Reveluar dhe vetëm një Revelim (zbulesë) mund të **na** e **zbulojë** atë. Dhe është ajo që bëri Krishti duke na zbuluar të Fshehtën e madhe të Botës. Ç'është kjo e vërtetë e fshehur? Simbolikisht, ajo që ne quajmë *Hiçi* dhe që identifikohet me Oënjen ("*Sein*") për të cilin na flet Heideggeri.

Siç thamë, sipas Heideggerit, Oenja ("*Sein*", ital. *Essere*) fshihet (mbyllet) e duke u fshehur shfaqet (hapet). Shfaqet *pó*, por jo ashtu siç është në vetvehte, jo si "*Sein*" por si "*Dasein*".

Siç pamë gjer diku edhe më sipër, kjo situatë do të jepej simbolikisht si:

$$- \bigcirc = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

e pra edhe si:

$$\bigcirc \perp = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

ose akoma edhe si:

$$\bullet = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

e pra si:

$$\text{Dasein} = [\text{Sein}]$$

Kujtojmë se formulat e mësipërme nuk janë tjetër veçse zbatime të veçanta të formulës së përgjithshme të Algoritmit Simbolik:

$$-x = \boxed{x} \quad \dots(F)$$

ku "x" mund të jetë një simbol çfarëdo... dhe duke vënë E në vend të "x"-it, do të kemi:

$$-E = \boxed{E}$$

ose edhe:

$$F = \boxed{E}$$

Kështu pra:

$$E = \textit{Sein} \quad \text{dhe} \quad F = \textit{Dasein}$$

Dhe ne shikojmë se si "Sein" shfaqet si "Dasein", e pra nëpërmjet asaj që ai nuk është: me mohimin e tij. Kjo është pra "fshehja" (\square) dhe "shfaqja" (\bullet) misterioze në të njejtën kohë e Qënjes, *mbyllja dhe hapja e njëkohshme e tij* për të cilën na flet Heideggeri.

Por formula ($-x = \boxed{x}$) nxirret në një mënyrë a në një tjetër, si çdo formulë tjetër e Algoritmit Simbolik, nga Gjuha. Si për shembull nga çifti thujse-homonimik i Shqipes "f s h i j" dhe "f s h e h", që nga dhe aforizma jonë e njohur "*Shka fshihet (-x) veç fshihet (\boxed{x})*".

Nga kjo, mund të nxirret si përfundim: 1) Rëndësia e Gjuhës dhe e një Etimologjie të Thellë të saj. Gjë kjo që justifikon të thënë e Heideggerit "*Gjuha është shtëpia e Qënjes*" (gjerm. *Sprache als Haus des Seins*), si edhe bindjen e tij të patundur se etimologjia, e veçanërisht ajo e gjuhëve arkaike (me të cilën ai dhe vetë intensivisht u mor në vitet e parafundit dhe të fundit të jetës së tij) është bash çelsi (në se ekziston ndonjë...) që do të na lejojë të hymë në shtëpinë e Qënjes.

Lidhur gjithnjë me çështjen e Gjuhës në Fillosofinë e Heideggerit, sipas tij gjuha e thellë, e vërtetë, e "mbrame", e "mbrime" (e Përsosur) dhe e "mbarë" (Universale) është ajo e Poezisë, dhe jo aspak ajo konceptuale dhe abstrakte e Shkencës, të cilës i shpëton thelbi, esenca e Realitetit.

Prandaj dhe ai e cilëson Fillosofinë e tij (veçan atë të fundit të karrierës së tij), një *fillosofi poetizuese* a një *poezi fillosofuese*. Pra dhe studjon intensivisht shkrimet e disa poetëve të tillë si poeti i madh Hölderlin i epokës së Romantizmit gjerman ku Fillosofia dhe Poezia bëhen një gjë e vetme. Kështu pra Fillosofia, në do të zbulojë "fundin e çdo fundi" duhet të bëhet poezi, gjuhë poetike. Ndaj pra dhe Heideggeri ngrë me të madhe problemin e Gjuhës, e një gjuhë adequate (të përshtatshme), për zbulimin dhe përshkrimin e misterit të Qënjes, sikundër nuk është mjerisht ajo, e cektë dhe jo adequate, e Shkencës.

Gjuha është bërë një problem i madh ende i pazgjidhur edhe për Fizikën e Kohës sonë. Le të citojmë për shembull, çfarë mendonte lidhur me këtë çështje Heisenbergu. Lexojmë se: "Pak kohë para se të vdiste, Heisenbergu botoi një shkrim në të cilin shprehte mendimin se një varg konceptesh, të rëndomta por edhe themelore të Mekanikës, si "i përbërë", "i pajisur me pjesë të veçanta dhe të emërtueshme", mund të mos kenë më asnjë kuptim për të vërtetat e fundme të cilat fizika përpiqet të arrijë" (shih Heisenberg: "Pjesa dhe e Tëra").

Një situatë e tillë në Fizikën Kuantike mund të parashikohej thjesht duke u bazuar në Algoritmin Simbolik. Dimë se koncepti themelvenës i Papërcaktueshmërisë i Heisenbergut, i përkthyer në gjuhën e simboleve tona shkruhet: – $\textcircled{1}$. Ky simbol ka një sërë interpretimesh (spektri i tij semantik), atë ndër të tjera të "Inseparability Principle" (parimi i mosndarjes), atë të "mosndërprerjes", të "vazhdimësisë", të "mungesës të pjesëve", e kështu me radhë. Nga ana tjetër, mund të shkruajmë:

$$- \textcircled{1} = \text{jo pjesë} = E = - \text{X} = \text{jo përbërje} = - \bullet = \\ \text{jo materie} = - \leftrightarrow = \text{jo kauzalitet...}$$

Kështu pra, në këtë fizikë të Avangardës nuk ka më kuptim të flasësh për pjesë, për përbërje, e kështu me radhë, të gjitha koncepte këto, tashmë të superuara, të Fizikës Klasike, deterministe.

Le të vëmë re këtu se Leibnitz-i ka qenë një nga të parët, në mos i pari, që mbrojtë tezën që fjalët kanë në vehte një kuptim. Këtë ai e provoi me

një listë të gjatë fjalësh Gjermanisht që ai i shpjegoi (motivoi) me një sërë fjalësh Shqip ("epirote", siç quheshin në kohën e tij), si për shembull fjalën Gjermanisht "H u n d" = qen, qen gjahu, zagar... të cilën ai e motivoi me Shqipen "h u n d ë" (ingl. *nose*, it. *naso*), për arsye, shkruan ai, se karakteristika dalluese e zagarit është nuhatja, e pra hunda.

Kështu Leibnitz, si fillosof i madh që ish, e vështroi fillosofikisht fjalën, nuk e ndau atë nga mendimi siç bëri një gjuhësi e mëvonshme.

Të njejtën gjë bën edhe Heideggeri, si një fillosof i madh i kohës sonë: Nuk e ndan fjalën nga kuptimi në vetvehte që ajo ka. Fjalët kanë kuptim, thotë ai, dhe madje kuptimin më të thellë që ekziston, atë të Qënjes. **Dhe bie** poshtë kështu edhe Saussure, edhe Lacan, edhe vija ("barriera") e tyre e famshme e ndarjes (*S / s*), ashtu sikundër bien poshtë e do të bien poshtë të gjitha ndarjet, gjë që do të sjelli me vehte fundin e Botës dhe kjo sepse:

a) Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang.*"

b) Në Latinisht: "**e l i m i n a t i o**" = *eliminim, asgjësim...*, fjalë kjo që duhet zbërthyer në "**e l i m i n**"... ku "e-" rri për simbolin "–", ndërsa "l i m i n" rri për "l i m e n" = *kufi*, e pra $\textcircled{1}$. Pra e gjithë fjala Latine jep, e përkthyer në gjuhën e simboleve, "– $\textcircled{1}$ " e pra "– \bullet " = *jo materie, jo Botë materiale*.

Me fjalë të tjera, edhe vetë Gjuha na tregon se heqja (rënia) e kufirit, e pra e ndarjes, sjell me vehte fundin e "sendit" material e pra, duke përgjithësuar, të vetë Botës, të vetë Realitetit tonë fizik.

c) Të gjitha mithet kozmogonike (Botëlindëse) realizojnë skemën:

$$E \downarrow = F$$

Mund të shkruajmë atëherë akoma:

$$\textcircled{O} \downarrow = \textcircled{1}$$

ose edhe:

$$- \textcircled{1} \downarrow = \textcircled{1} = \bullet$$

që nga edhe:

$$-\textcircled{1} = -\bullet$$

që do të thotë se: "Mos ndarja, heqja e ndarjes ($-\textcircled{1}$) shpie në fundin e Botës materiale ($-\bullet$)".

- ç) Në Sanskritisht: "m a t r a" (मत्रा) = *matje*, e pra edhe *ndarje*, e pra dhe *kufi* ($\textcircled{1}$) dhe, në të njejtën kohë, edhe *materie* (\bullet). Me fjalë të tjera, Sanskritishtja me fjalën *matra* shtron, siç e kemi parë, ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \bullet \\ \text{matra} & & \text{matra} \end{array} \quad \dots(\text{F})$$

që nga edhe, duke interpretuar " $\textcircled{1}$ " si *kufi* dhe " \bullet " si *Bota materiale*, dhe duke shumëzuar të dy krahët me " -1 ", do të kemi:

$$\begin{array}{ccc} -\textcircled{1} & = & -\bullet \\ \text{heqja e kufirit} & & \text{fund i botës materiale} \end{array} \quad \dots(\text{E})$$

*

Të gjitha këto sa më sipër janë rrjedhime të drejtpërdrejta a të tërthorta, por jo të eksplicituara e të artikulluara qartë, por mjaft *errët* edhe në një mënyrë gjer diku konfuzë, të mendimit fillosofik heideggerian...

Flitet shumë nga kritikët për motivin *eskatologjik* (gr. $\xi\sigma\chi\alpha\tau\omicron\varsigma$, *eskatos* = "fund"). Dhe është fjala këtu si për fundin e mendimit fillosofik, për fundin e vetë Fillosofisë, a, më sakt, të një mënyre të vjetëruar tashmë të të menduarit, të të fillosofuarit... ashtu edhe për fundin e Botës. Vetë Heideggeri flet shpesh e më shpesh për *Destraktion*, term të cilin ai e zëvendëson herë-herë me "Abbau" që do të thotë *ad litteram*... *çbërje*, *çmontim*, *shkatërrim*. Duke e treguar Botën materiale me simbolin X (me qenë se mithi kozmogonik i *Hieros Gamos*, ndër të tjera, na jep: ($\text{X} = \bullet$), "çbërja", "çmontimi", "shkatërrimi" (*Destraktion*), "çngatërrimi" i Botës do të jepej me:

$$-\text{X} = -\bullet \quad \dots(\text{E})$$

Vazhdojmë zgjerimin e Bisedës, edhe nëse rrezikojmë të dalim kështu jashtë themës. Po ia vlen, se informacioni që mund të marrim kështu është tepër i rëndësishëm.

dhe do të kalohej kështu nga Bota (●) tek Hiçi (– ● , ○).

Simboli " 8 " mund të interpretohet edhe si *përbërje*, ndërsa " ☉ " si *bërje* (*materializim*). Po kemi parë se, sipas aforizmës Shqipe:

"Çdo bërje është një përbërje".

Do të jetë atëhere:

– 8 = jo përbërje, çpërbërje, thjeshtësi, Hiç, ○

Simboli i fundit mund të interpretohet si ai i Hiçit, por edhe si *si-ai Nirvanës* (Sanskrit. "N i r v ā ṇ a", निर्वाण; në Pali, gjuha e disa prej shkruemeve më të hershme Budiste, "n i b b ā n a", që është Shqipja "nuk bana", e pra e *pabërë*, e *pakrijuar*). Që këndej edhe një pikë tjetër takimi themelor mes Fillosofisë të Heideggerit (me konceptin e tij të *Destruktion* dhe të *Abbau*) dhe Vizionit buddist të Realitetit nëpërmjet konceptit të Nirvanës, të Mosbërjes (të asaj që nuk është bërë, nuk është krijuar). Që këndej dhe e thëna e famshme e fillosofit të madh Lao-Tze: "Wú Wéi!" (無為) = *Mos bëj!*...

Le të vëmë re këtu shkarazi se në gjuhën Kineze "w u" = – 1, dhe kjo sepse kemi:

$$w < v < b = 2 = -1$$

...dhe kjo nga që gërma " b " është identifikuar me numurin 2 në shumë e shumë gjuhë të Botës dhe që, nga ana tjetër, nga: 2 = – 1 mund të nxjerrim: 3 = 0, që përbën bazën e Matematikës Mistike. Tërë fjala atëhere është "– w e i" dhe me Shqipen "– b ë j".

Me qenë se Gjuha referon, siç kemi thënë e pësëritur disa herë, tek një paradigmë superlative, primordiale, siç është ndër të tjera dhe paradigma e Krijimit të Botës, do patur parasysh se *jo çdo bërje është e keqe, por vetëm bërja e parë, pra Krijimi i Botës, që del kështu, edhe në fushë gjuhësore, se duhet vështruar si një krim.*

Numuri simbolik i Njeriut, siç thamë, është p e s a (5). Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$\text{Njeriu} = 5 = -1 \quad \dots(F)$$

Del pra kështu se Njeriu është mohues i Zotit.

Kushti i *ekzistencës* së Njeriut është, siç dimë, ashtu si edhe për çdo send tjetër lëndor, që të kënaqë ekuacionin e identitetit formal, parimin e moskontradiksionit (themeli i logjikës formale apo "aristoteliane", siç edhe quhet), d.m.th. ekuacionin $(x = x)$.

Por, nga ana tjetër:

$$\begin{aligned} \text{Zoti} &= \text{Qëndra Mistike} = \text{Parimi Suprem i Universit} \\ &= \text{Coincidentia oppositorum} = (x = -x) \end{aligned}$$

Kemi atëhere, siç duket qartë:

$$\text{Njeriu} = (x = x) = - (x = -x) = -\text{Qëndra Mistike} = -\text{Zoti}$$

Mund të shkruajmë atëhere edhe, në mëyrë më të përmbledhur, se kemi:

$$1 \downarrow = -1 = 5 \quad \dots(F)$$

Mund të shkruajmë edhe:

$$E \downarrow = F$$

dhe kemi të bëjmë kështu pra me një *mit kozmogonik*.

Nga ky mit kozmogonik marrim vesh edhe se:

$$\text{"Njeriu (5) është Perëndi e rënë (1 \downarrow = -1)."}$$

Në qoftë se shumëzojmë të dy anët e ekuacionit të mësipërm me -1 , do të përftojmë një ekuacion ekuivalent me të parin:

$$-(1 \downarrow) = -(-1) = -5 \quad \dots(E)$$

e pra:

$$1 \uparrow = 1 = -5 \quad \dots(E)$$

Që Njeriu të kthehet prap në atë Perëndi që ka qenë, përpara rënies, $(-1 \uparrow = 1)$, ai duhet të vetmohohet (-5) .

Kjo është ajo që predikon edhe Krishti dhe tërë Krishtërizmi i *mirfilltë* bashkë me të.*

108) Kinez. z u ò (作) = ingl. *to make* (bëj)

Është Shqipja:

z ë

në kuptimin e bërjes, e pra të materializimit, e pra simbolikisht ●.

Le ta zgjerojmë në këtë pikë disi Bisedën.

* Në Ungjill kjo kërkesë për njeriun që do të shpëtojë:

$$-\infty = E = (x = -x)$$

formulohet here–herë edhe me shprehjen:

"Për në Parajsë s'ka rrugë tjetër përveçse ajo e Kryqit."

Shtojmë këtu se:

$$+ \uparrow = \bigcirc \quad \dots(E)$$

siç vërtetohet në *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit.

Pra:

$$\text{Ruga e Kryqit} = + \uparrow = \bigcirc = -5 = \text{vetmohimi}$$

a) Simboli " ● " është, siç dimë dhe siç pamë, edhe ai *i bërjes* edhe ai *i të keqes, i gabimit, i mëkatit* etj., del se b ë r j a (zënia) është një e keqe (●), një mëkat. Kuptojmë atëhere thirrjen e fillosofit të math kinez Lao-Tze: "Wu wei!" (無 為) = Mos bëj, mos krijo!...

b) Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \text{X} \\ \text{z i} & & \text{z ë (kap)} \end{array} \quad \dots(\text{F})$$

Duke interpretuar këtu " ● " si *mëkat* dhe " X " si *skllavëri*, ne rigjejmë të thënë e njohur të Krishtit në Ungjill:

*"Kush mëkaton (●) bëhet skllav (X) i mëkatit."**

Me të tjera interpretime të simboleve në këtë ekuacion, rigjejmë të vërteta të rëndësishme në fusha të ndryshme të Dijes.**

109) Kinez. z ū (租) = zë me qira

Është Shqipja: z ë

Në Shqip gjithashtu:

"z u", "z u r i" (me qira)

* Gjoni, 8:34.

** Për këtë bëhet fjalë edhe në shkrime të tjera të Autorit si p.sh. "Shqipja dhe Sanskritishtja" dhe "Libri i Aforizmave". Mund ti drejtohem për këtë Shqipes dhe ekuacioneve simbolike që ajo shtron, por edhe çdo gjuhë tjetër, siç që këtu gjuha Kineze, edhe kjo pasi: *Algoritmi Simbolik, si një artikullim (organizim) llogjik i Mendimit Mistik ("Philosophia Perennis")*, është *i pranishëm në çdo gjuhë (duke përfshirë me emrin "Gjuhë" edhe çdo sistem njohës e më tej).*

110) Greq. **meta** (μ ε τ ά) = ingl. *among* (ndërmjet, midis)

Është Shqipja:

$$\text{m e d à} = \textcircled{1} = (|)$$

(midis)

111) Indon. **berkata** = ingl. *to speak* (me folë, me thanë)

Dhe me Shqipen:

$$\text{b è r k a t h à}$$

("ka thān")

Le të vëmë në dukje këtu se rrënja "k a t h a", "k a t h i t a"... në kuptimin "k a t h a n ë" e gjejmë edhe në Sanskritisht, e cila por nuk është në gjendje të ndajë veç pjesët "ka" dhe "tha-në" siç është në gjendje ta bëjë, përkundrazi, Shqipja ku "ka" (ingl. *to ha-ve*, gjerm. *ha-ben...*) dhe "than" (nga folja "me thanë", ingl. *to say*) janë operatorë të lirë.

112) Indon. **perbedaan** = ingl. *distinction, difference* (dallim)

Është Shqipja:

$$\text{b è r : b è d à n}$$

("e bërë e damun")

simbolikisht:

$$\textcircled{1} = \mathbf{F} = (\neq 1)$$

113) Indon. **berbeda** = ingl. *dissimilar* (i ndryshëm)

Motivohet me Shqipen:

$$\text{ber be da} \rightarrow \text{shq. b è r : b è d à} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = (\neq 1)$$

simbol ky i fundit i *ndryshmërisë*, i *pluralitetit*...

Vëmë ré këtu se edhe tek Shqipja "i n d r y s h ë m" ne mund të shquajmë rrënjën "n d a r ë" e pra simb. $\textcircled{1}$ etj. etj.

Edhe në Inglisht: "d i v e r s e" (*i ndryshëm, i larmishëm*) dhe "d i v i s i o n" (*ndarje*) ne mund të dallojmë radikalën e përbashkët "d i v" (ku "d i" është Shqipja "d à").

Edhe në Rusisht: "r a z- n o s t" (разность) = *ndryshueshmëri*, ndërsa "r e z- a t s" (резать) = *pres, ndaj*.

Mund të shkruajmë përmbledhtazi, si një "*Consensio linguarum*":

	$\textcircled{1}$	=	(≠ 1)	...	(F)
indon.	berbeda		berbeda		
ingl.	division		diverse		
rus.	rezats		raznost		
shq.	ndarë		ndryshëm		
		

114) Indon. d a n a = themel

Është Shqipja:

$$i \text{ d a n ë (i ndarë)} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \textcircled{\circ}$$

Dhe me qenë se " \circ " është ndër të tjera simboli i Zotit, del pra atëherë se themeli i gjithësisë identifikohet me Atë, me të Amshueshmin.*

* Simboli " \circ " kur paraqitet si i "okultuar", *i fshehur, i reçesivuar, i ndaluar...* si "*Deus Himmanens*" bëhet i vogël, do me thënë " \circ ".

Kështu që:

$$\textcircled{\circ} = \circ \quad \dots(\text{E})$$

Që do të thotë se këto dy simbole janë i njejtë simbol, por në dy pozicione të ndryshme.

Le ta zgjerojmë Bisedën në disa drejtime, edhe sepse duam, ndër të tjera, që lexuesi ynë të bindet gjer në fund, për saktësinë (gjer në rrënjët më të thella të Vizionit Mistik mbi Universin) e motivimeve tona, në unicitetin e tyre.

Marrim në Shqip fjalën "t h e m e l". Kjo fjalë zërthehet në "t h e m + e l", dhe me Shqipen: "t h y m E L", ku "EL" = shq. Yll = \bigcirc .*

Pra atëhere:

$$\text{themel} = \text{thym yll} = \text{⊕}$$

Mund të shkruajmë akoma në vazhdim të këtij shtjellimi:

$$\dots \text{⊕} = F = -\bigcirc = \boxed{\bigcirc}$$

Pra *themeli* (e pra *themelimi*) kërkon *mohimin* (*sakrifikimin*) e Hyjnisë ("kurbanin"), - \bigcirc , dhe "reçesivimin" a troç, burgosjen, "zh-dukjen"*** e Tij, $\boxed{\bigcirc}$. Kjo është ajo që në të gjitha tekstet mbi Mendimin Mistik simbolik quhet "*Cosmogonic Sacrifice*".

115) Indon. d a s a r = ingl. *foundation, basis* (themel)

Edhe kjo fjalë e Indonezishtes reduktohet tek Shqipja, që edhe e motivon atë.

Kemi:

$$\text{d a s a r} \rightarrow \text{shq. d a s í A r} = \text{⊕} = F = \boxed{\bigcirc} = \bullet = \text{realizimi material}$$

Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm.

* Shih dhe fq.154 dhe 400.

** Shih fq.210, 554 dhe 636.

1) $Ar = \bigcirc = 1 = E$

Dhe kjo sepse "A r i", edhe në kuptimin e Inglishtes "Gold", është kategoria më e lartë në të gjitha kuptimet. Ai rri, ndër të tjera, për Zotin, për të Tërën, për arkeotipin absolut, për arke-n, më të parën, më të lashtën e kështu me radhë.

2) Sipas Mendimit Mistik, Bota është krijuar simbolikisht me ndarjen (copëtimin) e " \bigcirc " në pjesë.

Pra: $\bigcirc = 1$ (e Tëra, Zoti... Fryma...) dhe ky është kodi E, ndërsa $\textcircled{1} = 2$ (jo e Tëra, pjesët që përftohen nga ndarja e të Tërës, "gjymtyrat e ndryshme të Hyjnisë") dhe ky është kodi F.

Gjuha na e rikujton këtë në shumë mënyra si, ndër të tjera, me mbaresën "-ar", si në shembullin e këtushëm "d a s - a r" që duhet lexuar si "d a s i e A r i t", si një pjesëtim i Arit. Në përgjithësi, sufiksimi me "Ar" "aludon" për prejardhjen e gjithshkaje nga Zoti (= Ar).*

* Cirlot (fq.123): $\bigcirc = \text{Infinity, the Universe, the All...}$

Kujtojmë këtu po nga "Dictionary of Symbols" nga Cirlot (fq.119): "Gold. In Hindu doctrine gold is the 'mineral light'. According to Guénon, the Latin word for gold aurum [Albanian ar] is the same as the as the Hebrew for light aor. Jung quotes the delightful explanation offered by the alchemist Michael Maier in 'De Circulo Physico Quadrato' to the effect that the sun, by virtue of millions of journeys round the earth (or conversely) has spun threads of gold all round it. Gold is the image of solar light and hence of the divine intelligence. If the heart is the image of the sun in man, in the earth is gold. Consequently, gold is symbolic of all is superior, the glorified or 'fourth state' after the first three stages of black (standing for sin and penitence), white (remission and innocence) and red (sublimation and passion). Everything golden or made of gold tends to pass on this quality of superiority to its utilitarian function. Chrysaor, the magic sword of gold, symbolizes supreme spiritual determination. Gold is also the essential element in the

- 3) "Ar" ka dhe kuptimin e Yllit, si mbartës dhe dhënës i Dritës. Ai përputhet me Qendrën Mistike që vështrohet si Parimi Suprem i Universit.*
- 4) Në vend të sufiksimit me "Ar" mund të kemi edhe një sufiksime me "yll" (në trajtat –ul, –el, –al, –il,...). Edhe "Yll" simbolizon Dritën e pra, rrjedhimisht, Zotin, Qendrën Mistike.**

symbolism of the hidden or elusive treasure which is an illustration of the fruits of the spiriti and of supreme illumination."

(Ari. Në doktrinën Hindiane, ari është 'drita minerale'. Sipas Guénonit, fjala Latine *aurum* që tregon arin, përputhet me fjalën Hebraisht *aor* që tregon dritën. Jungu citon shpjegimin e këndshëm të alkimistit Michael Maier në '*De Circulo Physico Quadrato*', sipas të cilit dielli nëpërmjet miliona e miliona udhëtimeve të tij rreth tokës (ose anasjelltas), ka thurur fije të arta rreth e rrotull saj. Ari është shëmbëlltyrë e dritës së diellit dhe pra që këndeje, e inteligjencës hyjnore. Ndërsa zemra është shëmbëlltyrë e diellit tek njeriu, këtë rol në Tokë e lot ari. Rrjedhimisht, ari simbolizon gjithçka është e lartë, e epërme, të fortlevduarën 'gjendje e katërt' pas tre gjendjeve të tjera paraardhëse, d.m.th. atë të të zezës (mëkati dhe pendimi), të bardhës (spastrim dhe pafajësi) dhe të kuqes (sublimim dhe passion). Çdo send i artë ose i gatitur prej ari priret të kalojë duke u mbështetur mbi këtë veti të epërme, në funksionin e tij utilitar. Krisaori, shpata magjike prej ari, simbolizon vendosmëri të epërme shpirtërore. Ari është gjithashtu edhe elementi esencial i simbolizmit të thesarit të fshehur, gjë që aludon për fryte spiritual dhe për një dritë mendore supreme.)

* Cirlot (fq.310): "*The 'flaming star' is a symbol of the mystic Centre.*"

** Kujtojmë se krahas me ekuacionin:

$$(a, u, o, e, i, \dots) + R = \bigcirc$$

ne mund të shkruajmë edhe ekuacionin:

$$(a, u, o, e, i, \dots) + L = \bigcirc$$

Mund të themi atëhere, duke *sintetizuar* dhe *përgjithësuar*, se:

**Çdo fjalë, pamvarësisht kuptimit që i është dhënë,
përfaqëson një mith kozmogonik.**

Dhe kjo sepse:

$$(E \downarrow = F) \rightarrow (O \downarrow = \textcircled{1})$$

sufiksi* "fjala" si një "felë"

Shembulla të sufiksimit me "-yll" në Shqip:

dj-al, p-yll, d-yll, etj.

Shtojmë *më në fund* se koncepti i *themelit* lidhet ngushtë me atë të *ndarjes...*

Edhe në Shqip "t h e m e l", që do zbërthyer e motivuar si:

$$t h e m e l \rightarrow \text{shq. thym yll} = \text{"El(i) i thym"} = \textcircled{1} = F = \boxed{\textcircled{0}} = \bullet$$

Edhe Italishtja "f o n d a r e" që motivohet edhe ajo me Shqipen si:

$$b \ddot{e} n d a r \ddot{e} = \textcircled{1} = F = \bullet$$

E kështu me radhë...

Do me thënë se operatorët: (zanore) + R dhe (zanore) + L janë nga pikë-pamja semantike, identike, shprehin d.m.th. të njejtën gjë.

Nëpërmjet Shqipes kemi:

Ingl. s t a r = s t + a r, e pra *âsht ar*

Shq. i s t ë r = i s t + ë r, e pra *isht ar*

Ital. s t e l l a = s t + e l l a, e pra *âsht yll*

e kështu me radhë...

116) Greq. **themelio** ($\theta\epsilon\mu\acute{\epsilon}\lambda\iota\omicron$) = themel

Motivimi me Shqipen:

$$\text{thym Yll} = \text{⊙} = F = \text{⊠}$$

Mund të përsërisim këtu ato që thamë më sipër. Themeli i Universit pra, sipas të gjitha gjuhëve, është simb. ⊙ , e pra $(x = -x) = \text{Coincidentia oppositorum} = \text{Qendra Mistike} = \text{Parimi Suprem i Universit} = \text{Zoti}^*$

Thotë shën Pali: "Se askush nuk mund të hedhë tjetër themel përveç atij që tashmë është hedhur dhe që është Jisu Krishti."** Dhe me qenë se për të e për të gjithë të Krishterët, Krishti, si biri i Zotit, është edhe vetë Zot, edhe Pali rikonfermon kështu përfundimin që nëpërmjet Gjuhës arrihet këtu, që themeli është Zoti.

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë edhe se:

Në Gjermanisht: "Auf-bruch" = fillimi,*** dhe në të njejtën kohë "Bruch" (nga "brechen") = thyerje, e pra ⊙ .

Gjermanishtja shtron kështu ekuacionin:

$$\begin{array}{ccccccc} \text{⊙} & = & -1 & = & \bullet & & \dots(F) \\ \text{brechen} & & & & \text{Aufbruch} & & \\ \text{(thyerja)} & & & & \text{(fillimi i Botës materiale)} & & \end{array}$$

* Edhe fjala tjetër Greqishte për të treguar *themelin*, "i d h r i m a" (ιδρυμα) përfshin operatorin e ndarjes: Greqisht "d h r", në Shqip "d a r", që na shpie më në fund tek *them-eli* si " ⊠ ".

** Korinthisit, 3:11.

*** Shih edhe fq.607 dhe 740.

Kemi një rikonfermë këtu të të thënës të pavdekshme të Paracelsus:

*"Die Separatio ist aller Geburt Anfang."**

Por, nga ana tjetër, me qenë se:

$$\textcircled{1} = F = \textcircled{0}$$

ne, duke parafrazuar të thënën e Paracelsus, mund të themi edhe:

"Die Inhumatio ist alles Geburt Anfang."

Që do të thotë që: *"Varrimi (groposja) është fillimi i çdo bërjeje"...* Varrimi i Kujt?... *Mos. Gjeha* referon tek një paradigmë superlative, zanafillore, është fjala *katu për varrimin* (fshehjen) e Zotit.

Parafrazimi i Paracelsus, merr atëhere këto trajta:

"Inhumatio Dei ist aller Geburt Anfang."

ose edhe:

"Occultatio Dei ist aller Geburt Anfang."

Pra gjithshka fillon me:

$$\textcircled{0} = \textit{inhumatio, occultatio Dei...}$$

Ndoshta do të kemi rast ta zgjerojmë edhe më vonë në një drejtim të tillë metafizik, theollogjike, këtë Bisedë...

117) Lat. **f u n d o** = ingl. *to lay the foundation of..., to found* (themeloj)

Dhe me Shqipen:

$$f u n d o \rightarrow \text{shq. } b \hat{a} n d \grave{a} = \textcircled{1} = F = \textcircled{0} = \textit{themeloj...}$$

* Shih ndër të tjera edhe fq.313, 408, 670 dhe 742.

118) Lat. **fundamen** = themel

Dhe me Shqipen:

$$\text{bâ ndamun} = \text{Ⓣ} = \text{F} = \text{Ⓚ}$$

119) Lat. **condo** = ingl. *to build* (ndërtoj, bëj)

Motivimi:

$$\text{co ndo} \rightarrow \text{shq. ka ndà} = \text{Ⓣ} = \text{Ⓚ} = \text{●} \dots(\text{F})$$

Rishohim, prap e prap, se *bërja, ndërtimi* presupozojnë një *ndarje*.

Ripohohet kështu në pafundësi e thëna e Paracelsus-it të *maoh*:

"Die Seperatio ist aller Geburt Anfang."

Me qenë se, nga ana tjetër, fjala Latinisht "**s e p a r o**" = *ridaj*, e pra me Shqipen "**b ë r ë S**", ne shohim se ndarja me të cilën Bota u krijua vjen nga "**S**", e pra nga "**S**-erpens", d.m.th. nga gjarpëri, që është një trajtë, një personifikim i Djallit.*

Në Shqip: "d j a l l i = d a l l u e s i".

Pra, me qenë se krijimi i Botës presupozon një *dallim*, një *ndarje*, simb. $\text{Ⓣ} = \text{●} \dots(\text{F})$, autori i krijimit të Botës, edhe theollogjikisht, është *Dalluesi* i madh, *Djalli*.**

Në zgjerim të Bisedës le të shtojmë se në Shqip "**b d a j**"*** = *bëj* (ingl. *d o*).

* Shih lidhur me këtë edhe fq.111 dhe 607.

** Shih lidhur me këtë edhe fq.243, 348, 543 dhe 701.

*** Shih: Konstandin Kristoforidhi "*Fjalor Shqip-Greqisht*" (ribotuar 1961).

Shqipja shtron kështu ekuacionin simbolik, që ripohon vërtetësinë e etimologjizimeve të mësipërme:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

$$\text{b ë d a j} \quad \text{b d a j (bëj)}$$

120) Sanskr. a - d o ṣ a (अदोष) = fr. *innocent* (i pafajshëm, pa mëkat)

Dhe me Shqipen:

$$-d y s h^* = -2 = -F = -\bullet$$

ku simboli " \bullet " është ndër të tjera ai arkeotipal i të keqes (si edhe ay i *errësirës* dhe, në kuptimin figurativ, edhe ai i *padijes*).

121) Sanskr. a - d ā s a (अदास) = fr. *non esclave, homme libre* (jo skllav, njeri i lirë)

Edhe kjo fjalë reduktohet tek Shqipja si:

$$-d y s h = -2 = -F = -\bullet = -\infty = \text{jo skllavëri, liri}$$

Shikojmë se si Sanskritishtja me këtë thujse-homonimi shtron ekuacionin simbolik:

$$-\bullet = -\infty \quad \dots(E)$$

$$\text{a-doṣa} \quad \text{a-dāsa}$$

$$(\text{अदोष}) \quad (\text{अदास})$$

* Dhe kjo sepse, siç kemi parë, numuri 2 simbolizon të keqen, negativitetin, kundërvënien Krijuesit dhe është për Mendimin Mistik më tersi nga të gjithë numurat. Mund të thuhet se ai është, shkurt, numuri i djallit.

Shih dhe Sanskritishten "d o ṣ a" (दोष) = *faj; e keqe; errësirë; padije* (fq.19).

Duke shumëzuar të dy anët e këtij ekuacioni me " -1 ", ne gjejmë ekuacionin simbolik ekuivalent:

$$\bullet = \text{X} \quad \dots(F)$$

një ekuacion tepër i rëndësishëm me aplikime themelore në fusha të rëndësishme të Dijes. Këto aplikime përftohen duke interpretuar në mënyra të ndryshme simbolet që marrin pjesë në këtë ekuacion.

Le të shohim disa prej tyre:

a) $\bullet = \text{mëkat}$ $\text{X} = \text{skllavëri}$

Rigjejmë kështu të thënë e famshme të Krishtit në Ungjill:

"Kush mëkaton (\bullet) bëhet skllav (X) i mëkatit."

Le të nënvizojmë këtu faktin tepër të rëndësishëm se pikërisht këtë lidhje themelore, që Krishti bën në Ungjill mes mëkatit dhe skllavërisë, bën edhe Sanskritishtja (e pra tërë Fillosofia e lashtë Indiane prapa saj) nëpërmjet ngjashmërisë së fjalëve "d o ṣ a" (*mëkat*) dhe "d ā s a" (*skllavëri*).

$$\begin{aligned} \text{"a-doṣa"} &= -\bullet = \bigcirc = (x = -x) = \text{Qendra} = \text{Zoti} = \text{e Vërteta} \\ \text{"a-dāsa"} &= -\text{X} = \text{çlirim, Liri} \end{aligned}$$

Rigjejmë kështu të thënë e Krishtit në Ungjill:

"Do njihni të vërtetën [$(x = -x) = \bigcirc = -\bullet$] dhe e vërteta do ju bëjë juve të lirë ($-\text{X}$)."

Ne pamë kështu praninë e Algoritmit Simbolik, ashtu si do të mund të shikonim praninë e tij edhe në sisteme të tjera mendore, sikundër janë, bie fjala, shkencat e ndryshme: Fizika, Psikologjia, Mjekësia etj., si edhe Fillosofia dhe Theologjia.

* Gjoni, 8:34.

Me qenë se, nga ana tjetër, Algoritmi Simbolik përfaqëson një Hologramë, gjë që do të thotë se çdo simbol në të është ekuivalent me të gjithë simbolet e tjerë, kjo do të thotë se ay është i pranishëm në tërë Ungjillin, i cili përbën kështu një sistem simbolik ku kritikohet, mohohet, kodi F, dhe ekzaltohet, predikohet kodi E.

Do të japim më vonë sqarime të ... të një korispondence të tillë që nxjerr në pah, ndër të tjera, aktualitetin e Ungjillit dhe inherencën e tij në Shkencën Moderne.*

Një rrjedhim tjetër i tërë këtij "zgjerimi" është dhe përfundimi krejt i sigurtë i një *! z o m o r f i z m i* "copë për copë" mes Theollogjisë së Krishterë (*dhe në përgjithësi mistike*) dhe Diturisë së lashtë dhe hyjnore të Vedave.

b) ● = *masa materiale e një trupi* ⌘ = *relativitet*

Gjejmë kështu se:

"Masa e një trupi (●) është relative (⌘)."

Një rezultat ky i rëndësishëm i Fizikës Relativiste...

c) ● = *masa e një trupi, e pra inercia e tij* ⌘ = *bashkëveprim*

Rigjejmë atëherë kështu parimin e Mach-ut në Fizikë: *"Inercia e një trupi (●) është e barabartë me tërësinë e bashkëveprimeve (⌘) të tij me të gjithë trupat e tjerë të Universit (∑ ⌘)".*

ç) ● = *Bota materiale* ⌘ = *Bashkimi (Conjunctio, Hieros Gamos)*

Rigjejmë atëherë këtu mitin kozmogonik të *Hieros Gamos*: *"Bota (●) është krijuar nëpërmjet martesës (⌘) së shenjtë mes Qiellit dhe Tokës."*

* "Prania e Jisu Krishtit në Shkencën Moderne"...

d) Me qenë se:

$$-\text{X} = \bigcirc = (x = -x) = \text{Qëndra}$$

ne vihemi në gjendje të rigjejmë këtë propozicion të rëndësishëm të Mendimit Mitik: *"To undo the knot [- X = a - d ā s a] was equivalent to finding the centre [(x = -x) = \bigcirc = - \bullet = - d o s a]."*

dh) Rigjejmë kështu të thënë e Krishtit në Ungjill: *"Do të njihni të vërtetën [a - d o s a = - \bullet = \bigcirc = (x = -x) = Qëndra = Zoti = e vërteta...] dhe e vërteta do ju bëjë juve të lirë [a - d ā s a = - X = çlirim, liri...]."***

...

Pamë pra kështu disa zbatime të një ekuacioni simbolik të përfutur nga një çift thujse-homonimik i Sanskritishtes. Zbatime të tilla janë gjithnjë të mundura dhe surprizonjëse në çdo rast kur nga një çift homonimik a thujse-homonimik në një sistem gjuhësor çfarëdo (si në rastin tonë Sanskritishtja) mund të nxirren me ndihmën e Algoritmit Simbolik dhe shpesh herë me ndihmën e Shqipes, rezultatet të rëndësishme në fusha të ndryshme të Dijes dhe në dimensione të ndryshme të Realitetit.

122) Indon. **k a d a r** = ingl. *measure* (matje; masë)

Është Shqipja:

$$\text{k â d a r} = \text{simb. } \textcircled{\text{D}}$$

Një shpjegim këtu është i nevojshëm:

Matja nënkupton gjithmonë ndarjen ose mundësinë e ndarjes. Le të vëmë re në Italisht: *"m e t a"* = *gjysma*, e pra simb. $\textcircled{\text{D}}$, dhe në të njëjtën kohë

* Cirlot (fq.173): *"Zgjidhja e nyjes barazohej dikur me gjetjen e Qendrës..."*

** Gjoni, 8:32.

"m e t r o". Në Shqip: "m e s", "m e s o j", "m e s o r e", e pra $\textcircled{1}$, e në të njëjtën kohë "m a s", "m a t". Në Rusisht: "m e r i t s" (мерить) = *me mat*, me prejardhje nga Greqishtja "m é r o s" (μέρος) = *pjesë* (ingl. *part, share*).

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë se Algoritmi Simbolik na jep:

$$\textcircled{1} = F = \bullet = \text{masa, materia}$$

nga rrjedh, ndër të tjera, se:

"Është matja ajo që krijon materien."

Del kështu në pah roli materializonjës i matjes... përfundim ky që arrin sot edhe Fizika **Kuantike**, sipas të cilës është vetë e vetëm procesi i matjes ai që, duke sjellë me vete kolapsimin e valës të Schrödinger-it,* krijon grimcën materiale. Ne jemi kështu në një farë mënyre bashk-autorë a bashk-krijues të Realitetit, të cilin Wheeler, për këtë arsye, e cilëson si një "*Participatory Universe*".**

* Vala e Schrödinger-it tregon probabilitetin që një grimcë të jetë këtu apo atje, apo shkurt, të ekzistojë. Vendndodhja e grimcës bëhet e saktë kur ndërhyhet në proces me anë të matjes.

** John Archibald Wheeler (1911–2008). Fizikant i shquar Amerikan. Është marrë me sukses me një sërë çështjesh të Fizikës dhe Astronomisë moderne, si për shembull me problemin e vrimave të zeza dhe të pasojave që rrjedhin nga pranimi i tyre, duke u përpjekur, bashkë me të tjerë, të hartojë një Teori të Përgjithshme, tërëpërfshirëse të këtyre zbulimeve të fundit të astronomisë teorike. Kërkimet dhe studimet e tij arritën në përfundimin e një "*Participatory Universe*", të një Universi që nuk është krejt objektiv e pra i pamvarur nga ne, por përkundrazi, i tillë që nuk mund të ekzistojë pa ne, si vrojtues, si koshiençë.

Dhe vëmë ré këtu se Sanskritishtja "m a t r a" (मत्रा) = a) *matje*, b) *materie*, rikonfermon saktësinë e motivimit tonë të fjalës Indonezist "k a d a r",

123) Lat. **de sum** = ingl. *to lack; to be down, to fail* (kam mangut; dështoj)

Do zbërthyer si:

de esse

dhe me Shqipen:

$$\begin{aligned} \mathbf{da\ \hat{a}sht} &= \text{"\hat{a}sht DA"} = \textcircled{\oplus} = \mathbf{F} = -\textcircled{\ominus} \text{ (-jo e plotë, e mangut)} \\ &= \downarrow \text{ (rënie, dështim)} \end{aligned}$$

Le të rikujtojmë se edhe Inglishtja "d o w n" zbërthehet në "d o + w n" dhe me Shqipen: "d a b â n" = $\textcircled{\oplus} = \mathbf{F} = \downarrow$.*

124) Ingl. **de spise** = përbuz, shoh me mospërfillje etj.

Kjo fjalë reduktohet tek Latinishtja "d e s p i c e r e" = ingl. *to look down, regard from above; despise* (shoh poshtë, shikoj nga sipër poshtë; përbuz).

Mund të zbërthehet në:

des s pi cere

"d e s" është Shqipja "d a s i" (ose "d y s h"), e pra simb. $\textcircled{\oplus}$, dhe për ekuivalencë simbolike **2**. Dimë se kemi: $\mathbf{2} = -\mathbf{1}$ (një ekuacion themelor simbolik, jo vetëm, por tepër i përhapur në Gjuhë, siç kemi parë dhe do të shohim).

si edhe rolin materializues të matjes, zbulim i fundit i Fizikës Kuantike, duke shtruar ekuacionin e njohur simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{\oplus} & = & \bullet & \dots(F) \\ \mathbf{m a t r a} & & \mathbf{m a t r a} & \end{array}$$

Shih ndër të tjera edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

* Shih gjithashtu fq.263, 239.

"s" është pleonastike, nuk luan, me fjalë të tjera, ndonjë rol të mirfilltë semantik.

"p i" është Shqipja "p a" nga folja "me pa" (ingl. *to see*), folje që mungon në gjendje të lirë në Latinisht. E gjejmë në Sanskritisht në kuptim të përafërt, si për shembull në: "p a" (प) = që mbron, që ruan, që sheh... (ingl. *to take care of...*), "g o-p ā" (गोपा) = bari (ingl. *shepherd*, fr. *berger*), fjalë për fjalë: pa-mësi i ka-ut, i qeve, etj.

"c e r e" është një sufiks verbalizues i identifikueshëm me Shqipen "k r y" (krye) dhe me Sanskritishten "k r" (कृ).

Pra tërë fjalë Latinishte jepet (motivohet) me Shqipen si:

d a s i	}	P A k r y
dy s h		
d e s (vdes)		

ose:

(⊕ , ose 2 , ose ●) + P A + k r y

dhe me qenë se: 2 = -1, dhe me qenë se: ● = ↓ ... (F), kemi kështu atëhere një segment të spektrit të mundshëm (potencial) kuptimor të fjalës Latinisht "despicere".

– Pa (nuk du me e pa..., e përbuz)

2 . Pa (e shoh me dyshim)

● . Pa (e shoh me keqdashje...)

↓ . Pa (e shoh nga lartë poshtë)

Tërë spektri i mundshëm i fjalës Latinisht "d e s p i c e r e", pas "reduktimit" të saj në Shqip, do të jepej me:

F (PA)

ku në vend të F (kodi formal) do të viheshin të gjitha spektrat semantike të të gjitha figurave simbolike në F. Do të kemi rast të flasim më hollësisht për këtë.

- 125) Lat. d e s s c r i b e r e (d e s c r i b o) = ingl. to divide up by writing (ndaj duke shkruar, ndaj me të shkruar...)**

Mund të ndahet në:

d e s s c r i b e r e

dhe është Shqipja:

d a s í s h k r u j b ë r ë

("bërë dasí shkruj")

d.m.th.:

"bërje d a s í në të shkruar"...

Fjala "s h k r u" në Shqip lidhet si me origjinën e saj me "g r y", "k r r u j", dhe kjo sepse shkrimi i parë është realizuar duke "g r r y e r" pllakat e gurit (Latinisht: "i n - s c r i - p t i o"). Që këndej dhe fjala "g ë r m a" që do të thotë zanafillisht "t ë g r r y m e t".

- 126) Greq. g r á m m a (γ ρ á μ μ α) = g ë r m a**

Lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen:

g r r y e m u n, g r r y

ku grupi "-m u n" i Shqipes është reduktuar në Greqisht në "-m m".

Kujtojmë se fjalët (e pra "g ë r m a t") në kohërat e lashta janë g r r y e r ("t ë g r r y e m e t") mbi "g u r" (ingl. *stone*).

127) Turq. *d o l g a* = ingl. *wave* (vala, dallga)

E pra është Shqipja:

d a l l g a

Le të tregojmë tani përse kemi:

turq. "*d o l g a*" < shq. "*d a l l g a*"

me fjalë të tjera përse prejardhja e gllosës Turqisht është nga Shqipja dhe jo anasjelltas.

Në vija të përgjithshme mund të themi se kur ndodh që dy gllosa, në dy sisteme të ndryshme gjuhësore, të jenë identike a thujse-identike për nga forma dhe identike edhe për nga kuptimi, caktimi i prioritetit lashtësor i njërës mbi tjetrën bëhet ndër të tjera kështu: shihen lidhet mitik të asaj fjale në sistemet gjuhësore përkatëse. Në qoftë se në sistemin " *X* " të themi ekziston një lidhje e tillë mitike e fjalës " *x* " në Shqyrtim dhe së në sistemin " *Y* " një lidhje e tillë nuk ekziston, ne mund të përfundojmë se:

$$x(Y) < x(X)^*$$

që lexohet:

"Fjala *x* në *Y* është më pak e vjetër në *Y* se sa ajo është në *X*."

* Shenja "<" rri në matematikë për "më i madh se...", kurse në Studimin tonë, sikundër edhe në studime të tjera të këtij lloji, po kjo shenjë tregon "prejardhje nga"... Kështu, në shembullin e mësipërm: turq. "*dolga*" < shq. "*dallga*", që duhet lexuar si: "Turqishtja *dolga* vjen nga (<) Shqipja *dallga*."

Për të sqaruar afërsinë e këtyre fjalëve le të citojmë sërish nga Cirlot:

*"Schneider points out the aptitude for symbolic thought and rhythmic thought of Primitive Man, who could identify the movement of a wave with that of the backs of moving flock of sheep."**

(Schneider vë më dukje prirjen e Njeriut Primitiv për një mendim simbolik dhe ritmik, i tillë sa ta barazonte lëvizjen e një dallge me atë të kurrizimit të një tufe delesh në lëvizje.)

Në rastin tonë konkret "d o l g a" e Turqishtes nuk ka në sistemin leksikor të Turqishtes ndonjë lidhje mitike me ndonjë fjalë tjetër të përngjashme për nga forma të sistemit, kurse fjala "d a l l g a" e ka një lidhje të tillë. Jo vetëm, por gjith po kjo lidhje mitike ekziston edhe në gjuhë tjera. Kështu kemi:

shq. **d e l e** (ingl. *sheep*)

d a l l g ë (ingl. *wave*)

frenj. **m o u t o n**

m o u t o n

rus. **b a r a n** (баран) (*dash*)

b u r j a (буря) (*dallgë e furishme*)

Është vërtetuar se trajta "d e l e" në Shqip është një shumës i singularizuar dhe se trajta e mirëfilltë ka qenë me " a ", do me thënë "d a l a" (krahaso me Hebraishten "d a l e t h" (דָּלָה) = dele e vogël, **d e l t h e**, shqerrë, Hebrisht "t a l e" (טָלָה) = ingl. *a young lamb* (qingj) dhe "d a l a l" = ingl. *totter, wave, to hang down* etc.). Pra fjala *dallgë* në gjuhën Shqipe lidhet në mënyrë mitike me fjalën *dele*, d.m.th. ato formojnë në këtë vështrim (raport analogjie, korrespondence) një fjalë të vetme.

Duke qenë kështu fjala Turqisht "d o l g a" ka shumë mundësi të jetë marrë (huajtur), si shumë e shumë fjalë të tjera, nga Shqipja dhe jo kurrësi anasjelltas.

** Cirlot, fq.xxxii.*

128) Turq. *d a m g a* = ingl. *stamp, mark* (damka)

Do zbërthyer si:

d a m g a → shq. *d a m k a* = *d ā m*... = ⊕ = *F* = ●

që është pikërisht kuptimi që kjo fjalë ka në Turqisht, do me thënë atë të *d a m k ë s*, të njollës (ingl. *stain*).

129) Turq. *d i ş i* = ingl. *female, she; woman* (femër, ajo; grua)

Lidhet si me *motivuesen* e vet me Shqipen:

d y s h

Edhe kjo sepse *d y s h i* (2) është numuri simbolik i *parimit femëror*, a shkurt i femrës, gruas. Kështu tek Cirlot, lexojmë: "*The HIEROS GAMOS is signified by the number five, since it represents the union of the principle of heaven (three) with that of the 'Magna Mater' (two)...*" (*Hieros Gamos* tre-gohet me numurin pesë, me qenë se paraqet bashkimin e parimit Oiellor (tre) me atë të *Magna Mater* (dy).)

Si edhe: "*[Two] is also symbolic [...] of the moon as opposed to the sun...*" (*Dyshi* gjithashtu simbolizon... Hënën në kundërvënje me Diellin...)

Dhe më tutje: "*...the moon is equated with the symbolism of the number two and with the passive or feminine principle.*" (...Hëna lidhet me simbolizmin e numurit *d y*, si edhe me parimin pasiv apo *femëror*...)*

Në Turqisht **2** është "*i k i*", pra Turqishtja nuk është në gjendje ta motivojë me mjetet e veta leksikore fjalën e saj "*d i s h i*" (femër).

* Shih Cirlot, fq. 233, 232 dhe 216.

130) Gjerm. **W e i b e** = femër, grua

Për motivimin e kësaj fjale kemi:

$$\mathbf{W e i b e} \rightarrow "b e W e i"$$

dhe me Shqipen:

$$\mathbf{b \hat{a} "W"}$$

dhe me qenë se:

$$\mathbf{w \rightarrow b = 2}$$

kemi përfundimisht:

$$\mathbf{b \hat{a} : 2 = 2}$$

Dhe Gjermanishtja pra i "përmbahet", siç shikojmë, Mendimin Mistik, sipas të cilit *parimi femëror* identifikohet me simbolizmen e numurit *dy*.

Në Gjermanisht gjithashtu:

$$\mathbf{z w e i} \text{ (ingl. } two) \rightarrow \mathbf{w e i} \rightarrow \mathbf{w = 2}$$

Kështu *d y s h i (2)* si numur simbolik i *parimit femëror* del dhe nga Gjermanishtja.*

131) Turq. **d u ş m a n** = ingl. *enemy, foe, adversary* (armik, hasëm, kundërshtar)

Motivohet me operatorin "d u ş-", jo i lirë në Turqisht, por i lirë në Shqip si:

$$\mathbf{d y ş = 2}$$

* Një nga mitet kozmogonike, ay i *Hieros Gamos*, na thotë se Bota është krijuar nga një "Martesë e Shenjtë" a, e thënë ndryshe dhe më thjeshtë, nga bashkimi i Qiellit (parimi mashkullor: **3**) dhe Tokës (parimi *femëror*: **2**). Kjo është edhe një nga arsyet themelore që na shtyn ti japim gruas numurin **2**.

Thelbi kuptimor (semantik) i kësaj fjale qëndron tek "d u s-" (numuri 2) dhe kjo sepse dyshi është numuri, ndër të tjera, i armikut *par excellence*, i armikut të Zotit, d.m.th. i Djallit.

Dhe vërtetë, tek Cirlot, lidhur me simbolizmin e dyshit lexojmë, ndër të tjera: *"Two stands for... conflict... contraposition... it is also symbolic of the first nucleus of matter, of nature in opposition to the CREATOR, of moon as opposed to the sun. In all esoteric thought, two is regarded as ominous..."*^{*}

Algoritmi Simbolik jep:

$$2 = -1 = (\rightarrow \neq \leftarrow) \quad \dots(F)$$

dysh mohim urrejtje, armiqësi

Kështu Shqipja e shpie fjalën Turqisht tek d y s h i (2) dhe tek simbolizma e tij që na jep kuptimet e kundërvënies e pra armiqësisë ($\rightarrow \neq \leftarrow$), atë të ligësisë (●), atë të negativitetit (- 1). M.q.s. dyshi (2) simbolizon kundërvënien ndaj Krijuesit e pra Zotit, është e qartë se d y s h i është edhe numuri simbolik i djallit (shejtanit), armikut paradigmatic të Njerëzimit. Dhe këtu kemi edhe një shembull tjetër, ndër të panumërtat, që rikonfermon tezën tonë themelore të emërimit (*denominimit*) në Gjuhë duke ju referuar një modeli paradigmatic primordial dhe superlatif.

Edhe një gjë tjetër:

Rikujtojmë se etimologjizimi i një fjale përfundon vetëm kur ajo përçohet (zakonisht me ndihmën e Shqipes, siç tregojnë shembullat që kemi parashtruar dhe të tjera që do të parashtrojmë), tek një s i m b o l. Del pyetja: *Përse vallë përçimi tek simboli duhet ta përfundojë "Odisenë"*^{**} e etimologjizimit të një fjale?

* Shih Cirlot, fq.232.

** Dhe ajo është vërtetë e tillë në etimologjinë klasike...

Përgjigja është kjo:

Siç lexojmë në librin e Jean Chevalier:

"La logique du symbol c'est la logique du Tiers Inclus."
(Llogjika e simbolit është ajo e të Tretit të Përfshirë.)

Por, siç dimë, llogjika e të Tretit të Përfshirë është llogjika e Zotit të Përfshirë, e Parimit Suprem të Universit, e *"Land of the Dead"*,* e Botës Tjetër, e Mbretërisë Qiellore, e Parajsës. Prandaj pra, simboli atëhere e shpie fjalën për t'u etimologjizuar gjer në *nec plus ultra*, siç është Mbretëria Qiellore për ne të gjithë.

Po ashtu tek Jean Chevalier lexojmë:

"Le symbol abat les murs."
(Simboli shemb muret.)

Pra mund të shkruajmë atëhere:

S i m b o l i = - ⊕ ... (E)

dhe dalim po atje, por me këtë rast del qartë edhe se zbarra (" / ") *"Lacan-iane"* mes *"le Signifiant"* e *"le signifier"* (**S / s**),** shembet, superohet dhe etimologjizimi i një fjale nuk mbetet kurrë përgjysëm, por arrin gjer në fundin e saj të *mbramë*, tek vetë *mbarimi* i gjithshkaje.

132) Turq. **d u ş e m e** = ingl. *floor* (dysHEME)

Theksi semantik në këtë fjalë bie mbi "d u ş-", që nuk është tjetër veçse Shqipja:

d y s h (2)

* Shih edhe pak më poshtë, fq.174, 371 dhe 716.

** Shih edhe fq.1, 139, 142 dhe 562.

Dhe kjo për arsye se, sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$2 = F = \downarrow = \text{poshtë...} = \text{dysHEME...}$$

133) Ingl. *ceiling* = tavan

Kjo fjalë e Inglishtes lidhet me Latinishten "c a e l u m", që nuk është tjetër veçse Shqipja:

q i e l l

Dhe kjo për arsye se: "dysHEMEja" përfaqëson *paradigmatikisht* Tokën, kurse "tavan" përfaqëson *paradigmatikisht* Qiellin.

Qoftë edhe sa për kuriozitet, shtojmë këtu edhe sa vijon:

Në Shqip: "t a b a n" (*dysHEME*) = \downarrow , kurse "t a v a n" (ingl. *ceiling*) = \uparrow .

Këtu kemi një ilustrim të tregimit të dy koncepteve të kundërta, siç është ai i *tavanit* dhe *tabanit* me të njejtën fjalë.

Dhe kjo për arsye se theksi semantik tek të dyja këto fjalë bie tek "t a", duke qenë "b a n" dhe "v a n" të reduktueshme tek Shqipja "b a n" (folja "BAJ").

Në gjuhët e para (si bie fjala në gjuhën Egjyptiane, për të cilën kemi folur dhe gjetiu), kjo ishte një praktikë e përhershme: *Fjala duhej të kënaqte ekuacionin e Qendrës Mistike, d.m.th. (x = -x)*. Një praktikë e tillë e "hyjnizonte" fjalën, jepte të kuptohej se ajo dilte drejt për së drejti nga goja e Zotit.

Kjo lidhet edhe me ato sa lexojmë në Ungjillin e Gjonit: "*Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Zotit, dhe Fjala ishte Zot...*" (Lat. "*In principio erat Verbum et Verbum erat apud Deum et Deus erat Verbum...*")*

* Gjoni (1:1).

134) Turq. **d u ş m e k** = ingl. *to fall* (bie)

"m e k" këtu është një sufiks verbalizonjës, pra theksi semantik bie mbi "d u ş" që nuk është tjetër edhe këtu veçse Shqipja:

d y s h (2)

Dhe kjo sepse:

$$2 = \bullet = \downarrow \text{ (ingl. } to\ fall) \quad \dots(F)$$

Kështu pra Shqipja e shpie fjalën e mësipërme Turqisht tek simbolizma e numurit **d y s h (2)** dhe që andej, për ekuivalencë simbolike, tek simboli " \downarrow " që është ndër të tjera edhe ai i **r ë n i e s** (ingl. *to fall*).

Le të vëmë ré këtu se *dyshi*, duke qenë numuri i *djallit*, është mitikisht krejt e rregullt që të jetë dhe numuri i *rënies*, në mos tjetër, sepse Shejtani (në Hebraisht: "Satana" = *kundërshtari*) dikur kryengjulli i Zotit, me emrin "Luciferus" (*dritëdhënësi*, *dritëprurësi*) pasi ju kundërvu Atij, me gjithë engjujt e tjerë rebelë të kryesuar prej tij.**

Ka dhe shumë fjalë të tjera Turqisht me rrënjën "d u ş" e që pra motivohen duke i shpënë tek Shqipja "d y s h" (2).

Le të përmendim disa prej tyre: "d ü ş ü k" = ingl. *fallen, dropping; unchaste, fallen, loose; miscarriage, abortion* (i rënë; i ulët (p.sh. çmimi); e rënë, e humbur (për një grua); dështim)*** ... "d ü ş ü r m e k"; "d ü ş ü ş";

* Gjë që jepet me simbolin e dyshit, me qenë se:

$$2 = F = (\rightarrow \nleftrightarrow) \text{ (kundërvënie)} = \downarrow \text{ (ramje)}$$

** Shih Cirlot, "Gems".

*** Vëmë ré këtu se edhe fjala Shqipe "d ë s h t i m" lidhet edhe ajo me sim-bolizmën e "d y s h i t" (2). Dhe kjo sepse, siç kemi parë edhe më sipër, kemi:

$$2 = F = \downarrow \text{ (ramje, dështim)}$$

"d ü ş ü m", etj. etj., të gjitha fjalë këto të cilat lidhen në një mënyrë a në një tjetër me "rënien" e pra me simbolizmën e numurit "d y s h" (2).*

135) Rus. *d i s h o v o* (д е ш е в о) = ingl. *low* (i lirë, i ulët, p.sh. një çmim)

Mund të motivohet me Shqipen:

d y s h (2)

me qenë se *siç pamë* edhe më lartë: **2** = ↓ ... (F), dhe ky simbol i fundit mund të interpretohet si "i ulët", e pra për një çmim "i lirë".

136) Turq. *k a b i r* = ingl. *grave, burial, burial place* (varr, varrim, varrezë)

Duhet ndarë në:

k a b i r

ku "k a-" nga folja Shqip "k a m" (ingl. *have*) dhe "-b i r" është Shqipja "b i r a" (v r i m a), e pra simbolikisht:

k a b i r ë = ☉

Le të vëmë ré tani sa vijon:

B i r a (ingl. *hole*) është në të njejtën kohë "pika gjeometrike" dhe simboli "P i" (π) lidhur me domethënien e të cilëve ne këtu detyrohemi të zgjerohemi pak për tu bindur edhe më mirë për saktësinë e motivimit tonë të fjalës Turqisht nëpërmjet Shqipes.

* Vëmë ré këtu se " u " me dy pika mbi (· ·) është dhënë në rrjeshtin e fjalëve të sipërpërmendura me Shqipen " y " sepse pikërisht kështu kjo zanore, d.m.th. " u " me dy pika, shqiptohet në Turqisht (pra: turq. " ü " = shq. " y ").

Sipas mentalitetit primordial a Vizionit (*Weltanschauung*) të lashtë mbi Botën, Qendra është origjina e gjithshkaje dhe, fundja më në fund, vetë Zoti si "*Coincidentia oppositorum*".

Le të lexojmë diçka lidhur me simbolizmën e Qendrës tek Cirlot:

*"To leave the circumference for the Centre is equivalent to moving from the EXTERIOR to the INTERIOR... from SPACE to SPACELESSNESS, from TIME to TIMELESSNESS. In all symbols expressive of the mystic Centre, the intention is to reveal to Man the meaning of the primordial "paradisial state" and to teach him to identify himself with the Supreme Principle of the Universe... Among the Chinese the infinite being is frequently symbolized as a POINT of light... This concept of the Centre coincides, of course, with that of the 'LAND OF THE DEAD'... it expresses the dimension of the 'infinite depth' of space, the SEED of the eternal cycle of the flux and flow of forms and beings..."**

Dhe diçka më në fund lidhur me simbolizmën e v r i m ë s (fq.155):

"...the persistent celestial symbol of the 'hole' in the disc of Chinese jade, represents the concept of the zenith as a void through which

* Cirlot, "*The Centre*" (fq.40): "Të largohesh nga periferia e rrethit me drejtim për nga qendra, është njëlloj si të lëvizësh nga jashtë brënda... nga hapësira tek pahapësira, nga koha tek pakohësia. Të gjitha simbolet shprehëse të Qendrës Mistike priren ti zbulojnë Njeriut kuptimin e "gjendjes parajsore" primordiale si edhe ti mësojnë atij se si të bëhet një me Parimin Suprem të Universit... Ndër kinezët, qënia infinite simbolizohet shpesh si një pikë drite e rrethuar nga rrathë koncentrikë që hapen dora-dorës që largohen prej Tij. Ky përfytyrim i Qendrës përputhet, padyshim, me atë të "Vendit të të Vdekurve" [ingl. *Land of the Dead*]. ajo shpreh dimensionin e "thellësisë infinite" të hapësirës, me fjalë të tjera, farën e ciklit të amshueshëm të ndryshimeve të pareshtura të formave dhe të qenjeve..."

one may pass out of the world of space and time into spacelessness and timelessness..."

Lidhur me simbolizmen e "Pi" (fq.244):

"...More abstract and therefore spirituality superior ways of depicting the 'Centre'... are to be found in China: the HOLE in the middle of the disk of jade known as Pi... where the centre is identified as the non-being of mystic Nothingness..."

Pamë se sipas Mendimit Mitik, Qëndra është "Vendi i të Vdekurve", vendi ku rri Zoti, Bota tjetër... Pamë se ajo ishte një v r i m ë (b i r). Pra atëhere edhe varri (bura, wima) është për a n a l l o g j i Qëndra, Vendi i të Vdekurve, Bota tjetër. Dhe me qenë se G j u h a * i referohet gjithnjë Qendrës dhe ngjarjeve më themelore në të, është e qartë që rituali i funeralit dhe veçanërisht hapja e varrit, futja e të vdekurit në të, duhet të IMITUJË atë që ndodhi në të vërtetë, sipas Mendimit Mitik, në krye të Herës, do me thënë, në krijimin e Botës, kur, sipas mitheve kozmogonike, Hyjnija (një qenje hyjnore) u sakrifikuua dhe u varros. Ky akt KRIJoi Botën, që mbështetet kështu mbi një KRIM. Hyjnija, si një qenje e përsosur dhe infinite, tregohet simbolikisht me " \bigcirc ". Duke u interpretuar si "Zero", ky simbol përbën zgjidhjen e ekuacionit të Qendrës ($x = -x$) e pra dhe Qendrën vetë.

Kemi parë se mund të shkruajmë:**

$$-x = \boxed{x} \quad \dots(F)$$

Me qenë se " x " mund të jetë çfarëdo, mund të marrim: $x = \bigcirc$.

* Sikur tërë Mentaliteti primitif, siç del ndër të tjera nga studimet e Mircea Eliade. (shih edhe fq.82 dhe 471).

** Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

Do të jetë atëhere:

$$- \bigcirc = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

Pra " \bigcirc " (Qëndra, Hyjnia) pas mohimit, sakrifikimit (- \bigcirc) varroset, fshihet, ruhet...*

Me qenë se siç dimë:

$$- \bigcirc = \bullet \quad \dots(F)$$

Ne mund të shkruajmë atëhere:

$$\bullet = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

" \bullet " këtu mund të interpretohet si Hyu "i vdekur", *materia, Bota materiale*.

Që këndej kuptohet se materia dhe Bota materiale, shkurt *jeta*, gjallnija është e mundur vetëm me vdekjen e Hyjnisë.** Po Hyjnija vdes për të krijuar Botën dhe gjallninë në të, por në të njejtën kohë ajo pra është e gjallë, e fshehur, si FRYMË. Dhe këtë tregon pikërisht edhe simboli $\boxed{\bigcirc}$. Kështu dhe Fryma ("shpirti") i të vdekurit nuk vdes, por kallet, fshihet, shkon në qiell.

Le të vëmë ré se në Latinisht:

"*c e l o*" = fsheh, mbaj sekret (ingl. *to hide*, "*c o n c e a l*", *keep secret*...) e njëkohësisht "*c a e l u m*" = greq. "*k i l l o s*" = shq. "*q i e l l i*", si për të dhënë për të kuptuar se *qielli* është vendi i *kaljes*, e i *fshehjes*... Në Italisht "*c i e l o*" (*q i e l l*) dhe "*c e l o*" (*k a l l, fsheh*).***

* Shih tek "*Libri i Aforizmave*" ndër të tjera: "*Shka fshihet veç fshihet*..."

** Shih edhe fq.371.

*** Në Shqip: HYU = Zoti dhe hyu = hyri, u fut brenda...

Gjithashtu në Latinisht: "c e l l a" = Shq. "q e l i".

Edhe Gjermanishtja "H i m m e l" = *qielli* (ingl. *sky*), duke u zbërthyer në:

H i m m e l

nuk është tjetër veçse Shqipja:

"Yll (i) h i m u n"

Shih "Libri i Aforizmave" ku, ndër të tjera, lidhur me këtë çështje gjejmë edhe aforizmin:

"Hyu ai që hyu."

Ky koncept i "Zotit të *himun*", është po ai i "*Deus himmanens*", fjalë që zbërthehet në "h i m m a n e n s" ku "ens, entis" do të thotë "entitet", ndërsa "h i m m a n" është Shqipja "h i m u n".

Shtojmë akoma këtu se janë pozicionet a "hipostazat", siç quhen në gjuhën theollogjike, të Hyjnisë:

T r a s h e n d e n c a

[kur Hyu supozohet jashtë e mbi Botën materiale]

dhe:

H i m a n e n c a

[kur Hyu supozohet brenda Botës materiale]

Algoritmi Simbolik na jep:

● = □ ... (F)

Dhe ky është, për definicion, "*Deus Himmanens*". Këtu " ● " simbolizon Botën materiale.

Këtë përfytyrim të Hyjnisë e gjejmë edhe tek theologu i madh i kohërave tona Teilhard de Chardin kur shkruan:

"*Dans le coeur de la matiere, il y a l'Esprit.*"

Vëmë në dukje se Ylli është njënjësuar në mendimin simbolik e pra mistik, me Qendrën e pra me Zotin (në Hebraisht: "El"). Lexojmë lidhur me këtë tek Cirlot: "*The 'flaming star' is a symbol of the mystic Centre.*"*

Ruajtja e Hyjnisë pas mohimit (sakrifikimit) del automatikisht nga formula e mësipërme ($-x = \boxed{x}$) që mund të interpretohet si shprehje e vetisë integrative të mohimit dialektik,** sipas të cilit entiteti i mohuar ruhet, integrohet.

Ne pamë se Qendra ishte:

b i r (një vrimë)

dhe se ajo ishte:

b u r i m i

i m **b a r ë** Universit

Në Inglisht kjo jepet me thujse-homoniminë "h o l e" (vrimë) dhe "W h o l e" (e tëra, gjithshka, mbarë...).


Kështu Inglishtja do të mund të sajonte dhe ajo një aforizëm që do të tingëllonte bie fjala kështu:

"From the **HOLE**, the **WHOLE**."

e pra:

"Nga **BIRA** e **M-BARA**. Do të kishim atëhere këtë paraqitje simbolike:





* Cirlot (fq.310): '*Ylli i përflakur' është një simbol i Qendrës Mistike...*

** Shih gjithashtu "*Libri i Aforizmave*", fq.41-45.

Kjo është në përputhje të plotë me Algoritmin Simbolik, që jep:

$$(x^2 + y^2 = 0) = (X^2 + Y^2 = \bigcirc)^* \quad \dots(E)$$

Qendra, rrethi me rreze pafundësisht të vogël (Zero) Rrethi me rreze pafundësisht të madhe (infiniti)

ingl. **h o l e** **W h o l e**

shq. **b i r ë** **m b a r ë**

137) Ingl. **b u r i a l** (*burial, buryel, biriel; byrgels < byrgan*) = varros

Nga sa më sipër del se edhe Inglishtja "b u r i a l" lidhet si me motivuesen e saj me Shqipërisë:

b i r a

Ne pamë se Qendra ishte një b r i m ë (ingl. *hole*), një vrimë, një v ë r ë.

Por:

Qendra = Z O T I

Nga ana tjetër:

Z O T I = e Vërteta

* Ekuacioni i dytë është shkruajtur në koordinata homogjene dhe, pos kësaj, lexuesi duhet ta ketë të qartë se simboli " \bigcirc " nuk është vetëm ai i zeros, por edhe ai i të Tërës, edhe ai i Infinitit, siç lexojmë tek Cirlot (fq.123).

$\bigcirc = \text{Infinity, the All, the Universe...}$

Le të shtojmë akoma edhe se ekuacioni i Qendrës Mistike, mbi të cilin ngrihet tërë Algoritmi Simbolik, dhe që shkruhet si "*Coincidentia oppositorum*" si:

$$(x = -x)$$

kënaqet si nga *Zero* (0), ashtu edhe nga *Infiniti* (∞) i cili, ky i fundit, tregohet shpesh në literaturën simbolike me të njejtin simbol të Zeros, do me thënë " \bigcirc ".

Pra atëhere edhe:

v ë r a = e V ë r t e t a

Duke qenë kështu fjala Latinisht "**v e r u m**" = e **v ë r - t e t a** (ingl. *truth*) mund fare mirë to mos jetë tjetër veçse Shqipja "**v ë r a**" (ingl. *hole*).

Ne dimë se Gjuha emërton duke ju referuar Qëndrës e pra, ndër të tjera, sipas një paradigme superlative, absolute, duke dashur të imitojë gjithnjë një model të epërm, hyjnor, që është sipas Gjuhës dhe sipas mentalitetit primordial, mitik (mbi të cilën të gjitha gjuhët ngrihen) i vetmi i vërtetë. Duke vepruar në këtë mënyrë, Gjuha nuk bën tjetër veçse të njejtën gjë që kanë bërë edhe të gjithë popujt e lashtë në kryerjen e akteve më themelore të jetës së tyre shoqërore si, ndër të tjera, dasmat, vallet, ndërtimet, etj., gjithnjë duke i m i t u a r, p ë r s ë r i t u a r një model të epërm.*

Ndonjë shembull do të sqarojë më mirë përse është pikërisht **tjala**.

Le të shqyrtojmë fjalën Shqip "**p a k**". Kjo fjalë tregon një sasi të vogël. Por vogëlsia më e madhe, superlative është ajo e "**P i k ë**"-s,** që është si sasi Zero, Hiç.

"P i – k a" atëhere do të jetë edhe paradigma tek e cila fjala që shpreh "p a k ë – s i n ë" do të referohet. Kështu mund të shkruajmë:

shq. "p a k" < "p i k ë"

Vetë fjala "**p i k ë**" do ndarë në "p i + k a" ku thelbi semantik përbëhet nga "**P i**", ndërsa "**k a**" është vetëm një prapashtesë verbalizonjese që mund të identifikohet mbrenda Shqipes me "**k a**" (folja "k a m"). Rrënja a

* Mund të lexohet me përfitim, ndër të tjera, lidhur me këtë çështje edhe studimi i etnologut, antropologut dhe mitologut të shquar rumun Mircea Eliade, "*L'éternel retour*".

** Shih ndër të tjera edhe fq.173, 330, 501 dhe 685.

operatori i lirë "P i" lidhet me simbolin e rëndësishëm kinez të "Pi"-së për të cilën u fol më sipër dhe që identifikohet me Qendrën, me vrimën, me Hiçin.

Marrim një shembull tjetër.

Na thuhet se në Mendimin Mitik, "Dielli" vështrohet si "Biri" i Qiellit. Pra, duke qenë kështu, Dielli është Djali *par excellence*, modeli i epërm, paradigmatic që duhet imituar. Dhe kjo realizohet në një sërë gjuhësh duke emërtuar "Djalin" me një fjalë homonimike a thujajse-homonimike me "Diellin".* Kështu kemi:

shq. djal	djell
ingl. son	sun
gjerm. Sohn	Sonne
rus. sin	sonce
(сын)	(солнце)

Do të kthehemi me shembulla të shumta e të larmishme mbi këtë çështje më vonë, me qenë se është fjala për një "taktikë" emërtimi (denotimi, denominimi) që gjuha përdor shpesh.

- 138) Ingl. **very**** = 1) *In the fullest sense; complete; absolute;* 2) *the same, identical;* 3) *even, even the...;* 4) *actual;* 5) *(archaic) real; true; genuine* (në kuptimin më të plotë; i plotë; absolut; i njejtë, identik; gjer edhe...; real; (arkaike) i vërtetë, i pastër)

* Shih edhe fq.170.

** Inglishte e mesme, Frengjishte e vjetër: "*vrai*" = ingl. *true*; Latinishte e vonë: "*verius*" < lat. "*verus*" = ingl. *true*.

Është Shqipja:

v ë r ë

Siç shikojmë kjo fjalë ka disa kuptime:

- Atë të "t ë **v ë r t e t ë s**" (lat. *veri-tas*), dhe lidhet atëhere si me motivuesen e vet me Shqipen "**v ë r ë**" (ingl. *hole*).
- Kuptimin e "të plotës", "të absolutit"... dhe lidhet atëhere me Shqipen "m B A R Ë" (= ingl. "wHOLE").
- Kuptimin e "identitetit", të asaj që mbetet gjithnjë *njëlloj*, që nuk ndryshon.
- Kuptimin e diçkaje të shpënë në ekstrem (ingl. *even..*; ital. *perfino*; shq. "deri edhe...").
- Kuptimin e realitetit, e puritetit, etj.

Ne pamë se:

$$\bullet = \bigcirc \quad \dots(E)$$

që nga dalin dhe dy kuptimet themelore të fjalës të Inglishtes "**v e r y**", kuptimi i "përPIKËmërisë" (\bullet) dhe kuptimi i "TËRËsisë" (\bigcirc).

Mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} \bullet &= \bigcirc = (x = -x) = \text{Qëndra} = E = -\sim \text{ (del kështu} \\ &\text{kuptimi "the same, identical...", d.m.th. i diçkaje që nuk ndryshon,} \\ &\text{që mbetet gjithnjë ajo që është)} = -\infty \text{ (del kështu kuptimi i Absolutit)*} \\ &= [\text{Alfa (} \alpha \text{) = Omega (} \omega \text{) }] \text{ (dhe del kështu kuptimi i diçkaje që} \\ &\text{shpihet në ekstrem, m. q.s. Omega jep mistikisht kuptimin e fundit)} \end{aligned}$$

* Fjala "absolut" vjen nga Lat. *Absolutus*, që rrjedh nga folja "a b s o l v e r e"
= liroj, gjej të pafajshëm, zgjidh... e pra atëhere simbolikisht " - ∞ ".

Kështu pra Shqipja, duke e shpënë fjalën Inglishte "v e r y" tek Shqipja "v ë r ë" (ingl. *hole*), e motivon plotësisht atë në të gjitha kuptimet.

Shohim gjithashtu, ndër të tjera, se Turqishtja "kaBIR", Inglishtja "BURy", Latinishtja "VERum", Inglishtja "VERY", Shqipja "BIR", "VARR", "VËRë", "mBARë"... lidhen që të gjitha me të njejtën rrënjë sikundër Shqipja e nxjerr në pah këtë fare qartë.

139) Gjerm. w a h r = ingl. *true* (i, e vërtetë)

Nga sa pamë e shpjeguam lidhur me identitetin simbolik të të VËR-tetës me VRI-mën, del qartë se edhe Gjermanishtes "w a h r" (ingl. *true*) lidhet edhe ajo me Shqipen:

v ë r

Dhe del se ka shumë mundësi që Inglishtja "t r u e" = *i, e vërtetë... të lidhet me Frengjishten "t r o u" = vrimë, vërë.*

Po ashtu edhe Gjermanishtja "t r e u" = besnik, e vërtetë.

140) Turq. d u v a r = ingl. *wall, barrier* (mur, ndarje; barrjer)

Zbërthehet në:

du var

dhe me Shqipen:

DA bër

e pra simbolikisht:

⊕

simbol që mund të interpretohet fare mirë në kuptimin e "ndarjes", e pra të "murit".

141) Gjerm. **W a n d** = ingl. *wall, partition* (mur; ndarje)

Zbërthehet në:

W a n d

dhe me Shqipen:

b â n d à = simb. ⊕

simbol ky që është pikërisht ndër të tjera edhe ai i "ndarjes", i "cakut", i "pengesës", e pra edhe ai i "murit".

142) Ital. **d i v a r i o** = ingl. *gap, difference* (ndarje, mosputhitje)

Është përsëri Shqipja:

d i v a r → shq. **d à b ë r ë** = ⊕

ku: "d i-" = shq. "**d a r ë**" (ingl. *divided*) dhe "-v a r" = shq. "**b ë r ë**".

143) Gjerm. **w a n d e l** = ingl. *change* (ndryshoj)

Zbërthehet në:

w a n d e l

ku:

"**w a**" është Shqipja "**b a (j)**"

"**n d**" është Shqipja "**n d a (j)**"

"**e l**" është Shqipja "**Y l l**" dhe Hebraishtja "**E l**" (ע ל)

Yll dhe *El* kanë kuptimin e Hyjnisë, e pra të Qendrës, e pra mund të jepen simbolikisht me " ⊙ ". Pra tërë fjala Gjermanisht "**w a n d e l**" do të thotë atëhere:

"**b â n d a j** ⊙ "

e pra simb. $\textcircled{1}$, simbol ky që ka pikërisht, ndër të tjera, edhe kuptimin e "ndarjes".

Vërejmë këtu se: "-el" është "EL" (\aleph) në Hebraisht dhe rri për Zotin. Mund të shkruajmë: hebr. "EI" < shq. "YII" ku "yll" (ingl. *star*) lidhet me Qëndrën Mistike, e pra me ($x = -x$) e pra me të Tërën, $\textcircled{0}$.

Le të shpjegojmë tani me ndihmën e Algoritmit Simbolik i cili është gjithnjë, në një mënyrë a në një tjetër, i pranishëm në Gjuhë (në çdo gjuhë) dhe që mund të nxirret i tëri prej saj, se si fjala Gjermanisht që po shqyrtojmë mund të japi kuptimin e ndryshimit.

Kemi:

wa nd el -- shq. $\textcircled{1}$ nd à YII = $\textcircled{1}$ = F = \sim = lëvizje, ndryshim

Rikujtojmë me këtë rast edhe sa vijon:

Në Shqip: "NDARje", simb. $\textcircled{1}$, dhe "NDRyshim", simb. \sim . Të dyja këto fjalë lidhen mbrenda Shqipes, sikundër mund të shihet lehtë, me të njejtën rrënjë a operator të lirë:

ND (R)

Kështu pra Shqipja jep ekuivalencën simbolike:

$$\textcircled{1} = \sim \quad \dots(F)$$

ndarë ndryshim

Si një rikonfirmim të saktësisë të motivimit tonë të Gjermanishtes "w a n d e l, vëmë ré se edhe Italishtja jep këtë ekuivalencë me çiftin thujse-homonimik "metá" (*gjysma*) dhe "moto" (*lëvizje*), e pra:

$$\textcircled{1} = \sim \quad \dots(F)$$

metá moto

Gjithmonë si një *Consensio linguarum* përmendim këtu edhe Inglishten, e cila e jep gjith'po këtë ekuacion p.sh. me "**mutilation**" = *sakatim, gjymtim*, e pra simb. " ⊕ ", dhe "**mutation**" = *ndryshim...*, e pra " ~ ".

Mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{mutilation} & & \text{mutation} \end{array} \quad \dots(F)$$

Le të vëmë ré këtu se në këtë mënyrë, si edhe në shumë mënyra të tjera, Inglishtja shtron këtu mithin kozmogonik të "*dismemberment*" (*çgjymtyrimit, sakatimit*, ⊕), sipas të cilit Bota u krijua dhe lëvizja (~) filloi me vrasjen, dhe më tej çgjymtyrimin, e një Qenieje Hyjnore.^{*}

Shqipja e jep gjith'po këtë ekuacion me: "**thysë**" = " ⊥ ", e pra edhe " ⊕ " (nga folja "thyej") dhe "**kthesë**" = ital. *svolta, cambiamento*, e pra simb. ~ . Vëmë ré këtu se fjala kthesë do ndarë në "k + the s ë", e pra "**ka thysë**".

Ekuacioni që sajohet në këtë mënyrë nga Shqipja është:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{thysë} & & \text{k-thesë} \end{array}$$

Në Rusisht: "dva" (два) = 2, simbol që është i barazvlefshëm me ⊕ ,^{**} si edhe "dvigats" (двигаться) = lëviz, e pra simb. ~ .

* Cirlot, "*Cosmogonic Sacrifice*", fq.64.

** Kujtojmë këtu ndër të tjera Shqipen:

$$\begin{array}{l} \text{"i datë"} \text{ (ingl. } \textit{divided}) = \oplus \\ \text{"i dytë"} \text{ (ingl. } \textit{second}) = 2 \end{array}$$

ose Inglishten:

$$\begin{array}{l} \text{"secant"} \text{ (matematikë: } \textit{sekant}) = \oplus \\ \text{"second (i dyti)"} = 2 \end{array}$$

Duke qenë kështu, ne shohim se Rusishtja shtron të njëjtin ekuacion simbolik:

$$\begin{array}{l} \textcircled{1} = \sim \quad \dots(F) \\ \text{dva} \quad \text{dvi-gats} \\ (\text{два}) \quad (\text{дви-гаться}) \end{array}$$

Pra kemi këtu një "*Consensio linguarum*" që flet për: *Taktika a strategjira semantike (emërtuese, denominuese) analloge mes gjuhërave të ndryshme.*

Vëmë ré se:

$$\text{Qëndra} = \textcircled{0} = -\sim = \text{ nuk lëviz, s'ndryshon}$$

Pra atëhere:

$$\textcircled{1} = -\textcircled{0} = -(-\sim) = \sim = \text{ lëvizje, ndryshim}$$

Pra mund të arrihej edhe kështu në përfundimin e mësipërm, ekuivalencën simbolike:

$$\textcircled{1} = \sim \quad \dots(F)$$

Vijojmë më tej...

Algoritmi Simbolik jep, siç dimë:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

...dhe simboli i fundit është ndër të tjera ai i *materies, i Botës materiale.*

Atëhere do të kemi, duke u mbështetur në sa më sipër:

$$\begin{array}{l} \textcircled{1} = \bullet = \sim \\ (\text{ndarja}) \quad (\text{materia}) \quad (\text{ndryshimi}) \end{array}$$

Barazimi ($2 = \textcircled{1}$) vërtetohet në këtë mënyrë:

Duke qenë: $\textcircled{0} = 1$, do të kemi: $\textcircled{1} = 1/2 = 2 = (4 = 1) = (3 = 0)$
= baza e Arithmetikës Mistike.

Që nga nxirret përfundimi, ndër të tjera, se:

"Materia lëviz, ndryshon."

Gjejmë kështu një lidhje themelore mes *materies* (●) dhe *lëvizjes* (~). Por me qenë se lëvizje do të thotë *energji*, ne gjejmë kështu një lidhje themelore edhe mes *materies* dhe *energjisë*, ne gjejmë shkurt se *materia është energji dhe se energjia është materie*. Duke qenë kështu, ne mund të themi edhe se:

"Materia mund të shndrrohet në energji dhe anasjelltas."

Rigjejmë kështu, thjesht vetëm përmes analizave tona *gjuhësore*, që i shpie fjalët e huaja tek simbolet që ato përshkruajnë (Roli "mesianik" a ndërmyjetësues i Shqipes), një zbulim nga më të rëndësishmit të Fizikës moderne. Dihet botërisht se Einsteini gjeti edhe relacionin *basior* që lidh Energjinë me Materien në kalimin nga njëra madhësi në tjetrën:

* Algoritmi Simbolik na lejon ta deduktojmë këtë formulë themelore të Fizikës (sado e çuditshme që kjo mund të duket) direkt e vetëm nga analiza e Gjuhës.

Dhe ja se si:

Dimë *praninë e Algoritmit Simbolik në Gjuhë*, kjo do të thotë që të gjitha *formulat, ekuacionet e Algoritmit Simbolik mund të nxirren nga Gjuha* dhe mund të tregojmë se si... Algoritmi na jep:

$$E^2 = F$$

" *c* " (shpejtësia *limit* e Dritës) si *kufi* përfshihet në *E*. Atëhere pra, me qenë se $E \supseteq F$, do të kemi edhe $E \supseteq c$.

Nga ana tjetër, dimë se:

$$E^2 = F = \bullet$$

e pra edhe atëhere:

$$E^2 = c^2 = F = m$$

$$E = mc^2$$

Mendojmë se ideja e shndrrimit të materies në energji e ka burimin e saj tek fillosofia e Spinozës, i cili në një nga propozicionet e librit të tij të famshëm "Etika" shkruan se: "*Trupat ndryshojnë nga njëri-tjetri vetëm nga gjendja e qetësisë dhe lëvizjes.*"* Kjo e thënë tej e rëndësishme e Spinozës përkthehet në gjuhën e Algoritmit si:

$$\bullet = \sim \dots(F)$$

trupi, masa lëvizja, shpejtësia

Që këndeje rrjedh se për:

$$\sim > = \bullet >$$

Tani, arsyetojmë kështu: Për njësinë e masës " m ", do të kemi një energji prej: $\epsilon = c^2$. Për " M " masë, do të kemi, në bazë të rregullës së treshit:

$$\epsilon = mc^2$$

Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, në fund të tekstit.

* *Baruch Spinoza* (1632–1677). Fillosof hollandez i shekullit XVII. Vepra e tij më themelore është "*Etika*" (*Ethica: Ordine Geometrico Demonstrata*). Fillosofia e tij ka patur dhe ka një ndikim të madh mbi tërë fillosofinë e kohës sonë.

I frymëzuar së tepërmi nga fillosofia e tij ka qenë, ndër të tjerë, edhe Albert Einstein, babai i Teorisë së Relativitetit. Mund të themi me plot gojë se vizioni mbi botën i Einsteinit dhe ai i Spinozës në vija të trasha përputhen. Puna shkon gjer aty sa ndonjë formulë, aty këtu, e Teorisë së Relativitetit, siç është formula e famshme e shndrrimit të energjisë ($\epsilon = mc^2$) në materie dhe anasjelltas, mund të vështrohet si një transpozicion matematik i propozicioneve të "*Etikës*", dhe kryesisht si i një propozicioni në Pjesën e Dytë të kësaj vepre që flet për "Mendjen" (Pjesa II, Lema I):

"Trupat dallohen nga njëri-tjetri (vetëm) për sa i përket lëvizjes dhe qetësisë, shpejtësisë dhe ngadalësisë, por jo për sa i përket substancës."

gjë që matematikisht jepet me formulën:

$$m_t = m_0 / \sqrt{1 - v^2/c^2}$$

Për të gjetur më tej formulën: $\epsilon = mc^2$, ne mund të arsyetojmë në këtë mënyrë:

Duke e përfunduar këtë vërejtje disi të gjatë, por të rëndësishme, se një pjesë e mirë e formulave të Einsteinit mund të deduktohen me mjete thjesht llogjike, pa ndërhyrjen e parimeve të Fizikës Klasike.

Kjo tregon dhe njëherë ndër të tjera se Einsteinin, një lexues shumë i apasionuar, ka marrë nga Spinoza, qoftë edhe në trajtë reminiscence, idetë më themelore dhe revolucionare të teorisë së tij.

144) **Ingl. to b e n d = përkul**

Mund të motivohet si:

b e n d → shq. b ë n d à

e pra simbolikisht:

$$\textcircled{\text{D}} = \mathbf{F} = -\perp = \perp$$

Kujtojmë këtu se Inglishtja shtron vargun e ekuivalencave simbolike:

$$\textcircled{\text{D}} = \mathfrak{X} = \cap \quad \dots(\text{F})$$

bound bond bend

Le të vëmë ré këtu dhe diçka, ta quajmë kështu, të "kureshtëshme".

Simboli " \mathfrak{X} " mund të interpretohet edhe si "Relativitet" (lat. *relatio* = lidhje).

M.q.s, nga ana tjetër, Gjuha emërton sipas një paradigme primordiale, superlative, siç është ajo e krijimit të Botës, dhe m.q.s. krijimi mitik i Botës është kryer me një bashkim të Hapësirës (S) me Kohën (T), të cilin mund ta shënojmë edhe me " $S + T$ ", që në gjuhën e Teorisë së Relativitetit do të thotë "kontinuumi kohë-hapësirë", atëhere ekuacioni:

$$\infty = \cap \dots(F)$$

mund të shkruhet edhe si:

$$\infty = (S+T) = \cap = F = \bullet = \downarrow$$

Teoria e *Kontinuumi* *përkulja e* *masa* *graviteti*
Relativitetit *Kontinuumit*

Gjetëm kështu, në dimensionin simbolik, pohimin madhor të Teorisë së Relativitetit (∞) sipas të cilit:

"Masa (\bullet) dhe graviteti (\downarrow) shpjegohen me një përkulje (\cap) të kontinuumit kohë-hapësirë ($S + T$)."

Ja pra dhe një moment euristik i Algoritmit Simbolik, i cili lejon kështu ndër të tjera, të bëhen zbulime të rëndësishme në fusha të ndryshme të Dijes si të lashtë, ashtu dhe të kohës sonë.

Do të kemi rast të shohim edhe të tjera ndërhyrje euristike të Algoritmit Simbolik, e pra edhe të Gjuhës, gjersa kjo e fundit mund edhe ta "pjellë" të parin.

145) Ingl. **w a n d e r** = endem, shkoj andej e këndej...

Motivimi me Shqipen:

$$w a n d e r \rightarrow \text{shq. } \mathbf{b \hat{a} n \ d \hat{a} r} = \oplus = F = \sim = \text{endja...}$$

Vëmë ré se edhe Shqipja "e n d e m" shpie prap simbolikisht tek simboli i "d a m j e s" ("n d a r j e s"). Kemi:

$$e n d e m \rightarrow \text{shq. } \hat{a} n d \bar{a} m = \textcircled{\text{1}} = F = \sim$$

Kështu Inglishtja "w a n d e r", Gjermanishtja "w a n d e r n",* Shqipja "e n d e m" lidhen që të gjitha me të njëjtën rrënjë:

$$N D \{ -ar, -am, -an, \dots \}$$

që është një operator i lirë në Shqip, por jo në Gjermanisht dhe as në Inglisht.

146) Ingl. w i n d o w = dritare; një e ndarë, një e hapur në mur a gjetkë...

Ndahet në:

w i n d o w

dhe me Shqipen:

$$b \hat{e} n : D \hat{A} b a = \textcircled{\text{1}} = \square \textcircled{\text{0}} = \blacksquare \dots(F)$$

një e ndarë një e hapur në mur

ku "b a" është folja Shqipe "b a j".

Vëmë ré se për "w"-në fundore në Inglishte mund të thuhet se:

$$-w < -w e n \rightarrow \text{shq. } "b \hat{e} n"$$

Në Gjermanishte prapashtesa verbalizonjëse "b e n" (në Inglisht "w", "w e n"...) është ruajtur në trajtën e mirëfilltë të Shqipes "b ë n".

* Shih edhe më poshtë shënimin mbi Parabolën e djalit plangprishës, fq.208.

Kështu: "s c h r e i - b e n" = shq. "b ë n s h k r u", "s t e r - b e n" (vdes; etimologjikisht: "b ë n s t e r", e pra simb. ●), e kështu me radhë.*

147) Hitit. **k i** = ingl. *this*; ital. *qu-esto* (ky)

Është Shqipja:

ky

Vëmë ré me këtë rast se ka mundësi që edhe Italishtja "q u e s t o" = "qu + esto" = shq. "k y ë s h t ë".

148) Hitit. **k e t i** = gjerm. *diesem*

Është Shqipja:

këti

149) Asir. **b ū r u** = ingl. *pit, hole, well* (birë, pus)

Është Shqipja:

birë

(vërë, vrimë, etj.)

150) Asir. **b ũ r u** = gjerm. *Kind, Son...* (biri, djali)

Është Shqipja:

biri

Me qenë se "b i r i" është "i b ë r i" dhe me qenë se folja "b ë j", "b ë r i",... është kaq produktive në Shqip, por jo aq në gjuhën Asiriane, ne mund të

* Shih edhe fq.35 dhe 313.

themi se Asirishtja, një gjuhë e stërlashtë, e ka huar këtë rrënjë nga Shqipja, në një kohë kur ajo si gjuhë njihej me një tjetër emër (si bie fjala "Pellazgjishte").

Vëmë ré këtu se kjo fjalë e Asirishtes është paralele me Hebraishten "b e n" me të njejtin kuptim. Por edhe kjo fjalë Hebraishte mund të "reduktohet" tek rrënja Shqipe "b a n", "b ë n", "b e n" (ingl. *to do*, fr. *faire*).

Kështu Shqipja shpjegon fare mirë si Asirishten "b ũ r u" (folja shq. "b ë r"), ashtu edhe Hebraishten "b e n" (folja shq. "b â n", "b ë n")

Vëmë ré se gjithashtu se në Asirishten e lashtë hasim edhe trajtën "b î r u" gjithpò me atë kuptim.

Vëmë ré së fundi se fjala "b i r" në Shqip do lidhur edhe me "m-b i r". Me fjalë të tjera "b i r i" do vështruar si "i b ë r i" dhe si "i m-b i r i". Në Shqip edhe "m-b i j" dhe "b i j-t ë". Është fjala pra në të gjitha këto raste për të njejtën rrënjë.

Kështu shpjegohet edhe përse fjala "b ũ r u" në Asirishte ka dhe kuptimin e "filizës", të së "m b i r ë s"...

151) Asir. d ũ r u = gjerm. *Mauer* (mur)

Me qenë se "muri" është një strukturë "ndarëse" e pra simb. ⊕, kjo fjalë Asirishte motivohet nga Shqipja:

d ā r

(nga folja "daj")

152) Asir. d u r u s s u = gjerm. *Grund, Fundament* (themel)

Edhe Asirishtja "d u r u s s u" lidhet siç shihet me rrënjën "d u r u" e pra me Shqipen:

d ā r = simb. (|)

Ne dimë, nga njohja e thellë e Mendimit Mitik, se asgjë nuk mund të krijohet pa një **n d a r j e**. Kjo ndarje përbën pra "themelin" për krijimin e gjithshkaje. Është rasti të kujtojmë këtu prap e prap Paracelsusin: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang".

Algoritmi Simbolik jep:

$$\text{n d a r j e} = \textcircled{\ominus} = \bullet = \text{materie, Realiteti material}$$

Në Shqip fjala "t h e m e l" zberthet në "t h e m + e l" ku "El" është "Zoti" (e pra simb. $\textcircled{\ominus}$) dhe "them", nga ana tjetër, është "thym". Pra tërë fjala "t h e m e l" do të thotë "t h y m E L", "Zoti i ndarë", "Zoti i sakrifikuar", "Zoti kurban". Edhe vetë fjala Latine "f o n d a r e" do lexuar etimologjikisht si "b ë n d a r ë", e pra simb. $\textcircled{\ominus}$.*

153) **Asir. a d û** = gjerm. *Festsetzung, Bestimmung* (përcaktim, caktim, vendim)

Kuptohet qartë atëhere se kjo fjalë duhet të përshkruajë simbolin " $\textcircled{\ominus}$ ", që është ndër të tjera edhe ai i "ndarjes", i "cakut", i "për-CAK-timit" etj.

Kjo fjalë Asirishte nuk është tjetër veçse Shqipja:

â d à
(âsht dà)

Përfitojmë nga rasti për të etimologjizuar këtu edhe Gjermanishten "**B e s t i m m u n g**", dhe me Shqipen:

$$\text{b e s t i m m u n g} \rightarrow \text{shq. b ë s h t i m u n} = \textcircled{\ominus} = F = \textcircled{\ominus} = \text{përcaktim}$$

* Shih edhe fq.150, 154 dhe 400.

154) Greq. **anthropos** (άνθρωπος) = ingl. *man* (*human*) (njeri)

Motivimi bëhet me Shqipen në këtë mënyrë:

$$\begin{aligned} a n t h r o p o s &\rightarrow \text{shq. } \hat{a} n d \bar{a} r \dots = \textcircled{1} = F = 1/2 = 0.5 \\ &= 5 = \text{numuri simbolik i Njeriut}^* \end{aligned}$$

"-p o s" është një sufiks që nuk lot rol në kuptimin etimologjik të fjalës.

155) Greq. **andras** (άνδρας) = ingl. *man* (burrë)

Motivimi jep:

$$a n d r - a s \rightarrow \text{shq. } \hat{a} n d \bar{a} r \dots = \textcircled{1} = F = 1/2 = 0.5 = 5$$

Gjejmë simbolikisht të njejtin numur: p e s ë n (5)... Dhe kjo sepse burri (greq. "a n d r a s"), sipas mentalitetit të lashtësisë, ishte n j e r i u i v ë r t e t ë , n j e r i u *par excellence*, prototipik.

156) Greq. **pas** (πάς) = ingl. *all* (të gjitha, gjithshka)

Ne mund të vërtetojmë se kjo fjalë e Greqishtes shpjegohet, motivohet nëpërmjet Shqipes:

$$p e s = 5$$

* Sikurse lexojmë shprehimisht tek Cirlot (fq.270), p e s a (5) është bash numuri simbolik i Njeriut pas rënies.

Si "*Consensus linguarum*", citojmë këtu edhe Latinishten:

$$"h o m o" = n j e r i$$

që lidhet brenda po kësaj gjuhe me fjalën:

$$"h e m i" = g j y s ë m = 1/2 = 0.5 = 5$$

Edhe kjo për arsye se numuri p e s ë (5), në Mendimin Mitik, sikundër lexojmë tek Cirlot, simbolizon ndër të tjera "tërësinë e sendeve materiale" (●):

*"...the quinary is symbolic of the whole of the material world...
The following groups (among others) are based upon the quinary 'model':
the five planets..., the five elemental forms..., the five colours...,
the five musical timbres..., the five essential landscapes..."**

Kështu Greqishtja ka patur parasysh pikërisht modelin e "p e s ë s" kur ka afruar fjalët "p e n d e" (πέντε) = pesë (5) dhe "p a n d a" (πάντα) = të gjitha.**

Në qoftë se tërësinë e Botës materiale e tregojmë me " ● ", ne shikojmë se Greqishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccccccc} 5 & = & \bullet & & \dots(F) \\ p e n d e & & p a n d a & & \end{array}$$

Por Greqishtja nuk është në gjendje të motivojë fjalën e saj "p a s a" që, siç del nga sa më sipër, mund të motivohet vetëm me Shqipen "p e s ë". Pra dhe mund të shkruajmë:

$$\text{greq. p a s a} \rightarrow \text{shq. p e s ë} = 5 = \bullet \dots(F)$$

* Cirlot, fq.271.

** Me këtë rast, vëmë ré se këtu se zbërthehen me Shqipen edhe këto fjalë të Greqishtes:

$$p e n d e \rightarrow \text{shq. b â n d à} = \textcircled{1} = F = 2 = 1/2 = 5$$

dhe:

$$p a n d a \rightarrow \text{shq. b â n d à} = \textcircled{1} = F = 1/2 = 0.5 = 5 = \bullet$$

Siç shihet, ajo që Greqishtja ["panda"] quan "e tëra" etj., duke u simbolizuar me " Ⓛ ", flet vetëm për "gjysmën e të tërës" (gjysmën e " ○ "), e pra për të "tërën materiale" (● = Ⓛ). (shih edhe fq.206, 625 dhe 63)

157) **Greg. p s e u d o** ($\psi \epsilon \upsilon \delta \omicron$) = ingl. *pseudo, false* (jo i vërtetë, i rremë, fallco)

Theksi semantik këtu bie tek "p s", që lidhet si me prejardhjen e vet me Shqipen:

p e s ë (5)

dhe kjo për arsye sepse kemi:*

$$5 = -1 \quad \dots(F)$$

Duke marrë:

$$1 = e \text{ Vërteta}$$

del qartë që:

$$5 = \text{"jo e Vërteta", gënjeshtër, rrena, fallsiteti}$$

e kështu me radhë...

Në zgjerim të Bisedës kujtojmë se:

$$5 = \textcircled{1} = \bullet = -1 = -\textcircled{0} = -(x = -x) = (x = x)$$

Shohim pra ndër të tjera se si 5 është edhe numuri i Arsyës, i identitetit formal.

Por, nga ana tjetër, dimë se: 5 = numuri i Njeriut.

Mund të shkruajmë atëherë se:

$$\begin{array}{rcc}
 5 & = & (x = x) \quad \dots(F) \\
 \text{Njeriu} & & \text{Arsyeja} \\
 & & \text{(llogjika aristoteliane)}
 \end{array}$$

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.847.

Kjo do të thotë se tërë kodi F është "njerëzor", vlen, me fjalë të tjera, vetëm për mendjen njerëzore. Prandaj i tërë informacioni që nxirret nga kodi F ka një karakter ngushtësisht anthropologjik. Ky do të që, në një këndvështrim shumë të gjerë dhe përfshirës, parimi i mistershëm "antropik" për të cilin na flet, deri diku tërthorazi, Fizika Moderne.*

Por krahas llogjikës formale a aristoteliane, e pra njerëzore, ekziston edhe një llogjikë tjetër, ajo e kodit $E = (x = -x)$, ajo e Qendrës Mistike, ajo e Parimit Suprem të Universit,** që është e kundërta e llogjikës njerëzore a formale, me qenë se siç dimë:

$$(x = -x) = -(x = x)$$

Dhe mund të shkruajmë:

$$(x = -x) = E = -\textcircled{1} = \textit{Parimi i papërcaktueshmërisë...}$$

që përbën themelin e Fizikës Kuantike...

Pra atëhere del vetvetiu se:

"Fizika Kuantike vepron me një Logos Hyjnor."

E pra ajo si e tillë është absolutisht e vërtetë, e pakundërshtueshme dhe e përjetshme. Ajo nuk merret me fenomenin (dukurinë), por me vetë Realitetin e mbramë ashtu sikundër ai është në vetvete (gjerm. *an sich*).

* Ideja mbi të cilat mbështetet në vijat e saja më të përgjithshme hipoteza e "The Anthropic Cosmological Principle" është ajo e një "marrëveshjeje" të heshtur, të çuditshme, por të përpiktë, midis ngjarjeve në Univers dhe Ndërgjegjes njerëzore.

Shih lidhur me këtë çështje edhe shënimet në këtë Studim mbi Wheeler, Eliade, Hermes Trismegistus, Spinoza, Hegel, Schopenhauer...

** Shih ndër të tjera fq.174, 175.

158) Rus. **Bjes** (б е с) = djall, demon, e pra simb. ● .

Është e qartë se edhe këtu motivimi mund të bëhet me Shqipen:

$$p e s ë = 5$$

Dhe kjo, ndër të tjera, sepse në Shqip:

$$\begin{aligned} p e s ë (5) &= p a s (2) = p j e s ë (\oplus) \\ &= p o s ë (-1) = p i s (\bullet) \end{aligned}$$

dhe dimë se:

$$5 = 2 = \oplus = -1 = \bullet \dots(F)$$

Le të rikujtojmë vetpërcaktimin e Mefistofelit tek "Fausti" e Goethes:

*"Ich bin der Geist der stets verneint (- 1)...
Ich bin ein Teil (\oplus) des Teiles,
Der in Anfang (1) ein Ganzes (\bigcirc) war..."*

*(Unë jam Fryma që parreshtur mohon...
...Unë jam një pjesë e asaj pjese
Që në fillim një e Tërë ish...)*

Pra:

$$në\ fillim\ (pa\ fillim,\ para\ fillimit...) = 1 , \bigcirc$$

dhe më pas:

$$pas\ fillimit = \oplus\ (gjerm.\ ein\ Teil)$$

Dhe më tej:

*"...Alles was sie B ö s e (\bullet) nennt
Ist mein eigentliches Element..."*
*(...Gjithshka ju quani e Keqja
Është bash thelbi im...)*

Prandaj, duke përmbledhur do të kemi:

$$\text{Mefistofeli : } -1 = \textcircled{\ominus} = \bullet \dots(F)$$

Shikojmë pra se numurat simbolikë (atributet) e Mefistofelit (djallit, rus. *bjes*) përputhen me ato të simbolizmës së numurit 5. Oë këndej, duke patur parasysh dhe thujse-homoniminë: rus. **b j e s** (**6 e c**) = shq. **p e s**, ne mund të përfundojmë "me zemër të lehtë" se 5 është bash numuri i largqoftit...

Do të shikojmë dhe rikonferma të tjera të kësaj, ta quajmë, "hipoteze".

Shtojmë këtu edhe se Gjermanishtja "b ö s e" = *i keq, i lig*... mund të shpjegohet fare mirë me Shqipen "p e s ë" (5). Dhe kuptohet lehtë gjithashtu se "b ö s e" e Gjermanishtes dhe "b j e s" e Rusishtes janë e njejta fjalë, e marrë në dy kuptime lehtës të ndryshme.*

159) Rus. **b j e z** (**6 e z**) = ingl. *without*, gjerm. *ohne* (pa)...

Fjala Rusishte "b j e z" lidhet, si me motivuesen e vet, me Shqipen:

$$\text{p e s (5)}^{**}$$

* Kujtojmë se në Shqip: "i l i g" = *i keq* (gjerm. *böse*), ndërsa, gjithnjë në Shqip: "i L i g u" = *djalli* (rus. *Bjes*).

** Teksti i cituar thotë se... në krye që një e Tërë, e pra simbolikisht:

$$\text{"Në krye që } \bigcirc \dots \text{ e pastaj erdhi } \textcircled{\ominus} \text{."}$$

Me qenë se:

$$\bigcirc = 1 \quad \text{dhe} \quad \textcircled{\ominus} = 1/2 = 2$$

është njëlloj edhe si të thuash se në krye ishte 1 dhe pas-taj erdhi 2 .

Vërejmë me këtë rast se Rusishtja "b j e s" (*demon, djall*, simb. ●) dhe "b j e z" (shq. *pa*, frengj. *pas*, simb. -1) janë simbolikisht e njëjta fjalë.

Dhe është prap, në të dy rastet, Shqipja "p e s" (5).

Rusishtja pozon kështu ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{rcc} \bullet & = & -1 \quad \dots(F) \\ \mathbf{Bjes} & & \mathbf{bjez} \\ (\mathbf{Бес}) & & (\mathbf{Без}) \end{array}$$

Rikujtojmë se në Shqip:

$$\mathbf{pes(5) = pis(\bullet) = pas(2) = pos\ddot{o}(-1)}$$

Në Frengjisht:

$$\mathbf{puis(2) = pas(-1) = pis(\bullet)}$$

Nga sa më sipër kuptohet vetvetiu se dhe këto fjalë të Frengjishtes lidhen, si me motivuesen e tyre, me Shqipen "p e s".

Me qenë se (2 = 5), siç pamë, ne mund të shkruajmë:

$$\mathbf{pas = 2 = 5 = pes}$$

Kështu "p a s" dhe "p e s" lidhen me të njëjtën rrënjë dhe me dy simbole ekuivalente (2 = 5).

Me qenë se:

$$\mathbf{2 = -1}$$

ne shohim se duhet të kemi edhe:

$$\mathbf{5 = -1}$$

...ajo që dhe duhej vërtetuar.

160) Rus. **v e z d è** (**Б е з д е**) = kudo

161) Rus. **v j e s** (**Б с е**) = gjithshka, krejt

Me gërmat cirilike shihet qartë që Rusishtja " **Б** " nuk është tjetër veçse Shqipja " **5** ".

Nga ana tjetër **p e s a** (**5**) është numuri simbolik i *tërësisë materiale*.^{*} Kjo është edhe një nga arsyet pse Greqishtja " **p a s** " (πας) = *e tëra, të gjitha*, nuk është veçse Shqipja " **p e s ë** " (**5**).

Po në Greqisht edhe: " **p e n d e** " (πέντε) = **5**, ndërsa " **p a n d a** " (πάντα) = *të gjitha*. **Ndaj pra** mund të themi se Greqishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc}
 5 & = & \bullet \quad \dots(F) \\
 \text{p e n d e} & & \text{p a n d a} \\
 (\text{shq. p e s}) & & (\text{greq. p a s a})
 \end{array}$$

Mund të vështrohen si rikonfirmime të sa parashtruam më sipër edhe këto:

Në Rusisht:

" **p j a t** " (пять) = **5**

" **p j a t n ò** " (пятно) = njollë, simb. **●**

Në Shqip:

" **p e s** " = **5**

" **p i s** " = **●**

Në Rusisht:

" **o p j a t** " (опять) = përsëri, **2**

në Shqip:

" **p a s** " = **2**

* Shiko edhe fq.44.

Në Rusisht:

"**B j e s**" (б е с) = djall, ●

në Shqip:

"**p i s**" = ●

Tek "*Fausti*" i Goethes, sikurse cituam pak më lartë, Mefistofeli vetpërcaktohet ndër të tjera si:

"...*Alles was Sie der Böse (●) nennt
Ist mein eigentliches Element...*"

(...*Gjithshka ju quani e Keqja
Është bash thelbi im...*)

Prandaj mund të shkruajmë:

● = rus. **B j e s** (djall) = gjerm. **B ö s e** (e keqja) = ...

Duke u kthyer tani tek etimologjizimi i Rusishtes "**v e z d e**" (В е з д е) do të kemi: "**v e z-**" = shq. "**p e s**", ndërsa "**-d e**" = shq. "**d h è**". Prandaj duke përfunduar:

v j e z d è → shq. **p e s d h è**

162) Rus. **v j e s** (в е с) = ingl. *weight* (peshë), e pra simb. ↓

Është prap Shqipja:

p e s ë

për arsye që kuptohen lehtë, ndër tjera nga ekuivalenca simbolike:

5 = ↓ ... (F)

shq. **p e s** rus. **v j e s**

shq. **p e s** shq. **p e s h è**

Para se të vijojmë më tej, vëmë re se kalimi nga Shqipja "p e s ë" në Rusishten "v j e s" është i lehtë e i natyrshëm, me qenë se "p" dhe "v" janë që të dyja buzore (labiale), gjysëm-buzore "v" dhe dybuzore "p".

163) Shq. **p a s** = ingl. *after*, fr. *puis*

Le të vërtetojmë tani se "**p a s**" (2) dhe "**p e s ë**" (5) në Shqip janë e njëjta fjalë, me dy kuptime konceptualisht të ndryshme.

Për të vërtetuar këtë duhet të demonstrojmë barazimin mistik:

$$\begin{array}{ccc} 5 & = & 2 & \dots(F) \\ \mathbf{p e s} & & \mathbf{p a s} & \end{array}$$

Ky barazim "absurd" vërtetohet nëpërmjet Arithmetikës Mistike që pozon:

$$\mathbf{9 = 0}$$

me të gjitha implikimet që këndeje pasojnë.

Sipas Arithmetikës Mistike numurat mund të rrjeshtohen në këtë mënyrë:

$$\begin{array}{cccccccc} \mathbf{0} & , & \mathbf{1} & , & \mathbf{2} & , & \mathbf{3} & , & \mathbf{4} & , & \mathbf{5} & , & \mathbf{6} & , & \mathbf{7} & , & \mathbf{8} \\ \mathbf{9} & \mathbf{10} & \mathbf{11} & \mathbf{12} & \mathbf{13} & \mathbf{14} & \mathbf{15} & \mathbf{16} & \mathbf{17} \\ \mathbf{18} & \mathbf{19} & \mathbf{20} & \mathbf{21} & \mathbf{22} & \mathbf{23} & \mathbf{24} & \mathbf{25} & \mathbf{26} \\ & & \dots & & \dots & & \dots & & \dots & & \dots & & \dots & & \dots & & \dots \end{array}$$

Numurat që ndodhen në të njëjtën kollonë vështrohen si të barabartë, për arsye të "mbledhjes mistike", do me thënë të pozimit: ($\mathbf{9 = 0}$). Kështu për shembull: $\mathbf{22 = 18 + 4 = 9 + 9 + 4 = 0 + 0 + 4 = 4}$.

Në rastin tonë kemi:

$$(\mathbf{5 = 2}) \rightarrow (\mathbf{5 - 2 = 0}) = (\mathbf{3 = 0})$$

*As Schneider has observed, the eternal duality of Nature means that no phenomenon can ever represent a complete reality, but only one half of a reality..."**

(...Misteri i dualitetit, që përbën rrënjën e çdo veprimi, na shfaqet në çdo kundërvënie forcash, qoftë hapësinor, qoftë fizik, apo qoftë fundja spiritual. Kundërvënira primordiale e qiellit me tokën interpretohet në pjesën më të madhe të traditave si një përfytyrim i kundërvënies zanafillore, si thelbi binar i jetës.

Sikundër Shnajder vë re: dualiteti i përjetshëm i atyrës na jep të kuptojmë *se asnjë fenomen nuk mund të paraqesë një realitet të plotë, por vetëm një gjysëm realiteti...*)

Dimë që " \bigcirc " përfaqëson "të Tërën", mund të shkruajmë simbolikisht:

$$\bigcirc / 2 = \text{"half of complete Reality"...} = 1/2$$

Ekuacioni:

$$\bullet = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

që ne përfuam këtu përmes Shqipes "p i s" (\bullet) dhe "p j e s ë" ($\textcircled{1}$) ka një sërë interpretimesh të rëndësishme që lidhen me fusha të ndryshme të Realitetit, për të cilat do të kemi sigurisht rastin të flasim më vonë...

Një nga këto është:

"Bota materiale (\bullet) nuk është e plotë, ajo nuk është e Tëra ($-\bigcirc$), po një pjesë, gjysma e të Tërës ($\textcircled{1}$)."

* Cirlot, fq.24.

** Ekuacioni ($\bigcirc = 1$) pozohet nga Shqipja edhe me: "krejt" = "kreu".

164) Ital. **p e s o** = ingl. *weight* (peshë, rëndesë)

Italishtja "p e s o" motivohet edhe ajo me Shqipen:

p e s h ë = simb. ↓

e pra përfundimisht:

p e s ë (5)

165) Lat. **d a m n u s** = ingl. *damage* (dëm)

Edhe fjala Latinishte "d a m n u s", që do të thotë "d ā m", nuk është tjetër veçse Shqipja "d a m u n" (folja "DAJ"), e pra simbolikisht:

d a m n - u s → shq. **d ā m u n**... = ⊕ = F = ●

166) Ital. **d è m o n e** = ingl. *demon, devil* (djalli)

Me Shqipen:

i d a m u n i = ⊕ = F = ●

Një shpjegim këtu është i nevojshëm: *Demoni* (djalli) është jo vetëm për definicion, por "historikisht", "theologjikisht", ai që u *nda* ("i *damuni*") nga Zoti (⊕) dhe që ju kundërvu Atij dhe e mohoi (- ○).⁴

* Duket se edhe parabola e djalit plangprishës në Ungjill (Lluka, 15) aludon tek e njejta situatë, që u bë shkas për krijimin e Botës, për *n d a r j e n* (⊕) (këtu) të Birit nga Ati. Përmbajtja e parabolës, shkurtimisht, është kjo:

Biri, duke iu drejtuar të Atit, i thotë: "*Nëm o At p j e s ë n që më përket.*" Dhe pas asaj, ai niset dhe kërkon një fat më të mirë për veten e tij, por mjerisht bëhet fatkeq. Pra dhe vendos të kthehet tek i Ati, të ribashkohet me të...

Kështu, skematikisht dhe simbolikisht ne mund të shkruajmë:

para ndarjes... ○ ... (E)

pas ndarjes... ⊕ ... (F)

Por ne dimë se:

⊕ = -1 = ● ... (F)
 ndarja fillimi Bota

Djali, pas ndarjes, pas dallimit nga i Ati, pas daljes nga shtëpia Atnore, bëhet *Djall*. Dhe si i tillë ai krijon Botën.

Që Bota mund të krijohet vetëm me një ndarje të së Tërës, këtë e gjejmë edhe në Rusisht, ku:

"*d e l i t s*" (делить) = ndaj = ⊕

ndërsa:

"*d e l a t s*" (делать) = bëj = ●

Pra edhe këtu, si në të gjitha mithet kozmogonike, kalohet nga kodi E në kodin F. Kemi pra dhe këtu skemën e përgjithshme të të gjitha miteve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

formulë kjo që tregon gjithashtu edhe se krijimi i Botës duhet vështruar si një rënie (lat. *decadentia*).

Të njejtën gjë ne e gjejmë edhe tek "*Fausti*" i Goethes, ku Mefistofeli (Djalli) thotë për veten e tij:

*"Ich bin ein Teil des Teiles,
 Der in Anfang ein Ganzes war..."*

(Unë jam një pjesë e pjesës,
 Që në fillim një e Tërë ish...)

Pra, dhe këtu na jipet të kuptojmë se para krijimit të Botës kemi patur të Tërën (simbolikisht: ○), dhe më pas pjesëtimin (⊕) e të Tërës dhe

krijimin pra të Botës ($\oplus = \bullet$). Kemi kështu edhe këtu të njejtin *mith kozmogonik*:

$$E(\bigcirc) \downarrow = F(\oplus) = \bullet$$

Ai që e *pjesëton* më *pas* të Tërën është vetë Mefistofeli (si në parabolën e djalit plangprishës: *Djali* që pas dallimit u bë *Djall*), shpirti i mohimit:

*"Ich bin der Geist
Der stets verneint..."*
(Unë jam Fryma
Që pa rreshtur mohon...)

Dhe mohimi i tij i parë është ai që i bëri Zotit, të Tërës, e pra " - \bigcirc ", duke krijuar me këtë veprim Botën materiale.

Dhe më në fund, këto të gjitha që pamë dhe shpjeguam më *lartë*, na japin mundësinë të formulojmë edhe një aforizëm të tillë:

"Nga mohu, mehja."

simbolikisht:

$$- \bigcirc = \bigcirc < \dots(F)$$

Shtojmë këtu edhe që krijimi i Botës (- $\bigcirc = \bullet$) lidhet me një zvogëlim (<) siç kemi vënë në dukje edhe gjetiu

Edhe mistikët Hebrëj kanë menduar se Bota është krijuar me një zvogëlim, që ata e quajnë "*Tzimtzum*" (ז צ מ צ ר ם), ose edhe "kontraktim", tkurrje, ose edhe fshehje. Me fjalë të tjera, Zoti (Hebraisht: "*Ein-Sof*" (א י נ ס ו פ) = i pafundmi, infiniti) nuk mund ta krijojë Botën me infinitetin e Tij. Duhet ta zvogëlojë pra *infinitin* dhe ky është pikërisht atëhere pra *kontraktimi* që Ai i bën vetes.

Simbolikisht, me Algoritmin tonë kjo situatë do të jepej kështu:

$$\boxed{\bigcirc} = \oplus = \bullet \dots(F)$$

"*Tzimtzum*", tkurrje mehja krijimi i
("kontraktim" i Zotit) (diferencimi) Botës materiale

167) Ital. **d a n n o** = ingl. *damage* (dām)

Mund të shkruajmë:

d a n n o < shq. **d a m u n** → **d e m o n i** = ⊕ = ●

Po këtu lidhet edhe Frengjishtja "**d o m m a g e**", gjithnjë në kuptimin e "**d ë m i t**".

Një sqarim:

Siç do të shohim me shembulla të shumta më vonë:

*Gjuha emërton sipas një paradigme superlative,
zanafillore, themelore.*

Në rastin **tonë**, pyetjes: *Cili është dëmi më i madh?* Është e natyrshme ti përgjigjemi: **A!** që na vjen nga Demoni, nga djalli. Që këndeje atëhere edhe fjala: "**d a m**" (ital. "**d a n n o**"), që lidhet pra kështu si me prejardhjen e saj me fjalën "**d e m o n**" (nga Shqipja "**i d a m u n i**", "**i d a m i**", nënkuptohet nga Zoti...), simbolikisht:

⊕ = ● = ↓ ... (F)

Le të shtojmë këtu se, duke qenë ky në një farë mënyre ekuacioni simbolik i Djallit, del vetvetiu se kodi F është djallëzor, sikundër që ne dhe e kemi parë. Pra duhet thënë kështu:

E = **Z O T I** = - ⊕ = ○

F = **D j a l l i** = ⊕ = - ○

Lidhur me krijimin e Botës përmes një zvogëlimi të Hyjnisë, shih edhe Cirlot (*Cosmogony*), fq.64.

* Shih lidhur me këtë fq.242.

Po të marrim parasysh se " - ⊕ " mund të interpretohet edhe si *papërcaktueshmëri*, si *Parimi i papërcaktueshmërisë i Fizikës Kuantike* dhe *vetë kjo Fizikë*, ne nxjerrim krejt të sigurtë përfundimin se:

$$\text{Fizika Klasike} = F = \text{fizika e djallit}$$

$$\text{Fizika Kuantike} = E = \text{fizika e Zotit}$$

Që Fizika Klasike është fizika e djallit del më thjeshtë duke arsyetur dhe kështu:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Klasike} &= \text{Parimi i determinimit} = \oplus = \bullet = (x = x) \\ &= -(x = -x) = - \text{Qendra Mistike} = - \text{Fryma e Shenjtë} = \text{djalli} \end{aligned}$$

168) Ingl. *to condemn* = dënoj

Theksi semantik bie mbi "-d e m n" dhe me Shqipen kemi:

$$d e m n < \text{shq. } d a m u n = F = \oplus = -1 = \bullet = \times = \square = \dots$$

Kështu pra "i **d ë n u a r i**" (ingl. *the condemned*) ndahet nga bashkësia, nga tërësia (⊕), mohohet (-1), vihet në një vend të errët (●), lidhet (i vihen prangat) (×), burgoset (□), vërvitet poshtë në një rast ekstrem (↓), për një faj të rëndë, nga gremina... e kështu me radhë. Zbatohen shkurt mbi të, të interpretuara në mënyrë të përshtatshme, të gjitha figurat simbolike të kodit F që është ndër të tjera ai i të keqes: $F = \bullet$.*

Do të kthehemi përsëri, me zgjerime të tjera dhe më të thella e universale mbi këtë çështje.

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

169) Ital. **condannare** = dënoj

Theksi semantik bie mbi "-d a n n a r e".

Dhe atëhere, me Shqipen:

$$d a m u n = \textcircled{1} = F = \bullet = \dots$$

Vëmë ré se kalimi nga Shqipja "d a m u n" në Italishten "d a n n a r e" është bërë me një asimilim progresif [*mun* → *nn*].

170) Lat. **damnare** (**condemnare**) = dënoj

Le të ndalemi një çast këtu.

Është e kuptueshme që ai që bën "d ë m i n" (lat. **d a m n u s**) të "d ë n o h e t" (lat. **d a m n a r e**). Kjo është pra dhe arsyeja që Latinishtja, ashtu dhe gjuhë të tjera, siç do të shohim, përdorin të njejtën rrënjë "d a m n" (me diferencime a modifikime të lehta si: ital. DANNo, DANNare, conDANNare; ingl. DAMAge, DAMN, conDEMn; frengj. DOMMAge = shq. DËNoj...).

Të gjitha këto fjalë pra lidhen, si me motivuesen e tyre, me Shqipen:

d a m u n

Me qenë se *d e m o n i* është djalli, ai që u nda nga Zoti, *i n d a m u n i* i parë nga Zoti, ai që i pari bani këtë *d a m* të madh, e u mallkue (ital. *dannare*; ingl. *damn...*), u *d ë n u e* (ital. *condannare*, ingl. *condemn*) për këtë, dhe m.q.s. Gjuha, siç e kemi parë dhe do ta shohim më mirë më tej, referohet gjithnjë për denominim, për emërtim, tek një *p a r a d i g m ë*, d.m.th. te një figure a ngjarje a objekt etj., që shpreh në një mënyrë sa më primordiale dhe superlative konceptin e signifikuar nga fjala e dhënë, është e qartë që të gjitha këto fjalë të huaja dhe Shqip që ne po analizojmë këtu,

lidhen të gjitha me Demonin (djallin) e pra me Shqipen "d a m u n" e pra simb. ① .

Le të shtojmë këtu dhe diçka të rëndësishme:

Ne kemi thënë e përsëritur se referenca e fjalës (për të etimologjizuar, motivuar, etj.) nuk është tek një *koncept* (sikundër ka menduar dhe vepruar shkenca klasike e etimologjisë), por tek një *simbol*, dhe shembullat rikonfermuese të kësaj teze janë më se të bollshme në këtë tekst. Por, nga ana tjetër, ne po pohojmë se fjala referon tek një *paradigmë primordiale, superlative*. A po themi vallë në të dy rastet të njejtën gjë?

Pò.

Dhe já sepse:

Lexojmë tek libri i Jean Chevalier se:

"La logique du symbol c'est la logique du Tiers Inclus."^{*}
(Llogjika e simbolit është ajo e Tretit të Përfshirë.)

Kjo do të thotë se s i m b o l i "përfshihet" në kodin E, e pra i bindet llogjikës së Qëndrës Mistike.

Por çfarë mund të ketë më primordiale, më superlative, se kjo Qëndër, që përfaqëson, siç lexojmë te Cirlot: *"The Supreme Principle of the Universe"...*^{**}

171) Ingl. **d a m n !** = djall! I mallkuar!... (ital. *maledizione!*)

Është Shqipja:

d ā m, i d a m u n, etj.

* Shih, J. Chevalier, *"Un dictionnaire des symboles"*.

** Shih Cirlot, *"Centre"*, fq.40.

172) **Frëngj. p u i s** = ingl. *after* (p a s, pastaj)

Lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen:

p e s

Kemi:

fr. **p u i s** → shq. **p a s (2)** = shq. **p e s (5)**

Inekuacioni: fr. "p u i s" < shq. "p a s", argumentohet me faktin se vetëm Shqipja "p a s" me ndërmjetësinë e "p e s ë" e përcjell Frëngjishten "p u i s" tek një *simbol*, tek ay i *pesës (5)*, që në Frëngjisht nuk ekziston [**5** = fr. "cinque"].

173) **Frëngj. p a s** = ingl. *without* (pa, jo...)

Me qenë se:

-1 = 5 ... (F)

mund të themi se Frëngjishtja "p a s" lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen:

fr. **p a s** → shq. **p e s = 5 = -1 = jo, pa...**

174) **Rus. p o s l e (п о с л е)** = ingl. *after, afterwards* (pas, pastaj)

Edhe Rusishtja "p o s - l e" = Shq. "p a s" (e pra simb. **2**) lidhet, si me motivuesen e vet, me Shqipen:

p e s (5)

Mund të shkruajmë:

rus. **p o s l e** < shq. **p a s (2)** = **p e s ë (5)**

Kështu simboli tek i cili Shqipja e bën Rusishten "p o s l e" të referojë është numuri **5**, i barabartë për ekuivalencë simbolike me numurin **2**.

Le të vëmë ré tani diçka tjetër.

Në Shqip: "p a s í" = *me qenë se, për arsye se, për shkak se...*

Me qenë se "Arsyeja" lidhet me *llogjikën formale*, që ngrihet e gjitha mbi parimin e *moskontradiksionit* që mund të shkruhet si: $(x = x)$, e të vështrohet si një propozicion llogjik, dhe me qenë se *shkaku* lidhet me ligjin e *Kauzalitetit* (që i vështrohet si një propozicion llogjik tregohet konvencionalisht me " \leftrightarrow "), * ne mund të shkruajmë se:

$$p a s í = (x = x) = \leftrightarrow \dots(F)$$

Pra Shqipja "p a s í" ka në të njejtën kohë si kuptimin e "arsyes", ashtu edhe atë të "shkakut". Prandaj dhe në Shqip mund të thuhet krejt njëjllor si: "për këtë arsye..." [p a s í, $(x = x)$], ashtu dhe: "për këtë shkak..." [p a s í, \leftrightarrow].

Por në Shqip edhe: "p a s í" (shq. *m b a s*; ingl. *after*; lat. *post*; frengj. *puis*) e pra simb. 2 .

Kështu Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccccccc} (x = x) & = & \leftrightarrow & = & 2 & \dots(F) \\ p a s i & & p a s í & & p a s i & & \\ & & (fr. puis-qe) & & (fr. puis) & & \end{array}$$

Në zgjerim të Bisedës le të shtojmë edhe sa vijon:

Dihet se në Fizikën Kuantike ka rënë *Parimi i Kauzalitetit*, siç është detyruar ta pranojë këtë dhe një kundërshtar i vendosur i Fizikës Kuantike siç ka qenë Einsteini.

Mund të shkruajmë pra: **Einstein** = $--\leftrightarrow$.

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.818.

Por:

$$- \leftrightarrow = E = -F = -\infty = - \text{Relativitet}$$

$$= - \text{Teoria e Relativitetit}$$

Kjo është ajo për të cilën është folur gjerësisht edhe tek "*Libri i Aforizmave*", duke u cilësuar si "vetvrasja teorike" e Einsteinit.

Nga ana tjetër, me qenë se *shkakësia* dhe *arsyeja* janë ekuivalente mes tyre, del se rënia e parimit të shkakësisë në Fizikën Kuantike sjell me vete automatikisht dhe rënien e arsyes, mohimin e saj, pamundësinë e saj për të shpjeguar parimet dhe faktet e "çuditshme" me të cilat zbulon e trajton Fizika Kuantike. Duke qenë kështu, mund të shkruajmë:

$$\text{Fizika Kuantike} = - \leftrightarrow = -(x = x)$$

$$= (x = -x) = \text{Qendra Mistike} = \text{"Absurdi"}$$

Mund të themi atëhere pra pa frikë se:

"Fizika Kuantike [si edhe të gjitha "Sciences des profondeurs", të cilat i binden, siç kemi parë, kodit E] studjon Absurdin dhe gjithshka ka të bëjë me të, siç është ndër të tjera edhe 'Mbretëria Qiellore'."

Duke qenë kështu, Tertulliani, me pohimin e tij:

"Credo quia absurdum est!"
(Besoj sepse është absurde!)

pohon dhe profetizon, në atë mënyrën e tij mistiko-fetare, ardhjen dhe triumfin në Shkencë të "Absurdit", e pra edhe të Fizikës Kuantike.

Ja pra dhe një tjetër pikë e rëndësishme kontakti (ndër të shumtat) mes Fësë së Krishterë (në nivelin e saj mistik, dhe jo të institucionalizuar e pra të dogmatizuar, e pra të "ç-frytëzuar") dhe Shkencës Moderne.

175) Frengj. **p u i s - q u e** = ingl. *because* (se, sepse...)

Edhe Frengjishtja "p u i s - q u e", që tregon *arsyen, shkakun* e diçkaje (simb. \leftrightarrow), dhe që lidhet brenda Frengjishtes me "p u i s" [= shq. "p a s", "p a s - t a j" = 2], lidhet si me motivuesen e saj të mbrame me Shqipen:

$$p e s (5) = p a s (2)$$

Le të kujtojmë këtu me këtë rast se në Shqip: "n d a j" = 1) *pjesëtoj, pres* (ingl. *to divide*), e pra simb. \oplus , por njëkohësisht edhe 2) *për këtë arsye, për këtë shkak...*, e pra $(x = x)$, \leftrightarrow .

Në këtë mënyrë Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\oplus = (x = x) = \leftrightarrow \dots (F)$$

Ky ekuacion i rëndësishëm është vërtetuar në *Një parashtim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, por ne mund ta rivërtetojmë atë shkurtimisht edhe këtu. Për këtë shkruajmë:

$$\oplus (pjesa) = - \bigcirc (jo e Tëra) = - (x = -x)^* = (x = x)$$

Nga ana tjetër:

$$T_{(x=x)} = T_{(\leftrightarrow)}^{**}$$

e pra:

$$(x = x) = \leftrightarrow$$

* Simboli " \bigcirc ", i *riinterpretuar* si "zero", përfaqëson zgjidhjen e ekuacionit të Qëndrës që është dhënë këtu si "*Coincidentia oppositorum*".

** Ku: " T " = *Tabelë Vërtetësie*. Sipas llogjikës matematike, kur dy propozicione llogjike kanë të njëjtën Tabelë Vërtetësie ato mund të vështrohen si ekuivalente. Dhe ky është rasti këtu me propozicionet " $(x = x)$ " dhe " \leftrightarrow ".


Në Shqip gjithashtu "d a s i" (①) dhe "d y s h" (2). Kështu Shqipja shtron edhe kështu ekuacionin simbolik që u ndesh edhe më lartë:

$$\textcircled{1} = 2$$

Prandaj nëpërmjet Shqipes (por jo vetëm) përftohet ekuacioni simbolik:

$$2 = \textcircled{1} = \leftrightarrow \dots(F)$$

Nga sa më sipër del shumë qartë edhe një gjë tjetër: dhe kjo është *polisemia** e simbolizmës të numurit **p e s ë** (5). Mund të shkruajmë:



Polisemia e pasur e numurit 5 do të mund të shpjegohej edhe me faktin se, simbolizmi i saj, siç lexojmë tek Cirlot, përfshin *tërë Botën materiale* a, e thënë ndryshe, një *pseudo-totalitet*.*

* D.m.th. kuptime të shumta, të ndryshme të së njejtës fjalë. Shkenca klasike e Etimologjisë nuk është në gjendje ta shpjegojë, ta zgjidhi "misterin" e polisemisë dhe pra kur përpiqet ta "shpjegojë" e bën këtë duke kuturuar se, gjatë evolucionit të gjuhës, fjalë që në fillim kanë qenë të ndryshme, jo vetëm nga kuptimi por edhe nga forma, kanë ardhur duke u afruar rastësisht, herë-herë gjer në atë pikë sa edhe të përputhen. Po punët natyrisht janë krejt ndryshe. Kuptimet e ndryshme të fjalës polisemike kanë mes tyre lidhje të thella mitike që, sic thamë Shkenca klasike e Etimologjisë as i dinte dhe as çante kokën t'i diktonte. (shih "Shqipja dhe Sanskritishtja")

176) Kinez. **chāi** (拆) = ingl. *to cut, to tear,...* (pres, çjerr)

Është Shqipja:

çaj = simb. ⊕

177) Kinez. **chāi** = ingl. *to send* (dër-goj, çoj, nis)

Është Shqipja:

çoj = simb. ~

Kështu gjuha Kineze, ashtu si Shqipja, shtron ekuacionin simbolik:

⊕	=	~	...(F)
kin. chai		chai	
shq. çaj		çoj	

Duke zgjeruar Bisedën:

Në Italisht: "**s-partire**" = *ndaj* [kin. *chai*; shq. *çaj*] dhe "**partire**" = *me u nis* [kin. *chai*; shq. *çoj*].*

Pra dhe Italishtja shtron të njëjtin ekuacion:

⊕	=	~
spartire		partire

Italishtja e shtron këtë ekuacion simbolik edhe me "**m e t à**" = *gjysma* (⊕) dhe "**m o t o**" = *lëvizje* (~).

Kemi pra:

⊕	=	~
metà		moto

* Shih edhe fq.108.

Ashtu dhe Shqipja e shtron po këtë ekuacion me "n d a r ë" (⊕) dhe "n d r y – s h i m" (~), e pra:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \quad \dots(F) \\ \text{ndarë} & & \text{ndryshim} \end{array}$$

Në Shqip gjithashtu:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{darë} & & \text{dërgoj} \end{array}$$

Po në Shqip:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \sim \\ \text{shkyj} & & \text{shkoj} \end{array}$$

Dhe në shumë e shumë mënyra të tjera, si Shqipja dhe shumë e shumë gjuhë të tjera...

Ky ekuacion na thotë, ndër të tjera, që:

"Shkaku i lëvizjes është *ndarja*."

...*Ndarja*, që është edhe shkaku i *fillimit* të Botës materiale (Paracelsus).

Simbolikisht e përmbledhtas mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{cccccccc} \oplus & = & \leftrightarrow & = & \sim & = & -1 & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{Ndarja} & & \text{shkaku} & & \text{i ndryshimit} & & \text{e i fillimit} & & \text{të Botës} & * \end{array}$$

* Nga sa më sipër del gjithashtu edhe se "Bota" (bota materiale) është krijuar me një "ndryshim". Del pyetja: *Ndryshimin e kujt?* Dhe përgjigja që pason është: *Me ndryshimin e një Bote tjetër të vërtetë, të pakrijuar, të asaj që Theologjinë e Krishterë quhet "Mbretëria e Qiejve".*

178) Kinez. $d a$ (搭) = ingl. *build, join* (ndërtoj, lidhem, bashkohem)

Është Shqipja:

$$D \grave{a} = \textcircled{\oplus} = F = \textcircled{\times} = \bullet$$

(join) (build)

Një ekuivalencë këtu e rëndësishme dhe "e çuditshme" është edhe ajo e ndarjes ($\textcircled{\oplus}$) dhe bashkimit ($\textcircled{\times}$).**

Por kjo ekuivalencë del qartë dhe bindëse (si çdo tjetër) duke ndërtuar Tabelat e Vërtetësisë të këtyre dy figurave simbolike të vështruara si propozicione llogjike.***

Si rikonfirmë të kësaj mund të sjellim edhe Mitin e Rënies: *"the Fall of the Spirit into the matter..."* (shih Cirlot), që na flet për një parësi të Frymës mbi materien.

Pra përfundimisht:

"Krijimi i Botës është bërë me ndryshimin (mohimin) e Frymës dhe për pasojë edhe të rënies së saj."

Ky është një mith kozmogonik, sepse përfshihet në skemën e përgjithshme të gjitha mitheve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

ku në vend "E" dhe "F" mund të vëmë të gjitha rrezet e tyre sematike, si p.sh.:

$$\textcircled{\circ} \downarrow = \bullet$$

rënia e Frymës Bota materiale

Për një zgjerim të kësaj problematike, shiko edhe fundin e Studimit ku jepet *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

** Si rikonfirmë saktësisë së kësaj etimologjie, mund të shërbejë ndër të tjera: a) Paracelsus: *"Die Separatio ist aller Geburt Anfang..."*; b) Miti kozmogonik i ndarjes (ingl. *dismemberment*), etj. etj.

Ekzistojnë edhe shembulla jo të pakta të kësaj ekuivalence edhe në gjuhë të tjera, si p.sh. në Inglisht: "b o u n d" (⊕) dhe "b o n d" (⋈); në Shqip: "d a s i" (⊕) dhe "d a s ë m" (⋈), etj. etj.

179) Kinez. d i (地) = ingl. *earth, ground* (dhè, tokë)

Është Shqipja:

d h è

180) Kinez. d ā (打) = ingl. *to break; to fight; to tie up; to build* (çaj, thyej; luftoj; lidh; ndërtoj)

Motivimi me Shqipen do të bëhej në këtë mënyrë:

d ā → shq. D a, d a j = ⊕ (ingl. *break*) = F = (→≠←) (*fight*)
= ⋈ (*tie up*) = ● (*build*)

181) Asir. p a r ā s u (i p r u s) = ingl. *to cut off, to sever, to separate; to determine...*; gjerm. *schneiden* (pres, ndaj; përcaktoj...)

Është Shqipja:

p r e s = simb. ⊕

182) Asir. p a r s i g u = lidhje, bashkim

Motivimi bëhet në këtë mënyrë:

p a r s i - g u → shq. p r e s ... = ⊕ = F = ⋈ = *bashkim, lidhje*

*** Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

183) **Asir. e l t u** = gjerm. *der obere, der oberste...* (pjesa më e nëlt), simb. \uparrow .

Është Shqipja:

i u l t ë

Ne dimë se Gjuha pozon Qëndrën, si $(x = -x)$, si përputhje të të kundërtave, prandaj siç kemi vënë në dukje edhe gjetkë, në gjuhët e lashta ka qenë si rregull që *dy koncepte me kuptime të kundërta të tregoheshin me të njejtën fjalë*.^{*} Atje është thënë gjithashtu se ndodh nga

* Dihet që gjuhët e stërlashta (si p.sh. gjuha egjiptiane) dy koncepte të kundërta i tregonin me të njejtën fjalë. Kjo do të thotë, **e parë** me syrin e Diturisë Simbolike, se ata pozonin ekuacionin e Qendrës Mistike:

$$(x = -x)$$

Gjuhët, jo më të lashta a të stërlashta, filluan të përdorin një logjikë tjetër, jo atë të Tretit të Përfshirë [kodi $E : (x = -x)$], por atë të të Tretit të Përrjashtuar [kodi $F : (x = x)$].

Mbeturina të pozimit të Qendrës Mistike nga Gjuha mund të gjenden edhe në gjuhët e reja. Por, për t'iu shmangur keqkuptimit, një partner i ekuacionit simbolik të Qendrës në këtë rast hidhet në një sistem tjetër gjuhësor.

Kështu për shembull:

shq. **shpejt** (x)

ital. **nuocevole** = *i dëmshëm* (x)

gjerm. **spät** = *vonë* ($-x$)

gjerm. **nützlich** = *i dobishëm* ($-x$)

ital. **caldo** (x)

ital. **tenace** = *i fortë* (x)

ingl. **cold** ($-x$)

ital. **tenero** = *i butë* ($-x$)

ital. **alto** (x)

turq. **ç o k** (x)

shq. **ult** ($-x$)

shq. **ç i k** ($-x$)

e kështu me radhë...

Shih ndër të tjera edhe fq. 260, 604.

ndonjë herë që njëri nga partnerët e homonimisë antinomike ("çiftit ekuivokal") të "hidhet" në një sistem tjetër gjuhësor. Kjo shpjegon dhe përligjeron atëhere identifikimin e Asirishtes "e l t u" në kuptimin *lart* me Shqipen "u l t ë" në kuptimin *poshtë* (ingl. *low*).

Shtrohet kështu ekuacioni simbolik *ndërgjuhësor*:

$$\begin{array}{ccc} \uparrow & = & \downarrow & \dots(E) \\ \text{asir. } \mathbf{e l t u} & & \text{shq. } \mathbf{u l t \ddot{e}} & \end{array}$$

Rigjejmë në këtë mënyrë të thënë e famshme të "*Tabula Smaragdina*".*

Vëmë re këtu se në Latinisht "**a l t u s**" = n - a l t, dhe shihet qartë se është Asirishtja "**e l t u**", si edhe sigurisht edhe Shqipja "**u l t ë**", "n-a l t"...

Në Shqip: "**n-a l t**" (ingl. *high*), simb. \uparrow , dhe "**u l t**" (ingl. *low*), e pra \downarrow . Vëmë re se si në Shqip njëri nga partnerët është diferencuar lehtë për të shmangur keqkuptimin. Kjo është realizuar ndër të tjera duke e "prefiksuar" atë me një "n" prostatike, pa kurrfarë roli semantik përveç atij të diferencimit nga partneri tjetër. Kështu Shqipja e shtron në këtë mënyrë *tërësisht* ekuacionin e mësipërm "smaragdinator".

Mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} \uparrow & = & \downarrow & \dots(E) \\ \text{shq. } \mathbf{n-a l t} & & \text{shq. } \mathbf{u l t} & \end{array}$$

Që kënde shihet edhe epërsia, në këtë pikë, e Shqipes ndaj Asirishtes.

* Lexojmë tek Cirlot (fq.291): "*The most comprehensive and valid definition of the significance of form is that which appears in the legendary 'Tabula Smaragdina': 'What is above is like what is below...'*" (Një nga përcaktimet më përfshirëse dhe solide të konceptit të formës dhe të rëndësisë së saj gjendet në "*Tabula Smaragdina*", që ka marrë tashmë një karakter legjendar: "*Shka është nalt ngjet me sa është poshtë...*")

184) Asir. **a d i ŝ u** = ingl. *meanwhile, until then...* (ndërsa, deri sa...)

Theksi semantik tek "d i ŝ" që është Shqipja:

d y s h (2)

ose edhe:

d a s í (⊕)

Algoritmi Simbolik na jep:

$2 = 1/2 = \oplus = (A \cdots B) = \text{ingl. mean-while} = \text{shq. ndër-sa} = \text{ndër-kohë}$

Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm:

- 1) Sanskritishtja "d o ŝ a" (दोष), siç kemi parë,^{*} do të thotë ndër të tjera: *e keqe; errësirë; natë; ves...* të gjitha kuptime **keto që** lidhen me spektrin semantik të Shqipes "d y s h", gjë për të cilën është folur edhe gjatë. Kështu që *Sanskritishtja nuk motivon dot me mjetet e saja* fjalën Asirisht "a d i s u".
- 2) Për sa i përket kuptimit tjetër po të kësaj fjale si "d e r i atëhere..." (ingl. *until then...*), edhe këtu motivimi është i mundur të bëhet me Shqipen dhe kjo për arsye se:

$$\text{asir. "a d i s u"} < \text{shq. "â d a s í"} = \oplus = (A \cdots B) \quad \dots(F)$$
- 3) Vetë Shqipja "d e r i" (ingl. *until*) lidhet si me prejardhjen e saj me "d a r ë", që është pjesore e foljes "DAj" (ingl. *to divide*).
- 4) Ruishtja: "d o" (до) = *deri* (ingl. *until, until then...*), motivohet fare thjeshtë edhe ajo me anë të Shqipes "d a" (ingl. *divide*).
- 5) Latinishtja: "d u m" = *deri*. Nuk është tjetër veçse Shqipja "d ā m" ...

* Shih edhe fq.19.

Kemi kështu pra, lidhur me etimologjinë e kësaj fjale të Asirishtes, një "*Consensio linguarum*" të pasur, që përligjeron si s'ka të bëhet më mirë, etimologjizimet tona.

- 185) Asir. **a d i r t u** = ingl. *obscurement, darkness; misfortune, calamity* (errësirë; fatkeqësi, ngjarje e kobshme, "një e zezë")

Theksi semantik bie tek "d i r" dhe me Shqipen:

$$d i r \rightarrow \text{shq. } d \bar{a} r = \textcircled{1} = F = \bullet$$

Le të vëmë ré këtu se ekuacioni simbolik:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

shërben për të motivuar një numër të madh fjalësh që tregojnë të keqen, errësirën, ndyrësinë, mëkatin e kështu me radhë... Kështu p.sh. në Shqip: "n d a r j a" (⊕) = "n d y r j a" (●), "p j e s ë" (⊕) dhe "p i s" (●), në Rusisht: "b e d à" (б е д а) (●) = fatkeqësi, që motivohet me Shqipen "b ë d à", e pra: ⊕ = F = ● ...

E kështu me radhë.

- 186) Ingl. **d i r t y** = i ndyrë, i fëlliqur

Dhe me Shqipen:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

i n d a r ë i n d y r ë

Le të vëmë ré këtu se në Shqip mund të thuhet edhe "i n d y r t i".

Në Shqip gjithashtu "i n d e r t i" (i nderuari, i ndrituri). Shtrohet përsëri kështu një ekuacion simbolik *ndërgjuhësor*, i trajtës ($x = -x$), e pra:

$$\bullet = \bigcirc \quad \dots(E)$$

ingl. **dirty** shq. **i nderiti**

Po një ekuacion i tillë i trajtës ($x = -x$) mund të shtrohej nga Shqipja krejt pavarësisht nga Inglishtja, dhe kjo sepse kemi:

$$\bullet = \bigcirc$$

shq. **i ndyrty** shq. **i nderiti**
shq. **i ndyri** shq. **i nderuari**

Duke patur parasysh se "n" është shpesh herë *prostatike në* Shqip, kemi "(n) d y r t" që është pothuaj identike me Inglishten "**dirty**".

- 187) Asir. ā d ā r u** = gjerm. *gefinstert, getrübt werden oder sein (von Licht und Lichten gesagt)* (i errësuar, që është i errësuar a bëhet i tillë; thuhet më shpesh për dritën)

Me Shqipen:

$$\text{ā d i r u} \rightarrow \text{shq. } \hat{\text{a}} \text{ d } \bar{\text{a}} \text{ r} = \bigoplus = F = \bullet$$

- 188) Gjerm. f i n s t e r** = i errët

Kjo fjalë e Gjermanishtes mund të zbërthehet në:

f i n s t e r

dhe atëhere me Shqipen:

$$\text{b } \bar{\text{e}} \text{ n } \text{ s t e r r} = \bullet$$

189) Inql. **d a r k** = errët

Edhe kjo fjalë e Inglishtes mund të motivohet fare mirë me Shqipen:

$$d a r k \rightarrow \text{shq. } \mathbf{d \bar{a} r k a} = \text{"ka darë"} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \bullet$$

Vëmë ré këtu se edhe fjala Shqip "**d a r k ë**" (ingl. *supper; evening*) duhet motivuar në të njejtën mënyrë dhe shihet se ajo është e njëllajtë, në thelb, me Inglishten "d a r k", e pra:

$$\text{shq. "d a r k ë"} = \text{"d \bar{a} r k a"} (\text{"ka darë"}) = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \bullet = \text{ingl. "d a r k"}$$

190) Asir. **A d d a r u** = muaji i 12^{te} (muaji i turbullt, i errët)

Me Shqipen:

$$\mathbf{\hat{a} d \bar{a} r} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \bullet$$

191) Asir. **a d i r u** = gjerm. *Furcht* (frikë, ndroje, ndrojtje)

Lidhet me Shqipen:

d r u h e m (*ndruhem*), **d r û** (*ndruj se...*), **n-d r o-j e** (*i ndrojtun*)

e kështu me radhë...

Por motivimi mund të bëhet përsëri hipotetikisht edhe me Shqipen "(n) **d a r ë**" ($\textcircled{1}$), që shpie me "(n) **d y r ë**" (\bullet) tek simboli ndër të tjera i *errësirës*, i *vdekjes*, e pra edhe tek ai i frikës *par excellence*, i frikës nga vdekja, përpara vdekjes.

Në Asirishte gjithnjë nga e njëjta rrënjë: "**a d â r u**" = *me pas frikë* (gjerm. *sich fürchten*) dhe "**â d i r i s**" = *i frikshëm, plot me frikë* (gjerm. *fürchtsam, voll Angst*)... fjalë edhe këto që motivohen si më sipër përmes Shqipes.

192) **Asir.** a d i = gjerm. *während; bis; nebst* (gjatë; deri; pranë)

Duhet zbërthyer në:

a d i

dhe me Shqipen:

â d à

("âsht dâ")

e pra simbolikisht:

⊕

Dhe për ekuivalencë simbolike:

(A → B)

Që mund të lexohet: "nga A *deri* (gjerm. *bis*) B".

Motivuar kështu, me ndihmën e Shqipes, kuptimin **e parë e** të dytë të fjalës Asirishte "a d i".

Vëmë ré se edhe fjala Shqipe "n d ë r s a" (gjerm. *während*) mund të ndahet në "n d ë r – s a" e pra edhe "n d ā r – s a", e pra edhe këtu puna reduktohet tek simboli i "n d a r – j e s" (⊕), me të gjitha ato që këndej pasojnë. Në Shqip edhe "n d ë r k a q" dhe "n d ë r k o h ë", etj.

Kuptimi tjetër "pranë" i Asirishtes "a d i" (gjerm. *nebst*) shpjegohet me faktin se:

⊕ = ∞ ... (F)

Dhe simboli i dytë është këtu, ndër të tjera, edhe ai i "bashkimit", i "fqinjësisë", i *afërsisë*, i "lidhjes".

Vëmë ré se edhe Shqipja "p r a n ë" (*afërsi*) lidhet mbrenda Shqipes me "p r ë n ë" (*këputje, ndarje*) duke na dhënë të njëjtin ekuacion simbolik të mësipërm.

Në Shqip gjithashtu: "n d a j" (*me ndà*, e pra simb. $\textcircled{1}$) dhe "n d a j" (*pranë, afër*, e pra X), si p.sh.: "*ndaj* mbrëmjes" = "*pranë, afër* mbrëmjes".

Në Greqisht: "k o n d a" (κ ο ν τ ά) = afër, pranë..., dhe do zbërthyer për etimologjizim në Shqipen:

k a n d à

e pra simbolikisht:

$$\textcircled{1} = \text{X} \quad \dots(F)$$

Shtojmë këtu se Asirishtja "a d i" ka dhe kuptimin "me" (gjerm. *mit*, ingl. *with*), simb. X . Edhe ky kuptim motivohet si më sipër. Me fjalë të tjera, me "a d i", Asirishtja shtron *me ndihmën e Shqipes* ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\textcircled{1} = (A \rightarrow B) = \text{X} \quad \dots(F)$$

shq. **â d à** asir. **a d i** asir. **a d i**

Duke u mbështetur në sa më sipër, ne mund të themi se edhe Frengjishtja "p r è s" motivohet përmes Shqipes si:

$$\text{p r è s} \rightarrow \text{shq. p r e s} = \textcircled{1} = F = \text{X}$$

Me fjalë të tjera, Frengjishtja, *me ndihmën e Shqipes*, shtron ekuacionin simbolik ndërgjuhësor:

$$\textcircled{1} = \text{X} \quad \dots(F)$$

shq. **p r e s** fr. **p r è s**

Shtojmë këtu se edhe Inglishtja "a n d" = shq. *dhe, edhe...*, simb. X , dhe Gjermanishtja "u n d", po me atë kuptim, duhen zbërthyer në "a n d" dhe me Shqipen "â n d à" e pra simb. $\textcircled{1}$, e pra më në fund, për ekuivalencë simbolike, simb. X .

Duke përmbledhur sa më sipër mund të shkruajmë:

\otimes	=	\oplus	...(F)
shq. n d a j		shq. n d a j	
shq. p r a n ë		shq. p r e n ë	
frengj. p r é s		shq. p r e s	
gjerm. u n d		shq. â n d à	
ingl. a n d		shq. â n d à	
shq. e n d e		shq. â n d à	
asir. a d i		shq. â n d à	
greq. k o n d a		shq. k a n d à	

Ne shohim se të gjitha këto gjuhë shtrojnë, në mënyra të ndryshme, të njejtin ekuacion simbolik, por *jo me mjetet e veta, por me ndihmën e Shqipes*. Që këndeje edhe: R o l i M e s i a n i k (ndërmjetësues) i Shqipes.

193) Kinez. qì (泣) = fr. *pleurer, sangloter* (qaj, qaj me dënësë)

Është Shqipja:

q a j

një operator shumë produktif në Shqip dhe që me "binomin":

q a j (k a j) – q e s h (k j e s h)

shtron ekuacionin e Qëdrës Mistike:

(x = -x)

Dimë se fjalët në gjuhët e stërlashta shtronin pa përjashtim ekuacionin e Qëdrës, duke treguar dy koncepte të kundërt me të njejtën fjalë. Pra dhe operatori "q a j" (< "k a j") në Shqip duhet të jetë tepër i lashtë.

Si në zgjerim të Bisedës shtojmë këtu edhe se gjuhët e lashta, si bie fjala gjuha Egjiptiane,^{*} duke treguar dy koncepte të ndryshme me të njejtën fjalë, pozonin tërthorazi ekuacionin simbolik të Qendrës Mistike, do me thënë $(x = -x)$, e pra kodin **E**, që është ay i thellësisë: $(x = -x) = (x^3 + y^3 + z^3 = 0)$; ndërsa gjuhët moderne dhe mendimi "modern" i gjertashëm kanë pozuar gjithnjë ekuacionin: $(x = x) = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3)$, që është ai i sipërfaqes së sferës, e pra ai i cektësisë, i përciptërisë.

Është për t'u "habitur" se të njejtën gjë, pas kaq e kaq shekujsh, gjejmë edhe tek Shkenca e Kohës sonë. Kështu Bohr-i, një nga themeluesit e Fizikës Kuantike, flet për dy lloj gjykimesh: 1) të cekta [kur e kundërta e një gjykimi të vërtetë nuk është e vërtetë, gjë që mund të shkruhet simbolikisht si: $(x \neq -x) = -(x = -x) = (x = x) = F$], dhe 2) të thella [kur e kundërta e një gjykimi të vërtetë është dhe ajo e vërtetë, gjë që mund të shkruhet simbolikisht si: $(x = -x)$].

* Carl Abel (1837–1906), linguist gjerman i njohur për kërkimet e tij mbi gjuhët Indo-Europiane dhe Semite, shkruan: "...Die ersten Begriffe werden geradezu mit ihrem Gegenteil in demselben Worte untergebracht, und haben ohne das Gegenteil ursprünglich nicht gedacht worden, nicht gefasst werden können." [...Konceptet, në krye të herës, tregoheshin me të njejtën fjalë si edhe të kundërtat e tyre. Në atë kohë ato nuk mund të mendoheshin e të kuptoheshin pa të kundërtat e tyre.]

Ai jep në studimin e tij "*Einleitung in ein Ägyptisch-Semitisch-Indoeuropäisches Wurzelwörterbuch*" (botuar në Leipzig më 1884) një listë të gjatë fjalësh nga gjuha Egjiptiane që shprehin koncepte të kundërta, ndonëse ruajnë të njejtën formë, si për shembull:

qen = *fortis* = i fortë

qen = *debilis* = i dobët

sept = *destruere* = shkatërroj

sept = *construere* = ndërtoj

tem = *includere* = përfshij

tem = *excludere* = përjashtoj

un = *esse* = me qenë

un = *desse* = mos me qenë...

194) Kinez. k ū (哭) = ingl. cry, weep (qaj)

Është Shqipja:

k u

("me vu **KU**-jën")

në kuptimin "me qa me të madhe".

Në Shqipe edhe: "me ku-jit", ndonëse me një kuptim disi të diferencuar dhe poetik, p.sh. "rrotat *kujitin*..." (lëshojnë një zë të hollë si një e "kjame").

Për të treguar se kjo rrënjë në Shqip është mjaft e përhapur përmendim ndër të tjera edhe këto fjalë (shprehje): "ku-ku për mu..." (që lidhet po ashtu me operatorin "k u", "k j a", "k a j", "q a j"...), "ku-ku-vajka", "qyqar" (i mjerë), etj. etj.

Në Greqisht: "**k a i m e n o s**" (καημένοσ) = ingl. *ianeniung*, që është padyshim një huazim i pastër nga Shqipja: "i **k j a m u n i**" = "ai që është ba me u kjamun"...

195) Kinez. x u é (学) = fr. apprendre (me mësue, me studjue)

Është Shqipja:

x a n

folja "me **x a n**", "**x a j**", "**x e j**", "i **x a n u n**", "n **x a n ë s**",...

196) Kinez. x u n (训) = fr. enseigner (me mësue, me dhënë mësim)

Është Shqipja:

x a n

folja Shqip "me **x a n**", "ata **x u n**"..., "**x a n j e**", "i **x a n u n**", etj. etj.

Vërejtje: Siç shikojmë ka një puthitje pothuajse tërësore mes Shqipes dhe Kinezçes, për sa i përket kësaj gllose, edhe si *morfemë*, edhe si *sememë* (spektër pothuajse identik semantik).

Mund të shkruajmë:

kin. "x u e" ("x u n") < shq. "x a" ("x a n", "x a j" etj. etj.)

197) Kinez. zhua (抓) = ingl. *grab, catch, seize* (za, zë, kap, etj.)

Është Shqipja:

z a

(nga folja "z a j", "z a n ë", etj.)

198) Kinez. s h i (视) = ingl. *to see, to inspect...* (shoh, me pa)

Është Shqipja:

s h o h, s h i h... s h i-k o j, etj.

Ka shumë mundësi që kjo fjalë të lidhet, tek e mbramja, me Shqipen "s y", që nga ndër të tjera dhe Inglishtja "t o s e e" = shoh.

199) Kinez. z h u o (捉) = ingl. *catch, grab, clutch, hold* (kap, mbaj, shtrëngoq...)

Është Shqipja:

z â (me zanë, me xan) = simb. ⌘

200) Kinez. z á (杂) = ingl. *miscellaneous, mixed, various* (i përzier, i ndryshëm)

Këtë rrënjë e gjejmë në fjalë të përbëra të Shqipes, si p.sh.:

"p ë r z i", "m e u p ë r-z i", "p ë r-z i-e r j e" etj. etj.

Në Shqip ekziston edhe një aforizëm e tillë:

"Me u përzi, sjell zi."

që jep ekuacionin simbolik:

$$\infty = \bullet \dots(F)$$

interpretimet e të cilit janë të shumta dhe të rëndësishme.*

201) Kinez. z à o (造) = ingl. *build, create* (bëj, krijoj)

Është Shqipja:

z ë, z â
(në kuptimin e bërjes)

202) Kin. c h u à n g (創) = ingl. *create; start, initiate, begin; cut; wound, injury* (krijoj; filloj, nis; pres, çaj; plagë, ofezë)

Motivimi bëhet duke e shpënë këtë fjalë tek Shqipja:

ç a j

folja "me ç a", me të gjitha fleksionimet e saj, si "ç a n", "i ç a m u n" etj.

Simbolikisht:

⊕

Por Algoritmi Simbolik na mëson se:

$$\begin{array}{ccccccc} \oplus & = & -1 & = & \bullet & = & -\bigcirc & \dots(F) \\ (to\ cut) & & (to\ start) & & (to\ create) & & (to\ injure) \end{array}$$

* Shih lidhur me këtë edhe *Një parashtrim i Shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

Dimë se çdo figurë simbolike në kodin F paraqet një mit kozmogonik, dhe kjo për arsye se skema e përgjithshme e të gjitha miteve kozmogonike është:

$$E \downarrow = F$$

Në rastin tonë:

$$\bigcirc \downarrow = \textcircled{\ominus}$$

$$\bigcirc \downarrow = -\bigcirc$$

$$\bigcirc \downarrow = \bullet$$

$$\bigcirc \downarrow = -1$$

... ..

Lidhur me këtë çështje shih edhe komentin tonë mbi mitet kozmogonike dhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit.

203) Pers. *ā d ā n a* = ingl. *piece, portion* (copë, porcion)

Është Shqipja:

$$\hat{a} d \grave{a}, \hat{a} d a m u n = \text{simb. } \bigcirc$$

Trajta më arkaike do të qe Shqipja: "*â d à j a m u n*", që nga edhe, me kalime fonetike të zakonshme: "*ā d ā n a*".

204) Pers. *ā d r a* = ingl. *lowly* (poshtë)

Zbërthimi bëhet me Shqipen:

$$\hat{a} d a r \rightarrow \text{shq. } d a r = \textcircled{\ominus} = \downarrow \dots(F)$$

Le të vërejmë se "ā d ā n a" dhe "ā d r a" janë *e njejta fjalë*, por me një ndryshim të lehtë për shmangie keqkuptimi. "ā d ā n a" do të ishte një trajtë e huar nga Shqipja e Veriut, ndërsa "ā d r a" do të ishte një trajtë e huar nga Shqipja e Jugut. Ndryshimi i kuptimit të fjalës së dytë shpjegohet me Algoritmin Simbolik, i cili i ekuivalentizon në rrafshin simbolik këto dy fjalë. Nga ana tjetër, duhet thënë se ky ndryshim, si i formës ashtu edhe i kuptimit të së njejtës fjalë, shpjegohet me një dëshirë diferencimi sa do të lehtë, për shmangien e keqkuptimit që do të rridhte nga identifikimi i konceptit të "ndarjes" me atë të "rënies" (*poshtësisë, ultësisë...*).

Në vazhdim të Bisedës, shtojmë se ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\textcircled{D} = \downarrow \dots(F)$$

e gjejmë gjerësisht të ilustruar (të rikonfermuar) nga një sërë gjuhësh ("*Consensio linguarum*").

Ja ndonjë shembull:

Në Sanskritisht: "a v a – p a t" që do të thotë "me nda" (ingl. *to split*), si edhe "a v a – p a d" që do të thotë "me rë" (ingl. *to fall*).

Simbolikisht pra:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{D} & = & \downarrow \\ \text{ava-pat} & & \text{ava-pad} \\ (\text{अवपट्}) & & (\text{अवपद्}) \end{array}$$

Në Rusisht: "p a d a t s" (падать) = me rë, që zbërthehet në "p a + d a t s" dhe me Shqipen "b â d à", e pra simb. \textcircled{D} .

Në këtë mënyrë, Rusishtja *me ndihmën* e Shqipes shtron ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{D} & = & \downarrow \\ \text{shq. b â d à} & & \text{rus. p a d a t s} \end{array}$$

Po ashtu Inglishtja "d o w n" zërthehet në "d o + w n" e me Shqipen "d à b a n", e pra kemi ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{\text{D}} = \downarrow \quad \dots(\text{F})$$

shq. **d à b à n** ingl. **d o w n**

Dhe ky është një ekuacion simbolik ndërghjuhësor, në kuptimin që shtrohet nga Inglishtja *me ndihmën e Shqipes*, e cila lejon identifikimin e operatoreve "d o-" (shq. "d a") dhe "-w n" (shq. "b a n").*

Inglishtja "u n d e r" = *poshtë*, zërthehet me Shqipen duke dhënë gjithpo këtë ekuacionin simbolik ndërghjuhësor:

$$\textcircled{\text{D}} = \downarrow$$

shq. **â n d â r** ingl. **u n d e r**

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Gjermanishten "u n t e r".

Në Frengjisht: "t o m b e r" = me *rà*, e pra "↓", fjalë kjo që zërthehet me Shqipen "b ë r d à m" (ose "b ë r t h y m"), e pra "⊕".

Sajohet kështu ekuacioni simbolik:

$$\textcircled{\text{D}} = \downarrow \quad \dots(\text{F})$$

shq. **b ë r d à m** fr. **t o m b e r**

Në Italisht: "c a d e r e" = me *rà*, e pra ↓. Kjo fjalë zërthehet me Shqipen si "k a d a r ë". Sajohet kështu ekuacioni simbolik ndërghjuhësor:

$$\textcircled{\text{D}} = \downarrow$$

shq. **k a d a r ë** ital. **c a d e r e**

E kështu me radhë...

* Shih gjithashtu fq.69 dhe 444.

205) Pers. **k a r** = ingl. *to do, to make; to create* (kry, bëj; krijoj)

Është Shqipja:

m e **k r y**, * **k r i j o j**

Fjala "**k r y j**" në Shqip ka një spektër të pasur, i cili mungon në Persisht, gjë që tregon se:

pers. "k a r" < shq. "k r y"

Fjalë me këtë operator të lirë në Shqip janë ndër të tjera:



Një sqarim këtu është i nevojshëm:

Me "k r e u" dhe "k r e j t", Shqipja shtron ekuacionin e rëndësishëm:

$$\mathbf{1} = \bigcirc \quad \dots(E)$$

kre-u kre-jt

Në qoftë se e tregojmë "krimin" me "●", ne jemi në gjendje të sajojmë ekuacionin simbolik themelor:

$$\bullet = -\bigcirc \quad \dots(F)$$

kri-m kri-jim

* Ky operator gjendet *talīs qualīs* edhe në Sanskritisht: "kr̥t" (कृत्).

Sa do e çuditshme mund ti duket dikujt, Bota ka filluar vërtetë me një krim. Në literaturën simbolike kjo njihet me emrin *Sacrifica Kozmogonike*, që është një lloj si të thuash "Krimi Botbërës".

Në Fenë e Krishterë ky krim botë-krijues njihet me emrin "mëkati në zanafillë" (lat. *peccatum originalis*).*

206) Pers. **d u š** = ingl. *bad, evil* (e keqe)

Është fjala Shqipe:

d y s h = 2

dhe kjo sepse, siç dimë tashmë:

2 = ● = e zeza, e keqja, materia, djalli...**

207) Pers. **d u ž d ā** = ingl. *bad gifts, maleficent* (dhuratë e keqe, keqbërës)

Kjo është një fjalë e përbërë nga:

"**d u ž**-" që është Persishtja "**d u š**" (e keqja) = shq. "**d y s h**" (2) dhe:

"**-d ā**" = shq. "**d h à**" (dha-nje, dhuratë), e pra me Shqipen:

"**d h a d y s h**"

dhe në gjuhën simbolike:

⊕ 2

ku "⊕" është simboli i *damjes*, e pra dhe ai i *dhanjes*, ndërsa "2" është simboli i të keqes (2 = ●).

* Shiko fq.20, 40, 442, 549 dhe 600.

** Shiko ndër të tjera fq.11-12.

208) Pers. **g a i r i** = ingl. *mountain* (mal)

Është Shqipja:

g u r

Krahaso me Rusishten "**g o r á**" (ropa) = mal, e cila dhe ajo rrjedh nga Shqipja "**g u r**".*

209) Pers. **g a o** = ingl. *cow*

Është Shqipja:

k a-u**

210) Pers. **g a n (j a n)** = ingl. *smite, strike* (godet, gjuan)

Është Shqipja:

g j ū n, g j u a n,...

211) Pers. **d â m i** = ingl. *creation* (krijimi)

Motivohet me Shqipen:

d â m (folja "DAJ") = \oplus = **F** = \bullet = *materializim, krijim...*

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë se:

1) Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"...

2) Në Shqip: "**B d a j**" = *bëj*, dhe ndahet në: "b + d a j", e pra brenda Shqipes në: "**b ë D a j**" = \oplus = **F** = \bullet .

* Shih edhe fq.122, 164, 445, 476, 531 dhe 570.

** Shih edhe fq.101 dhe 606.

3) Del që këndeje se edhe Inglishtja "t o d o" = bëj, s'është tjetër veçse Shqipja: "d a - j" = $\textcircled{1}$ = **F** = \bullet .

4) Në Shqip: "d ā m" = ingl. *damage*, ital. *danno*.

Pra, krijimi i Botës [pers. "d ā m i"] mund të vështrohet si një "d a m", e pra si një e keqe, si një mëkat.

5) Në Frengjisht "d o m m a g e" = *gjynah, mëkat*, dhe është një fjalë që motivohet më Shqipen "d a m u n", e pra dhe me Persishten "d ā m i". Jo vetëm kaq, po krijimi i Botës mund të vështrohet atëhere si një punë *demon-iake*, e pra shkurt djallëzore. Kështu është vështruar në fakt nga mendimi mistik i të gjithë Botës dhe i të gjitha kohërave.*

Le të marrim *bie fjela*, Fënë e Krishterë sipas të cilës, Bota është e keqe e nuk duhet *dashur*... edhe se dashuria për Botën materiale është një mëkat, dhe madje *më i madhi* i mëkateve, sikundër atje shpallet krejt haptazi: "Miqësia me Botën është armiqësi për Zotin..."**

Në Shqip gjithashtu:

"Çdo ndarje është e ndyrë."

Simbolikisht:

$\textcircled{1}$ = \bullet ... (F)

* Mund të gjenden shumë rikonferma të kësaj teze. Si për shembull në rrymë e fuqishme të Gnosticizmit, sipas të cilit Bota është krijuar nga një *Demiurg* i keq, e kështu me radhë...

Është tërë Mendimi Mistik i përbotshëm, përsërisim, që ngrihet mbi këtë aksiomë themelore.

** Jakovi (4:4): "...nuk e dini se miqësia me botën do të thotë armiqësi me Perëndinë? Ndaj pra, dhe cilido që do të bëhet mik me botën, bëhet armik me Perëndinë."

Dhe pa *ndarje*, siç pamë, nuk ka *krijim*, nuk ka *bërje*.

Në Shqip gjithashtu, siç pamë pak më lart:

"Krijimi nga një krim."

Dhe *krimi* është "*The Cosmogonic Sacrifice*", Sakrifica (Krimi!) Botëkrijues.*

Budizmi, me konceptin e "Nirvanës", na thotë të njejtën gjë. Edhe vetë Buddha na përsërit pak a shumë të njejtën gjë kur ngushllon Anandën, nxënësin e dashur që qan për vdekjen e Tij: "*Mos qaj Ananda, ti e di tashmë që gjithshka është e përbërë duhet të bëhet e thjeshtë...*"

E përkthyer në Gjuhën e Algoritmit tonë Simbolik të *kudopranishëm*, kjo e thënë e Buddës jep " - ∞ ", ku " ∞ " është, ndër të tjera, simboli i përbërjes. Pra duhet, sipas Buddës që:

$$\infty \rightarrow -\infty$$

e pra atëhere, sipas Algoritmit tonë Simbolik** duhet që:

$$\bullet \rightarrow -\bullet = \bigcirc = \text{Nirvana (निर्वाण)}^{***} = \text{Qendra Mistike} \\ = \text{Parimi Suprem i Universit} = E = \text{ZOTI} = \text{Fryma Absolute (Hegel)}$$

212) Pers. *d r a v* = ingl. *wood* (avestan)

Është Shqipja:

d r u

* Cirlot, "*Cosmogony*", fq.64-65.

** Artikullim llogjik i "*Philosophia Perennis*", i Vizionit Mistik mbi Botën...

*** Në gjuhën Pali të shkrimeve nga më të hershme Budiste: "*n i b b ā n a*", që është Shqipja "*n u k b a n a*", e pra e *pabërë*, e *pakrijuar*.

Edhe Rusishtja "d r a v a" (дрова) = ingl. *wood*, shpjegohet në të njejtën mënyrë me Shqipen:

dra va → shq. b â dru

Theksi semantik këtu pra, siç shihet, bie tek "d r", që nuk është tjetër veçse Shqipja "d r u" (ingl. *wood*). Një etimologji e tillë konfirmohet ngushtë nga ato sa lexojmë në Internet lidhur me "Druidët", që e marrin emrin pikërisht nga Shqipja "d r u".

Le të kujtojmë këtu edhe faktin tjetër madhor se druri *par excellence* në Orakullin e Dodonës ishte bash L i s i, brenda të cilit ishte e pranishme vetë Fryma e Perëndisë, që për paganët e asaj kohe mishërohej nga Zeusi. Sipas dridhjeve të fletëve të këtij lisi, priftërinjtë e Dodonës Pellazgjike i përgjigjeshin të gjithë atyre që shkonin atje për të njohur të ardhmen e tyre të pasigurt, duke i shkruar këto "response" në pllaka guri, pllaka që ekzistojnë edhe sot si një dëshmi e pamohueshme e saktësisë të profetizimeve të tyre.

213) Pers. n a r = ingl. *man* (njeri)

Është Shqipja "n j e r i" dhe në një trajtë të lashtë:

nir, n i r-i

Që këndej edhe Greqishtja "a n i r" (ανήρ), që këndej edhe Sanskritishtja "n r" (नृ), gjithpò me atë kuptim.

Këtu lidhet edhe Persishtja "n a i r y ā m" (ingl. *brave, manly*), që zbërthehet me Shqipen si:

j a m n j e r i

në kuptimin e çvendosur semantik:

"jam burrë", "jam trim"...

Referojmë lidhur me këtë çështje edhe tek etimologjizimet e fjalëve të huaja që lidhen, si me prejardhjen e tyre, me fjalën Shqipe "b u r r".*

214) Pers. **b a r** = ingl. *to bear, to carry* (me bart)

Është Shqipja:

me **b a r**, me **b a r t****

215) Pers. **b u** = ingl. *become* (bëhem)

Është Shqipja:

b ë j, **b â**, **b ë...**, **b ë - h e m...**

216) Pers. **r ā m a n** = ingl. *tranquillity, rest* (paq, qetësi, pushim...)

Është Shqipja:

r a m u n

nga folja "me **r à**", "me **r a-m u n**" = me pushue (ingl. *to rest*).

Shtojmë këtu se edhe vetë Inglishtja "**r e s t**" nuk është tjetër veçse Shqipja "**r à â s h t**".

217) Pers. **v a y o i** = ingl. *woe**** (mjerim)

Është Shqipja:

v a j

(folja "vaj-toj")

* Shiko ndër të tjera fq.432, 417 dhe 713.

** Mund të vërtetojmë edhe se: greq. "**f e r o**" (φερο) < shq. "**b a r (t)**"

*** Edhe Inglishtja "**w o e**" del qartë se rrjedh nga Shqipja "**v a j**", "v a j t o j",...

Në Shqip edhe: "Vaj medet! "... Rikujtojmë këtu fjalët e famshme të Vercingetorix, mbretit të Galëve, kur iu dorëzua me gjithë ushtrinë e tij Qezarit fitimtar: "V a e V i c t i s!" (Mjerë të mundurit!).

218) Pers. v a s = ingl. *be clothed* (me qenë veshun)

Është Shqipja:

v e s h *

219) Pers. v ā c = ingl. *voice* (zë)

Lidhet mitikisht me Shqipen:

v i ç

Në Shqip gjithashtu:

"v i ç" dhe "v i k a t"

Në Italisht:

"v a c c a" (lopë) dhe "v o c e" (zë)**

220) Pers. v ā d ā y a = ingl. *destroy* (shkatërroj)

Motivohet me Shqipen:

v ā d ā y a → shq. b â d à j = ⊕ = ∞ = ● ... (F)

Ky është ekuacioni i "ndërtimit", dhe jo i "shkatërrimit".

* Kjo rrënjë e pastër gjendet edhe në Sanskritisht, shih fq.528.

** Ndër të tjera lexojmë tek Cirlot (fq.65): "Lopa...'Vac', aspekti femëror i Brahmes, njihet si 'lopa melodioze'... një ide që rrjedh nga ajo e krijimit të Botës nga zëri..."

Por, siç lexojmë më poshtë:

Dihet se në gjuhët e lashta dy koncepte të kundërta tregoheshin me të njejtën fjalë, kështu pra atëhere dhe *shkatërrimi* edhe *ndërtimi*.

Persishtja dhe Shqipja shtrojnë kështu së bashku një ekuacion simbolik që mbështetet tek Uniteti i të Kundërtave:

$$(x = -x)$$

ku:

$$"-x" = \text{pers. "v a d a y a"} = - \textcircled{1} = - \textcircled{2}$$

ndërsa:

$$"x" = \text{shq. "b â d a j"} = \textcircled{1} = \textcircled{2}$$

Është fjala pra këtu për një ekuacion simbolik ndërgjuhësor, siç mund të ndeshim shumë të tjerë në këtë Studim:

koncepti i *ndërtimit* (x) = koncepti i *shkatërrimit* ($-x$)

Ekuacione të tjera ndërgjuhësore të formës ($x = -x$) janë, ndër shumë të tjera: shq. "s h p e j t" (x) = gjerm. "s p ä t" ($-x$), ital. "c a l d o" (x) = ingl. "c o l d" ($-x$), ital. "a l t o" (x) = shq. "u l t" ($-x$), etj. etj.*

Një gjë e tillë në gjuhët më të "evoluara", më afër kohës sonë, ndodh për arsye se, për mentalitetin e mëvonshëm, veçanërisht "Perëndimor", ($x = -x$) përfaqësonte një *tabu* të papranueshme, ishte shkurt ekuacioni "Absurdit", ishte pra si i tillë krejt kundra llogjikës njerëzore, aristoteliane. Për këtë arsye pra një partner i çiftit ekuivokal hidhej në një sistem tjetër gjuhësor.

* Shih fq.224 dhe 234.

221) Pers. **v i d** = ingl. *see, know* (shoh, di, njoh)

Është Shqipja:

b ë d i
(folja "di", "me ditë")

Edhe Rusishtja "**v i d**" (в и д) = ingl. *view*, shpjegohet gjithashtu me Shqipen: "**b a d i**", duke patur parasysh se "dituria" *par excellence*, paradigmatiche, superlative dhe primordiale, është "të parit"...* gjë që na siguron gjer në fund se: rus. "v i d" < shq. "b a d i".

222) Pers. **v ī c i d h a** = ingl. *decision, judgement* (vendim, gjykim)

Me Shqipen:

b ë k a d à = ⊕

Duke qenë **kështu**, edhe tek Shqipja "**v e n d i m**" ne shtyhem të shohim një etimologji të tillë:

v e n d i m → shq. **b ā n d ā m** = ⊕

Edhe Latinishtja "**d e c i d e r e**" = *vendos*, na shpie po atje, sepse kemi:

d e - c i d e r e → **c a d e r e**** → shq. **k a d a r ë** = ⊕

223) Pers. **s k e n d a** = ingl. *destruction* (shkatërrim)

Me Shqipen motivimi jep:

s ' k e n d à = - ⊕ = - ● = -**F** = **E** = ○ = **Hiç*****

* Shih gjithashtu fq.82, 374 dhe 772.

** Shih edhe fq.87, 239, 450 dhe 578.

Dimë që " S " ka dy kuptime themelore, atë të *mohimit* (si për shembull në Shqipen "s'kam" = *nuk kam*) dhe atë të *bashkimit* (si p.sh. në Rusishten "s'direktorom" = *me drejtorin*).

Po të gërmojmë më thellë, do të gjejmë: simbolin e *Yin Yang*–ut kinez, si edhe gjarpërin (lat. *S–erpens*) biblik që nxit Adamin dhe Evën në Parajsë që të hanë nga fryti i ndaluar.

Vërejmë se ky është një nga rastet e shumtë që dëshmon më së miri për faktin se *krijimi i fjalëve është i paramenduar*, e pra jo krejt i rastshëm e arbitrar, siç pretendonte një Shkencë Linguistike në perëndim e sipër.*

Më tej dhe më gjerë e më thellë akoma:

Bibla na tregon se si Gjarpëri (një trajtë e Djallit) që *ay që nxiti* Adamin dhe Evën që të hanë, siç thamë, nga fryti i ndaluar i *dallimit të* së Mirës nga e Keqja.

Sipas Algoritmit Simbolik ky veprim do të paraqitet me mosbarazimin:

$$(x \neq -x)$$

Algoritmi jep më tej:

$$(x \neq -x) = - (x = -x) = (x = x) = F$$

Pra, u kalua nga kodi E ("mosdallimi" i të Mirës nga e Keqja) në kodin F ("dallimi" i të Mirës nga e Keqja)... Ky veprim solli *ndarjen* "Paracelsiane" dhe *rëniën* nga kodi E në kodin F, gjë që mund të shkruhet si:

$$E \downarrow = F$$

*** Shih lidhur me këtë edhe fq.143, 144.

* Lacan, Saussure etj., dhe "zbarra" e tyre e famshme që ndan *emërtuesin* nga të *emërtuarit*: " S / s ". (shih edhe fq.1, 170, 139-142 dhe 562)

Formulë kjo, siç dimë, e çdo miti kozmogonik, d.m.th. "botëbërës".

Pra mund të themi pa frikë se *Krijuesi i Botës mund të vështrohet dhe vetë Gjarpëri*, siç pretendohet edhe nga shumë e shumë sekte fetare, ndër të cilat edhe ay i Gnostikëve. Sipas tyre, Gjarpëri lot rolin, këtu, të një Demiurgu, të një perëndie të keqe.*

224) Pers. **s t ā** = ingl. *stand, stay, remain* (qëndroj, rri, mbetem)

Kjo fjalë përshkruan simbolin e "moslëvizjes", e pra simb. $- \sim$.

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$F = [E]$$

ose edhe pra:

$$\sim = [-\sim]$$

Pra "ajo që nuk lëviz" (ingl. *stand, stay, remain*) është *brenda*, është pra e "shti-me", "e shti-mun", që nga dhe Inglishtja "**st a y**" < shq. "**s h t i**".

Kështu:

$$\text{pers. "s t ā"} = \text{ingl. "st a y"} < \text{shq. "s h t i"} = [-\sim]$$

225) Pers. **z a n** = ingl. *bear, give birth* (lind)

Është Shqipja:

me **z â n**

(në kuptimin "me *lind*")

Jepet kështu kuptimi i "konceptimit" (i *zënies* së foshnjës, i *lindjes* së saj).

* Shiko më poshtë, fq.27, 62-63 dhe 527.

Në Latinisht: "c o n c e p i r e" < shq. "k a p" = me *zanë* (në kuptimin e *ngjizjes*).

Vëmë ré se rrënja "z a" gjendet po me këtë kuptim edhe në gjuhën Kineze.*

226) Pers. **m a n a h** = ingl. **m i n d** (menja, mendja)

Është Shqipja:

m e n d j a

si edhe, pa epentezën "-d-":

m e n - j a

Kjo rrënjë ndodhet *talis qualis* edhe në Sanskritisht ku:

"**m a n y e**" (मन्ये) = shq. **m e n (d) o j**

Me që ra fjala, le të kujtojmë këtu se në Sanskritisht "**m a n a s**" (मनस्) = *mendje*, dhe "**m a n u s h a**" (मनुष) = *njeri*. Pra Sanskritishtja vendos një ekuivalencë themelore, fillosofike, midis *mendimit* edhe *njeriut*.

Kjo është si të thuash që, sipas Mendimit të lashtë Vedik, mund të shkruhet ky ekuacion:

Njeriu = Mendimi

Vëmë ré këtu se edhe në Shqip: "**m e n j a**" dhe "**m a n u s h a q j a**", dhe m.q.s. "*manusha*" = *lulevjollcë* = frengj. *pensée* = "*mendim*", shikojmë se edhe Shqipja "identifikon", në një mënyrë disi të tërthortë, Mendimin me vetë Njeriun.**

* Shih edhe fq.763.

** Shiko edhe fq.293-296.

Që është si të thuash se: *Mendimi është gjithmonë një prerogativë e Njeriut, e pra diçka tokësore e jo hyjnore, e pra atëhere jo i tillë që do të na lejonte të gjenim të Vërtetën e mbrame.*

Rikujtojmë si përforcim të kësaj etimologjie se, sipas Algoritmit Simbolik:

$$5 = -1 = - \bigcirc = \square \dots(F)$$

Kjo do të thotë ndër të tjera se:

*"Pesa e interpretuar si mendim, na e fsheh të tërën,
Zotin, të vërtetën."*

e pra simbolikisht:

$$5 = \square \dots(F)$$

pesa fshehja
("burgosja")

Në këtë përfundim arrin dhe fillosofi i madhe gjerman Heidegger, kur thotë:

*"Njeriu është bari i Qenies..."**

Kjo do të thotë se *pesa* (5) e pra *mendimi njerëzor* e ruan si një bari i rreptë (dhe jo aspak "i mirë") Zotin, Qenien (gjerm. *Sein*). Dhe kjo për arsye se mosruajtja e rreptë e Qenies, d.m.th. dalja e saj qoftë edhe aksidentalisht, do të sillte për pasojë një katastrofë të vërtetë, shkurt e me një fjalë: *Bota do të shkatërrohej...*

Dhe kjo sepse do të kishim:

$$- \square = \bigcirc = - \bullet = \text{mohimi, shkatërrimi i Botës materiale...}$$

$$= -1 = \text{fundi i Njeriut}$$

* Shih edhe shënimin mbi Heidegger, fq.134-144.

Në këto përfundime në të cilat ne arrijmë lehtë–lehtë nëpërmjet Algoritmit Simbolik dhe Shqipes, ka arritur sot nëpër një rrugë të mundimshme dhe "akademike" edhe Shkenca Moderne, dhe sidomos një nga fillosofët më të mëdhenj të kohës, siç është Heideggeri.

227) Pers. **m a n** = ingl. *know, think* (njoh, mendoj)

Është Shqipja:

m e n d o j

dhe pa epentezë:

m e n o j

228) Pers. **h a m, h e m** = ingl. *together* (bashk)

Algoritmi Simbolik do të na ndihmojë ta "redukojmë" këtë fjalë tek Shqipja, dhe ja se si:

$$\textcircled{1} = \frac{1}{2} = 0.5 = 5 = F = \infty = \textit{edhe...}$$

Nga ana tjetër në Shqip: "**h e m... h e m...**"* = *edhe... edhe...*

Pra, në këtë mënyrë Shqipja jep: "**h e m**" = *edhe... = ∞ = ingl. together.*

* Në Latinisht: "**h e m i**" = *gjysëm*, $\textcircled{1} = 1/2$ dhe "**h o m o**" = *njeri...*

Pra Latinishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} 1/2 & = & 5 \quad \dots(F) \\ \mathbf{hemi} & & \mathbf{homo} \end{array}$$

...që dëshmon edhe njëherë se numuri i Njeriut (pas Rënies) është bash 5.

Shih ndër të tjera edhe fq. 44, 133, 429 dhe 623.

Duke zgjeruar Bisedën:

- 1) Persishtja "**h a m**" lidhet me fjalën semite "**h a m s a**" = **5** = numuri simbolik i "*Hieros Gamos*", i Martesës (*bashkimit*, ingl. *togetherness*) së Shenjtë mes Qiellit (parimit mashkullor, 3) dhe Tokës (parimit femëror, 2). Pra numuri **5** simbolizon bashkimin *par excellence*, bashkimin *paradigmatik*. Prandaj edhe "**h a m s a**" = **5**, e për pasojë "**h a m**" (si edhe "**h e m**"...) vlen "*bashk*".
- 2) Dhe së fundi vetë fjala "**b a s h-k**", lidhet me Turqishten "**b e s h**" = **5** e pra është e njejta fjalë, në bazë të Rregullës të Përgjithshme që ne kemi cituar tashmë më se një herë.*

* Rikujtojmë këtu se: Në qoftë se dy fjalë nga e njejta gjuhë a edhe dy gjuhë të ndryshme, janë të ngjashme dhe referojnë tek i njejtë simbol, a në simbole të ndryshëm por ekuivalente, ato mund të kenë të njejtën prejardhje...

Nga sa më sipër del se ai që *ruhet* nuk është kuptimi ku referohet fjala *konceptualisht*, por simboli ku fjala referohet *simbolikisht*.

Kjo vërtetohet fare lehtë kështu:

Kuptimi (konceptual) = për-CAK-tim (lat. *definitio*) = $\textcircled{1}$ = **kodi F**
 = \sim = *ndryshimi, mosruajtja...*

Referenca simbolike = **S i m b o l i** = *La logique du Tiers Inclus* [Chevalier]
 = $(x = -x)$ = **E** = $-\sim$ = *jo ndryshim, ruajtje...*

Është e tepërt të shtojmë këtu se shkenca klasike e etimologjisë vështronte si të pandryshueshëm, si Invariant, kuptimin *konceptual*, dhe jo atë *simbolik*. Që këndeje edhe gabimet "*madhore*" të kësaj etimologjie, si edhe rezultatet e saj të pasigurta, në mos po krejt të dyshimta.

Kurse në shkencën e re të etimologjisë që ne po inaugurojmë, referenca është tek Simboli, i cili nuk ndryshon, e pra lot rolin kështu të një *Invarianti etimologjik* (**E** = $-\sim$). Pra dhe një etimologji që përcjell tek simboli, s'ka se si të mos jetë krejt e sigurt dhe e pakundërshtueshme.

Në rastin tonë, mund të shkruajmë:

$$5 = \infty \quad \dots(F)$$

turq. **b e ş** shq. **b a s h-k**

Dhe jemi kështu mbrenda regullës, sepse kemi *dy fjalë të ngjashme* [*besh, bash-k*] dhe që referojnë në *dy simbole ekuivalente* [$5 = \infty$].

Nga ana tjetër, me qenë se simboli referon tek Qëndra, e pra tek Zoti, dhe m.q.s. ka vetëm një Zot (**1**), ne mund të nxjerrim si përfundim që këndeje se Invarianti simbolik është "pan-hapësinor" [(**s = 0**)] dhe "pan-kohor" [(**t = 0**)], a e thënë ndryshe "pan-botëror", gjë që na siguron se etimologjizimi ynë nuk pyet për ndarjet gjuhësore që realizohen nga *linguistika klasike* duke formuluar nocionin, jo gjer në fund "të saktë", të familjeve gjuhësore.

Ky studim na bind për herë e më tepër, për një Unitet të çuditshëm, por të vërtetë, gjer në instancë të fundit, mes të gjitha gjuhërave, pa përjashtim, pamvarësisht familjes gjuhësore ku ato bëjnë pjesë. Ky Unitet i admirueshëm shpjegohet me ekzistencën e një Algoritmi Simbolik, si artikullim llogjik i Mendimit Mistik, i cili dhe ay është një dhe i vetëm.

Do të zgjidhej kështu dhe problemi i "vet-komplikuar" i Monogjenezës: *Pó, të gjitha gjuhët rrjedhin nga një gjuhë e vetme, që por nuk është asnjë prej tyre, por një gjuhë thjeshtë simbolike, pas të cilës kalkohen fjalët e gjuhërave të ndryshme me bazë konceptin.*

Lidhur me këtë çështje mund të sillet si një konfirmim "poetik" edhe legjenda e Kullës së Babelit.

Mund të themi se situata në të cilën gjendet Kultura e Sotme botërore, duke përfshirë këtu të gjitha gjuhërat e mundshme të komunikimit e të përhapjes së Dijes (e pra jo vetëm gjuhët në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe të gjitha shkencat dhe aktivitetet e ndryshme njohëse), i ngjan tmerrësisht një Kulle të Babelit. Mund të themi madje se ne jetojmë sot, duam s'duam, në një botë "babeliane". Pra, që këndeje dhe nevoja e një Unifikimi Universal, i shkencave dhe i kombeve, të cilit do të mund ti shërbejë gjer diku edhe ky Studim yni modest.

229) Pers. **h a d ā** = ingl. *together* (bashk)

Me Shqipen:

$$h a d ā \rightarrow \text{shq. } k a d à = \textcircled{\text{D}} = F = \infty \dots(F)$$

Duke zgjeruar Bisedën:

Ekuivalenca simbolike që mund të duket e çuditshme mes *ndarjes* dhe *bashkimit*, s'është aspak e tillë, dhe kjo sepse *ndarja është antitetike me Unitetin* (të bërit "Një") dhe *jo me bashkimin, që nuk realizon Unitetin por vetëm një lidhje*. Gjuha e di mirë këtë... p.sh. në Inqlisht: "**b o u n d**" dhe "**b o u n d a r y**") = *kufi*, ndërsa: "**b o n d**" = *lidhje, bashkim* (në Gjermanisht: "*die B u n d*").

Kështu Inqlishtja shtron ekuacionin simbolik:*

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{\text{D}} & = & \infty \dots(F) \\ \text{bound} & & \text{bond} \end{array}$$

230) Pers. **d ā n a** = ingl. *offering* (ofertë, dhënie)

Është Shqipja:

$$\begin{array}{c} \text{d h a n j e} \\ \text{(nga folja "me dhanë")} \end{array}$$

231) Pers. **j y ā t u** = ingl. *life* (jetë)

Është Shqipja:

$$\text{j e t a}$$

* Përsërisim këtu se këto dy fjalë të Inqlishtes motivohen me Shqipen: "**b ë n d a**", ashtu si edhe: "**b o u n d a r y**" → "**b ë n d a r ë**".

232) Pers. **k u** = ingl. *where*

Është Shqipja:

k u

233) Pers. **v a r t** = ingl. *turn* (vërtit)

Është Shqipja:

v ë r t i t j e

(nga folja "me vërtit")

Që këndeje edhe Rusishtja "**v a r t a t i**" me të njejtin kuptim, që duhet të ketë rrjedhur nga Shqipja "**v ë r t i t**" dhe jo anasjelltas.

234) Pers. **p ā** = ingl. *protect* (ruaj, mbroj)

Është Shqipja:

me **p a**

në kuptimin "me u *kujdes* për dikë", "me marrë në *mbrojtje*" (ingl. *look after*).

Mund të shtojmë këtu se Inglishtja "**c a r e**" = kujdes (si p.sh. në shprehjen "*to take care of somebody*") është Shqipja "**k y r**" në kuptimin "me pa" dhe, në kuptim të zgjeruar, "me u *kujdes* për...", "me marrë në *mbrotje*", etj.

235) Pers. **a r š t i** = ingl. *spear, weapon* (shtizë, armë)

Theksi semantik bie mbi "š t i" që është folja Shqip:

me **s h t i**

(me gjuj-të)

që nga, ndër të tjera, edhe fjala tjetër e Shqipes "**s h t i - z a**".

* Po këtu lidhet edhe Rusishtja "**p r o v o r o t**" (поворот) = ingl. *to turn*, etj.

236) Sanskr. **d ū r a** (दूर) = ingl. f a r (larg)

Me Shqipen:

d a r → ⊕ → (A.....B) = *distancë, largësi...*

Le të vemë rë "tangjencialisht" këtu se në Inglisht: "**a f a r**" = larg, kurse në Shqip: "**a f ë r**" = " – larg" ("jo larg").

Shtrohet kështu ekuacioni simbolik *ndërgjuhësor* ($x = -x$) që është ai i Qendrës Mistike:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

shq. **afër** ingl. **afar**

Ne dimë se në **gjuhët** e stërlashta, si bie fjala gjuha Egjiptiane, dy koncepte të kundërta **trëgohe**shin me të njejtën fjalë.* Ky "zakon" ka mbetur, aty e atje, edhe në **gjuhët** e reja. Dhe mund të sillen plot shembulla si nga Shqipja, ashtu edhe nga **gjuhë** të tjera, që e rikonfermojnë këtë. Por ndodh, jo më të rallë, që një sistem i caktuar **gjuhësor** nuk mund ti "mbajë" dy të kundërtat të padalluara fonetakisht në gjirin e saj, gjë që do të jepte shkak për keqkuptim. Kjo shpjegon edhe përse ajo e "hedh" njërin nga partnerët e një çifti ekuivokal (homonimi signifikative) në një sistem tjetër **gjuhësor**.

Ja përse atëhere edhe tek Shqipja "**a f ë r**" ne duhet të shohim etimologjikisht Inglishten "**a f a r**" (larg), dhe anasjelltas.

Le ta zgjerojmë pas kësaj edhe më tej Bisedën, për të thënë disa gjëra që duheshin përmendur, bashkë me shumë të tjera, që në krye të Studimit, të që që do të ndiqnim një metodë *deduktive*. Por ne vendosëm, dhe për këtë e vumë në dijeni lexonjës, të ndjekim një metodë *induktive* të cilën e gjykuam pedagogjikisht, për një sërë arsyes, më të përshtatshme.

* Shih më lartë, fq.248.

Vazhdojmë...

Ekuacioni ($x = -x$) është ai i Qëndrës Mistike, i "*Coincidentia oppositorum*", ai i "*Tertium Datur*", që është njëlloj si të thuash i *Deus Datur*.^{*} Pra është ai i një llogjike (logos) *Hyjnore*. Ai është kështu atëhere edhe llogjika e *Inkoshjentit*.

E pra:

Gjuhët e stërlashta, duke treguar dy koncepte të kundërta me të njejtën fjalë, pozojnë një Llogjikë Hyjnore, pozojnë Llogjikën e Inkoshjentit, atë që ne quajmë kod E.**

* Llogjika e *Tertium Datur* shkruhet si ($x = -x$), që do të thotë se " x " mund të jetë njëkohësisht edhe " p " edhe " $-p$ " (ku " p " është një predikatë çfarëdo).

Dimë se: ($x = -x$) = *Coincidentia oppositorum* = Qendra Mistike = DEUS.

Ja pra përse themi se Llogjika e *Tertium Datur* (kodi E) është një Llogjikë Hyjnore.

** Riprodhojmë këtu nga Otto Rank, një pasazh nga libri "*Die Bedeutung der Psychoanalyse für die Geisteswissenschaften*" (Rëndësia e Psikanalizës për Shkencat Humanitare) që trajton problemin e Gjuhës dhe atë të Inkoshjentit:

"... Njohja e Inkoshjentit ka një rëndësi të dorës së parë për të kuptuar zanafillën dhe zhvillimin e Gjuhës, sepse ai [Inkoshienti] përmban trajtat primitive të mendimit të cilat ndikuan në kohërat më të hershme në formimin e Gjuhës...

Pa patur një ide të qartë e të saktë mbi mënyrën e të menduarit të *njeriut primitiv* është e vështirë të ngrihet një hipotezë mbi lidhjen e ngushtë mes Mendimit dhe Gjuhës.

Por që tani mund të flitet pa frikë për ndikimin e disa mekanizmave psikike të pavetëdijshme (Inkoshiente) mbi mendimin...

Por nga ana tjetër na thuhet [J. Chevalier: "Un dictionnaire des symboles"] që:

"La logique des symboles est la logique du Tiers inclus."
(Llogjika e simboleve është llogjika e të Tretit të përfshirë.)

e pra: kodi E, e pra: $(x = -x)$ e pra Qendra Mistike, e pra Inkoshjenti dhe llogjika e tij.

Duke qenë kështu, duke pohuar bashkë me Shkencën e Rë të Etimologjisë se *Fjalët referojnë në instancë të fundit tek një simbol (e jo tek një koncept!)*... ne pohojmë *implicite* se *Gjuha është pjellë e Inkoshjentit*. Që këndeje edhe origjina hyjnore e Gjuhës.

Mund të shkruajmë duke përmbledhur:

Gjuhët e stërlashka: *Dy koncepte të kundërta tregohen me të njejtën fjalë = $(x = -x)$ = Qendra Mistike, Parimi Suprem i Universit, Llogjika e të Tretit (Zotit) të Përfshirë, kodi E, simboli, Inkoshjenti...*

...Kështu, përveç veçorive që u përmendën më sipër, Koshienti ka edhe një veti tjetër: ai lind ndjenjën e *mospajtueshmërisë të të kundërtave* [*Koshienti* = $(x \neq -x) = (x = x) = F$]; ndërsa *Inkonshientit*, përkundrazi, i *parapëlqen ti njënjësojë* (identifikojë) edhe atëhere kur ato paraqiten *diametralisht të kundërta* [*Inkoshienti* = $-(x \neq -x) = (x = -x) = E$].

...Aftësia e *abstraksionit* dhe të të menduarit me *koncepte*, është arritur dalëngadalë... Për sa i përket çështjes *mbi format e mendimit që përdornin njerëzit e hershëm, të cilët nuk përdornin koncepte*, mund të formojmë një ide duke i referuar ato tek *Inkonshienti*. Edhe *Inkoshienti* nuk e njeh "formimin e koncepteve" dhe përdor një mënyrë tjetër, me pranë intuitës, që i lejon, të paktën gjer në një farë mase, të shprehë me besnikëri veçoritë dhe lidhjet e sendeve mes tyre: Simbolizmin.

Mund të ndodhë pra kështu që dy përfytyrime të ndryshme në mendimin tonë të lidhen ngushtë mes tyre në jetën psikike në nivelin e *Inkoshientit*."

Kështu gjuhët e lashta dhe, për pasojë, Mendimi i lashtë, është më afër Zotit dhe pra më afër të Vërtetës. Kurse, *gjuhët e reja, duke mos treguar dy koncepte të kundërta me të njejtën fjalë:*

$$(x \neq -x) \rightarrow -(x = -x) \rightarrow (x = x) = F = \text{Arsyeja} = \text{Koshjenti} \\ = -\text{Inkoshjenti}...$$

E pra këto gjuhë dhe ky mendim, i ashtuquajtur "shkencor", është një mendim jo hyjnor, jo aspak qëndror dhe i përqëndruar, por krejt i shpërqëndruar... dhe si i tillë jo i vërtetë. Kështu Njeriu, siç dëshmon "evolucioni" i Gjuhës, është larguar hap pas hapi nga Qendra e pra edhe nga Zoti. Të tjerat pò dihen...

Kështu:

"Të parët tanë kanë qenë hyjnorë..."

...Mendimi se dy koncepte të kundërt duhen vështruar si të barabartë është rimarrë sot nga Shkenca Moderne.

Kështu Niels Bohr, një nga themeluesit e Fizikës Kuantike, flet për dy lloj gjykimesh: 1) *të thella*, kur dhe e kundërta e një gjykimi të vërtetë është e vërtetë; dhe 2) *të cekta*, kur e kundërta e një gjykimi të vërtetë nuk është e vërtetë.*

Nuk është vështirë të kuptohet se Bohr-i shtron kështu teorinë tonë të dy kodeve:

$$\text{kodi } E = (x = -x) \text{ dhe } \text{kodi } F = (x \neq -x) = (x = x)$$

Është e qartë që ai vetë opton për kodin E, i zbatueshëm në *thellësinë* e materjes ("Subatomiku") dhe jo për kodin F, i zbatueshëm vetëm në

* Shih ndër të tjera edhe fq.97-98 dhe 233.

cektësinë, "sipërfaqen" e materjes. * Ajo që është tepër e rëndësishme, origjinale e revolucionare për t'u vënë re e për t'u theksuar me të madh këtu, është:

"Ekzistenca e një paralelizmi (analogjie, izomorfizmi...) të papritur dhe krejt origjinal, mes Dijes së Lashtë (egjiptiane,...) dhe asaj të Kohës sonë (Fizika kuantike)."

A, e thënë ndryshe:

"Ekzistenca e një paralelizmi mes dy thellësive, asaj në Hapësinë (Fizika Kuantike, subatomiku) dhe asaj në Kohë (gjuhët dhe mentaliteti i lashtë)."

Sipas Autorit të këtij studimi kjo shpjegohet me këtë parim, të panjohur gjer tani, dhe të cilin ai e formulon kështu, në trajtë të një aforizme:

*"Shka është e thellë në Hapësinë, është dhe e hershme në Kohë." ***

* Sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$F = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) = (x = x) = \bullet$$

Kodi F është ai pra i sipërfaqes së sferës, a shkurt, i sipërfaqes, dhe rrjedhimisht ai i materies dhe i llogjikës aristoteliane.

$$E = (x^3 + y^3 + z^3 = 0) = (x = -x) = \circ$$

Kodi E është ai i qendrës së sferës, a shkurt, i Qendrës Mistike, i thellësisë, i llogjikës jo-aristoteliane.

** Një aplikim të një parimi gjer diku të tillë gjejmë në embriologji dhe ky është ay i "Ontogjenezës që përsërit Filogjenezën".

Ashtu edhe depërtimi shkencor në thellësi, në "hapësinë" e qelizës, mundëson sot një kthim spektakolar në "kohën e kaluar", në të shkuarën e padiferencuar të qelizës, nga të ashtuquajturat "qeliza staminale".

Dhe vazhdojmë duke vënë në dukje se edhe fjalë të tilla si Shqipja "d e r i" (ingl. *up to*, gjerm. *bis*) dhe Latinishtja "d e r i - v a r e" = *me rrjedh, me prejardh...* lidhen prap me Shqipen "d ā r" dhe "d ā r + b ë r ë", dhe kjo sepse (në rastin e dytë: *derivare*), rrjedhimi i parë, superlatif, arkeotipal

Shtojmë këtu, për qëllime etimologjike, se fjala "staminale" rrjedh nga Shqipja "shtimun" dhe kjo sepse këto qeliza janë vërtetë "të shtimuna", të inkapsulluara, të mbrendashkuara në çdo qelizë normale.

Simbolikisht, kjo "panoramë" do të jepej kështu:

$$\text{stamin-ale} \rightarrow \text{shq. shtimun} = \boxed{\circ}$$

Këtu "o" përfaqëson qelizën e padiferencuar, ose të dediferencuar staminale (ose edhe kanceroze).

Simbolikisht kjo qelizë do të mund të jepej edhe si:

$$-\text{⊖}$$

ose edhe si:

$$-\boxed{\circ} = \circ$$

ku simboli i fundit mund të interpretohet edhe si "dalja integrale", emergjenca e asaj çka është "shtimun", e pra e asaj që "pas daljes" do të emërohej "qelizë staminale". Plotfuqishmëria e kësaj qelize shpjgohet me strukturën e saj simbolike, me qenë se:

$$\circ = \text{e Gjitha, gjithshka, çdo qelizë e padiferencuar...}$$

Kjo është edhe një nga arsyet që shpjgon përse qeliza staminale mund të zëvendësojë e të rigjenerojë çdo qelizë a ind të organizimit.

Duke u shprehur ndryshe do të mund të thonim se tërë kjo problematikë lidhet me të ashtuquajturën "Paradigma Holografike", që po emergon vullshëm sot në çdo degë të Dijes.

Le të përmendim këtu edhe studimin tjetër ende të pabotuar të Autorit mbi "Fillosofinë e Llogjikën e Mjekësisë".

është prejardhja (*derivimi*) e Botës materiale, që është bërë (një nga mitet kozmogonike) me një *n d a r j e*. Të njejtën gjë na thotë edhe Paracelsus.*


Së fundi mund të shtojmë, në trajtën e një "*Consensio linguarum*", edhe Gjermanishten "A u f **b r u c h**" = *fillim, nisje...* Me qenë se Gjuha denominon sipas një paradigme superlative, primordiale, këtu është fjala për *fillimin e Botës*, e cila paska nisur pra me një *t h y e r j e* = "**b r e c h e n**", e pra simbolikisht me " ⊕ ".

237) Pers. *g a m* = ingl. *to go* (iki)

Është Shqipja:

k a m (b)

(ingl. *foot*, ital. *gamba*)

Një dëshmi gjuhësore të pohimit të mësipërm na jep ndër të tjera edhe gjuha Egjiptiane, në të cilën hieroglifi i ecjes (ingl. *to go*) jepet me atë të këmbës ().

Kuptohet që dhe Inglishtja "*t o c o m e*", si dhe Italishtja "*c a m m i n a r e*", lidhet dhe ato etimologjikisht me Shqipen "*k a m*" ("*k a m b*").

238) Pers. *g r a b* = ingl. *seize, grab* (kap, grabis)

Është Shqipja:

g r a b i s

që lidhet ndoshta më thellë me Shqipen "*k r a h*".

* Shiko edhe fq.43, 113, 358, 670 dhe 761.

239) Akad. *a d i* = ingl. *until* (*d e r i*)

Me Shqipen:

$$a d i \rightarrow \text{shq. } \hat{a} d \hat{a} = \textcircled{1} = (A \cdots B) \dots (F)$$

Simboli i fundit është ai i "distancës", fjalë kjo që lidhet me Latinishten "*d i s t a n t i a*", që zërthehet e motivohet edhe ajo përmes Shqipes: *

$$d y s h T a n = 2 \cdot \textcircled{0} = -1 \cdot \textcircled{0} = -\textcircled{0} = \textcircled{1} = (A \cdots B)$$

Rikujtojmë se Rusishtja "*d o*" (*д о*) = ingl. *until* (*d e r i*), motivohet edhe ajo me ndihmën e Shqipes "*d a*" (folja *daj*) = ingl. *divide*. **

240) Akad. *b ā m t u* = ingl. *half* (gjysëm)

Dhe me Shqipen:

$$b ā m t u \rightarrow \text{shq. } b \hat{a} m t h y = \textcircled{1} = 1/2 \dots (F)$$

241) Akad. *b a n ū* (*bāni, bānu... bān*) = gjerm. *bauen; schaffen, erschaffen, erzeugen* (ndërtoj; bëj; krijoj, prodhoj)

Lidhet me Shqipen:

b ā n

nga folja "*b a j*" = krijoj, ndërtoj.

Ky operator është mjaft produktif në Shqip, si p.sh. siç pamë pak më lart: "*ban-esë*", "*ban-a*" (shtëpi), "*ban-oj*", "*ban-or*" etj. etj.

* Shiko edhe fq. 563 dhe 660.

** Shiko edhe fq. 64 dhe 65.

Gjë kjo që e bën këtë fjalë më "autonome" në Shqip se sa në Akadisht, ndonëse kjo e fundit është një gjuhë e stërlashtë.

242) **Asir. b û n u** = gjerm. *Entstehung, Bildung; Kind* (ndërtesë; fëmij, bir)

Vëmë re se në Shqip, krahas me "b a n" kemi dhe "b ë r".

Në Shqip:

"b ë r" dhe "b i r i"

Pra Shqipja na thotë se:

"Biri është i bëri."*

Por këtë gjë **na thotë** edhe Asirishtja me:

"b a n u" = bëj, bërje dhe "b u n u" = bir, fëmijë

Në Asirisht, gjithë me rrënjën "b a n" (= bëj) kemi edhe fjalë të tilla si:

"t a b n û" = krijesë

"t a b b a n û" = ndërtim

"t a b n î t u" = krijim; krijesë

Lidhur me kuptimin "ndërtesë" (gjerm. *Bildung*), shih më sipër (248).

243) **Asir. b i n u** = gjerm. *Sohn* (biri)

Gjejmë edhe kështu Shqipen:

b i r

Është e qartë se Asirishtja "b i n u" (= biri) lidhet si me prejardhësen e vet me Shqipen "b a n" (= bërje), me qenë se, siç pamë, "B i r i" është

* Shih edhe fq.193 dhe 559.

"i b ë r i", e pra do mund të thonim edhe se Asirishtja (e jo vetëm) "**b e n**" (në kuptimin e birit), rrjedh nga Shqipja "**b a n**", gjë që do të shkruhej simbolikisht si:

asir. "b i n u" < shq. "b ā n"

244) Akad. e d ū = ingl. *to know* (di, me ditë)

Është Shqipja:

â d i

(folja *di, dije...*)

Këtë operator e gjejmë të inkapsulluar, përveçse në Sanskritisht dhe Hebraisht, edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera të vdekura e të gjalla.

245) Akad. e l ū = ingl. *go up* (ngjitem lart)

Lidhet me Shqipen:

u l t, n-a l t

Le të kujtojmë këtu edhe shprehjen e Shqipes: "**Lá e më lá!**" në kuptimin "**Lart e më lart!**"...

246) Gjerm. T e i l = pjesë

Është Shqipja:

t h e l ë

Për sa i përket motivimit:

$$\begin{aligned} t e i l &\rightarrow \text{shq. } t h y \text{ Yll} \rightarrow 1/2 \cdot \star = -\star \\ &= [\star] = \text{⊙} = F = \text{Ⓢ} \end{aligned}$$

Një sqarim këtu është i nevojshëm.

Siç lexojmë tek Cirlot: "*the flaming star can symbolize the mystic Centre*",* gjë që na lejon të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} \star & = & (x = -x) = \bigcirc \quad \dots(E) \\ \text{star} & & \text{Center} \end{array}$$

Duke zgjeruar Bisedën themi se "th" dhe "f" alternojnë në disa raste në Shqip njëra-tjetrën, si bie fjala: "t h e l ë" por edhe "f e l ë", "f ë m i" por edhe (në Veri) "t h m i", e kështu me radhë... Le të shtojmë këtu se në Rusisht "th"-ja nistore është zëvendësuar gjithmonë me "f", si *Theodor Dostojevskij* ka dhënë *Fjodor Dostojevskij*, etj. etj.

Duke qenë kështu, me qenë se ndër të tjera:

gjerm. **Teil** → shq. **felë**

ne shohim se si në Shqip mund të shtrohet ky ekuacion i rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{felë} & & \text{filloj} \end{array}$$

që është në pajtim të plotë ndër të tjera dhe me të thënë e Paracelsus-it:

"Die Separatio ($\textcircled{1}$) ist aller Geburt Anfang (-1)."

Duke vazhduar më tej:

...Ne dimë ekzistencën në Gjuhë (në të gjitha gjuhët) të ekuacionit simbolik: **2 = -1**. Bie fjala në Italisht: "**ri-**" = **2** ("**ri-**leggere" në kuptimin *ri-lexoj*, *lexoj prej së dyti...*) dhe "**-1**" (*ri-muovere* = heq nga një post...).

* Cirlot (fq.310): '*Ylli i përflakur*' është një simbol i Qendrës Mistike...

Ose në Inglisht "**again**" = përsëri, e pra "**2**", dhe "**again-st**" = kundra, e pra "**-1**", etj. etj.

Tek Cirlot lexojmë se simbolizma e numurit ogursëz **2** përfshin edhe *mohimin* e Qëndrës, e pra "**-1**", e pra *mohimin par excellence* nëpërmjet të cilit u krijua Bota.

Të thuash se Bota është krijuar me një *ndarje*, e pra simbolikisht "**⊕**", a të thuash se Bota është krijuar me një *mohim*, "**-1**" ose "**⊖**", është e njëjta gjë, sepse Algoritmi Simbolik na jep:

$$\oplus = -\ominus \quad \dots(F)$$

Le të theksojmë këtu se ky ekuacion që mund të shkruhet edhe si: (**1/2 = -1**), jep më në fund (**2 = -1**) ose edhe (**3 = 0**) që përbën themelin e Arithmetikës Mistike.

Ky ekuacion i fundit shtrohet në Shqip me:

$$\begin{array}{ccc} 3 & = & \ominus \\ \text{tre} & & \text{tër} \end{array} \quad \dots(E)$$

Ky ekuacion mund të interpretohet ndër të tjera edhe si:

"E Tëra (**⊖**) përbën një Trinitet (**3**)."

Këtë na thotë edhe "*Caduceum*"-i me antagonizmin e të dy gjarpinjëve dhe me parimin spiritual (në trajtë të një zogu) qi i pajton, i unifikon ata.

Me qenë se pra: **2 = -1**, ne mund të themi se Shqipja "**f i l l o j**" = **-1** dhe Inglishtja "**f o l l o w**" (ndjek) = **2**, janë e njëjta fjalë. Dhe kjo sepse plotësojnë kërkesat e rregullës së përgjithshme: *Janë të ngjashme dhe referojnë në simbole ekuivalente* (siç janë "**2**" dhe "**-1**").*

* Shih dhe fq.50 dhe 551.

Formohet kështu një ekuacion simbolik *ndërgjuhësor*:

$$-1 = 2 \quad \dots(F)$$

shq. filloj ingl. follow

Është rasti këtu të vemë në dukje dhe një herë "gjerësinë" e Shkencës së Ré të Etimologjisë (që ne po inaugurojmë), ndaj "ngushtësisë" të Shkencës Klasike të Etimologjisë:

Ndërsa kjo e fundit lejon vetëm afrimin e fjalëve me një *kuptim të njejtë apo të përafërt*, Shkenca e Ré e Etimologjisë lejon afrimin edhe të atyre fjalëve që kanë *kuptime të ndryshme*, duke respektuar por ekuivalencën e simboleve *tek të cilët* ato referojnë.

Duke e zgjeruar Bisedën, le të shtojmë këtu edhe ca gjëra sa interesante *aq dhe të rëndësishme*, që hedhin dritë mbi *një unitet të thellë botë-kuptimor* mes gjuhëve të ndryshme dhe popujve që i flasin ato.

Në Shqip: "fëlliqje" = ● .

Në Inglisht: "filth" = fëlliqje, pisllek.

Mund të shkruajmë atëhere:

$$-1 = \bullet = 2 \quad \dots(F)$$

shq. filloj shq. fëlliqje
ingl. filth ingl. follow

Këtu: ● = "fëlliqje", por njëkohësisht edhe simboli i "Botës materiale".

Pra atëhere, me Shqipen:

"Bota ka filluar (-1) me një fëlliqje (●)."

ose:

"Fillimi i Botës është i fëlliqur."

Dhe që *fillimi* i Botës është i *fëlliqur*, kjo dihet "botërisht" gjersa prapa *krijimit* qëndron një *krim*, *krimi* i famshëm *kozmogonik* (në Fenë e Krishterë: dogma e "*Peccatum Originalis*" = mëkati në zanafillë).

Por jo vetëm Shqipja, por edhe Inglishtja na thotë të njejtën gjë, me:

$$2 = \bullet \quad \dots(F)$$

dhe kjo me qenë se siç pamë e shkruajtëm më sipër:

$$\text{Fillimi...} = -1 = 2 = \bullet \quad \dots(F)$$

(ingl. **follow**) (**filth**)

247) Gjerm. **Z a n k** = zënkë, grindje

Është Shqipja:

z ë n k ë

nga folja "me u **z a n ë**" dhe "**z i h e m**", "z ë n j e", "z i m j e",

Në Gjermanisht "**Z a n k**" rri e izoluar nga çdo pikpamje, gjë që na shtyn të mendojmë se prejardhja e saj është nga Shqipja.

Le të flasim tani pak më gjerë për këtë operator të lirë të Shqipes dhe, mbi të gjitha, mbi përhapjen e tij.

Trajta e tij më e thjeshtë, monosilabike është "**z i**" (si p.sh. "me u **zi**"). Por në Shqip ndër të tjera "**z i**" = e zeza (gjerm. *schwarz*), e pra simb. \bullet .

Shqipja shtron kështu ekuacionin e thellë simbolik:

$$(\rightarrow \neq \leftarrow) = \bullet \quad \dots(F)$$

me u **zi** **zi**

dhe mund të sajojmë në këtë rast aforizmën:

"Me u zi, ndjell zi."

Në Italisht po me këtë ekuacion simbolik mund të sajohet aforizma:

"Dopo ogni *lotta* ($\rightarrow \neq \leftarrow$) un *lutto* (●)."

Në Shqip gjithashtu:

"Kush s'do të zihet, nuk përzihet."*

Ekuacioni që **shtron** kështu Shqipja është:

$$\begin{array}{rcc} \text{⌘} & = & (\rightarrow \neq \leftarrow) \quad \dots(F) \\ \text{për-zi-hem} & & \text{zi-hem} \end{array}$$

Operatorin "Z" ("zë", "zi", "za"...) e gjejmë, me një rrezatim të pasur semantik, në shumë fjalë të Shqipes.

Le të sjellim edhe disa shembulla të tjera: z â = *filloj* (në të folmen e Veriut), z ë = *filloj* (në të folmen e Jugut), z ë = *kap, burgos*...

E pra simbolikisht në Shqip:

$$z \hat{a}, z \hat{e} \text{ (filloj)} = -1 = F = \text{⌘} = \text{⊙} = z \hat{a}, z \hat{e} \text{ (kap)}$$

Simbolet "⌘" dhe "⊙" janë ndër të tjera ato të *kapjes*, të *burgosjes*.

Duke patur parasysh edhe ato që pamë më sipër ne mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{rcc} \text{⌘} & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{⊙} & = & -1 \quad \dots(F) \end{array}$$

* Shih lidhur me këtë edhe "*Libri i Aforizmave*", fq.14 dhe 143.

" - 1 " është numuri simbolik i "fillimit",* pra atëhere ekuacionet tona simbolike të mësipërme mund të interpretohen edhe si:

*"Bota filloi (- 1) me një zanje (∞),**
me një burgosje (□)."*

Në Shqip mund të formulohet atëhere kjo aforizëm:

"Bota me një zanje u ka zanë."

Por "z a n j e" (gjithnjë nga operatori "z â") në Shqip do thotë edhe *grindje, konflikt, luftë*.

Dhe atëhere mund të sajohet kjo aforizëm:

"Bota me një zanje (→ ≠ ←) u ka zanë (- 1)."

që ngrihet mbi ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{rcl} (\rightarrow \neq \leftarrow) & = & - 1 \quad \dots(F) \\ \text{z a n j e} & & \text{z a n j e} \\ (\text{grindje}) & & (\text{fillim}) \end{array}$$

Dhe ky është "përkthimi" simbolik i *mithit kozmogonik* të krijimit të Botës nëpërmjet një grindjeje, të një konflikti, të një lufte.

Përpara se të vazhdojmë me të tjera interpretime të operatorit "z a n", "z a", "z i", "z u", "z u r i", "z ë n j e"... etj. etj. të Shqipes, të prejdardhura që të gjitha nga operatori i lirë, i papërcaktuar e pra themelor i Shqipes

* Shiko edhe fq.70, 95, 389, 671 dhe 742.

** Le të shtojmë me këtë rast se ekuacioni simbolik: $\infty = -1 \dots(F)$, mund të vështrohet si ai i "*Hieros Gamos*".

" Z ", le të përmendim edhe Gjermanishten "Z a n k", për të cilën u fol këtu, që do të thotë prap "z a n j e", pra simbolikisht ($\rightarrow \neq \leftarrow$).

Që fillimi i jetës nis me një *kapje*, këtë ide e gjejmë edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera, siç do të shohim. Gjë kjo që mund të na shërbejë si një "*Consensio linguarum*", që dë të thotë si një "miratim", në kuptimin e një rikonfirmimi të përbashkët nga të gjitha gjuhët, të një të vërtete të zbuluar në një gjuhë të caktuar, të veçantë.

Kështu, bie fjala:

\square	=	- 1	...(F)
gjerm. fangen		Anfang	
(kap, burgos)		(filloj)	
shq. zë		zë	
shq. zanje		zanje	
lat. capere		incipere	
...		...	

Në Shqip: "zë një fëmijë" = ital. "*con-cepire un bambino*". Dhe s'do harruar se Italishtja "*concepire*" = "*con + cepire*" < "*con + capere*" = shq. "**k a p**" = shq. "z ë", dhe simb. \square ose për ekuivalencë, simb. ∞ .

Fillimi paradigmatic, e pra superlativ, e pra fillimi i Botës, është realizuar me një kapje, me një "burgosje" (\square).

Lind pyetja: *Burgosja e kujt?* Po është e qartë "e kujt": E simbolit " \circ ", i cili është ai ndër të tjera i Z e r o s, e pra i Hiçit, i të Tërës, i Infinitit, i Vakuumit,* e pra fundja më në fund, ai i Zotit (si zgjidhje e ekuacionit të Qëndrës Mistike, i "*Coincidentia oppositorum*").

* Kujtojmë këtu nga John Polkinghorne, fizikant, theollog, shkrimtar dhe prift anglikan, ndër të tjera edhe: "*The nearest analogy in the physical world*

Që Bota është krijuar nga *mohimi* (a *vet-mohimi*) i këtij "simboli", këtë të vërtetë e gjejmë ndër të tjerë edhe tek Heidegger-i kur, duke e interpretuar atë si "H i ç", "n i h i l", "n u l l a" në veprën e tij themelore: "*Was ist die Methaphysik?*", në versionin Italisht, ai shkruan: "Thënia e lashtë '*ex nihilo nihil fit*' [nga hiçi s'del asgjë] rifiton tani një tjetër kuptim që lidhet me vetë problemin e Qënjes, e ndaj pra mund të zëvendësohet me '*ex nihilo omne ens qua ens fit*' [nga hiçi dalin (lindin) të gjitha]"...^{*}

Që këndej del, ndër të tjera, se kusht i nevojshëm dhe i domosdoshëm i krijimit të Botës është " – ○ " e pra atëhere:

$$- (x = -x) = (x = x) = -1 = F$$

Që do të thotë: "Kalimi (që është një rënje = ingl. *fall*) nga kodi E tek kodi F". Po ky kalim, rënje, ndrrim kodi, përbën *skemën e përgjithshme të të gjitha mitheve kozmgonike*, skemë që siç dimë mund të shkruhet si:

$$E \downarrow = F$$

Gjermanishtja pozon, siç pamë, ekuacionin simbolik:

$$-1 = \oplus \quad \dots(F)$$

Aufbruch brechen

Pra: *fillimi* (i krijimit të Botës) si një *thyerje*... Kjo është në pajtim të plotë me atë që na thotë Paracelsus, kur e shpjegon krijimin me një "*Separatio*" e pra me një *ndarje*, e pra me një *thyerje*.

Me qenë se, nga ana tjetër, Algoritmi Simbolik jep:

[to God] would be... the Quantum Vacuum." [Analogjia më e ngushtë në botën fizike me Zotin do të ishte... Vakuumi Kuantik.]

* Shih edhe shënimin fq.136.

$$\textcircled{1} = F = \textcircled{\ominus} = -1$$

Auf-bruch An-fang

del qartë atëhere se të thuash se Bota është krijuar me një "t h y e r j e" (gjerm. *Auf-bruch*) apo me një "k a p j e" (gjerm. *An-fang*) është e njejta gjë.

Duke përgjithësuar, ne mund të themi, siç do të dalë edhe më qartë më tej, se:

"Bota fillon me një figurë çfarëdo, me një interpretim çfarëdo të kësaj figure, që përfshihet në kodin F."

Pikërisht ashtu siç del edhe nga skema e përgjithshme e miteve kozmogonike që pamë më sipër ($E \downarrow = F$), ku "E" mund të jetë një figurë çfarëdo (edhe për rrjedhojë një rreze çfarëdo semantike e kësaj figure), ndërsa "F" mund të jetë një figurë çfarëdo (dhe për rrjedhojë një rreze semantike çfarëdo e kësaj figure). Që këndej del ekzistenca e një numuri të madh mitesh kozmogonike, të gjitha të mundshme, sepse të gjitha *ekuivalente simbolikisht* mes tyre.

Do të mund të vazhdonim edhe më tej me plurisemantizmin e operatorit "Z" në Shqip, por po ndalemi, he për he, këtu, pasi bëmë të qartë prejardhjen e Gjermanishtes "z a n k" nga Shqipja.

248) Kinez. **z h e n g** (争) = ingl. *quarrel* (grindje, zënkë)

Është Shqipja:

z ë n k

249) Gjerm. **z e r** – = parashtesë foljore që tregon *ndarje, copëtim, shpërthim, shkatërrim...*

Le të vërtetojmë se si:

gjerm. "z e r" < "d e r" < shq. "d a r"

Për këtë, vëmë re se në Gjermanisht "d"-ja a "t"-ja nistore kthehet shpesh në "z".*

Kështu pra:

gjerm. **z e r** → shq. **d ā r** = ⊕ = (|)

Dhe ky simbol i fundit jep edhe kuptimin e "ndarjes" si "shpërthim", kuptim ky i fundit që është më themelori për këtë fjalë të Gjermanishtes.

250) Gjerm. z e r t e i l e n = ingl. *divide, split* (ndaj, copëtoj, pjesëtoj)

Zbërthimi i kësaj fjale të Gjermanishtes bëhet si:

z e r t e i l e n

dhe motivimi i saj me Shqipen:

d a r t h e l ë ...

e pra "**d a r t h e l ë**-s o j" = "ndaj në thela dhe i shpërndaj").

251) Gjerm. Z e r f a l l = ingl. *decay* (dekompozim, çthurrje)

Zbërthimi i kësaj fjale të Gjermanishtes bëhet si:

Z e r f a l l

Ku siç pamë më sipër:

gjerm. "**z e r**-" < shq. "**d ā r**"

* P.sh.:

gjerm. **z u** gjerm. **Z i e g e l** gjerm. **Z u n g e** gjerm. **z e h n**

ingl. **t o** shq. **t i e g u l l** ingl. **t o n g u e** ingl. **t e n**

ndërsa:

gjerm. "-fall" < shq. "fal" ("fal-item" etj.)

E pra e tërë kjo fjalë do të reduktohet në Shqipen:

dar fal-itje
("falem", "falitem")

252) Gjerm. **Z i e g e l** = ingl. *tile* (tjegull)

Është Shqipja:

tj e g u l l

253) Gjerm. **D a m m** = ingl. *dam* (digë, pritë)

Motivohet me Shqipen:

e **d ā m u n*** = simb. ①

Në zgjerim të Bisedës dhe si një "*Consensio linguarum*" përmendim këtu Rusishten "**d a m b a**" (дамба) = *digë*, si edhe Inglishten "**d a m**" gjith'po me atë kuptim, etj.**

254) Gjerm. **Z i m m e r** = ingl. *room* (dhomë)

Motivohet me Shqipen:

d a m u n A r

* Kalimi nga Shqipja "d a m u n" në Gjermanishten "D a m m" është kryer me një asimilim regresif: "-m n" → "-m m".

** Shih edhe fq.340.

Simbolikisht:

$$\textcircled{1} = F = \textcircled{0}$$

Në Shqip, me të njejtin kuptim edhe "h y m-j e", dhe është simbolikisht e njejta gjë: $\textcircled{0}$.

Përfitojmë këtu nga rasti për të vënë në dukje se rrënja Shqipe "h y m", që tregon *brendësi*, e pra *dhomë*, e pra *shtëpi* etj. etj., gjendet pothuaj *talīs qualis*, me të njejtën formë (si *morfemë*) dhe me të njejtën përmbajtje (si *sememë*), si në Gjermanisht ashtu dhe në Inqlisht, ku:

gjerm. **H e i m** (*shtëpi*) → shq. **h y m** je (nga *hyj*, i *hymë*,...) = $\textcircled{0}$

ingl. **h o m e** → shq. **h y m** je = $\textcircled{0}$

255) Gjerm. **G e h e i m n i s** = *efshehtë, sekret*

Motivimi me Shqipen:

g e h e i m n i s → shq. **ke H y m u n**... = *h y m u n* = $\textcircled{0}$

Dhe " o ",* Qendra Mistike, Zoti, është i H y m u n i, i fshehuni, i padukshmi *par excellence*, "i Hymi paradigmantik".**

Le të përmendim këtu edhe fjalën Latinisht "Deus **H i m m a n e n s**", ku "h i m m a n..." rrjedh Shqipja "i h i m u n u n", me një asimilim të grupit "m n" të Shqipes në "m m" të Latinishtes (asimilim progresif).

* Cirlot (fq. 138): $\textcircled{0}$ = *the Universe, Infinity, the All...*

Nga ana tjetër dimë se:

$$\textcircled{0} = (x = -x) = \text{Qendra Mistike} = \textit{the Supreme Principle of the Universe}$$

** Shih ndër të tjera edhe fq.177.

Një motivim më i imtë do të na jepte:

"H y m j a m u n"

Simbolikisht do të kishim:

Deus *Himmanens* = Zoti i *Himunun*... = "I himun jamun" = $\square \circ$ *

Rikujtojmë këtu Shqipen "H y u" = Zoti, e pra atëhere edhe aforizmen:

"H y u, A i q ë h y u."

Duke zgjeruar **Bisedën** jashtë tekstit themi se: Hyu, po të mos kishte hy, e pra të mos **fshihej**, duke u bërë kështu i padukshëm, do mos ishte i pavdekshëm. **Siç** lexojmë edhe tek të thënat e Hermes Trismegistus,** kusht i domosdoshëm i *përjetësisë* është *padukshmëria*, e pra fshehja, "hyrja brenda".

* Ekziston dhe një tjetër motivim, "zyrtar", i kësaj fjale si: "I m" (= shq. *në*) "m a n e n t" (= shq. *që mbahet, që manet, që qëndron, që banon*).

Shënojmë këtu se "m a n" ka dhënë Hebraishten "A m e n" dhe Shqipen "m a n" (m b a n). Është pra një rrënjë tepër e lashtë.

Një sinonim i kësaj fjale mund të vështrohet edhe "i n h e r e n t", që do të thotë "i brendshëm", që i përket mbrendësisë, që është "i h y r ë"...

Shqipja motivon fare mirë dhe këtë fjalë me operatorët e saj "h i n" dhe "h y r ë", që kanë kuptimin që të dy të *mbrendësisë*, të *integritit*.

** Kujtojmë këtu nga të thënat e Hermes Trismegistus:

(82) *What is God? The immutable or unalterable Good.*

[Ç'është Zoti? Një e Mirë që nuk ndryshon.]

Ky pohim i Trismegistus përkthehet në gjuhën simbolike si:

$(t = 0) = - \sim \dots(E)$

Krishti thotë në Ungjill:

*"Por ti kur do të lutesh ec në dhomën tënde, mbyll derën,
dhe lutju Atit tënd që rri në të fshehtë.
Dhe Ati tënd që sheh në të padukmen do ta vërë veshin ty..."**

Në një vend tjetër në Ungjill, Krishti thotë:

*"Mbretëria e qiejve është brenda jush..."***

Kierkegaard-i pohon, nga ana e tij, se e Vërteta (e pra Qendra Mistike, Zoti...) është Subjektive, e pra *mbrenda* nesh e jo jashtë në Botën Objektive, të qenurit e të cilës sot Shkenca Moderne po e vë madje në dyshim.***

* Gjoni, 6:6.

** Lluca, 17:21.

*** Shkenca Moderne vë në dyshim ekzistencën e një "Realiteti Objektiv". Ky dyshim që tashmë është një siguri, filloi me lindjen dhe përhapjen e parimeve të Fizikës Kuantike, Frymës të së cilës Einstein-i iu kundërvu me sa mund, siç del qartë edhe në librin mbi debatin mes Bohr-it dhe Einstein-it, me titull "*The moon of Einstein*". Lidhur me këtë çështje shih edhe rubrikat e ndryshme në Internet që flasin për "*The illusion of reality*".

Është për të vënë re këtu si diçka tepër të rëndësishme se, që Bota ishte veç një mashtrim, një dukuri e rreme, sikundër po pohon sot Fizika Moderne, kjo bindje është shfaqur që në lashtësinë më të lashtë të njerëzimit dhe më tej, ndonëse Shkenca Materialiste e ka quajtur këtë pohim sa të rremë, aq edhe qesharak...

Janë të shumta shembullat e përputhjes së pohimeve të Dijes së Kohës sonë me ato të Dijes së Lashtë.

Kështu për shembull:

Në Sanskritisht "*m a t r a*" (*मात्रा*) do të thotë në të njejtën kohë *matje* dhe *materie*.

Që këndeje mund të dali edhe përfundimi se:

"Është matja ajo që krijon materien."

Në këtë përfundim ka arritur dhe Fizika e sotme Kuantike nëpërmjet Wheeler e të tjerë, të cilët pohojnë pikërisht *varësinë e materies nga matja*, në kuptimin që *nuk mund të ketë materie pa matje dhe as matje pa materie*. Mbi këtë, fizikanti i madh amerikan Wheeler, duke pranuar dhe ai rënien "katastrofale" të *parimit të shkakësisë* në Fizikën Moderne, thotë se ky parim zëvendësohet sot me një tjetër, me atë të "pjesëmarrjes" (ingl. *participation*), që qëndron në pjesëmarrjen e vrojtuesit në vetë procesin e krijimit të materies. Kjo bën që Njeriu (vrojtuesi) ta vështrojë Botën, me fjalët e Wheeler, si "*A Participatory Universe*".

Lakonikisht do të shkruanim:

☉ - ☉ Parimi i pjesëmarrjes = - Parimi i shkakësisë

Po ajo që është tejmas interesante dhe e çuditshme këtu është se, gjith po ky parim (zëvendësues i kauzalitetit) ekziston *talīs qualis* edhe ndër popujt e egër (sikundër na tregon e na bind anthropologu i shquar frëng Levy Brühl), si një trashëgimi tepër e lashtë nga njerëzimi i hershëm.

Në zgjerim të Bisedës ia vlen të shtojmë edhe sa vijon:

- 1) Rënia e parimit të shkakësisë dhe zëvendësimi i tij me një "*participatory principle*" shënon, siç vë në dukje ndër të tjerë edhe fizikanti gjerman i shekullit XIX Helmholtz, fundin e Shkencës së Fizikës, ashtu siç është përcaktuar e kuptuar nga Fizika Klasike, duke përfshirë këtu edhe Teorinë e Relativitetit e cila, edhe ajo, është e detyruar të "dorëzojë tashmë armët".

Dhe kjo sepse:

- Parimi i shkakësisë = - ↔ = *E* = - ∞ = - Relativitet
= - Teoria e Relativitetit

- 2) Tërë Fizika Klasike mund të transkriptohet simbolikisht në figurat simbolike (dhe rrezet e tyre semantike) të kodit F.

Por me qenë se ky kod përbën një *H o l o g r a m ë*, a tëhere mohimi, goftë edhe i një figure të vetme të këtij kodit, do të sillte me vete edhe mohimin e çdo figure tjetër të tij, e pra të krejt kodit *F*, e për rrjedhim edhe mohimin *a*, më saktë, superimin, e Fizikës (Shkencës) Klasike nga Fizika Kuantike.

Këtë mund ta shprehim konvencionalisht si:

Fizika Kuantike > Fizika Klasike

Në këtë kuptim, Fizika Kuantike mund të vështrohet si një *zgjerrim nec plus ultra* i Fizikës Klasike.

Një përfundim i tillë nuk do ti pëlqente aspak Einstein-it, sipas të cilit Fizika Kuantike nuk ishte e plotë. Por na vjen keq të themi se edhe këtu ai gabohej dhe kjo për arsye se:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Kuantike} &= \text{parimi i papërcaktueshmërisë} = -\text{⊕} \\ &= \text{○} = \text{plotësia, përsosja} \end{aligned}$$

E pa plotë, e pra e pa përsosur, përkundrazi, është Fizika Relativiste (bashkë me tërë Fizikën Klasike, si eksponent ekstrem, më i lartë, i saj).

Dhe kjo sepse kemi:

$$\begin{aligned} \text{Teoria e Relativitetit} &= \text{⊗} = \text{F} = \\ &= \text{○} = \text{jo plotësi, jo përsosje} \end{aligned}$$

- 3) Thamë më sipër se heqja dorë nga parimi i kauzalitetit bën që Fizika Kuantike dhe ajo pjesë e Shkencës? Moderne që miraton këtë heqje, nuk mund të vështrohet më si "Shkencë", por si një "Metashkencë", si një "Metafizikë" (edhe në kuptimin aristotelian të fjalës).

Kjo shpjegon ndër të tjera mundësinë, që po bëhet reale sot, të pajtimit të *Shkencës me Fenë*, ndonëse theologët e "pagabueshëm" të Kishës së Krishterë, ose sepse nuk kuptojnë se ç'po bëhet, ose sepse nuk e duan (për arsye që vetëm ata e dinë) këtë pajtim, këtë dhuratë të paçmuar të Frymës së Shenjtë, vazhdojnë të flasin, pa asnjë argumentim për "tendencat heretike të Shkencës Moderne".

Dhe së fundi le të kujtojmë se në Gjermanisht: "i n n e r" = *brenda* (ingl. *inside*) dhe "i m m e r" = *gjithmonë, përjetësisht* (ingl. *always*),* që rikonfermojnë, ndër të tjera, ato sa na thotë dhe Trismegistus.

Le të mos lëmë pa përmendur këtu, më në fund, dhe të thënë e shën Palit:

*"Mos harroni se trupi juaj është tempulli i Perëndisë..."***

Simbolikisht kjo do të jepej në këtë mënyrë:

$$5 = \boxed{\circ} \quad \dots(F)$$

Ku "5" është numuri simbolik i Njeriut, e pra ay vetë, ndërsa "o" është simboli, ndër të tjera, i Qëndrës Mistike, e pra vetë Zoti. Kështu që "[]" mund të vështrohet atëhere edhe si Tempulli (shtëpia) e Zotit (○).***

Në zgjerim të Bisedës shtojmë se në Gjermanisht mungon operatori "h y j", që do të mund të motivonte me mjetet e saja "H e i m", "G e h e i m n i s"... Ndaj pra, edhe këto fjalë Gjermanisht janë krijuar me "material gjuhësor" shqiptar, i huajtur, i fshehur, apo ndoshta edhe i vjedhur...

Ne kemi folur për raste të tilla (dhe nuk janë të pakta, por të stërshumta...) për *inkapsullime* (brendakallje) të operatorëve të lirë shqiptarë në këtë apo atë gjuhë. Prandaj pra edhe në këtë rast do të flasim për inkapsullimin

* Sërish nga të thënat e Hermes Trismegistus kujtojmë:

(21) *That which abides always, is unchangeable.*

[Shka qëndron gjithmonë, nuk ndryshon].

** Korinthianët I, 6:19.

*** Diçka të tillë na thotë edhe Heideggeri, si një reminishencë, mendojmë ne, të studimeve të tij rinore theologji: "*Man als Hirt des Seins*" (Njeriu si bariu i Qenies)... (shih edhe fq.134, 253, 445 dhe 646)

e operatorit shqiptar "h y j" ("h y m u n") në Gjermanishten "H e i m", "G e h e i m n i s" dhe në Inglishten "h o m e" etj. etj.

Operatori Shqiptar "h y j" ndeshet si i inkapsulluar (brendashkruar) edhe në shumë fjalë të Latinishtes ose me prejardhje latine.

P.sh. në Latinisht: "p r o h i b e r e" = ingl. *to forbid* (ndaloj, nuk lejoj...)

Motivimi do të bëhej në këtë mënyrë:

p r o h i b e r e

dhe me Shqipen:

p a r a h y b ë r ë

Kujtojmë se: "p a r a" = "1" por edhe "-1".*

Motivimi atëhere, duke zgjedhur këtu kuptimin e dytë (-1), përfundon me:

-1 □ bërë

e pra:

"bërë : -□"

Motivuar pra kështu me anë të Shqipes edhe këtë fjalë të Latinishtes, si shumë e shumë të tjera, të cilat me numurin e tyre jo të vogël dëshmojnë për faktin e mvarësisë etimologjike të Latinishtes nga Shqipja, dhe jo anasjelltas siç ndonjë gjuhëtar i keqinformuar apo tendencioz është munduar të vërtetojë.

256) Gjerm. H e i m a t = Atdhé

Zbërthehet në:

H e i m a t

* Shih ndër të tjera edhe fq.96, 377, 484 dhe 497.

Motivimi me anë të Shqipes:

h y m-ja e **A t**-it
(Shtëpia e Atit, e Zotit)*

257) Gjerm. **d e u t e n** = dëftej, tregoj, shpjegoj

Nga Shqipja:

d ë f t e n
(nga folja "dëftej")

Duhet të vëmë **r é k ë t u** se grupi "-e f-" i Shqipes jep herë–herë në Gjermanisht grupin **ekuivalent** "-e u-". Ky transformacion realizohet gradualisht kështu:

gjerm. "e u" < shq. "e f" < "e v" ...

Kalimet e rëndomta të "f" në "v" dhe të "v" në "u", pò dihen.

258) Gjerm. **d r e h e n** = me dredh

Është Shqipja:

d r e d h

"-hen" është një sufiks verbalizonjës në Gjermanisht (si bie fjala ndër të tjera në "verzie–hen", "ste–hen" etj.).

259) Gjerm. **D r e c k** = pleh; baltë; bajgë; m...

Që nga dhe "**d r e c k i g**" = i ndyrë, i pështirë, i neveritshëm.

* Shih ndër të tjera edhe fq.280 dhe 499.

Lidhet me Shqipen:

n d r a g
(fëlliq)

Nga ana tjetër, me qenë se kuptimet e Gjermanisht "d r e c k" lidhen me simbolin "●", ne mund të supozojmë se kemi:

gjerm. "Dreck" < shq. "Dreq" → shq. "n d r a g" = ● *

260) Gjerm. dreierlei = i trefishtë, i trellojshëm

Këtu: "drei-" = shq. "tre", ndërsa: "-lei" = shq. "lloj".

Atëhere pra me Shqipen:

i t r e l l o j-shëm

Shtojmë këtu jashtë teme se fjala "lei" = shq. "lloj", ndeshet edhe në gjuhën Kineze po me atë kuptim e trajtë "lèi" (類).

261) Gjerm. verdammern = dënoj, mallkoj

Motivimi:

ver dammen → shq. **bër dām un** = ⊕ = F = ●

Mund të krahasojmë këtu me Italishten "c o n d a n n a r e" = dënoj..., "d a n n a r e"^{**} = mallkoj..., Inglishten "t o c o n d e m n"...

* E pra atëhere edhe:

shq. "d r a g u a" (që nga dhe "n d r a g") = gjerm. "D r e c k"

** Le të shtojmë këtu se Italishtja shtron këtë ekuacion simbolik:

Të gjitha këto fjalë motivohen me Shqipen "d a m u n" (nga folja "DAj", të cilën e gjejmë si të tillë e me të njejtin kuptim, me atë të *ndarjes*, edhe në Sanskritishten: "d ā y a" (दाय).

Vëmë ré se "v e r-" këtu është një parashtesë verbalizonjëse që, siç do të bindemi nga shembujt e shumta nga Gjermanishtja, mund të identifikohet me Shqipen "b ë r" [Sansk. "b h a r a"; Hebr. "b a r a" (א ב ר)] = ingl. *to do*; ital. "f a r e".

Shembuj të tjerë të rolit verbalizonjës të "v e r-" janë p.sh. "ver-älten" = "bërë plak" = me u plak; "ver-ändern" = "bërë ndrysh" = ndryshoj, etj.

Duhet shtuar edhe diçka tjetër:

Parashtesa verbalizonjëse "v e r-" ka në disa raste edhe një kuptim negativizonjës, dhe kjo për arsye se *bërja* (gjerm. *ver-*) është vështruar

"condannare" = "condonare"

(dënoj)

(fal)

që është pra i trajtës:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

Le ta zgjerojmë tani Bisedën...

Simboli " ⊕ " është, ndër të tjera, dhe ai i *ndarjes* e pra edhe ai i *krijimit* (Paracelsus) të materjes e të Botës materiale: ⊕ = ● ... (F). Por, siç pamë me rastin e gjerm. *verdammen*, është edhe ay i mallkimit, i dënimit... Ne mund të nxjerrim si përfundim atëhere se:

*"Bota është kryer me një krim,
dhe se ajo si e tillë është e mallkuar, e dënuar."*

Të tillë pra, për pasojë, të mallkuar, të dënuar jemi edhe ne të gjithë, banorët e saj. (shih edhe fq.213, 243, 442 dhe 526)

mistikisht si një e keqe, si një *negacion* (gjerm. *ver-*). * Kjo përputhet plotësisht me ato sa na mëson Algoritmi Simbolik, që pozon:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{mohim} & & \text{bërje} \end{array}$$

Le të vëmë ré me këtë rast edhe një gjë tjetër: Shqipja "d a M U N" ka dhënë Latinishten "d a M N u s", Italishten "d a N N a r e", Inglishten "d a M N" dhe "c o n d e M N", Frengjishten "d o M M a g e", Shqipen "d ë N o j", Shqipen "d a m i", e kështu me radhë.

Të gjitha këto trajta të ndryshme që ka marrë Shqipja "d a m u n" shpjegohen lehtë fonetikisht. Kështu p.sh. në kalimin: "daMUN" → "doMMage", kemi një asimilim regresif, në kalimin: "daMUN" → "daNNare", kemi një asimilim progresif, e kështu me radhë.

Ne dimë se sipas Arithmetikës Mistike:

$$3 = 0$$

Që këndeje mund të nxjerrim:

$$2 = -1$$

...ekuacion simbolik ky shumë i përhapur në Gjuhë.

Mund të shkruajmë atëhere:

$$\underline{\text{D e m o n i}} = \text{i Damuni} = \textcircled{1} = 1/2 = 2 = \bullet = -1 \quad \dots(F)$$

* Ja se çfarë shkruhet lidhur me këtë çështje (mbi "biseksualitetin" e parafjalës "v e r") në fjalorin Gjermanisht-Shqip të Zef Simonit (fq.125):

"ver" = parashtesë e pandashme foljore që tregon: ...*dështim të veprimit, veprim të kundërt me veprimin e shprehur prej foljes pa parashtesë...*

(p.sh. "kaufen" = blej, "ver-kaufen" = shes)...

Pra Demoni lidhet me pjesën (⊕ , 1/2) dhe jo me të Tërën (- ○), lidhet me të keqen, me të zezën (●), lidhet me negativitetin (- 1). Të gjitha këto karakteristika të Demonit (djallit), që ne i gjetëm nëpërmjet analizës së Gjuhës, i rigjejmë edhe në vetpërcaktimet e Mefistofelit (demonit, djallit) në veprën "Faust" të Goethes.

Lexojmë në Pjesën e Parë:

*"Ich bin der Geist
Der stets verneint... (- 1)
So ist denn alles, was ihr S u n d e (●)
Z e r s t ö r u n g , k u r z d a s B ö s e (●) n e n n t
M e i n e i g e n t l i c h e s E l e m e n t ..."*

(Unë jam Fryma
Që përherë *mohon*...
...Pra dhe gjithshka, që ju quani *mëkat*
Shkatërrim, shkurt e *Keqja*
Është bash thelbi im...)

Dhe më tej:

*"Ich bin ein T e i l d e s T e i l e s (⊕)
Der in Anfang ein G a n z e s w a r ... (○)"*
(Unë jam një pjesë e asaj pjese
Që në fillim një e Tërë ish...)

Kështu pra Goethe në thotë se:

Djalli	= ●	= ⊕ , 1/2	= -1	...(F)
	(Böse)	(Teil)	(Vernein-ung)	
	(ligësi)	(pjesë)	(mohim)	

...të gjitha karakteristika këto të Djallit, që ne i gjetëm thjesht nga analizat tona gjuhësore.

262) Gjerm. **D ä m m e r u n g** = muzg; errësirë

Motivimi:

shq. **d a m u n A r** = $\textcircled{\ominus}$ = \bullet = terr, errësirë

Këtu "A r" simbolizon parimin dritësor, Diellin, Yllin, simboli i të cilit përputhet me atë të Qendrës.*

Algoritmi Simbolik jep:

$$\textcircled{\ominus} = \textcircled{\circ} \quad \dots(F)$$

↓

shq. **d a m u n A r** gjerm. **D ä m m e r u n g**
(perëndim)

263) Gjerm. **d e n k e n** = mendoj

Theksi semantik bie mbi "d e n-", ndërsa "-k e n" është një prapashtesë foljore, ndoshta e përputhshme me Shqipen "k e n" ("q e n"), pjesore e kaluar e foljes "me ken" ("me qenë").

Mund të shkruajmë tani:

d e n → shq. **d ā n** (nga folja "daj") = $\textcircled{\ominus}$... (F)

Por Algoritmi Simbolik (dhe ndër të tjerë, Paracelsus) na jep ekuacionin:

$\textcircled{\ominus} = \bullet$... (F)

në të cilin simboli " \bullet " mund të interpretohet ndër të tjera edhe si ai i materjes, *Botës materiale, mëkatit, të keqes, padijes, errësirës,...*

* Shih edhe fq.151 dhe 768. Ari, Ylli, etj.

Del që këndeje *një lidhje e thellë ndërmjet Mendimit dhe Botës Materiale*, një lidhje a paralelizëm që është vënë në dukje edhe nga shumë mendimtarë të shquar si Koestler sipas të cilit "*Bota nuk është tjetër veçse një Mendim i madh*",* si Spinoza sipas të cilit "*Ordo Ideorum = Ordo Rerum*",** si Wittgstein-i e të tjerë.

Gjuha e rikonfermon këtë në mënyra të ndryshme.

Kështu p.sh. në Gjermanisht:

Denke = Dinge
(mendim) (send material)

Në Inglisht:

think = thing
(mendoj) (send material)

a) Që Mendimi lidhet me numurin 5 që është në të njejtën kohë edhe numuri i Njeriut rikonfermohet nga sa lexojmë tek Cirlot:

"V j o l l c a: Në Spanjisht kjo lule quhet 'mendim' dhe kjo për arsye se është bash mendimin që ajo simbolizon me strukturën e saj

* *Arthur Koestler* (1905–1983). Gazetar eseist, shkrimtar, fillosof e shumë e shumë gjëra të tjera... Personalitet i shumanshëm, që ka lënë mbresa të thella në tërë botëkuptimin shkencor të shekullit XX. Mendimi tij lidhet me traditat më të hershme mistike të njerëzimit. Ai është, në këtë kuptim, një "irracionalist". Këtë e tregon më së miri në një libër që ka shkruajtur mbi Keplerin, si astronom dhe matematikan gjenial, në të cilin e shpjegon frymëzimin e tij nga struktura krejt irracionale, intuitive dhe mistike. Në librin që quhet "*The Sleepwalkers*" (*Sonambulët*), ai trajton dhe zhvillon idenë se nuk është arsyeja ajo që krijon veprat madhore, gjeniale, letrare dhe shkencore, por diçka tjetër, një mendim inkoshient i fshehur thellë-thellë në psiken njerëzore. Dhe është fjala, ndonëse ai vetë nuk është në gjendje ta artikullojë këtë, për llogjikën e kodit E.

** *Rendi i Sendeve = Rendi i Ideve*

të qartë *pesëkëndore*, duke qenë *p e s a* numuri simbolik i njeriut... *Pensamiento* në Spanjisht do të thotë 'mendim' dhe në të njejtën kohë, në të folmen popullore 'vjollcë'.^{*}

- b) Në një vend tjetër Cirlot na thotë se **5** është numuri i Njeriut pas Rënjes...^{**} Duke qenë kështu, ne mund të shkruajmë:

$$5 = (1) \text{ Mendimi dhe } (2) \text{ Njeriu}$$

E pra atëhere:

$$\text{gjerm. } D e n k e = \bullet = 5 = \text{gjerm. } D i n g e$$

Por:

$$5 = 1/2 = 0.5 = \textcircled{1} = \text{shq. "d ā n k e n"} = \text{gjerm. "d e n k e n"}$$

- c) Na thuhet se **5** është numuri i njeriut pas Rënjes (ingl. *The Fall*).

Lind pyetja: *Por sa duhet të ketë qenë numuri i njeriut para Rënjes?*

Le ta tregojmë këtë numur me "**x**".

Duhet të kemi:

$$x \downarrow = 5$$

Por, sipas Algoritmit Simbolik:

$$\downarrow = F = -1$$

Pra mund të shkruajmë atëhere edhe:

$$-x = 5$$

* Cirlot, (fq.249).

** Po aty, (fq.270): "Sipas traditës pesa simbolizon njeriun pas rënies..."

e pra:

$$x = -5$$

Por:

$$5 = 1/2 = -1$$

e pra atëhere:

$$x = 1 = \text{numuri simbolik i Zotit}$$

Pra ne mund të themi atëhere se:

"Njeriu është një Zot i rënë."

Dhe ky është një përfundim ("zbulim") i rëndësishëm, i cili rikonfermohet, ndër të tjera nga:

a) Rromakët e lashtë, tek të cilët gjendet kjo e thënë:

"Est Deus in nobis."

Pra:

"Ne kemi brenda Zotin."

Me qenë se numuri i Zotit është **1**, ne mund të shkruajmë:

$$\text{Njeriu} = 5 = -1 = \boxed{1} = [\text{Zoti}]$$

b) Krishti në Ungjill thotë: *"Mbretëria e Qiejve është mbrenda jush."*^{*} Dhe me qenë se Mbretëria e Qiejve identifikohet me Qendrën Mistike e pra me "○", e pra me "1",^{**} dhe me qenë se numuri i Njeriut është "5", mund të shkruajmë:

* Lluca, 10:28.

** Shih *Një parashtrimin i shkurtër i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit.

Me qenë se, siç kemi parë:

$$5 = \bullet \dots(F)$$

Njeriu Bota materiale

Vëmë ré se falë Algoritmit Simbolik ne arrijmë të kuptojmë *Përse*-në e thellë të "Parimit *Antropik*" në Fizikën moderne.

...Në Fizikën Kuantike po rivleftësohet sot e thëna, dikur e vënë në lojë, e Berkley, sipas të cilit:

"Esse est percepti."

E përkthyer *disi* lirisht në Shqip kjo do të thotë:

*"Një send mund të ekzistojë (vetëm) kur
mund të perceptohet (x = x)."**

Por perceptimi bëhet nga njeriu, pra është ai, fundja më në fund, që realizon perceptimin e, pra, të ekzistuarit e sendeve.

Fjala Latinisht "p e r c e p i" etimologjizohet si "b ë r k a p".**

Në Latinisht kemi: "p e r c e p i r e" = shq. "k u p t o j", perceptoj... dhe "c a p e r e" = shq. "m e k a p".

Pra shkurt: *Perceptimi* lidhet me një *kapje*...

Lind pyetja: *Kapje të kujt?*... Të Zotit!

* Einstein's comments: "I, at any rate, am convinced that He (God) does not throw dice." and "Do you really think the moon isn't there if you aren't looking at it?" exemplify this. Bohr, in response, said: "Einstein, don't tell God what to do."

** Shih edhe fq.133 dhe 378.

Le ta bëjmë të qartë këtë.

Algoritmi Simbolik na jep ndër të tjera formulën:

$$\bullet = \boxed{\circ} \quad \dots(F)$$

materje, **Zoti i zatetur,**
Botë materiale **i kapur, i zënë**

Kjo formulë na thotë ndër të tjera se Zoti është *përmbajtja*, në instancë të fundit, e gjithshkaje.

Fjala "**përmbajtje**" flet për diçka që është *brenda*, diçka që përbën *brendinë* e një sendi dhe që "mbahet", "përmbahet", *ndalohet* që të mos dali jashtë.

Edhe gjuhët e tjera ("*Consentio linguarum*") na thonë mbi këtë çështje të njejtën gjë.

Kështu për shembull në Italisht: "**contenuto**" = *i, e përmbajtur...*, ndërsa "il **contenuto**" = *përmbajtja, brendia* e një sendi.

Po ashtu në Rusisht, ku: "**soderzhanje**" (содержание) = 1) *përmbajtje, frenim*, si edhe 2) *brendí*.

Në Gjermanisht: "**Inhalt**" = *përmbajtja, brendija e një sendi...*, dhe në të njejtën kohë, "**halt**" (nga "**halten**") = *ndaloj, nuk le të dalë...*

Dhe e njejtja gjë edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera.

Pra brendia e sendeve, që është vetë Zoti, nuk lihet të dali, të shfaqet *ashtu siç është*, e pra si një substancë* e një trashëndence Hyjnore.

* Në kuptimin pra të *Substantia*-s "Spinoziane". Zbërthimi etimologjik i kësaj fjale: "**sub stantia**" = "ajo që rri ndën"..., thelbi, esenca...

Duke dashur ti shkojmë gjer në fund, në dimensionin fillosofik, kësaj çështjeje, le të rimarrim formulën:

$$\bullet = \square \quad \dots(F)$$

Kjo formulë përbën një ekuacion simbolik në F dhe, si çdo ekuacion simbolik, mund të interpretohet në mënyra të ndryshme.*

Por, pikësëpari: *Nga del e si del ky ekuacion?*

Për këtë nisemi nga ekuacioni i Qëndrës Mistike:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

Me qenë se " x " mund të jetë çfarëdo, mund të marrim: " x " = *brenda* dhe ta tregojmë këtë me " \square ", dhe: " $-x$ " = *jashtë*.

E do të arrinim kështu në formulën:

$$-x = \square \quad \dots(F)$$

Me mjetet shprehëse të Algoritmit tonë Simbolik, do ta përfytyronim atë si një rreth i vogël brenda katrorit, si më poshtë:



ku:

■ = materia, moduset e Substancës, copërat, pjesët e Saj = ⊕

○ = Substanca (Fryma e Shenjtë)

Dhe kujtojmë këtu gjithashtu Teilhard de Chardin: "*Dans le cœur de la matière, il ya l'Esprit...*" (Në zemrën e materies qëndron Fryma.)

* Shih gjithashtu shënimet për ekuacionet simbolike dhe mitet kozmogonike në *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, në fund të tekstit.

Por m.q.s. këtu, në Qëndër:

Brenda = Jashtë*

ne mund të shkruajmë edhe:

$$E = (x = -x) = (x = \boxed{x})$$

Pra:

*"Në Qendrën Mistike që përfaqëson Parimin Suprem të Universit, e brendshmja dhe e jashtmjja janë njëlloj."***

* Kujtojmë ndër të tjera, nga "Fjalori i Simboleve" nga Cirlot (fq.291):

"The most comprehensive and valid definition of the significance of form is that which appears in the legendary *Tabula Smaragdina*: "What is above is like what is below", which Goethe confirmed and bettered by adding: 'What is within' – the idea – 'is also without' – form..."

[Një përcaktim tërëpërfshirës dhe gjer në fund të vërtetë të formave, në kuptimin e tyre të mbramë, e gjejmë në të thënat tashmë legjendare të *Tabula Smaragdina*: "Ç'është lartë është dhe poshtë", që Goethe e konfirmoi, duke shtuar mbi këtë edhe: "Ç'është brenda (ideja) është dhe jashtë (forma)"...]

** Kujtojmë këtu nga "Libri i Aforizmave" (fq.639):

"God is the Outward and the Inward."

(Zoti është e Jashtmjja dhe e Brendshmja [në të njejtën kohë].)

(Kur'an, 57:3)


Sipas Algoritmit Simbolik kjo do të shkruhej:

$$x = \boxed{x} \quad \dots(E)$$

D.m.th. se Misticizmi Islamik pozon Qendrën, ashtu siç bën dhe Misticizmi Hebrë kur thotë që: para se të krijohet Bota, Zoti ishte dhe *infini* (∞) edhe *hiç* (\bigcirc). Me fjalë të tjera, para se të krijohet Bota, Zoti përbënte zgjidhjen e ekuacionit $(x = -x)$, zgjidhje që është, siç dimë, pikërisht ∞ dhe 0 .

Një situatë e tillë realizohet sipas Krishtit në Mbretërinë Qiellore...*

Një gjë e tillë, barazimi i të jashtmes me të brendshmen, realizohet edhe në të ashtuquajturën "Fletë të Mobius-it":**



Fleta e Mobius-it

Dimë nga ana tjetër se:

$$F = -E$$

e pra atëherë:

$$F = -(x = \boxed{x}) = (-x = \boxed{x})$$

*(e jashtmjja nuk është e barabartë me të brendshmen,
por e kundërt me të)*

Mirëpo ne mund të shkruajmë, gjithmonë sipas Algoritmit Simbolik:

$$(x = -x) = (x = \boxed{x}) \quad \dots(E)$$

që mund të shprehet me fjalë: Zoti është shka është brenda dhe shka është jashtë. Po ky është edhe një nga pohimet themelore të Misticizmit Islamik.

* Pyesin nxënësit Krishtin: "Kur do vijë Mbretëria e Qiejve?" Dhe Ay u përgjigjet: "Kur ta bëni dyshin (2) një (1), të jashtmen si të mbrendshmen..." (shih dhe fq.58-61)

** Në fletën e Mobius-it dallimi mes të brendshmes dhe të jashtmes zhduket, gjë që mund të ndodhë vetëm në një entitet infinit. Matematika që ngrihet mbi Fletën e Mobius-it përbën një nga armët teorike për përballimin e "infinitit", e pra e thënë ndryshe, me një term Biblik, "për njohjen e mendjes së Zotit".

Duke e zbatuar këtë formulë të fundit për: $x = \bigcirc$, do të kemi:

$$-\bigcirc = \boxed{\bigcirc}$$

e pra atëhere:

$$\bullet = \boxed{\bigcirc}$$

që është formula që kërkonim.

Trajta më e përgjithshme e kësaj formule do të qé:

$$F = \boxed{E}$$

Këtu në vend të "F" dhe të "E" mund të vihen dy figura simbolike çfarëdo korrisponduese nga sejcili kod.

Kështu duke marrë: $F = \bullet$ dhe $E = \bigcirc$, dhe duke interpretuar arkeotipikisht simbolin e parë si "materie" dhe të dytin si "Frymë" (lat. *Spiritus*, frengj. *Esprit*) ne rigjejmë të thënë e Teilhard de Chardin:

"Dans le coeur de la matière il a l'Esprit."

(Në zemrën e materies është Fryma.)

që mund të shkruhet simbolikisht, siç kemi parë:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F) \\ \text{matière} & & \text{Èsprit} \end{array}$$

Algoritmi Simbolik na jep:

$$F = (x = x) \quad \text{dhe} \quad E = (x = -x)$$

Pra: "jashtë", $F =$ Llogjika e të Tretit të Përrjashtuar (*Tertium Non Datur*) a ndryshe llogjika formale a aristoteliane, a shkurt e më në fund, "Arsyeja";

ndërsa "brenda", $E =$ Llogjika e të Tretit të përfshirë (*Tertium Datur*) ose edhe "Anti-arsyeja", "Anti-llogjika", "A b s u r d i".

Me qenë se:

$$(x = -x) = \textit{Coincidentia oppositorum}, \textit{Qëndra Mistike}, \textit{Zoti}...$$

ne shohim se mund ti mbiquajmë të dy llogjikat tona edhe ndryshe:

$$\begin{aligned} F &= \textit{Llogjika e Deus non Datur} \\ &(\textit{Zoti i Përrjashtuar}) \end{aligned}$$

dhe:

$$\begin{aligned} E &= \textit{Llogjika e Deus Datur} \\ &(\textit{Zoti i Përfshirë}) \end{aligned}$$

Duke u mbështetur në formulën e mësipërme mund të shkruajmë:

$$\textit{Deus Non Datur} = [\textit{Deus Datur}]$$

Kuptojmë atëhere ndër të tjera përse Krishti thotë: "*Mbretëria e Qiejve është brenda jush...*" e na këshillon ti lutemi Zotit në "brendinë" e dhomës sonë...^{*}

Për të treguar e vërtetuar se "E" dhe "F" janë të kundërta, mjafton të ndërtojmë tabelat e vërtetësisë të $E = (x = -x)$ dhe $F = (x = x)$ të vështruara si dy propozicione llogjike. Do të gjejmë se këto tabela janë të kundërta, do me thënë se:

$$T_{(x=x)} = -T_{(x=-x)}$$

që nga dhe nxirret se:

$$F = -E$$

* Shiko fq.282, 295, 410 dhe 645.

dhe, natyrisht, edhe:

$$E = -F$$

Në gjuhën e Fillosofisë së Kantit:

$$F = \text{Bota fenomenale} \text{ dhe } E = \text{Bota noumenale}$$

F dhe bota e saj mund të njihet nga Arsyeja e pra nga mendimi njerëzor, ndërsa E dhe Bota e saj, gjithmonë sipas Kantit, jó.*

* *Immanuel Kant* (1724–1804). Fillosof i famshëm Gjerman, autor i një numri të madh veprash të rëndësishme, nga të cilat më themelore dhe "epokale" është "*Die Kritik der reinen Vernunft*" (*Kritika e Arsyes së Pastër*). Në këtë vepër ai bën një analizë të hollësishme të rolit të Arsyes në njohjen e Realitetit. Ai vë në dukje "të metat" e saj, a më saktë kufizimet e kundërthëniet e saj të brendshme. Këto janë "antinomitë" në të cilat Arsyeja pashmangërisht do të ndeshet, sa herë që do të orvatet ti kalojë kufijtë e saj duke dashur të njohë të "Përtejmen", retroskenën e Realitetit Objektiv.

Fillosofia e Kantit mund të cilësohet edhe si një farë *agnosticizmi* (pamundësinë e njohjes gjer në fund të Realitetit) që dallon dy livele të Realitetit, atë "fenomenal" (të dukshëm, të prekshëm, të njohshëm, të cekët) dhe atë të padukshëm, e të panjohshëm, që ai e quan "noumenik". Në gjuhën e Algoritmit tonë Simbolik këto dy nivele janë kodi F (llogjika formale, Arsyeja, Bota materiale, cektësia dhe natyra e saj iluzore) dhe kodi E (llogjika esenciale a e të Tretit të Përfshirë, e thellë, e padukshme, e vetmja në instancë të fundit e vërtetë).

Për Kantin "noumeni" ("sendi në vetvehte" siç është quajtur) nuk mund të njihet. Mirëpo Dijsa moderne e veçanërisht ajo e Kohës sonë, si e mbi të gjitha Fizika Kuantike, po tregon se punët nuk qëndrojnë bash kështu, gjersa kjo shkencë (si edhe çdo shkencë tjetër bashkohëse "*des profondeurs*") po fillon të operojë (ndonëse jo krejt në mënyrë koshiente herë-herë) me kodin E, e pra me llogjikën e *Tertium Datur*, e pra me atë të *Deus Datur*, e pra me Logosin Hyjnor për të cilin "*S'ka asgjë të fshehur që nuk do të zbulohet...*" (Lluka 8:17).

Sipas fillosofisë së Kantit, Realiteti që ne perceptojmë dhe njohim është "i stisur", i organizuar sipas "kallëpeve" të mendimit tonë të arsyeshëm. Këto janë kategoritë *a priori* të famshme kantiane, ku bëjnë pjesë, ndër të tjera, *Kauzaliteti, Materialiteti, Koha, Hapësira, Graviteti, Relativiteti...* e kështu me radhë.

Vëmë re se:

Të gjitha këto kategorira a priori kantiane, përkojnë me figurat simbolike dhe rrezet e tyre semantike të kodit F (llogjikës formale, Arsyes njerëzore).

Kujtojmë se kemi:

$$F = (x = -x) = \leftrightarrow (\text{kauzaliteti}) = \bullet (\text{materialiteti}) = (t \neq 0) (\text{koha}) \\ = (s \neq 0) (\text{hapësira}) = \infty (\text{relativiteti}) = \downarrow (\text{graviteti})...$$

Kjo është Bota e *fenomenit*, një Botë e dukshme, e perceptueshme nëpërmjet shkisave e që "qeveriset" nga kodi F, nga Arsyeya dhe llogjika e saj formale, aristoteliane. Kjo është edhe Bota materiale e Fizikës Klasike dhe e çdo shkencë deterministe...

Por ne dimë se Fizika Kuantike operon (ndonëse nuk e shpall këtë "publikisht") me kodin E, që është i aftë të "arrijë" thellë e më thellë (për-tej veshjes ("këllëfit") material të Realitetit), deri tek vetë *thelbi* i materies, e pra deri tek "noumeni" kantian. Noumeni misterioz kantian nuk është tjetër veçse Fryma e Shenjtë, a ndryshe "*The Unbroken Perfect Symmetry of Holy Trinity*", që përputhet me atë, në gjuhën e Kozmollogjisë moderne, të "*The Unbroken Perfect Symmetry of Nothingness*", e pra simbolikisht si: $(x = -x) = \circ$. Dhe rigjejmë kështu *dictum*-in e famshëm të Teilhard de Chardin: "*Dans le cœur de la matière il ya l'Esprit*".

Kështu pra "noumeni" kantian është bash Fryma e Shenjtë, logosi i të cilës (i Mendjes Hyjnore, i Qendrës Mistike...) është $(x = -x)$ e pra kodi E.

Dhe kemi, siç dimë:

$$E = -F$$

dhe me qenë se:

$$F = (x = x) = \text{Ilogjika formale} = \text{Arsyeja njerëzore} =$$

$$\bullet = \text{Bota materiale} = \text{të gjitha figurat simbolike në kodin } F \\ = \text{të gjitha kategoritë a priori të Kantit...}$$

atëhere:

$$E = -(x = x) = -\text{Ilogjika formale} = -\text{Arsyeja njerëzore} = -\bullet = \\ \text{jo Bota materiale} = \text{asnjë nga figurat simbolike në kodin } F, \\ \text{por të kundërtat e tyre etj. etj.}$$

Ja pra përse Arsyeja, sipas Kantit, ndonëse na lejon të njohim *Botën fenomenale* nuk na lejon të njohim *Botën noumenale*, që do të mbetej për Kantin përgjithmonë e panjohur. Dhe këtu ai gaboi, se: a) sipas Krishtit në Ungjill, siç pamë, "Nuk ka të fshehur që nuk do të zbulohet" (Matheu, 10:26); b) Fizika Kuantike dhe të gjitha shkencat *des profondeurs* (si bie fjalë teoria e Inkoshientit në Psikologjinë Analitike të Jungut) pikërisht me këtë dhe po mirren, me ato suksese të stuhishme dhe mahnitëse që pò dihen.

Nga sa më sipër ne pamë kështu se esenca e Fillosofisë kantiane, ashtu sikundër ajo del ne pah më qartë se në çdo vepër tjetër të tij të "*Kritika e Arsyes së Pastër*", është krejtësisht e algoritmizueshme a, e thënë ndryshe: ne mund të shprehemi për *praninë e Algoritmit tonë Simbolik* (artikullim Ilogjik i *Philosophia Perennis*) në fillosofinë Kantiane.

Emergjenca sot, kudo në Dijen njerëzore, të kodit E, flet qartë për një Përmbysje epokale, për dy kolapse (që janë në thelb i njëjti): për Kolapsin e Arsyes e pra të Mendimit Njerëzor, dhe për atë të Materies e të Botës materiale.

Në gjuhën e simboleve:

$$E = -F = -(x = x) = -\bullet \dots$$

Në gjuhën fillosofike–shkencore të Bohm-it:*

F = Explicit Order ndërsa ***E = Implicit Order***

Mund të vërtetojmë dhe të ilustrojmë me shembuj të shumtë se *dikotomia* mes dy *Logos*-ve (llogjika) është e stërlashtë dhe në themel të mendimit e jetës njerëzore. Por këtu na intereson të vëmë në dukje më së pari se të menduarit si i tillë (në Gjermanisht "*denken*" dhe në Inglisht "*think*"), për të cilën e kemi fjalën, është vetëm e vetëm ai që përfshihet në kodin *F* dhe, si i tillë, ai do të ketë të gjitha vetirat e tij. Këto vetira "mishërohen" që të gjitha në figurat simbolike të këtij kodi dhe në spektrat e tyre semantike. Se ç'do të thotë kjo më konkretisht, do bëhet gjithnjë e më e qartë doradurës që do ecim përpara në parashtrimet tona.

* *David Bohm* (1917–1992). Fizikant i famshëm anglez. Do të mbetet më tepër se çdo zbulim tjetër nga ai, ndarja e tërë Realitetit në dy pjesë. Një pjesë është e shfaqur, e manifestuar, dhe përbën realitetin tonë konkret, material të cilin Bohm e quan "*Explicate Order*". Pjesa tjetër nuk është e shfaqur por e fshehur, nuk është jashtë por brënda. Bohm e quan këtë pjesë "*Implicate Order*". Skematikisht kjo situatë do të paraqitej si:

Explicate Order = [Implicate Order]

Gjërat në "*Implicate Order*" ndodhin krejt ndryshe dhe në të kundërt të atyre në "*Explicate Order*". Në shkrimin tonë flitet hollësisht për të gjitha këto dhe arrihet në përfundimin e rëndësishëm:

***Explicate Order* = kodi *F* = llogjika formale = $(x = x)$**

= llogjika e *Tertium Non Datur*... (Fizika Klasike)

***Implicate Order* = kodi *E* = llogjika esenciale = $(x = -x)$**

= llogjika e *Tertium Datur*... (Fizika Kuantike)

Kështu teoria (vizioni) i Bohm-it përfshihet i tëri pa mbetje, siç mund të vërtetohet, në Teorinë e dy Kodeve.

Një nga këto vetira dhe ndoshta më e rëndësishmja e tyre, mund të shkruhet si:

$$F = (x = x) = \textcircled{1} = \dots$$

Simboli " $\textcircled{1}$ ", si çdo simbol tjetër i Algoritmit Simbolik, ka tërë një spektër semantik, që do të thotë se ai mund të interpretohet "konceptualisht" në shumë mënyra. Për shembull si:



Kjo do të thotë atëhere ndër të tjera se:

- 1) Mendimi njerëzor (Arsyeja, llogjika aristoteliane, kodi F...) lidhet, realizohet me një *ndarje*. Pa ndarje pra, nuk ka mendim.
- 2) Mendimi njerëzor mund të "rroki", shpjegojë vetëm një pjesë ($\textcircled{1}$) të së Tërës ($\textcircled{0}$), të krejt Realitetit. Ai është pra kurdoherë pjesor, gjysmak, e pra atëhere, me qenë se e Vërteta është e Tëra ($E = \textcircled{0}$) del se përfundimet drejt të cilave na prin mendimi nuk mund të jenë, në instancë të fundit, absolutisht të vërteta.

Në këtë mënyrë, ne rikonfermojmë saktësinë, me anë të Shqipes, të etimologjisë të Gjermanishtes "d e n k e n" (= shq. m e n d o j) që shpie, tek e mbramja, tek koncepti i "n d a r j e s".

Gjuha vërteton me shembulla të ndryshme "gjysmakësinë" e Arsyes...

Kështu për shembull:

$$(x = x) = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

it. ragione	regione
ingl. rationality	ration
sanskr. artha	ardha
shq. n d a j	n d a j
.....

3) Ndarja ka një kufi, një cak. Kjo do të thotë atëhere se edhe mendimi ka një cak, **një kufi**, por jo vetëm në Hapësirë (pamundësia e tij për të rrokur e **shpjeguar tërë** Realitetin), por edhe në Kohë, që do të thotë se do vijë një **çast që** ai (si kod F, si llogjikë aristoteliane) do të pushojë së funksionuari.

Dhe kjo **kohë, çast** edhe vetëm teorikisht, sot ka ardhur.

Disfunksionimi i llogjikës aristoteliane dhe pasojat e saj në Shkencën moderne përbëjnë një fakt që askush sot nuk mundet më ta mohojë.*

* Llogjika Aristoteliane = $(x = x) = \textcircled{1} = \leftrightarrow = \bullet = \dots$

Kurse sot, në Fizikën Kuantike dhe në të gjitha shkencat "*sciences des profondeurs*", kemi:

- \leftrightarrow = rënia e parimit të shkakësisë
- $\textcircled{1}$ = rënia e parimit të përcaktueshmërisë, rënia e Fizikës Deterministe, parimi i papërcaktueshmërisë i Fizikës Kuantike...
- \bullet = rënia e konceptit klasik të materies ("the Death of Matter myth")
-

Me qenë se Algoritmi Simbolik është një Hologramë, del që edhe figurat e tjera simbolike të kodit E, në të cilën "noton" sot Shkenca moderne, kanë rënë apo po bien.

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$F = \textcircled{\ominus} = \bullet = \text{materia, Bota materiale...}$$

Mund të themi atëhere se edhe:

*"Bota materiale (●) ka një cak, një kufi, si në Hapësirë (s ≠ 0)
ashtu edhe në Kohë (t ≠ 0)."*

Bota materiale, e thënë ndryshe, nuk është e përjeteshme, ajo një ditë duhet të marri fund.

Dhe ja, përse atëhere në qarqet shkencore sot flitet përherë e më dendur për: *"The death of matter myth..."* (Vdekja e mitit të materies...)

Nga sa pamë më sipër, del e qartë se Rusishtja "d u m a t s" (думать) = *mendoj*, me qenë se duhet të lidhet me një ndarje, *mund* e duhet të motivohet me Shqipen: "d a m j e" = $\textcircled{\ominus}$.

Në Inglisht gjithashtu: "t o p o n d e r"* = *mendoj*, duhet motivuar si:

Shih lidhur me këtë *Një parashtrim i Shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

* E gjejmë këtë folje disi të vjetëruar në përdorimin mondan edhe në poemën e famshme të Edgar Allan Poe "Raven" ku lexojmë që në krye:

"Once upon a midnight dreary,
while I *pondered* weak and weary..."

Le të shtojmë akoma se fjala "p o n d e r" do të thotë edhe "p e s h o j".

Pra atëhere:

ingl. *ponder* → greq. *pende* = shq. *pes* = *peshë*

Simbolikisht mund të shkruajmë:

pon der → shq. **b ë n d ā r** = ①

Le të shtojmë këtu se fjala "p o n d e r" lidhet edhe me Greq. "p e n d e" (πέντε) = 5 , dhe ne pamë se numuri p e s ë (5) ishte pikërisht, ndër të tjera, edhe ai i Mendimit.*

Rikonfermohet pra kështu, prap e prap, saktësia e etimologjizimeve tona.

264) Gjerm. **b e t r ü b e n** = turbulloj..., pikëlloj, hidhëroj

Është Shqipja:

b ë t u r b u l l , t u r b u l l o j , t r u b u l l o j . . .

265) Gjerm. **b e s t r e u e n** = mbuloj, shtroj mbi...

Është Shqipja:

b ë s h t r ū

Operatori "s h t r u", "s h t r o j", "s h t r u m",... është tepër pjellor në gjuhën Shqipe. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për këtë operator në Gjermanisht.

Shembuj të semantizmit të pasur të kësaj rrënje në Shqip janë ndër të tjera: *shtroj rrugën, shtroj një drekë, shtroj një popull, një njeri i shtruar, le ta marrim shtruar..., nënshtrim, parashtrim, shtrojet... etj.etj.*

5 = ↓ ... (F)
p e s p e s h o j

Dhe ne pamë se numuri 5 është ai i Njeriut (e pra dhe i Mendimit) *pas rënjes*, gjë që simbolikisht jep pikërisht:

1 ↓ = 5 ... (F)

* Shiko edhe më lartë fq.310 dhe 470.

266) Gjerm. **b e k l a g e n** = qaj, vajtoj; ankothem

Është Shqipja:

q a j < k l a j < k j a j < k a j

Pra trajta më e mirfilltë, më e lashtë dhe e thjeshtë, është Shqipja:

k a j

Shqipja shtron ekuacionin e Qëndrës Mistike me:

$$\begin{array}{rcl} x & = & -x \quad \dots(E) \\ \text{q a j} & & \text{q e s h} \end{array}$$

Kjo flet, krahas shumë arsyeve të tjera, për një autoktoni më të lashtë të këtij operatori në Shqip se sa në Gjermanisht.

267) Gjerm. **b e i d e** = të dy, të dyja

Është Shqipja:

b ë d y = simb. 2

268) Gjerm. **d ü s t e r** = i errët; i ngrysur

Motivohet me Shqipen:

d y s h

e pra me simbolizmen e numurit 2.

Krahaso edhe me Sanskritishten "**d o ṣ a**" (दोष) = *mbrëmje, errësi, mëkat, e zezë, e keqe...* e cila edhe ajo motivohet, siç e kemi parë, me Shqipen "**d y s h**" e pra gjithmonë me simbolizmen e numurit 2.*

* Shih edhe fq.11-12, 157-164, 475 dhe 633.

269) Gjerm. **b e d i n g e n** = caktoj, vendos

Motivimi me Shqipen do të na jepte:

b e d i n g e n → shq. **b ë d ā n k a n** = **d ā n...** = ⊕ = *cak, caktoj...*^{*}

Që *caktimi, vendimi* lidhet me një *n d a r j e*, ekziston krejt një "*Consensio linguarum*" që e rikonfermon.

Kështu për shembull Inglishtja "**d e c i s i o n**" = *vendim*, që rrjedh nga Latinishtja "**d e c i d e r e**" që zbërthehet në "**d e + c i d e r e**", ku "**c i d e r e**" = shq. **k a d a r ë** = ⊕, etj. etj.^{**}

270) Gjerm. **b e d ü r f e n** = kam nevojë për diçka, më duhet (diçka)...

Pra kjo fjalë e Gjermanishtes na flet për një *mung-esë*, për një *mang-ësi*.

Që këndeje del qartë motivimi i saj me Shqipen:

b e d ü r f e n^{***} → shq. **b ë d ā r b ë n** = ⊕ = **F** = ○
= *jo tërësi, jo plotësi, mangësi...*

Një etimologji e tillë justifikohet edhe nga një "*Consensio linguarum*" mjaft i gjerë.

* Shtojmë se në Gjermanisht kjo fjalë lidhet me "**D i n g**" = *send, gjë...* Me qenë se "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang...*", me qenë se, me fjalë të tjera, gjithshka (duke përfshirë këtu edhe vetë Botën) ka lindur nga një ndarje, mund të shkruajmë:

gjerm. **D i n g** < shq. **d ā n** (folja **D a j**) = ⊕ = ● = *sendi material*

** Shih edhe fq.106 dhe 337.

*** "**-f e n**" është një formë e alteruar e përdorur shpesh në Gjermanisht, në fund të fjalës, si prapashtesë verbalizonjëse dhe zëvendësuese e Gjermanishtes "**-b e n**" (në Shqip folja: "**b ë n**").

Kështu për shembull, në Inglisht "w a n t" = *nevojë, mungesë*.

Por mund të shkruajmë, për motivimin e kësaj fjale:

w a n t

dhe me Shqipen:

b ë â n d à = ⊕ = - ⊙ , *mungesë*

Në Inglisht gjithashtu "n e e d" = *nevojë*, që lidhet edhe ajo me Shqipen:

â n d à

Në Rusisht gjithashtu: "m n i e n a d a" (мне-надо) = *kam nevojë për... më duhet...*

Motivimi me Shqipen na jep përsëri:

n d a = ⊕ = F = - ⊙ (*mungesë*)

E kështu me radhë...*

* Le të vëmë ré këtu se:

"ndarja" = ⊕ = F = - ⊙ (*jo plotësi, jo përisosje, jo tërësi...*)
= ~ (*lëvizje*)

Me qenë se gjithshka në këtë Botë priret për nga fundi, për nga e kundërta e vet, për nga përsosja, etj. etj., dëshira e njeriut është që të arrijë përsosjen, qetësinë, plotësinë, e kështu me radhë... gjë që do të mund të realizohej vetëm kur ai të mbërrinte tek Qëndra, që vetë nuk lëviz dhe që vë gjithshka në lëvizje. (Qëndra Mistike është quajtur nga Aristoteli: "*The Unmoved Mover*"...). Kjo do të bënte pra që lëvizja të pushonte dhe bashkë me të ankthi i vdekjes e çdo e keqe tjetër, shkaku i të cilës duhet kërkuar gjithmonë tek *ndarja*. Del pyetja: *Ndarja nga kush?* Përgjigja: *Nga Parimi Suprem i Universit, nga Qendra Mistike, nga Zoti.*

271) Gjerm. **K u l m** = ingl. *tip, summit*

Është Shqipja:

k u l m

272) Gjerm. **K r u s t e** = *k o r e* (buke)

Motivimi me Shqipen:

k o r e â s h t

Edhe Italishtja "**c r o s t a**" motivohet në të njejtën mënyrë edhe ajo nëpërmjet Shqipes. Le të shtojmë këtu se Shqipja "**k o r e**" dhe Inglishtja "**c o r e**" (= *thelb*) sajojnë sëbashku një ekuacion simbolik ndërgjuhësor të trajtës:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

ingl. **core** shq. **kore**

Një fenomen i tillë nuk është i rrallë në Gjuhë dhe kjo për arsye se, në gjuhët e para, si p.sh. në gjuhën Egjiptiane, dy koncepte të kundërta tregoheshin me të njejtën fjalë. Më vonë ky zakon u la, por mbeturinat e tij rezistuan "për inerci" në gjuhët që erdhën më pas, si mbetje, si relike të kësaj faze të superuar të Gjuhës. Gjuhërat e reja përpiqen ti shmangen këtij zakoni, i cili do të shkaktonte keqkuptime po të jetë se dy të kundërtat do të emërtoheshin me të njejtën fjalë. Prandaj sot vëmë ré se një nga "partnerët ekuivokalë" (një nga partnerë e homonimisë sinjifikative) hidhet për shmangie keqkuptimi, siç thamë, në një sistem tjetër gjuhësor. Shembulla të kësaj natyre kemi plot.

273) Gjerm. **n i e d e r** = i ulët; poshtë

Motivohet me Shqipen:

$$n d a r ë = \ominus = F = \downarrow \text{ (poshtë)}$$

Në zgjerim të Bisedës, vëmë ré se:

gjerm. "n i e d e r" = gjerm. "u n t e r"

sikundër që lexuesi e ka shumë të lehtë ta identifikojë.

Vlen të shtohet këtu edhe Gjermanishtja "h i n d e r n" në kuptimin *ndaloj*, që mendojmë se mund të motivohet me Shqipen si:

h i n d e r n → shq. h y n d ë r

e pra simbolikisht:

(|) = ⊕ = F = - E = - Qendra Mistike = - Zoti

Si përfundim mund të themi pra se:

"Ndërmjetësia e pengon, e ndalon komunikimin me Qendrën Mistike."

Pasojat që mund të rjedhin që këndeje janë të shumta dhe tepër të rëndësishme, por ndofta do të mirremi me to një herë tjetër.

274) Gjerm. K i t z = ingl. *young goat*

Është Shqipja:

k e c

275) Gjerm. K i t t = lëndë ngjitëse, zamkë

Lidhet, si me prejardhësen e saj, me Shqipen:

n g j i t

Le të vëmë në dukje këtu se në Shqip "ngjit" (me *ngjit*, *ngjitje*,...) nuk rri e veçuar si Gjermanishtja "kitt".

Në Shqip ky operator ka një spektër të gjerë semantik.

Kështu për shembull në Shqip:

$$\text{ngjitje} = \rightarrow () \leftarrow = \bigcirc = F = \uparrow = \text{ngjitje}$$

(ingl. *bonding*) (ingl. *rising*)

Mund të formulohet kështu me këtë rast aforizma:

"Duhet me u ngjit, që me u ngjit."

Në Shqip kemi gjithashtu fjalën "n g j i z o j" në kuptimin e "bërjes" (që rezulton kështu një "për-bërje"), e pra simbolikisht:

$$\text{ngjis} = \bullet \dots(F)$$

(bashkoj) (bëj)

Pra dhe, rrjedhimisht, mund të mendohet se:

gjerm. "kitt" < shq. "n gjit"

276) Gjerm. **spülen** = ingl. *rinse*

Është Shqipja:

shpëlj

277) Gjerm. **spät** = vonë

Është Shqipja:

shpejt

me kuptim të kundërt.

Shqipja dhe Gjermanishtja shtrojnë së bashku në këtë rast ekuacionin *ndërgjuhësor* të Qendrës:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

shq. **shpejt** gjerm. **spät**

(herët) (vonë)

Fjala Shqip "s h p e j t" është marrë këtu në kuptimin "herët", sikundër edhe Gjermanishtja "s p ä t" = "– herët" = vonë...

278) Gjerm. D a u m e n = ingl. *thumb* (gishti i madh i dorës)

Ky gisht është "i **d a m u n**" nga të tjerët, që nga dhe emri "**D a u m e n**" në Gjermanisht.

Mendojmë se edhe Inglishtja "**t h u m b**" do të mund të motivohej me Shqipen "**t h y m b ë**".

Ky motivim mund të justifikohet me faktin se gishti i madh mund të vështrohet si personifikimi figurativ i "Demonit" (I Damuni, i t h y m u n i).

Le të shtojmë më në fund këtu si kuriozitet se në Shqip ekziston një "prallë" sipas së cilës gjishtërinjtë e dorës, të gjithë së bashku, e qortojnë gishtin e madh, për qëllimet e tija të ulëta, duke e dëbuar nga mesi i tyre me këto fjalë: "Kjofsh i **d a m u n** prej nesh..."

279) Gjerm. d a r b e n = heq keq

Motivimi me Shqipen:

$$b \bar{e} n \ d \bar{a} r = \textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

ku simboli i fundit "●" është ndër të tjera edhe ai i të keqes.

Vëmë në dukje këtu, prap e prap, se Gjermanishtja "b e n", si prapashtesë foljore është Shqipja "b ë n" (nga folja "b ë j"), që mungon si operator i lirë në Gjermanisht. Atë e gjejmë në shumë fjalë të Gjermanishtes si p.sh.:

"s t e r - b e n" = me vdekë

nga Shqipja: "b ë n s t e r" = ● = e zeza, si ngjyra simbolizuese botërisht e vdekjes.*

Po ashtu në Gjermanisht:

"s c h r e i - b e n" = me shkrū, shkruaj

nga Shqipja "b ë n s h k r ū"...

Një etimologjizim më i shtyrë i kësaj fjale do të jepte:

k r r u → g r r y

dhe kjo për arsye se fjalët në kohërat e stërlashta g r r y h e s h i n në gur.

Që këndeje edhe në Greqisht "g r a m m a" (γράμμα) < Shq. "g ë r m a", që do të thotë *ad litteram* të "g r r y m u n a t".**

280) Gjerm. **bleiben** = qëndroj, rri, mbetem

Motivimi me Shqipen:

b ë l e j b ë n

ku theksi semantik bie mbi "l e i" nga Shqipja "l e" (me lānë, lej, lejoj, lāmun = la + jamun, lā...).

* Shih edhe fq.14-19 dhe 553.

** Shiko fq.164 dhe 552.

Ky operator nuk është i lirë në trajtën e tij më të thjeshtë, më të pastër monosilabike ("la", "le", ...) në Gjermanisht, si në Shqip.

Nga Shqipja vjen edhe Inglishtja "t o l e a v e":

l e a v e < **l e a v e n** = shq. "â b a n l e" (â ban lâ)

Ky operator i lirë i Shqipes gjendet bash i tillë e me të njëjtin kuptim edhe në gjuhën Kineze ku "l i" (离) = ingl. *to leave*.

281) Gjerm. **B u n d** = bashkim, federate

Motivohet me Shqipen si:

B u n d → shq. **b â n d à** = $\textcircled{1}$ = **F** = X = *bashkim*...

Le ta zgjerojmë tani Bisedën...

Një konkretizim gjuhësor të ekuacionit simbolik ($\textcircled{1}$ = X) e gjejmë edhe, ndër të tjera, në Inglisht ku:

$\textcircled{1}$	=	X	...(F)
bound		bond	
(kufi)		(bashkim)	

Në Shqip:

$\textcircled{1}$	=	X
pjesë		bash-k *

E kështu me radhë...

* **P e s ë** = **5** = numuri i *Hieros Gamos* = numuri i **bashkimit** të Qiellit (parimi mashkullor, **3**) me Tokën (parimi femëror, **2**) = ... Kështu numuri **p e s ë** (**5**) është bashkimi *par excellence*, më i pari, më i lashti, si ay që u bë shkas për krijimin e Botës.

Le të shtojmë këtu se në Turqisht: **5** = "b e s h", që nga dhe shihet një kalim më i pranueshëm i: "**p e s ë**" = turq. "**b e s h**" = shq. "**b a s h-k**".

282) Gjerm. **E n d e** = ingl. *end* (fundi, caku)

Motivimi:

E n d e → shq. **â n d à** = simb. $\textcircled{1}$

Mund të themi atëhere se Gjermanishtja dhe Inglishtja shtrojnë ekuacionin simbolik:

X	=	$\textcircled{1}$...(F)
gjerm. und		Ende	
ingl. and		end	

Duke qenë kështu ne shohim se si të gjitha këto fjalë Gjermanisht dhe Inglisht **motivohen** nëpërmjet Shqipes "**â n d à**", e pra simb. " $\textcircled{1}$ ", dhe për ekuivalencë simbolike edhe " X ".

Vëmë ré gjithashtu se në Shqip:

d h e (ingl. *and*) e pra simb. X

dhe:

d à (ingl. *divide*) e pra simb. $\textcircled{1}$

Pra Shqipja edhe kështu shtron po atë ekuacion simbolik.

Një "arsye kozmogonike" e ekuivalencës simbolike ($\textcircled{1} = \text{X}$) është fakti se Bota (edhe sipas arritjeve të fundit të Kozmologjisë të sotme) është krijuar duke u nisur nga një entitet që mund të paraqitet simbolikisht

Dhe më në fund, ne jemi në gjendje të shpjegojmë edhe ekuivalencën simbolike: $\textcircled{1} = 5$. Për këtë mund të shkruajmë:

$\textcircled{1}$	=	$1/2$	=	0.5	=	5
p j e s a						p e s a

me " \bigcirc " (Hiçi, pika gjeometrike, "*Singularity*";* e Tëra, Infiniti, Qendra, Zoti, "*Unbroken Perfect Symmetry of Nothingness*",** vakuumi, "Mystic Void"...).

Shtojmë këtu se " \bigcirc " (shpesh herë e quajtur në gjuhën mistike edhe "Veja e Botës") "n d a h e t" (\oplus) në dy pjesë, që mund ti tregojmë simbolikisht si gjysma të " \bigcirc ", e pra me " (" dhe ") ". Ky është moment i parë e pra:

()

Momenti i dytë është kur këto dy pjesë "p ë r z i h e n", "l i d h e n" bashkë, e pra, në gjuhën e simboleve " \times ". Lidhja, përzjerja e këtyre dy pjesëve (parimeve) në përpjestime të ndryshme prodhon, krijon gjithshka në këtë Botën tonë materiale.*** Kështu pra shpjegohet ekuivalenca themelore e këtyre dy simboleve (ai i ndarjes, \oplus , dhe ai i bashkimit, lidhjes, \times).

Një gjë e tillë vërehet në Gjuhë, në kuptimin e dyfishtë të gërmës " S " (*sigma*) që mund të identifikohet krejt arsyeshëm me simbolin që ndan Yin-in nga Yang-u. Kjo gërmë ka edhe një kuptim "ndarës" e pra "mohues" (si p.sh. në Shqip: "s'dua" = nuk dua, "s'kam" = nuk kam...), dhe në të njejtën kohë edhe një kuptim "bashkues" (si bie fjala, ndër të tjera, në Rusishten "s-otksom" (с-отцом) = me babanë...).

* Sipas Stephen Hawking, Bota është krijuar nga një "*Singularity point*", që "ndodhet" jashtë Kohës e jashtë Hapësirës, e pra që përputhet kështu me pikën gjeometrike ($x^2 + y^2 = 0$), e pra edhe, për ekuivalencë, ($x = -x$) = Qendra Mistike = \bigcirc = Tërësia.

** Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

*** Shih lidhur me këtë çështje edhe Teorinë e Yin Yang-ut kinez (fq.111), si edhe figurën (fq.114) me Evën dhe Adamin dhe pemën e ndaluar të dallimit të së Mirës nga e Keqja.

283) Gjerm. **Brandung** = përplasje (dallgësh)

Theksi semantik këtu bie mbi pjesën e parë të fjalës, ndërsa "-u n g" është një prapashtesë stereotipe e kryerjes së një veprimi foljor.

Do motivuar si:

$$\text{b è r â n d à} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = (\rightarrow \nabla \leftarrow) = \text{kundërvënje, ndeshje, përplasje, ...}$$

Vëmë re këtu se edhe në Shqip kemi:

$$\text{ndeshje} = \text{nd à â sht} = \textcircled{1} = (\rightarrow \nabla \leftarrow) = \text{kundërvënje, përplasje, ...}$$

284) Gjerm. **Brand** = zjarr

Duhet motivuar si:

b r a n d

dhe me Shqipen:

$$\text{b è r è â n d à} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = (\rightarrow \nabla \leftarrow) = \text{kundërvënje} \\ = \text{ndeshje} = \text{ndezje} = \star$$

Duke e zgjeruar ende Bisedën shtojmë:

- 1) Zjarri është zbuluar historikisht pikërisht nga *përplasja* e rastëshme e dy gurëve. Edhe sot e kësaj dite në disa krahina të botës ai ndizet me goditje të gurit të strallit.
- 2) Ne vetë Gjermanishten kemi:

$$(\rightarrow \nabla \leftarrow) = \star \quad \dots(\mathbf{F})$$

Brandung	Brand
(ndeshje)	(ndezje, zjarr)

3) Në Italisht: "a c - c e n d e r e" = me *ndez*.

Kemi atëhere:

$$\begin{aligned} \text{a c - c e n d e r e} &\rightarrow \text{c e n d e r e} < \text{shq. k a n d a r ë} = \textcircled{1} = F \\ &= (\rightarrow \nrightarrow \leftarrow) = \text{shq. n d e s h j e} = \text{n d e z j e} = * \end{aligned}$$

285) Spanj. *a d e m a s* = ingl. *further, then; also, too...* (pas, më pas; gjithashtu, përveç asaj...)

Do zbërthyer në:

a d e m a s

Theksi semantik bie mbi "d e m" që është Shqipja:

d ā m

Mund të shkruajmë atëhere:

$$\begin{aligned} \textcircled{1} &= 2 \quad \dots(F) \\ \text{shq. "dā m"} &\quad \text{spanj. "ademas"} \end{aligned}$$

286) Greq. *a n d a m a* ($\alpha \nu \tau \acute{\alpha} \mu \alpha$) = ingl. *together* (bashkë)

Motivohet me Shqipen:

$$\hat{\text{a}} \text{ n d ā m} = \textcircled{1} = F = \infty = \text{bashkë}$$

287) Gjerm. *i n n e r* = mbrenda, i mbrendshëm

$$\text{i n n e r} < \text{shq. h i m u n A r} = \textcircled{\square}$$

288) Gjerm. *immer* = gjithmonë

$$\text{immer} < \text{himun Ar} = [\text{O} = - \sim = E = (t=0)]^*$$

Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm:

a) Dimë se kemi relacionin: $\bigcirc = \text{Ar}$.

b) Vëmë ré se e mbrendshmja është e përjetshme ($t = 0$), këtë pikërisht na thotë edhe Gjermanishtja me ngjashmërinë e fjalëve "i n n e r" (*brenda*) dhe "i m m e r" (*gjithmonë*), dy fjalë këto që reduktohen që të dyja tek Shqipja "h i m u n A r". Prandaj, fundja më në fund, është Shqipja ajo që na tregon se si:

"Një entitet që të jetë i përjetshëm [gjerm. immer] duhet të jetë i pashfaqur, nuk duhet të jetë jashtë, por brenda [gjerm. inner], e pra nuk duhet të ekzistojë [- exit]."

Këtë mendim e gjejmë, ndër të tjerë, edhe tek Hermes Trismegistus, sipas të cilit Zoti është i padukshëm pikërisht sepse është i përjetshëm.

Algoritmi Simbolik e bën fare të qartë këtë, sepse ai na jep:

$$\text{Z O T I: } " \bigcirc \text{ brenda} " = \boxed{\bigcirc} = [\bigcirc = - \sim = (t=0)]$$

$$\text{B o t a: } " \bigcirc \text{ jashtë} " = - \bigcirc = \bigoplus = F = \sim = (t \neq 0)$$

289) Gjerm. *mis-* = shenim nga fjalori Shqip-Gjermanisht

Është Shqipja:

$$\text{m o s} = - 1$$

* Kujtojmë këtu nga sentencat e Hermes Trismegistus (fq.399 dhe 494):

21) *"That which abides always, is unchangeable."*

[*Shka qëndron gjithmonë, nuk ndryshon*].

Le të shtojmë këtu edhe se Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccccccccc} -1 & = & 2 & = & \textcircled{1} & = & 1/2 & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{mos} & & \text{mas} & & \text{mas} & & \text{mes} & & \text{mu\~{s}} & \end{array}$$

Të gjitha këto kuptime mund të përmbliidhen në skemën:

$$m \{ o, a, e, u, \dots \} s$$

Spektri më i pasur semantik i Shqipes dëshmon për faktin se:

$$\text{gjerm. "m i s s" < shq. "m o s"}$$

e pra për një autoktonicitet më të thellë të Shqipes në krahasim me Gjermanishten për këtë fjalë.

290) Gjerm. *s c h w e r* = i rëndë

Lidhet si me prejardhjen e saj me Shqipen:

b a r r ë

(në kuptimin e *peshtës*)

Këtu lidhet edhe Greqishtja "**v a r o s**" (βάρως) = i rëndë. Lidhen këtu gjithashtu edhe të tilla terma shkencore si: "bari-qëndër" = qëndër e *gravitetit*, "baro-metër" = matës i *presionit*, etj. etj.

Le të vëmë në dukje këtu se Gjermanishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \downarrow & \dots(F) \\ \text{s c h w a r z}^* & & \text{s c h w e r} & \end{array}$$

* Le të vëmë ré këtu si zgjerim të Bisedës se koncepti i të zezës dhe ay i të rëndës afërsohen (identifikohen) shpesh në shumë shfaqje të jetës. Kështu

Duke interpretuar simbolin "●" si *masë inerciale*, ndërsa simbolin "↓" si *masa gravitacionale*, ekuacioni i mësipërm mund të interpretohet si "Parimi i madh i Ekuivalencës" në Teorinë e Zgjeruar të Relativitetit.

291) Gjerm. **G e s u n d** = ingl. *health* (shëndet)

Zbërthehet si:

G e s u n d

Dhe me Shqipen:

k e s h e n d
("ke shëndet")

Ky operator **i lirë në** Shqip është mjaft produktiv, gjë që s'mund të thuhet për po këtë **operator** të inkapsulluar në Gjermanisht ("ge-sund").

Është **kuptimplote** të vihet ré këtu se po kjo rrënjë ekziston edhe në gjuhën Kineze, në trajtën e "**s h ē n t ĩ**" (身体).

Ka dhe shumë e shumë fjalë të tjera të gjuhës Kineze që lidhen, si me prejardhjen e tyre tepër të lashtë, me operatorë të pastër Shqiptarë. Disa nga këto shembulla janë dhënë edhe në këtë Studim.

Duke patur parasysh distancën e madhe, si në hapësirë ashtu edhe në kohë, të këtyre dy gjuhërave, prania e operatorëve Shqiptarë në gjuhën Kineze, sikundër edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera, mund të shpjegohet vetëm duke supozuar se *gjuha Shqipe përbën zanafillën e përbashkët të të gjitha këtyre gjuhërave*, pamvarësisht familjes gjuhësore të cilës ato i përkasin. Edhe në këtë rast dhe në këtë mënyrë, Shqipja *heq kufijtë* dhe

për shembull, në një mortje (ngjarje e *rëndë*) vishen rroba të zeza. Gjithashtu edhe në ngjarje të rëndësishme (në jetën shoqërore, në politikë etj.) kërkohet gjithashtu që njerëzit të vishen me të zeza... Shih edhe fq.17.

Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

dëshmon për faktin, disi të çuditshëm dhe të papritur nga gjuhëtarë profesionistë, se *ndarja* rigjide e gjuhërave në familje të caktuara gjuhësore, nuk është krejt e saktë.

E thënë më thjeshtë, gjuha Shqipe ka shumë mundësi të cilësohet si "Gjuha Nënë" (gjerm. *Muttersprache*) e të gjitha gjuhërave, gjë që do të zgjidhte një herë e mirë enigmën ende të padeshifruar të Monogjenezës.

Heqja hipotetike e kufijve mes gjuhërave, gjë që realizohet me ndërhyrjen "mesianike" të Shqipes, duhet shpjeguar edhe me faktin tjetër themelor se Shkenca e Ré e Etimologjisë që ne po inaugurojmë, e referon fjalën, si tek prejardhja e saj, jo më tek *koncepti* – por tek *simboli*.

Dhe dimë që:

*"Qui decouvre une relation entre deux symboles,
ce trouve au centre de l'univers."*

(Kush gjen një marrëdhënie mes dy simboleve,
e gjen veten në Qendrën e Universit.)

Gjë që të tregon se pikëpamja nga e cila Etimologjia e Ré e sheh Gjuhën, është ajo e *Qendrës*, e Parimit Suprem të Universit, e pra më e sakta, më e vërteta, më e *qëndrueshmja* që mund të jetë.

Dimë gjithashtu që:

"Le symbol abat les murs."

(Simboli shemb muret.)

Pra mund të shkruajmë:

$$\text{Simboli} = - \text{⊕} = E = (x = -x)$$

$$= \textit{Coincidentia oppositorum}, \textit{"Philosophia Perennis"}^*$$

* Sipas Leibniz-it, e sipas Aldous Huxley edhe shumë e shumë studjuesve të tjerë të së Kaluarës dhe të së Tashmes, duhet të ketë ekzistuar një Fillosofi

Kjo shpjegon ndër të tjera dhe rënien e mureve që ndajnë, disi edhe sot, familjet e ndryshme gjuhësore, për të cilën u fol qoftë edhe shkarazi më sipër.

Shtojmë këtu edhe thujtjse-homoniminë në gjuhën Kineze:

"s h è n g" (圣) = ingl. *sacred, holy* (i shenjtë)

"s h e n t i" (身体) = ingl. *healthy* (i shëndetshëm)

Një gjë të tillë kemi edhe në Inglisht, ku:

"W h o l e" = e tëra; i shëndoshë (i shëndetshëm)

"h o l y" = i shenjtë

Simbolikisht do të kemi:

Whole = \bigcirc = $-\textcircled{1}$ = *i pa damë, i pa dëmtuar, i tanë... shëndosh*

Holy = i shenjtë = \bigcirc

Simboli " \bigcirc " është zgjidhja e ekuacionit të Qëndrës ($x = -x$), e pra të Zotit. Kështu gjuha Kineze na mëson se *shëndeti lidhet me shenjtërinë*.

e të Gjitha Fillosofirave (*La philosophie des philosophies*), nga e cila kanë rrjedhur ose të cilës, qoftë edhe në një mënyrë disi opake dhe implicite, i referohen të gjitha fillosofitë... e rrjedhimisht edhe të gjitha gjuhërat, me qenë se siç ka dalë haptas sot në Shkencë, edhe vetë Gjuhësia vështrohet dhe ajo tashmë si një Fillosofi, e për më tepër si një Fillosofi e Fillosofivë (Heidegger: "*Die Sprache ist das Haus des Seins...*").

Shënojmë më në fund se "identiteti": *Gjuhësi = Fillosofi* ("*It's the turn of Linguistics...*"), bëhet i mundur edhe për faktin themelor të referencës simbolike të fjalës dhe jo më të asaj konceptuale. Kjo sepse dimë se *koncepti ndan* (kodi F, arsyeja ose llogjika formale: $(x = x) = F = (x \neq (\neq x))$), ndërsa *simboli unifikon* (kodi E, llogjika e të Tretit të Përfshirë: $(x = -x) = E = (x = (\neq x))$).

Duke u kthyer tek Shqipja, vëmë ré se edhe ajo jep të njejtën lidhje mes "shëndetit" dhe "shenjtërisë". Kështu që dhe Shqipja na thotë të njejtën gjë: ...*Bëhuni të shenjtë, që të jeni të shëndetshëm.*

292) Rus. *z d o r o v i j* (*з д о р о в ы й*) = i shëndetshëm

Theksi semantik bie mbi "z - d o r o", që është Shqipja:

$$s' d a r ë = "- d a r ë" = - \textcircled{\ominus} = \textcircled{\ominus}$$

Analogjia me Inglishten është e plotë:

"whole" = a) i tërë, i plotë ($\textcircled{\ominus}$); b) i shëndosht, i shëndetshëm

"healthy" = i shëndosh

Le të vëmë ré me këtë rast, "jashtë themës", se Inglishtja shtron edhe ekuacionin shumë të rëndësishëm simbolik:

$$\textcircled{\ominus} = \textcircled{\ominus} \quad \dots(E)$$

hole W-hole

që jep të kuptohet se "vrime" (ingl. *hole*), e pra "pika" (gjeometrike) dhe "e Tëra" (ingl. *the All, whole*) janë simbolikisht ekuivalente.*

* Dimë nga Algoritmi Simbolik se:

$$\textcircled{\ominus} = (x = -x)$$

ku " $\textcircled{\ominus}$ " ka këtu kuptimin e infinitit (shih Cirlot, fq.123):

$$\textcircled{\ominus} = \text{the All, the Universe, Infinity...}$$

Dimë gjithashtu, po nga Algoritmi Simbolik se:

$$\textcircled{\ominus} = \text{the hole} = \text{pika, vrime} = (x^2 + y^2 = 0)$$

293) Lat. **stimulus** = stimul, nxitje

Mund të shkruajmë:

"**stimulus**" < shq. "**shtymje**"

294) Ital. **instinto** = instinkt

Kemi me Shqipen:

"**instinto**" < shq. "**hin shtyn**" = *shtymje e brendshme...*

295) Ingl. **stripe** = rrip

"**stripe**" < shq. "**është(ë) rrip**"

Në Inglisht "**stripe**" = shq. rripa-rripa.

296) Ingl. **stream** = rrëké

"**stream**" < shq. "**është rrym**"

Dhe së fundi, gjithmonë nga Algoritmi Simbolik:

$$(x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

E thënë dhe ndryshe, ne jemi pra në gjendje të vërtetojmë ekuacionin e rëndësishëm të tërë mendimit simbolik:

$$0 = \infty$$

(zero) (infinít)

Shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit...

297) Ingl. **st a r** = yll

"st a r" < shq. "ë s h t ë A r"

298) Ital. **st e l l a** = yll

"st e l l a" < shq. "â s h t Y l l"

299) Gjerm. **S t r o m** = rrymë

"s t r o m" < shq. "â s h t r r y m ë"

300) Indon. **b e d a** = ingl. *difference* (dallim, ndryshim)

Motivimi jep:

b e d a → shq. **b ë d à** = $\oplus = -1 = (\neq 1) = \text{jo barazi,}$
diferencë, ndryshim...

Vëmë ré se edhe tek fjala "**n d r y s h i m**" (diferencë) e Shqipës, theksi semantik bie mbi "**n d r**" e pra:

n d a r-je = $\oplus = F = -1 = \text{diferencë...}^*$

301) Indon. **b u d i** = ingl. *reason* (arsye)

Do zbërthyer në:

b u d i

* Si një "*Consensio linguarum*" sjellim këtu edhe shembulla analloge zbërthimi në Inglisht: "**sever**" = "**several**", në Italisht: "**diviso**" = "**diversi**", në Shqip: "**dasi**" = "**disa**", në Rusisht: "**rezats**" (резать) = "**raznie**" (разные).

dhe me Shqipen:

$$b \ddot{e} d \grave{a} = \textcircled{1} = F = \leftrightarrow = \text{shkak} = (x = x) = \text{Arsye}$$

Le të shtojmë këtu, si një "*Consensio linguarum*", edhe:

$\textcircled{1}$	=	\leftrightarrow	...(F)
shq. pjesë		pasí	
sansk. ardha		artha	
gjerm. Halb		deshalb	
it. quindi (2)*		quindi	
fr. puis (2)		puis-que	
indon. beda		budi	
....		

Përftohet kështu një "*Consensio linguarum*" që dëshmon për saktësinë e etimologjizimit (motivimit) të fjalës Indoneziane "b u d i".

302) Indon. m e m b e d a k a n = ingl. *to distinguish* (dalloj)

Do zbërthyer në:

m e m b e d a k a n

dhe me Shqipen:

$$k a n b \ddot{e} d \grave{a} = \textcircled{1} = \text{dalloj}...$$

Le të vërejmë këtu se "m e m" është një parashtresë verbale për të sajuar paskajoren, pak a shumë si Shqipja "m e", p.sh. *me shkruet, me punue...*

* Me qenë se siç dimë: $\textcircled{1} = 1/2 = 2$, mund të themi se edhe gjuhë të tjera (si këtu Ital. *quindi*, Frengj. *puis*) shtrojnë të njejtin ekuacion simbolik.

303) Indon. **p e r b e d a** = ingl. *to differ* (me ndryshue)

Motivimi jep:

$$\begin{aligned} \text{p e r b e d a} &\rightarrow \text{shq. } \mathbf{b \ddot{e} r} : \mathbf{b \ddot{e} d \grave{a}} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = -1 = \dots \\ &= (\neq 1) = \text{jo barazi, ndryshim...} \end{aligned}$$

304) Indon. **p e r p e d a a n** = ingl. *difference, distinction* (dallim, ndryshim)

Është Shqipja:

$$\mathbf{b \ddot{e} r} : \mathbf{b \ddot{e} d \grave{a} n} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = -1 = (\neq 1) = \text{ndryshim...}$$

305) Indon. **d a n** = ingl. *a n d* (dhe, edhe, ende)

Është Shqipja:

d \grave{a} n

(nga folja "d a j" = ingl. *to divide*)

Algoritmi Simbolik jep:

$$\mathbf{d a j} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = \textcircled{\times} = \text{dhe, edhe...}$$

306) Shq. **e n d e** = edhe

Motivimi:

$$\mathbf{e n d e} \rightarrow \text{shq. } \mathbf{\hat{a} n d \grave{a}} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = \textcircled{\times}$$

307) Asir. **p \hat{a} r u** = gjerm. *suchen* (me pa, me kërkue)

Motivimi:

p a r \grave{e}

(nga folja Shqip "me pa" = ingl. *to see*)

308) Gjerm. **s u c h e n** = kërkuj, shoh për...

Theksi semantik bie tek "s u", ndërsa "-k e n" është një prapashtesë foljore.

Pra motivimi:

s u c h e n → shq. **s y k e n** ("kansy")*

309) Ital. **c e r c a r e** = me kërkue

Motivimi:

c e r c a r e → shq. **k y r k r ý** ("kryj kyrjen", "kqyr")

310) Ingl. **c a r e** = **kqyrje**, përkujdesje

Motivimi:

m e k y r, k y r j e
(edhe në kuptimin e "kujdesit")

311) Kin. **d ā i** (歹) = ingl. *bad; wicked; evil* (i keq; i përdhosur; i lig)

Motivimi:

d a j (folja Shq. "DAj") = ⊕ = **F** = ● = *i keq, faqezi, zemërzi...*

Duke zgjeruar Bisedën:

Mund të arsyetonim edhe ndryshe:

⊕ = **F** = 1/2 = 2

* Shih edhe fq. 235 dhe 770.

dhe të referonim tek simbolizma e numurit 2, më i keqi, më ogursezi (●) nga të gjitha numrat.

312) Shq. b d a j = bëj (ital. *faccio, creo*)

Motivimi:

$$b d a j \rightarrow b \text{ ë } d a j = \textcircled{1} = F = \textcircled{\bullet}$$

Del pra edhe kështu (nga Shqipja) se bërja e Botës ka qenë një e Zezë (●), një fatkeqësi, një gjë e keqe.

313) Kinez. b à n (半) = ingl. *half, semi-; in the middle* (gjysëm; në mes)

Theksi semantik bie këtu tek bashtingëllorja "b" si gërmë e dytë (2) e alfabetit.

Duke qenë kështu, mund të shkruajmë:

$$"b" = 2 = F = 1/2 = \textcircled{1}$$

Që nga dalin dhe tërë kuptimet e fjalës "b à n":

2 (*partner, accompany*)

① (*fragment, piece, measure*)

1/2 (*half, semi-*)

Kështu edhe gjuha Kineze shtron, ndër të tjera, siç çdo gjuhë tjetër,* vargun e ekuivalencave simbolike:

* Është thënë dhe gjetkë se ekziston një "Invariant", një "quid" i njejtë për të gjitha gjuhët... dhe ky është *grupi i transformacioneve simbolike*, d.m.th. tërësia e ekuacioneve simbolike, që janë gjithmonë po ato, në të gjitha

$$\textcircled{1} = 1/2 = 2 \quad \dots(F)$$

- 314) Kinez. d u ā n (端) = ingl. *end, extremity* (skaj, ekstremitet, fund)
- 315) Kinez. d u à n (段) = ingl. *paragraph, segment, section, part* (paragraf, segment, seksion, pjesë)
- 316) Kinez. d u ā n (短) = ingl. *short; weak point; fault, lack...* (i shkurtër; pikë e dobët; gabim; mungesë...)
- 317) Kinez. d u à n (斷) = ingl. *break, stop; judge; sever* (frenoj, ndalem; gjykoj; daj, dalloj...)

Të gjitha këto fjale të gjuhës Kineze referohen, si tek paradigma e tyre kuptimdhënëse, tek Shqipja:

DAJ

("d ā n", "d ā m",...)

Sepse kemi:

d a j = $\textcircled{1}$ (to break, to stop...; segment...; end, extremity) = ...

Gjithshka këtu është e qartë, referimi për tërë këtë spektër kuptimesh të Kinzçes "d u a n" "funksionon" në rregull. Por prap, sidoqoftë, ndonjë sqarim këtu do të ishte i nevojshëm.

Shikojmë se Kinezçja "d u a n" ka njëkohësisht kuptimin e "mangësisë" dhe atë të "gabimit".

gjuhët që kanë qenë, janë e do të jenë... duke përfshirë këtu me termin "Gjuhë" edhe degët e ndryshme të Dijes njerëzore.

Algoritmi Simbolik e shpjegon fare mirë arsyen përse ndodh kjo:

mungesë = $-\bigcirc^*$... (F)

gabim = \bullet ... (F)

që nga dhe del qartë se: "mungesë" = "gabim", dhe anasjelltas.

Frengjishtja e ilustron këtë shumë bukur me biseminë e fjalës "f a u t e", që do të thotë në të njejtën kohë "mungesë" dhe "gabim".

Po ashtu edhe Gjermanishtja, ku: "f e h l e n" = ingl. *be lacking* (që mungon, i metë) dhe "F e h l e r" = ingl. *error* (gabim).

Përmbledhtaz pra, këtë situatë mund ta paraqesim kështu:

$-\bigcirc$	=	\bullet	... (F)
fr. faute		faute	
gjerm. fehlen		Fehler	
...		... ^{**}	

Pra *falë Shqipës dhe Algoritmit Simbolik* (që mund të nxirret fare lehtë nga Shqipja) *ne qemë në gjendje të motivojmë të gjitha kuptimet e fjalës Kineze "d u a n"* në të gjitha tjetërtheksimet kuptimbartëse të saj.

* Ndër kuptimet e shumta të këtij simboli është edhe ay i Tërësisë, siç shihet ndër të tjera edhe tek Cirlot (fq.123):

\bigcirc = *the All, the Universe, Infinity*

** Duke e zgjeruar disi Bisedën, mund të arrijmë në përfundimin se:

"Djali (\bullet), si kundërshtar i Zotit ($-\bigcirc$), nuk është tjetër veçse një pjesë (\bigoplus) e Tij." Pra, Djalli është i tillë vetëm sepse është i *mangët*, sepse është i *damun* ($\bigoplus = -\bigcirc$) nga Zoti.

Këtë koncept (atë të ndarjes, të mangësisë...) shpreh edhe fjala "d e m o n", një emër tjetër i Djallit, që motivohet me Shqipen: "i d a m u n".

318) Kin. **wǎn** (晚) = ingl. *late* (vonë)

Është Shqipja:

v o n ë

Kjo fjalë është në Shqip mjaft produktive (si p.sh. *v o n o j*, *v o n e s ë*, *v o n o h e m*, *i v o n u a r*...).

319) Indon. **b e r u a n g** = ingl. *to bear* (me bār, me bart)

Theksi semantik bie tek "b e r u" që lidhet me Shqipen:

b ā r

(**b a r t**)

Kjo rrënjë gjendet edhe në shumë gjuhë të tjera, si Sanskritisht, në gjuhën Kineze, në Greqisht, Inglisht... e kështu me radhë.

320) Indon. **b a n g a t** = ingl. *soon; quickly, fast* (shpejt, herët; me shpejtësi, nxitim)

Është Shqipja:

b ā n g u t

(ngut-je)

321) Indon. **b e r a n i** = ingl. *daring, valiant, brave* (i guximshëm, trim, burrëror)

Lidhet me Shqipen:

b u r r

Shtojmë këtu se edhe fjala "b r a v e" e Inglishtes lidhet edhe ajo, siç do të shohim më mirë më pas, me Shqipen "b u r r".*

* Shih edhe fq.432.

322) Indon. **b e n d u n g** = ingl. *to dam* (vu një cfrat, një pendë, vendos një digë)

Do zbërthyer si:

b e n d u n g

dhe me Shqipen:

b ë n d ā m = ①

(folja *ndaj, daj, dān...*)

Shtojmë këtu se edhe Shqipja "**p e n d ë**" (në kuptimin e *cfratit*) do zbërthyer, brenda Shqipes, si:

"p e n + d a" < shq. "**b ë n D A**" = ①

323) Ingl. **d a m** ("*break-water*") = digë, cfrat ("*prerës*", "*ndarës*" i ujrave...)

Motivohet me Shqipen:

d ā m, d ā m-j e = ①

nga folja "me **d à**", që mungon si e tillë në Inglisht.

324) Rus. **d a m b a** (**д а м б а**) = digë, cfrat

Motivohet me Shqipen:

d a m b a → shq. **d ā m b â** = "b â d ā m" = ①

E tepërt të themi se Ruishtja nuk është në gjendje ta motivojë këtë fjalë me qenë se i mungojnë operatorët e lirë të duhur: "b â" (në kuptimin e *bërjes*) dhe "d ā m" (në kuptimin e *ndarjes*).

325) Indon. **c a r i k** = ingl. *to tear* (çjerr, gris)

Lidhet me Shqipen:

çjerr

Simbolikisht:

"çjerr" → "çarë" = ⊕ = F = ●

Kuptojmë atëhere përse në Shqip:

ngrys = ● = gris = ⊕

dhe përse në Rusisht "ç e r e n" (черень) = i zi, që motivohet po ashtu me Shqipen si:

çeren → shq. i çjerrun = ⊕ = F = ●

326) Indon. **m e m b e d a** = ingl. *discrimination* (dallim)

Duhet zbërthyer si:

m e m b e d a

dhe me Shqipen:

m e b ë d à = ⊕ = ndarje, "diskriminim"...

327) Ital. **d i s c r i m i n a r e** = ingl. *to discriminate* (diskriminoj)

Do zbërthyer si:

d i s c r i m i n a r e

Theksi semantik këtu bie tek "d i s + c r i m i n" që lidhet me Shqipen:

d y s h k r y m u n = 2 = -1 = F = ⊕ = ndarje, dallim...

328) Indon. **b e d a k a n** = ingl. *distinguishing* (diskriminues, dallues)

Do zbërthyer si:

b e d a k a n

dhe me Shqipen:

k a n b ë d à = ⊕ = *ndarje, dallim*

329) Indon. **b e r a k h i r** = ingl. *end; come to an end* (fund; krymje, përkrymje...)

Motivimi me Shqipen:

b ë r â k r y

330) Jap. **k e s h i** (消し) = ingl. *erase* (fshij, shuaj)

Motivohet me Shqipen:

k a s h u, k a s h u j t
("që f-shi-n")

331) Jap. **f u k i n** (付近) = ingl. *neighborhood* (fqinjësi)

Është Shqipja:

f q i - u

332) Jap. **m o r a u** (もらう) = ingl. *receive, obtain, get, accept* (marr, pranoj...)

Lidhet me Shqipen:

m a r r, m o r a...

333) Jap. **me kura** (盲) = ingl. *blind* (i verbër, qorr)

Është Shqipja:

qorr

(që nuk "kyr", "mos-kyr-je")

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë:

Në Shqip:

○ = ● ... (E)
me kyr qorr

Sajohet kështu një ekuacion simbolik në E, një rast i veçantë i "*Coincidentia oppositorum*" në Gjuhë, siç e vëmë re dhe në gjuhët tepër të lashta, si bie fjala gjuha Egjiptiane.*

Mund të sajohet edhe ky ekuacion simbolik ndërgjuhësor:

○ = ●
shq. me kyr jap. me kura

334) Jap. **biru** (ビル) = ingl. *building* (ndërtesë)

Lidhet me Shqipen:

bër, bër-je

335) Sanskr. **a-vidita** (अविदित) = fr. *inconnu* (i panjohur)

Dhe me Shqipen:

- bâ dit

("i pa-dit-ur", i panjohur...)

* Shih edhe fq.224, 234 dhe 249.

- 336) Sanskr. **a v i d y ā** (अविद्या) = fr. *ignorance*; [Vedānta] *l'illusion personnifiée par Māyā* (inJORANCË, paDIJE; [Vedanta]: iluzioni i personifikuar nga Maya)

Duhet zbërthyer si:

a v i d y ā

dhe me Shqipen:

- b â d i

("pa-dije", inJORANCË...)

- 337) Sanskr. **a v a - b a n d h** (अवबन्धति) = fr. *lier* (me lidh)

Duhet zbërthyer në:

a v a b a n d h

dhe me Shqipen:

â b â : b â n d â = ⊕ = F = ⌘ = *lidhje...*

Rikujtojmë këtu se në Inglisht: "**b o u n d**" (edhe "**b o u n d a r y**") = *kufi*, e pra simb. ⊕, dhe në të njejtën kohë "**b o n d**" = *lidhje*, e pra ⌘. Kështu që edhe Inglishtja shtron, sikundër edhe Sanskritishtja *me ndihmën e Shqipes*, ekuacionin e rëndësishëm simbolik në F:

⊕ = ⌘ ... (F)

ingl. **bound** **bond**

sanskr. **ava-bandh** **ava-bandh**

- 338) Sanskr. **a t i - b h a r a** (अनिष्ण) = fr. *charge excessive; trop gros travail* (barrë e tej rëndë, punë tepër e madhe)

Është Shqipja:

â t e j b a r r ë

339) Sanskr. **v i v a r a** (**विवर**) = fr. *qui a de trou, de manque* (që ka vrimë, që ka mungesë)

Motivohet me Shqipen si:

$$b \ddot{e} \ v \ddot{e} r \ddot{e} = \square \circ = F = \bullet$$

340) Sanskr. **a - v i m i t a** (**अविमित**) = fr. *démesuré; immense* (i pa matë, i pamatur; i pamasë, infinit)

Motivimi me Shqipen jep:

$$- \ b \ddot{e} \ m \ddot{a} \ t = - \ \ominus$$

("i pa-mat")

Në Shqip gjithashtu "i p a m a s ë" në kuptimin "që nuk është matur", por edhe në kuptimin e "infinite", pikërisht ashtu si edhe në Sanskritisht (ingl. *unmeasured; immense*).

Simbolikisht:

$$- \ \ominus = \bigcirc \quad \dots(E)$$

shq. i pamatë	i pamasë
sansk. a-vimita	a-vimita

341) Sanskr. **a - v i b h r ā n t a** (**अविभ्रान्त**) = fr. *ferme* (i patundur, i palëvizur)

Do zbërthyer e motivuar me Shqipen si:

$$- \ v i \ b e r e \ a \ n d a \ \rightarrow \ shq. \ - \ b \ddot{e} : b \ddot{e} r \ \hat{a} \ n d \acute{a} = - \ \ominus = E$$

$$= - \ \sim = \text{jo lëvizje, jo i lëvizur}$$

Në zgjerim të Bisedës, mund të themi edhe se:

"Lëvizja lind gjithmonë nga një ndarje."

Gjë që jepet me ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{1} = \sim \dots(F)$$

ital. metà	moto
rus. dva *	dvi-gats
shq. ndar-je	ndry-shim
....	...

Prandaj pra, në mungesë të ndarjes, nuk mund të kemi as lëvizje.

Gjë që na lejon të shkruajmë, si më sipër:

$$- \textcircled{1} = E = - \sim$$

342) Sanskr. **chid** (छिद्) = fr. *couper, briser* (pres, ndaj, këput)

Motivohet me Shqipen:

$$k a d à = \textcircled{1} = 1/2$$

* Vërejmë këtu se $(2 = 1/2)$ dhe kjo sepse

$$(2 = 1/2) \rightarrow (4 = 1) = (3 = 0) = \text{baza e Arithmetikës Mistike}$$

Duke qenë kështu mund të shkruajmë:

$$2 = 1/2 = \textcircled{1}$$

Kështu që Rusishtja: "d v a" = $2 = 1/2 = \textcircled{1}$.

Sankritishtja duke mos e patur të lirë operatorin "k a" (folja Shqip "k a m", me *pasë*, Lat. "h a-b e r e"), nuk është në gjendje të motivojë.

Le të shtojmë këtu me këtë rast se edhe Frengjishtja "b r i s-e r" mund të motivohet me Shqipen "p r e s", sikundër dhe Gjermanishtja "b r e-c h e n" dhe Inglishtja "b r e-a k".

Edhe fjalë të tilla si "b r e v i s" (= i shkurtër) në Latinisht, gjejnë motivimin e tyre të sigurtë në Shqipen "p r e s" (ingl. *divide, cut*).

- 343) Sanskr. a-nisna (अनिष्ण) = fr. *non formé, non initié* (i pa iniciuar, i pa formuar)

Është Shqipja:

- n i s *

("i pa-nisun")

- 344) Sanskr. s a n - T A N (सन्तानी) = fr. *continuer, maintenir la continuité* (vazhdoj, ruaj vazhdimësinë)

Theksi semantik bie tek "T A N" që është Shqipja:

e T a n a, e Tëra

(ingl. *the All*)

e pra simbolikisht " ○ " ose edhe " - ⊕ ", që jep qartë kuptimin e *pandërprerjes*, të *vazhdueshmërisë*.

E gjejmë këtë operator të lirë të rëndësishëm të Shqipes, të "inkapsulluar" dhe në shumë fjalë të tjera të huaja.

* Kujtojmë se në Shqip gjithashtu: "n j i s h" (nga "n i s h") = 1.

345) Sanskr. **a ti - b a d h a t e** (अतिबाधते) = fr. *causer un grand tourment* (shkaktoj një vuajtje të madhe)

Me Shqipen:

a t i b a d h a t e → shq. **â t e j : b â d à** = ⊕ = ● ... (F)

Shtojmë më në fund se këtu lidhet dhe Inglishtja "t o **b o t h e r**" = *bezdis, shqetësoj, bëj të vuaj...*, sikundër dhe Shqipja me të njejtin kuptim "**b a d h ë r**".*

Kujtojmë këtu Rusishten "**b e d à**" (б е д а) = *fatkeqësi, që motivohet me* Shqipen në të njejtën mënyrë, si edhe Inglishtja "**b a d**" = *ikeq* (●).**

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë edhe se, sikurse e dimë, Bota ka filluar me një ndarje (Paracelsus dhe jo vetëm) e pra dhe krijimi i Botës, me qenë se:

n d a r j e = ⊕ = F = ● = *ligësi, fatkeqësi...*

ka qenë një fatkeqësi e madhe (fr. *grand tourment...*).

Vërejmë edhe se në Shqip: "**b d a j**" = *bëj* (ingl. *to do*), duke u zbërthyer në "**b + d a j**" e pra "**b ë d a j**" → ⊕ = ● = *materializim, Botë materiale..., bërje..., e keqja...* na jep të kuptojmë se:

*"Bërja, çdo bërje, është e keqe dhe veçanërisht
e mbi të gjitha bërja e Botës."*

Kuptojmë atëhere të thënë e fillosofit të madh, të lashtë Kinez, Lao-Tze: "*Wu Wei!*" (無 為) = *Mos bëj!* ["**w**" = gërma e dytë e alfabetit "**b**" = - 1 , ndërsa "**w e i**" = shq. "**b ë j**"]

* Shih fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe.

** Vizioni tragjik i botës së lashtë...

Pra tërë *dictum*-i i famshëm i diturisë të lashtë e të thellë Kineze përkthehet me anë të Shqipes si:

– b ë j = " – realizoj " = " – materializoj " = – ●

Ja pra pse sipas Lao–Tze, të bërit (të krijuarit) është një e keqe, një krim, siç e mbështet këtë edhe Shqipja me aforizmën e saj të famshme:

"Me një krim, krymja."

Po këtë gjë na pohojnë dhe mitet kozmogonike (botëkrijuese), që flasin për një "*Cosmogonic Sacrifice*" a, e thënë ndryshe, për një *kurban*, e pra për një therrje *rituale*, për një krim.*

Si *rikonfermë* të sa më sipër mund të përmendim edhe biseminë e Greqishtes "*aitia*" (αιτια) = 1) *shkaku* dhe njëkohësisht 2) *faji, mëkati*. Është e qartë që, m.q.s. Gjuha emëron sipas një paradigme primordiale (superlative etj. etj.), Greqishtja "a i t i a" na flet për *shkakun e krijimit të Botës* (krijimit "maksimal", superlativ, primordial). Po siç pamë, kjo fjalë e Greqishtes do të thotë edhe "*faj*", "*mëkat*", "*krim*". Pra shohim atëherë se edhe mentaliteti i Greqisë së lashtë dënon, në mënyrën e vet, krijimin e botës, të kësaj Bote që nuk është ajo e vërteta, siç pohojnë e stërpohojnë dhe férat më të lashta të njerëzimit gjer, më në fund dhe me plot gojë, Féja e Krishterë.**

Mos harrojmë se sipas Krishtërizmit, qoftë edhe atij "zyrtar", në themel të krijimit të Botës qëndron i ashtuquajtur i "*peccatum originalis*", pra një mëkat zanafillor, një krim.

* Shiko edhe fq. fq.34-35.

** Kujtojmë këtu nga Ungjilli (Jakovi, 4:4): "...nuk e dini se miqësia me botën do të thotë armiqësi me Perëndinë? Ndaj pra, dhe cilido që do të bëhet mik me botën, bëhet armik me Perëndinë." (shih edhe fq. 21)

346) Sanskr. a-b a d d h a (अबद्ध) = fr. *non lié; non encore apparu; qui n'a pas de sens* (i palidhur; që s'është shfaqur ende; që nuk ka kuptim)

Motivohet me Shqipen:

$$a \ b \ a \ d \ d \ h \ a \ \rightarrow \ shq. \ - \ b \ â \ d \ à \ = \ - \ \textcircled{1} \ = \ E \ = \ - \ \infty \ (non \ lie) \ = \\ - \ \bullet \ (non \ encore \ apparu) \ = \ - \ (x = x) \ (qui \ n'a \ pas \ de \ sens) \ = \ \dots$$

Zgjerojmë tani Bisedën:

1) Shqipja na thotë se:

"Gjithshka *lind* është *land*..."

Kjo mund të shkruhet si:

$$-1 \ = \ \bullet \ \dots(F) \\ \text{lindje} \ \quad \text{landë} \\ (\text{fillim})$$

Gjithashtu në Shqip dhe në Frengjisht:

$$-1 \ = \ \bullet \ = \ \infty \ \dots(F) \\ \text{naissance} \ \text{apparation} \ \text{lié} \\ (\text{fillimi}) \ \quad (\text{shfaqja}) \ \quad (\text{lidhja})$$

Pra edhe Algoritmi Simbolik na thotë të njejtën gjë:

"Nuk mund të ketë *lindje* (- 1)
dhe *shfaqje* të diçkaje (●), pa një *lidhje* (∞)."

Kjo do të thotë se: "*Fabrikuesit*" e *gjuhës Sanskrite njihnin mirë, ndër të tjera, dhe vetë Algoritmin Simbolik nëpërmjet të cilit neve, si me një*

Gjuhë Universale, vihemi në gjendje të shpegojmë të gjitha kuptimet e dyta, të treta... të një fjale të huaj (këtu Sanskritisht), e pra të gjithë spektrin e saj semantik.

- 2) Fjala "k u p - t i m" lidhet, brenda Shqipes, me fjalën "k a p - j e".

Algoritmi Simbolik na jep:

$$\begin{array}{ccc} (x = x) & = & \boxed{\circ} \quad \dots(F) \\ \text{kuptim} & & \text{kapje} \end{array}$$

Edhe në Latinisht kemi të njejtën gjë:

$$\begin{array}{ccc} (x = x) & = & \boxed{\circ} \\ \text{percepire} & & \text{capere} \\ (\text{perceptoj}) & & (\text{kap}) \end{array}$$

si edhe në Italisht (ekuacion simbolik ndërgjuhësor):

$$\begin{array}{ccc} (x = x) & = & \boxed{\circ} \\ \text{it. capire} & & \text{shq. kap} \end{array}$$

Edhe në Gjermanisht:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \text{X} = \boxed{\circ} \quad \dots(F) \\ \text{Anfang} & & \text{fangen} \\ (\text{fillim}) & & (\text{kap}) \end{array}$$

Nga kjo del se çdo gjë e krijuar, duke përfshirë këtu edhe Njeriun, është e "lidhur", është e "kapur", e pra simbolikisht, siç pamë, " $\boxed{\circ}$ ", " X ".

Pra asgjë nuk mund të ekzistojë pa qenë e kapur, pa qenë e lidhur...

Kjo është, s'do harruar, një kërkesë e Arsyes, sepse mund të shkruajmë, siç dimë:

$$\text{Arsyeja} = (x = x) = \textcircled{1} = \text{ndarje} = \text{X} = \text{lidhje, skllavëri}$$

Duke përmbledhur mund të shkruajmë:

$$\left. \begin{array}{l} \text{X} \\ (x = x) \\ \textcircled{1} \end{array} \right\} \rightarrow \bullet = F$$

Nga sa më sipër, del ndër të tjera edhe se pa "kapje", $-\textcircled{0}$, $-\text{X}$, nuk ka as "kuptim", $-(x = x)$, kemi pra një "Non-sense", $(x = -x)$, dhe kjo sepse mund të shkruajmë:

$$(x = -x) = -(x = x) = -\textcircled{0} = \textcircled{0} = -\text{X}$$

jo kuptim, jo Arsyje, Absurd jo kapje
(Non-sense)

3) Me qenë se:

$$\begin{aligned} -(x = x) &= \text{jo Arsyjeja} = (x = -x) = -\textcircled{1} = \text{pa cak} = \text{pacaktueshmëri} \\ &= \text{Parimi i papërcaktueshmërisë} = \text{Fizika Kuantike} \end{aligned}$$

del atëhere se:

"Fizika Kuantike nuk ka kuptim, nuk është e arsyeshme."

Se çdo të thotë kjo më thellë, ia lëmë lexuesit ta kuptojë... Prandaj pra dhe s'është për ti vënë shumë faj një shkencëtari të tillë madhor si

* Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.847.

Einsteini, që nuk arriti ta "kuptojë" Fizikën Kuantike dhe u sul me një egërsi të papritur dhe për shumëkënd të pamotivuar, kundër kësaj Fizike. Kemi folur dhe gjetiu për këtë, pra dhe nuk po e zgjatim...

- 4) Sot në rrethet "e brendshme" shkencore e fillosofike flitet, si të flitej për një fatkeqësi katastrofale dhe të pashpjegueshme, për mungesën e Arsyes, e pra të kuptimit, dhe për shfaqjen tronditëse të "Non-sense"-it."

Por, për neve, kjo nuk është aspak një fatkeqësi, por një fitore e madhe në rrugën e "çlirimit" të Fizikës Kuantike nga prangat e ndryshkura epistemologjike dhe ontologjike, tashmë, të Fizikës Klasike dhe të të gjithë Shkencës deterministe, e cila ngrihej mbi konceptin dhe llogjikën e tij, që ishte llogjika famëmadhe (a më saktë: famëkeqe) aristoteliane.

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned}
 & - \textcircled{1} = \text{mos ndarje} = \text{mos përCAKtim} \\
 & = \text{parimi i papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike} \\
 & = - \text{X} = \text{rënia e konceptit të ligjit}^{**} \\
 & = - \leftrightarrow = \text{rënja e parimit të shkakësisë} \\
 & = - \textcircled{1} = \text{Inseparability Principle}^{***} \text{ në Fizikën Kuantike}
 \end{aligned}$$

* "Nonsense" a ndryshe "mungesa e kuptimit" sjell me vete shkatërrimin e të gjitha pikëpamjeve apo opinioneve... Për hir të "Nonsense"-it, mohohet përfundimisht koncepti i dualitetit, si edhe llogjika formale aristoteliane.

** Einsteini nuk e pranonte dot kurrsesi rënien e ligjit, duke i kritikuar fizikantët kuantistë për një pohim të tillë e madje duke i vënë në lojë, me shprehjen tashmë të famshme: "I don't believe God plays dice!..." [Unë nuk besoj se Zoti lot me zare!...]

*** "Parimi i pandashmërisë": Ky parim lidhet me "*Entanglement*" që konsiston në vija të trasha dhe shkurtimisht në komunikimin e dy grimcave subatomike, goftë edhe në distanca galaktike, pa përçim informacioni dhe energjie.

Kujtojmë këtu ndër të tjera nga "Libri i Aforizmave" edhe sa vijon:

Theorema e Bell-it afron Lindjen me Perëndimin, Fizikën me Fenë, me Fillosofinë... duke zbuluar e pohuar nivelin e *harmonisë* të Realitetit, të cilën ne nuk arrijmë ta kapim, të mësuar, siç jemi, të analizojmë vetëm të pjesshmen, vetëm hollësisht... ashtu të pazot, siç jemi, që ta kaptojmë mesazhin që na vjen nga e Tëra...

- a) Theorema e Bell-it thotë se Realiteti në intimitetin e tij ngrë krye kundra llogjikës së ftohtë racionale me të cilën është kryer *çdo kërkim* shkencor gjer më sot dhe që duhet të pranojmë, përkundrazi, *sinkronicitetin* (njëkohshmërinë) në vend të *kausalitetit* (shkakësisë), *si edhe* llogjikën e të *Tretit të Përfshirë* në vend të llogjikës të të *Tretit të Përgjashuar*.
- b) Teorema e Bell-it afron Lindjen me Perëndimin... Fizikë, Fë, Fillosofi... duke vënë në pah nivelin e *harmonisë* të realitetit të cilin nuk arrijmë ta diktojmë, të mësuar siç jemi që të merremi me analizën e hollësishme të të *veçantës*, pa qenë kështu pra në gjendje të perceptojmë mesazhin që na vjen nga e Tëra.
- c) Teorema e Bell-it është në gjendje të harmonizojë dikotominë (ndarjen) mes Materies dhe Frymës që karakterizon Kulturën tonë Perëndimore.
- ç) Teorema e Bell-it është në gjendje të pajtojë shkencat ekzakte me ato humane, duke i ruajtur *çdo fushe* të shkencës dinjitetin e saj.

Me Teoremën e Bell-it, Fizika, që nisej dikur nga *truri*, po mbrin sot të prekë *zembrën*, ndaj edhe kjo është arsyeja që kemi frikë të pranojmë pasojat e saj.

Pas eksperimenteve të Alain Aspect dhe ekipit të tij në Francë, Theorema e Bell-it i vuri vulën triumfit të Fizikës Kuantike dhe *tregoi domosdoshërinë e introduktimit në Fizikë, si edhe në çdo shkencë tjetër "des profondeurs", të një llogjike tjetër, të asaj të të Tretit të Përfshirë...*

= zhdukja e ndarjes në thellësinë ekstreme të materjes = Liri
 = -● = jo materje ("*The death of matter myth*")*
 = shlyerja e mëkatit në zanafillë (lat. *peccatum originalis*)
 = I m m a c u l a t a c o n c e p t i o = zhdukja e të keqes =
 "vdekja" e Djallit = $-(\rightarrow \neq \leftarrow)$ = zhdukja, superimi i konfliktit
 = "– urrejtje" = Dashuri = $(x = -x)$ = Qendra Mistike =
 Mbretëria e Oiejve = Parajsa = ... **

Një gjë është për të vënë re veçanërisht këtu dhe kjo është pikërisht ekuivalenca:

E = Absurdi

Dhe për pasojë... absurditeti i lirisë, i dashurisë, i paqes (si zhdukje e konflikteve), i të vërtetës, i pavdekshmërisë, ($t = 0$), i Absolutit, $-\infty$ e kështu me radhë... në këtë Botën tonë materiale, që do të thotë se ato janë të paarrtshme këtu. Prandaj pra, ndër të tjera, slogani i famshëm i Revolucionit Frëng:

Liberté : $-\infty$, Egalité : $(x = (\neq x))$, Fraternité : $-(\rightarrow \neq \leftarrow)$

duhet vështruar, në rastin më të mirë, si një "naivitet" (duke përjashtuar hipotezën e mashtrimit). E njejta gjë mund të thuhet edhe për parullat utopike të Revolucionit Bolshevik.

* Teorikisht fundi i Botës materiale është arritur, me "*The death of Matter Myth*", me "zhdukjen" e asaj që përbënte Realitetin e Fizikës Klasike. Kështu që fundi i Botës është teorikisht në Fizikë kalimi në një Realitet Imagjiner. Për këtë dëshmon ndër të tjera superimi i shpejtësisë të Dritës e, lidhur me këtë, ekzistenca e një "komunikimi spektral" (e "telepatik"...), në çast e në çfarëdo distance, mes dy grimcave subatomike.

** Tërë figurat simbolike të kodit E, bashkë me tërësinë e spektrave të tyre konceptuale...

Dhe ndalemi hë-për-hë këtu, duke e lënë për një herë tjetër vazhdimin e kësaj Bisede. Ajo që duhet të na bëjë përshtypje këtu, sidoqoftë, është se si Sanskritishtja i ka ditur qoftë dhe *implicite* të gjitha këto, duke pozuar ndër të tjera ekuivalencën: *Liria = Absurdi*, dhe duke dëshmuar, në të njejtën kohë, për saktësinë e ekuacionit tonë simbolik:

$$- \infty = (x = -x)$$

Liria Absurdi

Një zgjerim tjetër do të qe ay në fushën e Theollogjisë e pikërisht në atë të ekzegjezës të teksteve Ungjillore.

- 5) Lidhur me sa thamë, Heidegger-i flet dhe nxit për "*Another way of thinking*", për "një mënyrë tjetër të menduari", që nuk mund të jetë tjetër për Autorin e këtij shkrimi veçse një të menduar simbolik, e pra për pasojë një të menduar artistik. Mund të flasim sot me gojë plot për kolapsin e mendimit.* Autori i këtij shkrimi e ka parandjerë këtë situatë që në vitin 1974, në një libër ende të pabotuar me titull "*Il collasso del pensiero*".
- 6) Në Ungjill, Krishti u thotë farisejve:

*"Do të mësoni të Vërtetën,
dhe e Vërteta do ju bëjë juve të lirë."***

Ata e kundërshtojnë. I thonë: "Ne jemi të lirë!..." Dhe s'kanë të drejtë.

Dhe kjo sepse:

"Gjithshka që lind është land."

si edhe:

"Gjithshka që lind është mish."

* Dhe është fjala sigurisht për mendimin konceptual...

** Ungjilli sipas Gjonit (8:32).

Prandaj Njeriu, si qenie mishtore, nuk mund të jetë i lirë.

Ekuacioni: $\bullet = \text{X}$, mund të interpretohet si: a) *Mëkat* = *skllavëri*; b) *Botë materiale* = *skllavëri*; c) Ky ekuacion është, siç dimë, edhe ay ndër të tjera i "*Hieros Gamos*", etj.

E vërteta mund të paraqitet simb. me " $-\bullet$ ", e atëhere edhe si " \bigcirc ".

Duke shumëzuar të dy anët e ekuacionit të mësipërm me " -1 ", ne gjejmë:

$$\begin{array}{ccc} \bigcirc & = & -\text{X} & \dots(\text{E}) \\ \text{e Vërteta} & & \text{Liria} & \end{array}$$

Pra, Krishti kishte të drejtë: *Për të qenë i lirë duhet të njohësh të vërtetën...* me të cilën Krishti identifikohet. Prandaj dhe është një thënie kaq e rëndësishme e Krishtit, që del kështu se është njohja e lirisë dhe mënyra se si ajo mund të mësohet e të fitohet nëpërmjet Ungjillit.

Është rasti të kujtojmë këtu edhe fjalët e arta të Hermes Trismegistus:

"Nothing in Heaven is servanted, nothing upon Earth is free."

[*Në Qiell s'ka robëri, në Tokë s'ka liri.*]*

Përmendim më në fund edhe faktin kuptimplotë sipas të cilit as fillosofi i madh Spinoza nuk mendonte se njeriu lind i lirë.

Ja fjalët e tij tekstuale: *"Në se njerëzit të lindnin të lirë, për sa kohë ata do të mbeteshin të tillë, nuk do të bënin ndonjë dallim midis të mirës dhe të keqes."**

* Përkthimi i këtij mendimi në gjuhën simbolike do të na japë:

Heaven = \bigcirc = *E* = $-\text{X}$ (*not servanted*)

Earth = \bullet = *F* = X (*servanted, not free*)

Dallimin mes të Mirës dhe të Keqes, paraardhësit tanë, Adami dhe Eva, duke iu kundërvënë urdhërit të Zotit dhe të nxitur nga Djalli në trajtën e gjarpërit, e bënë në Parajsë. Gjë kjo që solli humbjen e lirisë së tyre, dëbimin e tyre nga Parajsa, rënien e tyre, vdekshmërinë e tyre, dhe krijimin e Botës materiale. Algoritmikisht kjo tragjedi do të shprehej në këtë mënyrë:

$$\bigcirc \neq \bullet \quad \dots(F)$$

e Mira e Keqja

Pra, u kalua kështu nga kodi E në kodin F. Por një rënie e tillë paraqet skemën e përgjithshme të të gjitha miteve kozmogonike, skemë që mund të paraqitet si:

$$E \downarrow = F$$

Duke u kthyer tani tek motivimi i fjalës Sanskritishte "a - b a d d h a" (**अबद्ध**), që do të thotë ndër të tjera "i pashfaqur", shohim se asgjë nuk mund të shfaqet, të ekzistojë, duke mos qenë e lidhur. Asgjë pra në këtë Botë është e "zgjidhur" (**-X**), e pra ajo është e lidhur (**X**). Ky është kushti *sine qua non* i Ekzistencës së saj.

Duke zgjeruar edhe më tej Bisedën, kujtojmë se:

a) Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"... Mund të shkruajmë pra:

$$\textcircled{1} = \bullet = F = \text{X}$$

S-separatio Bota lidhja,
materiale materiale skllavëria

Pra dhe kështu vërtetohet se Njeriu nuk lind i lirë, duke i dhënë të drejtë Spinozës kundrejt teoricienëve të Revolucionit Francez.

* Spinoza, "Etika" (Pjesa IV, Prop. LXI).

b) Ekuacioni ($x = x$), që mund të shkruhet tradicionalisht si ($A = A$), paraqet, siç dihet, themelin e llogjikës aristoteliane. Ai quhet parimi i mos kontradiksionit. Dhe në të njejtën kohë, ai shpreh kushtin e nevojshëm e të domosdoshëm që diçka të mund të ekzistojë. Arthur Schopenhauer ka shkruar një libër të tërë lidhur me këtë çështje, me titull "*Rrënja e katërfishtë e parimit të moskontradiksionit*". ["*Über die vierfache Wurzel des Satzes vom zureichenden Grunde*", 1813].

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$(x = x) = F = \text{X} = \text{skllavëri}$$

Edhe kështu pra vërtetohet, fare lehtë, se Njeriu nuk lind i lirë, se vetë ekzistenca njerëzore ("*Condition humaine*") lidhet me një skllavëri, që në mënyrë "beninje" pagëzohet me emrin "domosdoshmëri".

Çështja nëse Bota ka *domosdoshmëri* apo *liri* është fare e lehtë tani të zgjidhet.

Mund të shkruajmë:

$$\text{Domosdoshmëri} = \text{X} = F = \bullet = \text{Bota materiale} \\ (\text{"Mbretëria tokësore"})$$

$$\text{Liri} = -\text{X} = -F = E = -\bullet = \circ = \text{Bota Spirituale} \\ (\text{"Mbretëria Qiellore"})$$

gjë kjo të cilën e rikonfermon, ndër të tjera, edhe e thëna fillosofike e Hermes Trismegistus siç pamë më lartë.

c) Simboli "X" është jo vetëm ay i *lidhjes*, i *skllavërisë* etj. etj., por edhe ay i *ligjit*, si edhe ay i *përbërjes*, dhe ay i *relatives*.

Atëhere mund të themi edhe, ndër të tjera, se gjithshka në këtë Botë është relative, që nga dhe Teoria e Relativitetit të Einsteinit.

Gjithashtu, gjithshka në këtë Botë është e përbërë (∞ = përbërje). Ky pohim i fundit gjendet edhe në antinomitë e "Arsyes së Pastër" të Kantit.

Por ky mendim, si një dëshirë supreme, gjendet edhe tek Buddha, sipas të cilit:

"Çdo gjë që është e përbërë, do të bëhet e thjeshtë."

Le të analizojmë pak më thellë tani këtë gjykim dhe të shohim ndonjë rrjedhim nga ay.

Me qenë se:

$$\text{e përbërë} = \infty \quad \dots(F)$$

$$\text{e çpërbërë, e thjeshtë} = -\infty \quad \dots(E)$$

atëhere, ajo që predikon Buddha është kalimi nga kodi F në kodin E. Ky i fundit është vetë Qendra Mistike, Parimi Suprem i Universit, Parajsa.*

Po Parajsa ose, siç e quan Krishti, "Mbretëria Qiellore", është gjithashtu kodi E. Që këndeje del si përfundim se Krishti dhe Buddha predikojnë në vija të përgjithshme të njejtën gjë: n d r r i m i n e kodit, do me thënë ç k r i j i m i n.

Por sa do e çuditshme mund të duket, këtë predikon edhe Heideggeri me termin "A b b a u",** ose edhe "D e s t r u k t i o n", si edhe në mënyrën e tij edhe Derrida.

* Cirlot (*The Center*, fq.173): "...to undo the knot was equivalent to finding the centre..." [...të zgjidhësh nyjen do thotë të gjesh Qendrën...].

** Le të vëmë re këtu edhe diçka tjetër: "A b b a u" = shq. "â p a b â" = "nuk është bërë" = skr. "n i r b a n a" = "— bana".

Ky është një shembull, nga të shumtët, që tregon se si:

"Mendimi i fundit (modern) përputhet në vijat e tij të përgjithshme me mendimin e stërlashtë."

Kemi kështu pra një mbyllje të ciklit.

Dhe nga ana tjetër e dimë se jemi brenda të Vërtetës, për arsye sepse:

"Ç'është më e thella në Hapësirë është më e hershmja në Kohë."

Pra ky pohim rrok të Tërën dhe e Tëra, po dihet, është bash e vërteta (*Holizmi*).

Në Shqip:

e mbara = e Tëra = e mira, pra e Vërteta

Gjithashtu, po në Shqip:

"E mbara mbrihet në mbarim."

Pra, gjersa është arritur *e mbara*, kjo do të thotë se jemi në *mbarim* (ose mjaft afër tij) të Historisë njerëzore. Dhe ky është një profetizim që bëhet duke u mbështetur në Urtinë, marramendthore në thellësinë e saj, të Gjuhës.

Le të vëmë ré këtu gjithashtu se në Inglisht:

W h o l e = e Tëra

H o l y, h o l i n e s s = shenjtëria

pra, kjo do të thotë se, mbritja e Tërësisë është mbritja e Shenjtërisë. Pra njerëzimi po shenjtërohet, po piqet pra për Mbretërinë Qiellore.

Pra Bota fillon me një ndarje, fillon me një lidhje, pra Njeriu lind i lidhur. Po për këtë ka folur edhe Ernst Mach, sikurse edhe Fritjof Capra: *Të gjitha gjërat janë të lidhura në një rrjetë të hollë marrëdhëniesh, asgjë nuk është e zgjidhur.*

Edhe Ernst Mach, fizikanti i madh dhe fillosof i shkencës, thotë të njejtën gjë, por ndryshe. Ai përballej me problemin e shpjegimit të inercisë: *Ç'është inercia? Pse trupat janë inertë?*

Sipas hipotezës së tij të guximshme, e cila i hapi rrugë Einsteinit për shumë gjëra, *inercia e trupave shpjegohet me bashkëveprimin, siç e dimë, e trupit me gjithë trupat e tjerë të Universit.* Sikur të mos kishte trupa të tjerë ne Univers, trupi nuk do të kishte inerci, pra inercia jashte një lidhjeje të tillë nuk mund të ekzistojë. *Do me thene trupi ka inerci se është i lidhur. Por dhe ne si trup lindim... lindim pra të lidhur, sikurse pra na thotë dhe Sanskritishtja "a-b a d d h a" (अबद्ध).**

Edhe Fritjof Capra, nga ana e tij, në librin e famshëm *"The Tao of Physics"*, pohon pak a shumë të njejtën gjë, me fjalë të tjera që të gjitha sendet në Univers janë të lidhura, të ndërlidhura mes tyre, me një rrjetë të imtë marrëdhëniesh, herë here të padukshme.** Pra lidhjes në

* Do me thënë njeriu lind i lidhur. Atëherë ai bëhet i dukshëm. Kur bëhet i dukshëm, ai duhet të lidhet. Po të mos jetë i lidhur nuk duket. Prandaj dhe Zoti nuk mund të duket, pasi është i zgjidhur dhe jo i lidhur. Ja pra një arsye përse ne nuk e shohim Zotin, kemi:

$$\text{Zoti} = -\infty = \text{Frymë} = \text{e Vërteta.}$$

** Kujtojmë ndër të tjera nga Fritjof Capra, *"The Tao of Physics"* (1975):

"In ordinary life we are not aware of the unity of all things but divide the world into separate objects and events. This division is useful and necessary to cope with our everyday environment, but *is not a fundamental feature of reality*, it is an abstraction devised by our *discriminating intellect*. To believe

këtë Botë nuk i shpëton asgjë dhe askush. Gjë që rikonfermon prap e prap saktësinë e spektrit kuptimor të fjalës "a - b a d d h a" të Sanskritishtes. Kemi këtu, si në shumë raste të tjera, një pajtim të plotë mes mendimit modern dhe atij të stërlashtë. Kjo mund të interpretohet edhe si një "mbyllje e ciklit", e pra si afrim i Fundit të Botës.

7) Shën Pali thotë: "*Krishti na shpëtoi nga mallkimi i ligjit.*"*

that our abstract concepts of separate 'things' and 'events' are realities of nature is an illusion."

(Në jetën e zakonshme ne nuk jemi në gjendje të vëmë ré unitetin e të gjitha sendeve dhe e ndajmë botën në objekte dhe ngjarje të veçanta. Një ndarje e tillë është e dobishme në marrëdhëniet dhe luftën tonë të përditshme me ambientin që na rrethon, por nuk përbën një tipar themelor të Realitetit, është përkundrazi një abstraksion i shpikur nga intelektu ynë diskriminonjës. Të besosh që konceptet tona abstrakte mbi 'sendet' dhe 'ngjarjet' janë realitete natyrale, ky është një iluzion.)

* Galatët (3:13).

Gjithpò tek Galatët (3.23-25): "*Para se të vinte besimi [tek Jisu Krishti], ne mbaheshim të burgosur nga ligji, kyçur nga ay gjer arsyeja e besimit më në fund të na zbulohet. Kështu pra që ligji mori përsipër barrën e shpënies tonë tek Krishti, në mënyrë që ay, besimi, të qe ay që do të na shpëtonte. Por, tani që besimi na u dha më në fund, ne nuk jemi më ndën mbikqyrjen e ligjit...*"

Si edhe (2:16): "*...duhet të dimë se nuk është vetëm të përmbajturit ligjit që mund të na shpëtojë, por besimi tek Jisu Krishti. Ndaj pra dhe tërë besimi ynë është tek Ay, tek Krishti, në mënyrë që shpëtimi të na vijë nëpërmjet Tij dhe jo nga të për-mbajturit ligjit, sepse vetëm të përmbajturit ligjit nuk do të mund të shpëtojë njeri... Nuk mund të lëmë pa përfillur kursesi këtu hirin e Perëndisë, sepse, sikur shpëtimi të mund të na vinte vetëm nga ligji, Krishti do kish vdekur më kot!*"

Kjo citatë, e përkthyer në gjuhën simbolike, do të shkruhej si:

Krishti :

$$-\infty = -\bullet \quad \dots(E)$$

superimi shpëtimi
i ligjit nga mëkati

Por:

$$E = (x = -x) = -(x = x) = - \text{Arsye} = \text{Absurdi (fr. absurde)}$$

$$= -\infty \text{ (fr. dénoué, libre)} = -\bullet \dots$$

Prandaj pra, *superimi i ligjit*, siç predikon Krishti, sjell me vete lirinë dhe shpëtimin nga mëkati.

Kjo na sjell ndërmend edhe të thënë e famshme të Tertullianos:

"Credo quia absurdum est."^{*}
(Besoj sepse është absurde!)

Edhe në të njëjtën kohë, ato sa thotë Shën Pali:

*"Ose do të jemi të mençur për Botën dhe të marrë për Zotin,
ose do të jemi të marrë për Botën dhe të mençur për Zotin..."*^{**}

* *Quintus Septimius Florens Tertullianus* (c.155–c.230). Një personazh tepër i njohur dhe i çmuar në historinë e Doktrinës dhe Kishës së Krishterë. Kontributi i tij në hedhjen e themeleve botëkuptimore të Doktrinës dhe Kishës së Krishterë në kohërat më të hershme të saj ka qenë i madh dhe i rëndësishëm.

** Fjalë për fjalë, në epistolën e Palit kjo e vërtetë është shprehur kështu: *"Mos gënjeni veten tuaj. Nëse dikujt i duket vetja i urtë në këtë botë, le të bëhet i marrë që të bëhet i urtë. Sepse urtësia e kësaj bote është marri për Zotin."*

Korinthasit, I.3:18-19

Këndej del qartë se besimi tek Zoti lidhet me Absurdin i cili, nga ana e vet, lidhet me Lirinë, Pavdekshmërinë e kështu me radhë.

Vëmë re se këtu, në këtë pikë, mentaliteti i stërlashtë Vedik përputhet plotësisht me atë të krishterë, gjë që dëshmon ndër të tjera edhe për një farë afiniteti të thellë mes këtyre dy mentaliteteve a botëkuptimeve, atij të Vedave të lashta dhe atij të Krishtërizmit.

Kjo dhe i ka shtyrë disa studionjës të mendojnë se Krishti e ka huar gjer diku vizionin e tij kozmik nga Indianët e lashtë, ndër të cilët hipotetizohet edhe se ka qenë një kohë të gjatë.

Algoritmi Simbolik na sqaron fare mirë si është puna...

Doktrina e Krishterë dhe Dituria e Indianëve të lashtë lidhen që të dyja me kodin E.

Tërë Ungjilli, me parimet e tij, rrjedh automatikisht nga Algoritmi me interpretimet adequate.

E njejta gjë ndodh edhe me Fillosofinë e lashtë Indiane (e pasqyruar besnikërisht në polisemantizmin e pasur të gjuhës Sanskrite) e cila, edhe ajo, mund të dedukohet në parimet e saj themelore, po nga Algoritmi Simbolik.

Kujtojmë këtu se kodi E është kod i thellësisë, dhe se atij i binden, ndoshta edhe pa e kuptuar, të gjitha ato që ne quajmë "*sciences des profondeurs*";* në të cilat bëjnë pjesë ndër të tjera: Theollogjia e Krishterë, Fizika Kuantike, Psikollogjia Jungiane (Inkoshienti), Shkenca e re e Etimollogjisë, e kështu me radhë.

Kodi E, po të gërmojmë akoma edhe më thellë, nuk është tjetër veçse artikullimi llogjik i "*Philosophia Perennis*".

* Shih edhe fq.217 dhe 309.

347) Greq. **a p l o s** (α π λ ó ς) = i thjeshtë, jo i palosur

Motivohet me Shqipen:

$$\mathbf{a - p a l} = \text{"jo palë"} = \text{i çpalosur}$$

Me qenë se, nga ana tjetër, kemi:

$$\text{shq. } \mathbf{p a l ë} = 2$$

dhe me qenë se, sipas Algoritmit Simbolik:

$$2 = \bullet = \infty \dots(F)$$

del se fjala Greqisht "a p l o s" ka, me ndihmën e **Shqipes**, kuptimin e *thjeshtësisë*.

Le të zgjerojmë tani disi Bisedën:

1) Mund të shkruajmë:

$$2 = \bullet = \text{materia, Bota materiale}$$

Nga ana tjetër, nga sa lexojmë ndër të tjera tek "*Fjalori i Simboleve*" Cirlot numuri dy (2) është nga të gjitha numurat më *ogursëzi* (ingl. *ominous*), ai që i kundërvihet Hyjnisë (- 1), "*the first nucleus of matter*" etj.

Duke qenë kështu ne arrijmë në përfundimin se *materializimi, Realiteti material* në të cilin neve jetojmë, është ndërtuar sipas strukturës dhe simbolizmës të numurit dy (2) e pra, si i tillë, do të kënaqë ekuacionin:

$$2 = \bullet \dots(F)$$

Pra: Bota që ne perceptojmë nuk është e thjeshtë dhe nuk është gjithashtu as e mirë... Një përfundim ky të cilin e kemi arritur edhe më parë, dhe në mënyra të tjera...

2) Budda thotë (në bashkëbisedimin me dishepullin e tij Ananda):

"Çdo gjë e përbërë duhet të bëhet e thjeshtë."

Dhe këtë fjalë ay i thotë në prag të vdekjes së tij.

Pra, Budda opton për ekuacionin:

$$\infty \rightarrow -\infty = -F = E = \bigcirc = \text{Nirvana} = \dots$$

Me fjalë të tjera dhe Budda e kërkon dhe e gjen shpëtimin jo në kodin F, por në kodin E, që sot, siç e kemi parë dhe gjetkë, po emergon në të gjitha degët e Diturisë së Kohës.

348) Ital. **a p p l i c a r e** = zbatoj

Kjo fjalë zërthehet në:

a p p l i c a r e

Ku "a p" rrjedh nga Latinishtja "a d" me kuptime të ndryshme, por veçanërisht atë të afërsisë, të bashkëngjijtes etj. etj., por që këtu e shohim në trajtën, siç thamë, "a p" që është një asimilim progresif i "a d".

"c a r e", si mbaresë foljore, në shumë e shumë fjalë Latinisht dhe Italisht, nuk është tjetër veçse Shqipja "k r y" (në kuptimin e *bërjes*). Po të konsultojmë fjalorin Sanskritisht do ta gjejmë këtë prapashtesë në trajtën "-k r." në një numër të madh rastesh, gjithpo me atë kuptim që ka në Shqip.

Kjo rrënjë në Shqip ka dhënë shumë e shumë fjalë, e madhje edhe aforizma, ku koncepti i "kryerjes" lidhet me atë të "krimit".

"Nga një **krim**, **krymja**."

Aforizëm që aludon për krymjen e Botës me anë të një krimi, me anë të krymjes së Sakrificës Kozmogonike.

Vazhdojmë më tej: "p l i" është Shqipja "p a l ë", e pra edhe 2 (p.sh. një palë këpucë = dy këpucë, etj.).

Duke e ditur se numuri dy (2) është ay i Djallit, shikojmë pra se aplikimi lidhet me një ndërhyrje djallëzore, e pra është si i tillë diçka negative dhe materiale (m.q.s. 2 = ●).

Pra ne mund të themi se: Zbatimi i origjinalit (Zotit), materializimi i tij, na riprodhon një botë negative, të keqe, atë të "Princit të kësaj Bote".

Kështu e kanë menduar dhe të Parët tanë, siç del qartë jo vetëm nga kjo etimologji, por edhe nga shumë të tjera.

349) Ital. c o m p l i c a r e = ngatërroj, vështirësoj etj.

Do zbërthyer në:

c o m p l i c a r e

Dhe me Shqipen:

k a m k r y p a l ë = 2

E pra atëhere, për ekuivalencë simbolike, edhe:

... = ● (materializim) = ∞ (ngatërresë, komplikim)

Njëri nga përfundimet që nxjerrim që këndeje është se:

*Bota jonë materiale, si një aplikim i një origjinali hyjnor,
është, si e tillë, e komplikuar.*

E thënë ndryshe, ky komplikim shpjegohet me kalimin (rënie) nga kodi E (origjinali) në kodin F (aplikimi).

Jemi pra në rastin e një "mithi kozmogonik", sepse arrijmë kështu në trajtën, skemën, e përgjithshme të të gjitha mitheve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

350) Greq. **p a l i** ($\pi \acute{\alpha} \lambda \iota$) = përsëri

Është Shqipja:

$$p a l \ddot{e} = 2$$

në kuptimin e Italishtes "p a i o", Inglishtes "p a i r", Frengjishtes "p a i r", etj. etj., e pra të numurit dy (2).

351) Greq. **p a l o** = :keq, e pra simb. " ● "

Edhe kjo **fjalë lidhet** me Shqipen:

$$p a l \ddot{e} = 2$$

Kështu, Greqishtja shtron me ndihmën e Shqipes, ekuacionin simbolik:

$$2 = \bullet \quad \dots(F)$$

shq. **p a l \ddot{e}** greq. **p a l o**

352) Ingl. **s i m p l e** = i thjeshtë

Zbërthehet me Shqipen si:

$$s'j a m p a l = (\neq 2) = -2 = 1$$

Që këndeje nxjerrim se *thjeshtësia* arrihet me një *çpalosje* që që mund ta tregojmë edhe me: $-\infty$. Dhe jemi kështu në kodin E.

Mund të themi atëhere se:

Kodi E është kodi i thjeshtësisë (duke qenë edhe ay i Hyjnisë, siç kemi parë).

Në këtë kod, që është dhe ay që ndjek verbazi Fizika Kuantike, gjithshka është e thjeshtë, asgjë s'ka peshë, asgjë s'përsëritet, etj. etj., gjithshka është jashtë Kohe dhe Hapësirë, e pra i të gjitha kohërave e i të gjitha hapësirave, e kështu me radhë e kështu me radhë.

Prandaj pra dhe Krishti, ashtu si Buddha, duke predikuar thjeshtësinë ("Si lum të thjeshtët, se do të trashëgojnë Mbretërinë e Qiejve..."), predikon Botën Tjetër, Qiellore, kodin E.

Këtë pohon edhe Hermes Trismegistus, për të cilin kemi folur tashmë.

Kuptojmë atëhere, ndër shumë e shumë gjëra të tjera, përse Krishti thotë "Barra ime është e lehtë...", d.m.th. me simbolet tonat:

$$-\downarrow = -\bullet = \bigcirc = \uparrow \dots (E)$$

353) Greq. **a n a s t a s i** (α ν ά σ τ α σ η) = ingl. *resurrection* (ngjallje)

Kjo fjalë e Greqishtes ndahet në:

a n(a) s t a s i

"a n" qëndron për "a", që është privative. Shtesa e "n"-së është bërë për të shmangur përplasjen e dy "a"-ve, gjë që do të sillte me vete një kakofoni të papëlqyer. Është pra një shtesë asemantike.

Pjesa tjetër "s t a s i" lidhet me Shqipen "s h t i", e pra simbolikisht " \square ".

Prandaj tërë fjala do të thotë:

$$-\square = -s h t i = -shtirje, dalje, ngritje, \\ \text{"ngjallje prej së vdekuri"}$$

Kjo fjalë në kuptimin e saj më të thellë, që është ai i "ringjalljes", përdoret rëndom në letërsinë kishtare, të paktën të Krishterë.

Vdekja krahasohet me një *futje*, e pra me një "padukje", ndërsa Ngjallja si e kundërta e saj.

Kështu pra, duke e përfunduar, mund të themi se fjala kaq e rëndësishme në Greqishten kishtare veçantisht, është ndërtuar me operatorë thjeshtë Shqiptarë.

E tepërt këtu të shtojmë se operatori "s h t i", nga folja Shqipe "me *shti*", mungon në Greqisht. Kjo është edhe arsyeja që ajo nuk është në gjendje që, me mjetet e saja gjuhësore, ta motivojë këtë fjalë.

Si zgjerim **Bisedë** shtojmë se ekziston në Sanskritishte, po në atë kuptim që ka në Shqip. Madje në Sanskritisht kemi edhe: "s h t i" dhe "s h t o j", si në Shqip, në kuptimin metaforik të "mbjelljes" (*mbylljes*) dhe "shtimit" (grurit, misrit etj. etj.).

Në Shqip mund të sajohet kjo aforizëm:

"Shka **shtihet**, **shtohet**."

Që simbolikisht do të ishte:

$$\boxed{1} = (\neq 1) \quad \dots(F)$$

shtij shtoj

Si zgjerim të mëtejshëm të Bisedës, shtojmë edhe se në mithollogjinë Egjiptiane, perëndia Osiris, simbolizon në të njejtën kohë edhe perëndi e "*Land of the Dead*" (Botës së të vdekurve), e pra Ay është "i shtimi" (\odot), dhe gjithashtu perëndi e vegjetacionit, e pra bollikët, e "të shtuarit" ($\neq 1$).

Paralelizmi struktural (simbolik) është i përsosur, gjë që flet për një mentalitet mithik anallog.

Pra e tërë fjala "reduktohet" në: – s h t i = – \square , ku simboli "o" nuk është tjetër, ndër të tjerë, veçse ay i "Oëndrës Mistike", i Zotit, i Krishtit...

Prandaj thuhet në Pashkë:

"Christos anesti!" (Χριστός ἀνέστη!) = Krishti u ngjall!

Dhe përgjegjja:

"Alithos anesti!" (Ἀληθῶς ἀνέστη!) = Vërtetë u ngjall!

Të dyja këto shprehje të "përkthyer" në Shqip japin:

$$- \text{lith}^* = - \text{sht i}$$

Dhe simbolikisht:

$$- \infty = - \square = \bigcirc \dots$$

Ky ekuacion i rëndësishëm i kodit E mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, ndër të tjera si një përkthim në gjuhën simbolike të të thënës së rëndësishme të Krishtit në Ungjill:

*"Do njihni të Vërtetën (\bigcirc) dhe
e Vërteta do ju bëjë juve të lirë ($-\infty$)."***

Në gjuhën e Buddizmit:

*"Çdo gjë e përbërë (∞) duhet të bëhet e thjeshtë ($-\infty$)...
Vetëm kështu do të fitojmë Nirvanën (\bigcirc), moskthimin më në Botën
materiale ($-\bullet$), lumturinë e përjetshme."*

* Shih edhe fq. 83-86 dhe 500.

** Shih edhe shënimin mbi ekuivalencën simbolike të " \bigcirc " me Kryqin, fq. 210.

354) Greq. **anesthesia** ($\alpha\nu\alpha\iota\sigma\theta\eta\sigma\acute{\iota}\alpha$) = ingl. *anesthesia* (anestezi)

Zbërthimi (shih edhe më lartë) do të bëhet si, me Shqipen:

a(n) â shti = "nuk âsht shti"

e pra simbolikisht:

$$- \square = \bigcirc \dots(E)$$

Anestezia njihet si ajo gjendje ku nuk dhimbje, e pra m.q.s. nga ana tjetër Shqipja na jep:

dhim(b)je = "dām (bâ) jam" = \oplus

Do të kemi atëherë:

$$\text{anesthesia} = - \square = \bigcirc = - \oplus = \text{"jo dhimbje"}$$

Me qenë se:

$$\oplus = F = \bullet = \text{e keqja; krijimi i gjithshkaje}$$

(Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*")

Në këtë mënyrë, koncepti i *lindjes* dhe ai *dhimbjes* vihen linguistikisht në korrespondencë, gjë që i përgjigjet, mjerisht, Realitetit...*

Mund të themi se: "*Krijimi i Botës, ashtu si edhe ajo vetë, janë një burim i përhershëm dhimbjeje...*"

Gjë që është thënë e stërthënë nga fillosofë dhe të urtë, të të gjitha kohërave.

* Ndoshta është e rastit të shtojmë këtu se në Shqip, aforizmatikisht:

"Lindja, lëndimi."

Mentaliteti i Krishterë (i pacënuar, i padeformuar, i painstrumentalizuar etj. etj., sikundër mjerisht ay paraqitet sot) e krahason Botën me një "luginë lotësh"* dhe vetë krijimin me një krim* (Lat. "*peccatum originalis*")... dhe jetën me një dhimbje të përjetshme nga e cila Profetët e mëdhenj të të gjitha feve, ndër të cilët edhe Krishti, na mësojnë se si duhet të çlirohemi.

355) Greq. e k s t a s i s (έ κ σ τ α σ η) = ekstazë

Duhet zberthyer me Shqipen si:

hek shtimjen = - \square = \bigcirc
(heq shtimjen)

Shikojmë atëhere se "ekstaza" është njohja direkt, pa ndërmjetësi dhe deformime, të Parimit Suprem të Universit, të Qëndrës Mistike, të Zotit, të simbolit " \bigcirc " në tërë spektrin e madh të kuptimeve të tija themelore.

Kështu për shembull, nëpërmjet *ekstazës* njeriu vihet në gjendje të njohi të Tërën (karakteri "holistik" i ekstazës), të realizojë në unitet tërësor themelor, të thellë, me vetë Zotin, i cili mund të njihet vetëm nëpërmjet ekstazës, d.m.th. me një pamje të pandërmjetësueshme të individit me Zotin dhe me të vërtetat e Tij të pavdekshme.

Duke zgjeruar Bisedën, le të mos rrimë pa përmendur këtu një fakt të rëndësishëm nga etimologjia, sipas të cilës Latinishtja "s c i o" = di, duhet të lidhet domosdoshmërisht, si me origjinën e saj, me Shqipen "s h o h". Dhe kjo për arsye se:

Gjuha emërton sipas një paradigme superlative dhe e cila është pikërisht, këtu, ajo e të parit direkt dhe të njohurit të drejtpërsëdrejtë të së drejtës. Kështu, të parët tanë duhet ta kenë ditur kolosal të *ekstazës* në procesin e Njohjes:

Marria = ekstaza permanente

Simboli i fundit mund të merret ndër shumë kuptime, por edhe sidomos atë të "Perëndisë" dhe të "Botës tjetër". *

Një njeri që "ngrihet" në ekstazë, ay vihet në komunikim të drejtpërdrejtë me "Mbretërinë Qiellore". Kjo u ndodh rëndom njerëzve të dhënë singërisht e gjer në fund pas misticizmit, sikundër lexojmë në Librat e Shenjtë.

Algoritmi Simbolik shpjegon ndër veçorirat e shumta të ekstazës edhe *ngritjen* e personit në ekstazë, duke mundur forcën e gravitetit.

* Me fjaiën "ekstazë" tregohet zakonisht një gjendje e tillë shpirtërore kur personi "rrëmbëhet" me gjithshka të tijën në një Botë tjetër, që është ajo që të Krishterët e quajnë "Mbretëri Qiellore".

Thuhet ndër të tjera se atyre, këtyre fatlumëve, në çastet e ekstazës "u hapet qielli" dhe *madje*, në disa raste, dhe ngrihen në ajër. Kjo është *ekstaza* në kuptimin *qëndror* të fjalës. Kurse në një kuptim tjetër më popullor është një gëzim i madh, një ngazëllim, një frymëzim i veçantë.

Ekstaza është edhe një "ngjitje" në kuptimin ontologjik, por edhe gnoseologjik të fjalës, një ngritje nga kodi F (tek i cili ka rënë tërë Njerëzimi, sipas fesë së krishterë pas mëkatit fatal të Adamit dhe Evës në Parajsë) në kodin E, në atë të Parajsës...

Pra simbolikisht:

$$F \downarrow \rightarrow E$$

e pra edhe:

$$(x = x) \downarrow \rightarrow (x = -x)$$

Duke patur parasysh skemën e përgjithshme e të gjitha mitheve kozmgonike ("botë-bërëse"):

$$E \downarrow \rightarrow F$$

ne mund të themi, qoftë edhe metaforikisht, se:

"Për një njeri që ngrihet në ekstazë ($F \downarrow = E$)

Bota çbëhet, humbet e zhduket..."

Dhe kjo sepse Algoritmi Simbolik na jep:*

$$-\square \circledast = \bigcirc = -\bullet = -\downarrow = \uparrow = \text{ngritje, "levitatio"} \dots(\text{E})$$

356) Lat. **h a b e r e** = ingl. *to have* (me pasë)

Zbërthehet në:

h a b e r e

Motivohet me Shqipen si:

b ë r ë k a

(folja "kam", "me pas")

Vëmë re' këtu se "h" dhe "k" janë të dyja guturale, prandaj dhe mund të shkitet lehtë nga njëra tek tjetra.

357) Ital. **a v a n t i** = përpara

Motivimi:

a v a n t i

dhe me Shqipen:

â b â n d à**

dhe simbolikisht:

$$\textcircled{1} = -1 \dots(\text{F})$$

Vëmë re me këtë rast ndër të tjera edhe sa vijon:

* Shih edhe *Një Parashtrim i Shkurtë i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit.

** Shih edhe fq.484 dhe 497.

" - 1 " dhe jo " 1 " për arsye se "fillimi" dhe "e para" në dimensionin e Botës tonë materiale është " - 1 ", si *mohim* i " 1 " (e pra i Zotit), e pra si fillim i Botës materiale...

Këtu lidhet edhe fjala "a n t i" që ka kuptimin e "kundërvënies" (- 1) dhe që zberthet me Shqipen njëlloj si fjala e mësipërme në "â n d à".

358) Sanskr. a-b a d d h a-v a t (अबद्धवत्) = ingl. *meaninglessness*
(që nuk ka kuptim, pakuptimësi)

Theksi *semantik* bie tek "a-b a d d h a" dhe motivimi bëhet si:

$$\begin{aligned} a \ b a \ d \ d h a &\rightarrow \text{shq.} - \mathbf{b \hat{a} \ d \hat{a} \dots} = - \textcircled{1} = E = -\infty \text{ (non lié)} \\ &= - (x = x) \text{ (insignifiance)} \end{aligned}$$

Duke zgjeruar Bisedën, mund të shtojmë se:

Shfaqja a, më saktë, dukja, ekzistenca e një entiteti shoqërohet, sipas Urtësisë të stërlashtë Indiane ("Vedat"), me një *lidhje*, e pra simbolikisht *dukja* e entitetit (entiteti në fjalë si një *fenomen*) shoqërohet me një *lidhje*, lidhje kjo që realizon, ndër të tjera, mithin kozmogonik të "Hieros Gamos"* të përgjithësuar:

● (dukja, shfaqja fenomenologjike) = ∞ (lidhja, *Hieros Gamos*)

Që këndej, duke interpretuar simbolin " ∞ " si *relativitet*, nxjerrim si përfundim se çdo "quid" që del në dritë, që "shfaqet" në Botën tonë fenomenale, vihet menjëherë në lidhje me çdo send tjetër, e pra me tërë Universin. Që këndej edhe teza e Fizikës Moderne (ndër të tjera) mbi *një mvarësi universale* të të gjitha sendeve mes tyre. Kjo qe edhe teza që i dha mundësi Ernst Mach-ut të shpjegojë inercinë e një trupi, e pra vlerën e

* Shih ndër të tjera fq.44 dhe 115.

masës së tij, me shumën e bashkëveprimeve të tij me të gjitha trupat e tjerë të Universit, gjë që mund të paraqitet simbolikisht si:

$$\bullet = \sum \mathcal{X}_i$$

Dhe me qene se simboli " \mathcal{X} " mund të interpretohet edhe si ai i *relativitetit* dhe i *ligjit*, kuptojmë atëhere *Përse*-në e Teorisë të Relativitetit, si edhe *Përse*-në e ekzistencës së ligjeve.

Po fjala Sanskritisht që po analizojmë ("a-b a d d h a-v a t") do të thotë edhe "pa kuptim", edhe "i, e gabuar".

Le të përpiqemi të shpjegojmë edhe këtë.

Kemi disa mënyra për ta bërë një gjë të tillë. P.sh. duke u mbështetur kryesisht, në mos po edhe krejt tërësisht, tek Gjuha, siç vumë në dukje pak më lartë, fjala **k u p t i m** lidhet me foljen "kap". Pra të kuptuarit është, sipas Gjuhës, një "kapje". Kapje e kujt? E Parimit Suprem të Universit, e Qendrës Mistike, e ZOTIT shkurt.

Pra mund të shkruajmë:

$$\mathbf{k u p - t o j} = \mathbf{k a p} = \mathcal{X} = \boxed{\circ} = \mathbf{F}$$

Do të jetë atëhere:

$$\begin{aligned} \text{"nuk kuptoj"} &= \text{"nuk kap"} = -\mathcal{X} = -\boxed{\circ} = -\mathbf{F} = -(x=x) \\ &= \mathbf{E} = (x=-x) = \text{jo Arsyë, Absurdi, mungesë e kuptimit} \\ &= -\mathcal{X} = \text{jo lidhje, jo Ligj, Liri} \end{aligned}$$

Nga fjala e Sanskritishtes që po shqyrtojmë shikojmë ndër të tjera edhe se **k u p t i m i** lidhet me një **n d a r j e**, e pra me një përCAKtim, me një deTERMINim.

simbolikisht:

$$\textcircled{1} (\text{ndarje} = \text{cak} = \text{përcaktim}) = F$$

...Ashtu sikundër Arsyeja ka një "cak", një "kufi", e pra simbolikisht:

$$\text{Arsye} = (x = x) = \textcircled{1}$$

po ashtu edhe:

"Kuptimi ka një kufi."

Duke qenë kështu, me qenë se:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Kuantike} &= \text{Parimi i Papërcaktueshmërisë} = - \textcircled{1} = \text{jo kufi} \\ &= \text{"Inseparability Principle"} = - \textcircled{\square} = - \infty = \text{jo kuptim} \end{aligned}$$

Mund të pohojmë atëhere se:

*"Fizika Kuantike, e bashkë me të edhe tërë kodi E,
nuk kanë kuptim (N'ont pas de sens...)."*

Shkurt:

*"Atje ku nuk ka ndarje,
nuk ka kufi, nuk ka cak, nuk ka as kuptim."*

Çfarë do të thotë kjo thellë e më thellë do ta shohim në ndonjë tjetër analizë gjuhësore.

359) Sanskr. a - p i t a (अपीत) = fr. qui n'a pas bu (që s'ka pirë)

Është Shqipja:

– p i j t ë = i pa pi, i pa pirë... (folja "me p i")

360) Rus. **падобјен (подробный)** = ingl. *similar* (i ngjashëm)

Duhet ndarë në:

па до бјен

Dhe me Shqipen:

б а д а б а н

Theksi semantik bie tek "d a", në kuptimin e "n-da-rjes" (jo vetëm në Shqip, por edhe në Sanskritisht dhe në gjuhë të tjera të stërlashta).

E pra simbolikisht, tërë kjo fjalë reduktohet në:

⊕

Me qenë se, sipas Algoritmit Simbolik:

$$\bigcirc = 1 \quad \dots(E)$$

ne mund të shkruajmë edhe se:

$$\oplus = 1/2 \quad \dots(F)$$

ose edhe akoma:

$$\oplus = 1/2 = 0.5 = 5 \quad \dots(F)$$

Por dimë se (Cirlot) **п е s а (5)** është numuri simbolik i Njeriut, ndërsa **н ј њ ш и (1)** ai i Zotit.

Kthehemi tani tek fjala "па до бј е н" e Rusishtes, që do të thotë "i ngjashëm" dhe njëkohësisht (e reduktuar në Shqip...) "ndarje".

Tregojmë me simbolin " \approx ", siç bëhet kudo në matematikë, konceptin e "ngjashmërisë". Kemi atëhere:

$$\text{па до бј е н} \rightarrow \oplus = F = \approx = \text{ngjashmëri...}$$

Ose edhe, thjesht simbolikisht:

$$1/2 = (\approx 1) \quad \dots(F)$$

Por:

$$1/2 = 0.5 = 5 = \text{numuri simbolik i Njeriut}$$

Ndërsa:

$$1 = \text{numuri simbolik i Zotit}$$

Atëhere ekuacioni:

$$1/2 = 5 = (\approx 1)$$

mund të lexohet si:

"Njeriu është i ngjashëm me Zotin."

Kuptojmë dhe argumetojmë atëherë përse në Bibël (*Gjenezë*) na thuhet: "...dhe Ai e krijoi atë, Adamin [*njeriun*] sipas shëmbëlltyrës së Tij" (frengj. "...a son image").

Shikojmë me këtë rast (siç do të mund të shikonim dhe në raste të tjera) se si analiza *sui generis* e Gjuhës (Algoritmi Simbolik si themel i çdo interpretimi...) na lejon të gjejmë të vërteta të stërlashta dhe të mistershme, gjer edhe në vetë Biblën, burim i thellë Diturie theollogjike.

Ky qe një rast madhor, ndër të shumtët, në të cilin Algoritmi Simbolik (si burim dhe artikullim llogjik i Mendimit Mistik) "funksionoi" si një *kriter vërtetësie*.

Ekuacioni simbolik:

$$5 = (\approx 1) \quad \dots(F)$$

e gjejmë edhe në gjuhë të tjera.

Kështu për shembull, në Italisht:

"s e m i" = gjysëm ($1/2$, 5)

"s i m i l e" = i ngjashëm (\approx)

Pra, përfundimisht ajo që donim të vërtetonim.

Në Shqip:

"g j y s" = $1/2$ = 5

"g j a s m e", "i, e n g j a s h ë m" = \approx

Por Shqipja na jep edhe më tepër, sepse kemi, gjithmonë në Shqip:

"g j y s" = $1/2$

"g j a s ë" = ndodhi, ngjarje, materializim = ●

"g j a s i" = dukje, fenomen, ngjashmëri = \approx

Kështu Shqipja na thotë, ndër të tjera, se:

"Çdo ngjarje (ndodhi) është vetëm një ngjarje (dukuri)."

Le të shtojmë këtu edhe diçka tjetër, si në një zgjerim Bisede:

Sipas studjesit të dëgjuar të mendimit simbolik Schneider: *Dualiteti* që përshkon anembanë tërë Kozmosin e *përgjysmon* informacionin primar (tërësor, të pacënuar, të patransformuar).^{*} Dhe kjo sepse, ndonëse Schneider-i nuk e thotë, Algoritmi Simbolik na jep:

$$2 \text{ (Dualiteti)} = 1/2 \quad \dots(F)$$

* Shih ndër të tjera edhe fq.206-207 dhe 633.

...një barazim i çuditshëm, por i vërtetë për Arithmetikën Simbolike, që pozon:

$$2 = \frac{1}{2}$$

e pra:

$$4 = 1$$

e pra akoma:

$$3 = 0$$

ekuacion ky i fundit që përbën themelin e tërë Arithmetikës Simbolike, për të cilën ne kemi folur dhe gjetkë në këtë Studim.

Mund të themi pra se: "Realiteti i thellë, i mbramë, i parë, "noumenik", na shfaqet (kur manifestohet si i realizuar): i përgjysmuar, jo i plotë. Kjo bën që ne të mos e njohim dot kurrë nëpërmjet mendimit racional dhe shkisave *noumen*-in, pohim ky që e gjejmë edhe në gojën e një fillosofi nga më të mëdhenjtë siç ka qenë Emmanuel Kant.*

Por në qoftë se Njeriu do me çdo kusht të njohi të Vërtetën e plotë (tërë të vërtetën...), duhet të heqë dorë nga informacioni shqisor dhe të kërkojë ta njohë Absolutin ("Noumen"-i) nëpërmjet "ekstazës", "marrisë".

Kjo është edhe arsyeja që shën Pali shpall pa kurrëfarë ngurrimi, duke ndjekur besnikërisht mësimet e Krishtit, se: "*O do të jemi të çmendur për botën dhe të mençur për Zotin, o do të jemi të mençur për botën e të çmendur për Zotin*".**

Këtu aludohet *implicite*, ndër të tjera, për *ekzistencën e dy kodeve*, e dy thellësirave mendore: për kodin F (i cekët, i përgjysmuar, i "arsyeshëm", *fenomenal*) dhe për kodin E (i thellë, i plotë, i "paarsyeshëm", "i çmendur", *noumenik*).

* Shih edhe fq.304-306.

** Shih më lartë fq.364.

361) Rus. ç o r t (ч е р т) = ingl. devil (djall)

Simboli arkeotipal i "Djallit" është, siç dihet botërisht, ay i " ● ", që është në të njejtën kohë edhe simboli i "*materies*". Prandaj dhe në Fenë e Krishterë, ndër të tjera, të mos duash *Djallin* është njëlloj si të mos duash *materien dhe Botën materiale...**

Tërë Feja e Krishterë nuk është tjetër veçse një manual për të luftuar Djallin dhe për ta mundur atë, me fuqinë e paepur të Frymës.

Duke qenë kështu, del se etimologjizimi i kësaj fjale duhet të na japë, si rezultat përfundimtar, simbolin e mësipërm, d.m.th. " ● ".

Dhe në fakt, Algoritmi Simbolik na jep bash:

$$\textcircled{\text{1}} = \bullet$$

shq. çjerr rus. çort

Nëpërmjet Shqipës ne vërtetua lidhjen algoritmike ndërmjet *Djallit* ("ç o r t") dhe ngjyrës së zezë (që është në të njejtën kohë ajo e *materies*).

Në zgjerim të Bisedës shtojmë edhe se:

Në Shqip:

$$\textcircled{\text{1}} = \bullet$$

gris-je n-grys-je

Një fenomen i tillë zbulohet me ndihmën e Shqipës edhe në Gjermanisht, sepse kemi:

$$\textcircled{\text{1}} = \bullet$$

shq. "damun Ar..." gjerm. "Dämmerung"

* "*Mos e duani botën dhe asgjë në të...*" thërret shën Jaku.

Siç kemi shpjeguar edhe gjetiu, kemi:

gjerm. "D ä m m e r"... < shq. "D a m u n A r..."*

Kështu që edhe Gjermanishtja e lidh *ngrysjen* ("Dämmerung") me një *grisje* ("Damun Ar"), siç Shqipja e ndihmon ta kuptojë...

Kjo që bëmë ish një segment i një "*Consensio linguarum*" që do të mund të zgjatej edhe më shumë.

Shtojmë më në fund se edhe në Inglisht: "d a r k" = *i errët*, "d a r k n e s s" = *errësirë*, etj.

Edhe kjo fjalë mund të etimologjizohet me ndihmën e Shqipes, që e shpie fjalën Inglisht tek simboli "⊕" (shq. "d a r ë k a") dhe për ekuivalencë simbolike tek "⊗", një nga interpretimet e të cilit është bash ay që lidhet me Inglishten "d a r k" (*errësirë*).

Nëpërmjet ekuacionit:

$$\oplus = \ominus \quad \dots(F)$$

që përftohet, edhe ay, me ndihmën e Shqipes, motivohet gjithashtu edhe fjala tjetër Inglisht me një kuptim të njejtë, atë të *errësirës*: "d i m".

Me Shqipen:

$$\text{Ingl. "d i m"} < \text{Shq. "d ā m"} = \oplus = F = \ominus = \text{terr, errësirë...}$$

Po ashtu, as Rusishtja nuk bën dot pa Shqipen për të shpjeguar kuptimin e fjalës së saj "v e ç e r" (в е ч е р) = *mbrëmje*.

* Shih edhe fq.292 dhe 583.

Shqipja, nëpërmjet operatorit të saj "ç a r ë" (⊕), të cilin Rusishtja e ka shfrytëzuar në shumë e shumë raste për të motivimin e fjalëve të saj, e shpie këtë fjalë tek "b ë ç a r ë", e pra simbolikisht: ⊕ = ● = *errësi, mbrëmje...*

Ky është një rast ndër të pafundëmit ku Shqipja funksionon si një *gjuhë e ndërmjetme* duke i pajisur të gjitha fjalët e të gjitha gjuhërave të botës me kuptimin që ato vetë nuk janë në gjendje ta zbulojnë. Kështu të gjitha gjuhët e botës, pa Shqipen, "nuk do të kishin kuptim", siç kanë pretenduar se ato vërtetë "s'kanë asnjë kuptim" shkencëtarë, gjuhëtarë të rangut botëror, si Saussure-i, Lacan-i etj.

Ata arritën tek ky gabim tmerrësisht i gabuar për dy arsye: (1) i mungonte një gjuhë *ndërmjetësuese*, siç është Shqipja ("Roli *Meslanik*" i Shqipes); (2) i mungonte një artikullim llogjik i mendimit *njerëzor të stërlashtë*, të lashtë dhe aktual, sikundër që është *Algoritmi Simbolik*.

Për të gjitha këto arsye ne mund të themi se *Gjuha Shqipe* është ndër të tjera një gjuhë para-Babeliane *par excellence*.

Që këndej del ndër të tjera edhe se:

"Një gjuhë para-Babeliane është patjetër një gjuhë simbolike."

Mos harrojmë ato sa na thotë Jean Chevalier në "Hyrjen" e fjalorit të tij të simboleve: "*La logique du symbol c'est la logique du Tiers Inclus*"... E pra, një Gjuhë Simbolike do të jetë patjetër një gjuhë që lidhet drejtpërsëdrejti me Qendrën Mistike, e pra ajo duhet vështruar atëhere padyshim si Gjuha e Parë, si Gjuha e Perëndisë, e Frymës së Shenjtë, nëpërmjet së cilës edhe vetë Bota u krijua, siç na tregojnë Shkrimet e Shenjta...

Duke u kthyer përsëri tek etimologjizimi i Rusishtes "ç o r t", është punë e lehtë të tregohet se si ajo shpjegohet me Shqipen "i ç j e r r ë", që nga edhe "i ç a r t u r".

Pra duke u mbështetur tek Shqipja, mund të shkruajmë:

Rus. "çort" < Shq. "çjerr" = \oplus = F = \bullet = Shq. "i çartun"

Mund të shtojmë këtu se Rusishtja "ç o r n i" = i zi, shtron edhe ajo ekuacionin simbolik:

\oplus = \bullet ... (F)
shq. çjerrun rus. çorni

Në Rusisht, siç pamë:

"p a d o b j e n" (подобный) = i ngjashëm

Por në Rusisht kemi edhe:

"p a d r o b j e n" (подробный) = i copëtuar, i hollësishëm (fr. *detaillé*)

fjalë kjo që motivohet gjithashtu me operatorin e lirë Shqiptar:

b â d ā r ...

e pra simbolikisht:

\oplus , 1/2 , 5 ...

Me fjalë të tjera, tërë spektri semantik që gjetëm edhe për fjalën tjetër Rusisht për *ngjashmërinë* ("p a d o b j e n").

Kështu ne mund të themi se *këto dy fjalë janë e njejtë fjalë*, se lidhen që të dyja me simbolin " \oplus ", dhe janë pothuajse homonime.

Por, farkuesit e gjuhës ruse kanë përdorur, me qëllim, këto dy "variante" si për t'iu shmangur keqkuptimit, si edhe për të humbur gjurmët e huazimit të operatorit Shqiptar "d a" (si "d à" dhe "d ā r").

Atëhere, e thëna e famshme e Paracelsus-i:

"Die *Separatio* [Rus. pa-dro-bnost] ist aller Geburt Anfang."

mund të parafrazohet edhe si:

"*Similitas* [Rus. pa-do-bjen] ist aller Geburt Anfang."

Në të dy rastet pra, siç thamë dhe pak më sipër, Ruishtja përdor operatorin Shqiptar "d a" (në kuptimin e *ndarjes*, si edhe atë të *ngjashmërisë*).

362) **Hebr. Rosh Hashanah** (ראש השנה) = ing! *new year* (viti i ri)

Etimologjizimi me anë të Shqipes na jep:

Riosh Syni

Ndonjë shpjegim këtu është i nevojshëm...

Shqipja "ri o s h" haset rallë në letërsinë shqiptare, si në atë të re dhe atë hershme, por bën pjesë themelore në një leksikografi më të gjerë e më të thelluar.

Në Shqip:

"i ri", "e re", "rini", "Rinush", "risi", "riosh"...

pra një sërë variantesh a sinonimesh thujse-homonimike që do të dëshmonin për një lashtësi më të madhe dhe më themelore të këtij operatori në Shqip se në çdo gjuhë tjetër. Ndaj pra dhe mund të themi se ai është bash i yni.

Gjithashtu fakti që në Shqip ekziston varianti më *i thjeshtë* i këtij operatori ("ri", "re") mund të vështrohet si një arsye tjetër për t'i atribuar variantit Shqip një lashtësi më të madhe se në gjuhë të tjera.

Në zgjerim të Bisedës:

Kemi parë se:

$$2 = -1$$

një nga formulat themelore të Arithmetikës Mistike, të cilën e gjejmë në një mënyrë a në një tjetër, në të gjitha gjuhët e botës.

Që andej mund të nxirret:

$$3 = 0$$

ekuacion ky që përbën themelin e Arithmetikës Mistike, sikundër e dimë.

Duke qenë kështu, ne mund të shohim se tek prefiksi "r i s-", "r e s-", "r i-", "r e-" (në Latinisht, Italisht, Frengjisht, Inglisht etj.) Shqipen "i r i", "e r e",... në kuptimin e "përsëritjes" (p.sh. Ital. *ri-mettere*, Ingl. *re-read*), si edhe në kuptimin e "mohimit" (p.sh. Ingl. *re-move*).

Dhe gjithashtu, shpjegimi i faktit të rëndësishëm gjuhësor që "r i", "r e" etj. etj. si prefiks në gjuhë të huaja, ka edhe kuptimin *negativ* (-1), duhet lidhur me tezën e Dialektikës fillosofike, sipas së cilës "e reja" vështrohet si "negativitet". Mos harrojmë gjithashtu se "e reja" vjen *pas* (2) së vjetrës, prandaj dhe mund të shkruajmë:

$$e \text{ Reja} = 2 = -1$$

Duke u futur edhe më tej në këtë tematikë, le të kemi parasysh se, siç kemi parë dhe gjetkë, mund të shkruajmë:

$$\bullet = -1 = F = 2$$

Bota	mohimi	dyshi,
materiale		Djalli

Tek Cirlot gjejmë një shpjegim më të hollësishëm dhe bindës lidhur me këtë ekuacion: Dyshi (2) si numuri më *ogursëz* që ekziston është ay që kthen çdo informacion primar në një fenomen. A e thënë ndryshe:

Kalimi nga "*Noumeni*" në një "*fenomen*" realizohet me kalimin:

$$1 \rightarrow 2 = -1 = 1/2$$

Pra, mund të themi ndër të tjera se:

Dyshi realizon "deformimin" e informacionit primar, *përgjysmimin* e tij, "fenomenalizimin" e tij... gjë që do të thotë se ne nuk perceptojmë dot me shqisat tona dhe mendimin tonë racional tërë informacionin primar që na vjen "*Noumeni*", por vetëm *gjysmën* e tij, pra jo "○", por:

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

gjysma, Realiteti material
fenomeni

Duke u kthyer tek etimologjia e fjalës Hebraisht që po shqyrtojmë, rikujtojmë se kalimin:

$$\text{"s e n e"} < \text{"s y n i"} \\ \text{(vit)} \quad \quad \text{(syri)}$$

e kemi parë dhe në shembuj të tjerë, të inkapsulluar në gjuhë të ndryshme.

Ne kemi folur gjithashtu, gjerë e gjatë, edhe për semantizmin shumë interesant të këtij operatori, jo vetëm në gjuhë të ndryshme të afërta a të largëta, të gjalla a të vdekura, por edhe ndër mithet kozmogonike etj. Referojmë atje.*

* Shih edhe fq.81 dhe 771.

363) Ingl. **drop** = rrëzoj

Theksi semantik bie tek "d r", që lidhet nga ana e saj me Shqipen:

$$\text{dar} = \text{⊖} = \mathbf{F} = \downarrow = \text{bie, rrëzohem...}$$

(n) d a r - j e

Gjithpo me këtë operator lidhet edhe Shqipja "**z - d r y - p**" (ingl. *go down, to descend*).

Kështu Shqipja shtron ekuacion simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \text{⊖} & = & \downarrow \quad \dots(\mathbf{F}) \\ \text{dar} & & \text{z-dry-p} \end{array}$$

Jashtë **Bisedës** rritojmë edhe se në Shqip, më tepër në gjuhën popullore, kemi gjithashtu:

$$\text{dro} = \text{ndoshta (ingl. perhaps)}$$

që jep konceptin e "dyshimit".

Pra dhe mund të shkruajmë:

$$\text{shq. dro} < \text{darë} = \text{⊖} = 1/2 = 2 = \text{dysh-im} \dots(\mathbf{F})$$

364) Ital. **estirpare** = ingl. *extirpate, uproot* (çrrënjës)

Motivimi:

$$\text{e stir pare}$$

e pra, me Shqipen:

$$- \text{shtir bërë} = - \text{⊖} = \text{○} = \text{Zero} = \text{Hiç...}$$

365) Rus. **вчeра** (вчeра) = ingl. *yesterday* (dje)

Motivimi:

v ç e r a

dhe me Shqipen:

bë ç a r ë = ⊕ = F = -1 = ditë e kaluar...,
e pra e mohuar, e pra "dje"...

366) Rus. **вeчeр** (вeчeр) = ingl. *dark* (mbrëmje)

Motivimi:

v e ç e r

dhe me Shqipen:

bë ç ā r = ⊕ = F = ☹

Shtojmë më në fund se të njejtin motivim ka edhe Inglishtja "d a r k" = *errësirë*, që duhet zberthyer me Shqipen si:

d a r k → shq. d a r ë k a = ⊕ = F = ☹

367) Rus. **нaçaлo** (нaчaлo) = ingl. *beginning, outbreak* (fillim)

Theksi semantik bie tek operatori i Shqipes "ç a" = simb. ⊕.

Dhe atëhere do të kemi:

нaçaлo → ç a = ⊕ = F = -1 = fillimi...*

Nuk do harruar këtu se fjala e mësipërme e Rusishtes që ne motivuam është pjesorja e shkuar e foljes "нaçaтs" (нaчaтs) = filloj..., ku del më qartë në pah operatori shqiptar "ç a", "i, e ç a t ë", e kështu me radhë.

* Shih edhe fq. 70, 95, 275, 671 dhe 742.

Paskajorja e kësaj foljeje është "**n a ç i n a t s**", por shtojmë këtu për ato që e njohin Rusishten se kjo gjuhë ka dy "aspekte" të quajtura respektivisht: 1) aspekti i kryer (auristi i Shqipes) ku hyn këtu edhe folja "n a ç i n a t s", 2) aspekti i pakryer (e pakryera e Shqipes, ital. *imperfetto*) dhe këtu hyn folja "n a ç a t s".

Kështu që etimologjia si e njërit aspekt, ashtu edhe e tjetrit, bëhet gjithmonë me operatorin e Shqipes "ç a", sikundër dhe e pamë.

368) Rus. **pri ç i n a** (**п р и ч и н а**) = ingl. *cause* (shkak)

Duhet ndarë në:

pri ç i n a

Këtu: "**ç i n a**" liëhet brenda Rosishtes me "**ç i n i t s**" (**ч и н и т ь**) = *bej, ndreq...*, e *pra simb.* " ● ". K'është mund të themi se Rosishtja shtron me ndihmën e Shqipes këtë ekuacion simbolik ndërgjuhësor:

⊕ = ● ... (F)

shq. çan rus. çin-its

Kështu Rosishtja na thotë se "shkaku" (i Botës) përputhet me një "bërje" primordiale, të parë (rus. "pri-"), pra shkurt: *Bota është bërë, nuk se ka qenë gjithmonë...* Por mund të themi edhe, gjithnjë sipas Rosishtes (me ndihmën e Shqipes), se: *Bota është krijuar me një ç a - r j e, me një për-ç a r j e...*

Duke u kthyer disi prapa përpikësojmë edhe diçka tjetër: "**p r i**" në fjalën "**p r i - ç i n a**" nuk është tjetër veçse Shqipja "i, e **p a r ë**".

Pra, duke përmbledhur, kemi:

rus. "**p r i - ç i n a**" = "**b ë r j a e p a r ë**"

369) Sanskr. a - p o h a (अपोह) = fr. *fait de contester, de nier* (kundërshtoj, mohoj)

Motivohet si:

– p o h o j , – p o h i m = m o h i m

370) Sanskr. p r e k ś y a (प्रेक्ष्य) = fr. *visible* (i dukshëm)

Motivimi me Shqipen:

b ë r ë k a s y

(që mund të shihet me sy...)

Shtojmë këtu se rrënja apo operatori "s y" nuk ekziston në gjendje të lirë në Sankritisht, ndaj pra dhe ajo nuk është në gjendje të motivojë këtë fjalë pa ndihmën e Shqipes.

371) Sanskr. a p e k a ś y a (अपेक्ष्य) = fr. *dont on doit tenir compte* (që do patur parasysh)

Motivimi:

â b ë : k a s y

(që do patur "para sysh")

372) Sanskr. a d h a r a (आधार) = fr. *situé au-dessous; inférieur* (i vendosur poshtë, inferior)

Motivimi me Shqipen:

â d ā r ē = ⊕ = F = ↓

ku "â" rri për "â s h t", dhe "d ā r ē" është pjesorja e foljes "DAj", folje

që ekziston në gjendje të lirë edhe në Sanskritisht, por jo veç me një pjesore a një infleksion çfarëdo në trajtën "d h a r a".

Kujtojmë këtu edhe motivimet analloge, me ndihmën e Shqipes dhe të Algoritmit Simbolik ("*Consentio linguarum*"):

Ingl. **u n d e r** (*poshtë, ndën*) = shq. **â n d ā r** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ↓

Ingl. **d o w n** (*poshtë, ndën*) = shq. **d à b â n** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ↓

Gjerm. **u n t e r** (*poshtë, ndën*) = shq. **â n d ā r** = $\textcircled{\text{D}}$ = ...

Greq. **k á t o** (κάτω) (*poshtë*) = shq. **k a d à** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ↓

Ital. **s c i n d e r e** (*ndaj*) = $\textcircled{\text{D}}$ = **s c e n d e r e** (*zbres*) = **F** = ↓

Frengj. **t o m b e r** = shq. **t h y m b ě r** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ↓

Etj. etj...

Në të gjitha këto raste dhe në shumë e shumë të tjerë *Rënja* (↓) lidhet si me shkakun e saj me një *Ndarje* ($\textcircled{\text{D}}$) sipas ekuacionit të Algoritmit Simbolik: $\textcircled{\text{D}}$ = ↓ ...(**F**).

373) Sanskr. **a d h a s** (अधस्) = fr. *sous, au-dessous, vers le bas, à terre* (ndën, për nga poshtë, përtokë)

Shpjegohet me Shqipen:

a d h a s → shq. **â d a s í** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ↓

Le të vëmë ré këtu se grupi:

D { a, e, i, o, ... } S

është shumë produktif në Shqip si rrënjë e pastër a operator i lirë, duke shërbyer për të ndërtuar fjalë me kuptime të ndryshme, por me lidhje simbolike (algoritmike) të sigurta dhe të rëndësishme. Le të shohim disa prej tyre:

$$\begin{aligned}
 \text{d y ş} &= 2 \\
 \text{d a s í} &= \textcircled{1} \\
 \text{d i s a} &= \neq 1 \\
 \text{d ë ş t o j} &= \downarrow \\
 \text{n d e ş j e} &= (\rightarrow \neq \leftarrow) \\
 (\text{v}) \text{ d e s} &= \bullet \\
 \text{n d y s í} &= \bullet \\
 \text{d y ş e m e} &= \downarrow \\
 \dots &\quad \dots
 \end{aligned}$$

Kështu Shqipja shtron në këtë mënyrë vargun e ekuivalencave simbolike në F:

$$\begin{array}{ccccccccc}
 2 & = & \textcircled{1} & = & (\neq 1) & = & \downarrow & = & (\rightarrow \neq \leftarrow) & = & \bullet & \dots(F) \\
 \text{dysh} & & \text{dasí} & & \text{disa} & & \text{dështoj} & & \text{ndeshje} & & (\text{v})\text{des} & \\
 & & & & & & \text{dyshe} & & & & (\text{n})\text{dysí} &
 \end{array}$$

374) Sanskr. a n t a r (अन्तर) = fr. a l'intérieur, au milieu, entre, dedans, dans (brenda, në mes, ndër, në...)

Motivimi:

$$\begin{aligned}
 \text{a n t a r} &\rightarrow \text{shq. â n d â r} = \textcircled{1} = (|) \text{ (au milieu, entre)} \\
 &= \textcircled{\square} \text{ (a l'interieur, dedans, dans) } \dots(F)
 \end{aligned}$$

Një sqarim: lidhur me përsë " \square " dhe jo " \boxtimes "..., kjo ndodh për arsye se Gjuha referon gjithmonë tek një paradigmë primordiale dhe superlative. Dhe këtu kjo paradigmë është vetë Qëndra, vetë Parimi Hyjnor që paraqitet simbolikisht, ndër të tjera, me " \circ " (shih edhe tek Cirlot disa nga interpretimet e ndryshme të këtij simboli, si "*the All*", "*the infinite*", "*the Universe*").

Shtojmë këtu se në Veri, kur e ndjellin lopën që të hyjë mbrenda në stallë i thonë: "Andé lopa, andé!", ku "a n d é" rri për "b r e n d a".

Kuptojmë atëherë edhe përsë Shqipja "b r e n d a" mund të motivohet si:

$$"b \acute{e} r \acute{e} \hat{a} n d \grave{a}" = \textcircled{1} = F = \square \dots(F)$$

Dhe së fundi kuptojmë fjalën Shqipe "a n t a r" (ingl. *member*) që lidhet direkt me Sanskritishten "ā n t a r a" (आन्तर), siç kuptohet lehtë.

Del vetvetiu atëherë se fjalët Frengjishte "e n t r e", "e n t r e r", "i n t é r i e u r"... "i n t i m e"... lidhen e shpjegohen të gjitha me Shqipen.

Kemi:

$$\text{fr. entre} \rightarrow \text{skr. antara} = \text{shq. \hat{a} ndar \acute{e}} = d a = \textcircled{1} = (|) \dots(F)$$

$$\text{fr. entrer} \rightarrow \text{shq. \hat{a} ndar \acute{e}} = \textcircled{1} = F = \square$$

$$\text{fr. intime} \rightarrow \text{shq. \hat{a} ndam \acute{e}} = \textcircled{1} = F = \square$$

375) Frengj. d a n s = ingl. *inside* (brenda)

Shpjegohet me Shqipen në këtë mënyrë:

$$d a n s \rightarrow \text{shq. dan (ndan)} = \textcircled{1} = F = \square$$

376) Greq. *endos* (εντός) = brenda

Motivohet me Shqipen:

$$e n d o s \rightarrow \text{shq. } \hat{a} n d \grave{a} = \textcircled{\circ} = F = \square$$

377) Lat. *intus* = brenda

Motivimi me Shqipen jep:

$$i n t u s \rightarrow \text{shq. } \hat{a} n d \grave{a} = \textcircled{\circ} = F = \square$$

Këtu një sqarim është i nevojshëm.

Gjuha, siç kemi treguar edhe gjatë, emërton (*denominon*) sipas një paradigme superlative, zanafillore... gjë që do të thotë se ajo referon tek situata a ngjarja absolutisht më e rëndësishme nga të gjitha, e pra tek "situata", "ngjarja" e krijimit të Botës. Vijimi më tej i këtij studimi do të vërë në pah plot shembulla të tilla. Këtu, lidhur me referencimin e "intus" (*brenda*) tek simboli " \square ", është fjala për "brendësimin" e "brendësive", atë të Zotit, me të cilin dhe Bota filloi, dhe kjo sepse Algoritmi Simbolik jep:

$$\square = \bullet \quad \dots(F)$$

brendësimi i Zotit Krijimi i Botës

Kjo është pra arsyeja përse ne shkruajmë " \square ", ku " \circ " është ndër të tjera simboli i Zotit, dhe jo " x " ku " x " është një "quid" çfarëdo.

Në zgjerim të Bisedës le të vëmë ré këtu se nga kjo etimologji del ndër të tjera edhe se e "brendshmja" (*intimiteti*, \square) është diçka Hyjnore, me qenë se:

$$\circ = (x = -x) = \text{DEUS}$$

Le të kujtojmë këtu edhe ato sa na thotë Krishti:

"Mbretëria e Qiejve është brenda jush."^{*}

Që e brendshmja është e pavdekshme, këtë e gjejmë, siç pamë, edhe tek Gjermanishtja, ku:

"i n n e r" = i brendshëm (ingl. *interior*)

"i m m e r" = i përhershëm, i përjetshëm, i pavdekshëm (ingl. *eternal*)

Nga ana tjetër, Hermes Trismegistus, autori legjendar, mes të tjerash, i "*Tabula Smaragdina*",^{**} na thotë se:

"That wich abides inside is always."

[Shka është brenda është për gjithmonë...]

Shtojmë më në fund, mbi të gjitha këto, se:

"Çdo figurë simbolike në F paraqet një mit kozmogonik."^{***}

* Lluca, 17:21.

** Shiko edhe fq.59, 225 dhe 571.

*** Për shembull: $\textcircled{1} = \text{ndarje} \dots$ Dimë se: $\textcircled{1} = \bullet \dots(F)$

Pra, Ndarja krijon Botën materiale.

Marrim një figurë tjetër simbolike në F: ∞ . Dimë se: $\infty = \bullet \dots(F)$

Pra, "*Hieros Gamos*" (lidhja, nyja) krijon Botën materiale.

Marrim: $(\rightarrow \neq \leftarrow) = \text{kundërvënie, luftë} \dots$ Algoritmi Simbolik jep:

$$(\rightarrow \neq \leftarrow) = \bullet \dots(F)$$

Kemi kështu mitin kozmogonik të krijimit të Botës me anë të një lufte.

E kështu me radhë...

Vëmë ré se në Sanskritisht, Latinishtja "i n t u s" do reduktohej në "a n t a".

Në të gjitha këto shembulla, siç pamë, *koncepti i mbrendësisë jepet me anë të atij të ndarjes*.

Le të ndalemi këtu për një çast.

Ne dimë se krijimi i Botës lidhet me një n d a r j e. Rikujtojmë të thënë e famshme të Paracelsus-it: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"... Një gjë e tillë pasqyrohet në Gjuhë (e cila ngrihet siç dimë mbi Vizionin Mistik të Universit). Kështu, bie fjala, në Shqip: "n d ë r - t o j" lidhet, siç shihet qartë, mbrenda Shqipes me "n d ā r" (folja "NDAj"), e pra simb. "⊕".

Rikujtojmë gjithashtu se Algoritmi Simbolik jep:

$$\oplus = \bullet \quad \dots(F)$$

ku simboli i fundit është ndër të tjera ai i "*materialës*", e pra i "Botës materiale", si edhe i çdo sendi material e realizimi *material*, a ndryshe, i LINDJES së LËNDËS. Vëmë ré shkarazi këtu se Shqipja me këtë thujse-homonimi provon se *lënda ka lindur*, se pra ajo nuk ka qenë përherë, siç pohon fillosofia materialiste, se ajo ka pra një fillim e një fund, gjë që përputhet plotësisht, ndër të tjera, gjer edhe me rezultatet më të fundit të Kozmollogjisë moderne.

Në Rusisht: "d e l a t s" (делать) = bëj (simb. ●), ndërsa "d e l i t s" (делит) = ndaj (⊕). Ndërsa në Shqipen e lashtë, arkaike: "b d a j" = bëj (●), fjalë kjo që ndahet në "b + d a j" e pra "b ë d a j" (e pra ⊕).

Si Shqipja pra, ashtu dhe Rusishtja, shtrojnë në të njejtën mënyrë ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{rus. delits} & & \text{delats} \\ \text{shq. daj} & & \text{bdaj} \end{array}$$

378) Inql. **t o d o** = bëj

Lidhet, në bazë të atyre që pamë më sipër, si me motivuesen e vet, me Shqipen:

d a j

dhe Inglishtja "**d o n e**" me Shqipen:

d ā n

e pra simbolikisht:

⊕

Rikujtojmë këtu se numuri i *materies* e pra dhe i *Botës materiale*, ku sundon i plotfuqishëm *dualiteti*, është **2**. Por kemi siç dimë: $2 = \oplus$, dhe simboli i fundit mund të interpretohet si ai i *ndarjes*, që këndej pra dhe *materializimi* ("bërja") nëpërmjet një *ndarjeje*, siç pamë në shembullat e mësipërme. Ky është një tjetër vërtetim, ndër shumë të tjerë, i saktësisë të etimologjisë tonë të Inglishtes "to do".

379) Greq. **d h e n** = ingl. *no* (jo)

Kemi:

$$d h e n \rightarrow \text{shq. } d \bar{a} n = \oplus = F = -1$$

380) Greq. **a g o u r o s** (ἀγούρος) = ingl. *not ripe, hard* (i papjekur, i fortë)

Motivohet me Shqipen:

â g u r = "është gur"

në kuptimin "është i fortë", "i papjekur"...

* Shih edhe fq.477 dhe 531.

381) Lat. *condita* = ingl. *built* (i ndërtuar, i bërë)

Është në Latinisht pjesorja e foljes "c o n d i r e" = bëj, ndërtoj.

Me Shqipen:

$$k a n d ā t ē = \textcircled{\ominus} = F = \bullet$$

Vëmë në dukje këtu se: "d ā t ē", "l ā t ē", "t h ā t ē"... , sot "d a r ē", "l a r ē", "t h a r ē"... kanë qenë dikur pjesore të foljeve përkatëse dhe më vonë "pjesore të adjektivizuara" dhe më pas shkurt adjektiva (mbiemra): "i,e dātë", "i,e lātë", "i,e thātë"..."

Shtojmë këtu akoma se në Latinisht: "*Ab urbe condita...*" = Që nga ndërtimi i Qytetit (Romës)... Dhe kjo sepse Rromakët e vjetër e matnin kohën duke u nisur nga themelimi i Romës, ashtu sikundër Koha Moderne (në Europë veçanërisht) e mat kohën me lindjen e Krishtit...

382) Sanskr. *su - d u r a* (सुदूर) = fr. *très distant* (shumë larg)

Motivohet me Shqipen:

$$s h u - m i (n) d ā r = \textcircled{\ominus} = (A \cdots B)$$

* Ekziston një ekuivalencë, fillosofike, llogjike dhe linguistike, mes mbaresës "-a r" dhe "-a t". Që të dyja këto do të paraqiteshin simbolikisht me:

" $\textcircled{\ominus}$ " që paraqet arkeotipisht Parimin Suprem të Universit, e pra këtu "Arin", dhe në të njëjtën kohë Parimin Suprem të Universit të personifikuar me Zotin, me "Atin". Është e qartë atëhere pse:

$$"-ar" = "-at"$$

Kështu që, p.sh. *tharë* = *thātë*, *larë* = *lātë* etj. etj.

Mund të optosh për mbaresën "-a t" ose për mbaresën "-a r", me qenë se këto të dyja janë ekuivalente. Këtë punë ka bërë dhe Gjuha...

383) Sanskr. **a r d h a k a t h a n a** (अर्धकथन) = fr. *fait de raconter à demi*
(të treguarit vetëm përgjysëm)

Motivimi:

"a r d h a" = shq. "A r d à" = ⊕ = 1/2

"k a t h a n a" = shq. "k a t h ā n" (ka thënë, ka treguar)

Pra:

"k a t h ē n ě 1/2 "

(⊕ , - ⊙ , jo të tërën...)

Vërejmë këtu se në Sanskritisht, ndryshe nga Shqipja, nuk ekzistojnë të gjitha fleksionimet (mënyrat e kohët e ndryshme) të foljes "me t h a n ě". Kjo do thotë atëherë se: sankr. "thana" < shq. "thanë".

384) Sanskr. **a v a - k h a n d a n a** (अवखण्डन) = fr. *fait de mettre en pièces* (ndaj në pjesë)

Motivimi me Shqipen:

â b â : k a n d ā (n) = ⊕

("është ndarë")

385) Sanskr. **v i - g a t t i t a** (विघटित) = fr. *touché, heurté* (goditur)

Motivimi me Shqipen:

â b â g o d i t

(folja "me godit")

386) Sanskr. **a v a - d h i** (अवधि) = fr. *limite* (cak, kufi)

Motivohet me Shqipen:

â b â d à = ①
 ("është bërë e darë")

Interpretimi i simbolit të fundit kënaq të gjitha kërkesat kuptimore të fjalës po shqyrtojmë

387) Sanskr. a - v e d i (अवेदि) = fr. *ignorance* (injorancë, padije)

Motivimi:

- b a d i
 ("që nuk di")

388) Sanskr. a - v e d y a (अवेद्य) = fr. *qui ne peut être connu* (që s'mund të dihet, të njihet)

Motivimi:

- b ë d i
 (pa dije, padituni)

389) Sanskr. d i t a (DAY-) (दित) = fr. *divisé, déchiré* (i ndarë, i grisur)

Motivimi:

(i) d ā t (i ndat, i ndarë, i ndam...) = simb. ①

Këtu "i d ā t" mund të vështrohet si një pjesore e lashtë e foljes "DAJ" (me nda) në Shqip.

Si shembull tjetër të ekzistencës së kësaj pjesoreje të lashtë (që në një kohë të dytë është adjektivizuar) mund të marrim:

i d y t ë (2) < i d a t ë (①)

Dhe dimë se Algoritmi Simbolik na jep:

$$1/2, \textcircled{1} = 2 \quad \dots(F)$$

i d a t ë i d y t ë

Do të mund të sillnim shembulla të ndryshme nga gjuhë të tjera, për të treguar saktësinë e ekuacionit simbolik që na u desh këtu për të motivuar fjalën Sanskritisht "d i t a": $\textcircled{1} = 1/2 = F = 2$.

Kujtojmë këtu se: $1/2 = 2$. Kjo sepse kemi, duke shumëzuar të dy anët me dy: $(4 = 1)$, që nga edhe: $(3 = 0)$, ekuacion ky që përbën themelin e tërë Arithmetikës Mistike, sikundër që e kemi vënë në dukje këtë edhe në raste të tjera motivimi.

390) Rus. **f t o r o j** (второй) = i dyti

Do zbërthyer si:

f t o r o j

Dhe me Shqipen:

$$\text{"b ë t h y e r"} = \textcircled{1} = 1/2 = 2 = \text{dy, i dyti...}$$

("bë darë")

Është e qartë se Rusishtja " f " (" B - ") nistore rri për Shqipen "b ë" (folja bëj).

Duke zgjeruar Bisedën, mund të introduktojmë një "*Consensio linguarum*" të tillë:

Gjermanishtja "a n d e r" = tjetri, i dyti, ai që vjen pas..., mund të zbërthet si:

$$a n d e r \rightarrow \text{shq. â n d â r} = \textcircled{1} = F = 1/2 = 2$$

Ashtu edhe Inglishtja "o t h e r" = tjetri, i dyti, ai që vjen pas...

Mund të zberthet edhe ajo si:

$$o t h e r \rightarrow \text{shq. } \hat{a} t h y e r = \textcircled{1} = F = 1/2 = 2$$

ose edhe:

$$o t h e r \rightarrow \text{shq. } \hat{a} t h e r u n \text{ ("ka t h e r")} = \textcircled{1} = F = \dots$$

391) Rus. *t v o r i t s* (творить) = krijoj, bëj

Motivimi bëhet me anë të Shqipes në këtë mënyrë:

$$t v o r i t s \rightarrow \text{shq. } t \hat{e} b \hat{e} r \hat{e} = \text{"bërje", krijim.}$$

392) Sanskr. *t a m a* (तम) = fr. *obscurité, tenèbres* (terr, errësi) (errësirë)

Motivimi:

$$t a m a \rightarrow \text{shq. } d \hat{a} m = \textcircled{1} = \bullet \dots(F)$$

Në zgjerim të Bisedës:

Rikujtojmë këtu se në Inglisht "d i m" = errësirë, motivohet edhe ajo me Shqipen:

$$d i m \rightarrow \text{shq. } d \hat{a} m = \textcircled{1} = F = \bullet$$

Në Inglisht gjithashtu: "d u s k" = perëndim dielli, mbrëmje (fr. *crépuscule, soir...*), që zberthehet edhe ajo me Shqipen si:

$$d u s k \rightarrow \text{shq. } k a d y s h = 2 = F = \bullet$$

Rikujtojmë këtu se dhe Sanskritishtja "d o ष a" (दोष) = mbrëmje, errësirë, motivohet nëpërmjet Shqipes "d y s h" = 2, numuri i çdo të keqeje, nga

të gjitha numurat më ogursezi, numuri i materies, i kundërvënies ndaj Parimit Suprem të Universit e pra Dritës, etj. etj.

Do mund të shtonim këtu si një "*Consensio linguarum*" edhe Gjermanishten "Dämmer" (muzg) → shq. **damun Ar** = $\textcircled{1}$ = 2 = ● = ...

Kështu, përsëri me Shqipen do të mund të motivohej edhe Ruishtja "temnotà" (темнота) < shq. **damun** = $\textcircled{1}$ = **F** = ● = terr, errësi.ë.

Mund të shtojmë këtu edhe Greqishten "skótos" (σκότος) ku theksi semantik bie mbi "kot" < shq. "kadà" = $\textcircled{1}$ = **F** = ● .

393) Rus. **tien** (тьень) = hije

Edhe kjo fjalë gjen një motivim adekuat me Shqipen si:

$$\text{tien} \rightarrow \text{shq. thyn} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \bullet$$

394) Ital. **tenebra** = errësi.ë

Zbërthehet si:

$$\text{tenebra} \rightarrow \text{shq. bërë thyn} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = \bullet$$

395) Sanskr. **an-ādi** (अनादि) = fr. *qui n'a pas de commencement* ; *eternel* (që s'ka fillim ; i përjeshëshëm, i amshueshëm, që gjithmonë ka qenë...)

Zbërthimi:

$$\begin{aligned} \text{anadi} &\rightarrow \text{shq. -âdà} = -\textcircled{1} \text{ (qui n'a pas de commencement)} \\ &= \textcircled{0} = (\mathbf{t} = 0) \text{ (eternel)} = (\mathbf{x} = -\mathbf{x}) = \text{Parimi Suprem i Universit} \end{aligned}$$

Dhe m.q.s. Gjuha emërton sipas një paradigme superlative, zanafillore, etj. etj., Sanskritishtja na thotë atëhere se:

- 1) Me qenë se gjithshka duhet të fillojë me një ndarje (Paracelsus: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang...), atëhere pa ndarje (– ⊕) nuk ka fillim.
- 2) Rikonfermohet një me të edhe Teoria shkencore e *Big Bang*-ut që flet për një *fillim* të Botës.

Pra, edhe sipas Dijes të stërlashtë, themelvënëse Indiane (*Vedat*) gjithshka ka filluar me një ndarje. Lind pyetja: *Me një ndarje të kujt?* Përgjigja është: *Të të kundërtave*, të cilat gjer atëhere "pushonin" në harmoni, pajtim të plotë në Tezën Hegeliane, që realizonte si Frymë Absolute (Frymë e Shenjtë), Unitetin e të kundërtave që përbën, ndër të tjera, vetë esencën e Qëndrës Mistike, "*the Supreme Principle of the Universe*", dhe ekuacioni i të cilës mund të shkruhet si:

$$(x = -x) = -(x \neq -x) = \text{jo ndarje e të kundërtave}$$

Jemi kështu para krijimit (para *ndarjes*), në kodin E (Fryma Absolute, Fryma e Shenjtë). Të kundërtat janë " x " dhe " $-x$ " dhe ato, siç shihet qartë, janë, në Qëndër, në pajtim, në unitet të plotë, në gjirin e "*Coincidentia oppositorum*". Bota s'është ende krijuar...

Por ja, s'dihet qysh e pse, të dy të kundërtat, " x " dhe " $-x$ " ndahen ("*Survient sans aucune raison évident la Séparation...*"* do të shprehej ky moment tragjik në një trajtë disi poetike...), dhe atëhere do të kemi ($x \neq -x$), dhe jemi tashmë (kemi "rënë" tashmë...) në kodin F.

U realizua kështu skema e të gjitha mytheve kozmogonike që mund të shkruhet si:

$$E \downarrow = F$$

* "*Çatis pa ndonjë arsye të dukshme ndarja...*"

Në gjuhën e Fillosofisë Hegeliane, krijimi i Botës (si "alienacion" i Frymës Absolute) realizohet në kalimin (rënie, "zbritjen") e Tezës në Antitezë, ku e kur të dy Frymat (ajo Subjektive dhe ajo Objektive), gjer atëhere në unitet e në harmoni, ndahen dhe kundërvihen. Fillon kështu, bashkë me krijimin e Botës edhe lufta e të kundërtave e cila shfaqet, në themel të saj, mes të Brendshmes (*subjektives*) dhe të Jashtmes (*objektives*).

Jo më kot në Gjermanisht e jashtëmja, objektiva, quhet "**Gegenstand**" = "ajo që na *kundërvihet*", dhe gjithpo ashtu nuk është pa kuptim që në Frengjisht "**objectivité**" dhe në të njejtën kohë "**object**" (qortoj, korrigjoj, kundërshtoj etj.) e kështu me radhë.

Në kohën tonë po vihet ré përherë e më tepër një mbiçmim i Subjektivitetit ndaj Objektivititetit, gjë që rikonfermon qëndrimin negativ të Gjuhës ndaj "objektivitetit" (gjerm. *Gegenstand*, fr. *objection*.)...

- a) Në Fizikën Kuantike po sfumohet përherë e më tepër koncepti i Objektivititetit dhe bashkë me të ay i Realitetit Material.
- b) Qendra Mistike, si "*The Supreme Principle of the Universe*", siç na tregon Cirlot, arrihet "duke kaluar nga e Jashtëmja (*objektiviteti*) tek e Brendshmja (*subjektiviteti*)". *
- c) Soren Kierkegaard, babai i Ekzistencializmit, thotë shprehimisht:

"E vërteta është subjektive."

* Kujtojmë ndër të tjera nga Cirlot (fq.40): "*The Centre.... To leave the circumference for the centre is equivalent to moving from the exterior to the interior, from form to contemplation, from multiplicity to unity, from space to spacelessness, from time and timelessness...*" [Qendra. Të largohesh nga periferia e rrethit me drejtim për nga qendra, është njëlloj si të lëvizësh nga jashtë brënda, nga forma tek esenca, nga shumësia tek njësia, nga hapësira tek pahapësira, nga koha tek pakohësia...]

- ç) Fjala "subjektive" do marrë sigurisht si "e mbrendshmja" dhe dimë se mund të shkruajmë:

$$\text{e Mbrendshmja} = \bigcirc$$

$$\text{e Jashtme} = \textcircled{\ominus}$$

Algoritmi Simbolik na jep gjithashtu:

$$F = \boxed{E}$$

Po me qenë se:

$$E = \bigcirc$$

Mund të shkruajmë:

$$F = \textcircled{\ominus} = \bullet = -\bigcirc = \boxed{\bigcirc}$$

Dhe kuptojmë atëhere përse në Italisht kemi thuar *e-homoniminë*:

$$\text{"i n t e r o"} \text{ (e tëra)} = \text{"i n t e r n o"} \text{ (brenda)}$$

- d) Po të njejtën gjë na thotë në mënyrën e saj edhe Gjermanishtja, ku: **"i m m e r"** (*gjithmonë, përjetësisht*) = **"i n n e r"** (*brenda*)

dh) Jisu Krishti: "Mbretëria e Qiejve është *brenda* jush..."*

- e) Fizikanti i shquar inglez Bohm, në librin e tij të famshëm "*Wholeness and the Implicate Order*", dallon një realitet të jashtëm, "fenomenal", dhe një realitet të brendshëm, esencial ose "noumenal". Tek i pari kemi fragmentaritet, tek i dyti kontinuitet.

Duke qenë kështu, Bohm-i pozon:

$$\textcircled{\ominus} = \boxed{\bigcirc} \rightarrow$$

explicit order implicit order

* Lluca 17:20-21.

- ë) Edhe Kanti bën të njejtën gjë me ndarjen e mbarë realitetit në "fenomenal" (\oplus) dhe "noumenal" (\ominus).

Shtojmë me këtë rast edhe se mund të shkruajmë:

$$\bigcirc = -\oplus = \text{papërcaktueshmëri} = \dots$$

Parimi i papërcaktueshmërisë i Fizikës Kuantike = Fizika Kuantike

Del që këndej se Fizika Kuantike merret jo më me fenomenin (siç bënte Fizika Klasike, deterministe, $\oplus = F$), por me noumenin ($-\oplus = E$).

- f) Dhe Heisenberg-u, në një shkrim të tij të vonë, flet në një mënyrë disi orakullore për një dallim që duhet bërë mes pjesës, e pra \oplus , e pra Fizika Deterministe, e jashtësisë apo Objektivititetit... dhe të tërës, e pra \bigcirc , $-\oplus$, e pra Fizika Indeterministe ose Kuantiste, e brendësisë apo Subjektivitetit.
- g) Edhe Schrödinger-i, një nga themeluesit e Fizikës Kuantike, flet gjerë e gjatë për Subjektivitetin a më saktë për Subjektin, që nuk vështrohet më pasiv ("Sub" = poshtë), por si aktiv e madje si krijues ay vetë i Realitetit.
- gj) M.q.s. e mbrendshja, apo subjektivja, vështrohet si "Spirituale" (ndërsa e jashtëmja si "materiale"), ato sa lexojmë tek libri i Ken Wilber "The Holographic Paradigm and Other Paradoxes", ku na jepet shkurtimisht ky diallog:

"It was: X : *Do you believe in the Spirit?*

Y : *How could I? I am a Scientist.*

It is: X : *Do you believe in the Spirit?*

Y : *How couldn't I? I am a Scientist! "...**

* Shih pak më poshtë, fq.421.

Kemi pra triumfin e ngadaltë, por të sigurt, të të mbrendshmes mbi të jashtmen, të Frymës mbi Materien...

Në përmbledhje ne mund ta paraqitim situatën në këtë mënyrë:

Kodi <i>E</i>	Kodi <i>F</i>
e mbrendshmja	e jashtmjja
Subjektivja	Objektivja
Noumeni	Fenomeni
<i>Implicit Order</i>	<i>Explicit Order</i>
e Tëra	Pjesa
Fizika Indeterministe	Fizika Deterministe
(Fizika Kuantike)	(Fizika Klasike)
Fryma	Materia
Qenia (<i>Sein</i>)	Ekzistenca (<i>Dasein</i>)
Orienti*	Oksidenti
....

* Që Orienti lidhet me kodin E, ndërsa Oksidenti me kodin F, këtë e dëshmon më së miri, ndër të tjera, dhe zhvillimi historik i vetë Mendimit, i Shkencës të Oksidentit, që synon përherë e më tepër për nga Urtia e Orientit.

Nuk është e rastit që Fizika Moderne (kuantike) dhe tërë Shkenca e Re bashkë me të, ka kthyer sytë nga Orienti, ku ka gjetur frymëzimin e epërm e të pavdekshëm të saj.

Pyetjes "metafizike": *Përse duhet të ndodhë një gjë e tillë?* Mund ti përgjigjemi: *Dija e Kohës sonë po pritët drejt fundit të saj, e pra po kthehet, qoftë edhe pa qenë krejt e ndërjegjeshme për këtë, atje që nga dhe filloi. Kjo*

396) Sanskr. **s u - s a k h i** (सुषखि) = fr. *bon ami* (shok i mirë, shumë shok)

Është Shqipja:

s h u - m s h o k

("shok shumë i mirë")

Që këndej del edhe se Latinishtja "s o c i u s" (ital. *socio*), që nga edhe "s o c i e t a s" (shoqëria), rrjedhin nga Shqipja "s h o k" (sansk. "s a k h i") dhe jo anasjelltas.

397) Sanskr. **a n - a n t y a** (आनन्त्य) = fr. *infinité; eternel; sans bornes* (infiniti; i përjetshëm; i pakufijshëm)

Motivimi:

- â n d e (që nuk është ndarë) = - \bigoplus (boundless) = \bigcirc^*

... = $E = \infty$ (infinite) = (t = 0) (eternal)

është një domosdoshmëri llogjike, që kërkon mbylljen e Ciklit, e pra sajimin, fundja më në fund, të simbolit \bigcirc , që të Parët tanë e kanë shprehur edhe me formulën ($\alpha = \omega$)...

Dhe Krishti thotë në Apokalips (Zbulesa, 1.8): "Unë jam alfa (α) dhe omega (ω)..."

* Tek Cirlot (fq.123) kemi: $\bigcirc =$ the Universe, the All, Infinity

Pra simboli " \bigcirc " do të thotë në të njejtën kohë "e Tëra" (hebr. *Einsof*, אֵינְסוֹף) dhe "infiniti" për sa lexojmë tek libri i simboleve i Cirlot.

Por siç dimë, simboli " \bigcirc " ka edhe kuptimin e "zeros". Atëhere si? Zero dhe *Infiniti* janë të barabartë? Pó. Mistikisht. Sepse kemi, ndër të tjera:

Zero = rrënja e ekuacionit të Qendrës Mistike ($x = -x$)

por edhe:

Infiniti = rrënja e ekuacionit ($x = -x$) = ($x^2 + y^2 = 0$)

Mund të vëmë re këtu se simboli " $\text{--} \textcircled{1}$ " mund të interpretohet edhe si: *pa cak, pacaktueshmëri, Parimi i papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike, vetë Fizika Kuantike...*

Mund të themi pra atëhere se në Fizikën Kuantike bie koncepti i ndarjes, gjë që rikonfermohet nga kjo Fizikë me "*Inseparability Principle*" apo "*Non-Localy Principle*" ("*entangled particles*", Theorema e Bell-it).*

* "*Entangled*" [$\cup \cup$] Një term jo krejt i përkthyeshem në Shqip a në ndonjë gjuhë tjetër. Po do të thotë pak a shumë: "i ngatërruar", "i ngecur", "i ngërthyer". Dhe është fjala këtu, sikurse shpjegohet në tekst, për dy grimca të kapura pas njëra-tjetrës dhe që ruajnë, ndër të tjera komplementaritetin e spineve ("*spin*" = vërtitja rreth vehtes me një kahje a në një tjetër), që do të thotë që, në se përpara ndarjes njëra nga këto grimca kishte një vërtitje ("*spin*") nga e majta në të djathtë, ndërsa tjetra në të kundërt, d.m.th. nga e djathta në të majtë, dhe në qoftë se pas ndarjes grimca e para ndron kahjen e "*spin*"-it të saj, grimca tjetër që mund të jetë gjer në një distancë "galaktikore" nga e para, do të ndrojtë edhe ajo vetvetiu kahjen e spinit të saj, në sens të kundërt.

Fizikanti frëng *Alain Aspect* në vitin 1982 realizoi në Francë një eksperiment "historik" me të cilin tregoi se John Bell kishte të drejtë dhe se Teorema e tij ishte e vërtetë. Rezultati i eksperimentit të tij vuri në dukje krejt qartë, pa pikë dyshimi, se një ngjarje kuantike në një vend (ingl. *location*) mund të ndikojë mbi një ngjarje tjetër në një vend tjetër në çfarëdo distance nga ngjarja e parë pa ndonjë mekanizëm të dukshëm.

Një ngjarje e tillë mund të shpjegohet sipas Fizikës Kuantike vetëm duke pranuar ekzistencën e një lidhje *jo hapsinore* por *jashtë hapsinore* mes këtyre dy grimcave.

Ky është i famshmi "*Non Locality Principle*" i Fizikës Kuantike që na shtyn kë-shtu të pranojmë, *krahas realitetit tonë material e pra hapsinor e kohor, edhe një realitet më të thellë, jashtë kohës dhe hapësirës*, një realitet pra "imagjiner", që lejon një "*spooky action at a distance*" (veprim "fantazmash" në distancë) siç e quante atë me ironi Einsteini.

Nga ana tjetër: *Fizika Kuantike* = $-\textcircled{1}$ = *E* = $-F$ = $-\bullet$ = *jo materje, jo Realitet Material*, gjë që rikonfermohet edhe nga "*Death of Matter Myth*."*

Në Fizikën Kuantike shpejtësia e Dritës është e kapërxyeshme, dhe në bazë të Algoritmit Simbolik kemi:

$$v > c = -\textcircled{1} = E = -\bullet = \text{jo materie}$$

Që do të thotë ndër të tjera se Fizika Kuantike nuk studjon më një Botë materiale, por një Botë Spirituale që i bindet kodit E.**

398) Sanskr. *su-vesa* (सुवेष) = fr. *bien vetu* (i veshur mirë)

Në Shqip kemi foljen:

m e v e s h

e pra:

s h u - m v e s h

Që këndeje edhe Italishtja "*vestire*", "*veste*",... e kështu me radhë, duhet menduar se rrjedhin nga Shqipja dhe jo anasjelltas.

399) Sanskr. *ṣithilīkṛta* (शिथिलीकृत) = fr. *relaché* (i çliruar, i zgjidhur)

Në Shqip:

t h i l é (nyje), e pra simb. X

ndërsa "ṣ" është privative.

* Shiko edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

** Shiko ndër të tjera edhe fq. 77, 217, 440 dhe 548.

Pra atëhere:

ṣ thili-sur kryt = -Ṣ
 ("kryer sh-tiliksur", shthiliksur...)

400) Sanskr. **su - sthira** (सुस्थिर) = fr. *ferme, stable, durable*
 (i palëvizur, i qëndrueshëm, i durueshëm (në kohë)

Motivimi:

shu-m i shtirë
 (i shtimë, i futur brenda)

Algoritmi Simbolik na jep:

$$F = \boxed{E}$$

dhe atëhere edhe:

$$\sim = [- \sim]$$

që do të thotë:

$$\text{lëvizje} = [\text{jo lëvizje}]$$

Kështu pra, ajo që është e shtirë, e shtimë, e futur a ngulur e fshehur mbrenda nuk lëviz, është e qëndrueshme.

Shikojmë se falë Algoritmit Simbolik jemi në gjendje të shpjegojmë përse fjala "s t h i r a" (në Shqip: "shtir-je") do të thotë "qëndrueshmëri" etj.

Kështu bie fjala, në Shqip: "burrë i s h t i r ë" = *burrë i fortë, i qëndrueshëm, që nuk thyhet, nuk ndryshon...*

401) Sanskr. **su - vira** (सुवीर) = fr. *grand héros* (hero i madh)

Është Shqipja:

shu-m ë burr

402) Hebr. **g a b o r** (g a v r i) (ג ב ר ג) = trim, burrë, hero...

Dhe zbërthehet me Shqipen:

k a b u r r - n i

403) Hebr. **G a b r i e l** (ג ב ר י א ל) = kryengjulli Gabriel

Të njejtin operator të Shqipes "b u r r" e gjejmë edhe në Hebraishten "Gabriel", që zbërthehet me Shqipen si:

K a b u r e l

pra:

K a b u r r - n i E l - i

Ky është dhe vetë kuptimi Hebraisht i kësaj fjale:

"Burri (fuqija, trimi...) i Zotit"

që jepet *ad litteram* me Shqipen:

ka BURRI i Yllit

("është burrnia e Yllit", "është fuqia e Zotit")

ku emri "Y I I" është Hebraishtja "E I" (א ל), e pra "Zoti".

Në Muslimanizëm (Arabisht) ky kryengjull quhet Xhebrail Emini.

Kujtojmë këtu edhe se në Latinisht "**v i r**" (nga shq. "**b u r r**") do të thotë në të njejtën kohë *burr, trim, i fuqishëm*.*

* Nga "*De bello gallico*", shënimet në "vetën e tretë" nga Jul Qezari, mbi luftën kundër Gallisë, kujtojmë ndër të tjera: "...*Viribus Unitis*..."

Në Latinisht gjithashtu "v i r-t u s" = virtyt, dhe motivohet përsëri me Shqipen "b u r r" duke qenë burr-nia në kohërat e lashta (dhe jo vetëm) virtuti *par excellence*.*

404) Sanskr. su - v i s t a r a (सुविस्त) = fr. *très étendu* (shumë i shtrirë)

Motivimi:

shu-m b â s h t r i

405) Sanskr. k r i y a (क्रिया) = fr. *exécution, réalisation; acte religieux, sacrifice; cérémonie (not. funéraire), sacrifice personifié* (krymje, ekzekutim, realizim; akt fetar, sakrificë (therorë); ceremoni (kryesisht e përmortshme) sakrificë e personifikuar)

Është Shqipja:

k r y e j, k r y m j e... p o r e d h e k r i m...

Në Shqip:

"Krymja nga një krim."

Për të kuptuar përse koncepte kaq të ndryshme në dukje, si ai i *krym*-jes dhe ai i *krim*-it, tregohen me fjalë kaq të përngjashme, duhet patur parasysh se:

Gjuha (siç kemi vënë në dukje edhe tjetër herë) emërton sipas një paradigme superlative dhe zanafillore. Duke qenë kështu, pyetjes: *Cila është krymja më e rëndësishme (superlative), më e hershme (zanafillore)?*

* Të gjitha këto shembulla tregojnë se trajta me "b" (në Shqip) do prioritizuar ndaj asaj me "v" si në Sanskritisht dhe në Latinisht. Kjo atëhere do të thotë shkurt se Sanskritishtja "v i r a", Latinishtja "v i r", "v e r t u s"... lidhen të gjitha si me prejardhësen e tyre me Shqipen "b u r r".

mund vetëm ti përgjigjemi: *Krijimi i krijimi të Botës*. Një rikonfirmë të këtij pohimi gjejmë edhe tek Cirlot, sipas të cilit mithi kozmogonik më i përhapur është ay i "*Cosmogonic Sacrifice*" (Therroria, "Therja Botëlindëse").

Le të shtojmë këtu se koncepti i therrorisë (sakrificë botëbërëse), i njohur edhe si *Teoria e Kurbanit*, është i përbashkët për të gjitha fetë. Kështu pra, në themel të Botës qëndron një kurban. *Cili është ky kurban?* Le t'ia lëmë lexuesit ta gjejë... Por po të konsultohet Cirlot,^{*} del fare qartë se ky kurban është një Qenie Hyjnore, e përsosur, e pafajshme. Prandaj dhe sakrifikimi i kësaj qenie vështrohet, duke qenë një padrejtësi, si një krim, si një faj.^{**} Shikojmë se si Shqipja, ashtu edhe Sanskritishtja, e ruajnë më së miri në "*gjinin*" e tyre këtë mith themelor.

Në zgjerim të Bisëdës shtojmë edhe se:

Në Greqisht kemi biseminë e "a i t i a" (αιτια) = 1) shkak; 2) faj, krim.

Me qenë se Gjuha, siç kemi përsëritur kaq e kaq herë, emërton sipas një paradigme zanafillore, këtu *shkaku* s'mund të jetë tjetër veçse ay i *krijimit* të Botës. Pra Greqishtja na le të nënkuptojmë se shkaku i krijimit të Botës është një krim.

Greqishtja shtron kështu ekuacionin:

$$\begin{array}{ccc} \leftrightarrow & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{aitia} & & \text{aitia} & \\ (\text{shkak}) & & (\text{krim}) & \end{array}$$

* Shiko edhe fq.34-35, 97, 237, 580 dhe 627.

** Kurban i duhet të jetë patjetër një qenie e përsosur, e pra e pafajshme, në mënyrë që sakrifikimi i saj të jetë i padrejtë, mos të jetë një akt drejtësie, por një akt padrejtësie. Ky akt padrejtësie përbën edhe atë që quhet nga féja e Krishterë "mëkati zanafillor" (*peccatum originalis*). Pra themeli i Botës vihet mbi padrejtësi, prandaj dhe Bota vështrohet si e padrejtë.

Vazhdojmë akoma me zgjerimin e Bisedës:

Siç dihet, në Fizikën Kuantike, parimi i kauzalitetit nuk është më funksionues, siç është detyruar ta pranojë këtë, ndër të tjera, edhe vetë Einsteini, armik i betuar i Fizikës Kuantike dhe i Frymës së saj. Duke cituar sërish, ja fjalët e tij tekstuale:

"Hitherto people have looked upon the Principle of Causality as a proposition which would in the course of years admit of experimental proof with an ever-increasing exactitude.

Now, Heisenberg has discovered a flaw in the proposition. The principle of causality loses its significance as an empirical proposition.

*Causality is thus only conceivable as a Form of the theoretical system."**

[Gjer më sot Parimi i Shkakësisë vështrohej si një propozicion që me kalimin e kohës do të mund të provohej eksperimentalisht me një saktësi gjithnjë e më të madhe.

Por ja Heisenbergu zbuloi në këtë propozicion një të metë... Kështu që parimi i shkakësisë humbet tani kuptimin e tij si një propozicion empirik.

Shkakësia mund të konceptohet këndeje e tutje vetëm si një Formë e Sistemit Teorik...]

Atëhere mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Kuantike} &= \text{parimi i papërcaktueshmërisë} = - \text{Ⓣ} = E \\ &= - \leftrightarrow = - \bullet \dots \end{aligned}$$

Simboli " ● " mund të interpretohet në të njejtën kohë edhe si "materie", "Botë materiale", por edhe si "mëkat", "krim".

* Shih edhe fq.77-79.

Kjo do të thotë atëhere se në Fizikën Kuantike do të kemi "*The Death of Matter Myth*", do me thënë "Vdekjen e Mitit të Materies", do me thënë vdekjen e Realitetit Material.*

Në të njejtën kohë del edhe se Fizika Kuantike është e pafajshme, mëkati origjinal tek ajo shlyhet:

Parimi i papërcaktueshmërisë = – ●

Çfarë studjon atëhere Fizika Kuantike? Çfarë tjetër veçse një Bote jo materiale, një Bote Spirituale, Botën Tjetër...?

Kjo nuk duhet të na çudisë. Ka kohë që në Fizikën Moderne ka depërtuar Fryma (*Spiritus*).**

Shtojmë edhe më në fund diçka tjetër për të cilën do të flasim më konkretisht më vonë.

* Shiko fq.310, 486, 814 dhe 839.

** Fizika Kuantike nuk përballlet *drejtpërsëdrejti* me këtë problematikë. Ajo nuk flet në mënyrë krejt eksplicite për faktin se materia është zhdukur ("*The death of matter myth*") dhe është zëvendësuar me "Frymën". Por kjo del në mënyrë të tërthortë nga një varg gjërash.

Kështu p.sh. siç kemi parë dhe gjetkë, në librin e Ken Wilber "*Holographic Paradigm and Other Paradoxes*", jepet një dialog i shkurtër mes dy shkencëtarëve, në dy kohëra (epoka) të ndryshme, dhe ndër të tjera lexojmë:

[...Shkenca e rë kërkon frymë; në mos tjetër ajo i lë shumë vend Frymës. Sidoqoftë, shkenca moderne në një mënyrë a në një tjetër, nuk e mohon më ekzistencën e Frymës. Sikundër Hans Kung ka vënë rë, përgjigja standart pyetjes "*A besoni ju në ekzistencën e Frymës?*" ka qenë zakonisht: "*Sigurisht që jo, unë jam shkencëtar*"; por ajo mund të shndërrohet shumë shpejt në: "*Sigurisht që besoj, unë jam shkencëtar.*"]

Në një fenomen që quhet "Near Death Experience" (NDE),* një njeri që pëson një vdekje klinike dhe më pas kthehet prap në jetë, dëshmon për sa ka perceptuar në botën tjetër. Të gjitha sa tregojnë ay, sa do e çuditshme mund të duket, mund të vihen në korrispondencë një-me-një me fakte e parime të Fizikës Kuantike.

Ekziston mes tyre, e thënë ndryshe, një izomorfizëm të paktën struktural. Kështu që, për të ditur se ç'na pret në vija të përgjithshme në botën tjetër, mjafton të studjohet thellë e më thellë Fizika Kuantike. Por siç thamë, kjo është një punë që do të mund ta bënin ndoshta më vonë në këtë Studim.

406) Sanskr. a n - a v a r a t a (अनवरत) = fr. *incessant; sans cesse*
(i parreshtur)

Motivimi:

- â b â r â t = - r â t (ra, bie, pushoj) = - ↓ = -- F = - ~

407) Sankr. u p a r a t i (उपरति) = fr. *repos; recueillement; mort*
(shplodhje, pushim; mbledhja në vete...; vdekje)

Zbërthehet me Shqipen:

u p a r a t i → shq. u b â r â t → r à, r ë n j e...

ku:

"u" është diateza e pësore në Shqip (p.sh. u çova, u dogja, etj.)

"p a" është folja Shqip "b a" (baj, ban, banë etj.)

"r a t" është pjesore e foljes Shqip "me r à" (gjerm. *fallen*)

* Të eksperimentuarit të afërsisë me vdekjen...

Asnjë nga këto elementë "u", "b a", "r a t" nuk ekziston në gjendje të lirë (më vete dhe me një kuptim *in sè*) në sistemin e Gjuhës Sanskrite. Duke qenë kështu, Sanskritishtja nuk është në gjendje ta motivojë, brenda sistemit të saj gjuhësor, pa dalë prej tij, fjalën "e saj" "u p a - r a t i", domethënë ajo nuk është në gjendje të na thotë përse kjo fjalë shpreh nocionin e vdekjes. Këtë është në gjendje ta bëjë Shqipja, e cila na tregon se nocioni i vdekjes jepet në Sanskritisht me atë të rënies dhe kjo, me të drejtë, duke qenë vdekja gjithmonë një *rënie* (në Shqip: "ra!" = u vra, vdiq).

Kështu pra, pa Algoritmin Simbolik (që mund të dalë nga Shqipja, si edhe nga çdo gjuhë tjetër) dhe pa Shqipen si ndërmjetëse ("roli ndërmjetësues" a "Roli *Mesianik*" i Shqipes), kjo fjalë Sanskritisht do të mbetej e pashpjeguar, e pamotivuar.

408) Sanskr. a **pa-rat**a (अপরत) = fr. *qui se repose* (që pushon)

Motivimi:

a p a r a t a → shq. **â b a r â t** = "âsht bâ rât"
(ka rà, ka pushue...)

Shtojmë këtu mbi të gjitha këto se operatori "r a" nuk ekziston me fleksionimet e tij të ndryshme në gjendje të lirë në Sanskritisht, ndaj pra dhe ajo nuk është në gjendje ti motivojë me mjetet e saj leksikore të gjitha këto fjalë.

409) Sanskr. a **g r y a** (अग्र्य) = fr. *qui est en tête, le meilleur; le plus ancien; éminent* (që është në krye, më i miri; më i lashti; i epërm, i shquar...)

Motivimi:

â k r y e
(që është në "k r y e")

"g r y a" nuk është operator i lirë dhe as shumë produktif në Sanskritisht, krejt e kundërta pra e Shqipësisë "k r y e" që ka një spektër të gjerë semantik dhe "idiomatik", si bie fjala: "k r y e-tar", "k r e" (kokë), "k r e-jt", "k r e-sht", "me ja dalë në k r y e", "me n-g r i t", "n-g r i-tje"... e kështu me radhë. Pra atëherë mund të shkruajmë:

sanskr. "a-g r y a" < shq. "k r e-u"

Ka dhe diçka tjetër që rikonfermon dhe më tej inekuacionin e mësipërm.

Shqipja shtron ekuacionin themelor simbolik:

$$\begin{array}{ccc} 1 & = & \textcircled{E} \\ \text{Kre-u} & & \text{Kre-jt} \end{array}$$

Edhe në Sanskritisht kemi diçka të tillë:

$$\begin{array}{ccc} 1 & = & \textcircled{} \\ \text{a-gry-a} & & \text{kr-tsa} \\ (\text{अग्र्य}) & & (\text{कृत्स}) \end{array}$$

por, siç shihet, jo aq qartë sa në Shqipësi...

410) Sanskr. a - m i t a (अमित) = fr. *non mesuré, démesuré; indéterminé; infinie...* (i pa matur, i pamasë; i pa përcaktuar; infinit, i pafund...)

Motivimi:

$$- \text{m a t} \text{ (pa mat-je) = simb. - } \textcircled{}$$

Simboli " $\textcircled{}$ " është edhe ay i *cakut*, i *kufirit*, i *përcaktimit*, i *ndarjes...* përveçse atij të *matjes*.

Duke qenë kështu, simboli " - $\textcircled{}$ " mund të interpretohet edhe si *papërcaktueshmëri*, e pra siç kemi thënë edhe më parë, si *Parimi i papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike* dhe vetë *Fizika Kuantike*.

Dimë se në Fizikën Kuantike nuk mund të kryhet një matje e saktë (Heisenberg). Por kjo del tani qartë e më qartë edhe në një rrugë krejt gjuhësore, krejt simbolike. Dhe kjo për arsye se simboli " - $\textcircled{1}$ ", duke qenë ay i *mosndarjes*, do të jetë detyrimisht edhe ay i *mosmatjes* (sanskrit. *a-mita*) a i një matjeje jo të saktë.

Në zgjerim të Bisedës, mund të shkruajmë:

$\textcircled{1}$ = përcaktim, determinim...

ky simbol mund të interpretohet edhe si "Shkencë deterministe", "Fizikë deterministe" (Fizika Klasike).

Me qenë se, nga ana tjetër, Algoritmi Simbolik na jep:

$$\textcircled{1} = F = \bullet = \leftrightarrow = \infty = (x=x) = \downarrow =$$

$$(\rightarrow \neq \leftarrow) = -\bigcirc = \square = < c \dots$$

ne mund të gjejmë, fare lehtë, të gjitha vetitë dhe atributet themelore të Fizikës Klasike.

Shohim kështu se ajo është:

Një Fizikë Materialiste, do me thënë një Fizikë që studjon vetëm gjithshka është materiale (\bullet);

Një Fizikë në të cilën Parimi i kauzalitetit është gjithmonë funksionues (\leftrightarrow);

Një Fizikë Relativiste (∞);

Një Fizikë ku sundon koncepti i Ligjit (∞);

Një Fizikë ku asnjë komunikim nuk mund të bëhet me një shpejtësi më të madhe se ajo e Dritës ($< c$);

Një Fizikë (Shkencë) Racionale që i bindet, me fjalë të tjera, llogjikës formale a aristoteliane ($x = x$);

Një Shkencë Ateiste : $(x = x) = - (x = -x) = -$ "Coincidentia oppositorum" = - llogjika e Tertium Datur = - Qendra Mistike = - Parimi Suprem i Universit = - Zoti)...

E kështu me radhë...

Me qenë se:

Fizika Kuantike = - \oplus = - Fizika Klasike

del se të gjitha parimet dhe fakte themelore të Fizikës Kuantike do të gjen-den fare lehtë duke mohuar të gjitha faktet e parimet e Fizikës Klasike, mohime këto që "realizohen" nga simbolet përkatëse të kodit E, dhe duke interpretuar mohimet e këtyre figurave në gjuhën e Fizikës Kuantike.

Kuptojmë atëhere, ndër të tjera:

Mungesën e saktësisë së matjes në Fizikën Kuantike (- \oplus);

Rënien e parimit të kauzalitetit (- \leftrightarrow) në të;

Mospajtimin e Fizikës Kuantike me Teorinë e Relativitetit (- \oplus = - ∞ = ...jo relativitet, jo Teori e Relativitetit);

Kapërximin e shpejtësisë së Dritës ($> c$);

Zhdukjen e materies (- \bullet): "Death of Matter Myth";

Pranimin e një Qenieje Supreme, Dituri dhe Mëshirëplote, të gjithë pranishme e të përjetshme, që drejton në mënyrë absolute (- ∞), me një mençuri të thellë e një drejtësi të përsosur, tërë Universin.*

* $- \oplus = \ominus = 1 = (s = 0) = (t = 0) = -(\rightarrow \leftarrow) = (\rightarrow = \leftarrow) \dots$

411) Sanskr. **matra** (**मात्रा**) = matje, ndarje; materje, sende materiale

Gjë që jep simbolikisht:

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

matra **matra**

Fizika Kuantike (Wheeler e të tjerë) e rikonfermojnë këtë edhe me shprehjen kaq të "modës" sot në qarqet shkencore: "...*We live in a participatory Universe...*"; që do të thotë jo më shumë e jo më pak se "ne jemi bashkrijues të Universit".*

Kështu pra Sanskritishtja me biseminë e fjalës "**matra**" (**मात्रा**) na "tregon" se **materia** krijohet nëpërmjet matjes siç pohon Fizika moderne.

Jo vetëm **kaq po** Sanskritishtja na tregon se Bota e krijuar në këtë mënyrë s'është **Bota e Vërtetë**, Realiteti i mbramë, por vetëm një ngjashmëri, pra vetëm diçka që ngjan, që duket (greq. *fenome*, *φαινόμεναι*) si e tillë.

* Zgjerim i Bisedës:

Fizika Kuantike ngrihet e tëra mbi parimin e *papërcaktueshmërisë* a të *indeterminimit*, siç edhe thuhet. Simbolikisht: – $\textcircled{\ominus}$. Pra edhe mund të thuhet se në këtë Fizikë një matje (e saktë) është e pamundur, sikundër e rikonfermon këtë Parimi i Papërcaktueshmërisë i Heisenbergut.

Por ka diçka edhe më shumë se kaq, pasi Algoritmi Simbolik (artikullim i llogjikës mistike) na jep:

$$- \textcircled{\ominus} = - \bullet \quad \dots(E)$$

jo matje jo materje

Që këndeje del përfundimi "paradoks" se pa matje nuk ka as materje e pra as Botë materiale, se është **matja** ajo që e krijon materjen.

(Shih lidhur me këtë çështje edhe fq.85, 141, 309, 547 dhe 823).

Në Sanskritisht kemi: "m ā n a" (मान) = *matje; ngjashmëri...*

Por ka dhe më: siç dimë, Fizika moderne ka arritur në përfundimin se Realiteti Objektif (i rremë, dukuri) krijohet nga koshienca njerëzore a ndryshe nga Mendimi Njerëzor. Por këtë na e thotë, në mënyrën e vet, edhe gjuha Sanskrite ku: "m a n a s" (मनस्) = *mendje*, ndërsa siç pamë "m a n a" = *matje; ngjashmëri...* (dhe nga ana tjetër, siç pamë, në Sanskritisht "matje" do të thoshte edhe "materie"). Pra Sanskritishtja gjer këtu na thotë se materia e pra Bota materiale është krijuar nga Mendimi (*manas*) nëpërmjet Matjes (*mana, matra*). Në këtë përfundim arrin dhe Fizika moderne që e shikon Botën materiale si një mendim dhe si e krijuar nga mendimi njerëzor.

Por ka akoma... Në Shkencë (Fizikë, Kozmologji) po imponohet gjithnjë e më shumë Parimi Antropik (*Anthropic Principle**) sipas të cilit është në instancë të fundit NJERIU që duke u vënë në Qëndër të Universit përcakton tiparet e tij. Pra matja, pra mendimi, pra njeriu në instancë të fundit "krijojnë" Botën materiale. Sanskritishtja e tregon këtë duke përdorur fjalë të përngjashme për këto tre entitete:

"m a n u s y a" (मनुष) = *njeri; njerëzor*

"m a n a s" (मनस्) = *mendje* dhe "m a n a" (मान) = *matje*

Para se të vazhdojmë më tej, me këtë disgresion të gjatë e në dukje pa vend këtu, por më se i nevojshëm, si do të bindemi më vonë për ti hyrë thellë e më thellë tabanit fillosofik të "fenomenit" Gjuhë, kujtojmë se – që Bota materiale mvaret në paraqitjen e saj fenomenale (perceptimi, shkisat) nga njeriu ("*Anthropic Principle*"), këtë fillosofët e lashtë Grekë sikundër dhe ata të Indisë së lashtë, para tyre) e dinin mirë, siç dëshmon shprehja "*Anthropos metron pandon*" (άνθρωπος μέτρον πάντων) = "Njeriu (është) masa e gjithshkaje."

* Shih edhe fq.199 dhe 297.

Në Shqip "m a t-j e" dhe "i m e t" janë dy fjalë të bashkrrënjëshme dhe të dyja shpjen tek i n j e j t i simbol " ⊕ " i interpretuar një herë si "ndarje", e pra si "matje", dhe një herë tjetër si "jo plotësi", "jo tërësi" (mos harrojmë se: ⊕ = - ⊙ = jo i plotë, jo tërësi...).

Kështu Shqipja na thotë:

"Çdo matje është e metë."

gjë që Fizika Kuantike e rikonfermon nëpërmjet Parimit të Papërcaktueshmërisë së Heisenbergut.*

Ne dimë se 5 është numuri simbolik i Njeriut.

Lexojmë për këtë tek Cirlot: "*Traditionally the number five symbolizes man after the fall...*" [Sipas traditës pesa simbolizon njeriun pas rënies... pesa simbolizon tërësinë e botës materiale...]**

* Werner Heisenberg (1901–1976). Është një nga themeluesit kryesorë të Fizikës Kuantike. Parimi i Papërcaktueshmërisë që ai zbuloi mund të shkruhet matematikisht si:

$$\Delta x \Delta p \geq h$$

ku x tregon koordinatën e pozicionit të grimcës, p momentumin e saj (sasine e lëvizjes), h = kostantja e Planck-ut, ndërsa Δx dhe Δp tregojnë respektivisht gabimet që bëhen në përlllogaritjen e njërës dhe të tjetrës madhësi.

Nga sa më sipër del se: Sa më saktë përcaktohet pozicioni i grimcës (x), aq dhe më pak saktë mund të përcaktohet momentumimi (p) i saj. Prandaj pra në çdo rast një matje e përpiktë, pa të meta, është e pamundur.

** Shih Cirlot, fq.270-1.

Rikujtojmë shkarazi këtu se në Turqisht "b e ş" = 5, ndërsa "b e ş e r i" (ingl. *human*) = njerëzor, gjë që rikonfermon linguistikisht se numuri simbolik i Njeriut është vërtet "p e s a" (5).

Në Shqip:

pes (5), pjesë (\oplus , 1/2), pas (2),
pasi (\leftrightarrow), pis (\bullet)...

Shqipja na ndihmon të formulojmë kështu këtë pohim të rëndësishëm që Shkenca dhe Mendimi Mistik rikonfermojnë:

"Njeriu (5) është shkaku (\leftrightarrow) i krijimit të Botës materiale (\bullet)."

...e cila Botë materiale ka një kufi ($\bullet = \oplus$)^{*} e përshkohet fund e majë nga dualiteti (2), gjë që do të thotë se asnjë fenomen në të nuk përfaqëson një realitet të plotë, por gjysmën e tij (1/2).^{**}

412) Sanskr. vira (वीर) = fr. *homme, male; héros, guerrier, chef, époux, fils...* (burrë, mashkull; herò, luftëtar; kre, bashkëshort, bir...)

413) Sanskr. vira-tva (वीरत्व) = fr. *heroïsme, vaillance* (heroizëm, trimëri)

Është Shqipja:

burr

fjalë kjo që ka në Shqip të gjitha kuptimet e fjalës Sanskritisht "vira", si atë të *mashkullit*, si atë të *bashkëshortit*, si atë të *trimit* e kështu me radhë.

Ajo që tërheq vëmendjen këtu është se fjala "vira" do të thotë në Sanskritisht edhe "burr" edhe "bir".

Përse vallë?

* Një cak në Hapësirë (*Black holes* = vrimat e zeza) dhe një fillim e fund në Kohë (*Big-Bang* dhe *Big Crunch*).

** Shiko ndër të tjera edhe fq.197, 206-207, 633 dhe 680.

Lexojmë për këtë tek Cirlot (fq.137):

"In theogony, the Sun represents the moment (surpassing all others in the succession of celestial dynasties) when the heroic principle shines at its brightest... On occasion, the Sun appears as the direct son and heir of the god of heaven... With his 'youthful' and filial characteristic, THE SUN IS ASSOCIATED WITH THE HERO... as opposed to the Father, who connotes the heavens, although the two (sun and sky) are sometimes equated..."

Ne shikojmë në këtë tekst LIDHJEN MITIKE mes "djalit" e "diellit" (*Dielli djali i Qiellit...*), si edhe lidhjen mitike mes "birit" dhe "burrit" (si *trim*, si *hero*).

Kështu shpjegohet përse në Sanskritisht me të njejtën fjalë "v i r a" tregohet si "burri" (heroi), ashtu edhe "biri". Duke qenë kështu, është e qartë atëherë se këto dy fjalë, "b u r r i" dhe "b i r i", duhen vështruar në Shqip si një fjalë e vetme, do me thënë të rrjedhura nga e njejta rrënjë a të "bashkrrënjëshme" (dy interpretime të ndryshme të së njejtës fjalë-simbol).

Lidhja e "Djalit" me "Diellin", një lidhje mitike *par excellence*, gjendet edhe në gjuhë të tjera.

Kështu për shembull në Inglisht:

"s u n" (dielli), "s o n" (djali)

Në Gjermanisht:

"S o n n e" (dielli), "S o h n" (djali)

Në Rusisht:

"s o l n e" (солнце) (dielli), "s i n" (сын) (djali)

Me qenë se "m-BURR-ja" më e madhe është "të jesh BURR", "të jesh trim" (BURRëror), ka shumë mundësi që fjala Shqip "m b u r r" zëbërthet në

"m b u r r" ku theksi semantik bie mbi "b u r r", ndërsa "m" mund të vështrohet si një prostazë asemantike. Kështu ne mund të shohim në Inglishten "**B R a g**" (folja "to brag") Shqipen "me u m-**b u r r**", e pra edhe Shqipen "**b u r r**". Pra Shqipja do të ishte në gjendje të motivonte kështu edhe Inglishten "b r a g".

- 414) **Lat. v i r** = ingl. *a man, male person ; a husband* (burrë, mashkull; burr, bashkshort)
- 415) **Lat. v i r t u s (vir)** = ingl. *manliness, manly excellence; excellent, capacity, worth, goodness; virtue, moral excellence; valour, bravery, courage* (burrëri, shkëlqim burrëror; i shkëlqyeshëm, zotësi, vlerë, mirësi; virtut, lartësi morale; vlerë, trimëri, kurajo)
- 416) **Lat. v i r e s** = ingl. *force, power, strength* (forcë, fuqi)

Të gjitha këto fjalë të Latinishtes lidhen me rrënjën "**v i r**", që është Shqipja:

b u r r

- 417) **Ingl. b r a v e** = trim

Kjo fjalë e Inglishtes (po ashtu dhe e Frengjishtes) mund të zbërthehet në:

b r a v e

dhe me Shqipen:

b u r r â b a

- 418) **Ingl. b r a v o !** = të lumtë! aferim!

Lidhet dhe kjo si me prejardhësen e saj me Shqipen:

b u r r, burr-ni etj.

419) Hebr. **A m e n!** (אָמֵן) = ingl. *So be it!* (Amin! Ashtu qoftë!)

Nga Hebraishtja Biblike vëmë ré se një fjalë kaq themelore fetare me kuptimin, siç lexojmë në Fjalorin Webster: "*truly, certainly, may it be so!; verily...*", lidhet edhe ajo me Shqipen:

m (b) a n

Po kështu në Hebraisht:

"**a m a n**" (אָמֵן) = ingl. *to prop, to stay, to support; to be supported; to be firm, stable, sure; to be durable, lasting, permanent; (metaph.) to be faithful, trustworthy, sure; to stand firm, still; amen!, i.e. certainly, truly, so be it!...* (me u mbështet, me u mbajt (mājt); qi mban (mān); qi nuk lëviz; i qëndrueshëm, permanent, që zgjat në kohë; (metaforikisht) besnik, i besueshëm, i sigurtë; siguri, vërtetësi; qëndrueshmëri, palëvizshmëri; Amin!, d.m.th. në të vërtetë,...).

Siç shihet pra, fjala Hebraishte "a m a n" lidhet me Shqipen "m a n" (me epentezë: "m-b-an") = "që s'lëviz", "mbi të cilin mund të mbështetesh" etj., dhe kemi pra: hebr. "a m a n" → shq. "â m a n" ("âsht mān").

420) Gjerm. **W e r t** = vlerë

Lidhet si me prejardhjen e saj me Latinishten "**v i r t u s**" = *virtut*, e cila nga ana e saj lidhet si me prejardhjen e saj me Latinishten "**v i r**" = *burrë*, por edhe *forcë, fuqi...*; *vlerë...*

Edhe në Gjermanishten "**W e r t e**" ne mund të shohim përsëri Latinishten "**v i r t u s**" e në instancë të fundit Sanskritishten "**v i r a**" (वीर) dhe Shqipen:

burrë,* burrëri...

* Duhet sqaruar tani çështja e prioritetit të trajtës "b u r r" të Shqipes mbi Sanskritishten "v i r a". Për këtë do patur parasysh se semilabjalja "v" është

duke u vështruar kjo e fundit (*burrnia*) si gjëja më me vlerë tek njeriu.

Si mbiemër fjala "w e r t" = *i nderuar, i çmuar, i rëndësishëm...*, të gjitha kuptime këto që lidhen natyrisht dhe ato me Shqipen "b u r r".

Le të kujtojmë këtu se në Hebraisht "g a b o r" (ג ו ר ב) = *fuqi, trimëri* etj., dhe është Shqipja "k a b u r r".*

421) Ingl. **w o r t h** = vlerë

Ne mund të shohim edhe tek kjo fjalë e Inglishtes rrënjën e pastër të Shqipes:

b u r r ë

me qenë se "w o r t h" nuk është tjetër veçse Latinishtja "v i r t - u s".

422) Sanskr. **a - m i t h y ā** (अमिथ्या) = fr. *sincèrement* (sinqerisht)

Motivimi:

- m i t h y a → shq. - e m e t ë = - ⊕ = - F = E = (x = x)
= "si jashtë, si brenda", sinqeritet...

Për sa i përket vetë fjalës "m i t h y ā" (मिथ्या) = ingl. *contrarily; deceitfully; wrongly; untruly...* (kundërshtesë; mashtrim; e keqe, padrejtësi; mosbesnikëri...), të gjitha kuptimet e saj rrjedhin automatikisht nga Shqipja dhe Algoritmi Simbolik:

një trajtë e zbutur e bilabiales "b". Trajta me "b" (shq. *burr*) duhet të vijë pra kështu para trajtës me "v" (sansk. *vira*). Nga ana tjetër ne pamë se *brave, brag...* lidheshin me trajtën "b" (*burr*) dhe jo me trajtën me "v" (*vira*).

* Shiko ndër të tjera edhe fq.417 dhe 713.

$$\begin{aligned}
 \text{i, e met ë} &= - \bigcirc = \text{jo e Tëra} = F = -1 \text{ (kundërshtesë)} = \\
 \bullet \text{ (ligësi)} &= \sim \text{ (ndryshim, mosbesnikëri, tradhëti)*} \\
 &= (-x = \boxed{x}) \text{ (hipokrizi, mashtrim)}
 \end{aligned}$$

Nga ana tjetër, siç e kemi shumë të qartë:

$$\begin{aligned}
 - \textcircled{1} &= E = (x = \boxed{x}) \text{ (si jashtë ashtu dhe brenda),} \\
 &= \text{sinqeritet (transparencë, jo hypokrizi...)}
 \end{aligned}$$

Tani mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned}
 (x = \boxed{x}) &= E = (x = -x) = \text{Qëndra Mistike} \\
 &= \text{Coincidentia oppositorum} = \text{DEUS} = \text{Veritas}
 \end{aligned}$$

Me qenë se: *materia* (●) = *matja* (Ⓛ), dhe me qenë se gjithashtu: Ⓛ = (-x = \boxed{x}) = *hipokrizi, jo sinqeritet, jo e vërtetë...* ne shohim atëherë se Bota materiale nuk është e sinqertë, e pra se ajo nuk është as e vërtetë, por fallso, e rreme, hipokrite... ashtu siç del edhe nga analiza e Gjuhës të stërlashtë e të shenjtë të *Vedave* (sikundër është Sanskritishtja) dhe ashtu sikundër kanë menduar edhe fillosofët e mëdhenj Indianë, për të cilët Bota ishte thjesht një vegim i rremë, i prodhuar me marifetet magjike të Maya-s, a ç'është njëlloj të Mara-s, e pra të Djallit.**

423) Sanskr. *a m i t h y a k r* (अमिथ्याकरोति) = fr. *rendre vrai*
(bëj të vërtetë)

Shih më sipër.

* Lidhjen e "ndryshimit" me "tradhëtinë" e gjejmë edhe në Rusishte, ku: "m e n - i a t s" (менять) = *ndryshoj*, ndërsa "i z - m e n a" (измена) = *tradhëti*.

** Shiko ndër të tjera fq.47-48, 635 dhe 843.

424) Sanskr. a - n i r a (अनिर) = fr. *pas un homme* (ingl. *destitute of vigor*)

Motivimi:

- n i r i*
("jo burrë")

Që këndeje edhe Greqishtja "a n i r" = njeri ("â n i r" = "âsht njeri").

Në Shqip: "n j ë r i" = 1, dhe në të njejtën kohë "n j e r i". Që këndeje del se numuri i Njeriut ka qenë 1. Po kur? Në krye të herës, para krijimit të Botës materiale, edhe kjo sepse dimë që numuri simbolik i njeriut "after the fall" është 5.

Mund të shkruajmë atëhere:

$$1 \downarrow = -1 = 1/2 = 0.5 = 5 \text{ (numuri i Njeriut pas Rënjes)}$$

425) Sanskr. a d h i t i (अधिति) = fr. *connaitre; apprendre* (me njoh; me mësoje)

Është Shqipja:

â d i t ë
(nga folja *dij*, me *ditë*...)

426) Sanskr. a s i t a (असित) = fr. *très noir* (shumë i zi)

Lidhet me Shqipen:

i z i, e z e z ë, t ë z i t ë...*** = simb. ●

* Kujtojmë këtu se trajta "n i r i" dhe jo "n j e r i" është ende sot e gjallë në Gegërisht.

427) Sanskr. **a t y - a d a r a** (अत्यादर) = fr. *respect excessif*
(respekt i tepruar)

Me Shqipen:

â t e j n d e r i m

Në zgjerim të Bisedës:

Fjala "n d e r" në Shqip lidhet mbrenda Shqipes me fjalën "n d a r j e", e pra " (⊙) ". Dhe kjo sepse një njeri i nderuar është ay që n d a h e t, veçohet nga të tjerët për arsye, merita të veçanta.

Kështu pra:

shq. "n d e r" < shq. "n d a r"

Kjo fjalë është më autoktone në Shqip se sa në Sanskritisht, edhe sepse lidhet me operatorin e "n-d a r-j e s", por edhe se Shqipja përmban çiftin ekuivokal "n d a r" – "n d y r", duke shtruar kështu ekuacionin simbolik qëndror:

$$\begin{array}{ccc}
 x & = & -x \\
 \text{i nderuar} & & \text{i ndyrë} \\
 (\bigcirc) & & (\bullet)
 \end{array} \quad \dots(E)$$

Duke e zgjeruar edhe më tepër Bisedën:

Me Shqipen krijohet këtu një situatë analloge me atë të Hebraishtes ku fjala "k a d o s h" (קָדוֹשׁ) do të thotë në të njejtën kohë edhe 1) "i shenjtë" edhe 2) "i poshtër".*

*** Si p.sh. në shprehjen "të zité e ullirit", "të zité ata" (në kuptimin: *mjerë ata*)...

* Shiko edhe fq.675.

428) Sanskr. a - k h a n d a (अखण्ड) = fr. *non divisé, entire, integral; a bien portant; sans motif, inattendu; tout a coup* (i pa-ndarë, i tërë, i plotë; që është mirë me shëndet; pa shkak, pa arsye; papritmas, befas)

Është Shqipja:

$$- k a n d à = - \textcircled{1} = \textcircled{0}$$

ku:

" a " është këtu privative (" - ")

" k a " është Shqipja *ka* (folja *kam*)

" n d a " është Shqipja *nda* (folja *ndaj*)

Pra tërë kjo fjalë do të thotë "- k a n d à" e pra simbolikisht " - $\textcircled{1}$ ", e pra edhe për ekuivalencë simbolike " $\textcircled{0}$ ", simbol *ky* fundit që ka, ndër të tjera, edhe kuptimin e të Tërës (fr. *entier*).

Kuptimi "*bien portant*" lidhet me faktin se sipas Mendimit Mistik mbi të cilin tërë Gjuha (të gjitha gjuhët pa përjashtim) ngrihet, shëndeti lidhet me një mos-përçarje shpirtërore, me një mos-konflikt shpirtëror gjë që është konform edhe Mjekësisë Bashkëkohëse Psikosomatike, sipas të cilës çdo sëmundje ka për shkak një konflikt specifik.

Po ashtu edhe në Inglisht shtrohet ekuivalenca mes "Tërësisë", "plotësisë" dhe "shëndetit": "**W h o l e**" = 1) i plotë; pa të meta (ingl. *complete; not defective*), por edhe 2) i shëndosh, mirë me shëndet (ingl. *sound*)

* Edhe tek fjala Frengjishte "**e n t i e r**" kemi si motivuese Shqipen:

$$"i, e t ë r ë" = \textcircled{0} = - \textcircled{1}$$

Në zgjerim të Bisedës le të vëmë re këtu se:

$$\text{fr. "c o n t i n u e l" < lat. "c o n t i n u u s"}$$

Theksi semantik bie këtu mbi operatorin "t i n" që nuk është tjetër veçse Shqipja "**T a n**" (simb. $\textcircled{0}$), një operator shumë produktif dhe shpesh i inkapsulluar në gllosat e huaja, duke i motivuar ato. (shih fq.92, 266 dhe 562)

Kështu Inglishtja "whole" rikonfermon sa më sipër, faktin, me fjalë të tjera, që shëndeti lidhet me një plotësi, me një mosndarje, etj.

Ne dimë se: *

$$\textcircled{1} \text{ (ndarje)} = \leftrightarrow \text{ (shkak)} = (x = x) \text{ (Arsye)} \quad \dots(F)$$

e pra atëhere edhe:

$$\begin{array}{lll} - \textcircled{1} \text{ (pa ndarje)} & = & - \leftrightarrow \text{ (pa shkak, pa "ndaj")} = - (t \neq 0) \\ \text{[non divisé, entiere,...]} & & \text{[sans motif, inattendu]} \quad \text{[tout a coup]} \end{array}$$

Pra duke qenë kështu, fjala Sanskritisht "a k h a n d a" duhet të përshkruajë simbolin " - $\textcircled{1}$ ", e pra atëherë ajo mund dhe duhet të referohet tek Shqipja "-ka ndà".

Le të vëmë re këtu edhe diçka tjetër:

Fjala "a-k a n d a" dhe "a-k h a n d a" janë e njejta fjalë në thelb, me gjithë se kuptimet e tyre janë të ndryshme. **

Diferencimet e lehta të një partneri të këtij çifti ("kh" në vend të "k", mungesa e theksit të gjatë " - " mbi "a"-në e parë), janë bërë për të shmangie keqkuptimi.

Me qenë se si njëra fjalë, si tjetra, përshkruajnë, siç e pamë, simbolin " - $\textcircled{1}$ ", me qenë se ky simbol mund të interpretohet si: mos (-) përCAKTueshmëri ($\textcircled{1}$), e pra atëherë edhe si Parimi i Papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike, e pra atëherë edhe vetë Fizika Kuantike, që ngrihet si mbi themelin e saj mbi këtë parim, nëpërmjet analizës së fjalëve të sipërmendura të Sanskritishtes, ne gjejmë, *me ndihmën e Shqipes*, që i

* Shih *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik* në fund të tekstit.

** Dhe kjo për arsye se ato përshkruajnë që të dyja të njejtin simbol dhe janë pothuajse krejt homonime. Shih edhe fq.50, 270 dhe 551.

shpie ato respektivisht tek simbolet " $- \leftrightarrow$ " dhe " $- \oplus$ ", një rezultat themelor të Fizikës Kuantike:

"Në nivelin e subatomikut të thellë, parimi i kauzalitetit bie."

Mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc}
 - \oplus & = & - \leftrightarrow & \dots(F) \\
 \text{a-khanda} & & \text{a-kānda} & \\
 \text{Parimi i papërcaktueshmërisë} & & \text{Akauzaliteti në} & \\
 \text{në Fizikën Kuantike (Heisenberg)} & & \text{Fizikën Kuantike} &
 \end{array}$$

Me qenë se:

$$\begin{aligned}
 - \oplus &= \bigcirc = (x = -x) = \text{Qendra} = \text{Parajsa} = \text{Zoti} \\
 &= \text{Fryma e Shenjtë} = \dots
 \end{aligned}$$

ne mund të themi atëhere se:

*"Fizika bashkohëse (kuantike) studjon tashmë
jo më materien, por Frymën."*

Kështu pra:

***Fizika Teorike e ditëve tona kthehet, ndoshta dhe pa e kuptuar,
në Metafizikë, në Spiritollogji, në Theollogji...***

Ky është një përfundim në përputhje të plotë me mendimin, lidhur me këtë çështje, e shumë fillosofëve dhe fizikantëve të shquar.

Ne u zgjatëm dhe do të zgjatemi mbi këtë lidhje të "çuditshme" mes Gjuhës dhe Shkencës, edhe për tu bindur akoma më mirë mbi saktësinë dhe rëndësinë themelore të analizave tona, që nxjerrin në pah se mbrenda, thellë në Gjuhë, fshihen të koduara, të vërteta të mëdha që i përkasin

fushave të ndryshme të Dijes, me një karakter pra universal, jo vetëm, por edhe të përjetshëm. Tërësia e tyre përbën përmbajtjen e Mendimit Mistik ose, siç quhet herë-herë, të *Perennial Philosophy*.*

429) Sanskr. a - k h a n d i t a (अखण्डित) = fr. *non endommagé; non troublé; non détourné de son objet* (i pa dëmtuar; i pa trazuar; i pa devijuar)

Me Shqipen:

- k a n d ā t ē = - ⊕ = - ● = *jo dām, jo dātim*

Pjesorja me "-atē" është një pjesore arkaike e Shqipes që e ndeshim si një "mbeturinë" në shembulla të tilla si: *thātē, rātē, lātē...***

Në Shqip fjala "d a m" ka dy kuptime, edhe atë të "damjes", "ndarjes" e pra simb. ⊕, edhe atë të "damit" (fr. *dommage*) e pra simb. ●. Në këtë mënyrë Shqipja shtron ekuacionin e rëndësishëm:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \\ \text{d a m} & & \text{d a m i} \end{array} \quad \dots(F)$$

Gjithpò këtë ekuacion themelor Shqipja e shtron edhe në një sërë mënyrash të tjera, si p.sh. në: "n d a r ē" (⊕) dhe "n d y r ē" (●), "p j e s ē" (⊕) dhe "p i s" (●), etj. etj.

Ne shohim se edhe Sanskritishtja ka ndjekur po këtë "taktikë" semantike, duke përdorur një herë "k h ā ṇ ḍ a" (खण्ड) për të treguar d a m j e n (⊕) dhe një herë tjetër "k h a n d i t a" (अखण्डित) për të treguar d a m i n (●). Por Shqipja tregon se këto dy fjalë janë të bashkrrenjshme.

* Shiko fq.2-3, 80,122, 147, 306, 767 dhe 824.

** Shih më lartë fq.402.

Duke zgjeruar tani disi Bisedën:

Dimë se Gjuha emërton sipas një paradigme (modeli) superlative, primordiale etj. etj. Prandaj *ajo do të referojë tek d a m j a e parë me të cilën Bota u krijua...* Simbolikisht kjo *damje krijuese* e Botës do të paraqitet si \textcircled{D} . Po kjo është bash edhe paraqitja simbolike e të *D a m u n i t*, e pra e *D e m o n i t*.

Por tani, në Shqip: "*d a m j e*" (që nga "Demon") dhe "*d ā m*" (it. *danno*) = \bullet . Po ky simbol i fundit është edhe ay i të keqes e, në të njejtën kohë, edhe ai i Botës materiale.* Pra Gjuha na zbulon se:

*"Krijimi i Botës i kryer nga Demoni, ka qenë një Dam,
ka qenë kjo krymje një Krim."*

Në Frengjisht: "*d o m m a g e*" = dëm, gjynah, mëkat.

Kjo fjalë mund etimologjizohet si:

d o m m a g e → shq. *d a m u n...* = \textcircled{D} = *F* = \bullet ...

Mund të themi pra se krijimi i Botës që u realizua me një "*d a m j e*", ka qenë një "*d o m m a g e*", një gjynah, një mëkat, një krim.

Ky është atëhere "mëkati në zanafillë" (lat. *peccatum originalis*) që përbën një nga dogmat themelore të fesë të Krishterë.

Ne shohim pra, ndër të tjera, se Bota nuk mund të krijohet kurrsesi ndryshe veçse me *krym*-jen e këtij *kri*-mi, të këtij mëkati.

* Këto kuptime "të ndryshme" të fjalës "*d a m*" në Shqip, përputhen me katër rreze të ndryshme semantike (*damje; dëm; demon; materie*) të të njejtit simbol " \bullet ".

Kuptimet e tjera të fjalës që po shqyrtojmë dalin lehtë nga fakti se referenca tek simboli " - ⊕ " jep:

$$\begin{aligned} - \oplus &= \bigcirc = (x = -x) = \text{Qendra} \\ &= - \sim \text{ (jo lëvizje, jo shmangie, jo devijim, përqëndrim)} \end{aligned}$$

430) Sanskr. a v a - p a ṭ (अवपत्) = fr. *mettre en pièces* (coptoj)...

Motivimi me Shqipen jep:

$$a v a p a t \rightarrow \text{shq. } \hat{a} b \hat{a} : b \hat{a} d \hat{a} = \oplus \dots (F)$$

431) Sanskr. a v a - p a d (अवपद्) = fr. *tomber* (bie, rrëzohem)

Motivimi me Shqipen jep:

$$\hat{a} b \hat{a} : b \hat{a} D \hat{a} = \oplus = F = \downarrow$$

Duke zgjeruar Bisedën, shtojmë:

Rusishtja "p a d a t s" (падать) = *bie, rrëzohem...*, motivohet edhe ajo me Shqipen:

$$b \hat{a} d \hat{a} t \hat{e} = \oplus = F = \downarrow$$

Motivohen gjithashtu, gjithpò me Shqipen, edhe:

Frengjishtja "t o m b e r" = *bie, rrëzohem*

$$t o m b e r \rightarrow \text{shq. } b \hat{e} r t h y m = \oplus = F = \downarrow$$

Inglishtja "d o w n" = *poshtë*

$$d o w n \rightarrow \text{shq. } d \hat{a} b \hat{e} n = \oplus = F = \downarrow$$

Rusishtja "p o d" (под) = ndën

p o d → shq. b ë d à = ⊕ = F = ↓

Shqipja "n d ë n" = poshtë

n d ë n → shq. n d a n = ⊕ = F = ↓

Gjermanishtja "u n t e r" = ndën

u n t e r → shq. â n d a r = ⊕ = F = ↓

Inglishtja "u n d e r" = ndën

u n d e r → shq. â n d a r = ⊕ =

Persishtja "a d r a" = poshtë

a d r a → shq. â d â r = ⊕ = ...

Ky "*Consensio linguarum*" mund të zgjatej dhe shumë më tepër, gjë që flet në favor të një "teknike" të njejtë fjalëformimi për të gjitha gjuhët. Do të shikojmë më tej arsyen e thellë të një fenomeni të tillë.

432) Sanskr. a - p a k v a (अपक्व) = fr. *non cuit* (jo i pjek-ur)

Motivimi me Shqipen:

– p j e k b â

433) Sanskr. a t i - P A = fr. *faire boire à l'excès* (të pish me të tepërt)

Motivimi:

â t e j P i

INDEX

1. Introduction
2. The first part of the book
3. The second part of the book
4. The third part of the book
5. The fourth part of the book
6. The fifth part of the book
7. The sixth part of the book
8. The seventh part of the book
9. The eighth part of the book
10. The ninth part of the book
11. The tenth part of the book
12. The eleventh part of the book
13. The twelfth part of the book
14. The thirteenth part of the book
15. The fourteenth part of the book
16. The fifteenth part of the book
17. The sixteenth part of the book
18. The seventeenth part of the book
19. The eighteenth part of the book
20. The nineteenth part of the book
21. The twentieth part of the book
22. The twenty-first part of the book
23. The twenty-second part of the book
24. The twenty-third part of the book
25. The twenty-fourth part of the book
26. The twenty-fifth part of the book
27. The twenty-sixth part of the book
28. The twenty-seventh part of the book
29. The twenty-eighth part of the book
30. The twenty-ninth part of the book
31. The thirtieth part of the book
32. The thirty-first part of the book
33. The thirty-second part of the book
34. The thirty-third part of the book
35. The thirty-fourth part of the book
36. The thirty-fifth part of the book
37. The thirty-sixth part of the book
38. The thirty-seventh part of the book
39. The thirty-eighth part of the book
40. The thirty-ninth part of the book
41. The fortieth part of the book
42. The forty-first part of the book
43. The forty-second part of the book
44. The forty-third part of the book
45. The forty-fourth part of the book
46. The forty-fifth part of the book
47. The forty-sixth part of the book
48. The forty-seventh part of the book
49. The forty-eighth part of the book
50. The forty-ninth part of the book
51. The fiftieth part of the book

1. Introduction
2. The first part of the book
3. The second part of the book
4. The third part of the book
5. The fourth part of the book
6. The fifth part of the book
7. The sixth part of the book
8. The seventh part of the book
9. The eighth part of the book
10. The ninth part of the book
11. The tenth part of the book
12. The eleventh part of the book
13. The twelfth part of the book
14. The thirteenth part of the book
15. The fourteenth part of the book
16. The fifteenth part of the book
17. The sixteenth part of the book
18. The seventeenth part of the book
19. The eighteenth part of the book
20. The nineteenth part of the book
21. The twentieth part of the book
22. The twenty-first part of the book
23. The twenty-second part of the book
24. The twenty-third part of the book
25. The twenty-fourth part of the book
26. The twenty-fifth part of the book
27. The twenty-sixth part of the book
28. The twenty-seventh part of the book
29. The twenty-eighth part of the book
30. The twenty-ninth part of the book
31. The thirtieth part of the book
32. The thirty-first part of the book
33. The thirty-second part of the book
34. The thirty-third part of the book
35. The thirty-fourth part of the book
36. The thirty-fifth part of the book
37. The thirty-sixth part of the book
38. The thirty-seventh part of the book
39. The thirty-eighth part of the book
40. The thirty-ninth part of the book
41. The fortieth part of the book
42. The forty-first part of the book
43. The forty-second part of the book
44. The forty-third part of the book
45. The forty-fourth part of the book
46. The forty-fifth part of the book
47. The forty-sixth part of the book
48. The forty-seventh part of the book
49. The forty-eighth part of the book
50. The forty-ninth part of the book
51. The fiftieth part of the book

434) Sanskr. a g ā r a (आगार) = fr. *maison, demeure* (shtëpi, banesë)

Motivimi me Shqipen:

â g u r

Dhe kjo për arsye se shtëpitë e para janë ndërtuar me gur.

Nga fjala Shqip "g u r" rrjedhin edhe Rusishtja "g o r à" (ropa) = *mal*, "g o r o d" (город) = *qytet*, dhe kjo e fundit për arsye se qytetet, për qëllime mbrojtjeje, ndërtoheshin mbi mal.

Në zgjerim të Disedës vëmë re edhe sa vijon:

Rusishtja "d o m" (дом) = *shtëpi*, motivohet edhe ajo me Shqipen:

d o m → shq. d a m-j e = ⊕ = F = ⊙

Simboli i fundit është ay i shtëpisë *par excellence*, i shtëpisë ([]) të Zotit (⊙)

Dhe me qenë se:

⊙ = ● = Bota materiale

ne mund të themi atëhere, goftë edhe metaforikisht, se: "*Bota është shtëpia e Zotit*", ashtu sikundër, në një dimension tjetër, në atë fetar e theollogjik, është thënë se: "*Njeriu është tempulli* i Perëndisë*",** dhe ashtu sikundër Heidegger-i tha dhe ay për njerinë: "*Njeriu është bariu i Qenies*".***

* Shih fq.71.

** Kujtojmë këtu edhe shën Palin (Korinthianët I, 3:16):

"Nuk e dini se dhe ju vetë jeni tempulli i Perëndisë?..."

*** "Man ist der Hirt des Seins..." (shiko ndër të tjera edhe fq.114)

Simbolikisht:

$$5 = \boxed{1} \dots(F)$$

Njeriu Zoti

Në Shqip: "d h o m a" = "d a m j e" ... = rus. "d o m" (shtëpi).

Frengjishtja "d e m e u r e" (ital. "d i m o r a") nuk është tjetër veçse Shqipja "d a m u r", "d ā m A r"... = $\textcircled{1}$ = $\textcircled{\square}$.

435) Sanskr. a - g a d a (अगद) = fr. *absence de mal, santé; remède; simple* (mungesë të keqeje, shëndet; shërim; i thjeshtë)

Motivimi me Shqipen:

$$\begin{aligned} - k a d à &= - \textcircled{1} = - \bullet = \textit{jo e keqe, jo ligësi} = E \\ &= - \infty = \textit{jo përbërje, thjeshtësi} \end{aligned}$$

Duke zgjeruar Bisedën:

Le të kujtojmë këtu Ruishten: "g a d k i j" (гадкий) = *i keq, i poshtër, që* motivohet dhe ajo me Shqipen:

$$g a d - k i j \rightarrow \text{shq. } k a d à = \textcircled{1} = F = \bullet^*$$

Si edhe Shqipen "b d a j" (bëj) që motivohet dhe ajo, brenda Shqipes, si:

$$b d a j \rightarrow \text{shq. } b ë d à = \textcircled{1} = F = \bullet \text{ (ingl. } to do)$$

* Është e qartë që: "k a d a" = "bâ ka da" = $\textcircled{1}$ = \bullet , gjë që na lejon të motivojmë edhe një sërë fjalësh si: ingl. "b a d" = *i keq*, rus. "b e d à" (беда) = *fatkeqësi*, rus. "b j e d e n" (Беден) = *i skamur*, e kështu me radhë.

...që na tregon se çdo *bërje* lidhet domosdoshmërisht me një *ndarje* (Paracelsus) dhe se gjithashtu çdo *bërje* është e *keqe*. Ne themi çdo *bërje* por do të ishte më e drejtë të thonim* se "bërja e parë", *bërja* e Botës ishte një gjë e keqe sikundër dëshmon, kur në një mënyrë e kur në një tjetër, tërë mendimi mitik e mistik, themeli teorik mbi të cilin ngrihet, dukshëm a padukshëm, çdo gjuhë.

436) Sanskr. *a n - a v a d y a* (*अनवद्य*) = fr. *immaculé; sans reproche* (i panjollësor; i paqortueshëm)

Motivimi me Shqipen:

$$- \hat{a} \hat{b} \hat{a} \hat{d} y = -2 = -F = -\bullet = \circ = \dots$$

ose edhe:

$$- \hat{a} \hat{b} \hat{a} \hat{d} \hat{a} = -\textcircled{1} = -F = \circ \text{ (immaculé) } = -(-1) \text{ (sans reproche)}$$

437) Sanskr. *a n a v a d h i* (*अनवधि*) = fr. *illimité, infini* (i pakufizuar, i pafund)

Motivimi me Shqipen do të na japë:

$$- \hat{a} \hat{b} \hat{a} \hat{d} \hat{a} = -\hat{d} \hat{a} \text{ ("jo darë")} = -\textcircled{1} = \circ \text{ (fr. illimité, infini)**}$$

438) Sanskr. *a g r a* (*अग्र*) = fr. *pointe, sommet, extrémité; d'abord, a l'origine* (majë, kreshtë; në fillim, në zanafillë, në krye të herës...)

* M.q.s. Gjuha emërton sipas një paradigme superlative dhe primordiale, që është në këtë rast krijimi i Botës...

** Lidhur me kuptimin e "infinite" të simbolit " \circ ", shih Cirlot (fq.123).

Motivimi:

a g r a → shq. â k r y

Në Shqip gjithashtu: "k r e-u", "k r e-shtë" (= "k r" është) etj., Shqipja shtron me këtë operator ("k r") edhe ekuacionin simbolik themelor:

$$\begin{array}{ccc} 1 & = & \bigcirc & \dots(E) \\ \text{Kreu} & & \text{Krejt} & \end{array}$$

Duke e zgjeruar Bisedën shtojmë:

Në Shqip tek folja "n-g r-e j" (ingl. *to lift*), theksi semantik bie mbi "g r" që është Sanskritishtja "gra" dhe Shqipja "kre-u", e pra simbolikisht ↑ .

Duke patur parasysh sa më sipër, ne shohim se Shqipja shtron këtë ekuacion simbolik:

$$\begin{array}{ccccc} 1 & = & \bigcirc & = & \uparrow & \dots(E) \\ \text{k r e-u} & & \text{k r e-jt} & & \text{n-g r e} & \end{array}$$

Le të vëmë ré edhe diçka tjetër me rëndësi:

Sanskritishtja "a g r a", dhe pra "k r e - u" i Shqipes, do të thotë jo vetëm m a j ë, k r e s h t ë (fr. *pointe, sommet*), por edhe prejardhje, fillim (fr. *origine, commencement*).

Po dimë se origjina e gjithshkaje (Cirlot) është Qendra Mistike, e pra simbolikisht:

$$\begin{aligned} \bigcirc &= (x = -x) = E = - \sim^* \\ &= (\rightarrow = \leftarrow) = \textit{Coincidentia oppositorum} = \textit{DEUS} = \dots \end{aligned}$$

Por Sanskritishtja "a g r a" (shq. "k r e-u") = 1) maja; 2) fillimi.

* Aristoteli: "Unmoved Mover"... [Lëvizjevenësi i Palëvizur]

Kjo do të thotë se "Zanafilla e gjithshkaje ka filluar nga një majë", e pra mund të shkruajmë simbolikisht:

$$\bigcirc = \uparrow = 1 \quad \dots(E)$$

Qendra maja Origjina

Ekuacioni i rëndësishëm simbolik: $\bigcirc = \uparrow \dots(E)$, jepet në Italisht me: "c o l m o" (i, e plotë, \bigcirc) dhe "c o l m o", "c u l m i n e" (kulmi, \uparrow), si edhe me: "s o m m a" = e tërë, dhe "s o m m o" = më i larti, "s o m m i t a" = maja.

Po ky ekuacion simbolik jepet në Inglisht me: "u p" = lart (\uparrow) dhe "u p" = fundi, e plota (\bigcirc).*

Edhe inglishtja "o v e r" na jep të njëjtën gjë ($\uparrow = \bigcirc$).

Edhe në Rusisht e njëjta e gjë: "v j e s" (весь) = e tëra (\bigcirc), ndërsa "v i s" (высь) = lartësi (\uparrow).

Lidhur me sa më sipër, përmbledhtazi do të mund të shkruanim edhe:

\bigcirc	=	\uparrow	$\dots(E)$
shq. kreu		krejt	
ital. colmo		culmine	
ital. somma		sommo	
ingl. up		up	
ingl. over		over	
rus. vjes		vis	
...		...	

* Në Shqip: "mbarimi" = "e mbara"...

Nga sa më sipër (*Zanafilla nga një majë...*), del se Bërja, krijimi i Botës materiale mund të barazohet me një Rënje.

Kjo gjen një rikonfermë jo vetëm në ato sa thamë e pamë më lartë, po edhe: 1) nga miti kozmogonik i Rënjes (ingl. *The Fall*); 2) nga ato sa dëshmon drejt a tërthor edhe vetë Gjuha:

Kështu p.sh. në Italisht "a c c a d e r e" = *ndodh, ngjan, bëhet...* dhe në të njejtën kohë "c a d e r e" = *bie*.

Pra Italishtja shtron kështu ekuacionin simbolik:

$$\bullet = \downarrow \quad \dots(F)$$

accadere cadere

Duke i shumëzuar të dy krahët e këtij ekuacioni me "-1", gjejmë:

$$\circ = \uparrow \quad \dots(E)$$

Në Shqip:

bjerje (ital. *caduta*, ↓)

bërje (ital. *il fare*, ●)

Por Shqipja jep edhe diçka më tepër me:

bërje (ital. *il fare*)

bjerrje (ital. *perdita*)

Shkurt, Shqipja na thotë se:

"**Bërja** (e Botës) ka qenë një **bjerrje** (humbje)."

Pra mësimi që nxirret nga Gjermanishtja është ky:

"Çdo brendësi është e përjetshme"

* Shih ndër të tjera dhe fq.325.

** Shih edhe fq.151.

505) Hitit. **a n d a** = gjerm. *drinnen, hinein* (brënda)

Kjo fjalë nuk është tjetër veçse Shqipja:

a n d é

që në të folmen e Malësisë së Madhe do të thotë pikërisht "brenda".

Tek fjalorit i Gazullit "*Fjalë të ralla të Malsisë*" lexojmë:

"**a n d é**" = **b r e n d ë**, me hi ande (kur i grahin lopëve me i shti mbrendë, u thërrasin: "*Ande, ande!*")

Edhe **vetë fjala** Shqipe "**b r e n d a**", sikundër pamë edhe pak më lart, nuk është tjetër veçse Shqipja "**b ë r a n d é**".

506) Hitit. **d a** = gjerm. *gib* (jep)

Është Shqipja:

d h a

Në Hititisht gjithashtu: "**d â w e n**" = gjerm. *wir gaben* ("ne d h a m ë"), e cila do zbërthyer në:

d â w e n

dhe me Shqipen:

d h a b ë n

Gjithashtu, po në Hititisht edhe:

"**d a s h k ê r**", "**d a s h k i r**" = gjerm. *Sie gibt* ("ata dhanë")

dhe me Shqipen:

d h a s h k r y

Duhet vërejtur këtu se "**d h a**" (me *dhanë*) dhe "**da**" (me *da*) janë në të dy rastet e njëjta rrënjë që përshkruan të njëjtin simbol " ⊕ ".

507) Ital. **d a r e** = ingl. *to give* (me d h a n ë)

Lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen:

d a r ë (ingl. *divided*) = simb. $\textcircled{1}$

508) Fr. **d o n n e r** = me d h a n ë

Tek kjo fjalë e Frengjishtes duhet parë Shqipja:

d o n n e r → shq. **d a m u n a r**

e pra simbolikisht:

$$1/2 \cdot \textcircled{0} = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

Këtu: $\textcircled{0}$ = **A r**, është një fjalë që tregon të Parin (*Ar* = ingl. *gold*), e pra "1", dhe m.q.s. "i Pari" është **Z o t i**, e pra Qendra, e pra simboli " $\textcircled{0}$ " [kujtojmë se: $1 = \textcircled{0}$].

509) Hitit. **m u** = gjerm. *mir, mich*

Është Shqipja:

m u, mua...

510) Asir. **a n â n t u** = gjerm. *Widerstand, Gegnerschaft, Kampf* (kundërshtesë, armiqësi, ndeshje)

Theksi semantik bie këtu mbi "â n t u" që është Shqipja:

â n d à = simb. $\textcircled{1}$

Algoritmi Simbolik jep:

$$\textcircled{1} = (\rightarrow \neq \leftarrow) = -1 \quad \dots(F)$$

Që këndeje edhe kuptimi i "kundërshtesës", "ndeshjes", "luftës"...

Rikujtojmë se edhe në Sanskritishte "a n t a" ka ndër të tjera edhe një kuptim të tillë, atë të kundërshtesës, atë të negativitetit. Kështu edhe Greqishtja e Latinishtja "a n t i" motivohen me Shqipen "â n d à".

Le të ndalemi një çast këtu.

Përse *kundërshtimi*, *negativiteti* reduktohet për motivim këtu tek n d a r j a?

Kësaj pyetjeje mund ti përgjigjemi në shumë mënyra:

P.sh. kështu: Ne dimë se Demoni (djalli) është i Damuni *par excellence* prej Zotit, ai është Kundërshtari (lat. *Adversarius*) më i madh i Tij, ai është negativiteti i kulluar.

Një tjetër mënyrë për t'iu përgjigjur kësaj pyetje është, në tabanin fillosofik, edhe kjo: Sipas fillosofisë së Hegelit, A n t i t e z a, moment i d y t ë i Triadës hegeliane, m o h i m i i Tezës (- 1), realizohet me n d a r j e n (⊕) e dy Frymave, asaj Subjektive dhe asaj Objektive në gjirin e Frymës Absolutive (Tezës).*

Një tjetër përgjigje mund të ishte edhe kjo: Në matematikë na tregohet se ashtu si shumëzimi (x) është një mbledhje (+) e përsëritur, po ashtu dhe p j e s ë -timi (ndarja, : , ⊖) është një zbritje (-) e përsëritur.

E kështu me radhë...

511) Asir. a d m â n u = gjerm. *Gebaude, Haus* (ndërtesë, shtëpi, banesë)

Do ndarë si:

$$a d m â n u \rightarrow \text{shq. } \hat{a} d a m u n = \oplus = \boxed{\ominus} \dots(F)$$

Simboli i fundit është pikërisht ai i "shtëpisë": *muret* ([]) dhe *Zoti* (o) "brenda".

* Shiko fq.37, 408, 656 dhe 752.

512) Rus. **d o m** (**д о м**) = ingl. *house* (shtëpi)

Motivohet edhe ajo fare mirë, si fjala korisponduese në gjuhën Asirishte "admânu", me Shqipen:

d ā m

nga foja DAJ (ingl. *to divide*), folje që ekziston pothuajse "tale quale" dhe me të njejtat kuptime edhe në Sanskritisht (DAY, दय्).

513) Lat. **d o m u s** = ingl. *house* (shtëpi)

Kjo fjalë e Latinishtes dhe fjalë të tjera që lidhen me të si: "d o m e s t i c u s", "d o m i c i l i u m" etj., janë të motivueshme të gjitha vetëm nëpërmjet Shqipes "d ā m" (si më sipër).

Vërejmë se në Shqip, fjala "d h o m a" (herë-herë dhomës i thonë në Shqip edhe "e n d a r a") motivohet edhe ajo brenda Shqipes me:

i,e **d ā m** = ⊕ = **F** = ⊗

514) Greq. **d h o m a** (**δ ω μ α**) = ingl. *house, home, building* (shtëpi, ndërtesë)

"Reduktohet" etimologjikisht tek Shqipja:

d a m - ja

E pra atëhere simbolikisht:

⊕ = **F** = ⊗

Dhe me qenë se " o " është Zoti, shohim se Shtëpia *par excellence* ("paradigmatike"), është Shtëpia e Zotit, e pra **T e m p u l l i**, që motivohet me Shqipen si:

d ā m b ā Yll = ⊕ = **F** = ⊗

Këtu "yll" (ingl. *star*) qëndron për *Oëndrën Mistike* e pra $(x = -x) = 0$.

Gjithpò tek Cirlot na thuhet se rrënja "t e m" në fjalën Latine "tem-plum" është, siç u pa dhe më lartë, një fjalë Etruske me kuptimin e dam-jes, e hym-jes.

Duke zgjeruar dhe më tej Bisedën mund të shtojmë edhe se Inglishtja "h o m e" dhe Gjermanishtja "H e i m" mund të motivohen me Shqipen "h y m-j e" (nga folja "h y j" = ingl. *enter, go inside*).*

515) Greq. *d h a r o n* (δ ώ ρ ο ν) = ingl. *gift* (dhuratë)

Në Shqip:

d h u r o j, dhurim, dhuratë...

Prejardhja e këtyre fjalëve është folja Shqipe "d a j" (me *dà*, me *ndà*), "d a r ë" etj. Një rikonfirmë për këtë përveç Sanskritishtes dhe Hebraishtes, na jep edhe Rusishtja me fjalët e saj "d a r" (дар) dhe "p o d a r o k" (подарок) = dhuratë, ku "d a r" është pjesorja e Shqipes "d a j".

516) Greq. *l y o* (λ ύ ω) = ingl. *loosen, free* (çliroj, e bëj më pak të ndëmë)

Simbolikisht kemi: "l y o" = - ∞

Kurse në Shqip: "l i t h" (dikur "l y t h") = ∞

Përftohet kështu ekuacioni simbolik ndërgjuhësor:

$$\begin{array}{ccc} - \infty & = & \infty \\ \text{greq. } l y o & & \text{shq. } l i t h \end{array} \quad \dots(E)$$

* Shih edhe fq.280 dhe 286.

Shqipja e pozon edhe vetëm me mjetet e saja leksikore këtë ekuacion simbolik të Qëndrës Mistike, me qenë se në Shqip: "l i t h" = ∞ , dhe në të njejtën kohë: "l e j" (*lë të lirë, liroj*) = $-\infty$, e pra simbolikisht:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

$$lej \quad lith$$

Shihet pra se Shqipja është në gjendje të motivojë dhe fjalën Greqishte "lyo" (shq. lej, lë).*

Duke e zgjeruar Bisedën, le të përpiqemi ta ~~ta~~ të motivojmë fjalën Greqisht "a l y t h i a" (αλήθεια) = e vërteta (ingl. *truth*).

Këtu: "a-" është privative, e pra -1 , ndërsa "l y t h" është Shqipja lith, lidh (ital. *leg-are*, ingl. *to bind*), e pra ∞ .

E pra atëhere:

$$a l y t h i a \rightarrow \text{shq. } "- lith" = -\infty$$

Pra:

$$"Alithia" (\alpha\lambda\eta\theta\epsilon\iota\alpha) = e \text{ Vërteta} = -\infty = E = (x = -x)$$

$$Coincidentia oppositorum = Qendra Mistike = Zoti$$

$$= Fryma e Shenjtë...$$

Kështu atëhere pyetjes: *Ç'është e Vërteta?...*

Ne mund ti përgjigjemi krejt të sigurt: Z O T I !*

* Në Frengjisht kemi "l a i s s e r", në Italisht "l a s c i a r e", në Inglisht "leave", në gjuhën Kineze "l i ú" (留) etj., të gjitha këto fjalë sillen për etimologjizim fare thjeshtë tek Shqipja: "l ë s h o j", "l ë", etj. Por për të gjitha këto do mund të flasim më gjerësisht ndoshta një herë tjetër.

Pra shikojmë se e Vërteta identifikohet me simbolin " - ∞ " .

Por Algoritmi Simbolik na jep:

$$- \infty = - \bullet = \text{jo materie} = \text{Frymë} \dots(E)$$

Kështu atëhere mund të themi se:

"E Vërteta është një dhuratë Spirituale, dhe jo aspak materiale."

Ekuivalentizimin e konceptit të të vërtetës me atë të lirisë, e gjejmë krejt shprehimisht në Ungjill, kur Krishti thotë: *"Do njihni të Vërtetën dhe e Vërteta do ju bëjë juve të lirë."*^{**}

Që nga pra, dhe, simbolikisht:

$$\bigcirc = - \infty \dots(E)$$

e Vërteta Liria

Kështu që Krishti, me të thënë e tij epokale (pavdekshme), siç janë të gjitha të thënat e Krishtit,^{***} rivërteton saktësinë e analizës sonë etimologjike.

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, qoftë edhe gjer diku jashtë e përtej temës që po trajtojmë, vëmë re këtu se:

"E Vërteta përputhet me Qendrën Mistike."

Por dimë se:

$$\text{Qendra} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

Ekuacioni i fundit është ay i një pike gjeometrike e cila është: 1) Qendra, 2) vrima... (shih ndër të tjera edhe fq.180, 685 dhe 677)

** Gjoni (8:32): *"...et cognoscetis veritatem et veritas liberabit vos..."*

*** Dhe në mënyrë të veçantë e profetike tek Ungjilli sipas Matheut (24:35):

"Qielli dhe toka do të kalojnë, por fjalët e mia nuk të kalojnë"
[...caelum et terra transibunt verba vero mea non praeteribunt...]

517) Sanskr. a - k r i y ā (अक्रिया) = fr. *fait de negliger* (neglixhim, mospërfillje)

Motivimi:

- k r y e j

Do me thënë: "që nuk kryen", "që nuk bën"

Arsyeja që fjalët e Krishtit "nuk mund të kalojnë" është sepse ato, sikundër tërë Doktrina e Krishterë "genuine" (ende e pa institucionalizuar, e pra deformuar për konjektura e qëllime politike), referojnë tek kodi E, dhe dimë se:

$$E = - \sim = (t = 0)$$

Le të shtojmë këtu edhe diçka, disi jashtë një **zojerimi** të thjeshtë të Bisedës...

Kemi folur e do të flasim, këtu e atje, për një korispondencë "të çuditshme" mes Ungjillit (të thëna të Krishtit) dhe Fizikës Kuantike, e cila edhe ajo i referohet jo më kodit F, e pra llogjikës formale, e pra Arsyës, por kodit E, e pra Qëndrës Mistike, e pra "Absurdit".

Duke qenë kështu, pavdekshmëria e Fjalës Ungjillore sjell domosdoshmërisht, si pasojë, dhe pavdekshmërinë e "parimeve hyjnore" të Fizikës Kuantike, sado që të madhit Einstein, si armik i betuar i saj, kjo nuk do ti pëlqente, për të thënë pak... nuk do ti pëlqente, në fakt, aspak!

Ai e akuzoi ndër të tjera Fizikën Kuantike se nuk ishte e plotë.

Por, mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Kuantike} &= \text{Parimi i papërcaktueshmërisë} = - \text{⊕} \\ &= \text{⊙} = \text{e plota, e Tëra} \end{aligned}$$

Më e plotë se kaq...?!

518) Sanskr. *s t y ā i* (स्तयै) = fr. *se congeler, durcir; augmenter; s'étendre*
(ngurtësoj, forcoj; shtoj; shtrihem)

Motivimi:

s h t i j
("fut brenda")

Simbolikisht kjo do të jepej me:

$$\begin{array}{ccccccc} \bigcirc & \xrightarrow{\quad} & \boxed{\bigcirc} & = & \bullet & = & (\neq 1) & \dots(F) \\ \text{shtij} & & \text{ngurtësoj} & & \text{shtoj} & & & \end{array}$$

Në *Shqip* mund të formulohej kjo aforizëm:

"Shka *shtihet* *shtohet*."

$$(\bigcirc \mapsto \boxed{\bigcirc}) (\neq 1)$$

Duke zgjeruar Bisedën shtojmë edhe se:

- 1) Ekuacioni i mësipërm paraqet simbolikisht procesin e mbjelljes së farës (*shti-hem*) dhe mbirjes, *shti-min*, nga një në shumë (*shto-hem*).
- 2) Me qenë se në bazë të Algoritmit Simbolik kemi:

$$-x = \boxed{x} \quad \dots(F)$$

do të kemi atëhere

$$\boxed{\bigcirc} = -\bigcirc$$

e pra atëhere do të mund të shkruajmë, duke patur parasysh edhe ekuacionin e mëparshëm:

$$\begin{array}{ccccccc} \bigcirc & \xrightarrow{\quad} & \boxed{\bigcirc} & = & -\bigcirc & = & \text{⊖} & = & (\neq 1) & \dots(F) \end{array}$$

Që do të mund të interpretohet si:

"Fara mbillet, mbyllet... (shtihet, ☉)..."

Mohohet ('vdes') (-○)...

Ndahet (⊕)...

Pjell shumë e shumë fara të tjera (shtohet, =1)."

Dhe kjo mund të vështrohet si një Sakrificë dhe një Mith Kozmogonik në miniaturë që, falë analizës gjuhësore–algoritmike që kryem, përmbahet në Gjuhë, në këtë rast në polisemantizmin e Sanskritishtes "s t a y i", ashtu sikundër, natyrisht, siç u pa, edhe në thujtjese–homoniminë e Shqipërisë "shtoj" dhe "shtij".

519) Sanskr. a - t r a p a (अत्रप) = fr. sans pudeur (pa turp)

Motivimi:

- t u r p

520) Sanskr. u p a s t r (उपस्त्र) = fr. étendre sur le sol; joncher, couvrir
(shtrij mbi dhë; shtroj, mbuloj)

Motivimi:

u p a s t r → shq. u b â s h t r i

Pra kemi Shqipërisë:

1) s h t r i j, si edhe 2) s h t r o j

Sanskritishtja me mjetet e saj leksikore nuk është në gjendje ta motivojë këtë fjalë, sikundër që lexuesi e kupton lehtë. Në mos tjetër për faktin se Sanskritishtja na e paraqet këtë fjalë të përbërë si një fjalë të vetme, pa qenë në gjendje të dallojë pjesët dhe sidomos ti motivojë ato.

Kurse, Shqipja e ndan fjalën në operatorët e saj përbërës, ndër të cilët me shumë rëndësi është edhe: "u bâ" në kuptimin "është bërë", trajtë kjo e lashtë por edhe e gjallë ende sot, veçanërisht në të folmen e Veriut.

Kështu, në Shqip:

"u bâ trim", "u bâ hajdut", etj. etj.

...tregon një proces bërjeje, rritjeje, që do të që në Italisht "*divenire*", në Inglisht "*to become*", e kështu me radhë.

521) Sanskr. *s t i m i t a* (स्तिमित) = fr. *sans mouvement, immobile; fixe; calme* (pa lëvizje, i palëvizshëm; i ngulitur; i qetë)

Motivimi në Shqipen:

i s h t i m (ë) t → simb. [○ = - ~] (*immobile, fixe...*)

Dimë se:

F = jashtë, lëvizje

E = brenda, jo lëvizje

Dhe gjithashtu:

F = E

E pra mund të shkruajmë:

(**F** = ~) = [**E** = - ~]

ose edhe:

(● = ~) = [○ = - ~]

Kujtojmë se në Shqip kemi gjithashtu:

shtij, shtimun, shtirë,...

* Shih edhe fq.98, 233, 383 dhe 800.

"allotropizma" të të njejtës rrënjë të përdorura në të tjera fjalëformime, si p.sh.: Italishtja "s t i r p e" = *prejardhje, rrënjë...*, që reduktohet tek Shqipja "b ë s h t i r ë"; Gjermanishtja "S t a m m" gjithpo me atë kuptim dhe që reduktohet po ashtu tek Shqipja "s h t i m u n", etj. etj. Të gjitha këto na bindin se Shqipja "i s h t i m ë t" (*shtimun*), nga folja "s h t i j", është më primare se Sanskritishtja "s t i m i t a".

- 522) Sanskr. s t h e m a n (स्थेमन्) = fr. *fermeté, fixité* (palëvizshmëri, qëndrueshmëri, ngulshmëri)

Motivimi:

i, e s h t i m u n = [○ = - ~]

Mund të kujtojmë me këtë rast këtu, si një *nikonfermë* të saktësisë së etimologjisë tonë edhe aforizmën e Shqipes:

"Shka ngulet ngelet."

- 523) Sanskr. s t h i r a (स्थिर) = fr. *ferme, dur, solide, figè* (i palëvizshëm, i ngulur, solid, i fortë)

Motivimi me Shqipen:

i s h t i r ë = [○ = - ~] *

Le të shtojmë me këtë rast se në Shqipen e Veriut ekziston dhe shprehja: "Burr i s h t i r ë" në kuptimin "i fortë", "i patundur".*

* Vëmë re se "s t h i r a" dhe "s t h e m a n" janë e njëjta fjalë, njëra sipas të folmes të Veriut: "i s h t i m", "i s h t i m u n", dhe tjetra sipas të folmes të Jugut: "i s h t i r ë". Për ti diferencuar sadopak në kuptim (duke shtrirë semantizmin e "s t h i r a"), Sanskritishtja nuk ka gjetur një taktikë emërtuese më të mire, këtu, veç ti drejtohet dy të folmeve të Veriut (*Gegërishtes*) në njërin rast, dhe të folmes të Jugut (*Toskërishtes*) në rastin tjetër të gjuhës Shqipe.

524) Sanskr. **s u - d a y i t a** (सुदयित) = fr. *très aimé* (shumë i dashtun)

Është Shqipja:

shu-më i dujtun

(nga folja *dua... duaj, i duajtun, i dujtun*** etj.)

Le të vëmë ré këtu se e gjejmë këtë rrënjë edhe në Hebraisht, ku emri "D a v i d" (דָּוִד) lexohet "D a u t" (sikundër edhe në Arabisht, داود), që do të thotë "i d u j t u n i" (i dashuri) i Zotit.*

* Përveç këtyre kuptimeve, kjo fjalë në Sanskritisht ka një sërë kuptimesh "të ndryshme", të cilat nuk janë veçse interpretime të ndryshme të "mbrendësisë" së figurës simbolike " [] " a, e thënë ndryshe, atribute të asaj që "sht i h e t", e pra për atë që është "i, e sht i r ë".

Kështu p.sh.:

a) "i qetë" (fr. *calme*), e pra me Shqipen:

i shtirë, i shtimun = $\boxed{\circ}$ = [E] = [- ~]

ku: " - ~ " = moslëvizje, qetësi, etj.

b) "konstante" (ingl. *constant*) (shih më sipër);

c) "pa kompromis" (ingl. *uncompromising*), e pra nëpërmjet Algoritmit Simbolik:

$\boxed{\circ}$ = F = [E] = ... = [- ⌘]

ku: " - ⌘ " = pa kompromis...

d) "që mbahet e fshehtë", (ingl. *kept secret*), e pra me Shqipen:

$\boxed{\circ}$ = M i s t e r → "m i s t e r" → shq. "me shtirë"

Pra etimologjia e "misterit" del kështu më në fund krejt e qartë: "një informacion a dituri e brendshme, e fshehur".

** Pjesore e vjetëruar e foljes "d u a".

525) Sanskr. **a b h y - a s ū y ā** (अभ्यसूया) = fr. *envie* (zili, smirë)

Motivimi:

â b â s y

Në Shqip: **m s y s h i**.

Në Italisht: "in **v i d i a**", dhe njëkohësisht: "v e d e r e" = *me pa*.

Në Frengjisht: "e **n v i e**", dhe njëkohësisht: "v o i r" = *me pa*.

Rusisht: "z a **v i d e t s**" (завидеть) = *me pas zili, smirë*, dhe gjithashtu: "v i d e t s" (видеть) = *me pa*.

E kështu me radhë...

Në të gjitha gjuhët koncepti i *zilisë* lidhet *me anë të syrit* dhe të të *parit*. Në Shqip, veçanërisht, kjo del në pah qartë në fjalën "**m-s y-s h i**".

Pra të gjitha këto rikonfermojnë saktësinë e etimologjisë të fjalës Sanskritisht që po analizojmë, duke e vënë theksin semantik tek "**s ū y ā**" = shq. "**s y**".

Këtë lidhje midis zilisë dhe syrit e gjejmë edhe në gjuhën e lashtë Hitite, ku:

"a r **š a n i y a**" = fr. *envier quelqu'un* (t'ia kesh dikujt zilinë)

"a r **š a n a n t**" = fr. *envieux* (ziliqar)

Në të dyja këto fjalë (të së njëjtës rrënjë) theksi semantik bie tek "**s a n**", që nuk është tjetër veçse Shqipja "**s y n i**", që nuk përbën në Hititisht, si në Shqip, një operator të lirë.*

* Shih edhe fq.81, 235 dhe 770.

526) Sanskr. **a p a** (**अप**) = fr. *marquant, privation, écart* (prefiks që tregon "heqje", "mungesë", "shmangie"...)

Motivimi me Shqipen:

â p a ("është pa") = -1 ... (F)

Ku: shq. "p a" = ingl. *without*, fr. *sans*, it. *senza*, lat. *sine*, rus. *bjez* (без), e kështu me radhë.

Kështu që "a p a" e Sanskritishtes nuk është një fjalë e thjeshtë, por, siç e vërteton Shqipja, ajo përbëhet nga përngjitja e dy operatorëve të lirë (në Shqip. por jo në Sanskritisht), sikundër janë "â" (shq. *është, është*) dhe "p a" (lat. *sine*).

Ajo që vihet re gjithmonë në shqyrtimin e fjalëve të Sanskritishtes është se ky fenomen (i një fjale të përngjitur që na serviret si e thjeshtë) ndodh shpesh, dhe Shqipja është në gjendje kurdoherë të realizojë "çpërngjitjen", të nxjerrë në gjendje të pastër, me fjalë të tjera, komponentet përbërëse.

Si një "*Consensio linguarum*", ja ndonjë shembull tjetër i të njejtit fenomen:

Në Sanskritisht: "**a v a-p a d**" (**अवपद**) = ingl. *fall down* (bie, rrëxohem), fjalë kjo që zberthehet në: *

a v a p a d

dhe me Shqipen:

â b a : b a d à

ku theksi semantik bie tek "p a d" dhe me Shqipen "b a d à" dhe së fuqi "d a" (folja "me da" = ingl. *to divide*).

* Shih edhe fq. 239, 445 dhe 457.

E pra atëhere, simbolikisht:

ava - pad $\rightarrow \textcircled{\text{D}} = F = \downarrow$ (ingl. *falling down*)

Duke e përfunduar gjejmë përfundimisht se Sanskritishtja "a v a-" përfaqëson një përngjitje të dy operatorëve të lirë të Shqipes: "â", "b â" (= "â s h t b â", "është bërë").*

Le të japim këtu dhe një shembull tjetër, po në Sanskritisht:

"a p a - r a t a" (**अपरत**) = ingl. *resting, ceasing* (që shp lodhet, pushon)**

Motivimi do të japë:

a p a r a t a \rightarrow shq. **u b â r â t**

Pra tërë kjo fjalë do të thotë, e shprehur ndryshe:

"ka r à", "ka rënë", "është rât"...
(*me flejt, me pushue*)

Shikojmë pra dhe këtu se "a p a", një fjalë e vetme në Sanskritisht, është e shpërbëshme në dy operatorë të thjeshtë të Shqipes: "u" (diategjë e pësorës) dhe "p a" (shq. *ba, baj*).

Mund të sillnim edhe shembulla të tjera të kësaj natyre, por mendojmë se edhe kaq mjafton për ti bërë të qartë lexuesit se përse është fjala.

Kjo që po themi këtu është vetëm një pjesë e tragjedisë të inkapsullimit të operatorëve të lirë shqiptarë (e pra të *burgosjes së tyre*) në gjuhërat e ndryshme të botës.

* Shih edhe fq.344, 403, 481, dhe 568.

** Shiko edhe fq.423.

527) Sanskr. **a p a - k ṛ** (**अपाकृ**) = fr. *écarter; enlever; faire tort; injurier*
(skartoj; heq; bëj një të padrejtë; ofendoj)

Motivimi:

k r y e j : **â p a** = -1 (heq) = **F** = ● (e keqe)
= - ⊥ (padrejtësi) = ...

Shtojmë këtu edhe fjalën "é c a r t e r" të Frengjishtes:

é c a r t e r < **s c a r t a r e** < shq. **s'k r y t**^{*}
= j o e k r y t (j o e p ë r s o s u r) = skarco...

528) Sanskr. **a g a m a** (**अगम्य**) = fr. *immobile; inabordable*
(i palëvizur; ku nuk mund të shkohet)

Motivimi:

- **k ā m** ("–kamb")
(që nuk ecën, s'lëviz; ku nuk mund të shkosh me kam-b...)

Edhe Gjermanishtja: "**k o m m e n**" = *me ardh, me ec, me lëviz...*, mund dhe duhet të etimologjizohet nëpërmjet Shqipes: "**k a m**", për më tepër që del qartë në dyfishimin e "m"-së, pasi në këtë fjalë ka ndodhur një asimi-lim regresiv ("b" → "m"), që nga dhe mund të shkruajmë:

gjerm. "**k o m m**-" < shq. "**k ë m b**"

Mund të shtojmë këtu në këtë etimologji edhe Inglishten: "**t o c o m e**" etj.**

* Shiko edhe fq.418, 514 dhe 627.

** Shiko edhe fq.265.

529) Sanskr. **s t h a** (स्थ) = fr. *se tenir debout, se tenir ferme, stationner, prendre place... se tenir tranquille, s'arrêter; consister, faire, tenir, établir, fonder, construire, ériger* (qëndroj në këmbë; ndalem, zë vend... rri i qetë... bëj, vendos, themeloj, ndërtoj, ngré...)

Motivimi:

$$\begin{aligned} \bigcirc & \quad [] = [\bigcirc = - \sim] = \text{ndalem, rri i qetë...} \\ & = \bullet = \text{ndërtoj, themeloj, bëj...} \end{aligned}$$

Le të vëmë re këtu edhe:

fr. **éta-blir** < it. **sta-bilire** = shq. **shti bā Yll** = $\boxed{\bigcirc}$ = \bullet

Kështu që mësimi që nxjerrim nga semantizmi i pasur, ndër të tjera, i fjalës Sanskritisht "s t h a" është se, që diçka të *qëndrojë*, "të mbahet" (fr. *se tenir*), të ekzisojë, "të zërë vend" (fr. *prendre place*), të bëhet, "të ndërtohet" (fr. *construire, eriger*) e pra "të jetë" fundja më në fund..., duhet të ngrihet si mbi *themelin* (fr. *fondement*) e saj mbi Qendrën Mistike, e cila simbolikisht jepet me " \bigcirc " dhe si themel me " $\boxed{\bigcirc}$ ".

Algoritmi Simbolik na jep ekuacionin:

$$\begin{aligned} \bigcirc & = (x = -x) = \text{"Coincidentia oppositorum"} = \text{T e z a Hegliane} \\ & = - \sim = \text{mos lëvizje (fr. } \textit{ferme}), \text{qëndrueshmëni (fr. } \textit{tranquille})...} \\ & = (t = 0) = \text{"qëndrueshmëni në Kohë", të qenurit jashtë Kohës...} \\ & = (s = 0) = \text{të qenurit kudo, jashtë Hapësirës...} \\ & = - \bullet = \text{jo lëndë, jo materie, Frymë, H i ç i (fr. } \textit{néant})... = E \end{aligned}$$

* Shih fq.154-156.

Kështu kemi:

$$\begin{aligned} \bigcirc &= E \\ -\bigcirc &= -E = \boxed{E} = F = \bullet = \dots^* \end{aligned}$$

Që këndeje del, ndër të tjera, se:

- a) Krijimi i materies dhe i Botës materiale kërkon sakrifikimin (*mohimin*) e një Qënjeje Supreme, siç është këtu Zoti.

E pra "krijimi i Botës": $-\bigcirc$.

Kjo rikonfermohet më së miri edhe nga ato sa mund të lexohen te *Cirlet* lidhur me "*Sakrificën Kozmogonike*", si edhe "*Mitet Kozmogonike*".

- b) *Mohimi*, sakrifikimi i Hyjnisë (Qëndrës mistike) sjell me vehte edhe *varrimin*, brendësimin (Interiorizimin), "okultimin" e saj, "zhdukjen" e saj, e njëkohësisht bërjen e saj themel.

Mund të shkruajmë:

$$-\bigcirc = \boxed{\bigcirc} = \bullet \dots(F)$$

Mohimi	"varrosja"	Krijimi
(sakrifikimi)	e Qëndrës	i Botës
i Qëndrës	(<i>Inhumatio Dei</i>)	

Kështu pra në brendësi, në thellësi të materies e të Botës Materiale, ne kemi Qëndrën Mistike, a ndryshe "Frymën e Shenjtë" (fr. *Saint Esprit*), gjë që Teilhard de Chardin e rikonfermon me të thënë e tij të famshme:

"Dans le coeur de la matière il y a l'Esprit."

(Në zemrën e materies qëndron Fryma.)

* Të gjitha këto kalime gjenden tek *Një parashtrimin i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, në fund të këtij teksti.

- c) Që **k r i j i m i** i Botës lidhet me një mohim madhor siç është ai i Qëndrës (e pra i Hyjnisë) e pra me një **k r i m**, për këtë dëshmon përsëri Sanskritishtja me fjalën e saj "**k r i y ā**" (क्रिया), që do të thotë në të njejtën kohë edhe **k r y-m j e** (ingl. *action*) dhe **k r i-m** (ingl. *sacrifice*)*.

Edhe Shqipja na thotë të njejtën gjë me aforizmën:

"Krymja, nga një krim."

- ç) Në Sanskritisht: **s t h ā**, **s t h i r a**, **s t h e m a n**,... janë të gjitha "forma" të ndryshme të së njejtës rrënjë "STH-", që është gjithpo Shqipja "SHTI". Nryshimet e lehta që ne vëmë **rë janë** lënë a bërë me qëllim për të diferencuar *kuptime të ndryshme mbrenda të njejtit spektër semantik të simbolit tek i cili referon kjo rrënjë*.

530) Sanskr. **a - l a s a** (अलस) = fr. *inactif, indolent, lent, alangui*
(jo aktiv, përtac, i ngadaltë, i lëshuar)

Motivimi:

â l ë s h u, i lshutë...

(nga folja *lësho*-hem)

Këtu lidhet ndoshta dhe Inglishtja "**l a z y**" = përtac (fr. "inactif").

Kujtojmë gjithashtu se Italishtja "**l a s c i a r e**", Frengjishtja "**l a i s s e r**", Gjermanishtja "**l a s s e n**"..., lidhen të gjitha me Shqipen "**l a**" (lë, lëshoj).

531) Sanskr. **ā r d h i k a** (आर्धिक) = fr. *formant la moitié te...*
(që përbën gjysmën e...)

* Veprimi *paradigmatik*, ai i sakrificës...

Motivimi me Shqipen:

ā r d h i k a → shq. **A r d à : k a** = "ka d à Ar"* = ⊕ = 1/2 ... (F)

532) Sanskr. **d a r a ṇ a** (**दरण**) = fr. *qui fend, qui sépare* (që çan, që ndan)

Motivimi me Shqipen:

d ā r, n d a r... = simb. ⊕

nga folja "DAI", *talis qualis* edhe në Sanskrisht: "DAY" (**दय्**) dhe po ashtu "Do" (**दो**).**

Edhe fjala **d i a e r e s i s***** e Latinishtes këtu e ka prejardhjen.

533) Sanskr. **ā p a - v a t s a** (**अपवत्स**) = fr. *sans veau* (pa viç)

Motivimi:

ā p a v i ç

("v j e t a", në të folmen e Veriut)

534) Sanskr. **a p a - l ā p a** (**अपलाप**) = fr. *nier* (mohoj)

Motivimi me Shqipen:

ā p a l l a p → "- 1 . l l a p " → m o h o j

* Lidhur me operatorin "Ar" shih ndër të tjera edhe fq.151, 402, 613 dhe 629.

** Gjithpò me këtë kuptim, por edhe me kuptime të tjera sipas një spektri semantik mjaft të gjerë.

*** D.m.th.: *ndarja* e dy zanoreve që nuk formojnë një diftong.

Këtu:

"I l a p", si në Shqip ashtu edhe në Sanskritisht, rri për: *them, flas*
(fr. *causer, bavarder*)*

"â p a" rri për "â s h t p a" (ingl. "is without").

535) Sanskr. s ū n u (सूनु) = fr. *fil*s (biri, çuni)

Është Shqipja:

ç u n i

536) Sanskr. a p a - v ṛ t t i (अपवृत्ति) = fr. *fin, disparition* (fund, zhdukje)

Motivimi:

â p a v ṛ t t i j e = - (o) = - ~ = - p = - (o)

= jo materje, jo realitet material

Le të pyesim: Përse vallë ndodh kështu, përse pa vërtitje nuk ka materie?

Përgjigja është kjo:

Mund të vërtetojmë se transformacionet Lorentziane, të përdorura nga Einsteini në Teorinë e tij të Relativitetit të Ngushtë, përbëjnë një vërtitje.**

* Shih gjithashtu edhe fq.500 dhe 529.


** Edhe në parashtrimin e Teorisë së Relativitetit të Ngushtë, thuhet e njehta gjë kur vjen fjala për transformimet Lorentziane, që tregojnë se si ndryshojnë koordinatat e një trupi kur kalohet, nëpërmjet një vërtitjeje hiperbolike, nga një sistem koordinativ në tjetrin.

Dhe ja se si:

Marrim një rreth me rreze " c " (shpejtësia konstante e Dritës) dhe me qendër qendrën e koordinatave.

Marrim mbi periferinë e këtij rrethi në kuadrantin e parë një pikë " M ". Zbresim prej saj mbi boshtin a absisave pingulen " MP ". Këndin në kulmin " O " të trekëndëshit që formohet në këtë mënyrë e tregojmë me " ω ".

Do të kemi: $\sin \omega = MP/c$ dhe $\cos \omega = OP/c$



Pozojmë tani: $MP = v$ (shpejtësia e lëvizjes së trupit). Do kemi atëherë: $\sin \omega = v/c$. Do të jetë kështu:

$$\cos \omega = \sqrt{1 - \sin^2 \omega} = \sqrt{1 - \frac{v^2}{c^2}} = \beta$$

Gjejmë kështu formulën për ndryshimin e masës së trupit me ndryshimin e shpejtësisë së trupit në funksion të këndit " ω " e pra si një **vërtitje**:

$$m_t = \frac{m_0}{\sqrt{1 - \frac{v^2}{c^2}}}$$

dhe pra sipas modelimit tonë:

$$m_t = \frac{m_0}{\cos \omega}$$

Prania e një funksioni trigonometrik (siç është: $\cos \omega$) flet për një vërtitje, dhe kemi për $t_t = t_0 \sqrt{1 - v^2/c^2}$, sipas modelit tonë:

$$t_t = t_0 \cos \omega$$

Nga këto formula del, ndër të tjera se:

$$\omega > = m > = t <$$

Për: $\omega = 0$, kemi: $m_t = m_0$. Për $\omega = 90^\circ$, kemi: $m_t = \infty$.

Dhe shikojmë kështu ndër të tjera se:

*Formulat e transformacioneve Lorentziane që Einsteini shfrytëzoi në Teorinë e tij të Ngushtë të Relativitetit mund të vështrohen si një vërtitje, një vërtitje që krijon materie ($\omega > = m >$).**

* Por ne mund ta justifikojmë edhe llogjikisht, me ndihmën e Algoritmit Simbolik, hipotezën e një krijimi të tillë.

Ne dimë se krijimi i Botës lidhet në çdo rast me një mit kozmogonik, skema e përgjithshme e të cilit është: $E \downarrow = F$. Dimë se: $E = (x = -x)$ dhe tabela e vërtetësisë të këtij ekuacioni (të Qendrës), vështruar si një propozicion llogjik, është:

$$T_{(x=-x)} : \text{II} = -, \quad \text{I} - = \text{I}, \quad - \text{I} = \text{I}, \quad - - = - \quad \dots \text{(E)}$$

Kryejmë tani një "Vërtitje" prej 90 shkallësh:

$$\text{I} \downarrow = - \quad \text{dhe} \quad - \downarrow = \text{I}$$

Pra atëhere do të kemi:

Le të vëmë re këtu gjithashtu se nga formula e Relativitetit të Einsteinit:

$$m_t = \frac{m_0}{\sqrt{1 - \frac{v^2}{c^2}}}$$

shihet se: $v > = m >$, me fjalë të tjera se:

"Me rritjen e vërtitjes rritet dhe masa e trupit."

Mund të shkruajmë pra:

$$\sim > = \bullet >$$

Kjo **do të** thotë që:

"Vërtitja (lëvizja) krijon materie."

Mund të shkruajmë atëhere edhe se:

$$- \sim = - \bullet$$

$$E = (|| = -) \rightarrow (- - = |) = F$$

...Dhe kështu edhe për të gjitha rrjeshtat e tjerë të tabelës së vërtetësisë të kodit E. Prandaj ne mund të shkruajmë: $E \downarrow = F$ dhe me qenë se: $E = \bigcirc = -\bullet = \text{Hiç}$, ndërsa: $F = \bullet = \text{materie, Bota materiale}$, ne kemi kështu **krijimin e materies, të Botës materiale nëpërmjet një vërtitje të Hiçit!**... Dhe kjo është pikërisht dhe teoria e *tourbillons*, dhe këtë na thotë në thelb edhe Teoria e Relativitetit nëpërmjet ekuacioneve të transformacioneve Lorentziane. Matematikisht kjo do të shkruhej:

$$\text{Rot. } E = F$$

ku "rot" = rotor, një transformacion vektorial në matematikën e lartë që lidhet pikërisht me një vërtitje, sikundër dhe vetë termi "rotor" (rotullim) do të thotë.

Pra: *Pa vërtitje (lëvizje) nuk mund të ketë krijim të materies e të Botës materiale, pikërisht ashtu siç na tregon fjala Sanskrite "apa-vṛtti".*

Mund të shtojmë këtu edhe diçka tjetër.

Formula e Einsteinit ($\epsilon = mc^2$) tregon se si energjia dhe masa janë ekuivalente. Por energjia nuk është gjë tjetër veçse lëvizje. Dhe kështu del relacioni:

$$\sim = \bullet \quad \dots(F)$$

lëvizje materie

Pra duke përgjithësuar këtë "rezultat", ne arrijmë në konkluzionin se në shumë e shumë raste (në mos në të gjitha) Dituria e Lashtë mbetet aktuale.

Le të shtojmë këtu se në Sanskritisht folja "**v a r t a t i**" do të thotë në të njëjtën kohë: **v ë r t i t** si edhe **k r i j o j**. Pra dijetarët e lashtë e kanë ditur këtë, ndonëse nuk njihnin ekuacionet e transformacioneve Lorentziane... ata e lidhnin krijimin e Botës me një "shakullere" (rus. *вихрь, vihr*, fr. *tourbillon*).

537) Sanskr. **s u - p a r y ā p t a** (**सुपर्याप्त**) = fr. *très spacieux, abondant* (që ka shumë hapësirë, i bollshëm)

Motivimi:

s u p a r y ā p t a → shq. "**shu-më bërë i hap të**"

Le të kujtojmë këtu se dhe vetë fjala "**H a p ë s i r ë**" (ingl. *space*) rrjedh nga folja Shqipes "m e **H a p**".

Mund të shtojmë këtu si një "*Consensio linguarum*" të shkurtër, edhe Inglishten "**t o o p e n**", që motivohet krejt natyrshëm edhe ajo me Shqipen "**h a p**", "**h a p u n**",...

538) Sanskr. s u- k a t h ā (सुकथा) = fr. *belle histoire* (histori e bukur)

Motivimi:

s h u- m ë k a t h a n- j e
("ka shumë *thanje*", "domethanje"...)

Vëmë në dukje se në Sanskritisht operatori "t h ā" nuk është i lirë.

539) Sanskr. s ā k ṣ i n (साक्षिन्) = fr. *spectateur, témoin* (spektator, dëshmitar)

Theksi semantik bie tek "s i n" që është Shqipja:

s y, s y n i

dhe ~~që~~ nuk është një operator i lirë në Sanskritisht.

Edhe Turqishtja "ş a h i t" = dëshmitar (ingl. *witness*), lidhet, siç kuptohet lehtë, me Shqipen: "s h o h" = me pa (ingl. *to see*).

540) Sanskr. s a k ṣ ā t (साक्षात्) = fr. *de visu, de ses yeux, visiblement, évidemment* (me të parë, me sytë e tij, dukshëm, në mënyrë të qartë)

Edhe këtu tërë theksi semantik bie tek "ṣ ā t" që është Shqipja:

s y t

541) Sanskr. s ā g r a (साग्र) = fr. *entier, complet* (i, e tërë, krejt)

Theksi semantik bie mbi "g r a" që është Shqipja:

k r e- j t

Kujtojmë se Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$1 = \bigcirc \quad \dots(E)$$

KRe-u KRe-jt

Por edhe Sanskritishtja shtron të njejtin ekuacion simbolik:

$$1 = \bigcirc$$

a-GRa (अग्रे) sā-GRa (साग्र)
(*qui est en tête*) (*entier, complet*)*

542) Sanskr. **s a v r a ṇ a** (सव्रण) = fr. *blessé, endommagé, ayant un défaut* (i plagosur, i dëmtuar, që ka një të metë)

Është Shqipja:

e v r a m j a, e v r a r a...

nga folja "me v r a", që nuk është e lirë në Sanskritisht.

Edhe në Shqip, madje edhe më shumë se në Sanskritisht, rrënja "v r a" e zgjeron semantizmin e saj primar, me shprehje të tilla si p.sh. "*më vrau me atë fjalë*", "*kishte një shprehje të vrarë në fytyrë*", e kështu me radhë.

543) Sanskr. **s a - v i ç e s a** (सविशेष) = fr. *singulier, extraordinaire, qui se distingue* (i veçantë, i jashtëzakonshëm, i dalluar)

Motivimi bëhet me Shqipen:

v e ç o j
(ndaj, dalloj, heq mënjanë...)

* Shih edhe fq.423, 447, 492 dhe 658.

që nga edhe:

veçësi, veçanti, i veçantë, veç, veçori...

"Ça" është një operator i lirë shumë pjellor në Shqip.

Një analizë e mëtejshme etimologjike do të na jepte:

veç → ve ç = b ë "ç" = "b ë ç a"... = simb. ⊕

544) Sanskr. s a-h a r ṣ a (सहर्ष) = fr. *réjouir, joyeux* (i gëzuar)

Nga Shqipja:

H a r é (ingl. *joy*)

operator që mungon në Sanskritishte, por jo në Hebraisht.

Në Shqip: i h a r e s h ë m.

Kujtojmë këtu me këtë rast nga "Libri i Aforizmave" edhe këtë aforizëm të Shqipes:

"Nga H i r i, h a r e j a."

"H i r i", këtu në kuptimin e Inglishtes "g r a c e", Italishtes "g r a z i a", Greqishtes "c h a r i s" (χάρις).

545) Sanskr. a t i g u r u (अतिगुरु) = fr. *très lourd* (shumë i rëndë)

Motivimi me Shqipen:

â t e j g u r

Me rrënjën e Shqipes "g u r" motivohen edhe shumë fjalë të huaja.*

* Shih edhe fq.122, 164, 445, 531 dhe 570.

546) Sanskr. a-g a r h i t a (अगर्हित) = fr. *qui n'est pas l'objet d'une blâme; irréprochable* (që s'bëhet objekt i një qortimi; i paqortueshëm)

Motivimi:

- g ë r t h i t a

547) Sanskr. s u - c e t a s (सूचेतस्) = fr. *très intelligent* (shumë i zgjuar)

Është Shqipja:

s h u (më) i q u t

Le të vëmë ré tani sa vijon: a) në Shqip: i z g j u a r = 1) inteligjent, 2) që nuk fle; b) në Greqisht: e k s i p n o s (ἐξυπνος) = 1) i zgjuar, 2) që nuk fle; c) në Shqip: i q u t ë (< i ç u t ë) = 1) që nuk fle, 2) i zgjuar...

Kjo na shtyn të besojmë se kjo rrënjë është më autohtone në Shqip se sa në Sanskritisht.

548) Sanskr. a k ṣ i (अक्षि) = fr. *œil* (sy, syri)

Theksi semantik bie tek "ṣ i" që nuk është tjetër veçse Shqipja:

S Y *

një operator jo i lirë ky në Sanskritisht...

549) Sanskr. s u - d ā n a (सुदान) = fr. *belle offrande* (dhuratë e bukur)

Është Shqipja:

s h u - m ë d h a n - j e

* Shih edhe fq.82, 235, 374 dhe 770.

550) Sanskr. *su-duṣprekṣya* (सुदुष्प्रेक्ष्य) = fr. *très difficile à constater* (shumë i vështirë për tu konstatuar)

Duhet zbërthyer në:

su duṣ : pre k ṣ ya

Dhe me Shqipen:

shumë dysh : bërë ka sy

Këtu:

"dysh" (Shqip) = 2 = ● = *me heq zi, me e pas të vështirë.**

Kuprimi pra është: "Diçka shumë e vështirë (2) që të kapet me sy."

551) Sanskr. *a-cchidra* (अच्छिद्र) = fr. *indemne; ininterrompue* (i pa dëmtuar; i pandërprerë)

Duhet zbërthyer në:

a c c h i d r a

dhe me Shqipen:

- q i k a d ā r ē → dar, dām = - ⊕ (i pandërprerë) = -F
= - ● = - d ě m (jo e keqe, e padëmtuar...)

Ta zgjerojmë tani Bisedën lidhur me konceptin e "d ě m i t" ashtu si e përfytyron atë Gjuha (të gjitha gjuhët në përgjithësi).

Le të themi, që në krye, se kuptimin më të saktë e më të qartë e të thellë të "dāmit" e gjejmë vetëm në Shqip.

* Lidhur me simbolizmen e numurit dy (2), shih edhe fq.11-12.

Edhe kjo sepse mund të shkruajmë:

shq. $d \bar{a} m$ (it. *danno*, lat. *damnus*) < shq. $d a m - j e = \textcircled{1}$

Shqipja shtron kështu ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \bullet \quad \dots(F) \\ d a m - j e & & d \bar{a} m \\ (fr. \textit{division}) & & (fr. \textit{dommage}) \end{array}$$

Me qenë se Gjuha emërtion sipas një paradigme superlative, zanafillore, del që këndejse " $d \bar{a} m i$ " më i madh është ay i " $d a m - j e s$ " nga Zoti, që neve e paraqesim simbolikisht si $\textcircled{1}$, ku \bigcirc është simboli i Zotit."

Nga ana tjetër " $i d a m i$ " a " $i d a m u r i$ " nga Zoti është bash $D e m o n i$, e pra Djalli, vetë personifikimi i të keqes. Kujtojmë këtu ndër të tjera vetë-përkufizimin e Mefistofelit në "*Faust*" e Goethes:

*"Alles was sie Böse nennt
Ist meine eigentliches Element..."*

[...Gjithshka ju quani e Keqja
Është bash thelbi im...]

Mund të shkruajmë pra:

$$d \bar{a} m i = d a m j a = \textcircled{1} = F = \bullet = e \textit{ keqja, djalli, materia, Bota materiale}$$

Dhe, mbi këtë, mos të harrojmë të thënë e artë të Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"...^{**}

* $\bigcirc = (x = -x) = \textit{Coincidentia oppositorum} = \textit{Qendra Mistike} = \textit{Zoti}$

** Gjithshka fillon me një ndarje", e pra: $\textcircled{1} = -1 = \bullet \dots(F)$

Të gjitha këto duan të thonë atëhere se: *Krijimi i Botës që është realizuar, si çdo gjë tjetër materiale, me një d a m-je, ka qenë një punë e d a m-shme, një punë e D e m o n i t.* *

Ky është mesazhi që na sjell, që nga stërllashtësia e kohërave, Gjuha. Këtu, më saktë, Shqipja dhe Sanskritishtja.

Siç e dimë, në këtë përfundim arrihet nëpërmjet Gjuhës (dhe jo vetëm) edhe në shumë mënyra të tjera.

Kuptohet, nga sa më sipër, se Shqipja është në gjendje të motivojë, *gjer në thellësinë e tyre mitike e theollogjike*, edhe një sërë fjalësh nga gjuhë të huaja që lidhen me *dëmin* dhe *demonin*.

Ndër to: it. "danno", "condannare", "dannato"; ingl. "damn!"; "damage"; "condemn"...; fr. "dommage"; gjerm. "verdammen", "Dämmer"...

* Kjo tezë është mbështetur e argumentuar gjerë e gjatë e në mënyrë mjaft bindëse, edhe nga Rryma e fuqishme e Gnosticizmit, e cila qëndroi e patrazuar gjatë 5 shekujve të parë pas Krishtit.

Gjurma të thella të këtij mendimi mistik gjejmë edhe vetë në Testamentin e Ri (Ungjilli).

Kjo dëshmi historike, dhe jo vetëm, por edhe thellësisht fillosofike, e Gnosticizmit, është një rikonfermë e mëtejshme e saktësisë së etimologjisë të fjalëve "d a m", "D e m o n" në Shqip dhe me anë të Shqipës. Si edhe të krijimit të Botës me një krim, nga një Demon a, siç shprehen fillosofët gnostikë, nga një "Demiurg i keq"... Bota materiale pra, jo e krijuar nga Zoti i Dashurisë (që nga zbuloi Krishti), por nga "Princi i kësaj Bote" (Gjoni, 14:30), shkurt e me një fjalë, nga Djalli. Bota e krijuar prej tij, që është kjo e jona, është vetëm *fenomenale*, do të thotë është vetëm një *dukuri*, është vetëm, siç na mëson Schneider, vetëm *gjysma e Realitetit*, e pra si e tillë nuk është e vërtetë. Është, siç thonë fillosofët e lashtë indianë, veçse një "mahi" e Marës.

Shih lidhur me këtë çështje edhe fq.27, 62-63 dhe 251.

552) Sanskr. **veṣa** (**वेष**) = fr. *costume* (veshje)

Është Shqipja:

v e s h - j e (nga folja: **v e s h**)

553) Sanskr. **svatas** (**स्वतस्**) = fr. *de soi, pour soi* (nga vetja, për veten)

Është Shqipja:

v e t ë, v e t j a

Edhe Greqishtja "**e a f t o s**" (**εαυτός**) = ingl. *self* (vetja), si edhe shumë fjalë të tjera që në një mënyrë a një tjetër **lidhen me** të, shpjegohen e motivohen me anë të Shqipes:

â v e t

Rrënja këtu është, siç shihet lehtë, "**v e t - j a**" (= ingl. *self*).

Duke qenë kështu, shumë e shumë fjalë që lidhen me këtë rrënjë ("**a u t o m a t**", "**a u t a r k i**", "**a u t o n o m i**", etj. etj.) dhe që vështrohen me rrënjë nga Greqishtja, i përkasin, në prejardhjen e tyre "ekstreme", Shqipes "**vetë**", një operator tepër pjellor, tepër produktiv ky në Shqip (p.sh. ...*vehtjak, vetëmohim, përvetësim, vetvetja, vetiu, vetë i dytë*... etj. etj.).

Vërejmë këtu më në fund edhe një fakt tjetër bindës të një etimollogjie të tillë me anë të Shqipes, alternimin fonetik:

v → **u**
(vetë) (auto)

që tregon se "v" është më primare se "u", dhe pra se "v e t ë" është më primare se "a u t o".

554) Sanskr. *s r a m s* (*स्रम्*) = fr. *tomber* (me rà)

Është Shqipja:

me rà, r a m-je, etj. = simb. ↓

555) Sanskr. *ç i k h a* (*शिखा*) = fr. *pointe* (majë)

Është Shqipja:

ç u k a

Këtë fjalë e gjejmë edhe në kryeveprën e Naim Frashërit "*Bagëti e Bujqësi*". Po riprodhojmë këtu nga kjo poemë strofën e parë:

*"O malet' e Shqipërisë e ju o lisat' e gjatë!
Fushat e gjëra me lule, q'u kam ndër mënt dit' e natë!
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar!
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pylle të gjelbëruar!
Do të këndonj bagëtinë që mbani ju e ushqeni,
O vendëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni..."*

556) Sanskr. *l a p* (*लप*) = fr. *causer, bavarder, faire parler* (flas, bisedoj, llap; bëj të flase, te llapë)

Është Shqipja:

l l a p

(me llap, me fol; bëj me llap, etj.)

Në Sanskritisht gjithashtu: "*l a p a n a*" = fr. *bouche; parler* (gojë; të folurit).

* Naim Frashëri, "*Bagëti e Bujqësi*", 1886.

Po në Shqip edhe: "I l a p a" = gjuha (fr. *langue*), d.m.th. "gjuha" si organi i të folurit.

Mbi këtë edhe një gjë tjetër: në Shqip kemi "I o p a" (ingl. *cow*), që lidhet mitikisht me të folurit.* Për të gjitha këto arsye ne mund të shkruajmë:

sanskr. "I a p" ≤ shq. "I l a p"

që do të thotë, një vjetërsi më e madhe ose e barabartë e kësaj gllose në Shqip krahas me Sanskritishten.

557) Greq. n a u s (ν α ú ς) = ingl. *ship* (anije)

Është Shqipja:

a n i j e

Në Hebraisht: "a n i a h" (א נ י ה) = ingl. *ship*.

Këtu lidhet edhe Italishtja: "n a v e".

Kështu pra, rrënja "a n i j e" e Shqipes rezulton shumë më e lashtë se ajo e Greqishtes dhe Italishtes, dhe lidhet më afër me Hebraishten.

558) Greq. k o u r i (κ ο ú ρ η) = ingl. *maiden* (vashë)

Lidhet me Shqipen:

g r u a

Këtu lidhet edhe Inglishtja: "g i r l" = vajzë.

Në studimin tjetër të Autorit, "*Shqipja dhe Sanskritishtja*", tregohet se si fjala "g r u a" në Shqip mund të vijë nga Shqipja "g j i r i" (lat. *g r e m b o*,

* Cirlot, fq.65.

ital. *seno materno*). Në të folmen e Veriut: "g j i n i", që nga edhe Greqishtja: "g j i n e k a" (γυναίκα) = grua.

Një etimologji e tillë e fjalës Shqip "g r u a" konfirmohet edhe nga miti i Deukalionit dhe Pirrhës.

Duke zgjeruar Bisedën, po riprodhojmë këtu nga Vëllimi i Parë i studimit "*Shqipja dhe Sanskritishtja*" sa vijon:^{*}

Fjalët Shqip "g u r i", "g j i r i", "g j i r í" duhen vështruar, jo nga ana e "kuptimit", por nga ana e një trajte arkeotipale, si identike, d.m.th. se mund të shkruajmë nga pikëpamja e kësaj trajte arkeotipale:

g u r i = g j i r i = g j i r í**

Në çoftë se tani ne duam të argumentojmë përse vallë *guri* të jetë lidhur edhe me *gjirin*, edhe me *gjirinë*, si edhe me të *parin* (fr. *ainé, aieul*, etj.), duhet të drejtohem për këtë mentalitetit primitiv. Tek Cirlot lexojmë ndër të tjera se:

"S t o n e is a symbol of being, of cohesion and harmonious reconciliation with self. The hardness and durability of stone have always impressed men, suggestin to them the antithesis to biological things subject to the laws of change, decay and death, as well as the antithesis to dust, sand and stone splinters, as aspects of disintegration. The stone when whole symbolized unity and strength, when shattered it signifies dismemberment, psychic disintegration, infirmity, death and annihilation. *Stones fallen from*

* Nga Autori shih edhe "*Shqipja dhe Sanskritishtja*", Vëllimi I.

** Ky ekuacion përligjet nga ato sa lexuam në Sanskritisht për gllösën "*guru*" dhe "*giri*", që kishin edhe kuptimit e "gurit", edhe atë të "gjirisë", edhe atë të "të parit", si edhe atë, siç do të shohim më vonë, të "gjirit", të "matricës", etj.

heaven served to explain the origin of life... Meteorites, in particular, came in for worship; the most celebrated are the Kaaba meteorite in Mecca and the Black Stone of Pessinus, an aniconic image of the Phrygian Great Mother taken to Rome during the last of the Punic Wars... Among the stones venerated by the ancients, we must not overlook the Greek omphaloi; Guénon maintains that they are really bethels, a word derived from the Hebrew *Beith-El* (or *House of God*), related to the biblical '*And this stone, which I have set for a pillar, shall be God's House*' (Genesis XXVIII, 22), even though its sense is magic and not architectonic. There are numerous legends dealing with stones: the so-called Abadir which Saturn devoured, mistaking it for Jupiter; or the stones of Deucalion and Pirrha; or these in the myth of Medusa the Gorgon; or that which contained Mithras until his birth."*

[Guri është simbol i qenies, i kompaktësisë dhe i pajtimit të harmonishëm me veten. Fortësia dhe jetëgjatësia e gurit u ka bërë gjithnjë përshtypje njerëzve, duke u sugjeruar atyre karakterin antitetik, të kundërt ndaj objekteve biologjike, të cilat u nënshtrohen ligjeve të ndryshimit, rënies dhe vdekjes, si dhe karakterin e tij antitetik ndaj pluhurit, rërës dhe ciflave gurore, si pamje këto të fundit të shpërbërjes. Guri kur është i plotë simbolizon unitet dhe forcë; kur është i çarë rri për çgjymtyrim, shpërbërje psikike, smundje, vdekje dhe anihilim. Gurë të rënë nga qielli kanë shërbyer për të shpjeguar zanfillën e jetës... Meteoritët, në veçanti, janë përdorur si objekte adhurimi; më të dëgjuarit janë në këtë drejtim, meteoriti Kaaba në Mekë dhe Guri i Zi i Pessinus, një shëmbëlltyr anikonike e Nënës së Madhe e cila u shpu në Romë gjatë luftës së fundit punike... Ndërmjet gurëve të adhuruar nga të lashtët, nuk duhen lënë pa përmendur omfalet greke; Génoni është i mendimit se ato janë në fakt bethele, një fjalë kjo e rrjedhur nga

* Cirlot, *The Stone*, fq. 313-315.

Hebraishtja *Beith-El* (ose *Shtëpia e Zotit*), ashtu siç thuhet në Bibël: 'Dhe ky gur të cilin unë e vura si një shtyllë do të jetë Shtëpia e Zotit' (Gjeneza 23:22), megjithëse kuptimi i saj është më fort magjik se sa arkitektonik. Ekzistojnë shumë legjenda që lidhen me gurin: i ashtuquajtur Abadir, të cilin Saturni e përpiu duke e marrë gabimisht për Jupiterin; ose ato në mitin e Deukalionit dhe të Pirrhas; ose ato në mitin e Gorgonës; ose ai që e përmbajti Mithran gjersa lindi.]

Nga ky tekst i shkurtër nxjerrim, ndër të tjera, argumentimin që kërkonim: *Gurë të rënë nga qielli vështroheshin si burim i jetës mbi dhë...*

Duke qenë kështu, ne kuptojmë përse në Shqip:

gur dhe gurrë (burim)

Me qenë se, nga an tjetër, *guri* ishte një shëmbëllturyë e "Nënës së Madhe" së Frigjianëve, ne kuptojmë përse në Shqip:

gur dhe grua

Dhe me qenë se *gurët* adhuroheshin, ne kuptojmë shprehjen Shqipe: "*Për atë gur!*" (si betim), ne kuptojmë po ashtu përse në Italisht "*g i u r a r e*" = me u betue.

Dhe shohim gjithpò nga ky tekst se *G o r g o n a*, vështrimi i së cilës i kthente njerëzit në *gur*, lidhet prapë me Shqipen *g u r*. Dhe me qenë se, siç thamë, origjina e jetës lidhej, sipas mentalitetit primitive, me *gurë* të rënë nga qielli, ne kuptojmë përse në gjuhën Sanskritishte rrënja "*g u r*" (*guru*, *giri*, etj.), krahas kuptimit fillestar të *gurit*, ka edhe atë të *prindit*, të *të parit* etj., të *gjirisë*.

Le të tregojmë tani, duke iu drejtuar gjithnjë mentalitetit primitiv, përse fjalë Shqip *guri* lidhet përbrenda Shqipes me fjalën *gjiri*. Për këtë na shërben, mes të tjerash, miti i Deukalionit dhe i Pirrhas.

Ja ky mit:

Deukalioni. I biri i Promotheut, ish martuar me Pirrhan, e bija e t'ungjit të tij Epimathé. Jupiteri, duke e parë që ligësia e njerëzve sa vinte e bëhej më e madhe (Ovidi, Met.I), vendosi ta shfarosë racën njerëzore, duke vërsuar rrëkera me ujë nga të gjitha anët e qiellit. Kështu tërë sipërfaqja e Tokës u përmyt, me përjashtim të një mali të vetëm në Focidë (mali Parnas), të cilin ujërat e kursyen m.q.s. maja e tij që përmbi retë. Atje pikërisht ndaloi edhe barka e vogël që mbante Deukalionin dhe të shoqen e tij. Jupiteri i shpëtoi ata, sepse nuk kishte parë kurrë një njeri kaq të drejtë dhe të ndershëm sa Deukalioni dhe një grua kaq të virtytshme e të devotshme sa Pirrha. Menjëherë porsa ujërat u tërhoqën, ata shkuan të konsultojnë perëndeshën Themis, e cila i jepte orakujt e saj në rrëzë të malit, në të njëjtin vend ku u ngrit më vonë orakulli i dëgjuar i Delfit. Perëndesha u tha: *Dilni nga tempulli, hidhni një vello mbi fytyrë, çlironi brezat dhe hidhni prapa eshtrat e nënës suaj të madhe!* Në krye ata nuk arritën dot të kuptonin se ç'desh të thoshte orakulli me këtë. Por më pas Deukalioni, duke u menduar mirë, kuptoi se nëna e tyre e përbashkët ishte Toka dhe se eshtrat mund të qenë fare mirë gurët që ajo mbante kyçur në gjirin e saj. Pra ata mblodhën disa syresh dhe i hodhën prapa duke mbyllur sytë; dhe gurët menjëherë u zbutën, u bënë të lakueshëm dhe morën një trajtë njerëzore: nga ato që hodhi Deukalioni dolën burra, kurse nga ato që hodhi Pirrha dolën gra...

Ky mit na jep lidhjen e kërkuar mes "g u r i t" dhe "g j i r i t" (it. g r e m b o, rus. g r u d, etj.).

559) Greq. i d h è (ἰ δ έ) = ingl. *and, also* (e, dhe, edhe...)

Është Shqipja:

e d h e

Motivimi:

$$\hat{a} d h a \rightarrow \text{shq. } \hat{a} d \hat{a} = \textcircled{1} = F = \text{X} = \dots$$

Le të vërejmë këtu sa vijon:

- a) Si në Shqip, ashtu dhe në Sanskritisht, kemi ekuivalencën kuptimore "dh" = "d". Kush është primar nga këto dy operatorë është e vështirë të thuhet, por ndofta, për një sërë arsyesh që nuk është vendi këtu të parashtrihen, kemi: "d" < "dh".
- b) Rikujtojmë ekuivalencën simbolike: ($\textcircled{1} = \text{X}$) që shtrohet ndër të tjera në Shqip edhe nga:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \text{X} & \dots(F) \\ d \hat{a} & & d h e \end{array}$$

Në Shqip gjithashtu:

- 2) Kështu pra Shqipja na zbulon një të vërtetë të thellë fillosofike që mund të shprehet në trajtë aforizme si:

*"Çdo bërje është një bjerrje."**

Me qenë se Gjuha, siç kemi patur rast ta vëmë në dukje më se një herë, emërton sipas një paradigme superlative e primordiale, fjala është këtu sidomos për b e r j e n e parë, bërjen (krijimin) e Botës, që qe një b j e r r j e, që u krijua, siç dimë, me një *krim* siç dëshmojnë ndër të tjera:

a) Doktrina (dogma) e "*peccatum originalis*" së Fésë të Krishterë.

b) Mithet Kozmogonike që ngrihen të gjitha mbi një s a k r i f i c ë ("krim") kozmogonik dhe që, siç kemi treguar e vërtetuar, mund të përfshihen të gjitha, pa përjashtim, në skemën:**

$$E \downarrow = F$$

e pra edhe, ndër të tjera:

$$\bigcirc \downarrow = \bullet$$

Parimi Hyjnor

Parimi djallëzor

Do të kemi rast të rikthehemi me rikonferma të tjera gjuhësore dhe fillosofike tek kjo problematikë.

* Shiko edhe "Libri i Aforizmave", fq.177 dhe 522.

** Shih edhe fq.105, 375, 600, 702 dhe 837.

603) Sanskr. u p a - p a d (उपपद) = fr. *avoir lieu, manifester*
(me ndodh, ngjet, shfaqet, manifestohet...)

Me Shqipen:

u b â : b â D à → ⊕ = F = ↓ (rënje) = ● (realizim,
bërje, materializim, ndodhje...)

Le të vëmë ré këtu se ekuacioni simbolik:

↓ = ● ... (F)

mund të interpretohet në frymën e një mythi kozmogonik (sikundër mund të interpretohet nga ana tjetër edhe çdo ekuacion simbolik në F), në atë të R ë n i e s (ingl. *the Fall*).**

* Kështu për shembull:

(→↔←) = ● = F (mithi kozmogonik i "Struggle")

⊕ = ● = F (mithi kozmogonik i shqyerjes, "dismemberment")

⌘ = ● = F (mithi kozmogonik i Martesës së Shenjtë)

E kështu me radhë...

Shihet kështu se *Gjuha*, nëpërmjet ekuacioneve të saj simbolike, përmban *mithe kozmogonike*. Kështu që mund të themi edhe se:

"Rrënja e rrënjëve të Gjuhës është Mithi."

Shtojmë edhe se fjala "m i t h" (μύθος) në Greqisht do të thotë "prallë".

Ose ndryshe:

"Gjuha është një prallë..."

Me qenë se, nga ana tjetër:

Fjala = Bota

("Në krye ishte fjala...", Gjoni 1:1)

Kështu që Sanskritishtja "u p a-p a d" (उपपद्) = fr. *avoir lieu...*, mund të vështrohet si një interpretim (paraqitje) gjuhësor pikërisht i këtij mythi, gjë që rikonfermon edhe më thellësisht saktësinë e etimologjisë të kryer nga ne të kësaj fjale.

Duke zgjeruar Bisedën mund të shtojmë se:

- b) Në Sanskritisht edhe "a v a-p a d" (अवपद्)^{***} = *me ra*, dhe me Shqipen: "â b a : b a d à" = ⊕ = **F** = ↓ (*me rà*).
- c) Në Rusisht: "p a d a t s" (падать) = *me rà* (ingl. *to fall*), dhe duket qartë se lidhet si me prejardhjen e saj me Sanskritishten "a v a p a d" dhe në instancë të fundit me Shqipen: "b â d à" = ⊕ = **F** = ↓ ...
- ç) Në Rusisht: "p o d" (под) = *poshtë* (ingl. *down, below*). Edhe kjo fjalë etimologjizohet me Shqipen:

$$p o d \rightarrow \text{shq. } b a d à = d a = \oplus = \mathbf{F} = \downarrow \text{ (poshtë)}$$

ne mund të themi edhe, gjithnjë në një stil gjer diku letrar:

"Bota është një prallë."

dhe rigjejmë kështu Shekspirin tonë të dashur: "*Life is a tale told by an idiot...*"

Dhe s'është e rastit, nga të gjitha këto sa parashtruam më sipër, se Italishtja "parola" dhe Shqipja "prallë" janë e njejta fjalë. Por na thuhet se: "*Në krye ishte Fjala...*", mund të themi atëhere edhe se: "*Në krye ishte Pralla...*"

Kjo do të shpjegonte ndër të tjera edhe përse fëmijëve u pëlqejnë kaq shumë prallat, duke i vështruar ato si të vërteta...

** Cirilot, *The Fall* (fq.101).

*** Shiko edhe fq.239, 445, 457 dhe 509.

d) Në Italisht: "**c a d e r e**" = *bie, rrëzohem*, simb. ↓ (nga Latinishtja: *cado, cecidi, casum, cadere*), që motivohet me Shqipen:

$$c a d e r e \rightarrow \text{shq. } k a d a r \ddot{e} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = \downarrow \text{ (me rà)...}$$

dh) Në Italisht gjithashtu:

$$\begin{aligned} a c c a d e r e \text{ (me ndodh)} < \text{it. } c a d e r e \rightarrow \text{shq. } k a d a r \ddot{e} &= \textcircled{\ominus} \\ &= \mathbf{F} = \bullet = \text{materializim, ndodhí...} \end{aligned}$$

Me qenë se "ndodhja" (*të ndodhurit*) lidhet me një "realizim", me një "materializim", shohim atëhere se si Italishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik (miti kozmogonik i rënies):

$$\begin{aligned} \downarrow &= \bullet \quad \dots(F) \\ c a d e r e & \quad a c - c a d e r e \end{aligned}$$

e) Dhe më në fund Shqipja "ndodhí", "ndodh-je" (ingl. *happening*) jep:

$$n d o d h \acute{i} \rightarrow n d o < \text{shq. } n d \grave{a} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = \bullet = \text{materializim...}$$

Në të gjitha këto shembulla bërja, ndodhja, *m a n i f e s t i m i*, shpjegohet me një *n d a r j e* e pra atëhere edhe me një *n d y r j e*, gjë që jep ekuacionin simbolik universal (miti kozmogonik i ndarjes, i shqyerjes):*

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

E rigjejmë edhe këtu Paracelsusin e madh: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang...*", që mund të shkruhet simbolikisht si:

$$\textcircled{\ominus} = (\neq 1) = \bullet = -1 \quad \dots(F)$$

* Shiko edhe fq.34-35, 237 dhe 627.

Tek Cirlot krijimi i Botës, në vija të përgjithshme, lidhet me *modifikimin* e energjisë infinite primordiale, që realizohet në dimensionin e fesë nëpërmjet Sakrificës Kozmogonike që vihet në praktikë në shumë raste me një *t h e r o r i* ("therje"), "kurban" që mishërohet në një Qenje të Përsosur e pra të pafajshme (simbolikisht pra: $-\bullet = \bigcirc = \infty$) mbi të cilin *k r y h e t k r i m i* i një vrasje të padrejtë rituale dhe jo vetëm.* Kjo bën të mundur krijimin e Realitetit material, të fajshëm.

Shqipja, ndër të tjera, me:

"Nga një *therrje* (*therori*), *thurja* (e Botës)."

[$-\bigcirc = \infty = \bullet \dots$]

si edhe me:

"Nga një *krım krymja* (*krijimi*)."

rikonfermon, në rrafshin gjuhësor, sa u tha më sipër lidhur me praktikën e kurbanit.

Edhe Greqishtja me biseminë e fjalës të saj "a i t i a" (αἰτία) = 1) *shkak*, 2) *faj*... na zbulon krejt qartë se shkaku i parë, zanafillor, paradigmatic, e pra ay i krijimit të Botës, lidhet me një faj, me një krim.

Në një zgjerim të mëtejshëm të Bisedës do të shtonim edhe sa vijon:

U tha se krijimi i Botës sipas Cirlot dhe sipas Misticizmës Hebraike lidhej me një *z v o g l i m* të Infinitit.

Një rikonfermë të kësaj të vërtete në Gjuhë, e gjejmë ndër të tjera edhe në Italishten (Frengjishten, Inglishten etj.): "co-MIN-ciare" = *filloj*, ku "min" lidhet brenda Italishtes me "*m e n o*" = *pa* (mohim, mungesë).

* Ky është ai që Feja Katolike quan dogmatikisht (pa ndonjë shpjegim llogjik të qartë) "*peccatum originalis*" (mëkati, krimi bash në zanafillën e krijimit të Botës).

Në Italisht gjithashtu: "di-MIN-uire" = *zvogloj*. Do të mund të sajohej kështu në Italisht, në këtë mënyrë, aforizma:

"Si **comincia** sempre con una **diminuzione**."^{*}
[Fillohet gjithmonë me një *zvoglim*.]

Simbolikisht kjo do të jepej me:

$$\bigcirc \rightarrow -\bigcirc = \bigoplus = \bullet$$

Dhe me qenë se:

$$\bigcirc = \infty$$

Shihet qartë edhe kështu se:

"Bota materiale (●) krijohet me një ndarje (⊕),
e pra me një *zvoglim* (⊕ < ∞) të Infinitit."

604) Sanskr. र ए णु (रेणु) = fr. *grain ou particule de sable* (kokërr rërë)

Është Shqipja:

r ā n a

(në dialektin e Jugut: r ë r a)

Përfitojmë nga rasti për të vënë në dukje diçka me rëndësi:

* Mund të shkruajmë atëhere (shih edhe *Një parashtrimin i shkurtër Algoritmit Simbolik*):

$$\langle \bigcirc = \bigoplus = \boxed{\bigcirc} = -\bigcirc = -1 = \bullet \dots(F)$$

zvoglimi ndarja tërheqja negativiteti, Bota
"burgosja" mohimi materiale

Gllosat Sanskritisht afrohen më ngushtë me Shqipen e Veriut, se sa me atë të Jugut.

E kundërta ndodh me gllosat e Hebraishtes, të cilat afrohen më ngushtë me Shqipen e Jugut, se sa me atë të Veriut

605) Sanskr. **kendra** (केन्द्र) = fr. *centre d'un cercle* (qendra e një rrethi)

Është Shqipja:

qendra, qendra

Këtu lidhet edhe Latinishtja "centrum".

Dhe është fjala gjithmonë për Qendrën Mistike, Parimin Suprem të Universit.*

606) Sanskr. **ava-tamasa, tamasa** (अवतमस) = fr. *obscurité* (errësirë)

Motivimi:

tam → shq. **dām** = ⊕ = **F** = ● = fr. *obscurité*

Në fjalorin Sanskritisht, lidhur me kuptimin e zgjeruar të kësaj fjale, thuhet akoma: "**tamoguna**" (मोह) = fr. *qualité de la nature, essence passive de l'ignorance et de l'inertie...* ku "guna" do të thotë "cilësi", e pra theksi themelor semantik vijon të bjerë si më parë tek "tam o") = veti e natyrës, esencë pasive e "padijes" dhe e "inercisë".

Kjo do të thotë se mund të shkruajmë: "tam o" = *errësirë*, e pra ●, *pasivitet* (parimi arkeotipal femëror), *inerci* e pra *materje*... të cilat të gjitha përbëjnë një segment të spektrit semantik të simbolit "●".

* Shiko Cirlot, fq.40.

Mund të shkruajmë pra:

t a m o = ● = 1) *errësirë*, 2) *padije*, 3) *pasivitet*, 4) *materialitet*

Po këtu lidhen edhe Latinishtja "**t e m e r e**", Gjermanishtja "**D a m m ä r**",
Inglishtja "**d i m**", Frengjishtja "**t é n è b r e s**", etj.

Na mbetet tani të komentojmë pak.

a) Prejardhja e Latinites "**t e m e r e**" nga Sanskritishtja "**t i m i r a**"
(तिमिर), e pra në instancë të fundit atëhere nga "**t a m**" (e pra
Shqipja "**d a m**" = ⊕ = ●), duket qartë.

b) Gjerm. **d ä m m e r** → shq. **d a m u n A r** → ⊕ = **F** = ● ...

Kalimi nga Shqipja "**d a m u n**" në Gjermanishten "**d ä m m e r**" është
realizuar me një asimilim regresiv të grupit "**mun**" në "**mm**".

"A r" qëndron për "parimin solar", i cili paraqitet arkeotipikisht me
simbolin ○.*

Vëmë ré akoma se:

$$\oplus = F = \bigcirc = \text{Perëndimi i Diellit}$$

↓

e pra:

$$\text{"errësira"} = \bullet$$

Dhe Gjermanishtja "**D ä m m e r u n g**" do të thotë pikërisht "perëndim
i Diellit" (it. *crepuscolo*).

c) Ingl. **d i m** → shq. **d ä m** = ⊕ = **F** = ● = *errësirë*...

* Shiko ndër të tjera edhe fq.151 dhe 768.

ç) Ital. **t e n e b r a** → t e n e b r a → shq. **bërë thyen** = ⊕ = ●...

d) Në Rusisht: "**T m a**" (тьма) = *errësirë*, dhe del kështu fare qartë prejardhja e saj nga Sanskritishtja "**t a m a s**", e pra nga Shqipja "**d a m**". Po në Rusisht: "**t j e m n o t a**" (темнота) = *errësirë*, si dhe "**t j e m e n**" (темень) = *errësirë...*, janë të gjitha fjalë këto të cilat motivohen me Shqipen: "**d a m**" = ⊕ = **F** = ● .

Duke e zgjeruar tani Bisedën në thellësi, mund të shtojmë edhe sa vijon:

Në Inqlisht: "**d i m**" = *errësirë*, ndërsa "**d a m**" = *digë* ("ndarja" e ujrave). Kështu Inqlishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{ingl. } d a m & & d i m \end{array}$$

Ky ekuacion simbolik, si çdo tjetër ekuacion simbolik, pozohet, qoftë edhe me interpretime të ndryshme konceptuale, nga çdo gjuhë.

Kështu për shembull:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{shq. } b a d à & & b d a j^* \\ & & n d a r j e \quad n d y r j e \\ & & d a s í \quad n d y s í \\ & & p j e s ë \quad p i s \\ \text{rus. } d e l i t s & & d e l a t s \\ & & (делить) \quad (делать) \\ \text{ingl. } f a l l & & f i l t h y \\ & & \dots \quad \dots \end{array}$$

* Shq. "bdaj" = *bëj*, realizoj, materializoj...

Dhe nënvizojmë këtu se:

Shpesh herë gjuhët e huaja, për mungesë operatorësh të lirë adekuatë, i shtrojnë ekuacionet simbolike me ndihmën e Shqipes.

Ndonjë shembull:

Në Rusisht: "b e d à" (беда) = *fatkeqësi, mjerim...*, e pra simb. ● .

Kjo fjalë e Rusishtes nuk është një fjalë e thjeshtë: ajo ndahet në "b ë" dhe "d a". Asnjë nga këto pjesë nuk është, në Rusisht, një operator i lirë. Jo vetëm kaq, por ato nuk janë as të tilla që, me kombinimin (bashkimin) e tyre, të mund të na japin kuptimin që fjala e përbërë Rusisht "b e d a" në fakt ka, atë të fatkeqësisë. Është ky çasti i çfaqjes (ushtrimit) të rolit ndër-mjetësues, "Mesianik" të Shqipes.

Në Shqip: "b e" → b ë (ingl. *to do*), dhe "d a" → d a j (folja "me da" = ingl. *to divide*). Duke qenë kështu Shqipja jep:

b e d à → shq. b ë d à = ⊕ = F = ● = e z e z ë, fatkeqësi...

...e pra bash atë kuptim që kjo fjalë ka në Rusisht.

Themi atëhere se me "ndihmën" (ndërhyrjen, "mesianizmin") e Shqipes, Rusishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{shq. } b \ddot{e} d \grave{a} & & \text{rus. } b e d \grave{a} \end{array}$$

Ky është një rast i veçantë i një *ekuacioni simbolik ndërgjuhësor*.

Ky ekuacion shtrohet, përsëri me ndihmën e Shqipes, edhe në Inglisht ku "b a d" = *keq*, e pra simb. ● .

Kemi

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet \\ \text{shq. } b \ddot{e} d \grave{a} & & \text{ingl. } b a d \end{array}$$

Dhe tani më në fund, m.q.s. simboli " ● " mund të interpretohet ndër të tjera si ai i *materjes*, i materializimit, i bërjes, i Botës materiale, mund të shkruajmë:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

n d a r j e n d y r j e

("Separatio") (G e b u r t)*

Rrjedh vetvetiu se krijimi i Botës (*Geburt*) ka qenë një gjë e keqe (ingl. b a d). Kemi në të dy rastet simbolin " ● " që është në të njejtën kohë si ai i *materjes* dhe i *Botës materiale*, ashtu edhe ai i të *Keqes*.

Nga ana tjetër, me qenë se simboli në fjalë është, ndër të tjera, edhe ai i *mëkatit*, si edhe i *padijes* dhe i *errësirës*, ne mund të pohojmë pa frikë se:

- a) Bota ka lindur nga një mëkat. Dhe ky është "*peccatum originalis*" (mëkati në zanafillë), që përbën një nga dogmat më themelore të Theologjisë së Krishterë.
- b) Bota është e keqe.
- c) Bota është "mbretëria e errësirës", gjë që do të thotë ndër të tjera se ajo që ne quajmë dritë në këtë Botë, duke mos qenë Drita e vërtetë por vetëm një dritë "luciferiane" (a edhe "Einsteiniane"), është në fakt e r r ë s i r ë.**

* Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang*"...

** "Lucifer" (nga Latinishtja: "dritësjellës") është emri i Djallit para se ti kundërvihej Zotit. (Shih Biblën)

Arsyeja që pozojmë: *drita luciferiane* = *drita einsteiniane*, është sepse "drita einsteiniane" ka një shpejtësi prej 299,998 m/s e cila, sipas Einsteinit, nuk mund kurrsesi të arrihet a të tejkalohet në këtë Botën tonë materiale. Po ç'do të ndodhte sikur kjo shpejtësi të tej-kalohej?

607) Sanskr. a b h a d r ā (अ भ द्र) = fr. *mauvais, méchant* (sale, mal, tort) (i keq, ... i ndyrë, ... padrejtesi...)

Motivimi me anë të Shqipës jep:

$$\hat{a} \hat{b} \hat{d} \hat{a} r = \textcircled{1} = F = \bullet \text{ (fr. } \textit{mauvais}) = -\perp \text{ (fr. } \textit{tort}) = \dots$$

608) Greq. l i m i n (λ ι μ η ν) = ingl. *harbour, anchoring place* (liman, vend ankorimi)

Në Greqishten e rë: "l i m a n i" (λ ι μ ά ν ι), pra njëlloj si në Shqip.

Është Shqipja:

l i m a n

Duke zgjeruar Bisedën, vëmë ré se në Latinisht: "l i m e n" = *kufi, cak*, dhe është persëri, siç duket qartë, fjala Greqisht që po shqyrtojmë.

Në Latinisht gjithashtu: "l u m e n" = *dritë*. Dhe kështu pra atëhere del sipas gjuhës Latine se: "Drita (*lumen*) është kufiri (*limen*, dhe në një Latinishte arkaike, *lumen*) i Botës", gjë që siç dimë Teoria e Relativitetit e rikonfermon.

Duke e simbolizuar *Botën materiale* me " ● " dhe *shpejtësinë e Dritës* me " c ", mund të shkruajmë:

$$\bullet = < c$$

siç del nga Teoria e Relativitetit, po si del edhe nga Gjuha (Rromake), e cila pra e ka ditur këtë si edhe shumë të vërteta shkencore gjër të Kohës sonë.

Mund të shkruajmë:

$$> c = -F = E = -\bullet = \text{jo errësirë; jo materie; Frymë (} \textit{Spiritus})$$

Pra tejkalimi i "dritës einstianiane" do të realizonte kalimin nga Bota materiale, e pra e errët (●), në Botën Spirituale, e pra me Dritë të vërtetë (○).

Ne mund të shkruajmë në një trajtë më të përgjithësuar:

$$F = < c$$

që do të thotë: tërë kodi F, (duke kuptuar me këtë çdo interpretim të çdo rreze semantike të çdo figure simbolike në F) "kufizohet" nga Drita dhe shpejtësia e saj.*

Nga sa më sipër del edhe se:

$$E = - F = > c$$

dhe duke qenë se: $E = - \textcircled{D} = \textit{Parimi i papërcaktueshmërisë i Fizikës Kuantike, vetë kjo Fizikë...}$, ne kuptojmë, qoftë edhe vetëm nëpërmjet G j u h ë s, përse në këtë Fizikë (Kuantike) mund të ketë edhe shpejtësira shumë më të mëdha se ajo e dritës, siç ndodh në rastin e "entangled particles".**

Shtojmë së fundi se edhe Italishtja "l i m i t e" lidhet me Shqipen "l i m a n", etj. etj.

* Shih për të gjitha këto parashtrimin e shkurtër të Algoritmit Simbolik në fund të këtij studimi.

Vëmë re këtu gjithashtu se në Latinisht: "e l i m i n a t i o" = asgjësim, fjalë kjo që duhet zërthyer në "e l i m i n"... ku "e" rri për simbolin " - ", ndërsa "l i m i n" = kufi, e pra \textcircled{D} .

Pra e gjithë fjala Latine jep, e përkthyer në gjuhën e simboleve, - \textcircled{D} , e pra - \bullet = jo materie, jo Botë materiale.

Me fjalë të tjera, edhe vetë Gjuha na tregon se heqja (rënia) e kufirit, e pra e ndarjes, sjell me vehte fundin e "sendit" material e pra, duke përgjithësuar, të vetë Botës, të vetë Realitetit tonë fizik.

** Shiko fq.354 dhe 414.

609) Greq. $\lambda \iota \omega$ ($\lambda \iota \omega$), $\lambda \iota \sigma \omega$ ($\lambda \iota \sigma \omega$) = ingl. *loose, free; break up, destroy, solve* (ç-shtrëngoj, çliroj, çpërbëj, shkatërroj; zgjidh)

Është Shqipja:

l ë, l ë s h o j (liroj etj.)

Algoritmi Simbolik jep ndër të tjera:

$$\begin{array}{ccc}
 - \infty & = & - \bullet \quad \dots(E) \\
 \text{greq. } \lambda \iota \omega, \lambda \iota \sigma \omega & & \lambda \iota \omega, \lambda \iota \sigma \omega \\
 \text{(free)} & & \text{(destroy)}
 \end{array}$$

Kujtojmë lidhur me këtë ekuacion edhe atë sa lexojmë tek Cirlot mbi simbolin e nyjes (ingl. *The knot*):

"To undo the knot was equivalent to finding the Center."
 [Zgjidhja e nyjes barazohej dikur me gjetjen e Qendrës.]

Kjo do të shkruhej simbolikisht si:

$$\begin{array}{ccc}
 - \infty & = & (x = -x) \quad \dots(E) \\
 \text{undoing of the knot} & & \text{the Center}
 \end{array}$$

Vëmë re me këtë rast se në Inglisht: "u n d o" = 1) *zgjidh*, e pra $-\infty$, dhe 2) *zhbëj* (= ingl. " - do "), e pra $-\bullet$.

Inglishtja, si gjuhë, shtron edhe ajo ekuacionin e rëndësishëm simbolik që pamë më sipër:

$$\begin{array}{ccc}
 - \infty & = & - \bullet \quad \dots(E) \\
 \text{undo} & & \text{undo} \\
 \text{(zgjidh)} & & \text{(shkatërroj)}
 \end{array}$$

* Cirlot, fq.173.

Në qoftë se shumëzohjmë të dy anët e këtij ekuacioni me -1 , do të kemi:

$$\text{X} = \bullet \quad \dots(F)$$

Por, interpretimet e këtij ekuacioni janë të shumta në fusha të ndryshme të Realitetit dhe të Shkencës.

Le të shqyrtojmë shkurtas ndonjë prej tyre:

- Miti kozmogonik i "*Hieros Gamos*" (Martesës së Shenjtë).
- Relativiteti (X) i masës të një trupi (●) në Teorinë e Relativitetit.
- Krishti në Ungjill: "*Kush mëkaton (●) bëhet skllav (X) i mëkatit.*"*
- Inercia e një trupi (●) e shpjeguar si tërësia e bashkëveprimeve ($\sum X$) të atij trupi me të gjithë trupat e tjerë të Universit.

Etj. etj.

610) Greq. *metá-fimi* ($\mu\epsilon\tau\alpha\phi\eta\mu\iota$) = ingl. *speak among, converse with* (flas ndër..., bisedoj me...)

Motivimi:

me ta → shq. *me dà* = $\oplus = F = (|)$ (*among*)

fimi → shq. *them* (*to speak, to talk*)

Tërë fjala është pra, me Shqipen:

*ndër** - them*

dhe gjejmë kuptimin e "flas ndër..." (ingl. *speak among*).

* Gjoni, 8:34.

** Shq. *ndār* (ingl. *divided*) = $\oplus = F = (|)$ = shq. *ndër* (ingl. *among*)

Nga ana tjetër, me qenë se:

$$\textcircled{1} = F = \text{X} = \text{shq. me (ingl. with)}$$

Pra atëhere, përmes Shqipes dhe Algoritmit Simbolik, gjejmë edhe kuptimin e "flas me..." (ingl. *speaks with*).

Gjetëm kështu pra, me ndërmjetësinë e Shqipes dhe të Algoritmit (që mund të nxirret fare lehtë prej saj), të gjitha kuptimet e ndryshme të Greqishtes "m e t a-f i m i".

Në zgjerim të Bisedës le të theksojmë këtu edhe faktin, tashmë të njohur për ne, të alternimit të "th"-së me "f"-në. Mund të hipotetizohet se: "f" < "th", se me fjalë të tjera "th" është më primare dhe arkaike se sa "f".*

Duke zgjeruar edhe më tej Bisedën shtojmë se:

Greqishten "m e t à" (μ ε τ α) e gjejmë ndër të tjera edhe në Italisht me kuptimin e "gjysmës":

$$\text{it. m e t à} \rightarrow \text{shq. m e d à} = \textcircled{1} = 1/2 = F = \text{X} = \text{greq. m e t a}$$

Kemi formuluar kështu një ekuacion themelor ndërgjuhësor:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \text{X} & \dots(F) \\ \text{it. met\`a} & & \text{greq. meta} & \end{array}$$

Greqishten "m e t a" e gjejmë edhe në Gjermanisht, ku: "m i t" = *bashkë*, simb. X ... Kuptim ky që shpjegohet përsëri me Shqipen:

$$\text{m i t} \rightarrow \text{shq. m e d à} = \textcircled{1} = F = \text{X}$$

* Shih edhe fq. 477 dhe 491.

Atë e gjejmë edhe në Shqipen "me **m a t**", dhe kjo sepse çdo **m a t j e** presupozon një **n d a r j e**, e pra \oplus , e pra edhe $- \bigcirc =$ *jo e tëra, e mangëta, e meta*.*



Version i hershëm Sumerian i *Caduceum*-it

611) Ing. **p e a k** = maja

612) Ital. **p i c c o** = maja, kulmi

Lidhen të gjitha si me prejardhjen e tyre me Shqipen:

p i k ë (ital. *punto*)

Le të shpjegojmë tani përse ndodh kështu.

* Shqipja na meson "aforizmatikisht" se: "*Çdo matje është e metë*"...

Vërtetimi i këtij pohimi mund të bëhet në dy mënyra: 1) Nëpërmjet Fizikës Kuantike që na thotë se, në nivelin subatomik, nuk mund të ketë një matje të saktë (*Parimi i papërcaktueshmërisë* i Heisenberg-ut); 2) Nëpërmjet Algoritmit Simbolik, në të cilin:

m a t j a = *ndarje* = \oplus = $- \bigcirc$ = *jo e tëra* = *mangësi* = **e m e t ë**

Algoritmi Simbolik jep ekuacionin:

$$\bigcirc = \uparrow \dots(E)$$

" \bigcirc " është, ndër të tjera, simboli i Qëndrës Mistike, e pra $(x = -x)$.*

Por dimë se:

$$\text{Qëndra} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = \text{pi-ka}$$

Kujtojmë tani se "maja" paraqet një *ekstremum*. Dhe në matematikë për ekstremumim jepet:

$$dv / dt = 0$$

Por kjo do të thotë se: "Në majë: $v = 0$..., pra lëvizja ndal..."

Pikërisht ashtu si në Qëndër.

Në të dy rastet mund të shkruajmë:

$$-\sim = 0$$

Është lehtë nga ky ekuacion të nxjerrësh atë të Qëndrës, sepse do të kemi:

$$-\sim = 0 = E = (x = -x) = \text{Qëndra}$$

Rikonfermimet e kësaj që pohuam më lartë janë të shumta në Gjuhë.

Le të shqyrtojmë disa shembulla:

1) Në Inglisht:

$$\text{"u p"} = \uparrow \text{ (nga Shq. "h y p", sikundër edhe Greq. "e p i", \epsilon\pi\iota)}$$

Por "u p" do të thotë edhe "mbarimi", "përkryerja", "e mbara", "e Tëra", pra simb. \bigcirc , e pra akoma: $(x = -x) = \text{Qëndra}$.

* Parimi Suprem i Universit...

2) Në Greqisht:

"p a n o" (π ά ν ω) = *lart* = ↑

"p a n" (π α ν) = *tërësia* = ○

Pra dhe Greqishtja shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

○ = ↑ ... (E)
pan pano

3) Në Inglisht:

"s u m m i t" = *maja* = ↑

"s u m m a r y" = *përmbledhja, tërësia* = ○

Pra dhe Inglishtja shtron në mënyrën e vet të njejtin ekuacion:

○ = ↑
summary summit

4) Në Rusisht:

"v j e s" (весь) = *e tëra, të gjitha...*, e pra ○

"v i s" (выс) = *lartësi...*, e pra simb. ↑

5) Në Italisht:

"l a s o m m a" = *e tëra*, e pra ○

"s o m m i t à" = *maja*, e pra ↑

Etj. etj.

Ndër të tjera, ne treguam nëpërmjet zgjerimit të kësaj çështjeje, se të gjitha gjuhët, sado të ndryshme në dukje, ngrihen mbi një "Metagjuhë", që do të thotë mbi një Gjuhë të "padukshme" për një sy të zakonshëm, mbi një Gjuhë të "nëndheshme" e cila është e njejta për të gjitha. Në këtë tekst jepen jo pak shembuj që rikonfermojnë këtë tipar themelor të çdo gjuhe.

E thënë ndryshe:

**"Të gjitha gjuhët janë, në nivelin simbolik (Algoritmi Simbolik),
e njehta Gjuhë."***

613) Greq. $\lambda \mu \alpha$ (λ ι μ α) = ingl. *filth* (pisllëk)

Është Shqipja:

I l u m i

Duke zgjeruar Bisedën:

Shqipja është në gjendje të motivojë edhe Inglishten "**f i l t h**".

Në Shqip kemi: "i, e **f ë l l i q u r**" (ingl. *filthy*) = ● .

Në Shqip gjithashtu: "**f i l l i m**" = - 1 . Shqipja shtron kështu ekuacionin e rëndësishëm:

$$\begin{array}{ccccc} -1 & = & \bullet & & \dots(F) \\ \text{fillim} & & \text{fëlliqje} & & \end{array}$$

Mund të themi atëhere se:

"Bota materiale (●) ka filluar (- 1) me një fëlliqje (●)."

Ose, dhe ndryshe:

"Fillimi (- 1) i gjithshkaje është i fëlliqur (●)."

* Këtë çështje e kemi trajtuar edhe tek "*Shqipja dhe Sanskritishtja*", si edhe tek "*Libri i Aforizmave*". Atje pamë e vërtetuar se të gjitha gjuhët pa përjashtim (duke përfshirë këtu me termin "Gjuhë" edhe çdo fushë të Dijes), shtronin të njejtat ekuacione simbolike që përbënin kështu një *Invariant Ndërgjuhësor*.

Ky mendim mund të duket i pabesueshëm, por ay i konformohet plotësisht të thënës madhore, në mos po edhe hyjnore, të Paracelsus:

"Die Separatio is aller Geburt Anfang."

(Ndarja është fillimi i gjithshkaje.)

Kjo shkruhet, siç dimë, në gjuhën simbolike, si:

$$\begin{array}{ccc} -1 & = & \textcircled{1} & \dots(F) \\ \text{Anfang} & & \text{Separatio} & \end{array}$$

Por Algoritmi na jep gjithashtu:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{ndarje} & & \text{ndyrje} & \end{array}$$

Por *ndyrje* do të thotë pikërisht *fëlliqje*.

Pra vërtetë atëhere:

"Çdo fillim është i fëlliqur."

Saktësinë e këtij gjykimi mund ta rikonfermojmë edhe ndryshe:

Dimë se: $-1 = 2 = \bullet \dots(F)$

Rikujtojmë se relacioni $(2 = -1)$ jep $(3 = 0)$, e pra bazën e Arithmetikës Mistike. Dhe nga ana tjetër, numuri 2 është, nga të gjithë numurat, *më i poshtri, më i ligu, më i ndyri* etj. etj., siç lexohet bollshëm mbi këtë tek Cirlot.

Në Shqip gjithashtu, nga e njejta rrënjë, kemi: "f a l e m", "f a l i t e m" = ingl. *to fall*, e pra simb. ↓ .

Kështu Shqipja shtron ekuacionin simbolik, tashmë të stërnjohur:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{1} & = & \downarrow & \dots(F) \\ \text{felë} & & \text{fa lem} & \end{array}$$

E kështu me radhë... *

Por është e drejtë të vihet në dukje se edhe Inglishtja ka një repertuar të gjerë kuptimor të këtij operatori.

Kështu, bie fjala, në Inglisht:

"to follow" = 2 "to follow" = 2 "to fall (away)" = ⊕
 "filthy" = ● "to fall" = ↓ "to fall" = ↓

Etj. etj.

Vëmë re këtu se:

ingl. "filthy" < shq. "fëlliq"

Në Shqip:

⊕ = ● ...(F)
 felë fëlliq **

* Edhe Inglishtja "d o w n" shkon, nëpërmjet Shqipes, tek ky ekuacion, si edhe ndër shumë e shumë gjuhë të tjera edhe në Sanskritishten "u p a p a d" dhe Rusishten "p a d a t s" etj. etj.

** Shqipja e replikon këtë ekuacion edhe me:

⊕ = ● ...(F)
 ndarë ndyrje
 pjesë pis

Ndërsa Sanskritishtja e jep këtë ekuacion me biseminë e fjalës "m a t r a", sepse kemi:

⊕ = ●
 matra matra
 (matje) (materie)

një ekuacion ky themelor, nga i cili mund të bëhen të rrjedhin në një kohë të dytë gjithë të tjerët dhe që në Inglisht mungon.

614) Greq. **k i d h o** (κ ή δ ω) = ingl. *grieve, affliction, suffering...* (vuajtje, pikëllim...)

Motivimi bëhet me Shqipen:

k i d h o → shq. **k a d à** = ⊕ = **F** = ● = ↓

Zgjerohet tani Bisedën:

a) Gjithshka që krijohet, krijohet me një *ndarje* ("κηδω"), e pra atëhere edhe çdo krijim sjell me vete *vuajtje*...

Kjo del më qartë edhe në një sërë gjuhësh të tjera.

Bie fjala, në Rusisht: "**b e d a**" (беда) = *fatkeqësi, mjerim*. Mund të shkruajmë:

b e d a → shq. **b ë d à** = ⊕ = ↓ = ● ... (F)

Shihet qartë që strukturalisht: greq. "**k i d h o**" = rus. "**b e d a**", gjersa që të dyja reduktohen për motivim te **D A** (folja Shqip dhe Sanskritisht "d a j"). Pra theksi semantik nuk bie as në "b e-" as në "k i-".

Mirëpo dimë se çdo *krijim rrjedh nga një ndarje*, prandaj **D A** lidhet edhe me një *ndarje*, por edhe gjithashtu me një *krijim*...

Nga ana tjetër:

D A = ⊕ = ● = *Botë materiale, e keqja, "e zeza", fatkeqësia...*

Ja pra se si Gjuha dëshmon për faktin sa themelor, aq edhe tragjik, që krijimi i Botës lidhet me një krim.

- b) Në Shqip: "b d a j" = bëj (ingl. *to do*). Motivohet si (sikundër që dhe kemi parë) me: "b ë d à" = $\bigoplus = F = \bullet = \downarrow$. Pra *bërja* vështrohet si një *e keqe*, vështrohet si një *rënie* (miti kozmogonik i "The Fall"). Prandaj dhe në Shqip:

"Çdo *bërje* (\bullet) është një *bjerrje* (\downarrow)."

- c) Në Inglisht: "b a d" = *i keq*. Motivohet si: "b â d à" = $\bigoplus = F = \bullet$.
- ç) Në Inglisht: "d o w n" = *poshtë*. Motivimi jep:

d o w n \rightarrow shq. "d à b â n" = $\bigoplus = F = \downarrow$

Etj. etj.

Nga të gjitha këto shembulla e nga të tjera që mund të silleshin, del e qartë se *thelosi* semantik vihet kryesisht e pothuajse gjithmonë tek operatori "d a", pamvarësisht se ai mund të parandiqet nga gërma "k", apo "b",... e *kështu me radhë* (greq. k-*idhos*, rus. b-*eda*, shq. b-*daj*, ingl. b-*ad*...). Kjo *ndodh për arsye* se, siç na mëson i madhi Paracelsus: *Die Separatio*...

Që Bota ka lindur nga një ndarje, kjo del edhe nga miti Biblik i humbjes së Parajsës nga Adami dhe Eva kur ata mësuan (nëpërmjet "ngasjes" së Djallit) ta ndajnë të Mirën nga e Keqja. Ata realizuan kështu ekuacionin:

$$\bigcirc \neq \bullet \quad \dots(F)$$

e Mira e Keqja

E pra, duke përgjithësuar:

$$x \neq -x$$

e pra atëhere akoma:

$$-(x = -x)$$

dhe përfundimisht:

$$(x = x)$$

Por pamë e dimë se:

$$(x = x) = \downarrow \dots(F)$$

Ja pra atëhere përse ata *ranë* nga Parajsa...

Mund të themi edhe ndryshe, me atë që bënë – ata realizuan mitin kozmogonik të rënies:

$$E \downarrow = F$$

skemë, kjo e fundit, tek e cila mund të reduktohen të gjitha mitet kozmogonike pa përjashtim, duke na bindur në mënyrë të pakundërshtueshme kështu se *krijimi* lidhet kurdoherë me një *rënie*, e pra me një *krim*.

Kjo është edhe arsyeja përse në Shqip:

"Krymja nga një krim."

Kjo është edhe arsyeja që në Greqisht fjala "a i t i a" (α ι τ ι α) do të thotë në të njejtën kohë "shkak" (dhe është *shkaku i krijimit të Botës*, gjersa gjuha, siç dimë, emërton sipas një paradigme superlative, zanafilliore) dhe "faj" (it. *colpa*). Pra me krijimin e Botës është bërë një faj. Kjo është edhe arsyeja që në Féné e Krishterë flitet dogmatikisht për një mëkat në zanafillë, do me thënë në fillimin e krijimit të Botës (lat. *peccatum originalis*).

615) Greq. **k a t a** (κ α τ α) = ingl. *down, below; from...* (poshtë, ndën; nga...)

Me Shqipen:

$$k a t a \rightarrow \text{shq. } k a d à = \textcircled{\downarrow} = F = \downarrow \text{ (below)}$$

$$= 2 \text{ (sipas, pas)} = (\rightarrow \neq \leftarrow) \text{ (kundra)} = \dots$$

Kuptimet i kemi shpjeguar, përveç "nga"... Të tregojmë tani përse "k a t a" ka në Greqisht, ndër të tjera, edhe kuptim "*prej-ardhjes*".

Sipas Paracelsit gjithshka fillon me një *ndarje*... Pra *prej*-ardhja e gjithësisë dhe gjithshkaje tjetër në të, lidhet me një *ndarje*.

Por:

Do me thënë, kjo fjalë Greqisht merr kuptimin, nëpërmjet Shqipes, të "ndarjes", e pra atëhere të "p r e j-ardhjes" (ingl. f r o m).*

Shkojmë më tej:

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, siç kemi bërë e do bëjmë vazhdimisht për arsye që lexuesi mund e duhet ti kuptojë vetë, le të vërtetojmë ekuacionin simbolik:

$$\alpha = -1 \quad \dots(F)$$

n g a n g a

Pra, fjalë "n g a" në Shqip ka edhe kuptimin e *prejardhjes*, por edhe r, kuptim *negativ* të cilin, këtë të fundit, e gjejmë sot vetëm në një shtresë arkaike të Shqipes, që ka mbetur ende gjallë në të folmen e Arbëreshëve.

* Dhe është fjala natyrisht për "Ndarjen e Parë", m.q.s. Gjuha, siç e kemi thënë kaq e kaq herë, emërton sipas një paradigme parësore, primordiale, superlative. Pra është fjala këtu për *ndarjen* me të cilën Bota u krijua.

Le të shtojmë me këtë rast, si një zgjerim Bisede, edhe se në Hebraisht "k a d m o n" = *i pari*, fjalë që motivohet me Shqipen:

$$"i k a d ā m u n i" = \textcircled{1}$$

Pra dhe këtu, *fillimi* (parësia) jepet me një *ndarje*.

Edhe në Shqip *prej-ardhja* jepet me një *ndarje*, sepse vetë kjo fjalë mban si theks semantik pjesëzën "p r e j" që tregon "prejardhje", por edhe "prerje".

Në Inglisht "prejardhja" tregohet ndër të tjera me "f r o m", që nuk është gjë tjetër veçse Shqipja "p r e j a m" (e pra: *prejardhje*) ose edhe "(i) parë jam".

E njejta gjë ndodh edhe në Rusisht ku: "iz" (из) tregon *prejardhje*, si p.sh. "iz Moskvi" (nga Moska), dhe në të njejtën kohë *negativitet*, si në foljen "iz-viniats" (извинять) që do të thotë "me çfajshue", sepse "vina" (вина), po në Rusisht, do të thotë "faj".

Kështu që dhe Rusishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\alpha = -1 \quad \dots(F)$$

$$iz(из) \quad iz(из)$$

Këto shembuj nga gjuhë të ndryshme kanë për qëllim që të vënë në dukje:

Anallogjinë (në mos identitetin) e taktikave semantike (emërtonjëse) mes gjuhërave të ndryshme.

Nga të gjitha këto nxirret edhe diçka tjetër me rëndësi:

"Bota materiale (●) fillon me një negativitet, me një mohim (- 1)."

Kemi folur gjithashtu për *persistencën* e miteve kozmogonike. Pra, atëhere negativiteti i fillimit të Botës do të ruhet, që do të thotë që jo vetëm Bota në tërësi, por edhe gjithshka në të, nuk mund të fillojë veçse me një negativitet, me një mohim. Gjë që e bën vetë Botën negative a, e thënë ndryshe, të keqe ($-1 = \bullet = \text{Bota materiale, e keqja...}$).

Sipas Paracelsus: *"Die Separatio ist aller Geburt Anfang"...*

Pra, sipas tij, fillimi lidhet me një ndarje. Po sipas Algoritmit Simbolik kemi:

$$\textcircled{1} = F = -1$$

ndarje negativitet, mohim

Pra Paracelsusi i madh rikonfermon në mënyrën e tij pohimin tonë lidhur me *mohimin si fillim*.

Kujtojmë gjithashtu edhe vargjet nga "*Fausti*" i Goethes, kur Mefistofeli (*alias* Djalli) vetë-përcaktohet si:

*"Ich bin der Geist,
Der stets verneint..."*

(Unë jam Fryma
Që pa rreshtur *mohon...*)

Me fjalë të tjera, Mefistofeli paraqitet si "shpirti i mohimit"... Që këndeje del edhe, detyrimisht, se fillimi i Botës është punë e Djallit, ndaj pra dhe Bota sipas tërë Mendimit Mistik, është e keqe, gjë për të cilën ne kemi folur dhe gjetkë.*

616) Grëq. σκότος (σκότος) = errësirë, terr

Me Shqipjen:

k a d à = ⊖ = F = ●

617) Hebr. ב a d h (בד) = ingl. *separation* (ndarje)

Është Shqipja:

b a d h → shq. b a d à = ⊖

618) Hebr. b a c h á (בכה) = ingl. *to weep, to shed tears* (qaj, derdh lot)

Është Shqipja:

b â q à, b â k j à

Nga ana tjetër, në Shqip kemi:

q a j (to wail) e q e s h (to laugh)

* Shih lidhur me këtë edhe fq.27, 62, 243, 527 dhe 635.

Me fjalë të tjera, Shqipja shtron nëpërmjet këtij operatori ekuacionin simbolik:

$$(x = -x)$$

që është ay i Qëndrës Mistike, bash siç bënin dikur, në lashtësinë e thellë të Njerëzimit, edhe Egjiptianët, sipas gjuhëtarit të njohur gjerman Abel, të cituar nga psikologu dhe anthropologu e fillosofi i famshëm gjerman Otto Ranke.*

Hebraishtja "b a c c h a" nuk ka një partner kontradiktor (homonimik) sikundër Shqipja, pra dhe kemi të drejtë të shkruajmë:

hebr. "b a c c h a" < shq. "b â k j à"

Për sa i përket Inglishtes "w a i l", kjo vjen nga Shqipja "v a j", vajtoj... Në këtë trajtë Shqipen e gjejmë edhe tek Latinishtja te thirrma e dëshpëruar e Vercingetorix "v a e v i c t i" (= v a j me det të mundura). Ajo është e përhapur edhe në shumë e shumë gjuhë të tjera, si p.sh. bie fjala në Gjermanisht ku "w e i n e n" = me qa, qaj.

619) Hebr. b u z (ב ו ז) = ingl. to despise, to disdain, treat ëith contempt
(përbuz, nënvleftësoj, trajtoj me përbuzje)

Është Shqipja:

p ë r b u z

"p ë r-" mund të vështrohet si prostatike. Në Shqip ekzistojnë shprehje të tilla: "Pse i bën buzë kësaj gjelle?", shprehje këto që tregojnë se theksi semantik bie mbi rrënjën "b u z".

Edhe Inglishtja "d e s p i s e" mund të zbërthehet në:

d e s p i s e → shq. d y s h b u z = 2 . b u z = - b u z = përbuz...

* Shih edhe fq.260.

620) Hebr. **b h a k i r** (ב ה י ח ב) = ingl. *chosen, elect* (i zgjedhur)

Është Shqipja:

b â k r y

ku "k r y" rri për "k r y e" (p.sh. krye-tar).

621) Hebr. **b a k h i r** (ב כ ר י ה) = ingl. *first born* (fëmija i parë)

Motivohet me Shqipen:

b â k r y e

("b â k r é", "k r e-u", i paralinduri...)

622) Hebr. **b a t a l l** (ב ט ל) = ingl. *to cease, to rest* (ndaloj, pushoj)

Është Shqipja:

b ë (n) d a l

Duke zgjeruar Bisedën, vëmë ré se në Shqip fjala "**n g a d a l**", që mund ta tregojmë simbolikisht me " $\sim <$ ", e ka prejardhjen e saj nga fjala "**n d a l**" simbolikisht " $- \sim$ ". Dhe kjo për arsye se, siç dimë, Gjuha referon gjithmonë në një paradigmë superlative dhe kulmi i *ngadalësisë* është *ndalja*.

Le të shtojmë këtu me këtë rast edhe se Inglishtja: "**t o r e s t**" = *pushoj*, mund të motivohet me anë të Shqipes:

r e s t → shq. **r à â s h t**

(*âsht rât, ka pushū, po pushon...*)

623) Hebr. **k h a d a l** = ingl. *ceased, stopped* (që ka pushuar, që ka mbaruar...)

Do ndarë në:

k h a d a l

dhe me Shqipen:

k a (n) d a l

e pra simbolikisht:

- ~

624) Hebr. n i' d a r = ingl. *missing, absent* (që mungon...)

Është Shqipja:

i, e n d ā r

e pra: *që është i ndarë nga të tjerët, që mungon (ingl. missing) nga tërësia.*

625) Hebr. b a n á h (בנה) = ingl. *built, constructed* (ndërtuar)

Lidhet me Shqipen:

b a n, b a n a,
ban-esë, ban-oj, ban-or... etj. etj.

Përmendim këtu edhe Gjermanishten: "**b a u e n**" (*ndërtoj*) = shq. "**b ë j**",
në të folmen e Veriut: "**m e b â**".

626) Hebr. b i n y ā (בניה) = ingl. *building* (ndërtesë, "biná")

Shih më lartë, 21.

627) Hebr. b a k á r (בקר) = ingl. *to examine, to look after* (shqyrtoj,
kujdesem për...)

Motivohet me Shqipen:

b â k y r

Le të shtojmë këtu, si zgjerim Bisede, se edhe Inglishtja "**t o c a r e**", në kuptimin e *kujdesjes*, lidhet si me prejardhjen e saj me Shqipen "**m e k y r**".

Edhe Italishtja "s-c r u-t a r e" duhet të lidhet si me prejardhjen e saj, siç shihet fare qartë, me Shqipen "sh-q y r-toj".

628) Hebr. b a k a (בָּקַע) = ingl. *to cleave, to sever* (të ndash)

Është Shqipja:

$$b \hat{a} \text{ (sh)k y} = \text{simb. } \oplus$$

629) Hebr. b a s a (בָּטַע) = ingl. *cut off, bre-a k** (p r e s, thyej)

Duhet motivuar si:

$$b \hat{a} \text{ "S"} = \bigcirc^{**} = \oplus = \ominus \ominus \dots(F)$$

* Kjo fjalë, si shumë të tjera të Inglishtes, zberthet lehtë me anë të Shqipes: *tëksi semantik* bie mbi "b r e" që nuk është tjetër veçse Shqipja "m e p r é". Këtë operator e gjejmë të inkapsulluar edhe në Gjermanishten "b r e-c h e n", në "A u f- b r u c h" etj.

** Dhe kjo "S" nuk është tjetër veçse simboli i "S-erpens", me fjalë të tjera i *gjarpërit* që i mbush mendjen Adamit dhe Evës, kundra urdhërit të Zotit, të ndajnë, të dallojnë mes të Mirës (\bigcirc) dhe të Keqes (\bullet), gjë që do të jepej simbolikisht si:

$$\bigcirc \neq \bullet$$

E pra, duke përgjithësuar:

$$(x = -x)$$

e pra edhe:

$$(x = x)$$

duke realizuar kështu, skemën e çdo miti kozmogonik:

$$E(x = -x) \quad (\bigcirc)$$



$$F(x = x) \quad (\bullet)$$

630) Hebr. **k a d e l** (ל ד ל) = ingl. *ceasing; falling...* (që ndalon; që bie...)

Motivimi:

k a d e l → shq. **k a n-d a l, k a d a l ū** = ⊕ = **F** = ↓ (*falling*)

Ekuacioni (⊕ = ↓) është i përhapur në të gjitha gjuhët, siç e "zbulon" ndërhyrja motivuese e Shqipes.

Kështu për shembull në Sanskritisht:

a v a-p a d (अवपद्) → shq. **â b â : b â d à** = ⊕ = **F** = ↓ (*falling*)

po ashtu edhe:

u p a-p a d (उपपद्) → shq. **u b â : b â d à** = ⊕ = ↓ (*falling*)

Kështu edhe në Rusisht:

p a d a t s (падать) → shq. **b â d à** = ⊕ = ↓ = *me rà...*

Etj. etj.*

631) Hebr. **k e d e r** (כ ד ר) = ingl. *ap-part-ment* (apartament, e n d a r ë)

Motivohet me Shqipen:

k a d ā r = ⊕ = **F** = ⊖

Ky shembull flet qartë për ekzistencën e simbolit kinez *Yin-Yang* edhe në kulturat jo-kineze

* Rrënja e mirëfilltë këtu është "d a", por mos harrojmë se "d a t s" mund të vështrohet si pjesorja arkaike e foljes "me *dà*" në Shqip, e pra "d ā t". Në këtë mënyrë, reduktimi i Rusishtes në Shqip bëhet më i plotë.

632) Hebr. **a b a d h** (א ב ד א) = ingl. *cease* (ndaloj, ndërpres)

Është Shqipja:

$$\hat{a} \hat{b} \hat{a} \hat{d} \hat{a} = \textcircled{1}$$

633) Hebr. **b a d a** (א ב ד א) = ingl. *to invent (in an evil sense); to lie* (shpik, shpif; gënjej)

Motivimi me Shqipen:

$$\begin{aligned} b a d a &\rightarrow \text{shq. } \hat{b} \hat{a} \hat{d} \hat{a} = \text{D} \hat{a} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = -\textcircled{0} \\ &= -(\hat{a} = -x) = -\text{Qendra Mistike} = -\text{Zoti} = -\mathbf{e} \text{ Vërteta} = \text{gënjeshtër} \end{aligned}$$

634) Hebr. **a n a k a h** (א נ א כ א ה) = ingl. *sighing, complaint* (pshertitje, ankësë)

Lidhet me Shqipen:

$$a n k - o j, a n k - o h e m, e t j.$$

635) Hebr. **g a d a d** (ג ד א ד) = ingl. *to cut, to break, to fall upon* (pres, thyej, bie mbi...)

Me Shqipen:

$$g a d a d \rightarrow \text{shq. } k a d \hat{a} t^* = \textcircled{1} (\text{cut, break}) = \mathbf{F} = \downarrow (\text{fall upon...})$$

Le të vëmë ré këtu se edhe në Shqip:

$$r \hat{a} = \textcircled{1}$$

si në: "zhurma *rà*" në kuptimin u "ndër-pré", "ndaloi".

* Shih edhe fq.402, 629 dhe 649.

Dhe në të njëjtën kohë, përsëri në Shqip:

$r \grave{a} = \downarrow$

si në: "r \grave{a} mbi ta..." = i sulmoi (ingl. *to fall upon...*).

Kështu Shqipja shtron në këtë mënyrë ekuacionin simbolik:

$\textcircled{1} = \downarrow \dots(F)$
 $r a \quad r a$
 (ndër-prej) (sulmoj)

636) Hebr. $g a d d \grave{a}^*$ (גדג) = ingl. *goddess of fortune* (perëndeshë e fatit, ajo që i p r e t Njeriut fatin)

Zbërthehet me Shqipen:

$k a d \grave{a} = \text{simb. } \textcircled{1}$

Në të gjitha gjuhët koncepti i fatit lidhet me atë të *prerjes, pjesës, e pra simbolikisht me* $\textcircled{1}$. Le të marrim disa shembulla:

1) Ital. "f a t o" = *fati, risku*, lidhet me "f e t t a" = *copë, pjesë* = $\textcircled{1}$.

2) Ingl. "d e s t i n y"... do zbërthyer në: "d e s + t i n". Dhe me Shqipen:

$d y s h t a n a = - T a n a = - \textcircled{0} = \textcircled{1}$

* Në Hebraisht përforcimi i një bashkëtingëlloreje jepet shpesh here më një shenjë diakritike (shih origjinalin në alfabetin Hebraik).

Ky është dhe rasti i fjalës që po marrim në shqyrtim "gadda", ku dublikimi i "d"-së flet për një "d" të vetme, por të përforcuar. Kështu pra, mund të shkruajmë: "g a d d a" → "g a d a".

- 3) Rus. "d o l j a" (доля) = *fati*, dhe në të njejtën kohë *pjesa*, ⊕ . *
- 4) Rus. "u d j e l l" (удел) = *fati*, fjalë kjo që lidhet me foljen "d e l i t s" (делить) = *ndaj*.
- 5) Shq. r i s k u = *fati*, dhe njëkohësisht *pjesa*, e pra simb. ⊕ .
- Etj. etj.

Le të kujtojmë këtu edhe shprehjen: "Kur u ndanë, kaq na ranë", që e lidh edhe kjo konceptin e *fatit* me atë të *ndarjes* e të *prerjes*.

637) Hebr. ב ש ר a s a r (ב ש ר) = ingl. *to announce* (me shpall)

Mund të motivohet me Shqipen:

b â z ë r i ("b ë z a", "bëzamje"...)

Vërejmë se fjala e Shqipes "b ë z a" ekziston *talis qualis* edhe në Sanskritisht (e pamotivuar prej saj). Por, si Hebraishtja ashtu dhe Sanskritishtja, nuk e zotërojnë operatorin "z a" (z ë , z ë r i , z ā n i , ...) në gjendje të lirë. Kështu që, as njëra as tjetra nuk është në gjendje, me mjetet e saj leksikore, të kryejë motivimin e kësaj fjale.

638) Hebr. א ת ז א ח a k a z a h (א ת ז א ח) = ingl. *occupation, possession, property* (okupim, zënie, posedim, pronë)

Mund të motivohet me Shqipen:

â k a z ā (n)

Në Shqip gjithashtu "z a n i e" gjithpò me kuptimin e *okupimit*.

* Shih edhe fq.459 dhe 684.

Përveç kësaj, siç kemi parë dhe do të shohim, spektri semantik i operatorit të lirë të Shqipës "Z a" është shumë i pasur, i larmishëm dhe i inkapsulluar në shumë e shumë gjuhë të huaja.

639) Hebr. **o d h o t h** (א ד ת) = ingl. *cause* (shkak)

Është Shqipja:

$o d h o t h \rightarrow \text{shq. } \hat{a} d \bar{a} t = \textcircled{\ominus} = F = \leftrightarrow$ (ingl. *cause*)

Rikujtojmë këtu se në Shqip:

$n d a j = \textcircled{\ominus} = F = \leftrightarrow$

Pra, theksi semantik këtu bie tek operatori i *ndarjes*, që është në Shqip "d a j", kurse në Hebraisht "d a t", e pra e njejtë rrënjë.

Që kauzaliteti lidhet ngushtë me ndarjen, këtë e kemi gjetur e kemi parë në suazën e një "*Consentio linguarum*" në shumë gjuhë të tjera, si në Sanskritisht: "a r t h a" / "a r d h a", Italisht: "m e t a" / "m o t i v o", Shqip: "p j e s ë" / "p a s i", Gjermanisht: "H a l b" / "d e s h a l b", etj. etj.*

640) Hebr. **ō r** (א ר) = ingl. *light, brightness, sunlight, daylight; gold* (dritë, ndriçim, dritë diellore, ditë; ar)

Është Shqipja:

A r

një operator i lirë ky në Shqip, por edhe i inkapsulluar në fjalë të ndryshme, si të Shqipës, ashtu edhe të huaja, e pra si i tillë shumë produktiv në gjuhën tonë.

* Shiko edhe fq.51, 469 dhe 612.

Jo vetëm kaq, por spektri semantik i operatorit "A r" në Shqip është mjaft i pasur e i larmishëm, gjë që rikonfirmon përsëri ato sa u pohuan më sipër.

Kështu për shembull, operatori "A r" në Shqip ka dhe kuptimin e *parimit mashkullor*, kuptim ky themelor për antikitetin e thellë.*

Në Shqip:

"A r j u n" = mashkull, burrë (si përfaqësues i parimit mashkullor)

Në Shqip (në të folmen e Arbëreshëve) gjithashtu:

"A r i" = dhëndri; mashkulli

Në Shqip gjithashtu, mbaresa "-a r" (si p.sh. *fshat-ar, det-ar, farkët-ar*), që tregon agjentin aktiv të një veprimi, nuk është tjetër veçse, përsëri, operatori (i inkapsulluar) i Shqipes "A r".

Të gjitha këto, e të tjera që mund të shtojmë, do mund të rikonfermonin epërsinë absolute të prejardhjes nga Shqipja të këtij operatori.

641) Hebr. $\bar{u} r$ (א ר) = ingl. *lighted country, land of the sunrise* (vend i ndriçuar, vendi i lindjes së diellit)

Lidhet me Shqipen:

A R

Në Hebraisht kjo fjalë do të thotë edhe "*the East*" (O r i e n t i) dhe është prapë operatori "A r", kryesisht i Shqipes.

Edhe fjala vetë fjala "O r i g j i n ë" (lat. *Originis*) përmban operatorin Shqiptar "A r", gjë që dëshmon pra, prap e prap, për faktin se Ari përbën parimin nga i cili të gjitha rrjedhin dhe tek i cili të gjitha përfundojnë.

* Shih lidhur me këtë edhe fq.151 dhe 768.

Në Shqip: "**A r b a n a**" = "B a n a e A r i t", "Banesa e Arit", dhe është "**A r b ë n i a**" dhe, me një kalim të "n"-së në "r" (siç ndodh rëndom gjatë kalimit nga Veriu në Jug), kjo është fjala "**A r b ë r i a**" dhe, me një kalim të "r"-së në "l" (që të dyja bashkëtingëllore "likuide" e pra, si të tilla, që kalojnë fare lehtë tek njëra-tjetra), kemi fjalën "**A l b a n i a**".

Pra, ky qe një shembull i shkurtër i produktivitetit i operatorit "A r" në gjuhën Shqipe.

Duke patur parasysh se "**A r i**", që përputhet me *Parimin Suprem të Universit*, lidhet me *fillimin* dhe *fundin* e gjithshkaje, del se edhe tek Gjermanishtja "**e r**", një prefiks ky që flet për përfundimin e një veprimi (si për shembull në fjalën "er-füllen" = *përmbush plotësisht*, apo në fjalën "er-reichen" = sanskr. "a r i j" = shq. "a r r i j"), ne duhet të shikojmë, përsëri e përsëri, operatorin Shqiptar "A r", disi herë-herë edhe të "përçudnuar" për qëllime integrimi dhe fshehje të huazimit. Në Gjermanisht e gjejmë këtë operator edhe si sufiks të prejardhjes, të zanafillës, të një sendi apo të një veprimi, si p.sh. në fjalët "**U r**-zeit" (= *koha e hershme*) dhe "**U r**-sprache" (= *gjuha e parë*). Siç shikojmë, ky operator ka gjithmonë kuptimine e "parësisë", të "absolutist", të "fundit" (që përputhet me "fillimin"), e kështu me radhë...

Mund të zgjateshim shumë mbi këtë çështje, që nuk është e parëndësishme, por po e lëmë me kaq...

642) Hebr. a n i (אני) = ingl. *I*, ital. *io*, rus. *ja* (я), gjerm. *ich*...

Është Shqipja:

u n, u n i...

643) Hebr. a n i j a h (אניה) = ingl. *ship*

Është Shqipja:

a n i j a

644) Hebr. **a s i r** (a s s i r) (א ס י ר) = ingl. *prisoner, captive, exiled*
(rob, i burgosur, i internuar)

Motivohet me Shqipen:

â z u r i

e pra me foljen Shqip "z ë", "z u r i", etj.

Edhe Latinishtja "**c a p t i v u s**" zërthehet me Shqipen "**k a p**" (= zë..., bëj rob...).

Le të vëmë ré këtu edhe një gjë tjetër:

Në Italisht "**c a t t i v o**" do të thotë *i keq*, ndërsa "**c a p t i v o**" do të thotë *i kapur, i robëruar*. Kështu që Italishtja, nëpërmjet Shqipes, shtron ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \infty & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{captive} & & \text{cattivo}^* \end{array}$$

645) Hebr. **b a d á l** (ב ד ל) = ingl. *to separate oneself, to be separated*
(ndahem, veçohem)

Motivohet me Shqipen:

b â d a l l ú = ⊕

Shtojmë këtu se këtë operator e gjejmë edhe në Rusisht, ku: "**d e l i t s**"
(делить) = *ndaj, dalloj*

Vëmë ré më këtë rast se Shqipja, me:

dalloj (ingl. *distinguish*) dhe **dal** (ingl. *go out*)

* Ky ekuacion ka një sërë interpretimesh të rëndësishme në fusha të ndryshme të Dijes dhe të Realitetit. (shih lidhur me këtë edhe fq.840-841)

flet për një të vërtetë të thellë, që mund të formulohet në një mënyrë aforizmatike edhe kështu:

*"Shka dallohet, del."**

Por "dalja" është "*Exit*", e pra mundësia e "ekzistencës" (lat. *Existencia*).**

Kështu:

$$\text{Ekzistenca} = \textcircled{1} \dots(F)$$

Dhe jemi në kodin F... Pra "d a l l i m i", që lejon "d a l j e n", është kusht i domosdoshëm i "ekzistencës".

Nga ana tjetër, dimë se:

$$\begin{aligned} \text{Dallimi} &= \textcircled{1} = F = (x = x) = \text{Arsyeja} \\ &= \text{Parimi i identitetit, i moskontradikcionit...} \end{aligned}$$

Na thuhet (Schopenhauer, ndër të tjerë) se: "*Asgjë nuk mund të ekzistojë pa kënaqur parimin e moskontradikcionit*".

Kjo do të thotë se:

$$\begin{array}{ccccc} - \textcircled{1} & = & - (x = x) & = & - \bullet \\ \text{mosdallimi} & & \text{jo parimi i} & & \text{mosmaterializim,} \\ & & \text{moskontradikcionit} & & \text{jo ekzistencë} \end{array}$$

Pra: D a l l i m i është kusht i domosdoshëm që një "*quid*" të mund të ekzistojë... Siç rikonfermon dhe Paracelsus: "*Die Separatio ist aller Geburt Anfang...*"

* Shih ndër të tjera tek "*Libri i Aforizmave*", fq.351.

** Nga Latinishtja "e x i t". Dhe kemi në këtë gjuhë gjithashtu: "e x i s t e r e" = 1) shquhem, dukem (ingl. *stand forth, appear*), si edhe 2) ekzistoj, jam (ingl. *exist, be*).

646) Hebr. **m a v d e l** (מַבְדִּיל) = ingl. *to sever, to divide, to distinguish*
(ndaj, veçoj, dalloj)

Motivohet me Shqipen:

m e b â d a l l ú = ⊕

Le të vëmë ré këtu se edhe Hebraishtja, po ashtu si Shqipja, e formon në shumë raste paskajoren me parafjalën prostatike "m a", në Shqip "m e"

647) Hebr. **b a m a** = ingl. *height, elevation, hill* (lartësi, kodër)

Zbërthehet me Shqipen:

b â m a - j ë

që simbolikisht do të mund të paraqitet si " ^ " .

Krenjën "m a" e gjejmë edhe në Sanskritisht, si edhe në gjuhë që kanë rrjedhur prej saj a (ç'është njëlloj) prej Shqipes. Kështu për shembull, në Italisht: "m a - e s t á" (*titull mbretëror*); "m a - e s t - o s o" (*i madhërishtëm*). Në Shqip gjithashtu: "m a i bukuri", "m a i dashtuni"... flet për një superlatif, që ekziston *talis qualis* edhe në gjuhën Sanskritishte (e marrë sigurisht nga Shqipja).*

648) Hebr. **b a ' a d** (בְּאֵד) = ingl. *interval, distance, behind, after, through, around, among* (interval, distancë, pas, përmes, rreth, ndër...)

Motivimi me anë të Shqipes jep:

b a d à = ⊕ = F = (A.....B) = 2 = (↑) = ⊙ = (|)
interval distance after through around among

* Shih fq.570.

Kështu ne arritëm të shpjegojmë të gjitha kuptimet e kësaj fjale Hebraisht, falë Algoritmit Simbolik dhe Shqipes.

649) Hebr. g ā d h a' (צ ד ג) = ingl. to cut; to hew down, to fell
(pres; rrëzoj)...

Motivimi bëhet me Shqipen:

$g a d h a \rightarrow \text{shq. } k a d à = \textcircled{D} = F = \downarrow$ (rrëzoj, shemb)

650) Hebr. g u d h (ד ו ג) = ingl. to break; to fall upon, to attack (thyej;
bie mbi..., sulmoj)

Zbërthimi me Shqipen jep:

$g u d h \rightarrow \text{shq. } k a d à = \textcircled{D}$ (thyej) = $F = \downarrow$ (bie rà mbi...)*

651) Hebr. g u f a' (ה פ ג) = ingl. body, corpse (trupi, kufoma)

Lidhet me Shqipen:

k u f - o m a

Në Shqip gjithashtu "k u f – k o", thuhet për diçka që është bosh brenda (p.sh. një arrë *kufko*). Edhe fjala "kufomë" presupozon trupin pa Shpirt, pra b o sh, "kufko".

Ndoshta këtu lidhet edhe Inglishtja "c o f f i n" (në Shqip: *qefini*).

* Lidhur me Hebraishten "g u d h", që ka në të njëjtën kohë edhe kuptimin e "rënies", edhe atë të "sulmit", mund të themi e njëjta gjë ndodh edhe me Shqipen "rà" që do të thotë në të njëjtën kohë "bie" (rrëxohem) dhe "sulmoj" (p.sh. "rà mbi ta..." = i sulmoi).

652) Hebr. **g a m a r** (ג מ ר) = ingl. *cease; disappear, vanish; finish, accomplish* (pushoj, mbaroj; zhdukem; përfundoj, realizoj, plotësoj)

Motivimi me Shqipen:

$$k a m a r \grave{u} = \bigcirc$$

si pjesore e shkuar e foljes "m a r o j", ose me epentezë "m-b-a r o j". Trajta me epentezë duket se është më e vonshme se ajo pa epentezë, që vështrohet si dialektale (e folmja e Tiranës), e pra sekondare.

Edhe këtu kemi në Hebraisht prostazën "g a-", që është e identifikueshme me Shqipen "k a", nga folja "me pasë" (ingl. *to have*)

Siç shikojmë Hebraishtja "g a m a r" shtron, me ndihmën e Shqipes, këtë **varg ekuivalencash** të rëndësishme simbolike:

$$- \sim = - \bullet = \bigcirc \quad \dots(E)$$

(cease) (disappear) (accomplish)

Algoritmi Simbolik jep:

$$\bigcirc = E = i$$

Që këndeje del se:

Mbarimi, fundi, përsosja... lidhet me një trashendencë dhe mund të kapet si e tillë vetëm me anë të Imagjnatës (*i*).

Shqipja e jep fare bukur këtë situatë edhe me:

$$P \grave{e} r s o s j a = S o s j a$$

653) Hebr. **g a m a l** (ג מ ל) = ingl. *to accomplish* (përfundoj, kryej)

Motivimi:

$$g a m a l \rightarrow \text{shq. } k a m y l l = \bigcirc$$

Dimë se simboli i fundit është, ndër të tjera, edhe ay i kryerjes së plotë, i mbarimit, i të mbarës, i të tërës, i të plotës, i të përsosurës... e kështu me radhë.

E "përçquam" kështu fjalën Hebraisht "g a m a l" tek simboli që ajo, në mënyrë ndofta të pavetëdijshme, përshkruan.

654) Hebr. **g e b u r á h** (גבורה) = ingl. *strength, power, force, valour, courage, victory* (fuqi, forcë, pushtet, trimëri, kurajo, fitore)

655) Hebr. **g i b o r** (גבר) = ingl. *to be or to become strong and mighty* (të jesh apo të bëhesh i fortë dhe i fuqishëm)

Është Shqipja:

k a b u r r (burr-ni,...)

656) Hebr. **d a b a r** (דבר) = ingl. *word, speech, saying; thing; cause; occurrence; law-suit* (fjalë, fjalim, e thënë; send; shkak; ndodhje; davà)

Duhet ndarë në:

d a b a r

dhe me Shqipen:

b è r d à = ⊕ = ● = ↓ = ↔ = (→≠←) ... (F)
*word thing occurrence cause law-suit**

Që "Fjala" (ingl. *word*) mund të paraqitet simbolikisht me simbolin e *ndarjes* (⊕), këtë e rikonfermon ndër gjuhë të tjera edhe Shqipja, ku:

f e l ë = ⊕ dhe **F j a l ë**

* Shiko edhe fq.106.

Pra, edhe në Shqip, "fjala" ekuivalentizohet me operatorin e "ndarjes", e pra simb. $\textcircled{1}$, që është edhe ai i "bërjes", me qenë se: $\textcircled{1} = \bullet \dots(F)$.

Madje edhe në Frengjisht kemi diçka të tillë, me:

moitié (*gjysma*, e pra $\textcircled{1}$) dhe **Mot** (*fjala*)

Vëmë ré pra, ndër të tjera, se sipas Mendimit Hebraik (sipas Biblës, *Gjenezës*), ashtu sikundër dhe sipas vizionit të Krishterë të Universit, Bota është krijuar nëpërmjet Fjalës, sikurse çdo send në të...*

Që këndeje edhe Fjala si *shkaku* (ingl. *cause*), simb. \leftrightarrow , i krijimit të **Botës**, siç pamë edhe më sipër.

Kjo është arsyeja pra, po e përsërisim, përse në gjuhën Hebraishte përdoret e njëjta fjalë për të treguar "fjalën" dhe "sendin".

Po kete rikonfermon në rrafshin gjuhësor, qoftë Inglishtja, ku:

think = *mendoj*

thing = *send*

qoftë edhe Gjermanishtja, ku:

denken = *mendoj*

Dinge = *send*

Shtojmë më në fund këtu se edhe në Inglisht mund të kemi ndoshta gjithashtu: "**w o r l d**" (*bota*) < "**w o r d**" (*fjala*).*

* Gjeneza (1-3): "*In principio erat Verbum et Verbum erat apud Deum et Deus erat Verbum... omnia per ipsum facta sunt et sine ipso factum est nihil quod factum est...*"

657) Hebr. **d i m y o n** (ד י מ י ן) = ingl. *resemblance, image* (ngjashmëri, imazh, përfytyrim)

658) Hebr. **d e m u t h** (ד מ ו ת) = ingl. *likeness, resemblance; image, model, shape* (ngjashmëri; përfytyrim, model, formë...)

Që të dyja këto fjalë shpjegohen me operatorin Shqiptar:

d ā m

"-y o n" dhe "-u t h" janë thjesht prapashtesa, të cilat nuk na intereson tani ti zbërthejmë, sepse nuk mbartin kurrfarë theksi semantik.

Të shpjegojmë tani përse "damja" lidhet me "ngjamjen" (*ngjashmërinë*).

Arsyet janë:

1) Në Shqip:

$$g j y s \ddot{e} m = 1/2 = \oplus (d a m - j a)$$

$$g j a s \ddot{e} = \bullet (n d o d h j a)$$

$$g j a s i m = \approx (n g j a s h m \ddot{e} r i)$$

Rrjedh që këndeju ekuacioni simbolik:

$$\approx = 1/2 = \bullet \quad \dots(F)$$

gjasim gjysëm gjasë

Ja pra përse në dimensionin gjuhësor vërtetohet, ndër të tjera, se "ngjasimi" lidhet me një "gjysmim".

* Por siç ka arritur në përfundim Shkenca moderne e Gjuhësisë, *Fjala* dhe *Mendimi* duhen vështruar tashmë si e njejta gjë... Në qarqet e larta zyrtare të Gjuhësisë e të Fillosofisë thuhet "*It's the turn of Linguistics...*", që flet pikërisht për "Martesën e Shenjtë" mes Gjuhës e Mendimit.

- 2) Në rastin e Rusishtes, "*Consentio linguarum*" na jep: "p a d o b n o s t" (подобность) = *ngjashmëri*, që zbërthehet në "p a d o b n o s t", dhe me Shqipen: "b â d à : b â n â s h t" → d a = ⊕ = 1/2 ...^(F)*

Pra, edhe Rusishtja pozon, me ndihmën e Shqipes:

$$\approx = 1/2 \quad \dots(F)$$

rus. padobnost shq. dà ban âsht

Pra atëhere edhe në Rusisht *ngjash*-mëria vështrohet si një ndarje, si një *gjys*-ëm.

- 3) Në vazhdim të "*Consensio linguarum*" le të marrim këtu edhe rastin e *Latinishtes* në të cilën:

"s i m i l i s" = *ingjashëm*

"s e m i s" = *gjysëm*

Mund të shkruajmë atëhere pra:

$$\approx = 1/2$$

similis semis

Le ta zgjerojmë Bisedën:

- a) Dimë që numuri i Njeriut është 5.**

Por mund të shkruajmë:

$$5 = 1/2$$

* Shih edhe fq.382.

** Cirlot (fq.270): "*Traditionally, the number five symbolizes man after the fall...*" (Sipas traditës pesa simbolizon njeriun pas rënies...)

e pra atëhere:

$$5 = 1/2 = \approx \dots(F)$$

Del pyetja: *Pesa është e ngjashme me kë?*

Me qenë se ($5 = 1/2$), dhe me qenë se ($1/2 = \approx 1$), p e s a do të jetë atëhere e ngjashme me N j ë s h i n (1).

Pra mund të shkruajmë:

$$5 = \approx 1$$

Mund të shkruajmë atëhere edhe se:

"Njeriu (5) është i ngjashëm (\approx) me Zotin (1)"

Kuptojmë atëhere përse në Bibël thuhet:

"Zoti e krijoi njeriun pas shëmbëlltyrës së tij..."

S'do harruar se i ngjashëm nuk do të thotë i barabartë, nuk do të thotë identik. Prandaj dhe njeriu është *vetëm* i ngjashëm me Zotin, por jo i barabartë me të.

b) Dimë se: $5 = 1/2 = 2$.

Tek Cirlot, Schneider flet për rëndësinë e simbolizmës së dyshit (2), që sipas tij (dhe sipas nesh) përshkon tërë Realitetin Material (gjersa siç dimë përfshihet në kodin F).

Lidhur me këtë kujtojmë ndër të tjera: *"The number two is the first nucleus of matter..."* [Dyshi... simbolizon gjithashtu bërthamën e parë të materies...] **

* *"Dieu crea l'homme a son image..."*

** Shih edhe fq.11-13, 245, 312, 525 dhe 675.

Prandaj pra, çdo gjë që është materiale lidhet me numurin 2, i cili është më ogursezi, më i keqj,... nga çdo numur tjetër, gjë që na lejon të shkruajmë:

$$2 = \bullet \quad \dots(F)$$

**e keqja, djalli,
materia**

Gjithmonë sipas Schneider-it, tek Cirlot: "...the eternal duality of Nature means that *no phenomenon can ever represent a complete reality, but only one half of a reality...*" [...dualiteti i përjetshëm i Natyrës na jep të kuptojmë se asnjë fenomen nuk mund të paraqesë një realitet të plotë, por vetëm një gjysëm realiteti.]

Mund të shkruajmë pra:

$$\text{fenomeni} = \textcircled{1} = 1/2$$

E pra në bazë të atyre që pamë më sipër:

$$\text{fenomeni} = \approx \textcircled{}$$

Fjala "fenomen" (φαινόμενο) do të thotë në Greqisht *dukuri, ngjashmëri*. Pra, ekuivalenca simbolike e mësipërme është e saktë.

659) Sanskr. **g o m e d h a** (गोमेध) = fr. *sacrifice d'une vache* (sakrifikimi si kurban i një lope)

Motivimi me Shqipen jep:

g o m e d h a

e pra:

k a (u) m e d à

* Shiko edhe fq.197, 206-207, 430 dhe 680.

Do me thënë:

"ndarja (therrja) e kaut"

Shtojmë këtu se koncepti i "kaut" dhe ai i "lopës" alternojnë shpesh njëri-tjetrin, si në Sanskritisht, ashtu edhe në gjuhë të tjera.

Le të kujtojmë gjithashtu se mund të shkruajmë:

$kau < kavi \lesseqgtr go-vi$

Në Shqip, siç kemi parë: "m e **kuvet**" < "kavi".*

660) Sanskr. **g a r i-m a n**, **g u r u-m a n** (गरिमन्) = fr. *poide, lourdeur, importance* (peshë, rëndesë, rëndësi)

Theksi semantik bie tek: "g a r i" < "g u r u".

Lidhet me Shqipen:

gur**

që mungon si trajtë e pastër në Sanskritisht.

661) Sanskr. **k ṛ t** (कृत्) = fr. *couper, diviser...* (pres, ndaj...)

Është Shqipja:

sh - k u r t - o j = simb. ⊕

Tek ky operator i Shqipes lidhen edhe Gjermanishtja "**k u r - t z**" (i shkurtër), Italishtja "**c o r - t o**" (i shkurtër) etj.

* Shiko edhe fq.101, 242 dhe 568.

** Shih fq.150 dhe 53, 122, 476 dhe 570.

662) Sanskr. कर्त, कर्तति (कर्तति) = fr. *qui fait, qui accomplit, qui execute; auteur et exécutant* (që bën, që përkryen, që ekzekuton; autor dhe ekzekutues...)

Është Shqipja:

kryj, kryt,... etj. etj.

Si Sanskritishtja ashtu dhe Shqipja shtrojnë me këtë bisemi interesante e të rëndësishme ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

sanskr. कर्त	कर्त
shq. shkurt	kryt

Ky ekuacion tregon se bërja, kryerja kërkon një shkurtim, një prerje..., një krim.

Rikujtojmë kështu aforizmën e Shqipes:

"Nga krimi, krymja."

Sanskritishtja dhe Shqipja na bëjnë të ditur, e thënë ndryshe, se duhet, për krijimin e Botës, një Sakrificë Kozmogonike.

Sanskritishtja dhe Shqipja dëshmojnë në mënyrën e tyre për saktësinë e të thënës së artë të Paracelsus-it të madh:

"Die Separatio ist aller Geburt Anfang."

që transkribohet njëjloj si ekuacionet tona të mësipërme:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

* Shih Cirlot, *Cosmogonic Sacrifice* (fq.64).

Po në gjuhën Sanskrite kemi, siç kemi parë: *

$$\textcircled{\ominus} = \bullet$$

matra matra
(matja) (materia)

Fizika Moderne arrin teorikisht e eksperimentalisht në këtë përfundim kaq mijëra-vjeçar. Archibald Wheeler thotë:

"We live in a *participatory* Universe" ... **

Gjë që do të thotë që, në krijimin e realitetit material, ne nuk jemi indiferentë, pasivë, por përkundrazi, aktivë, gjersa sipas tij dhe sipas tërë Fizikës Kuantike, është nëpërmjet *matjes* që realizohet kolapsi i valës të Schroedinger-it, që *materia* dhe tërë *Bota materiale* krijohet. ***

663) Hebr. *g e r e m* (ג ר מ) = ingl. *bone; body* (âsht; trup)

Lidhet me Shqipen:

k u r m i

664) Hebr. *b a d a d* (ב ד ל) = ingl. *to be separated* (të ndahesh)

Motivimi me Shqipen:

b a d a d → shq. *b â d â t* = $\textcircled{\ominus}$ = ...

* Shih edhe fq.427 dhe 485.

** Shih edhe fq.647 dhe 821.

*** Shih edhe fq.161.

Rikujtojmë këtu se pjesorja e kaluar e Shqipes, gjer diku arkaike, ka qenë me prapashtesën "-ā t", si p.sh. "l ā t" (i la-rë), "t h ā t" (i tha-rë).*

* Kujtojmë këtu ndër të tjera nga "Libri i Aforizmave" se:

$$\text{Ar} = 1$$

por edhe:

$$\text{At (Zoti)} = 1$$

Sufiksimi me "-ar" ose me "-at" është atëhere e njejta gjë. Mund të shtojmë këtu natyrisht edhe sufiksimin me "-al" ($Al = Ar$, si për shembull në *Albania* dhe *Arbëria*), dhe si një allotropizëm të "-al" edhe "-ul", "-el", "-il"... e kështu me radhë, gjithmonë me kuptimin e Hyjnisë.

Një përvënje të tillë të nyjes e gjejmë edhe në shumë gjuhë të tjera, si bie fjala në Romanisht, në trajtën *-ul*, si p.sh. *director-ul* = drejtori. Në Latinisht kemi *il* që nga edhe Italishtja *il* si "articolo determinativo maschile" (nyje e shquar mashkullore). Në të gjitha këto raste është fjala për Shqipen "y III" = ingl. *star* (= shq. *është ar*) që, siç lexojmë tek Cirlot, simbolizonte Qëndrën e pra Zotin. Në Hebraisht dhe Arabisht kemi "El" që rri për Zotin dhe shërben edhe si nyje e shquar mashkullore.

Tani një shpjegim tjetër: Gjuha ndërtohet duke u nisur nga Qendra siç dimë. Por: Qendra është *Ati, Ari... = 1 = ○ = e Tëra*. Por: ○ = *Infinit* (hebr. *Ein Sof*, אֵין סוֹף). Edhe sipas Misticizmit Hebraik, Zoti është *Infinit* dhe, si i tillë, nuk mund ta krijojë Botën. Duhet, për këtë, që të "tkurret", të "kontraktohet" (hebr. *Tzimtzum*, צִמְצוּם), gjë që neve do ta shfaqim me gjuhën tonë simbolike si:

$$\boxed{\bigcirc} = \textcircled{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

Me fjalë të tjera, energjia kolosale, potenciale e Hyjnisë duhej (gjithmon sipas misticizmit Hebraik, Luras etj.) të modifikohet. Ka një numur të pa-fund modifikimesh dhe çdo modifikim paraqet në rrafshin gjuhësor një fjalë. Pra, në të djathtë të fjalës kemi paraqitjen shkrimore të Hyjnisë ("-at", "-ar"), kurse në të majtë kemi modifikimin, kufizimin, "tkurrjen" (që mund të jetë e larmishme) të Tij.

Shohim se të njejtën gjë kemi edhe në gjuhën Hebraike, ku sufksi i pjesores së shkuar është "-ad" dhe, duke "d" dhe "t" që të dyja dentale, mund të nxirret si përfundim identiteti i të dyja këtyre prapashtesave pjesoreformuese.

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë se në Shqip gjejmë të zbatuar të njejtën strategji semantike në fjalën "v e ç" (ingl. *separately, with the exception of...*), që motivohet brenda Shqipes si:

$$v e \check{c} \rightarrow \text{shq. } b \check{e} \check{c} a = \textcircled{1}$$

Operatorin e lirë të Shqipes "ç" e gjejmë të inkapsulluar (të ndërkallur) edhe në shumë gjuhë të tjera.

Kështu për shembull në Rusisht:

"ç a s t" (часть) = pjesë, dhe është Shqipja: "ç á â s h t" = simb. $\textcircled{1}$

Po përsëri në Rusisht:

"s ç a s t j e" (счастье) = fat; risk = simb. $\textcircled{1}^*$

"s ç a s t l i v i" (счастливый) = me fat (njeri etj.)

"ç a s t o" (часто) = shpesh

"ç a s t o t a" (частота) = shpeshtësi, frekuencë

"ç u s t v o" (чувство) = ndjenjë

Prandaj dhe këtu ne barazojmë nga ana kompozicionale (e përbërjes, e ndërtimit të fjalës) *tharë* me *thatë*. Mund të mendojmë edhe duke u mbështetur në një numur shumë të madh shembujsh, se tëra fjala (çdo fjalë) mbahet tek një gjermë e alfabetit. Kështu që, fundja më në fund, rrënja e fundme, intime e çdo fjale do të qe mbase vetëm një gjermë e alfabetit.

* Shih ndër të tjera edhe fq.74, 459 dhe 565.

Le të shtojmë këtu edhe një fjalë tjetër të Rusishtes ku zbatohet e njejta strategji semantike për të cilën folëm më lartë:

"vjeçer" (вечер) = *mbrëmje*

dhe me Shqipen:

vje çer → shq. b e ç a r = ⊕ = F = ● (*mbrëmje, natë*)

Vëmë ré se *ndjenjat* pra lidhen me një *ndarje*, siç nxjerrim si përfundim qoftë nga Rusishtja nëpërmjet Shqipes ("ç u s i v o" = "ç a â s h t b â"), si edhe nëpërmjet vetë Shqipes me operatorin "n d" që dihet tashmë mirë që është gjithmonë, në kuptimin e parë, ay i *ndarjes*.

Në zgjerim të Bisedës, le të analizojmë pak më afër fjalën "*Separation*" që rrjedh (*në instancë të dytë*, jo të parë) nga Lat. "S e p a r a t i o". Motivimi i *kësaj fjale* të fundit bëhet me Shqipen (*instanca e parë* e motivimit):

"S" b e r e

Siç *shihet* theksi semantik këtu bie mbi një gërmë të vetme nistore: "S".

Kjo gërmë simbolizon gjarpërin, "*S-erpens*" që, si një metamorfozë e Djallit, qëndron për *ndarjen* në kuptimin absolut dhe primordial të fjalës.

Për cilën *ndarje*, atëhere? Për *ndarjen zanafillore që u bë shkas për krimin e krijimit të Botës*, siç del edhe ndër të tjera nga Miti Biblik i ngrënies nga fryti i ndaluar i njohjes së *ndarjes* të së Mirës nga e Keqja.

Këtë simbol kaq themelor, universal e të rëndësishëm, e gjejmë edhe në simbolikën e famshme të *Yin Yang*-ut kinez, *ndarjes* së parimit femëror ("yin", ●) nga ay mashkullor ("yang", ○).

Në një version tjetër të mitit kozmogonik nëpërmjet *ndarjes*, *ndarja zanafillore* krijuese shihet si ajo mes Qiellit ("yang") dhe Tokës ("yin").

Prandaj në lutjen e Krishterë të "Ati ynë" na thuhet, ndër të tjera:

"...Ardhtë mbretëria Yte, si në Qiell (○) ashtu mbi Tokë (●)..."*

Kjo lutje pra presupozon mosdallimin e këtyre dy entiteteve, unifikimin e këtyre dy simboleve, atë të Qiellit dhe atë të Tokës, atë të Yang-ut dhe atë të Yin-it, atë mes parimit mashkullor dhe parimit femëror. Po një gjë e tillë i jep fund Botës dhe lidhet në Theollogjinë e Krishterë me "Dheverta Parousia" (Δευτέρα παρουσία), do me thënë me shfaqjen (të dukurit) e dytë të Krishtit, që shënon dhe pra fundin e Botës, jo vetëm sipas Ungjillit, por edhe sipas Kur'anit.

Ndër mitet kozmogonike është dhe ay që flet për një krijim të Botës nëpërmjet "Hieros Gamos" (Martesës së Shenjtë) mes Qiellit (me numur simbolik, 3) dhe Tokës (me numur simbolik 2). Duke qenë kështu, shohim se numuri i Botës materiale duhet të jetë: $2 + 3 = 5$

Këtë e rekonfirmojnë edhe ato sa lexojmë tek Cirilot lidhur me simbolizmen e numurit p e s ë (5) që, duke qenë ai i "Hieros Gamos", është dhe ai i tërë Botës materiale.

Kjo "ekuivalencë" mes pesës dhe Botës tonë materiale jepet në Shqip me ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} 5 & = & \bullet \\ \text{p e s ë} & & \text{p i s} \end{array} \quad \dots(F)$$

Por Shqipja na jep të kuptojmë edhe se: *Bota materiale nuk është tërë Bota* (duke përfshirë pra këtu dhe Botën Spirituale, "Mbretërinë Qiellore").

Dhe kjo sepse:

$$5 = 1/2 \quad \dots(F)$$

* Ungjilli sipas Matheut, 6:10.

** Shih edhe fq.44, 115, 255, 663 dhe 737.

ose edhe:

$$5 = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

p e s ë p j e s ë

Në Shqip fjala "pis" do të thotë "i keq". Që këndeje pra del edhe se Bota jonë materiale (për të thënë më të paktën...), nuk është e mirë, pra e keqe, sikundër pohon dhe tërë Mendimi Mistik i të parëve tanë.

Populli flet për këtë Botë si për një Botë të rreme. Kështu bën edhe Hebraishtja, siç do të shohim me poshtë. Por mund të shtojmë këtu edhe faktin se, duke u lidhur Bota me numurin 2,* ajo bie në *grackën e dualitetit dhe atëhere kemi:*

$$\text{Bota materiale : } \bullet = 2 = 1/2 = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

Kjo do të thotë (edhe sipas Schneider-it) se ne jemi në gjendje të perceptojmë vetëm gjysmën e të Tërës, gjysmën e Realitetit të vërtetë, e pra ne jemi në gjendje të perceptojmë vetëm "fenomenin", dukurinë, atë që duket, por që nuk është.

Fjala "fenomen" do të thotë "dukuri". Pra siç shikojmë, gjithshka në këtë Botën tonë është vetëm fenomenale, pra thjesht një dukje, një ngjasim.

Dhe Shqipja e jep bukur këtë me:

g j a s ë (*ndodhje*)

g j a s í (*gjasim, shëmbëllim*)

Një rikonfermë të kësaj, të faktit me fjalë të tjera se *Bota është, fundja . . . në fund, një gënjeshtër (rrenë)* e gjejmë edhe në Hebraisht ku "**b a d a**" (**בדא**) = ingl. *to invent [in an evil sense], to lie* ("shpik" në një kuptim mohues, e pra "shpif"; gënjej, rrej).

* Cirlot (fq.232): '*The number two as Magna Mater...*'

Mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} \mathbf{b a d a} &\rightarrow \text{shq. } \mathbf{b \hat{a} d \grave{a}} = \textcircled{1} = 1/2 = \mathbf{F} = 2 = \bullet \\ &= -1 = \text{negativitet, mohim, gënjeshtëri...} \end{aligned}$$

Në zgjerim të Bisedës, kujtojmë se vetë-përcaktimi (ingl. *self-definition*) i Djallit (tek "Fausti") është:

*"Ich bin der Geist
Der stets verneint..."*

(Unë jam Fryma
Që parreshtur *mohon...*)

Duke qenë se Djalli përfaqëson "frymën e mohimit", e pra të "gënjeshtëris", mund të themi atëherë se edhe Hebraishtja, në mënyrën e vet, referon, goftë edhe tërthorazi, tek Djalli, të cilin Krishti në Ungjill e cilëson si "Babai i Rrenës": "*Ju jeni bijtë e djallit dhe ju doni të përmbushni dëshirat e tij. Ai ka qenë që në krye një vrasës dhe nuk i është përmbajtur kurrë të vërtetës, sepse e vërteta është krejt e huaj për të. Pra dhe kur gënjen, ai flet në gjuhën e tij, si gënjeshtar që është dhe si babai i gënjeshtëris...*"

Kjo është edhe një arsyet që Hebraishtja:

$$\mathbf{b a d a} \rightarrow -1 \text{ (mohim)} = \bullet \text{ (e keqja; ingl. evil)} = \text{Djalli}$$

Prapë tek "*Fausti*" lexojmë këtë tjetër vetë-përcaktim të Mefistofelit:

*"...Alles was Sie der Böse nennt,
Ist mein eigentliches Element..."*

(...Gjithshka ju quani e Keqja
Është bash thelbi im...)

* Gjoni, 8:44.

Që rikonfermon ato sa dhe pamë më sipër lidhur me kuptimin e "të keqes" (gjerm. "Böse"), e pra edhe atë të "gënjeshtërs" të fjalës Hebraisht "b a d a".

Kjo do të thotë, fundja më në fund që:

"Bota është një krijim (krim) i Djallit."

i cili sipas Krishtit është ndër të tjera, siç pamë, "Princi i kësaj bote"* dhe "Babai i Rrenës".

Në Shqip kjo jepet bukur me aforizmën:

"Krymja, nga një krim."

Vetëm nga fakti që fjala "b a d a" e Hebraishtes zberthet me Shqipen:

"b â d à" = ⊕ = F = - ⊙ = - e Tëra = - e Vërteta...

dal vetvetiu se një nga kuptimet themelore të kësaj gllöse në Hebraisht është ai i "gënjeshtërs", "jo të vërtetës".

Gjejmë pra kështu një rikonfermë në Hebraisht të pohimit se Bota fenomenale, *Bota e dukurive është diçka e shpifur prej nesh*, prej shqisave tona, prej mendjes tonë e, pra fundja më në fund, një gënjeshtërs (ingl. *lie*).**

* Shih edhe fq.36, 361 dhe 527.

** Rikujtojmë këtu nga Cirlot (fq.206): "...*The world, not as it is in itself but as we perceive it and react upon it, is the product of our own maya or delusion... The Highest Being is the lord and the master of Maya... All the rest of us... are the victims of our individual Maya... To liberate man from such a spell... is the principal aim of all the great Indian philosophies.*"

(...Bota, jo ashtu si ajo është të vërtetë, por ashtu sikundër ne e perceptojmë atë dhe reagojmë ndaj saj, është pjellë e Majas dhe iluzionit... *Qënja Supreme është zot e padron i Majas*, kurse ne të tjerët, jemi të gjithë viktima saj... Çlirimi i

Duke e zgjeruar më tej këtë Bisedë të përzgatur e duke dalur disi jashtë themës, le të flasim pak për një nga operatorët shqiptarë të ndër-kallur shpesh në gjuhët e huaja. Ky është operatori: T A N , e T Ě R A, simb. \bigcirc .

Kështu për shembull:

Në Latinisht:

"dis-TAN-tia" = shq. dysh Tan = 2 . \bigcirc = $-\bigcirc$ = \bigoplus = (A...B)

Në Italisht:

"TAN-to" = shumë

Por dimë që Gjuha emërton sipas një paradigme superlative. Dhe superlativi i "shumësisë" është *tanësia, tërësia, e gjitha*. Prandaj, pra mund të shkruajmë:

ital. TAN to = shq. TAN = \bigcirc = ∞

Siç shikojmë në këtë rast të veçantë, por mund të shikonim dhe në çdo rast tjetër, fjalët duke u referuar tek një paradigme superlative, s'ka se si, do të referojnë tek Infiniti. Përse vallë, akoma? Po sepse fjalët duhet të referojnë tek Qendra Mistike, duhet të referojnë tek Zoti, që dhe nga kanë dalë (kujto: "Në krye ishte Fjala..."), tek *Ein Sof*-i (אֵין סוֹף), para *Tzim-tzum*-it (צַמְצוּם), para se Infiniti të zvoglohej, të finitizohej, për të krijuar një Botë të fundme, siç është kjo Bota jonë materiale...

Edhe nga gjuhë të tjera del se Bota nuk mund të krijohej veçse me një zvoglim, me një cungim të Hyjnisë. Për këtë dëshmojnë dhe mithet kozmogonike, siç është ndër të tjera edhe ai i "Dismemberment".*

njeriut nga një magji e tillë... përbën qëllimin kryesor të fillosofirave të mëdha indiane.)

* Shih edhe Cirlot, *Cosmogony* (fq.64).

Kështu për shembull në Italisht:

"c o m i n c i a r e" = filloj

"d i m i n u i r e" = zvogloj

që nga edhe kuptohet fare qartë:

"...*Che il mondo e cominciato con una... diminuzione*".*

Në Gjermanisht:

"A u f b r u c h" = fillimi**

"b r e c h e n" = thyej, pres, çaj

Pra simbolikisht:

$\ominus = F = -1 = \dots$
(brechen) (Aufbruch)

Pra del fare qartë edhe këndeji se Bota është krijuar me një zvogëlim:

$\ominus < \bigcirc$

të Einsof-it (אֵינְסוֹף), para Tzimtzum-it (צִמְצוּמ) që do të thotë për Misticizmin Hebraik, nga Infiniti i pazvogluar, simb. \bigcirc , ose edhe ∞ .

Që Infiniti, e pra Zoti, duhet të "zvoglohet" për krijimin e Botës, këtë e lexojmë edhe tek Cirlot, i cili shpjegon nevojën e "Kurbanit" (sakrifica kozmogonike) pikërisht me domosdoshmërinë e një zvogëlimi të energjisë infinite primordiale.

* "Bota ka nisur me një zvogëlim..."

** Dhe me qenë se Gjuha, siç pamë, emërton sipas një superlativi, është fjala këtu për fillimin e Botës.

Në Italisht:

"conTINuo" = *i pandërprerë*, e pra simb. $-\textcircled{1} = \textcircled{0} = \text{shq. e TANA}^*$

Është e tepërt këtu të shtojmë që "e Tana" është "e Vërteta". Kjo del edhe nga ekuacioni i Qendrës Mistike ($x = -x$), me zgjidhje simbolike 0 (zero) dhe ∞ (infiniti).

Në Italisht gjithashtu:

"conTENTo" = *i lumtur, i kënaqur*

Theksi semantik këtu bie tek "T E N" që nuk është gjë tjetër veçse një deformim i lehtë i Shqipes: "T A N" = e Tëra (it. *il tutto, l'intero*).

Këtë na thotë edhe Hegeli:

"E vërteta është e tëra".

Simbolikisht kjo do të shkruhej kështu:

$$\textcircled{0} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

Zgjidhja e ekuacionit të fundit na jep:

$$y = \pm ix$$

që nga:

$$y/x = i$$

që nga edhe:

$$\text{tg } \psi = i$$

ose më në fund:

$$i$$

* Që "e Vërteta" është "e Tana", e pra simb. $\textcircled{0}$, këtë e gjejmë edhe tek Hegeli: T e z a = $\textcircled{0} = -\infty = -(\rightarrow \leftarrow) = E$, tek Kierkegaardi, tek Jaspersi: "e Tana" si "*der Umgreifender*" = ingl. *all encompassing* (e pra "tërëpërfshirësi", simb. $\textcircled{0}$).

me fjalë të tjera, arrihet tek "Imagjineri".*

Pra e vërteta, që përputhet me Qëndrën Mistike, mund të kapet vetëm me anë të imagjinatës.

Nga ana tjetër, sa më sipër tregon edhe se duke i përkur kodit E [$(x = -x)$], ajo është jashtë Kohës dhe Hapësirës ($t = 0, s = 0$), e pra ajo përbën një Trashëndencë dhe si e tillë nuk mund të kapet kurrsesi me anë të mjeteve njohëse të kaq të lëvduarës sot nga disa qarqe (me pa të drejtë) të Arsyës.

Vazhdojmë zgjerimin tonë të Bisedës...

Në Inglisht:

W h o l e = e Tëra, mbarë

h o l y = i, e shenjtë, i, e mbarë

Shikojmë pra se si shenjtëria, që është sigurisht e vërteta e mbrame, krejt e vërteta, lidhet me të Tërën, gjë që do të thotë se vetëm ay që vihet në një unitet të plotë me të tërën, mund të jetë i shenjtë. Dhe ky është Zoti që, siç e ka mbiquajtur psikiatri dhe fillozofi i shquar Jaspers, është "*der Umgreifender*" (Tërëpërfshirësi).

Fillozofi i dëgjuar anglez Herbert Spencer e quan Zotin "i papërcaktuari", e pra simb. – \odot , e pra atëhere edhe \bigcirc . Dhe dalim kështu po aty. Edhe për Spencer, Zoti përputhet me të Tërën, me Qëndrën Mistike etj. etj., dhe është si i tillë i paarritshëm me anë të Arsyës.

Zoti është gjithashtu i përputhshëm me "*Singularity*", me një pikë jashtë Kohës e Hapësirës, nga e cila dhe tërë Bota u krijua, sipas pohimeve të fundit të fizikantit të madh anglez Stephen Hawking.

* Shih lidhur me këtë edhe fq.685 dhe 796.

Në Shqip:

m b a r ë = krejt

i, e **m b a r ë** = i, e mirë

m b a r ë s i = mirësi

m b a r i m = fund

Shqipja pra i unifikon të gjitha këto koncepte dhe na thotë, ndër të tjera, edhe se:

"E mbara mbrihet në mbarim."

Italishtja "c o n T E N t o" na thotë, nëpërmjet Shqipes "T A N", se Njeriu mund të bëhet i lumtur vetëm në qoftë se asgjë s'i mungon, *sa ka*, me fjalë të tjera, të Tanën, se ka, me fjalë të tjera me vete Zotin.

Dhe mund të vazhdojmë kështu gjatë, por nuk është rasti...

665) Hebr. **b a n a'** (ב נ א) = ingl. *to build, form, develop, erect* (ndërtoj, formoj, zhvilloj, ngré...)

Lidhet si me prejardhësen e saj me foljen Shqip "b â j" dhe me fleksionimet e saj të ndryshme e shumta, si:

b a j, b a n a, b a n i...

Këtu lidhen gjithashtu edhe fjalët në Shqip "**b a n e s ë**", "**b a n a**" (për banesën në një Shqipe arkaike), "**b a n o j**", "**b a n o r**", "**A r b a n a**", etj. Këtu lidhen edhe Gjermanishtja: "**b a u e n**" = me ndërtu, me "**b a**", Turqishtja: "**b i n a**" (ndërtesë), etj. etj.

666) Hebr. **b e t h e r** (ב ת ר) = ingl. *piece, portion...* (pjesë, copë,...)

Motivimi me Shqipen:

b ë t h e r r = ⊕

Rrënja "t h e r r" në Shqip është shumë produktive, ndërsa në Hebraisht as që ekziston fare në gjendje të pastër. Kështu në Shqip: "t h e r r o r", "t h e r r o r í", "t h e r j e", etj. Në kuptimin figurativ: "më *theri* ajo fjalë", "më *theri* një dhimbje" etj. etj.

Nga kjo rrënjë vjen edhe Shqipja "t h ë r r i m e" (shq. *dromca*; ingl. *crumbs*).

667) Hebr. g ā l (ל א ג) = ingl. *redemption* (ngjallje)

Është Shqipja:

(n)g j a l l, n g j a l l j e

nga folja "me u n-gjall", një operator ky shumë produktiv në Shqip, p.sh.: "një njeri i gjallë" (aktiv), "gjallëri", "i ngjallur" (i ndrashur), "gjellë" (jetë)* etj. etj.

668) Hebr. n i g a l (ל א ג א) = ingl. *to be redeemed* (të jesh ngjallur)

Motivimi është Shqipja:

n-g j a l l

Ekzistojnë që të dy format, si në Hebraisht ashtu edhe në Shqip ("n-gjall", "gjall"). Prefiksimi me "n" nuk prek bërthamën semantike të fjalës. Këtë fenomen e vëmë ré edhe në Sanskritisht. Në Shqip: "da" dhe "n-da", "dëgjoj" dhe "n-dëgjoj", e kështu me radhë.

669) Hebr. n ā g a (נ ג א) = ingl. *to smite, beat, strike; to touch* (godas, rrah; prek, ngas)

Lidhet me Shqipen:

n g a s
(ingl. *to touch*)

* Tek Arbëreshët: "Gjella e shën Mërisë"...

si edhe me Shqipen:

n g a c - m o j...

Ky operator ka një spektër mjaft të pasur në Shqip, gjë që flet për një autoktoni të lashtë në gjuhën tonë, p.sh. ndër të tjera: "n g a s j e" = tundim (ingl. *temptation*), "n g u c", "n g u t", "n g e c", etj.

670) Hebr. n o g e s h (נ ג ש) = ingl. to press, urge, drive; driver; be pressed, harrassed... (ngjesh, ngut, nguc, nxit; drejtoj ose ngas (p.sh. makinën); më bëhet presion, ngacmohem, detyrohem...)

Lidhet me Shqipen:

n g a s

Pra s'ka dyshim se është fjala për të njëjtin operator të lirë.

Rrënja e mirëfilltë dhe e thellë e gjithë këtyre gllosave është grupi "n g", grup që e gjejmë edhe në fjalë të tjera jashtë spektrit semantik të mësipërm, si p.sh.: "a n k t h" (fr. *angoisse*, it. *angoscia*; gjerm. *Angst*).

Një tjetër kuptim themelor i grupit "n g" është edhe ai i "mohimit" në Shqipen e Arbëreshëve, ku "n g ë" rri për "n u k".*

Të gjitha këto flasin për epërsinë e Shqipes "n g a s" krahas Hebraishtes "n o g e s h".

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë se Shqipja shtron edhe ekuacionin e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \sim & = & \rightarrow () \leftarrow \quad \dots(F) \\ \text{n g a s} & & \text{n g j e s h} \end{array}$$

* Shih edhe fq.105 dhe 601.

Dhe rigjejmë kështu një nga pohimet e famshme të Teorisë së Relativitetit, sipas të cilës "n g a s j a" (*lëvizja*, \sim) sjell me vete një "n g j e s h j e" të trupit në lëvizje, e pra një rritje të densitetit të tij, si edhe një shkurtim të gjatësisë së tij (në drejtim të lëvizjes).

Mund të shkruajmë pra:

$$\text{ngas} > = \text{ngjesh} >$$

dhe simbolikisht:

$$\sim > = \oplus > = \bullet >$$

Me formulat Lorentziane të Teorisë së Relativitetit, kjo do të shkruhej:

$$m_t = \frac{m_0}{\sqrt{1 - \frac{v^2}{c^2}}}$$

Në Shqip gjithashtu, po nga kjo rrënjë: "n g u s h t ë", që mund të interpretohet, gjithmonë sipas Fizikës Einsteiniane, "ngushtimi" (tkurrja) apo "shkurtimi" i gjatësisë së trupit gjatë lëvizjes, sipas formulës:*

$$l_t = l_0 \sqrt{1 - \frac{v^2}{c^2}}$$

671) Hebr. n a d a (נ א ד א) = ingl. *to remove, to expel* (heq, përjashtoj)

Lidhet me Shqipen:

$$\begin{aligned} \text{n d a j} \text{ (në të gjitha kuptimet...)} &= \oplus \text{ ("heqje")} = F \\ &= -1 \text{ ("përjashtimi")} = \dots \end{aligned}$$

Rrënja e pastër është "d a", kurse "n a d a" përmban monosilabin "n a" që funksionon këtu si një prostazë (nuk prek, me fjalë të tjera, bërthamën

* Shih lidhur me këtë edhe fq.516-521.

semantike të fjalës). E kemi vënë re edhe më parë këtë fenomen, si me fjalët Hebraisht, ashtu edhe ato Sanskritisht, si edhe më në fund me ato Shqip ("dal" dhe "n-dal", "i darë" dhe "i n-darë", e kështu me radhë...)*

672) Hebr. **d ā m** (ד מ) = ingl. *likeness* (ngjashmëri)

Që këndeje:

d e m u t h (ת מ ד) = ingl. *likeness* (ngjashmëri)

si dhe:

d ā m a' (מ ד) = ingl. *to be like, to resemble* (të ngjash...)

Pra fjalët Hebraisht që ne këtu po shqyrtojmë dhe që kanë kuptimin e *ngjashmërisë*, "reduktohen" tek Shqipja:

d a m - j e = ⊕

Mund të shkruajmë pra atëhere:

≈ = ⊕ ... (F)

hbr. **dāma** shq. **dām**
(ngjashmëni) (ndamje)**

* Shtojmë këtu se fjala "n a d o" (надо) = *duhet*, flet dhe ajo, në mënyrë të tërthortë, në Rusisht, për një *mungesë*, për një *ndarje*. Po ashtu edhe Inglishtja "n e e d" = *nevojë*. (shih edhe fq.99)

Duke qenë kështu, të gjitha këto fjalë të huaja lidhen, si me prejardhjen e tyre, me Shqipen "d a" ose "n d a", që na jep simbolikisht kuptimin e *ndarjes* (⊕) nga i cili mund të bëhen të rrjedhin të gjitha kuptimet e tjera.

** Nga sa më sipër shohim se një "objekt i ngjashëm" është sa "gjysma e origjinalit", pra sa gjysma e të tërës, të plotës. Prandaj dhe "ngjashmërinë" e kemi treguar me " ⊕ ".

Por ka dhe më:

$$\oplus = F = 1/2 = 2$$

Sipas Schneider-it (Cirlot), introduktimi i *d y s h i t* (2), pra i *dualizmit* apo *dualitetit* (që përshkon tërë Realitetin material a, shkurt, tërë Botën tonë), bën të pamundur perceptimin e të Tërës, e tërë origjinalit, ashtu sikundër ay është para perceptimit tonë. Do të themi atëhere se: *Origjinali shndërrohet në një fenomenon*, që del kështu se është tamam sa *gjysma e Realitetit*. Bota është fenomenale, pra e përgjysmuar, e pra atëhere edhe jo e vërtetë, duke mos qenë e *Tëra*, që vështrohet, edhe nga mendimi i sotshëm fillosofik, si e *Vërteta*.

Është njëlloj si të thuash:

$$e \text{ Vërteta} = \bigcirc$$

$$\text{fenomeni} = \oplus = - \bigcirc = - e \text{ Vërteta} = \text{gënjeshtër}$$

Kështu, ne, duke jetuar në një Botë fenomale, jemi duke jetuar në një Botë të rreme. Po këtë mendim kanë patur edhe të Parët tanë, gjë për të cilën ne kemi folur edhe gjetkë gjatë këtij Studimi.

Sikur ne të viheshim në gjendje të perceptonim të tërën, ne do të njihnim atëhere "noumenin" i cili, sipas Kantit, është i panjohshëm. Përse vallë?

Pò sepse:

$$\text{Arsyeja} = (x = x) = \oplus = F = \bullet = \dots$$

Gjë që do të thotë se: *Arsyeja njerëzore* ($x = x$) mund të perceptojë vetëm *materien* (\bullet), vetëm *gjysmën* (1/2) e *Realitetit të fundëm*, e pra vetëm *fenomenin*, e pra në asnjë mënyrë *noumenin*.

Tërë Bota fenomenale është ajo që ne quajmë "Ekzistencë", ndërsa Bota noumenale është e brendshme, ajo nuk "ekziston", por vetëm "është".

Le të kujtojmë këtu edhe fjalët e Krishtit [Lluka, 17:21]

"Mbretëria e Qiejve është *brenda* jush..."

(ή βασιλεία τοῦ θεοῦ ἐντὸς ὑμῶν ἐστίν...)

Rikonfirmime gjuhësore të kësaj të vërtete i gjejmë edhe në Gjuhë.

Kështu p.sh. në Gjermanisht:

i m m e r (*gjithmonë, përjetësisht*), e pra (t = 0)

i n n e r (*brenda*), pra \square

Gjithashtu në Italisht:

i n t e r o (*e tana, e tëra*) = \bigcirc

i n t e r i o r e (*e brendshme*) = \square

Mund të shkruajmë atëhere akoma edhe, në gjuhën e Heidegger-it:

D a s e i n = *Ekzistenca, fenomeni*

S e i n = *Qënia, noumeni*

Është e famshme e thëna e Heidegger-it: "*Man ist der Hirt des Seins...*" [Njeriu është bariu i Qenies...] Kjo është njëlloj si të thuash se **Njeriu** është ai që e ruan Qenien, që nuk e lë, me fjalë të tjera, të dalë.

Me qenë se numuri simbolik i Njeriut është pesë (5), pohimi i Heidegger-it do të mund të transkriptohej simbolikisht si:

$$5 = \square 1 \dots(F)$$

Njeriu Qenia

Shih lidhur me këtë çështje edhe fq.320.

Kemi pra kështu rikonfirmime të shumta edhe në Gjuhë edhe jashtë Gjuhës, të saktësisë të fjalëve të Krishtit, kur thotë që "Mbretëria e Qiejve është brenda jush..."

Me qenë se, nga ana tjetër, *mbrendësia* lidhet me *Subjektin, subjektivitetin* (ndërsa *jashtësia* me *Objektin, objektivitetin*), kuptojmë atëhere edhe të thënë e Kierkegaard-it:

"E vërteta është subjektive."

- 673) Hebr. *d ā m ā'* (דָּמָא') = ingl. *to cease, to rest, to be silent; to destroy* (ndërpres, pushoj, hesht; shkatërroj)
- 674) Hebr. *n i-d a m a'* = ingl. *to perish, to be destroyed* (prishem, shkatërrohem, marr fund)

Duke e vazhduar zgjerimin e Bisedës, shtojmë edhe sa më poshtë:

Fizika Moderne arrin në përfundimin e mosqenies të *objektivitetit*, të *Realitetit* (material).

Fjala "o b j e c t i v i t é" (*objektivitet*) lidhet semantikisht me Frengjisht "o b j e c t i o n" që do të thotë *vërejtje, qortim, korrigjim, mohim*.

Në Gjermanisht, fjala për *objektivitetin* është: "G e g e n s t a n d" (*ai shka na çondron kundra*, lat. *adversarius*)...

Vëmë re këtu se fjala "Adversarius" është përdorur për Djallin. Ajo do thotë, shkurt: *Kundërshtari*... Dhe është fjala, sigurisht, për kundërshtarin e Zotit, e të Mirës, e të Vërtetës dhe të "Njeriut Para-Adamik", e kështu me radhë.

Rënia e konceptit të Objektivitetit sot në Fizikën Kuantike na jep të kuptojmë se kemi arritur në një epokë të tillë në të cilën "Djalli ka vdekur o është duke vdekur". Po një gjë e tillë lidhet, nga ana tjetër, në bazë të Shkrimeve të Shenjta (shih kryesisht një nga etërit më të mëdhenj të Kishës, Origjenin), me Fundin e Botës.

Ky është një përfundim madhor dhe epokal.

Rënia e "objektivitetit", e pra e "Realitetit material" sot në Shkencë flet edhe kundër tezës si të Leninit ("*Materializmi dhe Empiro-kriticizmi*"), ashtu edhe të Einsteinit (shih debatin Einstein-Bohr, në librin "*Hëna e Einsteinit*"), për Objektivitetin si diçka e pavarur nga Njeriu dhe koshienca e mendimi i tij.

Këtë e rikonfermon ndër të tjerë edhe Wheeler, kur pohon se "*We live in a participatory Universe...*", që do të thotë se ne jemi "bashkëkrijues" të Realitetit, e pra se ai nuk është e s'mund të jetë kurrsesi i pavarur nga ne.

Në të dy këto fjalë ne mund të shquajmë operatorin Shqiptar:

d à, d ā m, n d ā m...

që lidhen të gjitha brenda Shqipes me rrënjën "D A", që është ajo e "ndarjes", e "ndërprerjes" etj. etj.

Ky operator gjendet *talis qualis* edhe në Sanskritisht.*

Simbolikisht ai do të jepej me " ⊕ ".

Dimë se, sipas Paracelsus:

"Die Separatio ist aller Geburt Anfang."

... pra gjithshka ndërtohet me anë të një ndarjeje (sikundër e shquajmë edhe në Shqip, p.sh. në fjalën "n d ë r-t o j").

Por, këtu shohim diçka të kundërt: ekuivalentizimin e "ndarjes" me një "prishje", me një "shkatërrim".

Arsyeja mund të jetë kjo: për autorët hyjnorë të "Vedave", kjo Botë (tokësore) ngrihet dhe mbahet mbi shkatërrimin e Botës së Epërme, Qiellore. Kështu që, duke u vënë në pikëmpamjen e Botës Hyjnore, "ndërtimi" i kësaj Bote Tokësore nuk mund të jetë tjetër veçse një "prishje", një "shkatërrim".

Ky mentalitet ngjet jo pak, siç do të shohim më mirë më vonë, me botëkuptimin e Krishterë, ashtu si ay është shprehur në mënyrë genuine dhe pa shtrembërime në Ungjill, ku na thuhet ndër të tjera: *"Mos e duani këtë botë dhe asgjë në të..."***

* Shih edhe fq.498 dhe 515.

** Shih edhe fq.21 dhe 349.

- 675) Sanskr. **a t y a n t a** (अत्यन्त) = fr. *constant; ininterrompu; parfait éternel; extrême, qui passe les bornes* (i pandryshueshëm; i pandërprerë; i përsosur; i përjetshëm; ekstrem, që kapërcen kufijtë)

Motivimi:

$$\begin{aligned} a t y a n t a &\rightarrow \text{shq. } \hat{a} t e j \hat{a} n d \grave{a} \text{ ("përtej ndarjes")} = > \textcircled{1} \\ &= - \textcircled{1} \text{ (ininterrompu)} = \textcircled{0} \text{ (perfect)} = E = - \sim \text{ (constant)} \\ &= (t = 0) \text{ (éternel)} = > \textcircled{1} \text{ (qui passe les bornes)} \end{aligned}$$

Shikojmë pra se si Shqipja dhe Algoritmi Simbolik na lejojnë të justifikojmë, të motivojmë të gjitha kuptimet e shumta dhe të ndryshme të Sanskritishtes "a t y a n t a". Një gjë e tillë flet natyrisht për fuqinë motivuese të Shqipes, por mund të vështrohet edhe si një dëshmi e pakundërshtueshme e pranisë së Algoritmit Simbolik në gjuhën Sanskritiste, sikundër në të gjitha gjuhët e tjera pa përjashtim, siç kemi parë e do të shohim në vazhdim të këtij Studimi.

- 676) Sanskr. **a - k a t h i t a** = fr. *non mentionner* (që nuk është përmendur, që nuk është thënë)

Motivimi me Shqipen:

$$\begin{aligned} &- k a t h \grave{e} n \grave{e} \\ &\text{("që s'është thënë")} \end{aligned}$$

Trajta "t h i t a" gjendet e paraafruar në Shqip tek "t h o t ë".

Përveç kësaj, në një Shqipe disi arkaike gjejmë trajtën: "k a t h a t ë" ("k a t h o t ë").*

* Shiko edhe fq. 403.

Në Sanskritisht nuk ekziston operatori i lirë "t h a" (*them, thanë,...*). Prandaj motivimi i kësaj fjale mund të bëhet vetëm me ndihmën e Shqipes.

677) Sanskr. *pathita* (पठित) = ingl. *mentioned* (i përmendur, i thënë)

Motivimi me Shqipen:

b â t h ā t ě

("bërë thënë", "që është thënë"...)

678) Sanskr. *a-kathya* (अकथ्य) = ingl. *unspeakable, unutterable, unmentionable* (e pathënshme, e papërmendshme, e padalme nga goja...)

Motivimi me Shqipen:

a k a t h y a → shq. "- k a t h a"

("-ka thënë", "që s'mund të thuhet")

679) Sanskr. *akārya* (अकार्य) = fr. *qui ne doit pas être fait; mauvais, défendu, mauvaise action* (që nuk duhet të kryhet; e keqe, e ndaluar, veprim i keq)

Motivimi:

a k ā r y a → shq. "- k r y "*

Që këndeje dalin të gjitha kuptimet: "që nuk duhet të kryhet", "veprim i keq", etj.

* Shiko edhe fq.130 dhe 418, 511, 514 dhe 627.

680) Ital. (pane) **a z i m o** = ingl. *unleavened bread* (bukë e "pa-zënë", pa majá)

Është e qartë që fjala "azimo" është Shqipja:

– **z a n ë**

(i, e pa-zënë)

Kjo lloj buke nuk është tjetër veçse "mesha", si një bukë e shenjtë, e virgjërt, e bekuar, pa frymje (pa majá, pa tharm). Përdoret gjithmonë sa bëhet mesha, qoftë në Kishën Katolike, qoftë në Kishën Orthodokse, dhe identifikohet me trupin e Krishtit, që është dhe ay i shenjtë, i bekuar,...

681) Sankr. **u b h á** (**umbh**) (उभ) = fr. *les deux* (të dy, që të dy);

Greq. **a m f o** (αμφω); Lat. **a m b o**; Fr. **a m b i g u e**; Rus. **o b a** (оба);

Ingl. **b o t h**; Gjerm. **b e i d e**.

Theksi semantik bie në të gjitha këto fjalë tek "b" (në Greqisht "f").

Sanskritishtja "u m b h" do të mund të shpjegohej kështu me Shqipen:

"j a m b "

Dihet që gërmat në kohërat e lashta shërbenin edhe si numura (Hebr., Sanskr., etj. etj.). "b" si gërmë e dytë e alfabetit kishte vlerën numerike "2".

682) Sanskr. **k a t h** (**kathā, katháyati**) (कथ) = fr. *dire, raconter, exposer, parler* (me thënë, me tregu, me ekspozu, me fol)

Motivimi:

k a t h → shq. **k a t h á** ("ka thanë", "thotë" etj.)

Theksi semantik këtu bie tek "t h" (*them, the, thua, tha...*).

Në Sanskritisht ky operator nuk është i thjeshtë. Pra Sanskritishtja nuk është në gjendje të motivojë.*

683) Sanskr. *k a n d a r ā* (कन्दरा) = fr. *caverne* (shpellë)

Motivimi:

$$k a n d a r a \rightarrow \text{shq. } k a n d ā r ē = \textcircled{\ominus} = F = \boxed{\circ}$$

684) Sanskr. *d a m a* (दम) = fr. *maison, demeure* (shtëpi, banesë)

Motivohet me Shqipen:

$$d ā m, d a m-j e = \textcircled{\ominus} = F = \boxed{\circ}$$

Me qenë se, siç kemi vënë ré dhe më parë, Gjuha emërton sipas një paradigme primordiale dhe superlative, *banesa* për të cilën është fjala këtu është ajo e *Zotit*, pra *T e m p u l l i*, siç del edhe nga interpretimi i simbolit $\boxed{\circ}$, ku: $\textcircled{\ominus} = (x = -x) = \text{Qendra Mistike, Zoti}$.

Pra Shqipja motivon Frengjishten "*d e m e u r e*" = shq. "d ā m u n", "d a m u r"), Grekishten "*d h o m o s*" (δ ο μ ο ς) = shq. "d ā m j e", Latinishten "*d o m u s*" = shq. "d ā m", "d ā m j e").

Në Gjermanisht: "*Z i m m e r*" = dhomë. Por dihet se në një numur shumë të madh rastesh "d"-ja dhe "t"-ja nistore në Gjermanisht kthehen në "z".**

* Lidhur me operatorin e lirë të Shqipes: *t h { a, e, y, ... } m*, shih ndër të tjera edhe fq.67, 154, 239, 395, 476 dhe 545.

** Shiko edhe fq.278.

Kështu që mund të shkruajmë:

$$\text{gjerm. "Zimmer" < shq. "dāmun Ar"}^* = \text{⊕} = F = \text{⊗}$$


685) Sanskr. a p a - v a r g a (अपवर्ग) = fr. *completion, fin; emancipation de l'âme du corps; liberation, délivrance finale; arrêt des transmigrations* (plotësim, fund; çlirimi i shpirtit nga trupi; çlirim, çlirim i fundit; ndalim i "shpërnguljeve", i "rimishërimeve")

Motivimi me anë të Shqipes:

$$\hat{a} \text{ p a v a r g o j} = - \text{∞} \dots(E)$$

Ky simbol i fundit mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, si edhe në ato që i përgjigjen drejt për së drejti kuptimeve që kjo fjalë ka në Sanskritisht. Ndaj pra dhe kemi të bëjmë me një motivim të plotë.

Shkruajmë:



Me qenë se:

$$- \text{∞} = E$$

* Shih fq.827.

kemi gjithashtu:

$$-\infty = \bigcirc \quad \dots(E)$$

ku " \bigcirc " është ndër të tjera edhe simboli i të Tërës, i tanësisë, i krejtësisë, i plotësisë,...

Mund të shkruajmë gjithashtu, në zgjerim të Bisedës, edhe sa vijon:

$$\begin{aligned} -\infty \text{ (liberation, délivrance...)} &= E = (t = 0) \text{ (completion, fin)} \\ &= -\bullet \text{ (absolution)} = -\oplus = \bigcirc \text{ (Paradis)} = -\sim = \\ -\downarrow \text{ (arrêt des transmigrations)} &= \uparrow \text{ (émancipation de l'âme du corps)} \\ &= -(\rightarrow \neq \leftarrow) \text{ (Béatitude finale...)}^* \end{aligned}$$

Pra nga sa më sipër del se "a p a v a r g a" është momenti final, vdekja vetë, e kuptuar si një çlirim, si një arritje e të të Tërës, si një spiritualizim final dhe tërësor, si një deifikim, si fundi i Kohës.

Kështu që ne jo vetëm që motivuam plotësisht kuptimet e kësaj fjale të Sanskritishtes, por u vumë në gjendje të zhvillojmë më tej edhe të gjitha asosacionet e mundura e të thella që kjo fjalë implikon, por që Autori i këtij Studimi nuk e ka quajtur të nevojshme të na i paraqesë të gjitha ato këtu...

Tërheqim vëmendjen mbi faktin se sipas fillosofisë dhe librave të shenjtë të Indisë së lashtë, vdekja paraqitet, siç pamë, me simbolin " $-\infty$ ", gjë që do të thotë se jeta duhet të simbolizohet me " ∞ ". Ky simbol i fundit, ndër të tjera, është edhe ay i "lidhjes". Kjo lidhje është ajo që realizon jeta mes Shpirtit dhe Trupit, lidhje që, në rastin e vdekjes, zgjidhet. Ndaj pra dhe mund të shkruajmë:

$$\text{"vdekja"} = -\infty = \text{zgjidhja e Shpirtit nga Trupi}$$

* Të gjitha interpretimet e rrezeve semantike të kodit E...

Studimet e fundit lidhur me NDE ("*near of death experience*") tregojnë se Shpirti mund të ketë një të qenur të pavarur dhe vehtjake, siç vihet re në të ashtuquajturën "vdekje klinike". Eksperienca e një shpirti të shkëputur, të zgjidhur nga trupi, e pra nga materia, hedh një dritë të re mbi jetën dhe vdekjen. Por mjerisht ne nuk mund të zgjatemi më tej mbi këtë çështje, që është shumë e rëndësishme, por që edhe mund të sqarohet disi duke konsultuar Internetin *

Pra vdekja me të vërtetë paska qenë një çlirim, e madje përfundimtar, absolut. Ajo paska qenë me të vërtetë realizimi i një pavarësie absolute (– ∞), ashtu sikundër na thotë edhe Sanskritishtja me fjalën e saj "a p a v a r g a", e motivueshme si shumë e shumë fjalë të kësaj gjuhe e të të gjitha gjuhërave të botës, nëpërmjet: 1) Algoritmit Simbolik, dhe 2) Gjuhës Shqipe.

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë edhe se fjala "v a r g" (v a r g o j) në Shqip do të thotë edhe "pranga", por edhe "një sekuencë e pandërprerë" sendesh pak a shumë të njejtë a fundja edhe të ndryshme.

Duke qenë kështu "a p a v a r g a" mund të përkthehet jo vetëm si një mungesë vargonjsh, prangash, por edhe si një varg, si një rrjesht i pandërprerë "mishërimesh". Kjo lidhet me doktrinën e Budizmit ku ky varg mishërimesh është ay që përshkon çdo njeri pas vdekjes, gjer në çlirimin tërësor që mbrrin atëhere kur Individu bëhet i qartë mbi gjith-shka a, e thënë ndryshe, kur ay "përmendet" më në fund nga "gjumi i jetës".

Një individ i tillë ka qenë Buddha, themeluesi i Budizmit. Jeta dhe realiteti material i interpretuar si një përgjumje, si një ëndërr, sugjerohet qartë në Gjuhë, si p.sh. me:

Në Greqisht: "e k s i p n o s" (ἔξυπνος) = 1) i zgjuar, i mençur, por edhe 2) që nuk fle [greq. hypnos (ύπνος) = gjumë, ëndërr].

* Shih lidhur me këtë edhe fq.422.

Ashtu dhe në Shqip fjala "i z g j u a r" do të thotë në të njejtën kohë edhe "i mençur", por edhe "që nuk fle", që është përmendur nga gjumi.

686) Sanskr. a k ṛ t v a (अकृत्वा) = fr. *n'ayant pas fait* (që nuk është bërë, e pabërë...)

Me Shqipe:

– k r y t b â

ose edhe:

– k r e j t b â

e pra simbolikisht:

– ○ = ⊕ = F = ● = fr. *le mal* (e keqja)

Në zgjerim të Bisedës:

Në Shqip:

○ = 1 ... (E)
krejt kreu

prandaj:

– k r e j t = – 1 = – l p a r i = – Z o t i = D j a l l i = e k e q j a

Por mund të arsyetonim dhe ndryshe:

Shumë mendimtarë në të shkuarën dhe në të sotmen, kanë menduar dhe mendojnë se e Keqja (fr. *le mal*) si e tillë qëndron në faktin se evolucioni ende s'ka marrë fund, në zhargonin Hegelian: Fryma Absolute ende nuk është "shëruar" nga Alienimi (çmendia) i saj, e pra armiqësia mes të mbrendshmes (Teza) dhe të jashtmes (Antiteza) s'ka përfunduar ende.*

* Shiko edhe fq.34, 408 dhe 752.

Pra mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} (-x = \boxed{x}) &= (x \neq \boxed{x}) = -(x = -x) = -(\bigcirc = \bullet) \\ &= (\text{e Mira} \neq \text{e Keqja}) = F = -E = \infty \end{aligned}$$

Duke ju referuar këtu Mitit Biblik shohim se pra kemi dallimin e të Mirës nga e Keqja, e pra humbjen e Parajsës, e një me, humbjen e lirisë (∞) e pra të Keqen (\bullet).

Një interpretim tjetër do të qe ky:

Gjetëm se:

$$F = -E$$

që nga dhe:

$$E \downarrow = F$$

që përfaqëson skemën e përgjithshme të çdo miti kozmogonik, do me thënë të çdo miti të krijimit të Botës.

Dhe me qenë se:

$$F = \bullet = \text{Bota materiale}$$

del pra që fjala Sanskritisht "akṛt.va" na jep të kuptojmë tërthorazi se krijimi i Botës ka qenë një e keqe, një krim, ashtu sikundër dhe Shqipja e jep aq bukur me aforizmën:

"Nga një krim, krymja."

Vëmë në dukje këtu, jo pa qëllim, se nga një fjalë e vetme (Sansk., Shq., etj.) mund të nxjerrim një informacion shumë të pasur mbi çështje të rëndësishme, për një Metafizikë *sui generis* po të vërtetë, si edhe për zgjidhjen e shumë problemeve dhe "ngecjeve" theollogjike sikundër që do të kemi rast të shohim edhe më vonë.

687) Sanskr. *ágre* (अग्रे) = fr. *d'abord, à l'origine, avant...* (në krye..., në zanafille, përpara...)

Motivohet me operatorin Shqip:

kry, kré (it. *capo*)

Në Shqip: "në krye të Herës" = në fillim të kohërave...

Po në Shqip akoma:

1 = ○ ... (E)

kré kre-jt

një ekuivalencë e rëndësishme simbolike e cila nuk mund të krijohet kaq qartë me gllosarin e Sanskritishtes,* gjë që flet pra për epërsinë e operatorit "k r e" në Shqip dhe të huazimit eventual të këtij operatori në Sanskritisht.

Shtojmë akoma se ky operator ndodhet i inkapsulluar edhe në Hebraisht, si bie fjala në fjalën: "b a k h i r" (ב כ ר י ה) = *i pari, fëmija i parë*, që me Shqipen do shpjegohej si:

"bë kré", "bë krye",... "kreu i fëmijëve"

Anallogjirat emërtonjëse dhe konkordancat mes Hebraishtes dhe Sanskritishtes, të cilat i nxjerr në pah Shqipja, nuk janë të pakta.

Ne do të mundohemi gjatë këtij Studimi të vëmë në dukje një barazi rrënjësh të mirëfillta dhe të lashta mes Hebraishtes (gjuhës së lashtë "Semite") dhe Sanskritishtes (gjuhës së lashtë "Ariane"). Kështu që, mes këtyre dy gjuhërave themelore, gjer tani të ndara nga një mur i pakapërcyeshëm, do të mund të hidhet një urë bashkimi, unifikimi.

* Shih edhe fq.424 dhe 522.

688) Gjerm. **b e s t e h e n** = konsiston; përbëhet nga...; ekzistoj

Motivimi:

$$\text{b ë s h t i} = \boxed{\bigcirc} = F = \infty \text{ (përbërje)}$$

Kjo fjalë ka edhe kuptimin: "ekzistoj", gjë që shpjegohet prapë, në mënyrën e mësipërme, me qenë se:

$$\boxed{\bigcirc} = \textcircled{\bigcirc} = \bullet \quad \dots(F)$$

shq. "b ë s h t i" dallim materializim

gjerm. **b e s t e h e n**

Kujtojmë këtu se në Shqip:

$$\textcircled{\bigcirc} = \bullet \quad \dots(F)$$

dallim dalje

(lat. *exit, existentia*)*

689) Gjerm. **b e s t i m m e n** = ingl. *to determine* (përcaktoj)

Motivimi:

$$\text{b e s t i m m e n} \rightarrow \text{shq. b ë s h t i m u n} = \boxed{\bigcirc} = F = \textcircled{\bigcirc} = \text{c a k,}$$

për-cak-tim (ingl. *determination*)

690) Rus. **s o s t o j a t s** (**с о с т о я т ь**) = qëndron, përbëhet nga...

Theksi semantik bie tek "s t o", ndërsa "s o-" është një prefiks dhe "-i a t s" ("-ять") një sufiks verbalizonjës i huar nga Sankritishtja "j ā t i" (जाति) që nga ana e saj lidhet, ndoshta si me prejardhjen e vet, me Shqipen "j e t ë".

* Shiko edhe pak më lartë fq.616.

Simbolikisht, transkriptimi do të bëhej si:

so-sto-jats → **sto** → shq. **shti** = \square = **F** = ∞ (përbërje)

691) Ital. **i n t e r o** = i tëri

Është Shqipja:

i t ë r ë = simb. \bigcirc

Le të vëmë ré këtu se Latinishtja (Italishtja) e huazon operatorin e Tërësisë nga të dy të folmet, nga ajo e Veriut si "t a n a" (në fjalë si "d i s t a n t i a", "t a n t o" etj.) dhe nga ajo e Jugut si në këtë rast që po shqyrtojmë.

692) Turq. **b e ş** = ingl. *five* (pesë)

Është Shqipja:

p e s = 5

693) Turq. **b e ş e r i** = ingl. *human* (njerëzor)

Dihet se **p e s a** (5) është numuri simbolik i Njeriut.*

Ndaj pra dhe fjala Turqisht që po analizojmë lidhet brenda Turqishtes me fjalën "**b e ş**" = 5 dhe përfundimisht me Shqipen "**p e s**" (5).

694) Turq. **b a ş** = ingl. *head, chief, boss*,** *top* (kokë, shefi, "bosi", kreu)

* Siç lexojmë te Cirlot (fq.271): "*the number five symbolizes man after the fall...*"

** Përsëri tek Cirlot lexojmë lidhur me këtë çështje sa vijon: "*...the quinary is symbolic of the whole of the material world (denoted by the quaternary) plus the centre or quintessence...*" [... pesa simbolizon tërësinë e botës materiale (që jepet nga katrori) plus qëndrën ose 'kuinteesencën'...]

Kjo fjalë gjendet *talis qualis*, si me *prejardhjen* e saj, në Shqipen "b a s h" = "kre" ose "kokë" (si në shprehjen p.sh. "bashi i anijes" = *kreu* i anijes), dhe është Shqipja:

p e s (5)

Për motivimin e kësaj fjale me anë të Shqipes i referohemi Cirlot: "*Five... It comprises the four limbs of the body plus the Head which controls them...*" [Pesa... përfshin të katër gjymtyrët e trupit plus Kokën, që i kontrollon ato...]*

Ja përse pra mund të shkruajmë:

turq. "b a ş" = shq. "b a s h" < shq. "p e s"

Përfitojmë nga rasti për të analizuar edhe një kuptim tjetër të fjalës Shqip: "b a s h" = pikë-riht (si p.sh. "bash ay...", e pra "pikërisht ai...").

në qerim të Bisedës, vërejmë se:

Në Rusisht: "B j e s" (6 e c) = Djalli, dhe për arsyet që parashtruam më sipër, ka shumë mundësi që kjo fjalë të lidhet me fjalën Shqip "p e s ë" (5).

Po ashtu, Gjermanishtja: "B ö s e" = *i keq, i ligë*, lidhet po e po me Rusishten "B j e s", por, siç kuptohet, gjithnjë nga sa më sipër, edhe me Shqipen "p e s".

Tek "*Fausti*" i Goethes lexojmë këtë vetëpërcaktim të Mefistofelit (Djallit):

*"Alles was sie Böse nennt,
Ist mein eigentliches Element..."*

(Gjithshja ju quani Ligësi,
Përbën elementin tim themelor...)

Kuptohet vetvetiu se edhe fjala Inglishte "b o s s" mund të lidhet me Shqipen "p e s", me qenë se ajo (5) është vështruar si "qendra materiale" e Botës, e pra në të vërtetë, për ne sot, si një "pseudo-Qëndër".

* Cirlot, *ibid.*

Përsëritim se motivimi bëhet me fjalën "p e s" dhe kjo sepse, siç lexuam, tek Cirlot: "*The quinary is symbolic of the whole of the material world (denoted by the quaternary) plus the centre or quintessence.*"*

Por duhet thënë se kjo nuk është Qendra e vërtetë, që përfaqësohet nga "*the Mystic Centre*", "*the Supreme Principle of the Universe*".

Kështu pra p e s a (5) është një "pseudo-Qëndër".

Vetë fjala "p s e u d o" lidhet me Shqipen "p e s". Kështu pra 5 është ndër të tjera paradigma e *fallsitetit*, gënjeshtëris supreme, duke usurpuar, siç bën, vetitë e Qendrës së vërtetë, e Qendrës së mirfilltë, që është Spirituale dhe jo materiale.

Duhet patur kujdes nga ky konfuzion, në të cilin kanë rënë popuj të vjetër e të rinj, dijetarë të mëdhenj e të vegjël.

Rikujtojmë këtu se në Greqisht: "p s e m a" (ψ έ μ α) = gënjeshtëri (ingl. *lie*).*

* Mos harrojmë se ekziston ekuacioni: Q e n d r a = Pi-k a.

Shih edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.791.

* Le të shtojmë këtu dhe diçka tjetër... Kemi parë se:

$$\text{parimi i shkakësisë} = \leftrightarrow = \textcircled{1} = 1/2 = 0.5 = 5$$

Pra përfundimisht: $\leftrightarrow = 5 \dots(F)$

Por: $5 = \text{fallsitet, gënjeshtëri, si edhe negativitet } (5 = -1)$.

Atëhere edhe *Parimi i kauzalitetit* nuk do të jetë i vërtetë, por i rrëmë, sikundër që sot ka dalë në pah në një mënyrë krejt skandaloze dhe të pakundërshtueshme, dhe madje është pohuar nga një mendimtar kaq thellësisht racionalist si Einsteini. (shih fq.420 dhe 547)

695) Shq. **b a s h k** = ingl. *together*

Me qenë se dimë se 5 është numuri i mitit kozmogonik të *Hieros Gamos*, e pra atëhere numuri i bashkimit *par excellence*, paradigmatic, më shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} 5 & = & \infty \quad \dots(F) \\ \text{pes} & & \text{bash-k} \end{array}$$

696) Greq. **p i s t i** (πίστη) = ingl. *faith* (besim)

Me qenë se *besimi* lidhet me "r e l i g i o" (shq. *fé*; ingl. *faith*) dhe kjo fjalë flet për një "l i d h j e" (lat. *relatio*) mes Tokës edhe Qiellit, fjala Greqishte që po analizojmë duhet të flasë edhe ajo për një *bashkim*. Por numuri simbolik parësor i "bashkimit" është *p e s a (5)*, si bashkimi i Qiellit me Tokën, i njohur me emrin *Hieros Gamos* ("Martesë e Shenjtë"), që u bë shkak për krijimin e Botës. Mund të themi dhe ndryshe pra se 5 është simboli i bashkimit *par excellence*, i bashkimit paradigmatic, e pra si i tillë i "pistis".

Në Shqip kemi gjithashtu fjalën "**b e s a**", që flet edhe kjo për një *bashkim*, për një *lidhje* (si në shprehjen "lidhën besën", që do të thotë "bënë 2 + 3") dhe që pra na lejon të shkruajmë:

$$\text{b e s a} < \text{p e s a} = 5$$

697) Arab. **d u n y ā** (دُنْيَا) = ingl. *world* (bota)

Me qenë se, siç lexojmë tek Cirlot, numuri 2 është simbolik i Botës materiale ("*first nucleus of matter*"), ne mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccc} 2 & = & \bullet \quad \dots(F) \\ \text{shq. dy} & & \text{arab. dunyā} \end{array}$$

Me fjalë të tjera që: arab. "d u n y a" < shq. "d y" = d y s h (2)

698) Gjerm. **w i e d e r** = ingl. *again* (përsëri)

Do zbërthyer në:

w i e d e r

dhe me Shqipen:

$$\mathbf{b\ddot{e}^* d\bar{a}r} = \textcircled{1} = 1/2 = \mathbf{F} = 2 = \text{përsëritje...}$$

699) Gjerm. **w i d e r** = ingl. *against* (kundër)

Do zbërthyer në:

w i d e r

dhe me Shqipen:

$$\mathbf{b\hat{a} d\bar{a}r} = \textcircled{1} = \mathbf{F} = -1 = (\rightarrow \nrightarrow \leftarrow) = \textit{kundër, konfervënie...}$$

Dikur këto dy fjalë me kuptime të kundërta janë shkruar njëllëj, por një një moment të dytë janë diferencuar lehtë për shmangie keqkuptimi.

Shtojmë edhe se zanore e ndjekur nga "e"-ja (dhe kështu është fjala për "i"-në) zgjatet. Pra dhe fjala "w i e d e r" do lexuar si "w i i d e r".

700) Ingl. **s t i l l** = ende, megjithatë (tregon *vazhdimësi*, mos ndërprerje)

Motivimi me Shqipen:

s t i l l \rightarrow s h t i Y l l

Dimë se:

$$\mathbf{F} = [\mathbf{E}]$$

Pra:

$$\mathbf{F} = \textit{jashtë}$$

$$\mathbf{E} = \textit{brenda}$$

* Shih edhe fq.69, 239 dhe 184.

Nga ana tjetër:

$$E = - \textcircled{1} = \textit{mos ndërprerje}...$$

Dhe me qenë se:

$$YII = E = - \textcircled{1}$$

del se fjala "**s t i l l**" e Inglishtes motivohet plotësisht me anë të Shqipes:

$$\textit{s h t i Y I I} = [Y I I]$$

701) Gjerm. **stille** = i,e qetë (e pra simb. - ~)

Duke arsyetur si më sipër, mund të shkruajmë edhe:

$$\textit{s t i l l e} \rightarrow \textit{shq. s h t i Y I I}$$

Shpreh më këtu se simboli i "YII-it" është njëkohësisht edhe ay i Qendrës
Misnike e pra:

$$YII = E$$

E pra:

$$YII = E = - \sim$$

Gjë që motivon më së fundi edhe kuptimin e fjalës gjermanisht "**stille**"
(si në "*stiele Nacht*...").

702) Rus. **çest** (честь) = nder

Motivohet si:

$$\textit{ç à â s h t}$$

Dhe vërtetë, i nderuari është një njeri i veçantë. Dhe në Shqip fjala "**i n d e r u a r**" motivohet me: "**i n d a r ë**", i ndarë nga të tjerët, "që ha bukë veç", "**i v e ç a n t ë**"...

703) Rus. **çustvo** (чувство) = ndjenjë

Duhet motivuar si:

$$\textit{ç à â s h t b â} = \textcircled{1}$$

Kjo do të thotë se pa "ndarje" nuk ka "ndjenjë". Por bota ka filluar me një *ndarje* (Paracelsus), pra me një *ndjenjë*, me një "të ndjerë".

Dhe Shqipja "n d j e-një" lidhet me një "n d a-rje", e pra me simbolin \oplus .*

704) Ital. **contare** = numëroj, njehsoj

Do motivuar si:

$$k a n d a r ë = \oplus = (\neq 1) = 2, 3, 4, \dots$$

705) Ital. **quanto** = sa (tregon sasi...)

Zbërthehet me Shqipen si:

$$k a n d à = \oplus = (\neq 1) = s a s i$$

706) Shq. **sa dhe sa-si**

Operatori "S" është ndër të tjera ai i *ndarjes*, duke qenë një paraqitje mistike e gjarpërit (lat. *S-erpens*).

Grafikisht do të kemi:



Për sa kohë "S" ekziston në rolin e saj ndarës (mes sekseve në simbolin e *Yin-Yang*-ut; ** mes të Mirës e të Keqes, fryti i ndaluar në

* Del që këndeje se Qenia Absolute, Zoti, është i n d i f e r e n t, se Ai "nuk ndjen", të paktën në kuptimin njerëzor të fjalës. Kjo rikonfermohet edhe nga të dhënat e Theollogjisë moderne dhe veçanërisht nga eksperiencia e atyre që kalojnë në NDE (*near death experience*).

** Shiko ndër të tjera edhe fq.111, 322 dhe 631.

Parajsë) ne do të kemi gjithmonë *s a s í*, sepse, siç pamë, është ndarja ajo që krijon sasinë – dhe ndarësi *par excellence* është gjarpëri, Djalli (dalluesi).

Është e qartë se sasia, si ndarje, lidhet me kodin F, i cili është, ndër të tjera, edhe kodi i Realitetit material, e pra mistikisht i të Keqes.

Në kodin E sasia zhduket, sepse zhduket ndarja. Kemi, siç dihet:

$$E = - \textcircled{1}$$

Pra kodi E do të jetë ai i cilësisë së pastër.

Për t'u bindur më mirë për këtë le të marrim një shembull nga Ungjilli.

Krishti predikon Mbretërinë Qiellore, pra kodin E.

Atje na flitet për një zotni që pajtoi disa punëtorë për vreshtën e tij: *njëri e pajtoi në mëngjes, tjetrin në drekë, dhe tjetrin në darkë... duke i shpërblyer që të gjithë, pavarësisht kohës së punës, me një dinar, për sa që marrë vesh me ta.**

Pra koha e punës, "sasia", nuk u mor fare parasysh.

707) Hebr. *k a b e d* = ingl. *to be heavy, weighty, severe, numerous* (me qenë i rëndë, gjendje e rënduar, i shumëfishtë)

Me Shqipen:

k a b ë d à

Theksi semantik bie tek "da" e pra simbolikisht:

$$\textcircled{1} = \downarrow = (\neq 1) \quad \dots(F)$$

shq. *da* (*weighty*) (*numerous*)

* Ungjilli sipas Matheut, 20.1-16.

708) Hebr. **k e d e s h** (כַּדְּשׁ) = ingl. *several* (d i s a)

Me Shqipen:

$$\mathbf{k a d a s i} = \textcircled{\ominus} = \mathbf{F} = (\neq 1) \text{ (several...)}$$

Në zgjerim të Bisedës, mund të shkruajmë simbolikisht edhe, me Shqipen:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{\ominus} & = & (\neq 1) \quad \dots(\mathbf{F}) \\ \mathbf{d a s i} & & \mathbf{d i s à} \\ (\mathbf{sever}) & & (\mathbf{several}) \end{array}$$

Vetë Inglishtja:

$$\mathbf{s e v e r a l} < \mathbf{s e v e r} = \text{shq. bërë "S"} = \textcircled{\omin�} = \textcircled{\omin�} = (\neq 1) \dots(\mathbf{F})$$

709) Hebr. **k a d a r** (קָדָר) = ingl. *to be turbid, soiled, dark, gloomy, to wear mourning dress, to mourn; to darken, to obscure* (me qenë i turbullt, i ndyrë, i errët...; të vishesh me të zeza, të mbash zi; të errësosh...)

Motivohet me Shqipen:

$$\mathbf{k a d a r} \rightarrow \text{shq. } \mathbf{k a d a r ë} = \textcircled{\omin�} = \mathbf{F} = \textcircled{\bullet}$$

Kjo fjalë Hebraisht shpie tek simboli "●", që e motivon atë plotësisht me rrezet e tij të ndryshme semantike.

Ekuacioni që përshkruhet në këtë rast është:

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{\omin�} & = & \bullet \quad \dots(\mathbf{F}) \\ \text{hebr. } \mathbf{k a d a r} & & \text{ingl. } \mathbf{d a r k} \end{array}$$

Le ta zgjerojmë tani disi Bisedën:

a) Në Rusisht: "**t m a**" (тьма) = *errësirë*, dhe motivohet me Shqipen:

$$\mathbf{d ā m} = \textcircled{\omin�} = \bullet \quad \dots(\mathbf{F})$$

b) Si një "*Consensio linguarum*" shtojmë edhe Ingl. "d a r k" = *errësirë*.

Motivimi bëhet edhe në këtë rast me anë të Shqipes:

d a r k a → shq. k a d a r ë (ingl. "*has divided*") = ⊕ = F = ●

c) Në Inglisht: "d a m" = diga (ingl. "*break-water*") = ⊕, dhe njëkohësisht po në Inglisht: "d i m" = *errësirë*.

Kështu që Inglishtja shtron edhe ajo, me mjetet e veta, në këtë rast, ekuacionin simbolik themelor:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{d a m} & & \text{d i m} & \end{array}$$

☞ Në Gjermanisht: "D ü s t e r k e i t" = ingl. *darkness, gloominess, dimness* (*errësirë, zymëtirë, terr...*)

Dhe me Shqipen:

D ü s t e r -keit → shq. d y ë s h t ë = 2 = F = ●

d) Në Lituanisht: "t a m s a" = ingl. *darkness, obscurity...* (*errësirë...*)

Motivimi bëhet dhe këtu me anë të Shqipes:

t a m → shq. d ā m = ⊕ = F = ●

dh) Në Rusisht prapë: "ç o r n i" (черный) = shq. i z i = ●.

Motivimi bëhet me anë të Shqipes:

i ç j e r r u n = ⊕ = ● \dots(F)

Le të shtojmë këtu, qoftë edhe anësisht, se motivimi i një fjale vështrohet si i përkryer kur fjala "reduktohet" (çohet) tek simboli që ajo në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme përshkruan. Këto gjëra i

kemi thënë e përsëritur kaq e kaq herë në studimet tona, prandaj dhe nuk po zgjerohemi më tej mbi këtë çështje themelore. Në rastin e fjalëve të motivuara më sipër, simboli tek i cili fjalët Hebraisht ("k a d a r") dhe Rusisht ("t m a" e "ç o r n i") reduktohen për motivim, është "●", që është pikërisht ai që ato përshkruajnë, qoftë edhe (brenda sistemit të tyre gjuhësor) në mënyrë të pavetëdijshme.

E themi këtë sepse në Hebraisht fjala "k a d a r" nuk është e mundur të ndahet në pjesët përbërëse "k a" dhe "d a r". Kjo do të kish qenë e mundur vetëm në qoftë se "k a" në Hebraisht do të thoshte "me pasë" (ingl. *to have*) dhe "d a r" do të kishte kuptimin e "ndarjes" (simb. \ominus). Gjë që nuk ndodh.

710) Hebr. k a d m a (קדמא) = ingl. *origin, primitive state; before* (zanafillë, gjendje primitive; përpara)

Motivimi bëhet në këtë mënyrë:

$$k a d m a \rightarrow \text{shq. } k a d \bar{a} m = \ominus = -1 = F$$

Le të ndalemi për një çast këtu.

Le të kujtojmë të thënë e Paracelsusit të madh:

"Die Separatio ist aller Geburt Anfang."

(Ndarja është fillimi i çdo lindjeje.)

Kjo do të thotë, siç provohet dhe në shumë mënyra të tjera brenda Gjuhës dhe jashtë saj, se *fillimi* realizohet me një *ndarje* e pra simb. \ominus , dhe pra atëhere edhe -1 , me qenë se Algoritmi Simbolik na jep:

$$\begin{array}{l} \ominus = -1 \quad \dots(F) \\ \text{ndarja} \quad \text{zanafilla} \end{array}$$

Një motivim në rrafshin gjuhësor të kësaj të vërtete themelore e gjejmë, ndër të tjera, dhe në Gjermanisht, ku kemi:

$$\textcircled{1} = -1 \quad \dots(F)$$

Bruch	Aufbruch
(ndarje)	(fillim)

711) Hebr. **k e d e m** (כֶּדֶם) = ingl. *what is in front, before; the east, easte. lands; primitive, things of old* (shka asht përpara, shka ka kenë ma parë; lindja, vendet e lindjes; primitiviteti, lashtësia)

Pra:

k e d e m → shq. **k a d ā m** = $\textcircled{1}$ = **F** = **-1** = *i, e para...*,
përparësia, "ajo shka ndodhet përballë", etj. etj.

një ndarje ($\textcircled{1}$), e pra atëhere edhe me një *negativitet* (**-1**).

Në zgjerim të Bisëdës, le të japim edhe këtë shembull:

Italisht: "**a v a n t i**" = *para, përpara*. Me Shqipen: "**â b â n d à**" = $\textcircled{1}$.
Dhe në të njejtën kohë: "**d a v a n t i**" = *përballë, përpara...*

Kështu shpjegohet edhe përse Hebraishtja "kedem" do të thotë edhe *e para, fillim...*, por edhe *përballë*.

Nga ana tjetër, me qenë se:

$$\textcircled{1} = F = -1$$

kuptojmë edhe përse "e p a r a" jepet në këtë Botën tonë materiale me një "negativitet", i cili negativitet është, fundja më në fund, sipas Theologjisë së Krishterë: "*I pari i kësaj Bote...*"*

* Gjoni, 14:30.

Kuptohet vetvetiu edhe se që "shka asht e para" do të lidhet direkt me "Lindjen", me "lashtësinë"...

712) Hebr. **k a d m o n i** (קַדְמוֹנִי) = ingl. *eastern; former; primitive, primeval, ancient, past* (lindor; i mëparmë, primitiv, i lashtë, i kaluar)

Motivimi me Shqipen:

k a d ā m u n

e pra simbolikisht:

$$\textcircled{1} = F = -1$$

Në zgjerim të Bisedës mund të shtojmë edhe se sipas Algoritmit Simbolik:

$$\textcircled{1} = 1/2 = 2 = -1 \dots(\textcircled{2})$$

Kjo do të thotë se Bota ka filluar me një *mohim* (-1), *ashtu sikundër* ka filluar edhe me një *ndarje* ($\textcircled{1}$), me qenë se këto dy figura simbolike janë ekuivalente.

Kjo do të thotë akoma se Bota është me prejardhjen e saj "negative", si edhe pra edhe vetë negative, e pra edhe e keqe ($-1 = \textcircled{2}$) sipas vizionit të lashtë mistik të Universit.

Mund të shtojmë akoma këtu, duke argumentuar simbolikën e numurit *d y* (2) në këtë çështje, se krijimi i Botës, lindja e saj, lidhet me një *d u a l i t e t* ($2 = (x \neq -x)$), jo vetëm, porse ajo është krijuar në *një moment të dytë* (me qenë se Algoritmi Simbolik jep: ($-1 = 2$).

Dimë nga sa kemi parë përpara se:

"Nga një krim, krijimi."

Që këndej edhe numuri simbolik " -1 " (*negativitet*) dhe " 2 " me të gjitha atributet negative dhe ogursëze të këtij numuri të ligë, djallëzor.

Kështu pra motivuam më së miri të gjitha kuptimet e fjalës Hebraisht "k a d m o n i", si edhe "k e d e m" etj. etj.

Kujtojmë nga Shqipja edhe aforizmën:

"Shka ndahet, ndyhet."

ose edhe:

"Nga ndarja, ndyrja."

Aforizëm kjo që mund të jepen simbolikisht me ekuacionin tashmë të stërnjohur nga ne:

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

n d a r j e n d y r j e

Kështu pra, gjersa Bota krijohet me një ndarje, ajo s'mund të jetë veçse e ndyrë, qoftë edhe në një kuptim thjesht abstrakt dhe metafizik. Vëmë ré gjithashtu se vizioni mistik i Lindjes mbi Botën është, për pasojë, siç del nga analiza etimologjike dhe fillosofike e gjuhërave të stërlashta (duke përfshirë këtu në radhë të parë Shqipen e pastaj Hebraishten dhe pas asaj Sanskritishten...), një vizion kryekëput pesimist, tragjik.*

713) Hebr. **ke b u r a** (קַבְרָה) = ingl. *interment, sepulture; grave, sepulchre* (varrim, varr)

Motivimi:

$$k e b u r a \rightarrow \text{shq. } k a b i r \ddot{e} = \square$$

Duhet menduar se:

$$\text{shq. "v a r r" < "b i r \ddot{e}" = v \ddot{e} r \ddot{e} = v r i m \ddot{e}}$$

* Shih edhe fq.462.

714) Hebr. **k a v a r** = ingl. *buried* (i varrosur)

Është Shqipja:

k a v a r r u e
(nga fjala shq. "varr")

Krahaso edhe me Shqipen "q i - v u r".

715) Hebr. **k o b e l** = ingl. *front, in front, in the presence of...* (përballë, në prani të...)

Motivimi:

k o b e l → shq. **k a b a l l** → ball, balli (ingl. *front*)

Në Shqip gjithashtu: "për ballë" = "në prani të..." (ingl. *in presence of...*).

Mund të hipotetizojmë se origjina e kësaj fjale në Hebraisht mund të lidhet me perëndinë Baal të Babilonasve.

Në një sërë rastesh Mbreti, i Pari i shtetit tregohej me një mbiemër, si bie fjala atë të të *ndarit veçan nga të tjerët*, atë të të *parit*, e kështu me radhë... Për shembull: **K a d m i**, mbreti mitik i Fenikasve, do të thotë fjalë për fjalë "K a d a m u n", e pra "i damuni" nga të tjerët, ai që ha bukë veç..., i dalluari, i shquari, i adhuruari... Kështu edhe në rastin e Baal-it, mund të mendojmë që ai është karakterizuar si ai "qëndruesi në ballë të të gjithëve", e pra si "i pari", e pra si "mbreti", e pra si "Zoti".

716) Hebr. **k e b e r** (כְּבֵר) = ingl. *grave, sepulcher* (varr)

Motivimi:

k e b e r → shq. **k a b i r ë** = ☉

Le të vëmë ré këtu se Hebraishtja nuk është në gjendje ta motivojë këtë fjalë, sepse për këtë do të duhej që në këtë gjuhë "k e-" dhe "-b e r" të qenë operatorë të lirë, në kuptimin "k a" (folja: *me pas*) dhe "b i r ë" (*vrinë*).

Me që rà fjala, vëmë ré se: *Një numër gllosash Hebraisht, ashtu sikundër edhe Sanskritisht, hiqen si të thjeshta, kurse në fakt Shqipja i nxjerr por, me operatorët e saj, si të përbëra.*

Kjo është një pikëpyetje e madhe lidhur me origjinalitetin, që aq shum trumbetohet, të këtyre gjuhërave, ...

717) Hebr. *k a d a d* (קַדַּד) = ingl. *to incline, to bend, to bow down* (përkul...)

Motivimi:

k a d a d → shq. *k a d à* = ⊕ = *F* = ∩ = ...

Në zgjerim të Bisedës shtojmë edhe se Inglishtja: *to bend* = përkul, mund të etimologjizohet si:

b e n d → shq. *b ë n d à* = ⊕ = *F* = ∩ = ...

Vëmë ré pra të njejtën *taktikë semantike* në këto dy gjuhë, në Hebraisht dhe në Inglisht.

718) Hebr. *k a d o s h* (קָדוֹשׁ) = ingl. 1) *selected, pure, holy; sanctuary, the holy one;* 2) *dirty, villain* (i zgjedhur, i kulluar, i shenjtë; vend i shenjtë, shenjtor; i ndyrë, i poshtër)

Motivimi:

k a d o s h → shq. *k a d y s h* = 2 = *F* = -1 = ● (*dirty, villain*)

Me qenë se siç dimë, në gjuhët e lashta e sidomos të stërlashta, dy koncepte të kundërt tregohen me të njejtën fjalë, Hebraishtja "k a d o s h" do të ketë edhe kuptimin e "-x", e pra të "+1".

Mund të shkruajmë pra:

$$\begin{array}{rcccl} \text{k a d o s h:} & x & = & -x & \dots(\text{E}) \\ & +1 & & -1 & \\ & & & & (\text{holy, pure}) \quad (\text{dirty, villain}) \end{array}$$

Pra kështu gjejmë edhe kuptimin tjetër, "të kundërt", të fjalës që po shqyrtojmë, atë të *pastërtisë shpirtërore* (puritet), të *shenjtërisë* (\bigcirc).

719) Hebr. k a d a c h (קָדַח) = ingl. *to burn, to glow; to kindle* (dijgjem, lëshoj dritë; ndez, djeg)

Motivimi:

$$\text{k a d a c h} \rightarrow \text{shq. k a d à} = \bigcirc = (\rightarrow \neq \leftarrow) = \text{ndeshja} = \text{ndezja} = *$$

Edhe Inglishtja na thotë të njejtën gjë me qenë se tek fjala "k i n d l e" = *me ndez*, kemi grupin "n d" të ndarjes, ashtu sikundër dhe në Shqipen "n d e z". Me fjalë të tjera, këto dy fjalë, pamvarësisht se i përkasin dy gjuhërave të ndryshme, janë ndërtuar sipas të njejtës *strategji semantike*, nëpërmjet operatorit të lirë të Shqipes (por jo të Inglishtes) "n d a".

Që *ndezja* lidhet me një *ndeshje*, me një përplasje, këtë e gjejmë edhe në Inglisht ku fjala "m a t c h" do të thotë në të njejtën kohë *ndeshje* (si p.sh. një ndeshje sportive apo boksi, etj.), por edhe *ndezje* (kujto: "*safety match*"...).

Analiza e Gjuhës kështu siç e bëjmë ne (në rastin tonë zberthimi i fjalëve "k i n d l e", "n d e z", "k a d a c h"...) na lejon të hipotetizojmë krijimin e

Botës, e pra dhe Teorinë e *Big Bang*-ut, si një *përplasje*, si një *ndeshje* të të kundërtave, që gjer atëhere, *para fillimit* të Botës, mirreshin vesh goxha mirë mes tyre, "bashkëjetonin" në paq. Ky është dhe mendimi i Hegelit kur flet për "unitetin e të kundërtave", e pra simb. $(x = -x)$, që përbën atë që ai quan T e z ë; dhe momentin e dytë të Triadës hegeliane, që ai quan A n t i t e z ë, që nuk është gjë tjetër veçse mospajtimi, "mos uniteti" (përplasja) tashmë e të kundërtave.*

Në gjuhën e Algoritmit Simbolik:

$$\text{Teza} = (x = -x) = E$$

$$\text{Antiteza} = -(x = -x) = (x = x) = F$$

Duke qënë kështu, krijimi i Botës, që është ay sipas Hegelit i kalimit nga Teza te Antiteza, nuk është gjë tjetër veçse kalimi (rënia) nga kodi E në kodin F. Ai përfshihet kështu pra në skemën e përgjithshme të të gjithave miteve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

Me një mendjemadhësi ndofta disi të merituar, do të thonim, me mburrje:

"Asgjë nuk i shpëton dot Algoritmit!"

Stephen Hawking në zbulimet e tija më të fundit flet për "*Singularity*", që është sipas tij Origjina e Kozmosit temporal dhe spacial, duke qënë ajo vetë jashtë Kohës dhe Hapësirës.

Po ne mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned} \text{Singularity} &= 1 = (s = 0, t = 0) = \dots = E = \\ &= (x^2 + y^2 = 0) = \text{pika}, \dots \end{aligned}$$

* Në gjuhën e Hegelianizmit të "majtë", ku përfshihet natyrisht edhe Marksizmi: "lufta e të kundërtave", $(x \neq -x)$.

Thjesht Pika...^{*} thjesht çdo pikë gjeometrike që lidhet me Imagjinerin dhe me Trashendencën.

Kështu që edhe "Singularity", ky zbulim i fundit i Kozmollogjisë moderne, del i përfshishëm në Algoritmin tonë Simbolik.

720) Hebr. **k a d i m** (כַּדִּים) = ingl. *what is in front, the east, east side, astern wind* (shka asht përballë, përpara, ana lindore, era e veriut ("veri", "veriu"))

Motivimi:

$$k a d i m \rightarrow \text{shq. ka dam} = \textcircled{\ominus} = F = -1$$

Një shpjegim këtu mund të jetë i nevojshëm:

Bota fillon me një negativitet, pra "e para" është gjithmonë "- 1 " dhe jo " 1 ".** Algoritmi Simbolik jep:

$$F : -1 = 2 = \textcircled{\ominus} = 1/2 = \bullet = \infty = \dots (\rightarrow \leftrightarrow) = \downarrow \dots$$

Kjo do të thotë, ndër të tjera, se Bota fillon me kodin F, e pra rrjedhi-misht edhe *me një figurë simbolike çfarëdo të këtij kodi*. Kjo është në përputhje të plotë me formulën e përgjithshme, siç pamë edhe pak më lart, të mitheve kozmogonike:

$$E \downarrow = F$$

Kujtojmë këtu për ata që mund ta kenë harruar, se çdo figurë simbolike në kodin F përfaqëson, në atë mënyrën e saj, një mit të caktuar kozmogonik.

* Nocionin e "Pikës" si "Origjinë" të gjithshkaje, e gjejme edhe tek fillo-sofët e lashtë kinezë, që e tregonin atë me "P i". Që këndeje besojmë se del edhe fjala Shqipe "p i - k a", që do lexuar etimologjikisht si "k a P(i)".

** Shih lidhur me këtë edhe fq.685 dhe 796.

Kështu p.sh. :

⊖ = simboli i *ndarjes*, simboli i *shqyerjes* (ingl. *dismemberment*) i një Qenie Hyjnore, e pra simbolikisht i " ○ ".

(→≠←) = *ndeshja, lufta...* (sikundër lexojmë tek Cirlot: "*Hindu tradition links the struggle of the gods with a tribe of devils called Auras, or with monsters of some other kind...*")*

∞ = *nyja, lidhja*, "Hieros Gamos" (Martesa e Shenjtë ndërmjet Qiellit dhe Tokës) që u bë shkas për krijimin e Botës...

↓ = Rënia... (gjithpò tek Cirlot: "*The creation of the world as the fall of the Spirit into the matter...*")**

Kështu edhe më tej...

721) Hebr. *k a d a m* (קָדַם) = ingl. *to go before, to anticipate, to be beforehand, to be early, to meet, to encounter* (me shku para, me i dalë para punës, me qenë i pranishëm, me qenë herët; me ndesh, me taku)

Motivimi:

k a d a m → shq. *k a d ā m* = ⊖ = *F* = -1 (*go before, anticipate*)
= (→≠←) (*to meet, to encounter*)

Këtu, si kudo, " - 1 " tregon *parësinë materiale* në Kohë dhe në Hapësirë.

* Cirlot, "*Cosmogony*" (fq.64): "Traditat indiane e lidhin *luftën* e perëndive me një tribu djajsh të quajtur Asuras apo me monstra të një tjetër lloji."

** Po aty, "*the Fall*": "Krijimi i Botës si *rënia* e Shpirtit në materie..."

Duke zgjeruar disi Bisedën:

$$-1 = \textcircled{1} = 1/2 = 2 = \bullet \dots(F)$$

Kështu:

"Realiteti material është vetëm gjysma (1/2) e tërë Realitetit (\bigcirc)."

Tek Cirlot lexojmë: "As Schneider has observed, the eternal duality of Nature means that no phenomenon can ever represent a complete reality, but only one half of a reality..." [...Sikundër Shnajder vë rë: dualiteti i përjetshëm i Natyrës na jep të kuptojmë se *asnjë fenomen nuk mund të paraqesë një realitet të plotë, por vetëm një gjysëm realiteti.*]*

Simbolikisht pohimi i Schneider-it mund të përkthehet si:

$$2 \text{ (dualiteti)} = F = \textcircled{1} = 1/2 \cdot \bigcirc \text{ ("gjysma e tërës"...)}$$

Pra Schneider-i ka "algoritmikisht" të drejtë.

Duke zgjeruar dhe më tej Bisedën:

Fenomeni (\bullet) na jep vetëm gjysmën e Realitetit, e pra vetëm " 1/2 " e të Tërës (\bigcirc). Atëhere pra Bota fenomenale nuk mund të vështrohet si e vërtetë dhe ne në të nuk mund të jemi të lirë, edhe sepse dimë që:

$$(x = -x) = \bigcirc = E = -\infty$$

e Vërteta Liria**

Pra atëhere edhe:

$$1/2 = -\bigcirc = F = \infty = \text{skllavëria, Ligji}$$

* Shih Cirlot, "Binary" (fq.24).

** Shiko ndër të tjera edhe fq.85, 158, 356, 372, 500 dhe 689.

722) Hebr. **k u r** (קוּר) = ingl. *to dig, to dig up* (grryjej)

Është Shqipja:

grryj; kruj; gërmoj

723) Hebr. **k a t a r** (קָטַר) = ingl. *to kindle, to burn incense; to sacrifice*
(ndez, djeg, ndez thimjan; sakrifikoj, bëj theror)

Motivimi:

k a t a r → shq. **k a d ā r** → ⊕ (*therr, therror*) = **F**
= (→≠←) = * (*ndez, djeg*)

Duke e zgjeruar Bisedën, shtojmë se në Shqip gjithashtu "t h e r",
"t h e r o r", "t h e r o r i"... që lidhen me kuptimin tjetër të Hebraishtes
"katar", atë të *sakrificës fetare, të kurbanit*.*

724) Hebr. **k a t a r** (קָטַר) = ingl. *to shut, to enclose* (mbyll, fut mbrenda)

Motivimi:

k a t a r → shq. **k a d ā r** = ⊕ = **F** = ⊖ (*shut, enclose*)

Vëmë ré këtu se Hebraishtja shtron këtë ekuacion tepër të rëndësishën
simbolik:

⊕ = ⊖ ... (F)
k a t a r k a t a r

Simboli i parë është ai i mitit kozmogonik të *shqyerjes* (ingl. *dismemberment*),
ndërsa i dyti ai i *burgosjes*, i kapjes së parimit Hyjnor (⊖), që përbën
edhe ky një mith kozmogonik më vete.

* Shiko ndër të tjer edhe fq.34-35, 97, 237 dhe 627.

Ekuacioni i mësipërm tregon, ndër të tjera, se këto dy mithe, ai i *therjes* dhe ai i *kapjes* a burgosjes të Parimit Hyjnor, janë të barazvlefshëm.

Del që këndeji se *K u r b a n i*, i theruri, therori ($\textcircled{1}$), kapet, burgoset, vendoset në Qëndër ($\textcircled{\square}$). Në këtë mënyrë zë fill dhe krijimi i Botës, siç e dëshmojnë gjuhërat e ndryshme.

Bie fjala:

Në Gjermanisht: "A n-f a n g" = *fillimi* = -1 , dhe njëkohësisht po në Gjermanisht: "f a n g-e n" = *me kap, me burgos*, "Ge-fang-ene" = *i kapuri, i burgosuri* = $\textcircled{\square}$, si edhe X .

Në Shqip: "z ë" = 1) *kap, burgos...* X , $\textcircled{\square}$; 2) *filloj...* -1 . Kështu pra Shqipja shtron ekuacionin themelor simbolik të *krijimit të Botës* me një kapje, me një zënie (si edhe Gjermanishtja):

$$\begin{array}{ccc} \text{X} , \textcircled{\square} & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{shq. zë} & & \text{zë} \\ \text{gjerm. fangen} & & \text{Anfang} \end{array}$$

Në Latinisht: "c a p-ere" = shq. "me *k a p*" (X), dhe në të njëjtën kohë: "in-c i p-ere" = shq. *filloj* (-1). Pra Latinishtja shtron edhe ajo ekuacionin e rëndësishëm:

$$\begin{array}{ccc} \text{X} & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{capere} & & \text{incipere} \end{array}$$

Mund të jipen dhe shumë e shumë shembulla të tjera, por nuk është vendi këtu, sepse do të zgjateshim e stërzgjateshim pa fund...

Të gjitha këto shembulla, sidoqoftë, vlejnë për të rikonfermuar një mith kozmogonik themelor, atë të "Kurbanit", të Hyjnisë së sakrifikuar (apo "të vetë-sakrifikuar"...) për krijimin e Botës.

725) Hebr. **m e b a d a l** = ingl. *to sever, to separate, to divide, to discern, to distinguish...* (me ndà, me pjestú, me diktú, me dallú, me bâ dallú...)

Motivimi me Shqipen:

m e b â d a l l ũ = simb. ⊕

Interesant është të vihet ré këtu edhe fakti se si në Shqip, ashtu edhe në Hebraisht, paskajores së foljes i paravihet parafjala "m e". Kjo flet për një afërsi akoma më të madhe, edhe në sferën e gramatikës dhe të sintaksës, të Hebraishtes me Shqipen.

Operatori i Shqipes "d a l l o j", që gjendet pak a shumë i tillë edhe në Hebraisht, ka dhënë në gjuhën Ruse shumë fjalë të rëndësishme dhe **sajimin** e disa ekuacioneve simbolike po aq të rëndësishme.

Po rrjeshtojmë disa prej tyre:

"d e l i t s" (делить) = me dà

"d e l a t s" (делать) = me bâ

Pra formohet kështu ekuacioni simbolik themelor "Paracelsian"*:

⊕ = ● ... (F)
delits delats

Në Shqip po ky ekuacion jepet me:

⊕ = ● ... (F)
bë daj bdaj (bëj)**

* Shih edhe fq. 43, 113, 269, 388, 742 dhe 761.

** Shih edhe fq. 156, 243, 348, 446, 543 dhe 701.

Po në Rusisht:

"d o l j a" (доля) = risk, fat (⊕)

"d o l l o j" (долой) = poshtë (↓)

"d o l l g o" (долго) = i gjatë (← →)

"d a l e k o" (далеко) = larg (A... B)

"d o l j e j e" (далее) = më tej (2)

...

Në Shqip ky operator ka dhënë ndër të tjera fjalë si:

"d a l l o j", "d a l", ... etj.

726) Hebr. b o r (בּוּר) = ingl. *pit, hole; well; grave* (gropë e thellë, vrimë; pus; varr)

Është Shqipja:

birë, brimë,...

(në të folmen e Jugut: **v ë r ë**)

Në Shqip kemi gjithashtu:

"v a r r", "v o r r"... (ingl. *grave*)

Në zgjerim të Bisedës le të shtojmë edhe sa vijon:

Italishtja **"v e r o"** (Lat. "v e r u s") nuk është tjetër veçse Shqipja:

"v ë r ë" (ingl. *hole*) = simb. **o**

Dhe ja përse:

$$\begin{aligned} \text{Shq. } \mathbf{v \ddot{e} r \ddot{e}} &= \text{Pika (gjeometrike)} = (\mathbf{x^2 + y^2 = 0}) \\ &= (\mathbf{x = -x}) = \text{Coincidentia oppositorum} = \text{the Mystic Centre} \\ &= \text{the Supreme Principle of the Universe} = \mathbf{e V \ddot{e} r t e t a} \end{aligned}$$

Pikërisht pra atë që donim të vërtetonim...

Mund të shohim lidhur me këtë, edhe ato sa thotë Cirlot, i cili e barazon Pi-kën (gjeometrike) me Qëndrën, duke shpallur shprehimisht se: "The p o i n t is the Mystic Centre..." (Pika është Qendra Mistike...)*

Duke iu rikthyer përsëri ekuacionit të Qendrës Mistike, do të kemi:

$$\begin{aligned} (\mathbf{x^2 + y^2 = 0}) &= (\mathbf{y = \pm ix}) \\ &= (\mathbf{tg \psi = i}) = \mathbf{i} = \text{"njësia imagjinere"} = \text{Imagjinata} \end{aligned}$$

Kjo do të thotë ndër të tjera se:

"Qendra është imagjinere."

e pra ajo, duke qenë jashtë Kohës dhe jashtë Hapësirës,** është e paarritshme nëpërmjet Arsyes, ajo nuk bën pjesë në këtë Botën tonë materiale, ajo është pra e "mbinatyrshme" (trashdentale), jo materiale por Spirituale dhe, si e tillë, "e komunikueshme" vetëm përmes Imagjinatës. Nuk përbën, e thënë ndryshe, si e tillë, një "objekt shkencor", por "artistik" dhe theollogjik.

Mund të themi edhe se:

"Qendra (Pi-ka) është kudo, por edhe askund."

* Shiko ndër të tjera *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*, fq.796.

** $(\mathbf{x^2 + y^2 = 0}) = (\mathbf{x = -x}) = \mathbf{E} = (\mathbf{t = 0, s = 0})$

Ajo identifikohet me Sub-stancën* e çdo *quid*-i material, pa u identifikuar me të, si një ndën-realitet, si një nënshtresë e zhytur e tëra në Imagjiner, në Trashendencë.

Kjo është, fundja më në fundja, dhe e Vërteta.

Kjo është njëkohësisht e Tëra, dhe kjo sepse:

$$(x = -x) = \bigcirc \quad \dots(E)$$

Në Inglisht:

h o l e = vrima = Qendra

por njëkohësisht edhe:

W h o l e = e Tëra

dhe mund të shtojmë akoma këtu:

H o l y n e s s = Shenjtëria

Duke qenë kështu, ne shohim se Pi-ka (*vrima*, ingl. *hole*) përbën ndër të tjera edhe një "objekt" theollogjik. Kështu e kanë menduar edhe të Parët tanë, me atë shprehjen e tyre të famshme, të trashëguar gojë pas goje gjer tek ne: "*E vërteta është një pikë, xhahilat (injorantët) e zmadhojnë*"...

Gjithnjë në zgjerim të këtij zgjerimi të Bisedës, shtojmë edhe sa vijon:

Në Inglisht: "**t r u e**" = *i, e vërtetë*, kurse në Frengjisht: "**t r o u**" = *vrimë*.

Nuk ka dyshim se, duke u mbështetur në sa më sipër, ne mund të sajoj-
më këtë ekuacion simbolik ndërgjuhësor:

$$\begin{array}{ccc} \circ & = & \bigcirc \quad \dots(E) \\ \text{fr. } \mathbf{trou} & & \text{ingl. } \mathbf{true} \\ \text{(vërë)} & & \text{(e vërtetë)} \end{array}$$

* Lidhur me veprën madhore të Spinozës, "*Etika*", shih edhe fq.298.

727) Hebr. **b e k o r** (בְּכוֹר) = ingl. *first-born, eldest son* (djali i madh)

Motivimi:

b e k o r → shq. **b ë k r y** = "b ë k r e u" (i para-linduri...)

728) Hebr. **b a l a** (בָּלַע) = ingl. *to swallow, devour, eat up* (gëlltis, përlaj, ha gjer në fund)

Theksi semantik bie këtu mbi "l a", ndërsa "-b a" është një prostazë pa theks semantik, që mund të identifikohet me Shqipen "b â" në kuptimin e "bërjes" (ingl. *doing*), d.m.th. në kuptimin e një pjesëze verbalizonjëse.

Prostata vihet më dendur në fund të një emri a mbiemri për ta verbalizuar atë, por ndodh shpesh që kjo edhe paravihet.

Kështu p.sh. në Gjermanisht:

"s c h r e i b e n" = me shkru

Zbërthehet si "s c h r e i - b e n" ku "ben" është Shqipja "bëj" dhe tërë fjala do të thotë pra:

"b ë n s h k r ū"

Këtu pra siç shihet, prostaza verbalizonjëse vihet pas.

Kurse në fjalët "v e r - b e ß e r n" (= përmirësoj), "v e r - ä l t e r n" (= plakem), kjo prostazë, që është e identifikueshme me Shqipen "b ë r ë", vihet përpara.*

Në Shqip, në vend të Hebraishtes "-b a", është paravënë në këtë rrënjë, "p ë r -" që s'është tjetër veçse një trajtë e deformuar "ligjërisht" e foljes Shqipe "b ë r ë". Pra ndërsa Hebraishtja thotë "b â l á", Shqipja thotë "p ë r l á". Pra thonë që të dyja të njejtën gjë...

* Shih lidhur me këtë edhe fq.290 dhe 537.

Mund të themi se operatori "l a", kuptimdhënës i kësaj fjale Hebraisht, është më autokton në Shqip se sa në Hebraisht. Dhe kjo për arsye se në Shqip kemi:

për-lyj, lyj

dhe njëkohësisht:

për-l a j, l a j

Shqipja pra shton kështu ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \bullet & = & \circ & \dots(E) \\ \text{lyj} & & \text{l a j} & \\ (\text{për-lyj}) & & (\text{për-laj}) & \end{array}$$

Një gjë e tillë nuk ndodh në Hebraisht, por ndodh në Shqip, siç duhet të ndodhi në çdo gjuhë të stërlashtë sipas Abel.*

Në Shqip, me këtë "lojë" fjalësh sajohet aforizma:

"Ma parë shlymja, mandej shlumja."

Që jep ekuacion e rëndësishëm simbolik:

$$\begin{array}{ccc} - \bullet & = & - \text{X} & \dots(E) \\ \text{shlymja} & & \text{shlumja} & \end{array}$$

Kjo e rivërteton edhe njëherë autoktonicitetin më të madh të kësaj rrenje të thjeshtë në Shqip se sa në Hebraisht.

Në zgjerim të Bisedës, le të flasim pak për rëndësinë e këtij ekuacion themelor simbolik.

* Shih edhe fq.224, 260 dhe 604.

Me qenë se mund të shkruajmë:

$$- \bullet = \bigcirc = e \text{ Tana} = e \text{ Vërteta}$$

atëhere rigjejmë në këtë mënyrë të thënë e famshme të Krishtit në Ungjill:

*"Do të njihni të Vërtetën (\bigcirc)
dhe e Vërteta do ju bëjë juve të lirë ($-\infty$)."*

Duke shumëzuar të dy anët me " - 1 ", përftojme ekuacion simbolik:

$$\bullet = \infty \quad \dots(F)$$

një ekuacion ky shumë i rëndësishëm me interpretime të shumta në fusha të ndryshme të Dijes, siç kemi vënë në dukje gjatë shtjellimit të këtij studimi.

Rigjejmë ndër të tjera edhe këtu, një të thënë të famshme të Krishtit në Ungjill:

*"Kush mëkaton (\bullet), bëhet skllav (∞) i mëkatit."***

Kujtojmë se ky ekuacion është ndër të tjera edhe ay i "Hieros Gamos" (Martesës së Shenjtë), që përbën një nga mithet kozmogonike kryesore. Në të " \bullet " simbolizon *Botën materiale*, ndërsa " ∞ " *Martesën e Shenjtë* (mes Qiellit dhe Tokës).

* Ungjilli sipas Gjonit (8:32), Greqisht: *"καὶ γνώσεσθε τὴν ἀλήθειαν καὶ ἡ ἀλήθεια ἐλευθερώσει ὑμᾶς"*; Lat.: *"et cognoscetis veritatem et veritas liberabit vos"*.

** Gjoni (8:34), Greq.: *"...πᾶς ὁ ποιῶν τὴν ἁμαρτίαν δοῦλός ἐστιν τῆς ἁμαρτίας"*; Lat.: *"...omnis qui facit peccatum servus est peccati"*.

Duke përfunduar themi pra se:

Gjuha përmban një informacion të pasur e të rëndësishëm, i cili mund të nxirret prej saj nëpërmjet: 1) Shqipes (që e shpie fjalën e huaj te simboli tek i cili ajo në mënyrë "të pavetëdijshme" referon: *Roli Mesianik i Shqipes*); 2) Algoritmit Simbolik (që mund të përftohet në tërësinë e tij si nga Shqipja, ashtu dhe nga një gjuhë tjetër çfarëdo, me qenë se është thënë e provuar se ekziston një Invariant Ndërgjuhësor i përbërë nga një grup ekuacionesh simbolike, që është po ay për të gjitha gjuhët).*

729) Hebr. h a s h (שש) = ingl. *hush! silence!* (hesht!, qetësi!)

730) Hebr. h a s h a (ששה) = ingl. *to silence, to still* (bëj të hesht, qetësoj)

Në Shqip "h e s h t" zërthehet në:

" H " ë s h t ë

e pra:

"është H"

Një sqarim:

Gërma " H " (ה) në Hebraisht është gërma e pestë e alfabetit dhe kuptimi i saj është: "*foramen aeri*" (= vrimë ajri).

Ajo është kështu pra një *frymë* e jo një tingull, sepse nuk ka shqiptim tingëllor, është e pazëshme. Prandaj dhe në Italisht quhet: "*Acca muta*", d.m.th. " H "-ë e pazëshme. Kjo shpjegon atëhere përse fjala Shqipe "h e s h t" e mban theksin semantik kryesisht dhe tërësisht tek gërma " H ", ashtu sikundër nga ana tjetër edhe Hebraishtja, për ata që dinë të shikojnë e të kuptojnë...

* Për të gjitha këto kemi folur gjetiu dhe referojmë pra atje, ndër të tjera edhe fq.3, 255, 263, 336, 422 dhe 595.

731) Hebr. **din** (דִּין) = ingl. *to judge, to punish,...* (gjykoj, dënoj,...)

Motivimi:

$din \rightarrow shq. \text{daj, dān...} = \textcircled{1}$

Është fjala për "damjen e sherrit" nga gjyqtari, "damjen e davasë"...

Dhe në mënyrë më të "zgjeruar":

$dān \rightarrow \textcircled{1} (\textit{judgment})^* = F = \leftrightarrow (\textit{cause}) = (\rightarrow \neq \leftarrow) (\textit{law-suit}) = \dots$

Kuptimi tjetër, ay i "dënimit", del fare qartë nga Shqipja: "**d ë n o j**". Si rikonfermë, a më saktë si "*Consensio linguarum*", mund të sjellim edhe këto shembulla:

Ingl. "**t o c o n d e m n**" = *dënoj*...

Motivimi me Shqipen jep: "**k a d ā m u n**" = $\textcircled{1} = F = \bullet$.

Ital. "**c o n d a n n a**" = *dënim*. Theksi semantik bie ketu tek "d a n n" që është Shqipja "**d a m u n**" me një asimilim progresif: ($m \rightarrow n$).

Nga të gjitha këto shembulla e të tjera që mund të sillen, theksi semantik në të gjitha këto fjalë, duke përfshirë dhe Hebraishten, bie tek gërma "**D**", që është themelore këtu në kuptimdhënien e fjalës.

732) Hebr. **de oth** (דְּעוֹת) = ingl. *knowledge, wisdom* (njohuri, dituri)

Lidhet si me prejardhjen e saj me Shqipen:

di, dit, dije, dituri

"me ditë", "dijen i", "i dits h ë m", "dijetar"..., si dhe metaforikisht "**dita**" (ingl. *the day*).

* Shih edhe fq.106 dhe 542.

Spektri semantik i kësaj rrënje në Shqip është shumë i gjerë, po aq edhe sa përhapja e tij, në trajtë të ndërallur a të hapur e të thjeshtë, edhe në shumë e shumë fjalë të Shqipës. Gjë që na shtyn të mendojmë për një përparësi të mundshme dhe një autoktonicitet më të mundshëm të këtij operatori në Shqip se sa në Hebraisht.

733) Hebr. **d a t h** (דַּתּוּ) = ingl. *knowledge, information* (dituri, informatë...)

Edhe këtu kemi Shqipen:

d i t - u r i

(dije, me ditë, etj.)

nga rrënja e pastër foljore "d i", "me d i t".

Këtë rrënjë e kemi edhe në Sanskritisht, si p.sh. në "V e d a" (वेदाः), që përfaqëson thesari më i lashtë i kulturës botërore. Kjo fjalë do zëbërthyer si: "v e d a" dhe me Shqipen: "b â d i".

Në Sanskritisht gjithashtu: "a v i d y a" (अविद्या) = *mosdije, injorancë*, që zëbërthehet me anë të Shqipës si: "– b ë d i" = *mosdije*...

734) Hebr. **d a r o m** (דָּרוֹם) = ingl. *south, southern region* (jugu, krahinë jugore)

Motivimi:

d a r o m → shq. **d ā r j a m** = "jam e ndarë" = ⊕ = **F** = ...

= ↓ = poshtësi, j u g

Le të shtojmë këtu gjer diku si një rikonfermë Frengjishten "m i d i", që do të thotë në të njejtën kohë "mes–ditë" (*gjysëm–ditë*), e pra simb. ⊕ si dhe "jug", e pra simb. ↓ .

Edhe në Italisht "m e z z o-giorno" do të thotë "m e s-ditë" (⊕) dhe në të njejtën kohë "jug" (↓).*

735) Hebr. h a g a (הַגָּא) = ingl. *to remove, to separate* (heq, ndaj)

Është Shqipja:

h e q , h e k

Kuptimi tjetër, ay i ndarjes, që ka kjo fjalë në Hebraisht, shpjegohet me faktin se *ndarja* si një veprim matematik nuk është tjetër veçse një *heqje*, një *zbritje* e njëpasnjëshme.

Duke dashur ta paraqitim simbolikisht këtë që thamë, mund të shkruajmë:

$$\cdot / . = \Sigma (-)$$

pjesëtimi varg heqjesh

736) Hebr. h a d a r (הַדָּר) = ingl. *to honour* (nderoj)

Motivimi:

h a d a r → shq. i (n)d a r ë = i nderuar

Pra rrënja këtu është Shqipja "n d e r", që lidhet nga ana e saj, brenda Shqipes, me "n d a r ë". Gjë kjo që na jep të kuptojmë se një *njeri i*

* Algoritmi Simbolik jep:

$$1/2 = \oplus = \downarrow \dots(F)$$

Kjo dhe është arsyeja (që mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet Algoritmit Simbolik) që, si Italishtja (*mezzo-giorno*) dhe Frengjishtja (*midi*), tregojnë njëkohësisht "gjysmën e ditës" (1/2 , ⊕), por edhe "jugun" (↓).

nderuar është *i ndarë* nga të tjerët, është pra i veçantë. Ky përbën edhe motivimin e kësaj fjale, ashtu sikundër ay jepet nëpërmjet operatorit të ndarjes, ekzsitues si operator i lirë në Shqip, por jo në Hebraisht.

Mund të shtojmë këtu edhe Latin. "**a d o r a r e**" = shq. **a d h u r o j**, që mendojmë se mund të motivohet me të njejtin operator të Shqipes si më sipër, do me thënë me "**d a r**" (ndarje).

737) Hebr. **p a k a d** (פָּקַד) = ingl. *to look for, to inspect, to visit, to care for...*
(shoh për..., inspektoj, vizitoj, kujdesem për...)

Theksi semantik bie tek "p a", që është Shqipja:

me **p a**

Ky operator i Shqipes është shumë i përhapur si në Shqip, ashtu edhe në shumë gjuhë të huaja, veçanërisht në Sanskritisht, Latinisht etj.

Shqipja "me pa" ka një semantizëm të gjerë, si p.sh. atë të "të shikuarit", atë të "të përkujdesurit për...", atë të "të vizituarit", atë "të inspektuarit", pra po ato kuptime, edhe të tjera, që ka edhe Hebraishtja "pakad". Kjo e bën edhe më të sigurtë etimologjinë tonë.*

738) Hebr. **p a r a s** (פָּרַשׁ) = ingl. *to divide, to break in pieces* (ndaj, coptoj)

Është Shqipja:

p r e s

Le të shtojmë këtu edhe se Inglishtja "**b r e a k**" (thyej) lidhet edhe ajo si me prejardhjen e saj me Shq. "**p r é**", një operator i lirë i Shqipes shumë i përhapur në një sërë gjuhësh. Ndofta edhe fjala "**p e r i s h**" e Inglishtes lidhet me Shq. "p r e", që jep nga ana e saj Shqipen "**p r i s h**".

* Shih edhe fq.101, 258, 740-741

739) Hebr. p a r a k (פָּרַק) = ingl. *to break off, to tear to pieces*
(thyej, coptoj)

740) Hebr. p a r a k (פָּרַק) = ingl. *lump, bit; others* (copë; të tjerët)

Të dyja janë e njejta fjalë, por me kuptime lehtëzi të diferencuara.

Lidhen që të dyja me operatorin Shqip:

pré (p r e s), e pra simb. $\textcircled{1}$

Simboli në fjalë është ndër të tjera ay i "pjesës", e pra jo i të tërës. Që këndeje dhe kuptimi në Inglisht "lump", "bit".

Algoritmi Simbolik na jep:

$$\textcircled{1} = F = 2 = -1$$

që nga edhe kuptimi i "të tjerët".

Vëmë ré me këtë rast se edhe Inglishtja "o t h e r" (= tjetër) zërthehet me anë të Shqipes:

o t h e r → shq. â t h e r r ose edhe "â t h y e r"

që nga dhe, siç pamë edhe më sipër:

$$\textcircled{1} = 2 \dots(F)$$

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, vëmë ré se për sa i përket Inglishtes "b i t" ajo duhet të lidhet me Hebraishten "B e t h" (ב), gërma e dytë e alfabetit.

Pra mund të shkruajmë:

$$\text{hebr. b e t h (ב)} = 2 = F = 1/2 = \textcircled{1} = \text{ingl. b i t (pjesë, copë)}$$

Kujtojmë këtu edhe se Inglishtja shtron ndër të tjera:

$$2 = \textcircled{1} = -1 \quad \dots(F)$$

both	bit	but
(të dy)	(pjesë)	(por)

Dhe kemi, në të gjitha këto raste, të njejtin operator me modifikime... keqkuptimshmangëse...

741) Hebr. **p a t h a c h** (פתח) = ingl. *to open; to begin...* (hap, filloj...)

Motivimi:

$$p a t h a c h \rightarrow \text{shq. } \mathbf{b \hat{a} t h y k a} = \textcircled{1} = F = \epsilon \text{ (hapja)}$$

Theksi semantik këtu bie tek operatori Shqip "t h y", që nga dhe Hebraishtja "t h a".

Hebraishtja na thotë me semantizmin e kësaj fjaie se *fillimi* lidhet me një *thyerje*, dhe vërtetohen kështu fjalët e Paracelsit: "Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang"...

Rikonfermohet kështu ndër të tjera edhe saktësia e ekuacionit simbolik të pozuar nga Gjermanishtja me:

$$\textcircled{1} = -1 \quad \dots(F)$$

brechen	Aufbruch
(thyej)	(fillimi)

Të njejtën gjë kemi edhe në Rusisht:

$$\textcircled{1} = -1$$

rez-ats	raz
(me pré)	(një, fillim)

Nga sa më sipër del edhe se Bota, fillimi i gjithshkaje materiale, realizohet me mohimin e Njëshit, e pra të Zotit. Kjo njihet në Mendimin Mistik si "Sakrifica Kozmogonike" a ndryshe "Kurbani".*

Me qenë pra se krijimi i Botës kërkon një krim, siç është ay i mohimit, vrasjes, qoftë edhe "liturgjike", të Perëndisë, ky *krijim* s'është tjetër veçse një *krim* në kuptimin tërësor të fjalës. Kjo do të ishte edhe dogma, e pashpjeguar qartë nga theollogjia e një féje të institucionalizuar të Krishterë, e "mëkatit zanafillor" (lat. *peccatum originalis*).**

742) Hebr. *pa th a th* (פָּתַח) = ingl. *to break* (thyej)

Motivimi:

pa th a th → shq. *bâ thy* = ⊕

743) Hebr. *pa th a l* (פָּתַל) = ingl. *to twist* (shtrembëroj)

Motivimi:

pa th a l → shq. *bâ thy* = ⊕ → () →) → ⊕***

* Shih Cirlot (fq.64).

** Shih edhe fq.20, 40, 349, 463, 575 dhe 600.

*** Kjo figurë simbolike u krijua duke zhvendosur njëren pjesë ndën tjetrën, duke na dhënë kështu figurën e Gjarpërit, e pra të "*S-erpens*", e pra të Djallit, i cili po dihet se nuk është i drejtë, por i shtrembër...

Le të shtojmë këtu se:

- 1) Ky simbol është po ay që neve shohim tek *Yin Yang*-u kinez, që ndan dy parimet, atë mashkullor (*Yang*) nga ai femëror (*Yin*).

Jemi që jemi në këtë zgjerim Bisede, le të shtojmë edhe diçka tjetër që na duket jo pak e rëndësishme...

Algoritmi Simbolik na jep, siç e dimë:

$$\textcircled{\ominus} = \bullet \quad \dots(F)$$

grimca materiale

Në qoftë se tani e ndajmë rrethin në mënyrë horizontale (transversale) dhe spostojmë (shkasin) të dy të ndarat do të kemi pak a shumë këtë figurë:

$$\ominus = \infty \quad \dots(F)$$

- 2) Në Gjenezë na thuhet se Adami dhe Eva, të nxitur dinakësisht nga Djalli në trajtën e një gjarpëri, hëngrën nga fryti i dallimit të së Keqes nga e Mira, gjë që mund të jepet grafikisht si:

$$\bullet \neq \circ$$

që nga dhe, duke përgjithësuar:

$$-x \neq x$$

e pra atëhere edhe:

$$(x = x)$$

e pra përfundimisht:

$$F$$

U kalua kështu nga: kodi E, $(x = -x)$, në kodin F, $(x = x)$, kalim ky që qe një r ë n i e, dhe që realizoi pra skemën e përgjithshme të çdo miti kozmogonik:

$$E \downarrow = F$$

Ku: $F = \bullet =$ Bota materiale, krijimi i saj.

Lidhur me këtë problematikë, shih ndër të tjera edhe fq.21, 113, 322 dhe 548.

Që mund të vështrohet si grafiku i valës (në Fizikë e kudo...).

Mund të shkruajmë atëhere:

$$\textcircled{\bullet} = \bullet = F$$

ndërsa:

$$\ominus = \text{~} = F$$

Mund të shkruajmë pra atëhere më në fund:

$$\bullet = \text{~} \quad \dots(F)$$

grimca vala

materiale

Pre, arrijmë në përfundimin tronditës dhe të De Broglie-t, se:

"Edhe materia mund të ketë natyrë valore."

...Bie pra kështu dallimi epokal mes Materies (trupit dhe inercisë së tij) nga njëra anë, dhe Valës (me karakteristikat e saj të gjatësisë dhe frekuencës, të reflektimit, të refraktimit...) nga ana tjetër.

Kështu pra, Algoritmi Simbolik na lejoj edhe këtë radhë të gjejmë, fare lehtë e fare thjeshtë, një të vërtetë të thellë të Fizikës moderne, për zbulimin e së cilës shkencëtarëve u është dashur të lodhen jo pak.

744) Hebr. p a t h i l (פְּתִיל) = ingl. *thread* (pé, fill, thilé)

Motivimi:

p a t h i l → shq. b â t h i l é, b â f i l l

Një sqarim: ekziston alternimi: "f" ⇔ "th".

Kështu p.sh. në Shqip: "fëmi", si edhe "t^hmi" (në të folmen e Veriut). Në Rusisht: "Ejodor" në vend të "Theodor". E kështu me radhë...^{*} Dhe më në fund, në Shqip: "fⁱll" dhe "t^hil^é".

745) Hebr. *reshith* (ראשית) = ingl. *beginning, commencement, origin, former state, the first, the best, firstling*

Bota është krijuar nga "i Riu", prandaj nga "risia". Në Ungjill na thuhet se është krijuar nga "personi i dytë" i Trinitetit, dhe dimë se:

$$2 = -1^{**} = i \text{ Riu, risia}$$

Shihet pra se si gjuha Hebraike (dhe jo vetëm) rikonfirmon faktin se Bota është krijuar nga "personi i dytë" i Trinitetit, pra nga Biri, nga i Riu, shka konfirmon edhe vetë Teoria e Krishterë.

Kështu kemi një pajtim të thellë dhe me vlerë mes "brendisë", "thelësisë" së gjuhës Hebraike, e pra të vetë Hebraizmit, me një pohim themelor të Theologjisë së Krishterë, shkurt të Krishtërizmit.

Duke shkuar dhe më tej në këtë drejtim, ne mund të themi, ende pa një vërtetim të plotë, se të gjitha të dhënat kryesore të Fésë së Krishterë gjenden të inkapsulluara (fshehura, reçesivuara) në gjuhën Hebraike.

Skematikisht këtë mund ta paraqesim si:

$$\text{Hebraizmi} = [\text{Krishtërizmi}]$$

sipas formulës:

$$F = \boxed{E}$$

* Shiko edhe fq.477, 491 dhe 591.

** Shiko edhe fq.30 dhe 388.

746) Hebr. k i d (כִּד) = ingl. *calamity* (fatkeqësi)

Motivimi:

k i d → shq. k a d à = ⊕ = F = ● = zi, fatkeqësi

Në zgjerim të Bisedës:

Rus. "b e d á" (беда) → shq. b ë d à = ⊕ = F = ●

Ingl. "b a d" → shq. b ë d à = ⊕ = F = ●

Shq. "b d aj" (bëj) → shq. b ë d à = ⊕ = F = ●

Duke qenë kështu bërja, të bërit (ingl. *the doing*), lidhet me një fatkeqësi (כִּד), e pra si e tillë është një gjë e keqe.

Kështu kanë menduar dhe mistikët e lashtë, prandaj edhe në gjuhën Kineze, në gojën e Lao-Tze: "Wu Wei!" (無為) = Mos bëj, Mos vepro!...

Edhe Buddha, në një mënyrë a një tjetër, na thotë të njejtën gjë me "Nirvanën" e tij. Ai, duke iu drejtuar dishepullit të tij të dashur Ananda, i thotë ndërmjet të tjerash: "Mos qaj (për mua që po vdes) se çdo e përbërë duhet të bëhet e thjeshtë..."*

Fjalët e Buddës do të përktheheshin në gjuhën tonë simbolike si:

⌘ **	→	- ⌘
e përbëra		e thjeshta

Kjo do të qe atëhere edhe kalimi (*ngritja*) nga kodi F te kodi E.

* Shih ndër të tjera edhe fq.244 dhe 367.

** ● = ⌘ = përbërje ... (F)

Duke qenë se, nga ana tjetër, çdo mit kozmogonik mund të shkruhet në trajtën:

$$E \downarrow = F$$

sa thotë Budda do të shkruhej atëhere si:

$$F \uparrow = E$$

që përbën dhe skemën e përgjithshme të çdo "miti anti-kozmogonik".

Që *fundi* lidhet me një *ngritje* (\uparrow), ndërsa *bërja*, fillimi, me një *rënie* (\downarrow), këtë Gjuha na e dëshmon bollshëm.

Kështu p.sh. Inglishtja me fjalën "u p" që do të thotë "*lart*", por edhe "fundi" i një procesi (si p.sh.: "eat *up*", "write *up*"... (përfundoj se ngrëni, përfundoj se shkruari...).

Të njëjtën shikojmë në Inglisht edhe me fjalën "o v e r".

Në një vazhdim të mëtejshëm të Bisedës do të pohojmë edhe se tek antinomitë e Arsyes të Pastër,* se ajo që pohon Teza në Antinominë e Dytë (që gjithshka në botë është e thjeshtë dhe rrjedh nga e thjeshta) nuk mund të realizohet në Botën tonë materiale, sikundër e vë në dukje Anti-teza, që pohon se *asgjë në këtë Botë nuk është e thjeshtë*.

Dhe ka të drejtë.

Skematikisht:

$$\text{Teza} = - \infty = - \bullet \quad \dots(E)$$

$$\text{Anti-teza} = \infty = \bullet \quad \dots(F)$$

Shikojmë pra se Teza dhe Antiteza flasin për dy botëra të ndryshme e të kundërta, "Botën Qiellore" (*Teza*) dhe "Botën tokësore" (*Anti-teza*). Që nga dhe arsyeja e konfliktit të tyre.

* Shih edhe fq.304-306.

747) Hebr. **ki dor** (כִּידוֹר) = ingl. *war* (luftë)

Motivimi:

ki dor → shq. **ka d ā r** = ndarje = ⊕ = *F* = ...

(→ ≠ ←) = konflikt, ndeshje, luftë...

Këtë operator të Shqipes e gjejmë, me të njëjtin kuptim, edhe te Rusishtja "r a z d o r" (раз-дор) = sherr, konflikt, grindje.

Kjo na lejon të shtrojmë një ekuacion ndërgjuhësor, pak a shumë të tillë:

$$\begin{array}{rcc} \oplus & = & (\rightarrow \neq \leftarrow) \quad \dots(F) \\ \text{shq. } d \bar{a} r & & \text{hebr. ki-dor} \\ & & \text{rus. raz-dor} \end{array}$$

748) Hebr. **ka fa l** (כָּפַל) = ingl. *to fold together, to double up* (palos bashkë, dyfishoj)

Është Shqipja:

ka pal ë
("ka palue", palos)

Pra theksi semantik bie tek fjala "p a l ë" (hebr. "f a l").

Pjesa "k a" në Hebraisht është pra thjesht një prostazë, pa ndonjë semantizëm të saj të veçantë. Ajo mund të identifikohet, siç e kemi parë edhe në raste të tjera, me Shqipen "k a" = ingl. *has*, lat. *habet*.

Shtojmë këtu edhe se në Shqip kemi gjithashtu: "**p a l ë**" në kuptimin e "një palë" = ingl. *a pair* (p.sh. "një palë çorape" etj.), simb. 2, dhe pra është pikërisht kuptimi i "dyfishimit" që gjejmë edhe në fjalën Hebraisht që po shqyrtojmë.

749) Hebr. **m a t t a n a** (מַתָּנָה) = ingl. *gift, present, offering* (dhuratë, ofertë...)

Është Shqipja:

m e d h ā n ě

Pjesa "m a" duhet vështruar si një prostazë, e identifueshme me Shqipen "m e".*

750) Hebr. **g o m e d** (מִדָּה) = ingl. *a measure* (matje, masë)

Është Shqipja:

m e d à = ⊕ ... (F)

Theksi semantik në Hebraisht bie tek "m e d", ndërsa pjesa tjetër "g o" nuk është gjë tjetër veçse një prostazë. Prostatizimi është një shfaqje e rëndomtë në gllosat e Hebraishtes, që vështirëson diktimin e mënjës së vërtetë, primare. Ky prostatim mund të bëhet në mënyra të ndryshme, si me "k a", si me "g o", e kështu me radhë.

751) Hebr. **g a n a b** = ingl. *to deceive, deceive by habit* (gënjej, mashtroj)

Është Shqipja:

g ě n j e j

Në Italisht: "i n g a n n a r e", "i n g a n n o"... , kanë të njejtin kuptim, atë të *mashtimit, të gënjeshtërsë*.

752) Sanskr. **g h a r m a** (घर्म) = fr. *chaleur; feu intérieur* (ngrohtësi; zjarr i brendshëm)

* Shih edhe fq.683.

Është Shqipja:

ngroh

Vëmë ré se në Shqip kemi *ngroh* (ingl. *warm up*) dhe *ngrij* (ingl. *freeze*), që formojnë një çift ekuivokal, si një rast i zbatimit të ekuacionit të Qëndrës, ($x = -x$). Pra dhe mund të sajojmë në Shqip një ekuacion të tillë simbolik:

$$x = -x \quad \dots(E)$$

ngroh ngrij

Kemi parë se kjo ka qenë një shfaqje e zakonshme në gjuhë tepër të lashta. Pra dhe pajisja e një fjale (në çdo sistem gjuhësor qoftë) me një partner antitetik, flet për një nivel të thellë arkaik të kësaj fjale. Sanskritishtja nuk ka një partner antitetik për fjalën *gharma*, kurse Shqipja ka një të tillë për fjalën *ngrohem* (*ngrihem*). Që këndeje edhe përfundimi:

sanskr. "g h a r m a" < shq. "n g r o h"

Edhe Inglishtja "w a r m" këtu lidhet, m.q.s. Sanskritishtja (Shqipja) "g" ("k") nistore shpesh është shndërruar në "w" në Inglisht.*

Sigurisht këtu lidhet dhe Rusishtja "g r e t s" (греть) = ngroh.

753) Hebr. **k h a d a r** = ingl. *room of...* (dhomë e...)

Zbërthehet në:

$$k h a d a r \rightarrow \text{shq. } k a d a r \ddot{e} = \textcircled{1} = F = \textcircled{\circ}^{**}$$

* Shih edhe fq.731.

** Shiko lidhur me këtë edhe fq.279, 446, 498 dhe 652.

754) Hebr. **k a s h** = ingl. *straw* (kashtë)

755) Hebr. **k a s h i t** = ingl. *straw (for sipping drinks)* (kashtë, kallam për të pirë)

Është Shqipja:

k a s h t

756) Hebr. **b a r a** (ב ר א) = ingl. *created* (i krijuar)

Është Shqipja:

i b ë r ë

folja "b a j", b ë j..., b ë r a,...

757) Hebr. **k h a v a s h** = ingl. *dressed* (veshun)

Është Shqipja:

k a v e s h u n**

758) Hebr. **h i s t i r** = ingl. *concealed* (i fshehur)

Është Shqipja:

i s h t i r

(folja me *shti, shtij...* etj.)

Simbolikisht:



simbol ky që mund të interpretohet edhe si ai i "s h t i m j e s", edhe si ai i "fshehjes" (ingl. *concealment*).***

* Shih edhe fq.536, 606 dhe 640.

** Shiko edhe fq.415 dhe 528.

759) Hebr. **h i s t a t e r** = ingl. *hid, hidden* (i fshehur)

Është Shqipja:

i s h t i t u r = o

760) Hebr. **h i s t a r a** = ingl. *stretched out, extended, spread out...* (i shtrirë, i përhapur...)

Lidhet me Shqipen:

s h t r i j, i s h t r i r ë, etj.

Këtë rrënjë e gjejmë edhe në Sanskritisht ("s t r"), gjë që përbën një nga pikat jo të pakta takimi midis këtyre dy sistemeve themelore gjuhësore, d.m.th. Hebraishtes dhe Sanskritishtes, që shpjegohet me faktin se ato përfaqësojnë dy degëzime të të njejtit "trung gjuhësor" i përbërë në pjesën e tij më të madhe nga operatorë shqiptarë dhe nga marrëdhëniet e tyre të shumëfishta. Duke qenë kështu, shihet mundësia që Shqipja të mund të cilësohet, si të thuash, si një *burim i përbashkët* i këtyre dy gjuhërave, e pra pikërisht si ai "trung" për të cilin folëm më sipër. Një mendim i tillë ekziston sot edhe në qarqet më të përparuara të Gjuhësisë, ndonëse për këtë nuk flitet aq sa duhet.**

761) Hebr. **y a s h a n** (*y a s h a n a h*) = ingl. *old* (i vjetër, plak)

Theksi semantik bie tek "s h a n" që lidhet mitikisht me Shqipen:

s y n i

*** Lidhur me hollësira të mëtejshme të këtij operatori shumë të rëndësi-shëm në të gjitha gjuhët, por veç me prejardhje shqiptare, shih ndër të tjera edhe fq.251, 311, 505-507, 573 dhe 659.

** Shih ndër shumë e shumë studime të kësaj natyre edhe atë Luigi Cavalli Sforza, "*Genes and Peoples*" (Genuset dhe Popujt).

...syni si çuni i qiellit, e pra djali si dielli, "the son like the sun...", dhe Dielli lidhet, siç dihet, me vitin (turq. *sene*) që nuk është tjetër veçse një rrotullim i plotë i Tokës rreth Diellit.*

762) Hebr. *j o z e m* = ingl. *initiator; initiates* (nismëtar...)

Lidhet me Shqipen:

me *zan* (me *fillue*), *za* (*filloj*), *zamje* (*zanie*)**

763) Hebr. *k v u r a k h a m o r* = ingl. *contemptible burial*; lit. "the burial of an ass" (varrim i "përbuzshëm"; fjalë për fjalë: "varrimi i një gomari")

Është Shqipja:

"kivuri i gamorit"

e pra: "varrimi i gomarit"...

Vëmë ré se në Shqip edhe "g a m o r", si edhe "q i v u r".

764) Hebr. *h u f a l* = ingl. *was activated; was started...* (u aktivizua; u fillua...)

Është Shqipja:

u fillua

Vëmë ré se në Shqip: "u fillua" (ingl. *was started*) dhe "u fal" (*perëndoi, mbaroi*) (ingl. *is ended, is up...*).

* Lidhur me kuptimet e shumta në gjuhë të ndryshme të operatorit shqiptar "s y n i", shih edhe fq.81, 390 dhe 771.

** Shiko ndër të tjera edhe fq.275 dhe 766.

Shqipja shtron në këtë mënyrë ekuacionin simbolik:

$$\alpha = \omega \quad \dots(E)$$

u fillua u fal (u falit)

që është ai i Qëndrës, ($x = -x$), dhe që pra flet për një lashtësi shumë të madhe të kësaj rrënje në Shqip, me qenë se në gjuhërat e lashta, si bie fjala në atë Egjiptiane, dy koncepte të kundërta tregoheshin me të njejtën fjalë.

765) Hebr. h u k a m = ingl. *was established, set up, erected* (u vendos, u ngrit, u ndërtua)

Lidhet me Shqipen:

këmbë, k ā m

Pra, me Shqipen:

u kamsue
(në të folmen e Veriut)

766) Hebr. k u m = ingl. *get up!* (ngrihu në këmbë!)

Lidhet me Shqipen:

k ā m

Kujtojmë nga Ungjilli, kur Krishti i flet vajzës të cilën Ai e ngall ngjall nga vdekja:

"*Talitha kumi!*"*
[יִמּוֹק אֶתִּילֵט]

Me Shqipen:

"*Delthe, kam!*"

* Marku (5:41): "Duke e marrë vazjën përdore, Ay i tha asaj: *Delthe, kām!...*"

Ku "delthe" (hebr. *talitha*), "delthe e vogël" në Hebraisht, figurativisht për "vajzë të vogël".

767) Hebr. b i m e k o m = ingl. *in the place of, instead of...* (më këmbë të..., në kam të...)

Motivimi me Shqipen, duke patur parasysh që theksi semantik bie mbi "m e k o m" ("bi-" është një prefiks asemantik), do të na jepte:

m ë-k ë m b ë-s o j, mëkëmbës...

Të gjitha këto fjalë lidhen me rrënjën Shqip "k ā m".

768) Hebr. s k i r a h = ingl. *review; survey....; glance* (kqyrje; shikim...; shikim)

Lidhet me Shqipen:



s h k y r t o j


që nga ana e saj lidhet me foljen: "me **k y r**" (*shoh*), e cila nuk ndodhet në gjendje të lirë në Hebraisht.*

769) Hebr. 'u k a l = ingl. *was seized* (u kap)

Është Shqipja:

u k a l l

e pra simbolikisht "  ", e pra atëhere edhe, për ekuivalencë simbolike, "  ".

Dhe kemi kështu si kuptimin e *kapjes* (), ashtu edhe atë të *futjes brenda, të të burgosurit...*

* Shih edhe fq.335.

770) Hebr. **h u k h a l** = ingl. *was begun, started* (nisi, filloi)

Është përsëri Shqipja:

$$u \text{ k a l l} = \boxed{\bigcirc}$$

Dimë që kemi:

$$\boxed{\bigcirc} = -1 = \textit{fillimi}$$

Vëmë ré këtu se edhe Hebraishtja e lidh *fillimin* me *kapjen, burgosjen* ($\boxed{\bigcirc}$) e Parimit Hyjnor (\bigcirc),* po ashtu si Shqipja me "z ë" (*kapje* dhe *fillim*), Gjermanishtja me "f a n g e n" (*kap, zë*) dhe "a n f a n g e n" (*filloj*), Latinishtja me "c a p e r e" (*kap*) dhe "i n c i p e r e" (*filloj*), etj. etj.

Mund të shkruajmë atëhere përmbledhtaz:

$$\boxed{\bigcirc}, \infty = -1 \quad \dots(F)$$

hebr. 'ukal	hukhal
shq. zë	zë
gjerm. fangen	Anfang
lat. capere	incipere
...	...

771) Ingl. **y e s t e r - d a y** = dje

Motivimi me anë të Shqipes bëhet në këtë mënyrë:

j e s h t i A r...

"Ari" këtu simbolizon "Diellin", parimin mashkullor, Yllin, Qëndrën, Dritën...

Pra: "s h t i Ar" do të mund të simbolizohet atëhere me:

$$[y l l] = -\bigcirc = \bullet$$

* Shih edhe fq.210, 554 dhe 636.

Kështu që, Gjermanishtja na jep të kuptojmë se "e djeshmja" është dita (që ishte, po s'është më, sepse u mohua dhe si e tillë u "s h t i" brenda).

Të njejtën taktikë semantike ndeshim edhe në Gjermanishten:

"g e s t e r n" = dje

që duhet zbërthyer si:

k e s h t i A r = \square =

Edhe në Frengjisht shohim të njejtën gjë:

"h i e r" = dje

Motivimi:

h y A r = \square = ...

772) Hebr. h i t v a d a' = ingl. *became acquainted* (u bë i njohur, i ditur)

Theksi semantik bie tek:

v a d a'

që është Shqipja:

b â d î

Sqarojmë se "h i t-" përfaqëson në Hebraisht diatezën e pësore, pra nuk mbart kurrëfarë theksi semantik.

Këtë rrënjë ("d i", "d a"...) në kuptimin e "Dijes", ashtu si edhe shumë rrënjë të tjera të Hebraishtes, e gjejmë edhe në Sanskritisht, gjë kjo që flet për një largësi jo aq të madhe mes këtyre dy familjeve gjuhësore, gjuhëve *indoeuropiane* (me Sanskritishten si "burim") dhe gjuhëve *semitike* (me Hebraishten si pikënisje).*

* Shih edhe fq.327 dhe 457.

773) Hebr. **hitgarah** = ingl. *teased, challenged* (i ngarë, i ngacmuar, i sfiduar)

Lidhet me Shqipen:

ngaj, i ngarë, ... ngasje...

Edhe këtu, "hit-" është diateza e pësore.

774) Hebr. **hitgarut** = ingl. *provocation* (provokim)

Është Shqipja:

ngarje, ngasje...

775) Hebr. **hitgared** = ingl. *scratched oneself* (u krrua)

Lidhet me Shqipen:

me krrue (ingl. to scratch)

776) Hebr. **hitgabrut** = ingl. *strengthening* (që forcon, duke forcuar)

Lidhet me Shqipen:

burrnoj

nga fjala:

burrë

Ky operator i lirë i Shqipes është i pranishëm (i inkapsulluar), siç e kemi parë, në shumë fjalë të përbëra të Hebraishtes si "gabror" (גברור), "Gabrieli" (לאירבג) etj.*

* Shih edhe fq.417 dhe 432.

777) Hebr. **z e f e t** = ingl. *tar, pitch* (katran, zift)

Lidhet me Shqipen:

z i f t

778) Hebr. **z i f t** = ingl. *no good; unhappy, unhappily* (i keq; palumturisht, fatkeqësisht)

Theksi semantik këtu bie mbi:

z i

që nuk është tjetër veçse Shqipja: "i zi", "e zezë"... , e pra simb. ☉ . *

Ngjyra e zezë, si në Shqip ashtu dhe në shumë gjuhë të tjera, rri për: *fatkeqësi, kob, e keqe, mjerim*... Në Shqip: "i ziu unë" (i mjeri unë, fatkeqi unë), "ç'është kjo e zezë që na ndodhi?" etj. etj.

779) Greq. **m b r o s t a** (μ π ρ ο σ τ α) = ingl. *front; before* (ballë, krye; përpara, më parë...)

Me anë të Shqipes, kjo fjalë zbërthehet si vijon:

m b a r ë â s h t

ose edhe:

"e mbara është"

780) Greq. **e m b r o s** (ε μ π ρ ó ς) = ingl. *forward* (përpara)

Është përsëri Shqipja:

â m b a r ë

* Shih edhe fq.17.

Rrënja "m b a r ë" në Shqip ka një polisemantizëm të pasur e të thellë.

Kështu, në Shqip:

- 1) ana e m b a r ë (it. *lato anteriore*), e pra simb. " 1 "
- 2) m b a r i m (it. *fine*), e pra simb. " ○ "
- 3) m b ë r r i j = arrij (it. *arrivare*), simb. " ω "
- 4) i m b a r u m = i përsosur
- 5) i m b a r ë = i mirë

...

Do të mund të shtonim në këtë listë të gjatë të spektrit semantik të rrënjës Shqip "m b a r ë" edhe fjalën "(m)b i r ë" = "b i r a".

Duke qenë kështu, ne mund të shkruajmë simbolikisht:

$$\circ = \bigcirc \quad \dots(E)$$

bira mbarë

Gjejmë këtu një paralelizëm perfekt semantik me Inglishten, si në rastin e:

$$\circ = \bigcirc$$

"hole" "whole"

(vrimë) (e tëra)

Me qenë se:

$$m b a r ë s i = shenjtëri$$

kuptojmë atëhere edhe përse në Inglisht:

$$"W-holeness" = "holiness"$$

(e tëra) (shenjtëria)

Në Shqip, duke përfituar nga spektri i pasur semantik i operatorit "mbarë" ("m-b-r"), mund të formulohet edhe një aforizëm e tillë:

"E mbara mbrihet në mbarim."

Në zgjerim të Bisedës shtojmë edhe sa vijon:

Kemi parë e vërtetuar ekuacionin simbolik ndërgjuhësor:

$$\bigcirc = \circ \quad \dots(E)$$

it. *vero* shq. *vërë*

Shihet pra, ndër të tjera, se e Vërteta është vetë Qendra Mistike për të cilën kemi folur kaq herë.

Por tek Cirlot lexojmë edhe se: "The Mystic Centre... is the Land of the Dead...",* që do të thotë se Qendra Mistike është "Bota tjetër", "Mbretëria Qiellore", etj. etj.

Duke qenë kështu, del se e Vërteta (it. *vero*), që u pa se mund të paraqitej simbolikisht me një *v r i m ë* (shq. *vërë*), lidhet jo vetëm semantikisht, por edhe mistikisht, me "*v a r r i n*".

Kuptojmë atëhere përse: gjerm. "*W a h r*" = e Vërteta = shq. "*v a r r*".

Vazhdojmë më tej:

Në Shqip: "*b i r ë*" (*hole*) dhe "*b u r i m*" (*source, spring, fountain*).

Dhe nga ana tjetër: "*v ë r ë*" dhe "*v a r r*" (*grave, tomb*).

Që këndeje del që:

"Varri dhe burimi përputhen."

...jo vetëm semantikisht, por edhe mitikisht, mistikisht, fillosofikisht.

* Shih Cirlot, fq.41.

Kuptojmë atëhere edhe më mirë vargjet e famshme të Goethes:

"Ich bin der Geist
Der stets verneint...
Weil Alles das entsteht
Wert ist es zu Grund zu geht..."

(...Unë jam Fryma që parreshtur mohon
Dhe me të drejtë, se gjithshka del
Duhet prapë në thelb me u mshelë...)*

781) Hebr. h u s h t a t = ingl. *was founded; based...* (u themelua;
bazuar...)



Lidhet me Shqipen:

s h t ī, s h t ī t
("u shtit")

e pra simbolikisht:



Gjë që jep, për ekuivalencë simbolike:

s h t i =  =  = *materializim, ndërtim*

Krahaso dhe me të njejtën rrënjë Sanskritisht, si edhe me Shqipen "**s h t e t**",
"m b ë **s h t e t**",... etj. etj.

782) Hebr. m a d o r = ingl. *section* (seksion, e ndarë)

Lidhet me Shqipen:

d ā r (i,e ndarë)

* Shiko edhe fq.209, 291, 526 dhe 603.

nga folja "DAJ", që nuk ekziston në gjendje të lirë në Hebraisht, e pra që nuk motivon në këtë mënyrë fjalën që po shqyrtojmë.

783) Hebr. **k a t s a t s** = ingl. *chopped; cut off* (i coptuar; i prerë, i ndarë)

Është Shqipja:

k a ç a = $\textcircled{\text{D}}$ = $\textcircled{\text{D}}$ $\textcircled{\text{D}}$

784) Hebr. **k a t s a r** (**k a t s e r**) = ingl. *short* (i shkurtër)

Është Shqipja:

k a ç a, k a ç a r ë
(folja ÇAJ)

Një sqarim është i nevojshëm këtu.

Në Inglisht:

"**t o s h a r e**" (*ndaj*) dhe "**s h o r t**" (*i shkurtër*)

Në Frengjisht:

"**b r i s e r**" (*thyej*) dhe "**b r e f**" (*i shkurtër*)

Me fjalë të tjera: koncepti i *shkurtësisë* lidhet me atë të një *prerje* ($\textcircled{\text{D}}$), të një *ndarjeje*, të një *shkurtimi*.

Jo vetëm..., por duke e zgjeruar Bisedën, ne mund të themi se edhe koncepti i *mprehtësisë* lidhet me atë të *prerjes*.

Kështu për shembull në Shqip:

"**p r e s**" dhe "**i m p r e h t ë**"

Në Inglisht:

"**t o s h a r e**" (*nda*) dhe "**s h a r p**" (*imprehtë*)

Në Rusisht:

"**r e z a t s**" (резать) (*pres*) dhe "**r e z k i j**" (резкий) (*imprehtë*)*

Edhe fjala Shqip "**b r i s k**" lidhet po këtu, do me thënë mbrënda Shqipes me foljen "**p r e s**" dhe jashtë Shqipes me Frengjishten "**b r i s e r**" (= pres, copëtoj).

Se si dhe pse koncepti i *imprehtësisë* lidhet me atë të *copëtimit*, kjo shpjegohet "algoritmikisht" kështu:

Nisja bëhet gjithmonë, siç dimë, nga Qendra, e pra simboli "○" i cili, siç shihet, nuk ka *cepa*, nuk është i *prerë*, dhe pra si i tillë *nuk është as i imprehtë*. Shqipja me *copë* dhe *cep* na thotë se *cepat dalin nga një copëtim i tërës*, që jepet nga simboli "○".

Kjo situatë përshkruhet bukur nga aforizma e Shqipes:

"Nga copëtimi **cepat**."

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën shtojmë se *copëtimi* (dhe *cepat* që lindin prej tij) realizon kalimin nga "○" në "⊕", e pra nga kodi E në kodin F, e pra nga kodi i *thellësisë* në kodin e *cektësisë* a *përçiptësisë*.**

* Vërejmë shkarazi se edhe Rusishtja "**r a z**" (раз) lidhet brënda Rusishtes me fjalën "**r e z a t s**" (резать) = me *pré*, e pra simb. ⊕.

Kështu Rusishtja shtron ekuacionin e njohur simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & -1 \quad \dots(F) \\ \text{rezats} & & \text{raz} \end{array}$$

Atëherë kuptojmë përse në Shqip kjo situatë jepet më së miri me:

c o p (ë), c e p, c i p (ë)

që lidhen që të gjitha me të njejtën rrënjë me vokalizime të ndryshme:

C { o, e, i, ... } P

Duke e zgjeruar akoma më tej Bisedën, shtojmë edhe sa vijon:

Figura simbolike " \bigcirc " është në të njejtën kohë ajo e *Qëndrës*, ajo e *Hiçit*, ajo e *Përsosjes*.

Mund të shkruajmë edhe, siç dimë:

$$\bigcirc = (x = -x) = -(x \neq -x) = \text{Unbroken Symmetry}$$

Pra mund të shkruajmë atëhere edhe:

$$\bigcirc = \text{The Perfect, Unbroken Symmetry of Nothingness}^{***}$$

Shih lidhur me këtë edhe *Një parashtrim i shkurtër i Algoritmit Simbolik*.

*** Kujtojmë këtu ndër të tjera, nga "Libri i Aforizmave" (fq.98) se sipas Kozmollogjisë moderne, ekziston ajo që ajo quan "*the Unbroken Perfect Symmetry of Nothingness*" (*Simetria e përsosur, e pathyer e Hiçit*), një gjendje kur s'ka asgjë përveç Hiçit, kur materja ende s'ka lindur dhe natyrisht as Bota materiale.

Përkthejmë në gjuhën e simboleve:


$$\text{Hiçi} = (x = -x) = 0$$

Me qenë se x mund të jetë çfarëdo, ne mund të mendojmë se x dhe $-x$ janë dy pika, dy abshisa simetrike ndaj boshtit yy' , grafikiisht, pak a shumë kështu:

...këtu s'ka copëtim, këtu s'ka cepa. Pò, këtu s'ka as Botë materiale. Jemi pra para Krijimit... * Krijimi fillon, siç dimë, me \oplus e pra me copëtimin, me cepat, me përcipshmerinë. Këtu nuk ka më as përsosje ($\oplus = -\circ$), as Unbroken Symmetry ($\oplus = -\circ = -[-(x \neq -x)]$). Këtu kemi krijim të Botës materiale dhe mbajtje të saj ($\oplus = \bullet = Bota materiale$).

Kështu pra, nga sa më sipër del se:

*"Bota materiale është e përciptë, është me copa,
është me cepa..."*



Prandaj pra dhe ekuacioni i Qëndrës, ($x = -x$), mund të vështrohet fare mirë si ai i simetrisë ($-x \quad x$) të Hiçit (\circ). Kjo është një simetri perfekte, e pathyer (unbroken), e pra kjo është atëhere "the Unbroken Perfect Symmetry of Nothingness". Bota është krijuar, sipas Kozmologjisë Moderne, bash me thyerjen e kësaj Simetrie. Mund të shkruajmë atëhere në gjuhën tonë simbolike:

$$\text{unbroken perfect symmetry of nothingness} = -(x \neq -x) = \circ \quad \dots(\text{E})$$

si edhe:

$$\text{broken perfect symmetry of nothingness} = (x \neq -x) = \bullet \quad \dots(\text{F})$$

Ne atëhere shikojmë se krijimi i Botës Materiale shpjegohet edhe sipas Kozmologjisë Moderne me kalimin ($\downarrow =$ rënie!) nga kodi E në kodin F.

785) Greq. **krima** (κρίμα) = ingl. *sin, pity* (krim, gjynah)

Kjo fjalë lidhet me Shqipen:

krym-je

Dhe kjo sepse "k r y m j a" e Botës është vështruar nga të lashtët si një "krim", si një gjë që s'duhet të ndodhte.*

Le të kujtojmë këtu, ndofta edhe disi pa vend, fjalët kuptimplote të Krishtit (asnjëherë të cituara nga Ungjilli...):

*"Rijepmë o Atë lavdinë që pata pranë Teje,
para se bota të krijohet..."***

Le të përmendim këtu dhe fjalët e arta të Lao-Tze: "Wu wei!" (無為) = *Mos bëj, mos vepra!*

Që krijimi i Botës është lidhur me një krim, këtë e gjejmë në rrafshin gjuhësor edhe tek Greqishtja, ku "a i t i a" (αἰτία) do të thotë në të njejtën kohë "arsye", "shkak", por edhe "krim", "faj". Duke qenë kështu, dhe me qenë se Gjuha motivon paradigmatisht, primordialisht, superlativisht..., Greqishtja na thotë tërthorazi se shka u bë *shkak* ("aitia") për krijimin e Botës, ka qenë një *krim* ("aitia")...

Le ta zgjerojmë disi Bisedën.

Sipas Buddës:

"Çdo bërje është një përbërje."

* Mos harrojmë se Gjuha emërton paradigmatisht dhe pra "Krimi i krimeve" është "Krymja e Botës"...

** Gjoni (17:5): "And now, Father, glorify me in your presence with the glory I had with you before the world began." (Greq.: καὶ νῦν δόξασόν μεσὺ πάτερ, παρὰ σεαυτῶ τῇ δόξει ἣ εἶχον πρὸ τοῦ τὸν κόσμον εἶναι παρὰ σοί).

gjë që përkthehet në gjuhën e Algoritmit si:

$$\bullet = \infty \quad \dots(F)$$

bërje për-bërje

Vetë Buddha është për "thjeshtësinë", e pra për:

$$-\infty$$

e pra rrjedhimisht për:

$$-\bullet$$

që do të thotë për "shuarjen e Botës", për "Nirvanën" ("të pakrijuarën", "të gabëren").*

Këtu rikonfermohet edhe njëherë nëpërmjet këtyre personazheve maqhorë që krymja e Botës lidhet me një *krim*.

786) Greq. *h a r i* (χ ά ρ η) = ingl. *grace* (hir)

Është Shqipja:

Hiri

787) Greq. *h a r a* (χ α ρ ά) = ingl. *joy, delight* (gëzim)

* Sanskr. "n i r v a n a", zbërthehet në "nir + vana", ku "nir-" është një parashtesë mohuese (si "n i-", "n i h-", "n i s"... etj. etj.), e pra mund të shkruajmë: "n i r" = -1 = (-). Pjesa tjetër "-vana" është Sanskritishtja dhe Shqipja "b a n a" = ingl. *done, did...* e pra atëhere simbolikisht \bullet . Pra tërë fjala:

$$\text{Nirvana (निर्वाण)} = -\bullet = \circ \quad \dots(E)$$

Është Shqipja:

H a r é

Duke zgjeruar Bisedën:

Vëmë ré se ngjashmëria Greqisht e fjalës "h a r i" (χ á ρ η) me "h a r a" (χ α ρ á) nuk është e rastësishme, por kuptimplote dhe e thellë. Ajo na jep të kuptojmë se është *Hiri* ai që mund të bëjë të *hareshëm* e të lumtur. Edhe në Shqip është e njëjta gjë:

H i r i = H a r é

Kujtojmë këtu se në motivimin e fjalës Italisht "con-Ten-to" ne kemi veçuar, si motivues, operatorin "T e n" që lidhet, si me prejardhësen e tij, me Shqipen "i,e Tana" (it. *il Tutto*). * Simbolikisht, dimë se:

e T a n a = ○ ... (E)

Mund të shkruajmë pra, duke marrë parasysh sa më sipër, se:

H i r i = H a r e j a = e T a n a = ○ ... (E)

Duke qenë kështu, përpjekjet e Shkencës Moderne për realizimin e Holizimit** mund të vështrohen si një përpjekje, sa kryeneçe aq edhe e dëshpëruar, e Njerëzimit për të mbërritur tek Hareja Supreme, tek e Tana a, e thënë ndryshe, shkurt e troç, tek Zoti, që i qofshim falë!

788) Greq. v a r o s (β á ρ ο ς) = ingl. weight (barra)

Është Shqipja:

b a r r a

* Shiko edhe fq.94 dhe 565.

** Shiko edhe fq.60, 126, 374 dhe 566.

Gjith nga kjo rrënjë kemi në Shqip: "b a r", "b a r t"...

Një zgjerim i tillë nuk ekziston në Greqisht, ku zgjerimi është bërë me "f e r o" dhe pra mund të shkruajmë se:

greq. "f e r o" < shq. "b a r"

Në Shqip gjithashtu:

"Nga *barra*, *bërja*."

"Nga *barra*, *bjerja*."

"Nga *barra*, *përbërja*."

Simbolikisht këto gjykime shkruhen si:

↓ = ● ... (F)

barra bërja

↓ = ↓ = ...

barra bjerja

↓ = ∞ = (F)

barra përbërja

Këtë rrënjë e gjejmë edhe në gjuhë të tjera, si bie fjala në Gjermanisht ku: "s c h w e r" (i rëndë) < shq. "b a r r ë".*

Gjermanishtja na jep edhe këtë ekuacion simbolik:

● = ↓
schwarz schwer

* Shih edhe fq.18 dhe 326.

Këtë rrënjë a, më saktë, këtë operator të lirë të Shqipes e gjejmë të ndërkallur edhe në Italisht në fjalën: "i n **b a r a z z o**" = pengesë.

Në Spanjisht: "e m **b a r a z a d a**" = me barrë.

Nga të gjithë shembujt që dhamë lidhur me këtë operator në Shqip, nxirret si përfundim se ay është më produktiv në Shqip se sa në Greqisht, kështu mund të shkruajmë me të drejtë:

greq. "v a r o s" < shq. "b a r r a"

Dhe duke përfunduar, do të mund të shtonim këtu edhe se Italishtja "v a r i c e" (zgjerim venash, në këmbë zakonisht) dhe Inql. "v a r i c o s e" lidhen edhe ato me Greqishten "v a r o s" dhe me Shqipen "b a r r ë", me genë se prejardhja e tyre është nga një mbajtje e vazhdueshme peshash.*

789) Greq. a t o m o (á τ ο μ ο) = ingl. atom (atomi)

Sipas fillosofisë materialiste Greke (Demokriti) përbërte pjesën më të vogël të "pandarshme" të materies.

Motivimi bëhet me Shqipen:

a t o m o → shq. "â d ā m" = - d ā m = - ⊕

Vërejmë se gjersa atomi vështrohej si diçka materiale, ai nuk mund të ishte, siç mendonte Demokriti, i p a n d a r s h ë m, gjë që del direkt nga:

- ⊕ = E = - ● = jo materie = ○ = Frymë

Kështu pra, teza se ekzistojnë grimca materiale të pandarshme, siç pretendonte Demokriti, është krejtësisht e gabuar, siç e ka vënë në dukje, më se njëherë dhe në mënyrën më rigorozë të mundshme, Fizika moderne.

Kështu *Gjuha dhe analiza e saj na ndihmon të nxjerrim në pah një të vërtetë të rëndësishme të Shkencës, duke vënë në një provë kruciale një pohim të gënjeshtërt "shkencor".*

Ky është një rast nga të shumtët kur Algoritmi Simbolik funksionon, ndër të tjera, edhe si një *kriter absolut vërtetësie*.

Në zgjerim të Bisedës shtojmë se Fizika Klasike supozoi se duhet të ekzistonin tre grimca (*elektron, proton, neutron*) që duhet të përbënin tre përbërëset tashmë të thjeshta dhe të pandashme të materies.

Po kjo s'doli e vërtetë dhe nuk mund të ishte kurrsesi e tillë nga pikëpamja e një llojike të epërme, që është ajo e Algoritmit Simbolik i cili nga tregon se si *materia*, si e tillë, nuk është e thjeshtë, por e përbërë, siç tregonin ekuacioni simbolik:

$$\bullet = \text{X} \quad \dots(F)$$

materia përbërja

Mund të shkruajmë edhe:

$$\oplus = \bullet = \text{X} \quad \dots(F)$$

që na tregon se çdo grimcë (\oplus) e materies (\bullet), sado e vogël ajo qoftë, do të jetë gjithmonë e përbërë (X), e pra atëhere dhe e çpërbëshme në grimca më të vogla.

Kështu shpjegohet llogjikisht proliferimi (bollëku i tepruar) i grimcave subatomike në Fizikën Klasike (*neutrino, bozoni, muoni* etj. etj.).*

790) Greq. *diarezi* ($\delta\iota\alpha\acute{\iota}\rho\epsilon\sigma\eta$) = ingl. *division* (ndarje)

* Shih edhe Antinomitë e Kantit, ndër të tjera fq.304, 353, 472, 702, 841 dhe 843.

Është Shqipja:

darje, **darësi** = $\textcircled{1}$

"Diareza" përdoret shpesh në një sërë gjuhësh, sidomos në Frengjisht, për të ndarë një zanore nga një tjetër me të cilën ajo, pa diarezën, do të krijonte një diftong.

791) Greq. **dikotomia** ($\delta\iota\chi\omicron\tau\omicron\mu\acute{\iota}\alpha$) = ingl. *dichotomy* (ndarje në dy pjesë)

Motivimi me Shqipen:

dy ka dām = $\textcircled{1}$ = $1/2 = 2 \dots(F)$

792) Greq. **ektomia** ($\epsilon\kappa\tau\omicron\mu\acute{\iota}\alpha$) = ingl. *ectomy, a cutting of...* (ektomí, prerja e..., heqja e...)

Motivimi me Shqipen:

hek dāmje

Pra dy veprime: ai i *damjes* (greq. "tomia") dhe ai i *heqjes* (– 1) së një pjese (greq. "ek").

793) Shq. **katua** (bodrum) = ingl. *basement*

Kjo fjalë lidhet me Greqishten "kato" ($\kappa\acute{\alpha}\tau\omega$) = *poshtë*.

Pra mund të mendohet se ajo vjen nga Greqishtja dhe kjo është "disi e vërtetë", por jo e vërtetë deri në fund...

Dhe kjo për arsye se vetë fjala Greqisht "kato", mund të shpjegohet (motivohet) vetëm me Shqipen:

katō → shq. **ka dā** = $\textcircled{1}$ = **F** = ↓ (*poshtë*)

Është rasti të shtojmë këtu se ka dhe shumë fjalë të huaja që duket sikur Shqipja i ka huajtur, por që vetëm ajo është në gjendje t'i motivojë ato deri në fund...

Le të japim ndonjë shembull tjetër:

Në Shqip: "d y s h e m é". Kjo është fjalë e Turqishtes, por prapë Turqishtja nuk është në gjendje ta motivojë këtë fjalë, që lidhet me Shqipen: "d y s h" = 2 = **F** = ↓ (poshtë...)

Kujtojmë këtu se në Sllavisht *dyshe*mësë i thonë "p o d" (под), fjalë kjo të cilën vetë Sllavishtja s'është në gjendje ta motivojë dhe që s'është tjetër veçse Shqipja: "b a d à" = ⊕ = **F** = ↓ ...

Ej. etj.

794) Greq. o r a o (όράω) = ingl. *to see, observe* (me pa)

Lidhet me Shqipen:

o r o e

si në shprehjen: "O r o e!"* (dhe: "R é!") = Vini ré!

Në zgjerim të Bisedës, vëmë ré këtu se Inglishtja "b e w a r e" = *ki kujdes, ruhu...*, është prapë Shqipja: "b ë v ë r é".

Dhe më në fund: Kujtojmë këtu me këtë rast se rrënja "r é" lidhet me fjalën Egjyptiane "r a", perëndia "R a", pra Dielli i Hyjnizuar, si simbolizim i Dritës.^{***}

* Kjo trajtë është tashmë disi e vjetëruar në Shqipe, por ajo ishte e gjallë në tekstet deri-diku "zyrtare" dhe në të folmen e Veriut (Gegërisht).

795) Greq. *o r a i a* (ωρᾶία) = ingl. *pretty, nice* (i pashëm, i bukur)

Kemi edhe këtu Shqipen:

O r o e

(në kuptimin e "pamjes", vrojtimit)

Në Shqip:

"me pa" dhe "i pashëm" = që vlen me u pa, i bukur...

(ingl. *pretty*)

Pra edhe këtu nga "o r o e" (*me pa*) kalohet në Greqisht në "o r e i a" (*i bukur, i pashëm*). Duke qenë kështu, na lejohet të themi se edhe kjo fjalë e Greqishtes lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen "o r o e".

796) Greq. *a p o l i o* (ἀπολύω)** = liroj, pushoj (p.sh. "pushoj nga puna") etj.

Dhe është Shqipja:

â b â l a (lë)

Ky operator ("l a", "l ë", "l e",...) është shumë i përhapur edhe në shumë gjuhë të tjera, qoftë edhe si i fleksionuar, a me prapashitesa asemantike, si bie fjala në Gjermanisht "*lassen*", Frengjisht "*laissez*", Italisht "*lasciare*" etj., si edhe në Inglisht "*leave*", "-*less*" (si sufiks, si p.sh. në "meaning-*less*" = pa kuptim).*

Ky operator gjendet madje edhe në gjuhën Kineze, ku "l" (离) = shq. "l ë", "l a"... gjë që flet për stërlashtësinë e tij.

*** Shih lidhur me këtë edhe fq.777.

** Shih lidhur me këtë edhe fq.488 dhe 589.

* Shih lidhur me këtë edhe fq.320, 514 dhe 538.

Në zgjerim të Bisedës shtojmë edhe se në Shqip:

$$\begin{array}{ccc} -\text{Ë} & = & \text{Ë} \quad \dots(\text{E}) \\ \text{lë} & & \text{lith} \\ (\text{lëshoj}) & & \end{array}$$

gjë që dëshmon gjithashtu për lashtësinë e këtij operatori në Shqip, një lashtësi që shkon deri në atë kohë kur, sikundër në gjuhën Egjyptiane, dy kuptime të kundërta tregoheshin me të njejtën fjalë (rrënjë a operator).

797) Greq. *krio* (κρύο) = ingl. *cold* (ftohtë)

Lidhet me Shqipen:

ngrij

Vetë kjo fjalë ka si operator të ndërkallur kuptimdhënës grupin "g r" që s'është tjetër veçse fjala "g u r" (ingl. *stone, rock*).*

Në Shqip gjithashtu "n g r i j" dhe "n g r o h". Pra Shqipja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} x & = & -x \quad \dots(\text{E}) \\ \text{ngrij} & & \text{ngroh} \end{array}$$

gjë që ridëshmon për lashtësinë dhe autoktonicitetin e këtij operatori në Gjuhën e Arbrit.

* Do të mund të vinim ré këtu alternimin: "w" (ingl.) → "k", si p.sh. në fjalët e mëposhtme:

ingl. walk → lat. calcare = shq. shkel

ingl. warm → sanskr. garma = shq. (n)groh

ingl. worm → shq. krim(b)

Që këndeje edhe Shqipja: "s h k r i j" = " - n g r i j".

Në Rusisht: "g r i e t s" (греть) = shq. n g r o h (ingl. *to warm, to heat*).
Por partneri antitetik në Rusisht (ndryshe nga Shqipja) mungon, që nga
dhe atëhere:

rus. "g r i e t s" < shq. "n g r o h"

798) Greq. k l e o (κλαίω) = ingl. *cry* (qaj)

Është Shqipja:

k l a j

dhe në një trajtë akoma më të lashtë:

k ā j

Në Shqip: "kam k ā..." = "kam q ā..."

Në Shqip gjithashtu:

"k a j" e "k j e s h"*
(q a j) (q e s h)

Pra kemi dy kuptime të kundërta me pothuajse të njejtën fjalë, gjë
që flet për lashtësinë dhe autoktonicitetin e këtij operatori në Shqip.

Në zgjerim të Bisedës:

Në Greqisht: "k a i m e n o s" (καημένος) = "i k j a m u n i", *ai qi është bā
me u kjà, i mjerë...* e kështu me radhë.

Vërejmë me këtë rast dhe diçka tjetër: prapashtesa "-m u n" nuk është
tjetër veçse një pjesë e pjesores të foljes "j a m" ("j a m u n") të Shqipes.

* Shih lidhur me këtë edhe fq.632.

Në Shqip:

daj → i dāmun ("i dā jamun" = "jamun dā")

laj → lāmun ("la jamun" = "jamun lá")

etj. etj.

Prandaj dhe në Greqisht çdo mbaresë me "-m e n o s" (-μένος) duhet të lidhet patjetër, si me origjinën e vet, me Shqipen "j a m u n".

799) Greq. **z e s t o s** (ζεστός) = ingl. *hot* (nxehhtë)

Dobzërthyer si:

x é â s h t

Ky operator në Shqipe është mjaft produktiv: "me u x é", "âsht x é h t", "x é h t é s i", etj.

800) Greq. **e t e r o** (ετερο) = ingl. *other*,* *otherness* (tjetër, tjetërsi)

Lidhet me Shqipen:

t j e t ë r

801) Greq. **p i s t e v o** (πιστευω) = ingl. *believe* (besoj)

Lidhet me Shqipen:

b e s o j

Dhe ja se si:

Në Shqip: "b e s a" = p e s a = 5 = 8 = bashkimi *par excellence*, primordial, ai mes Qiellit (*parimi mashkullor*, 3) e Tokës (*parimi femëror*, 2).

* Sic kemi parë dhe gjetiu, kjo fjalë motivohet me Shqipen:

o t h e r → shq. â t h y e r = ⊕ = F = 1/2 = 2 = -1 = jo unë...

Kjo është paradigma e mirëfilltë për çdo lidhje, për çdo bashkim.*

Në Latinisht: "re l i g i o" = *fé, besim*, dhe në të njejtën kohë po në Latinisht: "l e g a r e" = lidh. Kjo tregon pra se edhe në Latinisht *besimi* konceptohej si një *lidhje*, sikundër edhe në Greqisht, sikundër që e nxjerr në pah këtë Gjuha Shqipe.

Prandaj pra, *besimi* flet për një *lidhje* të njeriut me Zotin. Dhe duke qenë kështu, fjala "p i s t i s" nuk mund të lidhet me ndonjë simbol tjetër veçse me atë të *pesës* ("p i s t i s" = "p e s ë â s h t"), që përfaqëson, siç thamë, bashkimin paradigmatic, absolut, primordial..., që si i tillë duhet të jetë referencë simbolike për *bashkimin* si të tillë, për *besën* si të tillë, për besimin *tout court*, e pra për "p i s t i s", që s'është tjetër *pra*, siç e vumë në dukje, veçse Shqipja "p e s ë" (5).

Në Shqip thuhet: "lidhën b e s ë n"... pra:

"kanë bâ : 2 + 3 " = 5 = p e s a = b e s a , b e s i m i

Kjo dëshmon, prap e prap, për faktin se "b e s a" (e pra "p e s a", 5) realizon një *lidhje*, një *bashkim* (⚡) siç është treguar edhe më sipër.

* Tek Cirlot na thuhet se simbolizma e numurit 5 përfshin ndër të tjera atë që në gjuhën mistike quhet "Hieros Gamos", do me thënë me Shqipen: "Martesa e Shenjtë", e pra bashkëshortësia *par excellence*, e pra "bashkimi" *tout court*.

Kujtojmë në këtë rast se Gjuha emërton sipas një paradigma primordiale, superlative. Kjo është një arsye më tepër që na jep të drejtë të nxjerrim si përfundim se:

greq. "pistevo" = *besoj*, si edhe "pistis" = *besim*

lidhen, si me motivuesen e tyre, me Shqipen "p e s ë". (Shih edhe fq.663)

802) **Asir.** a l â d u = gjerm. *gebären, zeugen* (lind; prodhoj)

Do zbërthyer në:

a l a d u

dhe me Shqipen:

â l i n d, â l é
(folja "me lind")

Në Asirisht, gjithpò nga kjo rrënjë:

"l i d â n u" = gjerm. *Kind* (fëmijë)

fjalë që nuk është tjetër veçse Shqipja "i l i n d u n i".

"l i d â t u" = gjerm. *Nachkommenschaft, Sprossling* (pinjoll)

"t a l i t t u" = gjerm. *Geburt* (lindje)

E kështu me radhë... të gjitha fjalë që lidhen me rrënjën "alâdu" e pra edhe me Shqipen "lind".

Le ta zgjerojmë pak Bisedën.

Rrënja Shqipe "l i n d" ka mbrenda Shqipes një lidhje fillosofike–mitike të rëndësishme. Në Shqip: "l i n d" dhe në të njejtën kohë "l ë n d" (ingl. *matter*). Pra, nëpërmjet kësaj lidhjeje (homonimie pothuajse perfekte mes këtyre dy fjalëve), Shqipja na thotë:

"Lënda është ajo që lind."

Ose edhe:

"Çdo entitet i lindun është i lëndshëm."

Kështu Shqipja na thotë atëhere se materia, e pra dhe Bota materiale, është krijuar – dhe se ajo nuk është pra e përjetshme, siç pretendonte fillosofia materialiste. Sot, siç dimë, Shkenca (Kozmollogjia moderne) e

rikonfermon tezën e *krijimit* të Kozmosit, ndër të tjera edhe me Teorinë e *Big Bang*-ut.

803) **Greq.** **d h e m a** = ingl. *cord; laces, bandage, band* (litar, lidhje, fashnjë)

Lidhet si me motivuesen e saj me Shqipen "d a m" (folja DAJ), e pra:

d h e m a → shq. **d ā m** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X = *lidhje...*

Si "*Consensio linguarum*" sjellim këtu edhe shembullën e Inglishtes "**b a n d**" ("b a n d a g e") që motivohet edhe ajo nëpërmjet Shqipes si:

b a n d → shq. **b â n d à** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X

si edhe shembuj të tjerë nga Gjermanishtja:

B u n d → shq. **b â n d à** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X (ingl. *league, federation*)

V e r b a n d → shq. **b ë r : b â n d à** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X (*association..*)

B i n d u n g → shq. **b ë n d à** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X (*bond, tie, connection*)

Greqishtja:

d e s m o s (δεσμός) → shq. **d a s í m** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = X (*tie, knot, band*)

Sanskritishtja:

b a n d h a n a (बन्ध) → shq. **b â n d ā n** = $\textcircled{\text{D}}$ = **F** = ...
= X (*tying, fettering, captivating...*)

E kështu me radhë.

Ekuacioni themelor që vihet në përdorim në këto raste është:

$$\textcircled{1} = \text{X} \quad \dots(\text{F})$$

ndarja bashkimi

Shtojmë mbi të gjitha këto edhe se në Shqip mund të formohet po ky ekuacion ndryshe, si

$$\textcircled{1} = 5 = \text{X} \quad \dots(\text{F})$$

pjesë pesë Hieros Gamos
(lidhje, bashkim)

804) Greq. **d h e s i m o n** = ingl. *binding, bond, knot* (lidhje, nyjë...)

Motivohet me Shqipen:

d a s i j a m u n

Shih edhe më sipër.

805) Greq. **d h e s i s** = ingl. *barrage, dam* (digë, cfrat)

Është Shqipja:

d a s i = \textcircled{1}

Kështu motivohet edhe Inglishtja "d a m" = d i g ë, që s'është tjetër veçse Shqipja "d ā m", "i d a m u n" (nga folja DAj).

Kështu ne shohim se si Greqishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\textcircled{1} = \text{X}$$

d h e s i s d h e s i m o n

Në vend të "d h e s i m o n" mund të vinim edhe "d h e s m i" = tufë, pako, gjë e lidhur (ingl. *bunch, bundle, pack*), ose edhe "d h e s m i o s" = rob, i burgosur (ingl. *captive, prisoner*)... të gjitha fjalë këto që mund të paraqiten simbolikisht me " ⌘ ".

806) Asir. g a m â l u = gjerm. *vollkommen* (i përsosur, i plotë, absolut)...

Është Shqipja:

k a m y l l = ○
(me epentezë: "m-b-yll")

807) Turq. k â m i l = ingl. *perfect, complete; mature* (i përsosur, i plotë; i pjekun)

Motivohet me Shqipen:

k a m y l l = ○

dhe kjo me që simboli " ○ " është pikërisht, siç dimë, simboli arkeotipal i të plotës, i të tërës, i të përsosurës, etj. etj.

Edhe ky është një nga rastet e stërshumta që tregon se si Shqipja e motivon një fjalë të huaj duke e referuar jo tek një koncept (më "të thellë" a më "të vjetër"), por tek një simbol, duke realizuar kështu një referencë absolute tek koncepti më superlativ dhe më primordial.

Duke zgjeruar Bisedën, kujtojmë se në gjuhën e stërklashtë Egjiptiane dy sende a koncepte të kundërt tregohen me të njejtën fjalë. Kjo do të thotë se Egjiptianët përdornin një llogjikë krejt të kundërt me atë aristoteliane, kjo llogjikë ishte ajo të Tretit të Përfshirë (*Tertium Inclusus*) që shkruhet si: $(x = -x)$, dhe që është, nga ana tjetër, sikundër e dimë, ajo që botërisht referon tek Qëndra Mistike. Tek Jean Chevalier lexojmë se: "*La logique du symbol c'est la logique du Tiers Inclus*". Kjo pra atëhere do të

thotë se referenca për qëllime etimologjike tek simboli (e jo tek koncepti) është referenca tek Qendra Mistike, që realizon kështu, me qenë se nuk ka "më tej" (*nec plus ultra*),* një referencë *absolute*, një motivim dhe etimologjizim që s'mund kurrsesi të modifikohet a të kundërshtohet.

808) Asir. **d â k u** = gjer. *todten* (me vra, me lanë dekun)

Është Shqipja:

me **d e k ë**

(i d e k u n, i v-dekun, d e k a, v-dekja,...)

Kështu pra Asirishtja "**d â k u**" motivohet me Shqipen:

d â k u → shq. **d à k a** = $\textcircled{1}$ = **F** = ●

ku simboli i fundit është bash ai i vdekjes.

Vëmë re këtu edhe se, me qenë që: $\textcircled{1}$ = 2 , Shqipja e lidh vdekjen me numurin 2 dhe me simbolizmëm e tij.

Lexojmë tani tek Cirlot: "Two ...in all esoteric thought, two is regarded as o m i n o u s."**

Kështu pra dyshi (2) është pikërisht, ndër të tjera, numuri i vdekjes, gjë që del qartë përmes Shqipes, por jo përmes Asirishtes. Shtojmë këtu se në Shqip:

i d y t ë (2) , i n d y t ë (●)

dhe:

i d â t ë (\textcircled{1}) , i d y t ë (2)

* Shiko lidhur me këtë edhe fq.169, 255, 328, 457 dhe 563.

** Shih lidhur me këtë edhe fq.11-12, 406, 525, 633 dhe 675.

809) **Asir.** **n a d â n u** = gjerm. *geben, schenken* (me dhanë; me dhurue)

Është Shqipja:

n d a n ë; dhanë; dhunti; dhuratë...

të gjitha fjalë këto që lidhen me foljen DAJ (*darë, dan, ndaj, ndanë,...*).

810) **Frengj.** **d o n n e r** = ingl. *to give* (me dhanë)

Nuk është tjetër veçse Shqipja:

d ā m u n A r

e pra:

d a m u n . ○ = ⊕

Ashtu natyrisht edhe Italishtja "**d o n a r e**" (me *dhurue*), si edhe Italishtja "**d a r e**" (me dhanë)... lidhen të gjitha me Shqipjen "**d a n**", "**d a r ë**" (folja DAJ = simb. ⊕).

Për të vënë ré këtu është afërsija e Italishtes "**d o n o**" (lat. *donus*) me Asirishten "**n a d â n u**" duke patur parasysh se "na" këtu, si edhe në Shqip, është prostatike (e pra pak a shumë pleonastike, e tepërt...).

Prostaticiteti në Shqip i "n-" (si edhe në Sanskritisht) vihet ré në raste të tilla për shembull si: *digjon, n-digjon; dan, n-dan; pas, m-bas* (nga një: *n-pas; ban, m-ban* (nga një: *n-ban*),...

811) **Asir.** **p â r u** = gjerm. *suchen** (me pa, me kërkue)

* Tek Gjermanishtja "s u- c h e n" theksi semantik bie tek "s u" (Shq. "s y", "s y r i"), ndërsa "-c h e n" është një sufiks verbalizonjës, siç e kemi në shumë folje të tjera të Gjermanishtes, si p.sh. në "b r e- c h e n" (= thyej) ku theksi semantik bie tek "b r e", e pra tek Shqipja "p r e", ndërsa "-c h e n" është, si edhe më sipër, një sufiks verbalizonjës.

Është Shqipja:

p a r ë

Nga folja "me p a" (ingl. *to see, look*), një operator i lirë dhe tepër aktiv në Shqip.

812) Ital. p a r e r e, p a r e, a p p a r i r e = me u duk, duket, shfaqet...

Të gjitha këto fjalë dhe të tjera si këto në Italisht, Frengjisht, Inglisht... lidhen si me motivuesen e tyre me foljen Shqipe "me p a" dhe me fleksionimet e saj të ndryshme.

Një fjalë e tillë si Inglishtja (nga Latinishtja) "s p e c t a t o r" = spektator, mund të zbërthehet në:

s + p e + c t (a) + t o r

ku "s" është një afiks e pra pa ndonjë rol semantik; "p e" është Shqipja "p e" (folja "me pa") që nuk ekziston e lirë as në Latinishte dhe as në gjuhët që lidhen direkt a tërthorazi me të; "c t" është Shqipja "g a t i-s", "k a t i s" (kjo rrënjë është e lirë në Sanskritisht, në trajtën "ghaṭita") = bëj, përgatit; "t o r" është një prapashtesë që tregon vepruesin (agjentin) dhe është Shqipja "-t o r", si në *punë-tor, shërbë-tor, etj. etj.* E gjejmë si të tillë edhe në Sanskritisht. Që këndeje del pra se fjala "s p e c t a t o r" dhe fjalë të tjera që lidhen me të, si bie fjala "s p e c t a c l e" etj. etj., janë të motivueshme plotësisht nëpërmjet Shqipes.

Do të kthehemi edhe më pas mbi operatorin e lirë shqiptar "p a", "p e"... dhe mbi rrezatimin e tij në gjuhë të ndryshme.*

813) Asir. k u d m u = gjerm. *Vorderseite, Front* (pjesa e përparme, ball)

* Shih edhe fq.101 dhe 250.

Do zbërthyer në:

k a d m u

dhe me Shqipen:

k a d ā m

e pra simbolikisht:

⊕

Por Algoritmi Simbolik na jep:

⊕ = -1 = 2 = ● (materie, Botë materiale...)

Kjo do të thotë që ai që ne në këtë Botën tonë materiale (●) e quajmë një (1) është në të vërtetë " - 1 ", që do të thotë se është i barabartë me Njëshin vetëm në vlerë absolute, me qenë se : $|1| = |-1|$, por me sens të kundërt, negativ e jo pozitiv. Ai është madje jo i pari (- 1), por i dyti (2). Mendimi Mistik (sidomos pas artikullimit dhe strukturimit të tij në "sistemin" e një Algoritmi Simbolik), e tregon qartë këtë.*

Por le të përpiqemi të japim këtu edhe shpjegime të tjera përse ndodh kështu.

Sipas fillosofisë së Hegelit, Bota *fillon* me Antitezën që është *kundërvënie*, e pra *negativitet*, d.m.th. " - 1 ", dhe momenti i dytë (2) i Triadës Hegeliane.

Ne kemi parë, me shembulla edhe nga Gjuha, se Bota filloi, *n i s i* ("njishi") me një *n d a r j e*.

Kujtojmë mësimin e madh të Paracelsit, që rikonfermohet në të gjitha gjuhët dhe jo vetëm atje, sipas të cilit: "Die *Separatio* is taller Geburt Anfang", që mund të transkribohet simbolikisht si:

* Shiko ndër të tjera edhe fq.70, 275, 389 dhe 671.

$$\textcircled{1} = \bullet \quad \dots(F)$$

Separatio **Geburt**
 (ndarja) (lindja e Botës
 materiale)

Pra mund të shkruajmë:

$$n i s j a \text{ ("njishi")} = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

Por:

$$\textcircled{1} = -\bigcirc = F = -1 = \bullet = 1/2 = 5 \text{ (mistikisht)} = 2$$

Pra:

$$\text{"njishi"} = -1 = 2$$

...çfarë edhe duhej vërtetuar.

Në planin gjuhësor, Rusishtja e tregon këtë mjaft qartë.

Në Rusisht: "r a z" (раз) = një (1); "r a z-" (раз) = prefiks foljor me kuptim negativues, privatif (pra simb. - 1), p.sh. "raz-dets" (раздеть) = ç-vesh, "raz-utçitsa" (разучится) = ç-mëso, etj. ; "rez-ats" (резать) = pres (e pra simb. $\textcircled{1}$, e pra 1/2, e pra 2).

Bindemi kështu që "k u d m u" e Asirishtes mund të motivohet me Shqipen "k a d ā m".

Edhe "k a d m o n", që do të thotë *i pari, udhëheqës* etj., në Hebraisht (por edhe në Asirisht) nuk është tjetër veçse Shqipja "k a d a m u n".*

* Kujtojmë këtu "A d a m K a d m o n i n", *njeriun primordial* (prototipik) sipas traditës së Kabbalas.

Duke qenë kështu, duke qenë me fjalë të tjera se njëshi i kësaj Bote lidhet me një ndarje, ne mund të bëjmë lidhjen mes fjalës "i p a r ë" në Shqip dhe "p r e" (folja "pres"), simb. $\textcircled{1}$ e pra, për ekuivalencë simbolike, -1 . Edhe fjala "p r a", që tregon kauzalitet në Shqip, lidhet, mund të lidhet me këtë rrënjë. Ne mund të shkruajmë:

$$\begin{array}{ccccccc} \leftrightarrow & = & -1 & = & \textcircled{1} & & \dots(F) \\ \text{pra} & & \text{parë} & & \text{pre} & & \end{array}$$

Që mund të lexohet:

"Shkaku (*pra*) i lindjes së të parit (*parë*) që një prerje (*pre*)."

Një nga rikonfermat e shumta të këtij pohimi është edhe Shqipja "p r e j-ardhje" = origjinë, zanafillë.

Duke qenë kështu, mund të themi se edhe Inglishtja "f r o m" (shq. n g a) mund dhe duhet të shprehë edhe konceptin e ndarjes, të prerjes, e pra atëhere mund të shkruajmë:

$$\text{ingl. "from"} < \text{shq. "jam pré"} = \textcircled{1} = \dots^*$$

814) **Asir. ki bîru** = gjerm. *Grab, Begrabniss* (varr, varrim)

Duhet ndarë në:

ki bîru

Ky emër zberthehet etimologjikisht me Shqipen si:

Â dhōm Ka dāmuni

Në Bibël (Gjeneza) na thuhet se Njeriu i Parë u krijua me baltë (Shqipja e veriut: "d h ō m"), ndaj pra dhe etimologjia e mësipërme, me anë të Shqipes, nuk mund të zëvendësohet me asnjë tjetër.

* Shih edhe fq.64, 103 dhe 601.

dhe me Shqipen:

ka birë

e pra simbolikisht:



Pra është Shqipja "b i r a" (bri-ma), "v ë r a" (vri-ma)... një rrënjë mjaft produktive në Shqip që motivon plotësisht fjalën e mësipërme Asirishte.

Edhe fjalë të tjera Asirishte si "k a b r u" = varr (gjerm. *Grab*) etj., shpjegohen edhe ato të gjitha përmes Shqipes siç treguam më lartë.

815) Asir. a s r u = gjerm. *heilbrigender* (shërues)

Rrënja motivuese është Shqipja:

shër-oj

Në Shqip: s h ë r i m, s h ë r u e s, etj. etj. Po këtu duhet kërkuar edhe rrënja e fjalës Asirishte "A s u r" = zoti Asur, i quajtur kështu sepse sjell s h ë r i m, shëndet... zoti shëronjës (gjerm. *Gott Asur, so gennant als heilbrigender, heiliger Gott*).

816) Asir. N i s a n = emri i muajit të parë Asiro-Babilonas

Kjo fjalë motivohet përmes Shqipes:

n i s

Kemi, ndër të tjera, në Shqip: "n i s j e" = *fillim*, "n j i s h" (dikur "n i s h"), "n j i s i" (dikur "n i s i").

Në shqip kjo rrënjë është mjaft produktive dhe nuk rri e izoluar si në Asirisht. Në Shqip: "nisu!", "nisma", "nismëtar", e kështu me radhë.

817) **Asir.** **a d a n n u** = gjerm. *Festsetzung, Bestimmung, Termin, Endziel* (përcaktim; cak; cak i mbramë; qëllim)

Kuptohet se kjo fjalë duhet të jetë një nga interpretimet e simbolit $\textcircled{1}$ që është, ndër të tjera, ai i *cakut, i fundit, i përcaktimit, kufirit, etj.*

Duke qenë kështu kjo fjalë motivohet më së miri me Shqipen:

â d ā m u n ("ka ndarë")

Ne dimë se grupi "-m u n" (nga folja "j a m u n" e Shqipes) pëson "përçudnime" të ndryshme kur kalon në gjuhë të tjera, si për shembull nga "d a m u n" e Shqipes kemi "d a m" po në Shqip, kemi "d a m n u s" në Latinisht, kemi "d a n n o" në Italisht, kemi "d o m m a g e" në Frengjisht e kështu me radhë.

818) **Asir.** **b a s â r u** = gjerm. *abschneiden* (ndaj, pjesëtoj)

Duhet ndarë në:

b a s â r u

dhe me Shqipen:

b â s h a r r ù

ose edhe:

b a ç a r ë

e pra simbolikisht " $\textcircled{1}$ " (*ndaj*), e pra edhe " *!.*" (*pjesëtoj*).

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë edhe se fjala "s h e r r" (grindje, zënie) në Shqip duhet vështruar si e prejardhur nga rrënja "ç a r" (ose edhe: "s h a r r o j") edhe kjo sepse kemi:

$\textcircled{1}$ = ($\rightarrow \neq \leftarrow$) ... (F)
 sharroj sherr

Shqipja e shtron këtë ekuacion simbolik edhe në ndonjë mënyrë tjetër, si për shembull me:

$$\textcircled{1} = (\rightarrow \neq \leftarrow) \quad \dots(F)$$

dasi ndesh

819) **Ingl. s h a r e** = pjesë, porcion; të ndash diçka me një tjetër...*

Mund të motivohet fare mirë edhe me Shqipen:

$$s h a r e \rightarrow \text{shq. } \zeta a r j e \text{ (nga folja "ç a j")} = \textcircled{1}$$

Po ashtu Inqlishtja: "s h i r e" = distrikt, krahinë (ingl. *a district or a region*), simbolikisht $\textcircled{1}$, mund të motivohet gjithashtu me Shqipen "ç a r j e" (pjesë).

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë edhe se operatori i lirë shqiptar "ç A j" (çarë, çarje) është i pranishëm dhe motivues edhe në Rusisht, ku kemi:

$$\text{"ç a s t"} \text{ (часть)} = \text{pjesë}$$

Dhe me Shqipen:

$$\text{"ç a â s h t"} = \textcircled{1} \quad \dots(F)$$

Gjithpo ashtu motivohen me Shqipen edhe: "ç a s t o" (часто) = *shpesh*, "ç a s t a t a" (частота) = *frekuencë*, "ç a s t i t s a" (частица) = *grimcë*, "ç a s t n i j" (частный) = *privat*, "ç e s t" (честь) = *nder, etj.***

* Në Italisht do të ishte "con-dividere" = fjalë për fjalë: "bashkë-ndaj", "ndaj me...".

** Që lidhet brenda Shqipes me fjalën "n d a r", me qenë se një njeri i *nderuar* është një njeri i *ndarë* për respekt nga të tjerët, është një njeri "ha bukë veç".

Të gjitha këto fjalë, vetë Rusishtja nuk është në gjendje ti motivojë, sepse i mungon operatori i lirë, folja "ç a j" = n d a j = \textcircled{D} .

820) Ingl. s h a r p = i mprehët

Mund të vështrohet si e motivueshme brenda Inglishtes me "s h a r e", dhe kjo sepse Gjuha referon, siç dimë, tek Qëndra.

Simbolikisht Qëndra, që është ndër të tjera edhe e Tëra, mund të paraqitet si " \textcircled{O} ". Dhe këtu nuk kemi majë ("majuca"), dhe këtu nuk kemi mprehtësi (ingl. *sharp-ness*). Momenti i dytë është ndarja, me të cilën, siç e kemi thënë e parë kaq e kaq herë, Bota u krijua. Simbolikisht kjo mund të paraqitet si " \textcircled{D} ".

Por mund të shkruajmë, për ekuivalencë simbolike:

$$\textcircled{D} = \textcircled{D}$$

dhe këtu pas *ndarjes* (prerjes më dysh) rrumbullakësija *number*, dhe ne kemi *maja*, *cepa*, do me thënë dy pjesë të *mprehta*. Prandaj pra vërtetë pas *prerjes* (ingl. *share*) ne kemi *mprehje* (ingl. *sharpening*).

Ingl. "s h a r-p e n" (= mpreh) nuk është tjetër pra kështu veçse Shqipja:

b ë n ç a r

simbolikisht " \textcircled{D} " dhe për ekuivalencë simbolike, siç pamë, \textcircled{D} dhe \textcircled{D} .

Në zgjerim të Bisedës shtojmë edhe këtë aforizëm të Shqipes:

"Shka ka **cepa**, është përciptë."

Vëmë ré pra këtu se taktika semantike e Rusishtes realizohet (me ndihmën e Shqipes) me "ç a s t" dhe "ç e s t", kurse në Shqip me "n d a r" dhe "n d e r". Pra, dy taktika analloge, në mos pò identike...

që shtron ekuacionin:

$$\textcircled{1} = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) \dots(F)$$

duke justifikuar gjithë sa ne pohuam më sipër lidhur me etimologjinë, ndër të tjera, të fjalës Inglisht "sharpen".

Në Shqip gjithashtu:

"p r e j" (ingl. *to cut*), simb. $\textcircled{1}$

dhe:

"i m p r e h t ë" (ingl. *sharp*)

që "anallogjizon" Rusishten:

"r e z - a t s" (резать) = pres

dhe:

"r e z - k i j" (резкий) = i mprehtë

821) Asir. a b â r u = gjerm. *stark sein, stark warden* (me qenë i fortë, me u bërë i fortë)

Është Shqipja:

â b u r r ë

Kujtojmë se edhe në Latinisht rrënja "v i r" do të thotë "b ū r r", por në të njejtën kohë edhe *forcë, fuqi*, si bie fjala në shprehjen nga libri "*De bello gallico*" i Çezarit: "*De viribus, unitis*" = me forca të bashkuara...

822) Asir. a p a t â r u (p a t ê r u) = gjerm. *spalten, zerreiben, durchbrechen* (me çarë, me thy)

Do zbërthyer në:

a p a t â r u

dhe me Shqipen:

$$\hat{a} \hat{b} \hat{d} \hat{a} \hat{r} \hat{e} = \textcircled{1} = (\quad)$$

ose:

$$\hat{a} \hat{b} \hat{t} \hat{h} \hat{y} \hat{e} \hat{r}$$

Ky version i "dytë" i motivimit i qëndron më besnik Gjermanishtes "durchbrechen" ku "brechen" do të thotë pikërisht *thyej, shpërthej*.

823) **Asir. e p s e t û** = gjerm. *Gedanken* (mendime)

Theksi semantik bie tek "p s e", pra tek Shqipja:

$$p e s = 5$$

sepse 5 lidhet mistikisht me mendimin, siç mund të lexojmë tek Cirlot:

"P a n s y : In Spanish, this flower is called 'thought' *precisely* because it is thought which it symbolizes by virtue of its clearly pentagonal pattern – five being the number that symbolizes man."

(Vjollca: Në Spanjisht kjo lule quhet 'mendim' dhe kjo për arsye se është bash mendimin që ajo simbolizon me strukturën e saj të qartë pesëkëndore, duke qenë p e s a numuri simbolik i njeriut...)"

Le ta zgjerojmë pak Bisedën.

Lidhja mes "njeriut" dhe "manushaqes" jepet me Sanskritishten "m a n u s y a" (मनुष) = njeri (ingl. *man*) dhe Shqipen "m a n u s h a q e" (ingl. *pansy*).

Lidhja mes Njeriut dhe numurit pesë jepet edhe nëpërmjet "b e ş" = 5 dhe "b e ş e r i" = njerëzor (ingl. *human*) në Turqisht.

* Cirlot, fq.249.

Në Latinisht: "h o m o" = *njeri*, dhe në të njejtën kohë po në Latinisht: "h e m i-" si prefiks = $1/2$ (p.sh. *hemi-sferë*). Mirëpo: $1/2 = 0.5$ dhe pra mistikisht 5. Në këtë mënyrë Latinishtja pozon *implicite* ekuacionin:

$$H o m o (njeri) = 5$$

824) **Asir. e p i s t u** = gjerm. *Tat, Handlung, Werk* (veprim, bërje, punë)

Kjo fjalë lidhet me fjalën e mësipërme "e p s e t u" (= mendim), sepse të lashtët nuk bënin ndonjë dallim mes të *menduarit* dhe të *bërit*, të *Realitetit*... Sipas të lashtëve, ashtu si edhe për Shkencën moderne, **Realiteti** (Objektiviteti) nuk është tjetër veçse Mendim. Mes tyre ekziston një paralelizëm perfekt dhe një ndërvarësi ("interdipendencë") ose, siç argumenton fillosofiksht Fizika Moderne, Realiteti krijohet nga Mendimi, **pak a shumë** sipas formulës të Berkley:

"Esse est percipi."

Ne shohim këtu një rikonfermë gjuhësore të kësaj të vërtete.

Në Gjermanisht:

denken = mendoj

Dinge = send material

Në Inglisht:

to think = mendoj

thing = send

Kështu të lashtët (siç na rikonfermon Gjuha) vendosnin një korrispondencë të harmonishme mes Mendimit dhe Realitetit, që do të thotë mes të Mbrendshmes dhe të Jashtmes, mes Subjektives dhe Objektives.

Dhe s'mund të qe ndryshe, sepse të lashtët i referoheshin Qëndrës Mistike (Zotit) me llogjikën e saj të të Tretit të Përfshirë, a kod E, siç e kemi quajtur ne, kodi i tërë Mendimit Mistik a Simbolik dhe, siç dime, edhe ay i Gjuhës që ngrihet e tëra mbi këtë mendim.

Ti referohesh Qëndrës do të thotë të vendosësh si themel të themeleve ekuacioni ($x = -x$), parimin e *Coincidentia oppositorum*, dhe me qenë se Subjektivja dhe Objektivja formojnë një çift të kundërtash, del atëhere se për Mendimin Mistik:

Subjektivitet = Objektivitet

që është si të pozosh (në fillosofinë e Hegelit) Tezën, e pra Frymën Absolute, të pa alienuar, të pa "reifikur" (sendëzuar), e pra para fillimit të Botës. Ne shohim kështu se Mendimi Mistik pozon Trashëndencën, nga pikëpamja e të cilës, Subjektiviteti dhe Objektiviteti korrispondojnë dhe nuk i kundërvihen njëri-tjetrit siç ndodh në momentin e dytë të Triadës hegeliane, në atë të Antitezës, që përputhet me alienimin e Frymës Absolute, me krijimin e Botës materiale dhe të kodit F (llogjikës aristoteliane a arsyes njerëzore) të cilës ajo i bindet.

825) Kinez. d à i (歹) = ingl. *bad; wicked; evil* (i keq; i përdhosur)

Motivohet me Shqipen "d a j" (ingl. *to divide*) dhe kjo për arsye se, sipas Algoritmit Simbolik:

$$d a j = \textcircled{1} = \bullet \dots(F)$$

Dhe simboli i fundit, duke qenë ndër të tjera edhe ai i të zezës, është arkeotipikisht edhe ai i të Ligut, i të keqes, etj.

Le ta zgjerojmë Bisedën për ta justifikuar kështu akoma dhe më mirë motivimin tonë përmes Shqipes.

Në Shqip ekuacioni i mësipërm shtrohet përmes çifteve:

$ndaj (\oplus)$, $ndyj (\bullet)$

$ndarje (\oplus)$, $ndyrje (\bullet)$

$pjesë (\oplus)$, $pis (\bullet)$

Pyetjes: *Përse ndarja është vështruar nga të lashtët si një gjë e keqe, si një mëkat, etj. etj.?* mund ti përgjigjemi kështu: Sepse, me qenë se Gjuha referon gjithmonë tek Qendra, tek Zoti, ndarja duhet vështruar si një **ndarje** zanafillore nga Qendra (decentrim, materializim), nga Zoti (mëkat, ligësi).

Vëmë re këtu edhe një gjë tjetër: simboli " \bullet " është ndër të tjera edhe ai i **m a t e r i e s**, e r r ë s i r ë s... Duke qenë kështu, për të lashtët **materia** dhe Bota materiale vështroheshin si diçka e keqe. Një ndër rikonfermat e shumta të kësaj të vërtete gjendet edhe tek Cirlot, ku lidhur me simbolizmin e numurit dy (2) na thuhet ndër të tjera:

"T w o stands for echo, reflection, conflict and counterpoise or contraposition... It is also symbolic of the first nucleus of **m a t t e r**, of nature in opposition to the creator, of the moon as opposed to the sun. *In all esoteric thought, two is regarded as o m i n o u s* : it connotes shadow and the bisexuality of everything..."

Ne dimë se:

$$2 = \oplus \dots(F)$$

E pra atëhere ato sa thuhet për simbolizmin e dyshit këtu janë të vërteta dhe për *ndarjen*, për simbolin \oplus . E pra atëhere, kjo do të thotë se fjala "d à i" e gjuhës Kineze duke u "reduktuar" tek Shqipja "d a j", e pra simbolikisht \oplus , mund të shprehi të gjitha kuptimet (interpretimet) e

simbolit $\textcircled{1}$, si edhe ato të simbolit \bullet dhe, sigurisht, ato të simbolizmës së numurit 2.

Le të tregojmë tani me ndonjë shembull se si Gjuha (gjuhët e ndryshme) e pozon këtë ekuacion, duke treguar kështu se *dyshi* dhe numurat që vijnë pas tij lidhen të gjithë me një ndarje të simbolit $\textcircled{0}$, që është ai i Qëndrës, por edhe ai i Zeros, i të Tërës, i Hiçit... e kështu me radhë.

	$\textcircled{1}$	=	2	...	(F)
shq.	dasí		dysh		
	daj		dy		
	i dātë		i dytë		
ingl.	secant		second		
		

826) Kinez. d à i (殆) = ingl. *dangerous; almost possible; only* (i rrezikshëm; pothuajse i mundshëm; vetëm)

Shqipja dhe Algoritmi Simbolik na lejon të motivojmë të gjitha kuptimet e kësaj fjale Kineze.

Ajo, si edhe e fjala e mëparshme, lidhet si e bashkërrënjëshme me Shqipen:

"d a j" (ingl. *to divide*), e pra simb. $\textcircled{1}$


Po kemi sipas Algoritmit:

$$\textcircled{1} = 2 = \bullet = \text{vdekje...} = \text{rrezik!}$$

Për kuptimin e dytë:

$$d a j = \textcircled{1} = -\textcircled{0} = -(x = -x) = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2)$$

Do të kemi atëhere grafikisht:



...që nga kemi dhe "rreth", "përreth", "afërsisht"... (gjerm. *Ungefahr*, ital. *circa*)* e pra atëhere edhe kuptimi "almost probably". Këtu "e sigurta"

Jashtë "tekstit" shtojmë edhe këtë:

Në Gjermanisht:

"**G e f a h r**" = rrezik (ingl. *danger, threat*)

"**u n g e f ä h r**" = jo afër, përreth, rreth e rrotull (ingl. *around*)

Del që këndej se lëvizja rrethore është për të shmangur lëvizjen drejt Qendrës, që përfaqëson rrezikun "mortar", fundin.

Rigjejmë kështu, në Gjermanisht, mendimin e Aristotelit që e shpjegon lëvizjen si një *shmangje* të Qendrës, si një "*Horror vacui*" (frikë, tmerr nga boshi, nga hiçi..., që përfaqësohet simbolikisht, pikërisht nga Qendra: $x^2 + y^2 = 0$).

Në zgjerim të Bisedës vërejmë edhe se: "të jesh në rrezik do thotë të jesh afër Qendrës". Prandaj, duke qenë kështu, mund të supozojmë se Gjermanishtja "**G e f a h r**" që do të thotë "rrezik", motivohet nga Shqipja "**k e a f ë r**-si", "je afër"... Afër kujt? Qendrës! Pra... je në rrezik!

Shtojmë gjithashtu akoma këtu, disi jashtë themës, se Shqipja shtron me Inglishten ekuacionin ndërgjuhësor, "qëndror":

$$x = -x \quad \dots(E)$$

shq. **afër** ingl. **afar**
 (pranë) (larg)

do të puthitej me Qëndrën, me Pi-kën ("pikërisht"), kurse "afërsia", "probabiliteti" do të puthitej me rrethin ("periferinë").

Lidhur me kuptimin e tretë të fjalës Kineze "d a i", mund të shtojmë edhe sa vijon:

Në Italisht: "a p a r t e" = *vetëm*, ndërsa "p a r t e" = *pjesë, copë* (e pra simb. $\textcircled{1}$).

Edhe Shqipja: "i v e ç a n t ë", "v e ç a n"... mund të interpretohet në dritën e shpjegimeve të mësipërme si:

$$v e \quad \zeta \quad a \quad n \quad \rightarrow \quad shq. \quad b \quad \ddot{e} \quad \zeta \quad \bar{a} \quad n = \zeta \quad a \quad j = \textcircled{1}$$

Dhe së fundi ne dimë se:

$$\textcircled{1} = -1$$

dhe:

$$|-1| = 1 = \text{një, i vetëm (ingl. only)}$$

Kështu pra ne arritëm, nëpërmjet Algoritmit Simbolik dhe Shqipes, të motivojmë të gjitha kuptimet e ndryshme të fjalës Kineze "d a i", çfarë dhe duhej bërë...

827) Kinez. d ā (答) = ingl. echo; respond (jehonë; gjegjem, reagoj)

Edhe këtu kemi Shqipen:

d a (folja DAJ)

Pasi arritëm në këtë pikë, dikush mund të pyesë: Përse vallë "afërsia" me Qëndrën paraqet një rrezik? Përgjigja është se: Qendra është ndër të tjera edhe "The Land of the Dead" (d.m.th. "vendi i të vdekurit") e pra Mbretëria Qiellore, Bota tjetër...

Edhe më në fund: Motivimi me Shqipen "a f ë r" (dhe jo me Ingl. "afar") është ay që motivon më saktësisht dhe krejt saktësisht Gjerm. "g e f a h r".

që na jep simb. " ① " dhe për ekuivalencë simbolike " 2 ".

Lidhur me simbolizmën e numurit 2, tek Cirlot ne lexuam ndër të tjera:

"Two... stands for echo... contraposition..."*

Por "*Contraposition*" do të thotë *kundërvendosje*, e pra atëhere dhe *korrispondencë*, edhe *reagim*, etj. etj.

Mund të arsyetonim edhe kështu:

$$d a j = \textcircled{1} = \begin{pmatrix} +1 & \\ & -1 \end{pmatrix}$$

dhe atëhere do të kemi:

$$\begin{array}{cc} +1 & -1 \\ \rightarrow & \leftarrow \end{array}$$

Shohim qartë këtu kuptimet "korrispondencë", "reagim", "përgjigje"...

828) Indon. **k e l u k** = ingl. *curve* (vijë e lakuar)

Do zbërthyer si:

k e l u k

dhe me Shqipen:

k e l a k

Vëmë re se kuptimin e "vijës së lakuar" e kemi gjetur në Indonezishte edhe në fjalën "b e l o k" që e zbërthyem dhe e reduktuam tek Shqipja "b ë l a k". Ndodh shpesh që ta gjejmë të njejtën rrënjë në Indonezishte edhe në fjalë të përbëra me parashtesa (ose edhe prapashtesa) të ndryshme, e pra në një farë kuptimi "të ndryshme"...

* Shih edhe fq.11-12, 164, 312, 475 dhe 675.

829) Indon. **m e m b e d a h** = ingl. *dissect* (disektoj, copëtoj për qëllime studimi)

Do zbërthyer si:

m e m b e d a h

dhe është Shqipja:

m e b ë d à

e pra simbolikisht:

⊕

830) Indon. **p a n d a k** (p e n d a k) = ingl. *short* (i shkurtër)

Do zbërthyer si:

p a n d a k

dhe është Shqipja:

b ë n : d à k a

e pra:

"k a b â n d à"

Edhe Inglishtja: "**s h o r t**" = *i shkurtër*, lidhet brenda Inglishtes me "**s h a r e**" = *ndaj* (që është Shqipja "**s h a r r o j**"), e pra simb. ⊕.

831) Indon. **b i s u** = ingl. *mute* (i heshtur)

Është Shqipja:

b â s h ù

e pra folja "s h u e j" që ka në Shqip edhe kuptimin "h e s h t".*

* Shih edhe fq.690.

832) Indon. **p u n c a k** = ingl. *summit* (majë)

Zbërthehet në:

p u n c a k

dhe është Shqipja:

b ë n ç u k ë

ku "ç u k ë" në Shqip: majë e lartë e një kodre, e një mali.

833) Indon. **b e r a t** = ingl. *occidental* (perëndimor)

Zbërthehet në:

b a r a t

dhe është Shqipja:

b a r ā t (folja me RA) = e pra simb. ↓

simbol ky që jep fare mirë *perëndimin* e diellit...

Një shpjegim këtu është i nevojshëm. Fjala "o c c i d e n t" vjen nga Latinishtja "o c c i d e n s" nga folja "o c c i d e r e" = me rà (ingl. *to fall*)*. Dhe është fjala këtu për ramjen e Diellit. Në Shqip kemi: "perëndim i diellit" (ingl. *sunset*) dhe "Perëndim" (ingl. *Occident*).

834) Indon. **k e r a s** = ingl. *stiff* (i ngurtë)

Lidhet me Shqipen:

g u r

("i n g u r t ë") **

* Shih edhe fq.292.

** Shih edhe fq.122, 477, 531 dhe 570.

Dhe dihet mirë spektri shumë i pasur semantik i kësaj fjale të Shqipësisë për të cilën është folur bollshëm edhe gjetiu, gjë që, ndër të tjera, e bën këtë operator të lirë dhe të përbotshëm.

835) Indon. p i n c u n g = ingl. *cripple* (sakat, gjymtyran, i cunguar, i cungët)

Zbërthehet në:

p i n c u n g

dhe me Shqipen:

b ë n c u n g

Rrënja "c u n g" në Shqip është mjaft e përhapur duke dhënë fjalë me kuptime deri diku të ndryshme, si p.sh. "cungu i pemës", "cungu i trupit"..., "u bë cung nga të ftohtit", "dal pas cungut" (mohoj diçka të pohuar më parë...), "i ka duart cung" (është dorështrënguar)... Pra është një rrënjë e ngulur thellë në Shqip dhe si e tillë autoktone dhe e lashtë në të.

836) Indon. m e n c i p t a k a n = ingl. *to create* (krijoj)

Zbërthehet në:

m e n c i p t a k a n

Theksi semantik bie mbi:

"c i p t a"

që është Shqipja:

c o p t o j, e pra simb. ⊕

Algoritmi Simbolik jep:

⊕ = F = ● ... (F)

ndarja
coptimi

materia,
Bota materiale

Ndonjë shpjegim këtu është i nevojshëm.

Në dimë se sipas Mendimit Mistik (themeli fillosofik i të gjitha gjuhërave), Bota është krijuar me një sakrificë, e quajtur "*Cosmogonic Sacrifice*" në Inglisht.

Shohim pra se sipas një mithi kozmogonik themelor, Bota u krijua me sakrifikimin (vrasjen) e një Hyjniqe dhe në ndarjen e saj në c o p a (c o p t i m, indon. c i p t a) që shërbyen për të ndërtuar pjesët e ndryshme të Kozmosit. Kështu pra fjala Indoneziste që po shqyrtojmë përmban një mith kozmogonik të njohur. Ky mith edhe motivon në kuptimin e "krijimit" fjalën Indoneziste "m e m c i p t a k a n" sikundër që Shqipja na e nxjerr fare mirë në pah.

Është e tepërt të përsërisim këtu se *krijimi, bërja e Botës* (paradigmatikisht) lidhet kurdoherë me një *ndarje*, siç paraqitet bollshëm në mënyra të ndryshme në gjuhë të ndryshme. Kështu për shembull në Shqip: NDReq, NDËRtoj... dhe NDARË...; në Rusisht: "d e l a t s" (делать) = *bëj* dhe "d e l i t s" (делить) = *ndaj*; në Shqip: "b d a j" = *bëj*, dhe "d a j" = *ndaj, copëtoj...*, e kështu me radhë. Është gjithmonë ajo që thotë Paracelsus: "Die *Separatio* is taller Geburt Anfang."

Fjala "c o p ë" është tepër produktive në Shqip: "copa–copa", "coptoj", "i përciptë", "cep"... etj. etj.

Jo vetëm, por kjo fjalë jep edhe një ekuacion simbolik të rëndësishëm:

$$\textcircled{1} = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) \quad \dots(F)$$

COPa-copa i përCIPTë
i COPëtuar
(fragmentar)

Kështu "c o p ë" e "c i p ë" përbëjnë në Shqip një çift homonimik kuptimplotë, d.m.th. të tillë që mund të japë një ekuacion simbolik. Mesazhi

"informues" që na jep Shqipja me këtë rast është se: Një "sistem" (i Botës, i Dijes) i ndërtuar me *c o p a* (*fragmentar*) do të jetë patjetër i p ë r c i p t ë (jo i thellë). I tillë është pra dhe Realiteti ynë material, fenomenal që, siç na mëson mithi, është ndërtuar me *c o p a* (pas copëtimit të Hyjnisë). E pra atëhere ajo është kështu vetëm një *m a s k ë*, vetëm një *v e l l o* që mbulon fytyrën e vërtetë të Hyjnisë që mund të shihet, qoftë edhe për një çast, vetëm nëpërmjet një *r e v e l a t ë* (zbulimi..., heqje, largimi të vellos).*

Shqipja e shtron gjithpò këtë ekuacion simbolik edhe me *c a k* dhe *i c e k ë t*. Dhe *mesazhi* është ky:

"Gjithshka ka një *c a k* është *e c e k ë t*."

E pra simbolikisht, siç pamë edhe më sipër"

$$\textcircled{1} = (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) \quad \dots(F)$$

cak **e cekët**

Dhe e tillë është Bota jonë materiale, pra *e cekët* dhe *e fundme*, edhe sipas Kozmologjisë Moderne.

Ky është një nga rastet e shumta të përputhjes së "gjetjeve" të Etimologjisë sonë të Re dhe zbulimeve më të fundit të Shkencës.

837) Indon. **p e c a h a n** = ingl. *fraction* (thyesë)

Zbërthehet në:

p e c a h a n

* Mund të referojmë këtu edhe tek librat themelorë të Helena Blavatsky-t (1831-1891): "*Isis Unveiled*" (Isis pa Vello), "*The Secret Doctrine*" (Doktrina Sekrete) dhe "*The key to Theosophy*" (Çelësi i Theozofisë).

ku theksi semantik bie mbi "c a" që është Shqipja:

ç a

(folja "çaj" = ingl. *break, split*)

e pra simbolikisht \oplus , ose $1/2$, ose $-/-$.

838) Indon. p a t a h = ingl. *fracture* (frakturë, thyerje, çarje)

Zbërthehet në:

p a t a h

dhe është Shqipja:

b a d à ("b a t h y") = simb. \oplus ose $-/-$

839) Kinez. z h ŭ (煮) = ingl. *to boil, to cook* (ziej, pjek)

Është Shqipja:

z i, z i e j

840) Kinez. z h ū = ingl. *famous* (i famshëm)

Lidhet me Shqipen:

"m e z ë"

ku "z ë" = ingl. *voice*. Rrënja "z ë", "z ë r i" nuk është e pastër në gjuhën Kineze.

841) Kinez. z ŭ (阻) = ingl. *hinder, obstruct, stop* (zë, pengoj, bllokoj)

Është Shqipja:

z ë, z u r i, z u

842) Kinez. k o ũ s h ì = ingl. *oral examination* (ekzaminim gojor)

Këtu "k o u" është Shqipja "g o j ë", ndërsa "s h i" është Shqipja "s h i h", "s h i k o" etj. E pra atëhere, motivimi me Shqipen jep:

g o j ë s h o h

843) Kinez. k o ũ z h à o (口 罩) = ingl. *mouthmask* (maskë goje)

Me Shqipen:

g o j ë z ë n j e

844) Kinez. z h í (執) = ingl. *to hold; to grasp* (mbaj, zë; kap)

Është Shqipja:

z ë

845) Kinez. z h ǐ (止) = ingl. *to stop; to cease* (zë, ndaloj)

Lidhet me Shqipen:

z ë

846) Kinez. z ũ (阻) = ingl. *blocked; choked; suffocated* (i bllokuar; i mbytur)

Është Shqipja:

z ë, z u, zuri, zënë,...

847) Kinez. z h ì (制) = ingl. *to make, to create, to build* (bëj, krijoj, ndërtoj)

Është Shqipja:

z ë

(në kuptimin "krijoj")

848) Kinez. z à o (皂) = ingl. *black; dark* (i zi; i errët)

Është Shqipja:

i zi, e zezë

849) Kinez. z ā (紮) = ingl. *to tie, to bind; to fasten* (lidh; shtrëngoj)

Është Shqipja:

z ë, me z â n ë... = simb. 8

Në Shqip: "zâ për dore...", "të zanë për dore..." = të lidhur, të shtrënguar për dore...

850) Kinez. z á = ingl. *one* (një)

Lidhet me Shqipen:

z â, z ë (filloj)

e pra simb. " - 1 ", me qenë se, siç dimë e kemi parë edhe gjetkë, *fillimi*, krijimi i Botës vështrohej nga Mendimi Mistik* (mbi të cilin të gjitha gjuhët ngrihen) si një "involucion"**, si një e keqe.***

851) Kinez. z ā i (災) = ingl. *disaster, calamity* (fatkeqësi, e Zezë)

Është Shqipja:

zi = simb. ●

* Mendim Mistik që cilin ne e kemi artikulluar e strukturizuar në një Algoritëm Simbolik.

** Shih Cirlot, fq.382.

*** Shih edhe fq.70, 95, 601, 671 dhe 742.

Vëmë ré tani edhe sa vijon:

Kinezja shtron me gllosat e mësipërme këtë varg ekuivalencash simbolike:

$$\begin{array}{ccccccc} -1 & = & \infty & = & \bullet & & \dots(F) \\ z \acute{a} & & z \acute{a} & & z \bar{a} i & & \end{array}$$

Kurse Shqipja, për ato sa pamë këtu e ato sa kemi parë gjetiu, shtron një varg edhe më të gjatë ekuivalencash simbolike, një pjesë e të cilit përbëhet nga:

$$\begin{array}{ccccccccccc} -1 & = & \bullet & = & \infty & = & - \bigcirc & = & (\rightarrow \neq \leftarrow) & = & \boxed{\bigcirc} & = & \dots (F) \\ z \grave{e} & & z i & & z \grave{e} & & z \grave{e} n \grave{e} & & m e u z i & & z \grave{e} & & \\ (filloj) & & (err\grave{e}t) & & (b\grave{e}j, ngjiz) & & (jo bosh) & & & & (mbuq\grave{e}j) & & \\ & & e z e z a & & p \grave{e} r z i & & & & & & z \grave{e} & & \\ & & (fatkeq\grave{e}si) & & & & & & & & (kap) & & \end{array}$$

Operatori i lirë mbi të cilin "ngrihen" të gjitha këto fjalë është g è r m a (një e vetme):

Z

e cila modifikohet për të diferencuar kuptimet të ndryshme brenda të njejtit simbol (këtu *gërmë*), me prapashtesa, parashtesa, zgjerime të themes (fr. *élargissement du thème*), etj. etj., tërë një proces që del në pah, më mirë se në çdo gjuhë tjetër, me Shqipen.

Pra dhe të gjitha këto fjalë që renditëm më sipër, të një gjuhe kaq shumë mijëvjeçare të lashtë siç është Kinezçja, mund të vështrohen pa frikë si të prejardhura nga një gjuhë që rezulton kështu (për shkak të fuqisë motivuese gjer edhe të spektrave semantikë të gjuhës Kineze) akoma edhe më e stërlashtë: nga Gjuha Shqipen.

Në një zgjerim të mëtejshëm të Bisedës, duhet të themi se përbashkësia (qoftë edhe pjesore) e gllosarit të gjuhës Kineze me Shqipen, shpjegohet

me faktin se Shqipja, duke qenë trunq nga i cili degëzohen gjithë gjuhët e tjera (duke përfshirë këtu edhe gjuhë të stërlashta si Kinezçja, Sanskritishtja, Hebraishtja...) është Nëna, "die Muttersprache", që aq shumë është kërkuar dhe vazhdon të kërkohet nga shkencëtarë të mëdhenj, por mjerisht disi miopë...

Duke vënë gishtin mbi Shqipen si "Gjuhë Mëmë" zgjidhet, një me të, edhe problemi i *M o n o g j e n e z ë s*.

Jemi në gjendje, nga ana tjetër, të zbulojmë edhe kuptimin e thellë të mitit të Kullës së Babelit.

Dhe ja se si:

Gjuhët diferencohen nga njëra-tjetra vetëm në nivelin e përciptit *konceptual*, kurse e kundërta ndodh me to në nivelin e thellë *simbolik* në të cilin që të gjitha janë *strukturalisht* (simbolikisht) e njejtë Gjuhë, sikundër janë një në këtë nivel edhe të gjitha fillosofitë e të gjitha fetë. Kjo ndodh për arsye se në këtë nivel "funksionon" lirshëm dhe pa pengesa vizioni arkeotipal mbi Botën i "*Philosophia Perennis*", që është vështruar në fillim të kohërave si një *revelatë hyjnore*, si një "*Philosophy of Philosophies*", si një Super-Fillosofi.*

Këtë e dëshmon më së miri edhe fakti që të gjitha gjuhët që kanë qenë, janë e do të jenë... nuk bëjnë dot pa Algoritmin Simbolik, i cili përfshin tërësinë e ekuacioneve simbolike që çdo gjuhë, duke nënkuptuar këtu me fjalën "Gjuhë" edhe çdo aktivitet tjetër mendor (Shkencë, Fillosofi, Theollogji etj. etj.), duhet patjetër të pozojë.**

* Që nxirret më lehtë e më pastër, se nga çdo gjuhë tjetër, nga Shqipja...

** Shih ndër të tjera e dhe fq.3, 255, 263, 336, 595 dhe 690.

Jemi që jemi, le të bëjmë dhe një motivim (me që na doli në shteg...), me anë të Shqipës, të fjalës Inglisht (dhe jo vetëm...) "**d i s a s t e r**".

Motivimi bëhet kështu:

$$\text{d i s a s t e r} \rightarrow \text{shq. dysh âsht Ar} = 2 \cdot \bigcirc = - \bigcirc =$$

$$\bigcirc \downarrow = \bullet = \text{e Zeza} \quad \dots(\text{F})$$

Siç lexojmë tek Cirlot, "Ylli" (ingl. *star*) është ndër të tjera dhe simbol i Qëndrës Mistike (\bigcirc).

Nga ana tjetër, fjala "**a s t e r**" e Latinishtes është e zbrërthyeshme me Shqipën "**â s h t A r**", ku "**A r**" (ingl. *gold*) tregon *diellin, dritën*.

Edhe fjala e Italishtes "**s t e l l a**", zbrërthehet edhe *ajo me* anë të Shqipës "**â s h t Y l l**".

Dhe më në fund, ekziston ekuivalenca:

$$\text{A r} = \text{A l}$$

ku që të dyja këto rrënjë të pastra lidhen me kuptimin e *Dritës, Diellit* etj. Kështu p.sh. thuhet "Arbënia" dhe "Albania" (që të dyja këto fjalë do të thonë "Bana e Arit", "Banesa e Diellit", "Banesa e Dritës": të tillë e kanë parë të Parët vendin tonë).

Dimë se simboli i popullit tonë është Shqiponja, d.m.th. zogu i Zeusit, më i pari nga të gjithë shpendët.

Kemi pra ekuivalencën:

$$\text{A r} = \text{Shqiponjë}^*$$

* Si një rikonfermë të kësaj ekuivalence mund të vështrohet edhe Rusishtja: "**a r i o l**" (орёл) = shqiponjë (ingl. *eagle*), që reduktohet, si tek prejardhja e saj, tek Shqipja "**A r**" (ingl. *gold*).

Lexojmë tek Cirlot:^{*}

"Eagle... A symbol of height, of the *spirit* as the *sun*, and of the *spiritual principle* in general. In the Egyptian hieroglyphic system, the letter A is represented by the figure of an eagle, standing for the warmth of life, the *Origin*, the *day*... The eagle is a bird living in the full *light* of the sun and it is therefore considered to be *luminous* in its essence, and to share in Elements of air and fire... It also *conducted souls to immortality*... Dante even calls the eagle the bird of God..."

(*Shqiponja*... Një simbol i lartësisë, i Frymës si diell, si edhe i Parimit Spiritual në përgjithësi... Në sistemin hieroglifik egjiptian, gërma "A" paraqitet nga figura e një Shqiponje, e cila tregon afshin e ngrohtë të jetës, Zanafillën, Ditën... Shqiponja është një shpend që rron në dritën e plotë të diellit, duke u vështruar si e tillë si dritëplote në esencën e saj, dhe në lidhje të ngushtë me ajrin dhe zjarrin si elementë përbërës... Mendohej gjithashtu se shqiponja ishte edhe "Psikopomp", d.m.th. ajo që i përcillte pra shpirtrat në jetën e pavdekshme... Dante Aligheri arriti madje gjer atje sa ta quante shqiponjën "Shpend i Perëndisë"...)

Dhe më në fund si një "kuriozitet" dhe disi jashtë theme, shtojmë edhe se nga kjo rrënjë e Shqipes rrjedh edhe fjala tjetër e Rusishtes "a r i e h" (opex) që do të thotë "a r r ë" (ingl. *walnut*). Arsyeya është se, sipas mendimit tonë (që mbështetet në Teorinë e Korespondencave, që përbën thelbin e thelbit (në trajtën e Analogjisë) të Mendimit Simbolik), duke hapur (thyer) *arrën*, ne shohim brenda saj diçka si një *shqiponjë*. (shih lidhur me këtë çështje edhe ato sa parashtrohet Cirlot ndën titullin "*Symbolic Analogy*" tek hyrja e "Fjalorit të Simboleve")

Nga kjo nxjerrim gjithashtu përfundimin se edhe fjala "a r r ë" në Shqip mund të rrjedhë, brenda Shqipes, nga fjala "A r" (ingl. *gold*).

* Cirlot, fq.91.

852) Kinez. *shì* (視) = ingl. *regard, consider; see; look; inspect; examine* (shoh; shqyrtoj; inspektoj; shi-koj; marr parasysh)

Është Shqipja:

sh-i-koj, shoh, shih...

folje që lidhet mbrenda Shqipes me fjalën "s y", "sy-ni", "sy-ri" = ingl. *eye*.

Duke e zgjeruar Bisedën, le të vërejmë tani edhe sa vijon:

a) Tek fjala "s h i k o j", rrënja (a operatori i lirë siç e kemi quajtur) është "shi", ndërsa "-koj" ("-goj") është një prapashtesë verbalizo-njëse (foljore). Si të tillë ne e gjejmë atë edhe në një sërë fjalësh në Shqip, si p.sh.: *an-koj, rrën-koj, mun-goj, shtrën-goj, lën-goj, më-koj, be-koj...*

Duke qenë kështu, përputhja e Kinezes "shì" me Shqipen "shi(h)" është e plotë. Pra nuk mund të ketë asnjë dyshim se keni të bëjmë në të dyja rastet me të njejtën rrënjë e madje me të njejtën fjalë.

b) Edhe Inglishtja "t o s e e" nuk është tjetër veçse Shqipja "s h i h", "s h i -k o j"... , dhe më thellë akoma Shqipja "s y".

c) Mistikisht "Syri" (ingl. *eye*) dhe "Dielli" identifikohen. Lexojmë për këtë tek "*Fjalori i Simboleve*" nga Cirlot, që në këtë Studim e në të tjerë të një natyre të përafërt ne konsultojmë vazhdimisht:

"E y e : The essence of the question involved here is contained in the saying of Plotinus that the eye would not be able to see the sun if, in a manner, it were not a sun."^{*}

(S y r i : Thelbi i çështjes për të cilën flitet tërthorazi këtu lidhet me ato sa ka thënë Plotini, sipas të cilit *syri* nuk do të ishte i aftë ta shihte *diellin* sikur të mos ishte edhe ay vetë, në një mënyrë a në një tjetër, një diell.)

* Cirlot, fq.99.

Dhe po më tej, po tek Cirlot lexojmë:

"S u n : ...In India, as S u r y a, it (the sun) is the e y e of Varuna; in Persia, it is the eye of Ahura-Mazda; in Greece, as Helios, the eye of Zeus (or of Uranus); in Egypt it is the eye of R a, and in Islam is the eye of Allah."

(D i e l l i : ...Në Indi, si S u r y a, ay (dielli) është s y r i i Varunës; në Persi ai është s y r i i Ahura-Mazda; në Greqi, si Helios, është s y r i i Zeusit (ose i Uraniusit); në Egjipt është s y r i i Ra, dhe në Islam është s y r i i Allahut.) *

Pra siç shohim, ekuacioni: D i e l l (ingl. *sun*) = s y n i (ingl. *eye*) është, në rrafshin mitik, ezoterik, plotësisht i justifikuar. Por kjo sjell me vete, në rrafshin gjuhësor, një sërë rrjedhimesh të rëndësishme.

Le të shohim këtu disa prej tyre:

ingl. **s u n** (diell) = Shq. **s y n**-i

Hind. **S u r y a** (सूर्य) (dielli) = Shq. **s y r i**

Frengj. **o e i l** (syri) = Shq. **y l l i**

Një tjetër veçori e d i e l l i t është se ai është vështruar si d j a l i i Qiellit. Lexojmë lidhur me këtë, gjithnjë tek Cirlot:

"...the S u n appears as the direct s o n of the god of heaven, and Krappe notes that he inherits one of the most notable and moral attributes of this deity: he s e e s all, and in consequence, k n o w s all..."

(...D i e l l i vështrohet si b i r i i drejtpërdrejtë i Perëndisë së Qiellit, dhe Krappe na vë në dukje se ai trashëgon një nga vetirat më të shquara dhe më lavdiplote të kësaj Hyjnie: ai i sheh të gjitha, dhe për pasojë, ai i njeh të gjitha...)

* Shih Cirlot, fq.317.

Në Gjuhë, e cila (nuk është e tepërt të përsëritet prap e prap) ngrihet e gjitha mbi vizionin mistik, mitik, ezoterik të stërllashtë të Botës, kjo pasqyrohet në këtë mënyrë:

Ingl. **sun** (dielli) **son** (djali, biri)

Rus. **sonce** (солнце) **sin** (сын)

Gjerm. **Sonne** **Sohn**

Shq. **djell** **djal**

...

...

Pamë se Dielli (e pra *syri* dhe *të parit*) simbolizon ndër të tjera Diturinë e plotë.

Duke qenë kështu, ne mund të mendojmë se Latinishtja "**scio**" = di (ingl. *know*) nuk është tjetër veçse Shqipja "**shoh**"... E pra, dhe fjala "**Scientia**" lidhet edhe kjo, si me motivuesen e vet, me Shqipen "**shoh**".

Po ashtu edhe Greqishtja "**sophia**" (σοφία) = dituria, motivohet fare mirë, sipas sa më sipër, me Shqipen "**shof**".

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, shtojmë edhe sa më poshtë:

Vëmë re se në Greqisht kemi:

"**lios**" (ἥλιος) = diell (ingl. *sun*)

"**lika**" (ἡλικία) = moshë (ingl. *age*)

Me fjalë të tjera, **mosha**, duke u lidhur me **vitet**, lidhet llogjikisht edhe me **dillin**, me qenë se një **vjet** nuk është tjetër veçse një rrotullim i plotë rreth diellit.

Duke qenë kështu, dhe me qenë se Inglishtja "**sun**" (dielli) është, siç pamë, Shqipja "**syni**", ne vihemi në gjendje të motivojmë me Shqipen (a me Inglishten) një sërë fjalësh: Turq. "**senen**" = vjet; Lat. "**senex**" =

i vjetër, "s e n e c t u s" = pleqëri, "s e n a t u s", "s e n i o r",... lidhen të gjitha si me motivuesen e tyre me Shqipen "s y n i" (ing. eye).

Duke e zgjeruar edhe më tej Bisedën, shtojmë edhe sa vijon:

Në Sanskritisht "v a t s a" (वत्स) do të thotë:

"viç" (ingl. calf)

dhe në të njejtën kohë:

"vit" (ingl. year)

Por po ashtu në Shqip:

"v j e t a"* = viç (ingl. calf)

dhe:

"v j e t" (ingl. year)

Pra kemi lidhjen mitike të v i t i t (vjeta) me v i ç i n (vjeta).

Duke qenë kështu, Latinishtja "v e t u s" = i vjetër (ingl. old) motivohet me Shqipen "v j e t" dhe në instancë të fundit me "v j e t a" (viçi), si edhe sigurisht me Sanskritishten "v a t s a" (वत्स), siç pamë më sipër.

Po ashtu sigurisht edhe fjalët "v e t u s t u s" = i vjetër, i lashtë..., "v e t e r a n u s" etj. etj., nuk janë veçse Shqipja "i v j e t ë r".**

* Në të folmen e Veriut.

** Shtojmë në këtë listë huazimesh nga Shqipja edhe Rusishten "v j e t h i j" = i vjetër, që vjen, sic shihet qartë nga Shqipja "v j e t" (ingl. year).

Ndoshta edhe Inglishtja "weather" dhe Gjermanishtja "Wetter" (= mot), mund të shpjegohen me Shqipen "vjet", "vjet a"... dhe kjo me qenë se në një sërë gjuhësh *koha* dhe *moti* tregohen me të njejtën fjalë.*

Në Hebraisht:

"shemesh" (שֶׁמֶשׁ) = dielli

dhe është e qartë, për arsyet që parashtruam më lartë, lidhja me Shqipen "shesh", "sy"...

Dhe po në Hebraisht:

"shannah" (שָׁנָה) = vit

Pra edhe këtu shihet lidhja mes *diellit* (SHE-mesh) dhe *vitit* (SHA-nah).

Pra edhe këtu Shqipja motivon me "syni".

* Si p.sh. në Frengjisht: "temps" që do të thotë edhe "kohë" (në kuptimin e rrjedhjes së viteve...) edhe "mot" (në kuptimin e temperaturës, e stinës etj.); edhe në Shqip "mot" dhe "kohë" kanë të dyja kuptimet, etj.

Jemi që jemi këtu, le të vëmë re se dhe shprehja Ital. "remoto" = *ilashtë*, mund motivohet me Shqipen: " - 1 . mot " = "mot i kaluar", e *shkumja*... Operatori "mot" nuk është i lirë në Italisht, ndaj pra dhe ajo nuk është në gjendje ta motivojë këtë gllisë të saj, siç ndodh rëndom me të gjitha gjuhët dhe me të gjitha gllisat e tyre, siç kemi parë gjatë këtij Studimi dhe atyre pararendëse mbi lashtësinë e Shqipes. Shih "*Shqipja dhe Sanskritishja*" (Vëllimi I dhe II) dhe "*Libri i Aforizmave*".

Prefiksi "re-" në Italisht (e në përgjithësi në gjuhët me origjinë nga Latinishtja, ndonëse jo vetëm syresh) ka dy kuptime: 1) atë të *përsëritjes*, dhe 2) atë të *zbrapsjes*, të *kthimit mbrapa në kohë*..., etj. Kemi folur për këtë edhe gjetkë, pra referojmë atje. Shih ndër të tjera, fq.38-39.

Pamë se Shqipja me "d j e l l" / "d j a l" vendoste një lidhje mitike të rëndëishme. Por Shqipja bën të njejtën gjë edhe me: "s y n i" dhe "ç u n i" (djali, biri). Dhe kjo për arsye se, siç pamë: Shq. "s y n i" = Ingl. "s u n". Nga kjo del edhe se: Ingl. "s o n" = Shq. "ç u n"... janë e njejta fjalë.

Është rasti këtu të vëmë në dukje edhe sa vijon:

Fjala Ingjishte "c h i l d" lidhet me Shqipen "c u l l ë" = *djal i vogël, fëmijë*

Për t'u bindur edhe më mirë për këtë, le të shohim diçka për etimologjinë e fjalësh "c h i l d" në Ingjisht.

Në fjalorin "Webster" lexojmë ndër të tjera lidhur me këtë çështje:

Child = *an infant, baby...* akin to the Goth. "kil thei", *womb*:
Indo-Europ. "q e l -t", *a swelling up* < base "q e l-", *rounded*

Vëmë ré se trajta "c u l l ë" e Shqipes është edhe më afër rrënjës së lashtë "q e l-" nga e cila mendohet se fjala Ingl. "c h i l d" ka ardhur.

Fjala "c u l l ë" është sot krahinore, gjë që flet për një origjinë të saj të lashtë. Ajo është mjaft produktive dhe e përdorur në idioma, si: "Cull e mull" ("me cullë e mullë") = i madh dhe i vogël, të gjithë...

Le të tregojmë tani se si fjala "c u l l ë" (e djali i vogël) lidhet mbrenda Shqipes me "s h u l l ë" = vend që e zë Di e l l i mirë dhe nuk e rreh era. Në shprehjen: "ngrohej në *shullë*" = "ngrohej në *diell*", është krejt e qartë se: *shullë* = *diell*. Po, në qoftë kështu, ekuacioni themelor mitik i mësipërm shtrohet nga Shqipja si:

djelli djali

por edhe nga:

shullë cullë

Në Inglisht "c h i l d" nuk lidhet me një ekuacion mitik të tillë. Kjo është një dëshmi më tepër për:

ingl. "c h i l d" < shq. "c u l l ë"

Le të vëmë re së fundi se fjala "s h u l l ë" e Shqipes nuk është tjetër veçse Latinishtja "s o l" ("solis") = dielli. Për të gjykuar mbi prioritetin lashtësor të njërës glosë ndaj tjetrës, le të kemi parasysh se në Latinisht nuk ekziston, si në Shqip, një lidhje mitike mes diellit (shq. shullë) dhe djalit (shq. cullë), lidhje kjo që si çdo lidhje mitike flet gjithmonë për një lashtësi primordiale, protohistorike dhe madje prehistorike të fjalëve që lidhen në një ekuacion të tillë. Por nga ana tjetër, shihet se fjala "s o l" është mjaft produktive në Latinisht dhe se kjo fjalë (me atë kuptim që ka dhe me kuptime të tjera të përafërta) është trashëguar nga të gjitha gjuhët që erdhën dhe u lindën në një farë mënyre prej Latinishtes. Pra është vështirë të gjykohet për këtë, d.m.th. të vendoset në se duhet marrë:

lat. "s o l" < shq. "s h u l l"

apo:

shq. "s h u l l" < lat. "s o l"

Vëmë ré gjithashtu se edhe në Latinisht, ashtu si në Greqisht e në një sërë gjuhësh të tjera, koncepti i *diellit* lidhet me atë të *vitit*.

Kemi:

"s o l" = diell (ingl. *sun*)


"s o l l e m n i s" ("sollus" = totus/anus) = vjetor, i përvjetshëm
(ingl. *yearly, annual, recurring*)

...lexuam tek Cirlot se në Hindí *dielli* ishte *syri* i Varunas. Pra "V a r u n a" është "Ai që V ë r e n", që nga dhe mund të nxirret, qoftë edhe hipotetikusht, ekuacioni:

sanskr. "V a r u ṇ a" (वरुण) = shq. "v ë r e n"

Gjithpo tek Cirlot lexuam se në Egjypt, *dielli* ishte syri Ra-së. Pra "R A" është "Ai që vë R E", "Ai që R U a n".

Që këndej mund të nxjerrim ekuacionin:

egjyp. "R a" () = shq. "R é" (vë ré), "R u" (ruaj)

Në Inglisht: "a w a r e" = i vetëdijshëm, që vë ré... (ital. *consapevole*), mund të zberthet në "a w a r e" dhe me Shqipen "a v u r é".

Në Inglisht: "b e w a r e" = ru-hem, kam kujdes (ital. *guardarsi*, fare attenzione), zberthehet në "b e w a r e" dhe me Shqipen "b ë v ë r é".

Gjithpo ashtu, në Inglisht: "w a r n - i n g" = vërejtje, paralajmërim...

E dhe këtu mund të veçojmë Shqipen: "v ë r é".

Në të gjitha këto raste referenca etimologjike e mbrame është Egjyptiançja "R a" dhe Shqipja "R é".

U larguam ca si tepër nga tema e ngushtë e Bisedës mbi konkordancat semantike mes Kinezçes dhe Shqipes, por kjo u bë për të thelluar njoh-jen e tabanit mitik ku fjalët e kuptimet e tyre zhyten e unifikohen dhe për të treguar në të njejtën kohë përhapjen universale të operatorëve të lirë të Shqipes.

853) Kinez. t i á n (填) = fr. *remplir; completer* (plotësoj; kompletoj)

Lidhet me Shqipen:

i, e t a n ë*

* Lidhur me operatorin "T A N" të Shqipes (në kuptimin e "tërësisë"), shënojmë këtu se atë e gjejmë në një varg fjalësh të huaja me përmbajtje fillosofike e më tej. Rikujtojmë pra se ky operator i lirë i Shqipes, i

Në Shqip do të ishte "t a n ë s o j".

854) Kinez. t i á n = frengj. *tranquille, calme, paisible* (i qetë, paqësor)

Megjithëse konkordanca këtu me Shqipen mungon, prap mund të themi se ("në favor" të Shqipes), operatori i lirë "T a n" i Shqipes, i pasur me kuptime të shumëfishta, është ay vetë motivuesi themelor i Kinezçes "t i a n" në kuptimin "*tranquille*", "*calme*"...

Dhe vërtetë:

$$\begin{aligned} \text{shq. TAN} &= \bigcirc^* = (x = -x) = E = - \sim = \text{i qetë...} \\ &= -(\rightarrow \nleftrightarrow) = \text{paqësor} \end{aligned}$$

Vëmë ré me këtë rast se Kinezja, me biseminë e fjalës "t i a n", shtron një ekuacion të rëndësishëm siç bën edhe nga një sërë gjuhësh të tjera:

\bigcirc	=	- \sim	...(E)
kinez. t i a n		t i a n	
ingl. q u i t e		q u i e t	
ital. c o l m o		c a l m o	
...		...	

Këtu simboli, siç pamë, " \bigcirc " tregon arkeotipisht të *plotën*, të *përsosurën*, të *tërën*. Simboli " \sim " është ndër të tjera, siç dimë, ai i *lëvizjes*, *indryshimit*.

Edhe Shqipja e shtron këtë ekuacion, por në një mënyrë tjetër.

"inkapsulluar" (ndërkallur) në glosa të huaja, jep kuptime të rëndësishme e të thella.

* Cirlot (fq.123): \bigcirc = *the Universe, the Infinite, the All...*

Në Shqip:

"Qëndra" dhe "qëndron"

lidhen me të njejtën rrënjë.

Por dimë se "Qëndra" jepet nga $(x = -x)$ e pra edhe nga \bigcirc . Nga ana tjetër, "qëndron" do të thotë *nuk lëviz, nuk ndryshon*, e pra simb. $- \sim$.

Në zgjerim të Bisedës, vëmë re gjithashtu se, gjithpo në gjuhën kineze, kemi:

"t i ā n" = qiell (ingl. sky)

E pra, duke vënë bashkë fjalët "t i a n" (i plotë, i tërë, i përsosur), "t i a n" (i qetë, i palëvizshëm, i pandryshueshëm) dhe "t i a n" (qiell, parajsë,...), në **simi që** nxirret nga gjuha e lashtë kineze është ky:

"**Vetëm Q i e l l i (Zoti) është i përsosur dhe i pandryshuarshëm.**"

Qielli, Zoti, Parajsa... lidhen me Qëndrën dhe të gjitha fillosofitë e theollogjitë në mbarë botën i japin Qëndrës (Zotit) pikërisht (ndër të tjera) këto attribute: atë të qëndrueshmërisë ($- \sim$), të përsosjes, të tërësisë (\bigcirc), të amshimit ($t = 0$) dhe të gjithëpranishmërisë ($s = 0$) ...*

855) Kinez. s u ī (綏) = fr. calmer; apaiser; pacifier (qetësoj; paqësoj)

Është Shqipja:

s h u j (s h u a j)

Në Shqip p.sh.: "shuaj sherret...", "shuaj zjarrin..." etj. etj., gjë që tregon se spektri semantik i këtij operatori në Shqip është më i gjerë** se ay në gjuhën Kineze, që nga dhe: kinez. "s u ī" < shq. "s h u j".

* Të gjitha figura simbolike këto në E.

** Në Shqip gjithashtu "s h u a j" do hotë edhe "h e s h t", p.sh. "shuaj fjalën".

856) Kinez. s u ì (岁) = fr. *an, annee; âge* (vjet; moshë)

Motivohet me Shqipen:

s y, s y u, s y n i, s y r i...

Ne pamë më sipër se në gjuhën Kineze, fjala "s h i" do të thoshte "s h o h".

Duke qenë kështu, Kinezja lidh edhe ajo mitikisht "vitin" me "shi-kimin", e pra me "sy-n", e pra, nga ato sa u panë e u thanë më parë, me "diellin".

857) Kinez. s ā n g (噪) = frengj. *voix* (zâ)

Është Shqipja:

z a n i

Në Gjermanisht: "s i n - g e n" = *këndoj*, ku theksi semantik bie tek "s i n", duke qenë "-g e n" një prapashtesë foljore. Pothuajse-homonimia perfekte mes këtyre dy fjalëve me të njëjtin kuptim të parafërtë, na shtyn të besojmë se Gjermanishtja "s i n" nuk është tjetër veçse një deformim i Shqipes "z a", "z a n i". Po ashtu edhe Inglishtja "s o n g" dhe më në fund edhe Kinezja "s ā n g".

858) Kinez. r ù (入) = fr. *entrer; penetrer* (hyj, ryj; depërtoj)

Është Shqipja:

r y j (= h y j)

859) Kinez. r ù n (闰) = fr. *intercaler* (ndërkall)

Është Shqipja:

r y n

860) Gjerm. *h i n d e r n* = pengoj

Motivohet me Shqipen:

h i n d ë r

dhe me një Shqipe më "zyrtare":

h y n d ë r, hy ndër-mjet
(n d ë r - h y j)

Dhe dimë, vërtetë, që çdo *ndërhyrje*, (|) , në përgjithësi vështrohet si *ndërprerje* (⊕) e një procesi, e pra si një *pengesë* (→ ≠ ←)...*

Simbolikisht pra, ky proces "etimologjizimi" do të mund të paraqitet përmbledhtazi, pak a shumë kështu:

gjerm. "h i n d e r n" → shq. "h i n d ë r" = (|) = **F** = ⊕ = ...
ndarë = ndyrë = ● = (→ ≠ ←) = kundërshtimi, pengesa...

861) Frangj. h i v e r = dimër

Etimologjizimi i kësaj fjale me Shqipen bëhet në këtë mënyrë:

h i v e r → shq. **h i v ë r ë** (*hymja në vërë, në birë*) = ⊖ = **F** = ●

Mithologjikisht një motivim i tillë do të mbështetet nga miti i Demetrës (Ceres), Persefonit (Proserpinës) dhe Hadesit (Plutos).

Sipas këtij miti, Pluto, perëndia e botës së nëndheshme (Hades) dhe vëllai i Zeusit, i rrëmbeu Demetrës të bijën, që të martohej me të e ta bënte mbretëreshë të botës së Hadesit.

* Lidhur me operatorin e lirë në Shqip (por jo në Gjermanisht): "h y", "h y j", "h i", "h i n", "h y m"... kemi follur edhe gjatë etimologjizimit të një pjese të gllosarit Gjermanisht, pra dhe nuk po e zgjasim...

Shih ndër të tjera fq.280, 286 dhe 499.

Demetra iu ankua për këtë Zeusit, i cili e gjykoi çështjen me drejtësi: Persefoni do të qëndronte gjashtë muajt të vitit në botën e nëndheshme, si e shoqja e Plutos, ndërsa gjashtë muajt e tjerë do të dilte jashtë, në botën e "mbidheshme", pranë të jëmës, Ceres.

Kështu pra, Persefoni *do të hynte në vërë* dhe ky do të qe *dimri*. Prandaj dhe Frengjishtja "h i v e r" mendojmë se është një transpozim gjuhësor i këtij miti.

Si "*Consensio linguarum*", sjellim:

lat. "hibernis" (*dimër*) → shq. "h i (në) b i r ë" = $\boxed{\circ}$ = F = ●

ital. "inverno" (*dimër*) → shq. "h i n v ë r ë" = $\boxed{\circ}$ = F = ●

Edhe Inglishtja "t o h i b e r n a t e" (*bie në gjumë dimëror, për dimërim...*) motivohet me Shqipen: h i b e r - n a t e → shq. "h i b ë r ë" = $\boxed{\circ}$ = ●.

Dihet që një numër i madh kafshësh të "egra", gjatë dimrit futen në strofkat (vrimat) e tyre, në gjendje letargjie të plotë. Që këndej edhe fjala Inglišhte "t o h i b e r n a t e".

Në Inglišht gjithashtu:

"winter" (*dimër*) → w i n t e r * → shq. "b ë â n d â r ë" = $\textcircled{1}$
= F = $\boxed{\circ}$ = ●

Në Greqisht: "h i m o n a s" (χειμώνας) = *dimër*. Motivimi me Shqipen:

h i m o n - a s → shq. h i m u n = $\boxed{\circ}$ = ...

* "i n t e r" nuk është tjetër veçse Sanskritishtja "a n t a r a" = brenda, i brendshëm, a n ë t a r..., e pra Shqipja: "â n d â r" = $\textcircled{1}$ = F = $\boxed{\circ}$ (ingl. *inside*). Shih lidhur me këtë edhe fq.105 dhe 397.

Në Latinisht gjithashtu:

h i e m s → shq. **h y** j a m = ☐ = ...

Në Sanskritisht, koncepti i "dimrit" jepet gjithashtu, ndër të tjera, me: "h i m ā" (हिमा), "h e m a n" (हेमन्), "h a i m a l a" (हैमल), që referojnë që të gjitha, në motivim, te një "h y m j e", në një të "h y m u n"...

Dhe është fjala, mitologjikisht, për *hymjen* e Persefonit në mbretërinë e nëndheshme, gjë që përputhet me fillimin e stinës së dimrit...

Dhe në përfundim shtojmë edhe se rrënja "H y" ("h y m u n") ekziston si operator i lirë vetëm në Shqip. Kjo dhe e bën atë, Shqipen, që t'i motivojë më së mirë të gjitha këto gllloja të huaja.

Në zgjerim të Bisedës, shtojmë se:

Në Rusisht: "z i m à" (зима) = dimër. Mendojmë se në këtë fjalë theksi semantik bie tek "z i" = simb. ● .

Dhe nga ato sa shpjeguam më sipër, kuptohet përse...

Në Shqip: "d i m ë r" = ingl. *winter*. Motivohet, brenda Shqipes, si:

d i m ë r → d ā m A r * = ⊕ = F = ☐ = ● = shq. zi, rus. zi-mà

862) Kinez. s h ā n (删) = ingl. *to conceal; efface, erase* (fshij; anulloj, shuaj)

Është Shqipja:

s h u a n

që lidhet mbrenda Shqipes me foljen "SHUj", "shu-aj".

* Shih edhe fq.151 dhe 768.

863) Kinez. sǎo (掃) = ingl. *to sweep* (fshij)

Është Shqipja:

s h u j, s h u a j...

Këtë rrënjë e gjejmë me "përngjitje" edhe tek Shqipja "f s h i j" që duhet ndarë në "f s h i j", ku "f" rri për "b", e pra mund të shkruajmë:

"f s h i j" < "bë s h i j" < "s h i - j"

Vëmë ré se në Shqip, krahas trajtës "f-s h i j" kemi edhe trajtën "p-s h i j" (pra: "f" < "p" < "b").

NJË PARASHTRIM I SHKURTËR I ALGORITMIT SIMBOLIK

Ndërtimi i Algoritmit Simbolik nga Hiçi

Hiçi = zero = 0

"Hiçi" mund të simbolizohet, sikundër dhe është bërë, me simbolin arkeotipal \bigcirc . Të ndërtosh Algoritmin Simbolik duke u nisur nga *Hiçi* është njëlloj si ta nisësh punën nga *zero*, m.q.s. i njëjti simbol jo "rastësisht" tregon edhe "zeron".

Por kjo do të thotë që të ndërtosh një sistem duke u nisur jo nga *disa* premisa të dhëna, nga një sërë aksiomash pa vërtetim e kështu me radhë.* Ky, një sistem pra që ndërtohet duke nisur nga Zero, nga *Hiçi*, do të jetë atëhere një sistem unikal, themelor, absolut.

* Kështu është ndërtuar çdo sistem formal në Shkencë, si bie fjala për shembull Gjeometria e Euklidit, sistemi fillosofik i Spinozës e kështu me radhë. Kurse në rastin tonë, me qenë se kemi të bëjmë jo më me një *Dituri formale* (që i bindet llogjikës $(x = x)$ a e thënë ndryshe *kodit F*), por me një *Dituri esenciale* (që i bindet llogjikës $(x = -x)$ a ndryshe *kodit E*), jo një *Dituri relative* (∞) por absolute ($-\infty$), siç do të shihet më mirë më vonë... mund të fillohet drejt e nga *Hiçi*, pa premisa, pa postulate, pa dogma.

Shtojmë këtu se asnjë *sistem formal* nuk mund të shprehë tërë informacionin të cilin ai përmban. Dhe kjo sepse, Teorema e Papërplotësisë

Siç do të shohim, i tillë është dhe sistemi i Algoritmit Simbolik.

Zero si rrënja e ekuacionit të Qëndrës

Duke marrë për simbolin \bigcirc vlerën (interpretimin) "zero", gjejmë se mund të shkruajmë:

$$\bigcirc = (x = -x)$$

Që do të thotë se zero është rrënja e ekuacionit $(x = -x)$.

Dhe kjo sepse, siç shihet lehtë, kemi, duke zëvendësuar " x " me zero:

$$0 = -0$$

Qendra si *Coincidentia oppositorum*

Ekuacioni $(x = -x)$ përfaqëson Qendrën Mistike si *Coincidentia*

(*Incompleteness Theorem*) e Gödel-it, e pengon një gjë të tillë, kur sanksionon që: një sistem formal nuk mund të "japë" (eksplicitojë, artikullojë...) tërë informacionin që përmban, sepse duke dashur të demonstrojë vërtetësinë e tij, do të shkatërrohej. Algoritmi na lejon ta kuptojmë fare thjeshtë dhe saktë këtë:

$$\text{sistem formal} = \text{llogjikë formale} = (x = x) = \bigcirc = \boxed{\bigcirc} \dots(F)$$

Informacioni që përmban një sistem formal çfarëdo, si ky i yni këtu, është pra " \bigcirc ", d.m.th. është tërë informacioni i mundshëm. Por në goftë se ai do të dilte jashtë, do të kishim:

$$-\boxed{\bigcirc} = \bigcirc = -\bigcirc = -(x = x) \dots(E)$$

që do të thotë, ndër të tjera, *shkatërrimin e sistemit formal* $(-\bigcirc)$ dhe *pamundësinë e vërtetimit llogjik të tij* $[-(x = x)]$. Sistemi F do të kalonte pra kështu në sistemin E , e pra në Hiç, ai do të asgjësohej. Ky është dhe kuptimi i thellë dhe në vija të përgjithshme i Theoremës së famshme e Papërplotësisë së Gödel-it...

oppositorum (përputhje të kundërtash) dhe, siç do shihet më mirë më tej, vetë Zotin.

* Shih për këtë edhe Cirlot (fq.39-40). Lexojmë:

"Centre. To leave the circumference for the centre is equivalent to moving from the exterior to the interior, from form to contemplation, from multiplicity to unity, from space to spacelessness, from time and timelessness. In all symbols expressive of the mystic Centre, the intention is to reveal to Man the meaning of the primordial 'paradisaal state' and to teach him to identify himself with the supreme principle of the universe. This centre is in effect Aristotle's 'unmoved mover' and Dante's 'l'Amore che muove il sole e le altre stelle'. Similarly, Hindu doctrine declares that God resides in the centre, at the point where the radii of the wheel meet at its axis. In diagrams of the cosmos, the central place is always reserved for the Creator... surrounded by concentric circles spreading outwards... Among the Chinese, the infinite is frequently symbolized as a point of light with concentric circles spreading outwards from it.

...In some Hindu mandalas, such as the Shri-Yantra, the centre itself is not actually portrayed but has to be supplied mentally by the contemplator... A great many ritual acts have the sole purpose to finding out the spiritual "Centre" of a locality... There are many legends which tell of pilgrimages to places with characteristics which relate them to Paradise. This Chinese tale, for example, retold by the orientalist Whilhelm in his work on Lao-Tse: 'The King Huangti had a dream. He crossed into the kingdom of the Hua Hsü. The kingdom of the Hua Hsü is west of the far West and north of the far North. It is not known how many hundreds of thousands of leagues it is from the Ch'i state. It can be reached neither by boat nor by carriage, nor on foot. It can be reached only by the spirit in flight. This country has no sovereign; everyone acts according to his own dictates... They enter the water and are not drowned, walk through the fire and are not scorched... They rise up into the air as others

walk on the face of the earth... They rest in space as others sleep in beds; cloud and mist do not veil their gaze... They walk only in the spirit. This concept of the Centre coincides, of course, with that of the 'Land of the Dead' in which the theme of the COINCIDENTIA OPPOSITORUM of the mystic tradition come to signify not so much 'opposition' as neutralization, in the characteristically oriental sense.

The Centre is located at the point of intersection of the two arms of the superficial (or two-dimensional) cross, or of the three arms of the essential, three-dimensional cross. In this position it expresses the dimension of the 'infinite depth' of space, that is, the seed of the eternal cycle of the flux and flow of forms and beings, as well as the dimensions of the space itself. In some liturgical crosses, as for example that of Cong in Ireland, the centre is marked by a precious stone."

[Qëndra. Të largohesh nga periferia e rrethit me drejtim për nga qëndra, është njëlloj si të lëvizësh nga jashtë brënda, nga forma tek esenca, nga shumësia tek njësia, nga hapësira tek pahapësira, nga koha tek pakohësia. Të gjitha simbolet shprehëse të Qendrës Mistike priren ti zbulojnë Njeriut kuptimin e "gjendjes parajsore" primordiale si edhe ti mësojnë atij se si të bëhet një me Parimin Suprem të Universit. Qëndra është në fakt "Lëvizjevenësi i palëvizur" i Aristotelit dhe "L'Amore che muove il sole e le altre stelle" i Dantes. Edhe doktrinën hindiane pohojnë se Zoti rri në qëndër tek pika e takimit të rrezeve të rrotës me boshtin e saj. Në diagramat e Kozmosit, vendi qëndror i përket gjithmonë Krijuesit... ku ai është i qarkuar nga rrahë koncentrikë në përhapje... Ndër kinezët, qenia infinite simbolizohet shpesh si një pikë drite e rrethuar nga rrahë koncentrikë që hapen dora-dorës që largohen prej Tij.

...Në disa mandala hindiane, si bie fjala në Shri-Yantra, vetë qëndra nuk paraqitet konkretisht, por soditësi duhet, sipas mendjes së tij, ta

vërë atë në vendin e duhur... Një numur i madh aktesh ritual kanë për qëllim gjetjen e "Qëndrës" spirituale të një lokaliteti...

Ekziston një numur i madh legjendash që flasin për pelegrinazhe në vende me karakteristika të përngjashme me ato të Parajsës, si bie fjala kjo rrëfenjë Kineze e ritreguar nga orientalisti Wilhelm në veprën e tij mbi Lao-Tse: "Mbreti Huangti pa në ëndërr sikur po udhëtonte mes për mes mbretërisë së Hua Hsü. Mbretëria e Hua Hsü është në perëndim të Perëndimit të Largët (*Far West*) dhe në veri të Veriut të Largët (*Far North*). Nuk dihet sa qindra mijëra lega ajo ndodhet nga shteti Ch'i. Atje nuk mund të arrish as me barkë, as me karrocë dhe as me këmbë. Atje mund të mbërrish vetëm mbi krahët e Frymës në fluturim. Kjo mbretëri nuk ka mbret: sikush bën si di vetë. Nuk ka ligje, sikush ndjek lirisht dëshirat e tij... Ata futen në ujë dhe nuk mbyten, ecin mbi zjarr dhe nuk digjen... Ata ngrihen lartë në ajër sikundër dikush tjetër do të ecte mbi dhë, ata pushojnë në ajër sikundër dikush tjetër do të flinte në shtratin e tij... Ata udhëtojnë mbi krahët e Frymës... Ky përfytyrim i Qëndrës përputhet, padyshim, me atë të "Vendit të të Vdekurve" (ingl. *Land of the Dead*) ku motivi i "*Coincidentia oppositorum*" i traditave mistike ka shumë më tepër kuptimin e "neutralizimit" (komplementarizimit) në stilin karakteristik oriental, se sa atë të "kundërvënies".

Qendra është vendosur në pikën e ndërprerjes të të dy krahëve të kryqit sipërfaqësor (ose dy-dimensional), ose tre krahëve të kryqit esencial apo tri-dimensional. Në këtë pozicion ajo shpreh dimensionin e "thellësisë infinite" të hapësirës, me fjalë të tjera, farën e ciklit të amshueshëm të ndryshimeve të pareshtura të formave dhe të qënjeve si edhe gjithashtu edhe vetë dimensionet e hapësirës. Në disa kryqe liturgjikale, si për shembull në atë të Kong në Irlandë, qendra shënohet me një gur të çmueshëm.]

Zero dhe Infiniti

Nga ($x = -x$) mund të nxjerrim edhe:

$$1/x = -1/x$$

e pra edhe:

$$1/0 = -1/0$$

e pra:

$$\infty = -\infty$$

Pra dhe Infiniti, krahas Zeros kënaq ekuacionin e Qëndrës. Mund pra të shkruajmë:

$$(x = -x) = 0$$

$$(x = -x) = \infty$$

që nga edhe:

$$0 = \infty$$

$$(zero = infinit)$$

Në gjuhën e matematikës, ky barazim "i çuditshëm", "paradoksal" do të formulohej edhe kështu:

$$\text{pambarimisht e vogla} = \text{pambarimisht e madhja}$$

Dhe, në mënyrë më të përgjithësuar:

$$\text{Mikrokozmosi}^* = \text{Makrokozmosi}$$

* Lidhur me këtë çështje shih edhe Cirlot (fq. xxxi).

Me qenë se:

$$\text{Qëndra} = (x = -x) = \text{Coincidentia oppositorum} = \text{Zoti}$$

Dhe me qenë se, siç pamë, vetëm 0 dhe ∞ e kënaqin këtë ekuacion, ne mund të themi, bashkë me Nicola de Cusa, se *Zoti qëndron në ekstremet*.

Qëndra Mistike si qëndra e një rrethi (sfere)

Qëndra mund të paraqitet edhe ndryshe, d.m.th. me një tjetër ekuacion, me atë të *qendrës së një rrethi* çfarëdo a, ç'është njëlloj, me atë të Pikës.*

Edhe Frëngjishtja: "*Les extremes se touchent*" (Ekstremet takohen), na thotë pak a shumë të njejtën gjë. Kjo dëshmon, përveç asaj, për strukturën ciklike të të Tërës, që me fjalë të tjera mund të themi se:

$$e \text{ Tëra} = \text{ingl. the All} = \odot$$

* Cirlot (fq.260):

"Pika: Ka kuptimin e unitetit, të origjinës dhe të Qendrës..."

Shkalla e parë e gjithshkaje është krejt e fshehtë, jo e shfaqur, dhe nuk mund kurrë të arrihet... Kështu shpjegohet përse Qëndra, identike me pikën mistike, paraqitet zakonisht si një vrimë...

Poli: Qëndra mistike, ose mesi i pandryshueshëm është pika fikse që njihet në traditën simbolike me emrin *pol* me qenë se Toka vërtitet rreth tij. Poli identifikohet gjithashtu edhe me zenithin. Në Kinën e lashtë ai paraqitej nga një vrimë në qendër të një disku prej nefriti e quajtur *P* i... 'Mesi i pandryshueshëm' vështrohej si shkak i çdo ndryshimi...

'*Libri i Ndryshimeve*', në Kinë, na thotë se metamorfozat e pandërprera të materies lindin nga poli i madh – një Njënjësi (ingl. *Oneness*) e vendosur larg e përtej çdo dualiteti, larg e përtej çdo ngjarjeje dhe që identifikohet me '*Lëvizjevenësin e palëvizur*' të Aristotelit..."

Nga sa lexuam, del ekuacioni:

$$Pika = vrima = \circ = Qendra = \bigcirc = \infty = e \text{ Tëra} = Universi$$

Gjuha jep një dëshmi të kësaj të vërtete kaq paradoksale dhe të çuditshme. Kështu, në Inglisht kemi:

$$\begin{aligned} \text{w hole} &= e \text{ Tëra} = \bigcirc \\ \text{hole} &= vrima = \circ \end{aligned}$$

Mund të vërtetojmë se:

$$(x = -x) = (x^2 + y^2 = 0)$$

Këtu "w" është prostatike, që do të thotë se është një "parashtesë" asemantike që shërben vetëm për të shmangur ambiguitetin që do të krijohej duke i treguar të dy këto koncepte me të njëjtën fjalë. Kështu pra, Inghishtja pozon ekuacionin simbolik:

$$\bigcirc = \circ$$

w hole hole

Atëhere, këtu lidhet dhe fjala tjetër e Inghishtes *holy*. Mund të shkruajmë pra ekuacionin:

$$\mathbf{whole = hole = holy}$$

Pse "*holy*" ? Po sepse, Zoti qëndron në Qëndër, e pra qëndron tek "*hole*", e pra ky vend këtu është "*holy*".

Duke e zgjeruar disi Bisedën, mund të hipotetizojmë se:

$$\text{lat. } \textit{verus} < \text{shq. } \textit{vërë} = \bigcirc = (x = -x) = \textit{Qëndra Mistike}$$

Gjithashtu:

$$\begin{aligned} & \text{ingl. } \textit{true} < \text{fr. } \textit{trou} = \textit{vrimë} = \bigcirc = (x = -x) \\ & = \textit{Qëndra Mistike ('the Supreme Principle of the Universe')} \end{aligned}$$

Edhe diçka tjetër...

Nga ekuacioni:

$$(\bigcirc = \bigcirc) = (\text{pi-ka} = \text{Universi})$$

justifikohet pohimi i çuditshëm i fizikës moderne sipas të cilit: "*Në çdo Pikë të Universit ndodhet i pranishëm informacioni i Tërë Universit.*" Ne tani arrijmë ta kuptojmë përse...

Vëmë ré gjithashtu rëndësinë e madhe të Gjuhës dhe të analizave tona *sui generis* etimologjike, llogjike, fillosofike për zbulimin e një sërë të vërtetash të thella e madhore të Shkencës.

$$1) (x = -x) \rightarrow (x^2 + y^2 = 0)$$

Duke u nisur nga ekuacioni i Qendrës Mistike ($x = -x$) dhe duke shumëzuar të anët me i (njësia imagjinere = $\sqrt{-1}$) do të kemi:

$$ix = -ix$$

e pra atëhere, duke pozuar $y = ix$, do të kemi edhe:

$$y = -y$$

e pra edhe:

$$y = ix \quad \text{që nga } (y - ix = 0)$$

$$y = -ix \quad \text{që nga } (y + ix = 0)$$

Duke shumëzuar krah më krah këto dy ekuacione, do të kemi:

$$(x^2 + y^2 = 0)$$

Kjo është qendra e një rrethi me rreze zero (0), a thjeshtë Qendra. Kështu pra, gjetëm një tjetër ekuacion për të paraqitur Qendrën Mistike. Ky ekuacion na lejon të kuptojmë edhe përse-në e emërtimit "qëndër".

$$2) (x^2 + y^2 = 0) \rightarrow (x = -x)$$

Mund të shkruajmë:

$$(x^2 + y^2 = 0) = ((y + ix)(y - ix) = 0)$$

Do të kemi atëhere:

$$(y = ix) = 0 \quad \text{dhe} \quad (y = -ix) = 0$$

që nga edhe:

$$ix = -ix$$

dhe duke pjesëtuar të dy anët me i , kemi:

$$(x = -x)$$

Çfarë dhe duhej vërtetuar...

Disa vetira të Qëndrës

Pamë se Qendra zbërthehesh në ekuacionet e dy drejtëzave të ashtuquajtura *drejtëza imagjinere*. Mund të vërtetojmë se këto drejtëza, në të cilat shpërbëhet dhe nga të cilat përbëhet qendra e rrethit, nuk lëvizin: *as çvendosen, as vërtiten*.*

Le të vërtetojmë atëherë se *Qendra nuk lëviz*. Mund të shkruajmë:

$$\text{Qendra} = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = \dots (y = \pm ix)$$

Marrim njërën prej drejtëzave çfarëdo imagjinere, p.sh. $y = ix$. Mbi të marrim dy pika çfarëdo (x_1, y_1) dhe (x_2, y_2) .

Kryejmë një çvendosje që do ta tregojmë me d , nga njëra pikë në tjetrën mbi drejtëzën imagjinere.

Do të kemi, sipas rregullave të Gjeometrisë Analitike:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + (y_2 - y_1)^2$$

dhe për:

$$y_1 = i x_1$$

$$y_2 = i x_2$$

duke zëvendësuar më sipër, do të kemi:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + (ix_2 - ix_1)^2$$

ose edhe:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 + i^2(x_2 - x_1)^2$$

* Që këndeje dhe kuptojmë pse Qendra, si *Coincidentia oppositorum* ($x = -x$), është, siç e quan Aristoteli, "*the Unmoved Mover*" (Lëvizvënësi i Palëvizur): *Qendra vetë nuk lëviz, kurse çdo gjë tjetër vihet prej saj në lëvizje...*

ose edhe përfundimisht:

$$d^2 = (x_2 - x_1)^2 - (x_2 - x_1)^2 = 0$$

Pra kjo çvendosje është: $d = 0$.

Kjo do të thotë se *drejtëza izotrope* (imagjinere) *nuk mund të shkasë mbi veten e vet*, (ose "shket pa shkarë"), a ndryshe se *Qendra* (këtu e rrethit, por në përgjithësi *Qendra* në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, pavarësisht se si ajo përcaktohet) *nuk çvendoset*.

Le të vërtetojmë tani se *Qendra as nuk vërtitet*.

Me qenë se *Qendra* reduktohet tek drejtëzat imagjinere, le të marrim parasysh, si më lartë, drejtëzën imagjinere: $y = ix$. Le të supozojmë se ajo bën me boshtin xx' një kënd ω . Do të kemi kështu:

$$\operatorname{tg} \omega = i$$

Le të supozojmë tani *per absurdum* se drejtëza imagjinere vërtitet me një kënd $\Delta \omega$.

Do të kishim kështu një drejtëz që do të formonte me boshtin xx' këndin $(\omega + \Delta \omega)$.


Le të njehsojmë tangjenten e këtij këndi (që do të shprehte koeficientin këndësor të drejtëzës së "rë" imagjinere që do të përfitohej në këtë mënyrë:

$$\begin{aligned} \operatorname{tg}(\omega + \Delta \omega) &= \frac{\operatorname{tg} \omega + \operatorname{tg} \Delta \omega}{1 - \operatorname{tg} \omega \operatorname{tg} \Delta \omega} = \frac{i + \operatorname{tg} \Delta \omega}{i - i \cdot \operatorname{tg} \Delta \omega} \\ &= \frac{i + \operatorname{tg} \Delta \omega}{1 + \frac{1}{i \cdot \operatorname{tg} \Delta \omega}} = \frac{i + \operatorname{tg} \Delta \omega}{i + \operatorname{tg} \Delta \omega} i = i \end{aligned}$$

Kështu pra përfundimisht:

$$\operatorname{tg}(\omega + \Delta\omega) = i = \operatorname{tg} \omega$$

Kjo do të thotë atëhere se pas "vërtitjes" ne arrijmë përsëri tek drejtëza imagjinere nga e cila u nisëm.



Kështu pra: Asnjë lëvizje vërtitëse mbi drejtëzën imagjinere. A e thënë ndryshe, e në një mënyrë paradoksale:

Drejtëza imagjinere vërtitet pa u vërtitur.

Qendra, imagjineri dhe infiniti

Shkruajmë:

$$\begin{aligned} \text{Qendra} &= (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) \\ &= (y = ix)(y = -ix) = \text{drejtëzat imagjinere (a izotropë)} \end{aligned}$$

Le të marrim një të një prej tyre, për shembull: $(y = ix)$.

Mund të shkruajmë: $y = ix$, $y/x = i$, e pra edhe: $\operatorname{tg} \psi = i$, pra edhe:

$$\text{Qendra} = (\operatorname{tg} \psi = i) = i$$

Çfarë dhe duhej vërtetuar.

Le të vëmë re shkarazi këtu edhe se, duke u nisur nga ekuacioni ($\operatorname{tg} \psi = i$), ne mund të rigjejmë përsëri ekuacionin e Qendrës.

Dhe vërtetë:

$$(\operatorname{tg} \psi = i)^2 = (\operatorname{tg}^2 \psi = i^2) = (x^2/y^2 = -1) = (y^2 = -x^2)$$

dhe përfundimisht:

$$(x^2 + y^2 = 0) = \text{Qendra}$$

Duke u mbështetur në sa më sipër, mund të shkruajmë:

$$\operatorname{tg} \psi = \sin \psi / \cos \psi = i$$

që nga:

$$\sin \psi = i \cos \psi$$

ose edhe:

$$-i \cos \psi + \sin \psi = 0$$

Dimë që: $i^2 = (\sqrt{-1})^2 = -1$.* Duke zëvendësuar tek ekuacioni i mësipërm do të kemi: $1/i \cos \psi = i \sin \psi = 0$, dhe pra përfundimisht:

$$\cos \psi + i \sin \psi = 0$$

Në bazë të formulës së Euler-it do të kemi:

$$e^{i\psi} = \cos \psi + i \sin \psi$$

e pra atëhere edhe, në rastin tonë:

$$e^{i\psi} = 0$$

një ekuacion ky që kënaqet vetëm për: $\psi = -\infty$.


* Që nga edhe: $ii = -1$, e pra edhe $i = -1/i$ ose edhe $-i = 1/i$.

Dhe vërtetë, në këtë rast do të kemi:

$$e^{i\psi} = e^{i(-\infty)} = 1/e^{i\infty} = 1/\infty = 0$$

Kemi: $\operatorname{tg} \psi = i$, e pra atëhere përfundimisht:

$$\operatorname{Arctg} i = -\infty$$



Dhe kjo është lidhja që kërkonim dhe donim të provonim mes *Qëndrës* dhe *Infinitit*. Ne gjejmë kështu, në të njejtën kohë, edhe një lidhje të rëndësishme mes *imagjinerit* dhe *infinitit*.

***Tabula Smaragdina* dhe disa zbatime të ekuacionit të Qëndrës**

$$\text{Qëndra} = (x = -x)$$

Këtu "x" mund të jetë çfarëdo. Marrim atëhere, për shembull:

$$x = \uparrow$$

do të jetë atëhere:

$$-x = -\uparrow = \downarrow$$

E pra atëhere, në Qëndër:

$$\uparrow = \downarrow$$

dhe rigjejmë kështu *Tabula Smaragdina*, që vështrohet si një paradigmë legjendare e simbolizmit.

Mund të marrim: $-x = \text{"brenda"}$, dhe ta tregojmë këtë simbolikisht me \boxed{x} . Do të jetë atëhere: $x = \text{"jashtë"}$...

Do të kemi kështu, në Qëndër:

$$x = \boxed{x}$$

Dhe rigjëjmë kështu një përplotësim të *Tabula Smaragdina* të bërë nga Goethe: "Shka është jashtë (forma), është dhe mbrenda (ideja)."

Përitohen në këtë mënyrë dy zbatime të rëndësishme, të stërlashta të ekuacionit të Qëndrës. Por ne mund të gjejme gjithashtu në këtë mënyrë edhe të tjera e të tjera zbatime, duke zëvendësuar "x"-in me çdo gjë tjetër...

Një përmbledhje e shkurtër e vetirave të Qëndrës, nga sa u tha më sipër, do të ishte:

Qendra është **bosh** (ingl. *void*), gjersa lidhet me pikën gjeometrike dhe pasi kjo e fundit përfaqëson simbolikisht një **vrinë** (ingl. *hole*).

Qendra është **zero** (**0**), gjersa zero është zgjidhja e ekuacionit të Qëndrës, d.m.th. e ekuacionit ($x = -x$).

Qendra nuk është reale, ajo është **imagjinere**.

Qendra **nuk lëviz**, porse prap vë në lëvizje gjithshka.

Qendra përfaqëson të **Tërën** (ingl. *the All*), me qenë se, siç thuhet, prap tek Cirlot (fq. 260), Qendra (*pika*) "...përfaqëson shumën tërësore të të gjitha aspekteve të realitetit..."

Qendra është **përtej çdo dualitetit** (*far beyond all duality...*), se ajo lidhet ngushtë me **njëshin**, **unitetin** dhe **unicitetin** (ingl. *oneness*).

Qendra është e **fshehur** (ingl. *occult*).

Qëndra, ndonëse vetë *nuk ndryshon*, është prap shkak i çdo ndryshimi, i çdo formë-lindjeje dhe formë-ndryshimi (metamorfoze).

E kështu me radhë...

Dy llogjikat (logoset), dy kodet

$(x = -x)$ mund të vështrohet si një propozicion llogjik. Ai është shprehës i *llogjikës së të Tretit të Përfshirë* (*Tertium Datur*). Do ta quajmë këtë kod *E*.

Marrim në konsideratë tani ekuacionin $(x = x)$. Ai mund të vështrohet si një propozicion llogjik e si shprehës i ligjit të mos kontradikcionit, a ç'është njëlloj, i *llogjikës së të Tretit të Përyshuar* (*Tertium Non Datur*). Do ta quajmë këtë kod *F*. Ai përputhet kështu me *llogjikën formale* a, ç'është njëlloj, me *Arsyen njerëzore*. Me qenë se, siç pamë:

$$(x = x) = -(x = -x)$$

atëherë pra edhe:

$$(x = -x) = -(x = x) = -\text{llogjika formale}$$

Shihet qartë se llogjika e dytë mund të vështrohet, nga pikëpamja e llogjikës së parë, si një *Antilogjikë*.

Le të shtojmë këtu edhe se, siç do të shihet më qartë më vonë:

F : kodi i cektësisë

(periferia e rrethit ose sipërfaqja e sferës)


E : kodi i thellësisë

(qendra e rrethit ose qendra e sferës)

Mund të shkruajmë:

$$F = -E = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2)$$

E pra:



Dhe ky është një relacion tjetër mes dy kodeve. Kodi E është pra kështu: **kodi i mbrendësisë, i thellësisë** (ndaj pra edhe i mirë, esencial) ndërsa **kodi F është kodi i jashtësisë, i periferisë, i sipërfaqes**, e pra si i tillë një kod *sipërfaqësor, i përciptë, formal*.

Duke zgjeruar Bisedën, para se të shkojmë më tej, le ti përgjigjemi pyetjes: *Përse simboli bën pjesë në kodin E, ndërsa koncepti në F?*

Ka disa mënyra për ta shpjeguar këtë...

- a) Në librin e simboleve të Jean Chevalier, të cilin e kemi përmendur dhe do të na duhet ta përmendim akoma në të ardhshmen, thuhet tekstualisht:

"La logique du symbole c'est la logique du Tiers Inclus."

(Llogjika e simbolit është llogjika
e të Tretit të Përfshirë.)

Pra, ajo e kodit E.

- b) Nga ana tjetër siç do të shohim, kemi: $F = -E$. Pra, rrjedh vetvetiu që kodi F nuk bën pjesë në llogjikën e të Tretit të Përfshirë e pra atëhere dhe nuk operon me simbole (por me koncepte). Dhe kështu shpjeguar atë çfarë na kërkohej.
- c) Përsëri tek Jean Chevalier (*Dictionnaire des symboles, Introduction*) lexojmë:

"Le symbole abat les murs."
(Simboli shemb muret.)

që mund të shkruhet simbolikisht:

$$\text{simboli} = - \textcircled{1}$$

dhe që mund të interpretohet si "jo ndarje" e pra si "jo përcaktim" e pra, fundja më në fund, si "jo koncept" gjersa koncepti s'bën dot pa për-cak-timin. Që këndej del edhe një gjë tjetër. Spinoza thotë: "*Omnis Definitio est Negatio*", që mund të shkruhet simbolikisht:

$$\textcircled{1} = - 1$$

Pra, definicioni dhe bashkë me të edhe koncepti janë entitete negative, ndërsa simboli që i kundërvihet atyre është një entitet pozitiv, siç del edhe nga:

$$\text{simboli} = - \textcircled{1} = - (-1) = 1$$

Mund të shkruajmë atëhere:

$$E = +1$$

(llogjikë pozitive)

$$F = -1$$

(llogjikë negative)

dhe më në fund mund të themi se:

Dituria që përfshihet në kodin E është një dituri pozitive dhe si e tillë e mbarë, kurse dituria që përfshihet në kodin F është përkundrazi një dituri negative dhe si e tillë e mbrapshtë. Duhet thënë pra se pozitiviteti dhe negativiteti nuk janë dy kategorira relative, por absolute. E theksojmë këtë sepse Shkenca Klasike relativizon përkatësinë në negativitet a në pozitivitet. Por pozitiviteti dhe negativiteti nuk janë pra konvencionalë, nuk janë emërtime a klasifikime relative por *absolute*.

Po kjo çështje sqarohet edhe në mënyrë më bindëse në tekst, sikundër dhe lexuesi do ta ketë vënë re.

Disa marrëdhënie mes dy kodeve

Duke ndërtuar tabelën e vërtetësisë të $(x = -x)$ dhe të $(x = x)^*$ të vështruara si propozicione llogjike, ne gjejmë se ato janë të kundërta. Pra atëhere edhe ato vetë, këto propozicione, janë të kundërta. Mund të shkruajmë atëhere:

$$E = -F$$

dhe anasjelltas:

$$F = -E$$

Dhe ky është një relacion i parë mes dy kodeve (logoseve).

Shkruajmë:

$$E^2 = (x = -x)^2 = [x^2 = (-x)^2] = (x^2 = x^2)$$

dhe, duke pozuar $x^2 = X$, gjejmë:

$$E^2 = F$$

që nga dhe:

$$E = \sqrt{F}$$

* Këto janë tabelat e vërtetësisë të dy kodeve. "I" rri për "T" (ingl. *true*), kurse "-" rri për "F" (ingl. *false*).

	<u>x</u>	<u>x</u>	<u>(x = x)</u>		<u>x</u>	<u>x</u>	<u>(x = -x)</u>
F:	I	I	I	E:	I	I	-
	I	-	-		I	-	I
	-	I	-		-	I	I
	-	-	I		-	-	-

Dhe ky është një relacion tjetër mes dy kodeve...*

Vazhdojmë:

Me qenë se shenjat "I" dhe "—" në tabelat e vërtetësisë të paraqitura më lartë mund të vështrohen si konvencionale, ne mund të pozojmë: "I" = "Z" dhe "—" = "S". Duke zëvendësuar në tabelat përkatëse (*grupe transformacionesh*), do të kemi:

$$E = \begin{array}{|c|c|c|} \hline SS & = & Z \\ \hline SZ & = & S \\ \hline ZS & = & S \\ \hline ZZ & = & Z \\ \hline \end{array}$$

* Siç u pa dhe më lartë, *Qendra nuk lëviz*. Pra dhe atëhere, duke treguar *arkeotipisht* lëvizjen (ndryshimin) me \sim , mund të shkruajmë:

$$(x = -x) = E = - \sim$$

Me qenë se:

$$F = -E$$

do të kemi atëhere:

$$F = -(-\sim) = \sim$$

pra:

$$F = \sim$$

Dhe me qenë se: $E = \sqrt{F}$, do të kemi edhe:

$$E = \sqrt{\sim}$$


Me fjalë të tjera:

E (Qendra) ndonëse vetë nuk lëviz (E = - ~) është prap rrënja e çdo lëvizjeje (E = -√~).

Kështu pra... Qendra, ndonëse vetë nuk lëviz, vë në lëvizje gjithshka... (*"Immobilis mobilis"*, sipas shprehjes së Aristotelit):

$$Qendra = (x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = - \sim$$

Le ta shikojmë tani E -në në pasqyrë:



E pra:

Refl. $E =$	22	$=$	S
	$2S$	$=$	2
	$S2$	$=$	2
	SS	$=$	S

Dhe duke u kthyer tek shenjat e para, duke ripozuar me fjalë të tjera " S " = " $|$ " dhe " 2 " = " $-$ ", do të kemi, siç shihet lehtë:

$\text{Refl. } E = F$

Dhe ky është një relacion tjetër i rëndësishëm mes E dhe F .

Dhe vazhdojmë më tej: Një relacion i rëndësishëm mes dy kodeve do të përftohej duke vërtitur "grupin e transformacioneve" në E me një kënd prej 90 gradësh. Do të kishim në këtë rast:

$$E \overset{90^\circ}{\curvearrowright} = | \overset{90^\circ}{\curvearrowright} = - \overset{90^\circ}{\curvearrowright} \\ = - - = | = F$$

e kështu edhe për të gjitha rrjeshtat e tjera të tabelës të vërtetësisë të kodit E ... që do të thotë: F lind me një "vërtitje" (rrotullim) të kodit E .

Pra mund të shkruajmë:

$$\text{Rot. } E = F$$

ku "Rot" qëndron për *rotor* (rrotullim).

Mund të shtojmë këtu edhe një relacion tjetër të rëndësishëm...

Për këtë shkruajmë:

$$-x = \boxed{x} \quad \dots(F)$$

Me qenë se "x" mund të jetë çfarëdo, marrim:

$$x = E$$

do të jetë atëhere:

$$-x = F$$

Duke zëvendësuar në formulë, gjejmë përfundimisht relacionin e ri të kërkuar:

$$F = \boxed{E}$$

Le të shikojmë tani disa zbatime të kësaj formule:

1) Mund të marrim:

$$F = \bullet^*$$

Do të kemi atëhere:

$$\bullet = \boxed{\circ} \quad \dots(F)$$

Me qenë se: $\circ = -\bullet$, po të jetë se do të interpretojmë: $\bullet = \text{materie}$, *Botë materiale*, \circ do të na rezultojë atëhere si *Frymë*, *Botë Shpirtërore*.

Gjejmë kështu të thënë e famshme të Teilhard de Chardin:

"Dans le cœur de la matière il y a l'Esprit."

* Mbi këtë relacion shih edhe më poshtë, fq.812.

- 2) Sipas Bohm-it, ekzistojnë dy realitete: njëri jashtë, të cilin ai e quan "Explicate Order", dhe tjetri brenda, të cilin ai e quan "Implicate Order". Nëpërmjet Algoritmit Simbolik [veçanërisht me anë të formulës $(-x = \boxed{x})$], ne rigjejmë idenë dhe vizionin e Bohm-it mbi të dy rendet (për ne: të dy kodet). Mund të themi pa kurrëfarë frike se "Explicate Order" identifikohet me kodin F, ndërsa "Implicate Order" me kodin E. Ky është një tjetër zbatim i rëndësishëm i formulës në fjalë.
- 3) Kodi E mund të quhet edhe kodi i brendisë, kurse kodi F ai jashtësisë, siç thamë që në fillim. Pra dy realitete, një subjektiv (E) dhe tjetri objektiv (F). Duke qenë kështu, "Implicate Order" nuk mund të jetë veçse subjektiv, pamvarësisht se Bohm-i mbase nuk e ka vizionuar të tillë. Mirëpo, ne dimë se dekadat e fundit kanë parë pranimin e pranisë së Frymës në Fizikën Moderne (kuantike). Mund të referojmë për këtë, ndër të tjera, Ken Wilber-in nga i cili citojmë: "...the new science demands spirit; at least, it makes ample room for spirit."*

* Ken Wilber (ed.), "Holographic Paradigm and Other Paradoxes" (1982):
 ...the new science demands spirit; at least, it makes ample room for spirit. Either way, **modern science is no longer denying spirit**. And that, **that** is epochal. As Hans Kung remarked, the standard answer to 'Do you believe in Spirit?' used to be, 'Of course not, I'm a scientist', but it might very soon become, 'Of course **I believe, I'm a scientist**'...

[...shkenca e rë kërkon frymë; në mos tjetër ajo i hap shumë vend frymës. Sidoqoftë, shkenca moderne në një mënyrë a në një tjetër, nuk e mohon më ekzistencën e frymës. Sikundër Hans Kung ka vënë ré, përgjigja standart pyetjes "A besoni ju në ekzistencën e Frymës?" ka qenë zakonisht: "Sigurisht që jo, unë jam shkencëtar"; por ajo mund të shndrrohet shumë shpejt në: "Sigurisht që besoj, unë jam shkencëtar."]

Nga ana tjetër, Einsteini, duke iu kundërvënë rreptësisht dhe egërsisht parimeve të Fizikës Kuantike, foli për ekzistencën në këtë fizikë të një "*s p e c t r a l communication at distance*"*, duke e quajtur tërë Fizikën Kuantike në tërësinë e saj si një "*spooky physics*", shkurt e me një fjalë, një fizikë fantazmash (ital. *una fisica di spiriti*, ku fjala *Spirito* do të thotë edhe *Frymë*).

4) Cirlot, kur flet për Qëndrën Mistike si Parim Suprem i Universit, thotë, ndër të tjera, këto dy gjëra të rëndësishme: a) tek Qendra shkohet nga jashtë–brenda. Kjo do të thotë pra se Qendra është një realitet i brendshëm, e pra një realitet subjektiv, dhe b) Qendra mund të arrihet vetëm me "*the Spirit in flight*".

Pra të gjitha këto e shumë të tjera posë këtyre, na e bëjnë krejt të qartë natyrën spirituale të "*Implicate Order*", të kodit E e pra edhe, fundja më në fund, të përmbajtjes së Fizikës Kuantike, e cila mund të thuhet me bindje se studjon një realitet që nuk është ky i yni, një realitet qiellor, hyjnor, të pakrijuar, të përjetshëm.

5) Të njejtën gjë na thotë dhe Krishti kur na flet për Mbretërinë Qiellore dhe kur thekson se: "*Mbretëria e Qiellit nuk është jashtë jush, por brenda jush.*"** Jo vetëm, po Krishti vë në dukje dhe epërsinë e kësaj bote shpirtërore, të brendshme, ndaj asaj të jashtme e tokësore, kur thotë: "*Mos u trembni, ai që është brenda jush është më i madh se ai që është jashtë jush.*"***

E përkthyer në gjuhën tonë të Algoritmit, Krishti pozon:

$$E > F$$

* Shih gjithashtu fq.76 dhe 414.

** Lluca, 17:21.

*** Gjoni, 4:4.

Dhe kjo është fare e saktë, sepse:

$$E = \bigcirc$$

ndërsa:

$$F = -E = -\bigcirc = \ominus$$

Dhe është krejt e qartë se:

$$\ominus < \bigcirc$$

Nga ky shembull, si edhe nga shumë e shumë të tjerë (që do të shikojmë më vonë), mund të nxjerrim si përfundim se: *Formulat e Algoritmit e Simbolik janë të zbatueshme në çdo sferë të Dijes e në çdo dimension të Realitetit, duke përbërë një Euristikë që na lejon të rigjejmë të vërtetat e zbuluara nga shkenca në një rrugë më të shpejtë, më të thjeshtë e liogjike, si edhe për të zbuluar të tjera e të tjera të vërteta. "Libri i Aforizmave" dëshmon, qoftë edhe pjesërisht, për këtë...*

Këto qenë pra disa relacione mes dy kodeve.

Një tjetër klasifikim i kodeve

Mund të shkruajmë nga sa kemi parë gjer këtu:

$$E = (x = -x)$$

Nga ana tjetër kemi:

$$(x = -x) = (x^2 + y^2 = 0) = (y = \pm ix) = [(tg \psi = y/x) = \pm i]^*$$

Me qenë se, siç kemi parë:

$$E = \sqrt{F}$$

atëhere:

$$i = \sqrt{F}$$

e pra F -së nuk i mbetet tjetër veçse të jetë:

$$F = -1$$

* Qëllimisht e neglizhojmë "shenjën" përpara "i"-së pasi rezultati do të jetë, në të dy rastet, i njejtë.

Që këndeje, mund të nxjerrim gjithashtu edhe se:

$$E = -F = -(-1) = 1$$

pra, mund të shkruajmë se:

$$E = 1 \text{ (pozitiv)}$$

dhe,

$$F = -1 \text{ (negativ)}$$

Disa formula në F dhe universaliteti e rëndësia e tyre

Pamë disa formula në E (zbatime të ekuacionit të Qëndrës). Le të shohim tani disa formula në F.

Me qenë se:

$$F = -E$$

dhe me qenë se:

$$E = (x = -x)$$

do të kemi:

$$F = -(x = -x) = (x \neq -x)$$

e për pasojë:

$$(\uparrow \neq \downarrow) = \text{jo Tabula Smaragdina}$$

si edhe:

$$F = (x \neq \boxed{x}) \text{ (jo jashtë si mbrënda)}$$

ose:

$$F = (-x = \boxed{x})$$

Le të shikojmë tani disa zbatime të rëndësishme të formulës së fundit.

1. Marrim:

$$-x = \text{"fshij"}$$

$$\boxed{x} = \text{"fshih"}$$

Gjejmë kështu një nga aforizmat e tekstit tonë:

"Shka fshihet, veç fshihet."

3. Kjo formulë mund të vështrohet edhe si ajo e vetisë integrative të mohimit dialektik.*
4. Kjo formulë mund të interpretohet edhe si ajo e "hipokrizisë": *ndryshe paraqitesh jashtë... e ndryshe je brenda...* Me qenë se kjo formulë, siç pamë, bën pjesë në kodin F dhe me qenë se të gjitha figurat simbolike të këtij kodi, siç do të sqarohet më mirë më poshtë, janë ekuivalente mes tyre, del se kodi F (i mbështetur fuqimisht mbi Arsyen njerëzore, parimin e identiteti formal, llogjikën aristoteliane) është, si ndër shumë gjëra të tjera negative,** dhe ai i hipokrizisë.
- Del kështu pra, sado e çuditshme dhe e papranueshme që mund të duket, se një njeri i arsyeshëm s'mund të jetë veçse hipokrit.
5. Le të kujtojmë këtu diçka mbi prejardhjen e kësaj formule kaq të rëndësishme.

Nisemi nga ekuacioni i Qëndrës:

$$E = (x = -x)$$

Nga ana tjetër kemi:

$$F = (x = x)$$

- * Dhe Mefistofeli tek vepra "Faust" i Goethes flet në mënyrën e tij (poetike) për vetinë integrative të mohimit dialektik kur thotë:

*"Ich bin der Geist der stets verneint (-x)
Und das mit Recht weil Alles was entsteht,
Wert ist es zum Grund zu geht." (x)*

*...Unë jam Fryma që parreshtur mohon
Dhe me të drejtë, se gjithshka del
Duhet prapë në thelb me u mshelë...*

- ** Pamë se: $F = -1$.

që mund të shkruhet edhe si:

$$F = (x = - - x)$$

Pozojmë:

$$x = \text{jashtë}$$

$$-x = \text{brenda} = \boxed{x}$$

Duke zëvendësuar do të kemi:

$$F = (x = - \boxed{x})$$

ose edhe:

$$F = (-x = \boxed{x})$$

Një zbatim tjetër i rëndësishëm i kësaj formule mund të kërket me të thënë e famshme të Teilhard de Chardin:

"Dans le cœur de la matière, il y a l'Esprit."
(Në zemrën e materies qëndron Fryma.)

Vërtetësia e kësaj formule bëhet krejt e qartë duke marrë:

$$x = \bigcirc$$

E pra atëhere:

$$-x = - \bigcirc = \bullet$$

Këtu, sikurse do të shohim dhe më poshtë, \bigcirc mund të interpretohet si "Fryma", kurse \bullet si "Materia". Atëhere, duke bërë zëvendësimet, do të kemi:

$$\bullet = \boxed{\bigcirc} \quad \dots(F)$$

matière Esprit

Ky mendim i Teilhard de Chardin ka një karakter profetik, sepse i prin zbulimeve të Fizikës Kuantike lidhur me brendinë Spirituale të materies.

6. Formula $(-x = \boxed{x})$, që është ajo e Antitezës hegeliane, dhe që lidhet me kodin F, na jep edhe:

$$(-x = \boxed{x}) = F = \bullet, \text{ Bota, Realiteti Material}$$

Kjo na flet për përbotshmërinë e kësaj formule, për faktin, me fjalë të tjera, se asgjë materiale nuk mund ti shpëtojë asaj.

Nga ana tjetër, me qenë se:

$$F = (x = x) = \text{Llogjika Aristoteliane} = \text{Arsyeja Njerëzore}^*$$

kjo formulë na thotë se Antiteza është e "arsyeshme", se e tillë është atëherë edhe Materia dhe Materializmi, dhe se pra, sipas kësaj llogjike, Racionalizmi,** qoftë ai i Einsteinit a ai Marksit a ai Freudit, është i "arsyeshëm" e pra si i tillë i "pranueshëm", ndonëse lidhet drejt për së drejti, si do të shohim, me natyrën negative të materies ($\bullet = -1$).

* Le të kujtojmë këtu se në momentin e dytë të Triadës:

$$\begin{aligned} \text{Bota materiale} &= \bullet = -(x = -x) \\ &= (-x = \boxed{x}) = \text{Antiteza} = -\text{Teza} = -\text{'Coincidentia oppositorum'} \\ &= -\text{Harmonia} = \text{Dizarmonia} \end{aligned}$$

Pra mund të themi edhe se arsyeja e Dizarmonisë që vihet ré në Botë është pikërisht Arsyeja, që lidhet ngushtë me Antitezën, gjersa formula e Antitezës: $(-x = \boxed{x}) = (x = x) = \text{llogjika aristoteliane} = \text{Arsyeja}$.

Duke e zgjeruar Bisedën, themi se kjo është situata që krijon mospajtimi i Subjektit (e mbrendshmjia) me Objektin (e jashtëmjia), që dhe sjell kundërvënien, mosmarrëveshjen, luftën mes tyre, e pra, fundja më në fund, Dizarmoninë që sundon në Botën tonë materiale.

(shih edhe fq.19, 656, 677, 702 dhe 834)

** Nga lat. *ratio* = arsye...

Kurse ne dimë tashmë, nëpërmjet Fizikës Kuantike si edhe të gjitha *sciences des profondeurs* të Kohës sonë (si Psikologjia e Inkoshientit, si Genetika, Fillosofia e Avangardës, ajo e Heideggerit e Derridas,...), se Racionalizmi është teorikisht i superuar, ndaj dhe flitet sot për "*The Death of the Matter Myth*", "*The Death of Reason*."*

Një segment interpretativ i simbolit ○

Simboli ○ mund të interpretohet si *Zero (Hiç)*, *Infinit*, si *e Tërë*.

Për të vërtetuar se ○ mund të vështrohet si e Tëra, në një ballafaqim të drejtpërdrejtë me mendimin mistik, tek Cirlot** gjejmë lidhur me këtë simbol:

$$\bigcirc = \text{Infinity, the Universe, the All}$$


Që këndej del, ndër të tjera, edhe se *Qendra është e Tëra (e Gjitha)*.

Mund të shkruajmë pra:

$$\text{Qendra} = (x = -x) = \bigcirc = e \text{ Tëra}$$

Kemi kështu një segment semantik (konceptual, interpretativ) të simbolit ○.

Mund të paraqesim pra skematikisht:



* Shih gjithashtu fq.261, 537, 572 dhe 629.

** Cirlot, fq.118.

Pasurimi i mëtejshëm i spektrit të simbolit ○

Mund të shkruajmë:

○ = - ⊕, jo ndërprerje, jo fragmentarizëm, kontinuitet

○ = simboli i përsosjes*

○ = simboli i Qiellit**

○ = simboli i bardhësisë, i qartësisë***

○ = simboli i të mbarës (e mbara si *e tërë* dhe si *e mirë*)*

○ = simboli i Hyjnisë**

...

Duke qenë kështu, ndër të tjera, do të kemi edhe: - ○ = ●.

Një segment interpretativ i kodit F

Për kodin F do të kemi:

$$F = -E = -○ = \text{jo e Tëra} = \text{pjesa} = ⊕ \\ = \text{jo infiniti, jo universi}$$

* Arkeotipikisht, *përsosja* paraqitet një gjarpër që kafshon bishtin e vet, e pra simbolikisht ○. Nga ana tjetër, përsosja:

$$(\alpha = \omega) = (x = -x) = ○$$


** Cirlot (fq.62): "...the path of heaven is round..."

*** Po aty: "...the essence of the round is the clear..."

* Kujtojmë këtu dhe Inglishten: *whole* = e tëra, e mbara (ku "w" një komponente prostatike, e pra asemantike) dhe *holy* = e shenjtë, e mbarë.

** ○ = (x = -x) = *Coincidentia oppositorum* = DEUS

e pra skematikisht:



Parimi i Moskontradikcionit ($x = x$) dhe *Ligji i Shkakësisë* (\leftrightarrow)

Për ti krahasuar këto dy propozicione, ndërtojmë tabelat e tyre të vërtetësisë.

	x	x	$(x = x)$		p	q	$p \leftrightarrow q$
$T_{(x=x)}$:	I	I	I	$T_{(\leftrightarrow)}$	I	I	I
	I	-	-		I	-	-
	-	I	-		-	I	-
	-	-	I		-	-	I

Këtu p tregon "shkakun", ndërsa q efektin (pasojën). Rreshti parë i Tabelës na thotë: që mes p (një veprim) dhe q (një tjetër veprim) të ekzistojë një raport shkakësie, që me fjalë të tjera, p të jetë shkaku i q -së dhe q efekti i p -së, duhet që kur kemi p (I) të kemi edhe q (I) dhe anasjelltas. Në këtë rast ne mund të shkruajmë me plot të drejtë:

$$p \leftrightarrow q = I$$

Rrjeshti i dytë na thotë se: kur kemi p (I), por nuk kemi q (-) (kur p nuk ndiqet nga q), nuk kemi shkakësi ($- \leftrightarrow$).

Rrjeshti i tretë na thotë se: kur nuk kemi p (-) dhe kemi q (I), kur me fjalë të tjera, q nuk paraprihet nga p , nuk kemi shkakësi, pra nuk kemi raport shkak-efekt ($- \leftrightarrow$).

Rreshti i fundit na thotë se: kur nuk kemi $p(-)$, nuk kemi as $q(-)$, ka mundësi që mes p dhe q të ekzistojë një raport shkakësie: $p \leftrightarrow q$.

Ja, kjo është e gjitha...

Shikojmë se tabela e vërtetësisë të $(x = x)$ dhe ajo e \leftrightarrow janë identike.* Që këndej mund të nxirret konkluzioni se:

$$T_{(x=x)} = T_{(\leftrightarrow)}$$

që nga:

$$(x = x) = \leftrightarrow$$

Me *qenë se*: $(x = x) = \text{parimi i identitetit i llogjikës formale} = \text{vetë kjo llogjikë} = \text{Arsyeja Njerëzore}$, ne mund pra të themi se

"Parimi i shkakësisë buron drejtë për së drejti nga Arsyeja."

Prandaj dhe në vend të "për këtë *shkak*" thuhet dhe "për këtë *arsye*".**

* Në Llogjikën Matematike na thuhet se në qoftë se dy propozicione (pohime, ingl. *statements*) llogjike kanë tabela vërtetësie identike, atëhere ata mund të vështrohen si ekuivalente (të barazvlefshme), e pra dhe njëra mund të zëvendësojë tjetrën.

** Del që këndej, ndër të tjera, se Gjuha e ka ditur këtë. Ky shembull flet edhe për praninë e Algoritmit Simbolik në Gjuhë, në çdo gjuhë, siç do të shohim më bollshëm më vonë.

Le të nënvizojmë këtu edhe faktin se rënia e *parimit të shkakësisë* në Fizikën Kuantike sjell domosdoshmërisht me vete dhe rënien e *parimit të moskontradiksionit* e pra shkurt të *arsyes*. Mund të themi atëhere "paradoksalisht" se *Fizika Kuantike nuk është e arsyeshme*, se ajo nuk është racionale, sikundër Fizika Klasike. Por historia e shkencës tregoi se e vërteta që me Fizikën Kuantike e jo me Fizikën Klasike, se ajo që me Bohr-in e jo me Einstein-in e madh...

Algoritmi Simbolik dhe Llogjika Matematike

Algoritmi Simbolik megjithëse punon me simbole (arkeotipike) mund të "reduktohet", në një farë mënyre e me një farë teknike, në një tërësi propozicionesh llogjike.

Kjo do të na lejojë të kuptojmë e të vërtetojmë përse të gjitha figurat simbolike brenda të njejtit kod (qoftë E apo F) janë të gjitha ekui-valente mes tyre. Dhe ja se si:

Marrim simbolin \oplus .

Dimë se mund të shkruajmë:

$$\oplus = -\bigcirc^* = -(x = -x) = (x = x)$$

simbol propozicion
llogjik

Marrim tani simbolin \bullet .

$$\bullet = -\bigcirc^{**} = -(x = -x) = (x = x)$$

simbol propozicion
llogjik

Marrim simbolin \square .

$$\square = -\bigcirc^{***} = -E = F = (x = x)$$

simbol propozicion
llogjik

Si figurë simbolike mund të vështrohet edhe numuri 2. Le ta reduk-

* Me fjalë: gjysma (\oplus) si jo e tëra ($-\bigcirc$)

** Me fjalë: e zeza (\bullet) si jo e bardha ($-\bigcirc$)

*** Ky barazim është një zbatim i formulës: $-x = \boxed{x} \dots(F)$, ku " x " = \bigcirc .

tojme edhe ate ne nje propozicion llogjik. Do te kemi:

$$2 = -1^* = - \bigcirc = -(x = -x) = (x = x)^{**}$$

"simbol" propozicion llogjik

* Ne baze te formulës themelore te Arithmetikës Mistike, sipas te cilës: $3 = 0$, qe nga dhe: $2 = -1$, nje formulë kjo shumë e përhapur ne Gjuhë, sikundër edhe e kemi parë gjatë shtjellimit të tekstit.

Kujtojmë këtu për ata qe ndoshta nuk e mbajnë mend, se ne Inglisht ka dy fjale të ndryshme për numrin: *number* (dhe është fjala për numrin si sasi) dhe *figure* (dhe është fjala për numrin si strukturë). Numri simbolik tregon gjithnjë një strukturë, dhe kurrë një sasi. Prandaj dhe bie ndesh, jo më të rrallë, me rregullat e algoritmit numerik, arithmetikës së zakonshme. Siç pamë pak më lart:

$$-1 = F$$

kështu qe, edhe njësia negative, duke u vështruar si një figurë simbolike, del e reduktueshme, si të gjitha figurat e tjera simbolike qe pamë deri këtu, ne kodin F a ne ekuacionin $(x = x)$ të identitetit formal.

** Siç dimë dhe siç lexojmë ne mënyrë bindëse tek Cirlot (fq.232), numuri 2 është nga të gjithë bash më i keqi, bash më ogurzezi, shkurt e me një fjale numuri i Djallit dhe i materies. Duke qenë kështu, ekuacioni:

$$\text{Arsyeja} = (x = x) = 2 = \bullet$$

flet haptaz për ligësinë e Arsyes (2), për materializmin e Arsyes (\bullet).

Rikonfermohet kështu ajo qe thamë mbi Hipokrizinë e Arsyes (shih pak më lart, fq.811). Fizika Kuantike po ashtu na e rikonfermon këtë edhe, ndër të tjera, me:

"the Death of Matter Myth" = "the Death of Reason Myth"

Pra *materia*, e *keqja* dhe *arsyeja* janë lidhur ngushtë me njëra-tjetrën. A më troç janë, secila ne llojin e vet, e nejta gjë.

Marrim: $(\rightarrow\leftarrow) = (\mathbf{x} \neq -\mathbf{x}) = (\mathbf{x} = \mathbf{x})$
 "simbol" propozicion llogjik

Marrim: $\mathcal{X} = T\mathcal{X} = T(\mathbf{x} = \mathbf{x}) = (\mathbf{x} = \mathbf{x})$
 "simbol" propozicion llogjik

Marrim: $(\mathbf{x} \neq -\mathbf{x}) = -1 = -\bigcirc = -(\mathbf{x} = -\mathbf{x}) = (\mathbf{x} = \mathbf{x})$
 "simbol" propozicion llogjik

Akausaliteti, Mendimi Mistik dhe Fizika Kuantike

Tani le të vëmë ré edhe këtë, duke u nisur nga ekuivalenca e njohur:

$$E = -F$$

E pra atëhere, ndërsa:

$$F = (\mathbf{x} = \mathbf{x}) = \leftrightarrow$$

do të kemi:

$$E = -F = -(\mathbf{x} = \mathbf{x}) = (\mathbf{x} = -\mathbf{x}) = -\leftrightarrow$$

Kështu, të pozosh Qëndrën (*Coincidentia oppositorum*): $(\mathbf{x} = -\mathbf{x})$, a të pozosh "akausalitetin" (mos shkakësinë): $-\leftrightarrow$ është e "njejta" gjë.

Dhe sipas Ernst Cassirer, etnograf dhe fillosof i dëgjuar gjerman, mendimi mistik dhe mitik është pikërisht i tillë, do me thënë akauzal. Dhe në këtë përfundim, ndoshta edhe më parë se Cassirer, arrin edhe Lévy-Brühl në veprën e famshme të tij "*L'âme sauvage*", duke pohuar

Prandaj rënia e parimit të kauzalitetit në Fizikën Kuantike, gjë që edhe vetë Einsteini u detyrua ta pranojë (shih fq.78 dhe 420), solli me vete po në Fizikë Kuantike edhe rënien e parimit të mos kontradiksionit, të formulës $(\mathbf{x} = \mathbf{x})$, e pra të Arsyës.

mbi këtë se tek popujt e egër dhe primitiv, parimi i shkakësisë, që mungon, zëvendësohet me një tjetër, që Brühl e emërton "*principe de participation*" (Parim i Pjesëmarrjes).^{*} Por parimi i shkakësisë mungon edhe në Fizikën Kuantike e ai zëvendësohet edhe atje me Parimin e Pjesëmarrjes, gjë që e shtyn fizikantin e madh të kohës tonë Wheeler të flasi për një "*Participatory Universe*."^{**}

Kemi folur duke u zgjeruar në këtë pikë më parë, kur kemi hyrë në parashtrimin e aforizmave të Shqipes dhe interpretimet e tyre edhe në sfera të ndryshme të Realitetit. Sidoqoftë, le të theksojmë edhe këtu *se, këto koinçidenca të shumta (siç do të shikojmë) mes mendimit primitiv, arkaik dhe atij të shkencës e fillosofisë të Kohës sonë, shpjegojnë arsyen e një dyndjeje kaq të vrullshme, të pandalshme të Mendimit Mistik të Lindjes në Dijen bashkohëse të Perëndimit.*

Pasurimi i përmbajtjes së kodit F dhe kufizimet e tij

Me qenë se, siç dime: $F = -E$, do të jetë kështu: $F = -\bigcirc$ e pra atëhere e kundërt dhe me të gjitha figurat simbolike me të cilat \bigcirc , siç pamë më sipër, ishte ekuivalente. Do të kemi kështu:

$$\begin{aligned}
 F &= -\text{Pikë} = -(x^2 + y^2 = 0) = (x^2 + y^2 = r^2) = \text{periferia} \\
 &= -\bigcirc = \text{jo tanësi, pjesë} = \bigoplus = \text{jo bosh, plot} = -\bigcirc = \bullet = \text{materie} \\
 &-(x = -x) = (x \neq -x) = (x = x) = -\infty = \text{jo infinit, jo pafundësi,} \\
 &= \text{fundësi (it. finito)} = \text{jo hiç} = -\bigcirc = \text{diç} = \bullet = \dots
 \end{aligned}$$

Dhe mund të vazhdojmë kështu akoma, gjë që do ta bëjmë më pas

^{*} Shiko edhe fq.82-83.

^{**} Një univers në bërjen e të cilit kemi dhe ne pjesën tonë...
Lidhur me këtë çështje shih gjithashtu fq.427, 628 dhe 647.

kur të rrjeshtojmë veç të gjitha figurat simbolike në E dhe ato në F.

Po dhe nga kaq sa pamë dalin shumë gjëra me rëndësi... Kështu, për shembull, $F = (x = x) = \textcircled{1}$ na thotë se llogjika formale, e pra Arsyeya njerëzore $(x = x)$ mund të studjojë e të kuptojë vetëm një pjesë ($\textcircled{1}$) të së Tërës ($\textcircled{0}$), të krejt Realitetit.* Dhe nga ana tjetër, me qenë se:

$$(x = x) = \textcircled{1} = \leftrightarrow = \bullet = \dots(F)$$

* Tërësia është e para, para fillimit a krijimit të Botës. Në Shqip, kjo e vërtetë e thellë jepet me "çiftin ekuivokal":

$$\begin{array}{ccc} \textcircled{0} & = & 1 \quad \dots(E) \\ \text{krejt} & & \text{kreu} \end{array}$$

Këtë gjë na thotë edhe Goethe në veprën e tij *Faust*, nëpërmjet personazhit të Mefistofelit, që jep këtë vetë-përcaktim:

*"Ich bin ein Teil des Teiles,
Der in Anfang ein Ganzes war..."*

Pra, flitet dhe këtu për një tanësi para krijimit të Botës, para fillimit të Kohës, e pra simbolikisht $\textcircled{0}$ (gjerm. *Ganze*), dhe për ndarjen e të Tërës e pra simbolikisht $\textcircled{1}$ (gjerm. *verteilen, Teil*).

Edhe tek Heidegger gjejmë të njejtën gjë kur ai pohon se në fillimin pa fillim ka qenë Hiçi, e pra simbolikisht $\textcircled{0}$, dhe më vonë, me krijimin e Botës, ai u mohua, $-\textcircled{0}$, e pra simbolikisht (sipas Algoritmit Simbolik, siç do ta shohim më vonë):

$$\begin{aligned} \textcircled{1} \text{ (pjesë, gjerm. Teil)} &= 1/2 \\ &= -1 = 2 = \bullet \text{ (materia, Bota materiale)} = -\textcircled{0} \end{aligned}$$

Pra siç shihet, fillimi nis me gjysmën ($1/2$), me një kundërshti, me një negativitet (-1), me dyshin (2) që është, siç dimë, edhe numuri i *Magna Mater* (Cirlot, fq.232), d.m.th. i materies, i Botës materiale (\bullet).

ne gjejmë se:

- 1) Materia dhe Bota materiale (●) përbëjnë vetëm një pjesë (⊕) të së Tërës. Gjë që do të thotë se Universi nuk përbëhet vetëm nga materia.
- 2) Se parimi i shkakësisë (↔), ashtu si edhe Arsyeja ($x = x$), a e thënë ndryshe llogjika e të Tretit të Përrjashtuar, vlen, funksionon vetëm për një realitet material (●).
- 3) Mund të shkruajmë:

$$\oplus = \leftrightarrow \quad \dots(F)$$

që nga duke shumëzuar të dy krahët e këtij barazimi me -1 , do të kemi:

$$-\oplus = -\leftrightarrow \quad \dots(E)$$

Duke interpretuar \oplus si një pjesë të së Tërës (që do të paraqitet simbolikisht me \bigcirc), del se parimi a ligji i shkakësisë funksionon vetëm në një pjesë të së Tërës.

Duke interpretuar \oplus si kufi, si cak... mund të shkruajmë:

\oplus = cak, përcaktim, përcaktueshmëri, parimi i përcaktueshmërisë a i determinimit, të cilit i përmbahet rreptësisht tërë Shkenca Klasike, ku parimi i shkakësisë është kurdoherë funksionues dhe i patundur.

Në qoftë se tani interpretojmë simbolin $-\oplus$ si jo cak, jo përcaktim, jo përcaktueshmëri = jo parim i përcaktueshmërisë = parimi i papërcaktueshmërisë në Fizikën Kuantike... ne mund të shkruajmë atëhere:

$$\begin{aligned} \text{Fizika Kuantike} &= \text{Parimi i Papërcaktueshmërisë} = -\oplus \\ &= -\leftrightarrow = \text{jo Ligji i Shkakësisë} \end{aligned}$$

Gjejmë kështu *thjesht e vetëm llogjikisht* një të vërtetë të madhe dhe themelore: *mosfunksionimin, rënien e ligjit të shkakësisë në Fizikën Kuantike*, gjë që edhe vetë Einsteini, armik i betuar i Fizikës Kuantike dhe më tepër e mbi të gjitha i Frymës të saj, u detyrua ta pranojë.*

Bëmë kështu këtu, ndër të tjera, një ekspozim vërtetë të shkurtër, por krejt të saktë dhe konkret, të rëndësisë *euristike* (zbuluese) të atyre pak njohurive që ne gjer këtu arritëm të mbledhim (përmes elementeve fillestare të Algoritmit Simbolik) nga thesari i pashtershëm dhe ende i pazbuluar i Fillosofisë të Përjetshme (*Philosophia Perennis*).** Por, sidoqoftë, nuk mund të rrimë pa thënë se *kjo* është deri diku veç një përsëritje e atyre që janë parashtruar tashmë gjerë e gjatë e me tërë saktësinë e duhur në *Librin e Aforizmave*.

...Por le të fitojmë tani kohën e humbur, se mbetëm *ca prapa*, duke rënë në ngasjen e zbatimit tashmë të kryer të rezultateve herë-herë krejt të papritura në të cilat ndeshim (a më saktë "përplasemi") si duke u tallur gjatë parashtrimin të Algoritmit Simbolik... Por kjo ndodh edhe sepse ne e dimë rëndësinë e tyre, një rëndësi që guxojmë ta quajmë, pa një pa dy, e pa një modesti fallso, *e p o k a l e*.

Simboli \times dhe interpretimet e ndryshme të tij

Le të shqyrtojmë tani një figurë tjetër simbolike që do ta tregojmë me " \times " e që është në të njejtën kohë edhe një propozicion llogjik, ai i *Conjunctio*, ose siç i thonë edhe ndryshe, ai "*edhe... edhe...*" (Latinisht: "*et... et...*"). Ai flet për praninë e njëkohshme të dy sendeve të ndryshme, për ndodhjen e njëkohshme të dy ngjarjeve të ndryshme...

* Shih pak më lart, fq.820.

** Shiko gjithashtu fq.3, 80 dhe 365.

Edhe ai, ka si çdo propozicion tjetër, tabelën e tij të vërtetësisë e cila me simbolet tona ("I" në vend të "T" dhe "-" në vend të "F") do të paraqitet si:

p	q	$p \& q$
I	I	I
I	-	-
-	I	-
-	-	I *

Shohim kështu se:

$$T(\&) = T(x=x) = T(\leftrightarrow)$$

Dimë se, dy a më tepër propozicione llogjike me tabela vërtetësie identike duhen vështruar si ekuivalente. Ky është rasti këtu... Pra dhe mund të shkruajmë:

$$\& = (x=x) = \leftrightarrow = \oplus = \bullet = -\circ = \dots(F)$$

Dhe me qenë se: $E = -F$, do të kemi atëhere detyrimisht:

$$-\& = (x=-x) = -\leftrightarrow = -\oplus = -\bullet = \circ = \dots(E)$$

Kemi kështu një varg edhe më të gjatë ekuivalencash në F dhe në E.

* Mund të sillet si arsye a justifikim për këtë ndryshim të rrjeshtit të fundit të tabelës së vërtetësisë të këtij propozicioni të *disjunctio* (\vee) se, siç e tregon vetë fjala, duhet të jetë i kundërt në çdo pikë me *conjunctio* ($\&$), gjë që kërkon ndryshimin pra të rrjeshtit të fundit të tabelës së vërtetësisë të kësaj të fundit nga:

-	-	-
---	---	---

në:

-	-	I
---	---	---

Spektri semantik i një simboli

Një simbol i vetëm mund të interpretohet në mënyra të ndryshme, mënyra që përbëhen nga *rrezet semantike** a kuptimore të simbolit në fjalë. Mund të flitet pra kështu për *polisemantizmin* e një simboli. Dhe kjo ndodh sepse një simboli të vetëm mund ti përgjigjen një sërë konceptesh të ndryshme, gjë që do të thotë se *korrispondenca mes simbolit dhe konceptit nuk është univoqe por plurivoqe*.

Por ne e kemi trajtuar tashmë këtë çështje edhe në Studimin tonë. Këtu vetëm sa e çikëm...

Le të ndërtojmë tani një segment të *spektrit semantik* të simbolit \otimes .

Ky simbol, siç shihet qartë, mund të jetë fare mirë ai i *lidhjes* e pra atëhere edhe ai i *skllavërisë*. Me qenë se edhe ligji nuk është *tjetër*, në fund të fundit, veçse një *lidhje* që supozohet e qëndrueshme *mes* dy koncepteve, ngjarjeve etj., po ky simbol mund të përfaqësojë fare mirë edhe konceptin e *ligjit*... Ja pra atëhere përse në Italisht *legare* = lidh, e pra \otimes , dhe, në të njejtën kohë, *legge*...

Po i njejtë simbol \otimes mund të interpretohet edhe si *përbërje*, një send a diçka tjetër jo e thjeshtë por e përbërë, si *përzierje*... si *relativitet*...,** si *ngatrrësë*..., si *nyje*..., si *mvarësi*..., Por, po ky simbol mund të interpretohet edhe si *kapje*, *zënie*... si *thurrje*... si *seks*... miti kozmogonik i *Hieros Gamos* (miti botëbërës i "Martesës së Shenjtë")...

* Kuptimet, interpretimet e ndryshme të të njejtit simbol... Në analogji me optikën, quajmë "spektër semantik" tërësinë e kuptimeve ("rrezeve") të të njejtit simbol.


** Kujtojmë se në Latinisht: *relatio* = lidhje, që nga *relativ* = i varur, i kushtëzuar... dhe në Anglisht: *relative* = farefisni, kushurin, etj...

Mund të shkruajmë pra:




Spektri semantik i disa figurave të tjera simbolike

Le të ndërtojmë tani një segment të spektrit semantik të simbolit ● :



si edhe një segment të spektrit semantik të simbolit \oplus :



Duke interpretuar \ominus si e Tëra, e pra atëhere \oplus si gjysma, mund të shkruajmë:

$$\oplus = -\ominus$$

Por \ominus e interpretuar si Hiçi, e pra *zero* ose edhe *infiniti* ($0 = \infty$), mund të vështrohet si zgjidhja e ekuacionit të Qendrës ($x = -x$) e jemi pra kështu në kodin E. Nga barazimi i mësipërm del atëhere se:

$$\oplus = -\ominus = -(x = -x) = (x = x)$$

Dhe jemi kështu në kodin F, në atë të llogjikës formale a atë të Tretit të Përrjashtuar. Mund të shkruajmë pra atëhere:

$$\oplus = (x = x) = F$$

Me qenë se pamë që:

$$\oplus = -\ominus = \infty = \bullet \quad \dots(F)$$

nga ekuivalenca e këtyre simboleve do të dalë edhe ekuivalenca e rrezeve të tyre semantike. Kjo do thotë që, për shembull, nga $\oplus = \bullet$

rrjedhin llogjikisht edhe të tilla ekuivalenca konceptuale si:

$\textcircled{1}$	=	\bullet	...(F)
ndarja shq.		ndyrja shq.	
matja shq.		materia shq.	
matra skr.		matra skr.	
pjesë shq.		pis shq.	
...		...	

Dhe vazhdojmë tani më tej në ndërtimin e Algoritmit Simbolik si artikullim llogjik i Mendimit të lashtë Mistik.

Pamë se të gjitha figurat simbolike në kodin F qenë të reduktueshme në propozicione llogjike e madje, aty-këtu, në po ato të llogjikës matematike. Kjo bën që të gjitha ato të jenë ekuivalente mes tyre, si propozicione që kanë të njejtat tabela vërtetësie.

Nga ana tjetër, simboli është një tjetër realitet, krejt i kundërt (a fundja "komplementar") me realitetin konceptual. Pra dhe korrisondenca, për pasojë, mes simbolit dhe konceptit, është plurivoke, gjë kjo që e bën simbolin shumë më superior dhe pjellor se koncepti. Le të bisedojmë pak për të dy këto kategori.

Tek Jean Chevalier (*Un dictionnaire des symboles*) na thuhet: "*La logique du symbole c'est la logique du Tiers Inclus.*" Pohohet pra përkatësia e simbolit në kodin E. Dhe më tej: "*Le symbole abat les murs*", që do të thotë se simboli shemb çdo kufi, pra dhe referon tek $-\textcircled{1}$ dhe jo tek $\textcircled{1}$. Kurse ndryshe puna e konceptit... Ai ka nevojë të përcaktohet. Por, siç thotë Spinoza: "*Omnis definitio est negatio*", që simbolikisht do shkruhej: $\textcircled{1} = -1$. Kështu pra, koncepti është i kufizuar, i përcaktuar, negativ, kurse simboli është i pakufizuar, i papërcaktuar dhe pozitiv.


Mund të shtojmë këtu edhe diçka tjetër lidhur gjithnjë me simbolin, përsëri nga Jean Chevalier: "...*Qui découvre une relation entre deux symboles, se trouve au Centre de l'Univers...*" Por "le Centre de l'Univers" është thjeshtë Qendra Mistike, Fryma e Shenjtë, Zoti. Kështu që, një Dituri simbolike, siç është ajo e Algoritmit Simbolik, nuk ka se si të jetë ndryshe veçse *Hyjnore* dhe si e tillë *Absolute*, e *pagabueshme* dhe e *pavdekshme*. E njehta gjë s'mund të thuhet për Dijen konceptuale, Dijen e shkencës klasike, që është *relative*, e *pasigurtë*, e *përkohshme* dhe *mashtuese*.

"Bashkëpunimi" i simbolit me konceptin

Duke qenë i pakufizuar, del vetvetiu se simboli mund të ketë, në përgjithësi, jo vetëm një kuptim, por shumë kuptime. Çdo kuptim i përgjigjet një koncept i veçantë. Që këndej edhe *spektri konceptual* a *semantik* i një simboli. Le ta ilustrojmë këtë me ndonjë shembull.

Marrim simbolin \oplus . Ai si i tillë, në bazë të atyre që thamë pak më sipër, do të ketë disa kuptime. Korrispondenca e tij me konceptin nuk është univoqe, po plurivoqe.

Këtë situatë, për dy simbole çfarëdo, mund ta paraqesim kështu:



Le të supozojmë se këto dy simbole janë ekuivalente. Të tilla do të

jenë edhe rrezet e tyre konceptuale a semantike, d.m.th. konceptet e ndryshme që u korrispondojnë atyre. E paraqesim këtë situatë kështu:

$$\begin{aligned} X &= Y \\ \downarrow \\ x_p &= y_q \end{aligned}$$


ku, me "X" e "Y" janë treguar simbolet ekuivalente, kurse me " x_p " dhe " y_q " tregohen rrezet semantike (konceptuale) të këtyre simboleve, që janë edhe ato, për rrjedhim, ekuivalente mes tyre.

Një shembull konkret do të na sqarojë për se është fjala praktikisht.


Marrim:

$$X = \oplus \text{ dhe } Y = \bullet$$

Konsiderojmë spektrat semantike të këtyre dy simboleve:



ndërsa për simbolin tjetër kemi:



Tek formula $x_p = y_q$ u japim vlera të ndryshme "p"-së dhe "q"-së, duke përfshirë edhe vlerën zero për njëren prej të dyjave ($p = 0, q \neq 0$, edhe $p \neq 0, q = 0$). Formohen kështu pohime apodiktikisht të vërteta.

Le ta provojmë:

$$x_1 = y_7$$

Zëvendësojmë vlerat e tyre:

$$matja = materia$$

dhe interpretojmë:

1) "matja" krijon "materien"

Kjo është një e vërtetë që po triumfon sot në Fizikën Moderne, falë punimeve dhe zbulimeve shkencëtarësh të tillë të mëdhenj si Wheeler etj. Gjetëm kështu pra një propozicion jo vetëm të vërtetë, por jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe aktual.

Vazhdojmë me ndonjë tjetër interpretim...

2) Realiteti material (y_7) ka një kufi (x_7).*

* Një konfirmim të rëndësishëm të këtij përfundimi e gjejmë si në Shkencën moderne, ashtu edhe në fusha të tjera të Dijes, si bie fjala në Fillosofi:

- Bota ka një kufi në Kohë dhe në Hapësirë ($t \neq 0, s \neq 0$)... hipoteza e *Big Bang*-ut.
- Mund të përmendim këtu edhe faktin se aty rreth viteve '60, shkencëtarët Rusë deklarorin se: "*Mir eto ne vse mir*" (Bota nuk është tërë bota). Kjo u konfirmua nga zbulimet teorike mbi vrimën e zezë dhe mbi *Big Bang*-un dhe *Big Crunch*-in.
- Shpejtësia e Dritës (c) është kufiri që ndan botën e Fizikës Klasike nga ajo e Fizikës Kuantike. Kështu që mund të shkruajmë:

$$\text{Fizika Klasike} \leq c$$

$$\text{Fizika Kuantike} \geq c$$

Einsteini nuk mund të pajtohej kurrësesi me kapërximin e shpejtësisë së Dritës. Dhe kjo sipas tij me "të drejtë", ngaqë ai nuhaste se me një pajtim të tillë do të shembej gjer edhe vetë Teoria e Relativitetit, sikundër Algoritmi Simbolik na jep të kuptojmë fare qartë:

$$> c = -\textcircled{1} = -\bullet = -\text{X} = -\text{Teoria e Relativitetit}$$

Por sidoqoftë, Teoria e Relativitetit mbetet e vërtetë dhe e zbatueshme brenda kuadrit të Fizikës Klasike, që do të thotë brenda kësaj Botës tonë materiale. (shiko lidhur me këtë çështje edhe fq.587-588)

- Kufiri për të cilin bëhet fjalë këtu "transferohet" edhe në sfera të tjera të Dijes. Kështu, në fillosofi Kanti vendos një *kufi* midis *fenomenit* (për ne: kodi F) dhe *noumenit* (për ne: kodi E).
- Për fizikantin e shquar David Bohm, kufiri ai është mes "*Explicate Order*" (për ne: kodi F) dhe "*Implicate Order*" (për ne: kodi E).

dh) Për Hegelin, kufiri është ai mes Tezës dhe Antitezës.

....

Vëmë në dukje tani këtu se për Algoritmin Simbolik, *të gjithë këto kufij janë i njejtë kufi (llogjik): ai mes kodit F dhe kodit E.*

Kjo do të thotë, për shembull, atëhere se:

Teza (Hegel) = Noumeni (Kant) = Implicate order (Bohm)

Antiteza (Hegel) = Fenomeni (Kant) = Explicate order (Bohm)

E kështu me radhë...

Barazimi i të gjithë këtyre kategorive qëndron në atë që mund të quajmë, në mënyrë ndoshta jo krejt të saktë, "Identitet Struktural", "Izomorfizëm", "Korrispondencë Analogjike".

Këtu mund të theksojmë edhe faktin e ekzistencës të një **Dikotomie** Universale, që përfshin çdo sistem njohës, pamvarësisht nëse ai bën pjesë në Fizikë, apo në Theologji, apo në Psikologji e kështu me radhë. Të gjitha dikotomitë, pa marrë parasysh sistemin ku ato realizohen, janë në thelb të barabarta.

Kjo është një e rë e rëndësishme që ky Studim ndër të tjera komunikon.

Kështu del e vërtetë dhe e thëna e famshme e Leibnitz-it që të gjithë fillosofët kanë të drejtë për sa pohojnë dhe nuk kanë të drejtë për sa mohojnë. Kjo do të thotë, më në fund, se të gjithë fillosofët thonë të njëjtën gjë, ndonëse në forma, në dukje, të ndryshme.

Mos harrojmë këtu se Dituria jonë është ajo e simboleve (Mendimi Mistik) dhe se, nga ana tjetër, *simboli shemb muret, ndarjet* (gjë që simboli kisht jepet me $-\textcircled{1}$) mes shkencave, fillosofëve dhe çdo sistemi tjetër njohës. Sa thamë gjen një rikonfermë "zyrtare" edhe në përpjekjet sot, për të realizuar një Interdisiplinaritet konkret e të besueshëm.

(shih gjithashtu fq.263 dhe 422)

3) Mëkati (y_5) është ndarje (x_2) nga Zoti.*

4) Një shkencë deterministe (x_9) nuk mund të jetë
veçse materialiste (y_7).**

* Konfirmime të këtij pohimi janë, ndër të tjera:

- a) Dogma e *peccatum originalis* (mëkati në origjinë, në zanafillë të krijimit të Botës).
- b) Hipoteza theollogjike e ekzistencës të "djallit", i cilësuar edhe si një *demon*. fjalë kjo që i ka rrënjët në Shqipen *i damuni* që përbën vetë përcaktimin më të saktë të "largqoftit". Shtojmë këtu se nga ky përcaktim i djallit, *i damuni* (nga Zoti), rrjedhin një tok fjalësh si: në shq. *dani*, it. *danno*, ingl. *to condemn*, it. *dannare*, ingl. *damn*,...
- c) Fillosofia ekzistencialiste shtron këtë ekuacion:

$$la\ condition\ humaine = finitude\ humaine$$

E përkthyer në gjuhën e Algoritmit Simbolik, ky pohim do të japë (duke patur parasysh edhe që, sipas Cirlot, "*the number F i v e is the number of Man after the Fall*"):

$$\begin{aligned} numuri\ simbolik\ i\ Njeriut,\ pas\ Rënies &= 5\ (condition\ humaine) \\ &= 0.5 = 1/2 = \textcircled{1}\ (finitude) \end{aligned}$$

Ky pohim i Ekzistencializmit mund pra, siç pamë, të "algoritmizohej", që do të thotë, të pozonte një ekuacion simbolik.

Si rregull e përgjithshme është se: porsa që një pohim çfarëdo në çdo fushë të Dijes qoftë, të mund të "algoritmizohet", ai duhet të jetë i vërtetë (Algoritmi Simbolik si *kriter vërtetësie*, shih fq.281). Prandaj pra dhe Ekzistencializmi modern ka qëlluar këtu drejt...

** Determinizëm do të thotë *përcaktim, kufizim*... Pra, simbolikisht $\textcircled{1}$. Ky simbol bën pjesë në kodin F, ndaj pra dhe do të jetë ekuivalent me të gjitha figurat simbolike dhe rrezet e tyre semantike të këtij kodi.

5) Çdo dije fragmentare (x_3) s' mund të jetë veçse djallëzore (y_6).*

6) Bota materiale (y_7) është kryer me një ndarje (x_3).**

Ndër to është edhe simboli ●, që është i interpretueshëm ndër të tjera edhe si *materie*. Shtojmë këtu se të gjitha "faktet" themelore të Fizikës Klasike janë të përfshira në kodin F. Nuk kemi veçse, siç kemi treguar në *Librin e Aforizmave*, të bëjmë interpretimin e tyre të saktë në dimensionin e Fizikës.

* Mund të shkruajmë:

fragment = pjesë = ⊕ = F = ● = e zeza, e keqja, Djalli

Shih lidhur me këtë çështje edhe Cirlot (fq.80), ku na thuhet se: *"The aim of the devil is regression or stagnation in what is fragmentary, inferior, diverse and discontinuous..."* Simbolikisht do të mund të shkruanim:

the Devil = ● = -1 = ⊕ = ↓ = -○
regression fragmentarity inferiority discontinuity

** Kujtojmë këtu si rikonfermë, të thënë themelvënëse të Paracelsit:

"Die *Separatio* ist aller Geburt Anfang"...

Gjuha na e jep bukur këtë të vërtetë. Kështu, p.sh. në Rusisht:

⊕ = ●
delits (делить) *delats* (делать)
 (ndarje) (bërje)

Edhe Shqipja, me:

⊕ = ●
ndarje *ndërtim*
thymje *themelim*

... ..

si edhe në shumë mënyra të tjera na rikonfermon të njëjtën gjë...

7) Bota materiale (y_7) është vetëm një pjesë (x_3) e të Tërës.*

Që Bota është krijuar me një ndarje apo me një thyerje, këtë e gjejmë edhe në Misticizmin e lashtë Hebrë (shih gjithashtu fq.210 dhe 579).

Kjo e vërtetë del në pah edhe në Gjermanisht, sepse në këtë gjuhë kemi:

$$\textcircled{1} = -1 = \bullet \quad \dots(F)$$

brechen Aufbruch

• Mund të shkruajmë:

$$e \text{ Tëra} = \bigcirc = E$$

$$\text{Bota materiale} = \bullet = F = \textcircled{1} = \text{pjesë}$$

Thelbesojmë këtu se edhe çdo kalim nga E në F, siç ndodh dhe këtu, është një *mit kosmogonik*, skema e përgjithshme e të cilit është:

$$E \downarrow = F$$

Atëherë pra mund të shkruajmë edhe:

$$\bigcirc \downarrow = \textcircled{1}$$

Kështu, krijimi i Botës bëhet me një *pjesëtim*, me një *copëtim*, me një *ndarje*, me një *kufizim* etj. etj.... të të Tërës...

Sipas Hegelit (dhe jo vetëm sipas atij), vetëm e Tëra është e Vërtetë (me të vërtetë reale). Prandaj, duke qenë kështu:

$$pjesa = \textcircled{1} = -\bigcirc = \text{jo e Tëra} = \text{jo e Vërteta} = \text{jo me të vërtetë reale}$$

Mund të shkruajmë gjithashtu edhe:

$$\begin{aligned} pjesa &= \textcircled{1} = \bullet = \text{materia} = \text{Bota materiale} \\ &= \text{jo e Vërtetë, jo me të vërtetë reale, e rreme, iluzore!} \end{aligned}$$

Në këtë përfundim ka arritur sot, sa do e çuditshme që mund të duket, edhe shkenca e avangardës, Fizika Kuantike.

Shtojmë këtu, tangjencialisht, se vetë fjala "pseudo", fallco, e rreme...

8) Bota materiale (y_7) është pjellë e matjes (x_1).*

mund ta ketë prejardhjen e saj nga Shqipja "pjesë" (\oplus) ose, ç'është njëlloj, "pesë" (5). Dhe kjo sepse:

$$5 = 1/2 = \oplus = -\ominus = \text{jo e vërtetë} = \text{pseudo}$$

Prandaj dhe sot shkenca dhe fillosofia e avangardës i kanë sytë të kthyer nga "HOLIZMI" (shiko edhe shënimin fq.64), fjalë kjo që rrjedh nga Greqishtja *holos* (όλος) = e Tëra. Ky është një tjetër rikonfermim "zyrtar" i saktësisë të përfundimeve të rëndësishme që ne nxorrem duke u mbështetur vetëm tek Algoritmi Simbolik, i cili, siç shikojmë dhe këtu, mund të funksionojë gjithmonë si një *kriter vërtetësi*, gjë që do të thotë që "prodhimet" e tij janë gjithmonë apodiktikisht të vërteta. Jashtë temës, shtojmë dhe diçka tjetër.

Me qenë se:

$$\text{diversity} < \text{division} = \oplus = F = \neq 1 = -E = - \text{Qendra Mistike} = - \text{Zoti}$$

Ne atëhere mund të themi se, larmia që vihet ré në mendimin fillosofik, si edhe në atë shkencor, është e justifikuar vetëm nga pikëpamja e kodit F, i cili është një kod negativ, e pra edhe i rremë. (shih fq.810)

Kështu që fakti i një përputhjeje të mendimeve, tezave, pohimeve fillosofësh e shkencëtarësh të ndryshëm, që kanë jetuar madje edhe në vende e epoka të ndryshme, flet qartë për faktin se *kjo larmi (diversitet) është vetëm një iluzion, sepse ata thonë, nga pikëpamja e kodit E (e pra e Qendrës, e pra e Zotit) që të gjithë, në trajta të ndryshme, të njejtën gjë.*

* Në Sanskritisht fjala "matra" do të thotë në të njejtën kohë edhe *matje*, edhe *materie*. Kështu Sanskritishtja shtron ekuacionin simbolik:

$$\begin{array}{ccc} \oplus & = & \bullet & \dots(F) \\ \text{matra} & & \text{matra} & \end{array}$$

Siç dimë, ky ekuacion jepet dhe në shumë mënyra të tjera nga Gjuha.

Marrim: $X = \oplus$ dhe $Y = \otimes$

x_p : $(x_1) = \text{ndarje}$, $(x_2) = \text{cak}$, $(x_3) = \text{pjesë}$, $(x_4) = \text{determinim}$,
shkencë deterministe... $(x_5) = \text{matje}$, $(x_6) = \text{madhësi}$...

y_q : $(y_1) = \text{lidhje}$, $(y_2) = \text{ligj}$, $(y_3) = \text{relativitet}$, $(y_4) = \text{përbërje}$,
 $(y_5) = \text{përzierje}$, $(y_6) = \text{ngatrrësë}$, $(y_7) = \text{skllavëri}$...

Por, ajo që na intereson këtu është ky fakt tepër i rëndësishëm, sipas të cilit edhe Fizika Kuantike, shkencë pararojë e kohës sonë, arrin në të njëjtin përfundim si edhe Fillosofia e lashtë Indo-Europiane, se me fjalë të tjera *është matja ajo që krijon materien dhe tërë realitetin material*. Këtë tezë e gjejmë, të vërtetuar edhe eksperimentalisht, për shembull, tek Wheeler:

Kjo do të ishte pra një "shenjë" kuptimplote që do fliste për një "kthim" në të kaluarën e lashtë të Dijes njerëzore. Kuptojmë atëhere edhe përse fillosofi të shquar si Nietzsche, Mircea Eliade, Fritjof Capra etj. flasin për një "*Éternel Retour*." (shih fq.33 dhe 362-363).

Le të shtojmë këtu, më tepër si një "kuriozitet", edhe këtë "zbulim" të Shqipes, ku aforizmatikisht kemi:

"Çdo matje është e metë."

Nga ana tjetër, *matja = materia* (në Sanskritisht, bisemia e fjalës "matra"). Si përfundim pra, *gjersa çdo matje është e metë*, edhe *vetë materja është e metë*. Gjë që është konform realitetit, me qenë se mund të shkruajmë:

materia = ● = ⊕ = - ○ = jo e Tëra, e metë

Kështu shpjegohet edhe "*The Death of Matter Myth...*" Që do të thotë, *materia jo më si një referencë vërtetësie...*

Fizika Kuantike, siç dihet, arrin po në këtë përfundim me Parimin e Papërcaktueshmërisë së Heisenbergut. (shih fq.429, 486 dhe 592)

Tani disa pohime:

1) Çdo lidhje (y_1) është një skllavëri (y_7)*.

$$\text{X} = \text{X}$$

2) Një shkencë deterministe (x_4) është edhe relativiste (y_3).

$$\text{O} = \text{X}$$

3) Ligjet (y_2) janë relative (y_3).

$$\text{X} = \text{X}$$

4) Çdo matje (x_5) është relative (y_3).

$$\text{O} = \text{X}$$

5) Çdo madhësi (x_6) është relative (y_3).

$$\text{O} = \text{X}$$

6) Koncepti i ligjit (y_2) është funksionues vetëm në një shkencë deterministe (x_4).

$$\text{X} = \text{O}$$

.....

Dhe mund të vazhdohet kështu me të tjera interpretime të simboleve X dhe Y, me të tjera vlera për p dhe për q.

Le të marrim tani një tjetër ekuacion simbolik:

$$\bullet = \text{X} \quad \dots(\text{F})$$

Do të kemi ndër të tjera në këtë rast, duke përsëritur procedurën që u ndoq në dy shembullat e mëparshme e "duke i rënë disi shkurt":

1) Materia dhe Bota materiale (\bullet) kanë ligje (X).

* Këtu: $p = 0, q \neq 0$.

- 2) **Materia (●) është e përbërë (⌘), ashtu si edhe gjithshka në Botën materiale.***
- 3) **Në Botë (●) s'ka liri (⌘ = -(-⌘)), por vetëm domosdoshmëri (⌘).****
- 4) **Gjithshka në këtë Botë (●) është relative (⌘).*****
- 5) **Mund të flitet për mallkimin (●) e ligjit (⌘).***

...

* Në kapitullin *Antinomitë e Arsyës* nga libri "*Kritika e Arsyës së Pastër*" i Kantit, në antitezën e antinomisë së dytë na thuhet:

"No composite thing in the world is made up of simple parts, and there nowhere exists in the world anything simple."

Fjalët e Buddës:

"Mos harroni, o vllazër, se çdo gjë e përbërë është e destinuar të çpërbëhet."

Kjo do të thotë se Buddha është për: - ⌘ (jo përbërje). E pra atëhere edhe për: - ● (jo Botë materiale) = Nirvana = kodi E = Qendra Mistike, Parajsa (shih *Qendra Mistike*, fq.787). E thënë ndryshe, Buddha, ashtu si Krishti, kritikon, mohon kodin F (⌘, ●...) e nxit për tek kodi E (-⌘, -●...). Del kështu se Buddha dhe Krishti thonë në vija të përgjithshme dhe në esencë, të njejtën gjë. (shih lidhur me këtë edhe fq.360 dhe Marcus Borg: "*Jesus and Buddha: The parallel sayings*", 2004)

** Shiko Hermes Trismegistus, sentenca 55 (shih edhe fq.357).

Bota materiale = ● = kodi F = ⌘ = -(-⌘) = jo liri, domosdoshmëri

*** Ky mund të vështrohet një përgjithësim i Teorisë së Relativitetit, duke përfshirë jo vetëm madhësitë fizike, por gjithshka.

* Kujtojmë këtu shën Palin: "*Krishti na shpëtoi nga mallkimi i ligjit*", si edhe aforizmën: "*Ligji nga i Ligu.*"

Mund ti trajtojmë punët edhe ndryshe:

Me qenë se siç pamë çdo figurë simbolike (a më sakt çdo rreze semantike e çdo figure simbolike) e kodit F reduktohet në një propozicion llogjik, dhe me qenë se pasqyrat e vërtetësisë të këtyre propozicioneve janë të gjitha të barabarta mes tyre, ato atëhere të gjitha do të jenë atëhere ekuivalente me njërën cilëndo prej tyre, si për shembull me \bullet , apo me \times , apo me \square , apo me \oplus ... e kështu me radhë.

Duke e nxjerrë një prej këtyre figurave në "faktor", do të kemi suksesivisht: F (të gjitha simbolike në F pa një, pra pa atë që nxirret në "faktor"...) = \bullet , ose \times , ose \oplus , ose \sim , ose \leftrightarrow , ose ...

Kështu do të kemi atëhere, ndër të tjera:

$$(F = \sim)$$

që do të thotë që të gjitha rrezet semantike të të gjitha interpretimeve konceptuale të të gjitha figurave simbolike në F janë të ndryshueshme.

Do të jetë të jetë atëhere:

$$\bullet = \sim$$

Materia dhe Bota materiale janë në ndryshim të vazhdueshëm.

Materia nuk është tjetër veçse lëvizje, energji.*

$$\oplus = \sim$$

Pjesët ndryshojnë.

Ndryshimet kanë një kufi.

Kufijtë ndryshojnë.

* Kjo edhe i dha mundësi Einsteinit të shkruante formulën: $\epsilon = mc^2$, do me thënë atë të shndrrimit të materies në energji, dhe anasjelltas.

$\bigcirc = -\bigoplus = -\sim$ E tëra nuk ndryshon.

$\infty = \sim$ Ligjet ndryshojnë.

Lëvizja është relative.

$2 = \sim$ Mund të flitet për dualitetin e lëvizjes.

$-1 = \sim$ Mund të flitet për negativitetin e lëvizjes.

... ..

Nxjerrim tani në "faktor" ($x = x$). Do të kemi ndër të tjera:

$\textcircled{1} = (x = x)$ Arsyeja është e metë.

Arsyeja ka një kufi tej të cilit nuk mund të zbatohet.*

$\textcircled{2} = (x = x)$ Është Arsyeja, mendja njerëzore ajo që krijon materien e Botën materiale.**

* Kanti provon se Arsyeja dhe ushtrimi i saj kanë një kufi, duke kapërxyer të cilin, ajo bie në kundërshtim me veten e vet (shih "*Antinomitë e Arsyës së Pastër*").

Fizika Kuantike na tregon se kapërximi i shpejtësisë së Dritës ($> c$) sjell me vete kalimin nga kodi F te kodi E, e pra mohimin e Arsyës a më saktë superimin e saj.

** Sipas Koestler (etj.), Bota nuk është veçse një Mendim i Madh (shih librin "*The Sleepwalkers: A History of Man's Changing Vision of the Universe*").

Sipas Berkley "*Esse est percipi*," që do të thotë me fjalë të thjeshta se *jemi ne, me shkisat tona, me mendjen tonë, që e krijojmë Botën, që ndryshe do mos qe*. Sipas fillosofisë së lashtë Indiane, Bota s'është gjë tjetër veçse një magji e *Maya-s* (*Mara-s* = Djallit). Pra ajo në realitet nuk ekziston.

- $\square = (x = x)$ Është Arsyeja ajo që fsheh, burgos parimin hyjnor, Zotin.
- $(x = x) = -(x = -x)$ Është mohimi i Qëndrës Mistike, shkurt i Zotit, ajo që bën të mundur krijimin e Botës.*
- $\leftrightarrow = (x = x)$ Arsyeja është shkaku i çdo entiteti material.**
- $\infty = (x = x)$ Arsyeja është relative.
Një dituri racionale do të jetë edhe *relative*.
(ose *Relativitet = Racionalitet*)***

...

E mund të vazhdojmë kështu gjatë duke përfutur *propozicione* të rëndësishme dhe *apodiktikisht të vërteta sepse të dedukuara llogjikisht*.

Lexuesi mund të provojë *dhe ai vetë*, pas shembullave që u dhanë këtu, të deduktojë nëpërmjet interpretimeve të simboleve, brenda spektrave të tyre semantikë, të tjera e të tjera pohime që depërtojnë në fusha të shumta të Dijes dhe në dimensione të ndryshme të Realitetit.

Edhe ai do të marrë pjesë kështu në këtë Euristikë *sui generis*.

Edhe sipas arritjeve më të fundit të Fizikës Moderne, Bota është një iluzion.

* Heideggeri në librin e tij "Was ist die Metaphysik?" thotë që *pa mohimin e Hiçit, krijimi i Botës do të ishte i pamundur*. Kjo mund të shkruhet algoritmikisht si: $-\bigcirc = -(x = -x) = (x = x) = \bullet \dots(F)$

** E pra: $(x = x) = \leftrightarrow = \bullet \dots(F)$

*** Rigjejmë kështu Hegelin.

Prania e Algoritmit Simbolik në Gjuhë

Ekuivalenca e dy simboleve përbën atë që ne kemi quajtur një *ekuacion simbolik*. Pamë disa të tilla më lartë. Ato dëshmonin, ndër të tjera, për praninë e Algoritmit në fusha të ndryshme të Dijes.

Algoritmi Simbolik është i pranishëm edhe në Gjuhë, në të gjitha gjuhët pa përjashtim, të vdekura (si Sanskritishtja, Greqishtja e vjetër, Latinishtja, etj. etj.) dhe të gjalla (si Shqipja, Italishtja, Inglishtja, Gjermanishtja, etj. etj.). Ekuacionet simbolike shtrohen nga Gjuha nëpërmjet gëfiteve homonimike a thujse-homonimike a kuptimeve të ndryshme të së njëjtës fjale (bisemi, trisemi...). Shembujt e shumtë që pasojnë do ta bëjnë të qartë përse është fjala.

Në Greqisht:

$$\begin{array}{ccccccc} -1 & = & 2 & = & \downarrow & = & \bullet & \dots(F) \\ \textit{kata} (\textit{κατά}) & \textit{kata} (\textit{κατά}) & \textit{kato} (\textit{κάτω}) & \textit{s-koto-s} (\textit{σκοτός}) & & & & \\ (\textit{kundër}) & (\textit{pas}) & (\textit{poshtë}) & (\textit{errësirë}) & & & & \end{array}$$

Në Shqip:

$$\begin{array}{ccccccc} \textcircled{1} & = & \neq 1 & = & 2 & = & \bullet & = & (\rightarrow\leftarrow) & \dots(F) \\ \textit{dasí} (\textit{daj}) & \textit{dìsa} & \textit{dys} & \textit{n-dyj} & \textit{n-desh-em} & & & & & \end{array}$$

Në Rusisht:

$$\begin{array}{ccccccc} 2 & = & \textcircled{1} & = & \bullet & = & \downarrow & = & \langle \dots \rangle & \dots(F) \\ \textit{dva} & \textit{delits} & \textit{delats} & \textit{dolloj} & \textit{daleko} & & & & & \\ (\textit{два}) & (\textit{делить}) & (\textit{делать}) & (\textit{долой!}) & (\textit{далеко}) & & & & & \end{array}$$

Po dhe në gjuhëra të tjera kemi të njëjtën gjë, gjë që do të përbënte një "*Consentio linguarum*" të fuqishëm e bindës të faktit se të gjitha gjuhët ngrihen, siç del në pah nga grupi i njëjtë i ekuacioneve të tyre simbolike, mbi të njëjtin Vizionin të Universit, që është, si më i lashti, ai i Mendimit Mistik...

Kështu për shembull:

	2	=	↔	...(F)
gjerm.	<i>dann</i>		<i>denn</i>	
	shq. <i>pas</i>		<i>pasi</i>	
	ital. <i>quindi</i>		<i>quindi</i>	
	frëngj. <i>puis</i>		<i>puis-que</i>	
	

	2	=	-1	...(F)
gjerm.	<i>wieder</i>		<i>wider</i>	
	ingl. <i>again</i>		<i>again-st</i>	
	shq. <i>prap</i>		<i>prap-sim</i>	
	ital. <i>ri-</i>		<i>ri-</i>	
	shq. <i>përsëritje</i>		<i>përtëritje*</i>	
	

	⊕	=	●	...(F)
skr.	<i>matra</i>		<i>matra</i>	
	(matje)		(materie)	
	shq. <i>ndarje</i>		<i>ndyrje</i>	
ital.	<i>determinare</i>		<i>deteriorare</i>	
	shq. <i>bë daj</i>		<i>bdaj</i>	
	shq. <i>pjesë</i>		<i>pis</i>	
	frëngj. <i>pièce</i>		<i>pis</i>	
	

* *përtëritje* = *krijim*... dhe dimë se shkaku i krijimit të Botës është një mohim:

$$-1 = \leftrightarrow = \bullet \quad \dots(F)$$

mohimi është shkaku i Botës

I mohuari është **1** (Njëshi), e pra \bigcirc , e pra $(x = -x)$, e pra Zoti.

Dhe ndër të tjera, Inglishtja dhe Shqipja, pozojnë:

2	=	●	=	↓	=	-○	=	⊕	...(F)
ingl.	<i>follow</i>	<i>filthy</i>	<i>fall</i>	<i>flaw</i>	<i>fall (away)</i>				
shq.	<i>filloj</i>	<i>fëlliq</i>	<i>falit</i>	<i>fela</i>					
ingl.	<i>dam (!)</i>			<i>dam</i>					
shq.	<i>ndjek</i>	<i>ndyj</i>		<i>ndaj</i>					

E kështu me radhë... për shumë e shumë gjuhë të tjera...

Pamë kështu një konkretizim, ndonëse jo të plotë (por që mund të bëhet lehtë i tillë), të konceptit të *Invariantit Ndërgjuhësor*, të cilit duhet ti binden pa përjashtim të gjitha gjuhët, ku termi "Gjuhë", siç kemi vënë në dukje dhe gjetiu, përfshin jo vetëm gjuhët e folura e të shkrojtura, të gjalla e të vdekura, por dhe çdo aktivitet a sistem tjetër njohës, siç është Shkenca, Fillosofia, Theollogjia e kështu me radhë...

Tërësia e figurave simbolike dhe ekuivalencave të tyre në F dhe në E

Me qenë se figurat simbolike në kodin F janë, ekuivalente mes tyre, mund të shkruajmë:

$$\begin{aligned}
 F &= (x = x) = \oplus = \bullet = -\circ = -1 = 2 = 1/2 = 5 \\
 &= (\rightarrow\leftarrow) = (\neq 1) = (-x = \boxed{x}) = \boxed{\circ} = (s \neq 0) = (t \neq 0) \\
 &= \downarrow = \leftrightarrow = (\uparrow \neq \downarrow) = \infty = \sim = (x^2 + y^2 = r^2) \\
 &= (x^3 + y^3 + z^3 = r^3) = \{F = -(F = E)\} = \dots
 \end{aligned}$$

Me qenë se: $E = -F$, do të kemi:

$$\begin{aligned}
 E &= -(x = x) = (x = x) = -\textcircled{1} = -\bullet = \bigcirc = \mathbf{1} = \\
 &-2 = -1/2 = -5 = -(\rightarrow\leftarrow) = -(\neq \mathbf{1}) = -\boxed{\bigcirc} = \\
 (s = 0) &= (t = 0) = -(\uparrow \neq \downarrow) = (\uparrow \neq \downarrow) = -\infty = -\sim \\
 &= (x^2 + y^2 = 0) = (x^3 + y^3 + z^3 = 0) = -\leftrightarrow = i \\
 &= (x = \boxed{x}) = \infty = \{E = (E = F)\} = \dots
 \end{aligned}$$

Ndonjë sqarim këtu është i nevojshëm.

1) Le të vërtetojmë p.sh. relacionin: $-1 = 2 = 1/2 = 5 \dots(F)$

a) Arithmetika Mistike na jep: $3 = 0$, që nga $(2 + 1 = 0) \rightarrow 2 = -1$

b) $(3 = 0) \rightarrow (3 + 2 = 2) \rightarrow (5 = 2)$; c) $1/2 = 0.5 = 0 + 5 = 5$

2) $\{F = (F \neq E)\}$ do të thotë ndër të tjera që F nuk komunikon me E, kurse $\{E = (E = F)\}$ do të thotë ndër të tjera se nga E (p.sh. Mbretëria Qiellore) mund të komunikosh me Mbretërinë Tokësore (F). Kështu Zoti mund të komunikojë e komunikon *de facto* në mënyrën e tij me njerëzit, por njerëzit nuk mund të komunikojnë (me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë e të jashtëzakonshëm) me Zotin.*

3) Simboli $(\neq \mathbf{1})$ do të thotë "jo një", "më shumë se një", "pluralitet". Relacioni $(\neq \mathbf{1}) = -1 = \bullet \dots(F)$ mund të interpretohet ndër të tjera si: "Pluraliteti (e pra sasia) është diçka negative (-1) e pra, si i tillë, diçka e keqe dhe materiale (\bullet). Kjo është dhe arsyeja që popujt shumë të lashtë e të lashtë, me llogjikën e tyre të *Tertium Datur* ($x = -x$),

* Shih edhe të thënat e Hermes Trimedistus, fq.116, 281, 325 dhe 357.

e nënvleftësonin, e përçmonin sasinë dhe nuk e përdornin atë ne "njehsimet" e tyre.

4) Simbolet $\uparrow = \downarrow$ dhe $x = \boxed{x}$ paraqesin transpozimin ('përkthimin') simbolik të të dy të thënave themelore të "Tabula Smaragdina": "Çfarë është lartë është dhe poshtë"... dhe "Çfarë është jashtë, është dhe brenda"... Këtë të thënë të fundit e gjejmë edhe në Kur'an, në krye të tij na thuhet: "Allahu është edhe e mbrendshmjia edhe e jashtmjia."* Që

* "God is the Outward and the Inward."

(Zoti është e Jashtmjia dhe e Brendshmjia [në të njëjtën kohë].)

(Kur'an, 57:3)

Sipas Algoritmit Simbolik kjo do të shkruhej:

$$x = \boxed{x} \quad \dots(E)$$

Do me thënë se Misticizmi Islamik pozon Qëndrën, ashtu siç bën dhe Misticizmi Hebrë kur thotë që: para se të krijohet Bota, Zoti ishte dhe infinit (∞) edhe hiç (0). Me fjalë të tjera, para se të krijohet Bota, Zoti përbënte zgjidhjen e ekuacionit ($x = -x$), zgjidhje që është, siç dimë, pikërisht ∞ dhe 0 .

Mirëpo ne mund të shkruajmë, gjithmonë sipas Algoritmit Simbolik:

$$(x = -x) = (x = \boxed{x}) \quad \dots(E)$$

që mund të shprehet me fjalë: Zoti është shka është brenda dhe shka është jashtë. Po ky është edhe një nga pohimet themelore të Misticizmit Islamik.

Dhe kujtojmë këtu, sërish nga Kur'ani (24:35):

"And God strikes similitudes for man and
God has knowledge of everything."

Dhe ky pohim i Misticizmit Islamik është i përkthyeshem në gjuhën e Algoritmit dhe madje i vërtetueshem në të. Dhe ja se si:

$$\text{similitude: } \cong = 1/2 = 0.5 = 5 = \boxed{1}$$

Ajo që vlen të vihët ré këtu është "hymnizimi" i analogjisë si i vetmi mjet për të njohur, gjer diku, të vërtetat hyjnore.

Mirëpo ne dimë se:

